

## PASQYRA E LËNDËS

PASQYRA E LËNDËS.....	I
Parathënie.....	III
Hyrje.....	VII
<b>1. Kreu I Tregimi si një pararendës i romanit në letërsinë e hershme.....</b>	<b>1</b>
1.1.Tregimet në vargje në letërsinë e vjetër turke.....	3
1.2.Tregimet në prozë në letërsinë klasike turke.....	7
1.3.Tregimet gojore.....	10
1.4.Tregimet popullore të shkruara.....	10
1.5.Tematika në tregimet popullore turke.....	19
<b>2. Kreu II Ndikimet e letërsisë botërore.....</b>	<b>23</b>
2.1.Romani në Perëndim.....	23
2.2.Fillimet e përkthimeve të romaneve perëndimore .....	25
<b>3. Kreu III Romancierët e parë në letërsinë turke.....</b>	<b>34</b>
3.1.Sami Frashëri.....	35
3.2.Namik Kemal.....	38
3.3.Ahmet Mid’hat Efendi.....	41
3.4.Rexhaizade Mahmut Ekrem.....	45
3.5.Nabizade Nadim.....	48
3.6.Halit Zija Ushakllëgil.....	49
3.7.Fatma Alije Hanëm.....	51
3.8.Emine Semije Hanëm.....	54
3.9.Mizanci Murad (Mehmet Murat Bey).....	56
<b>4. Kreu IV Tematika në romanet e hershme.....</b>	<b>59</b>
4.1.Periudha e parë e letërsisë së Tanzimatit.....	60
4.1.1. Romanet me tematikë shoqërore.....	61
4.1.2. Romanet me tematikë historike.....	72
4.1.3. Romanet aventurore.....	77
4.2.Periudha e dytë e letërsisë së Tanzimatit.....	84
4.2.1. Romanet me tematikë shoqërore.....	84
4.2.2. Romanet aventurore.....	130
4.2.3. Romanet policore.....	134
4.2.4. Romani politik.....	138
<b>5. Kreu V Tipologjia e personazheve.....</b>	<b>144</b>
5.1.Intelektuali.....	145
5.2.Bashkëshortja ideale.....	163
5.3.Gruaja punëtore.....	171
5.4.Sipërmarrësi.....	174
5.5.Prindi ose i afërmi.....	177

5.6.Trimi.....	181
5.7.Romantiku.....	186
5.8.Shkencëtari (studiuesi).....	188
5.9.Personazhi negativ.....	191
<b>6. Përfundime.....</b>	<b>198</b>
<b>7. Bibliografi.....</b>	<b>201</b>

## PARATHËNIE

### PËRLIGJJA E PUNIMIT

*Letërsia turke është një letërsi shumë pak e rrahur nga studiuesit shqiptarë. Me shkëputjen nga Perandoria Osmane në vitin 1912 merr fund sundimi gati 500-vjeçar osman dhe shqiptarët i drejtohen Evropës, si më e përparuar dhe moderne, për çdo ndryshim që dëshironin të bënin. Lidhjet me Lindjen u prenë thuajse krejtësisht. Pas një periudhe të gjatë shkëputjeje, si për shkaqe politike, ashtu edhe ekonomike e shoqërore, në fund të shekullit XX me hapjen e Shqipërisë ndaj botës, filluan, edhe pse jo në masë të madhe, të kujtoheshin lidhjet e vjetra. Letërsia turke nisi të njihet me përkthime sporadike. Punime të mirëfillta nga studiues shqiptarë në lidhje me letërsinë turke të shekullit XIX deri më sot nuk ka. Ka pasur studime për shkrimtarët me origjinë shqiptare, por jo një studim mbi një periudhë apo një gjini të veçantë të kësaj letërsie. Duke u nisur nga kjo pikë menduam që si temë studimi për mbrojtjen e doktoraturës të marrim fillimin e romanit në letërsinë turke, pasi fillimet e romanit në këtë letërsi shënojnë një pikë kthese duke e shndërruar atë nga një letërsi plotësisht lindore në një letërsi me tipare ose e thënë ndryshe me ndikim perëndimor.*

*Me këtë punim synojmë të japim një pasqyrë të gjerë të zanafillës së romanit si një gjini e re në letërsinë turke e cila përkon me atë që në historinë turke quhet Periudha e Tanzimatit në mesin e shekullit XIX. Do të përpiqemi të paraqesim zhvillimin e romanit në këtë periudhë kur shteti dhe shoqëria osmane po pësonte ndryshime thelbësore. Njohja më në detaje e romanit në fillimet e tij do të ndihmojë në konceptimin më të mirë të ndryshimeve letrare që do të ndikojnë në letërsinë moderne turke.*

*Duke thelluar njohuritë në këtë fushë do të kemi mundësi të njohim letërsinë turke të kësaj periudhe në kompleksitetin e saj dhe do të kemi mundësi ta shpjegojmë më mirë atë tek studentët që e studiojnë letërsinë e Tanzimatit gjatë programit të tyre mësimor.*

*Arsyeja e tretë lidhet me faktin se deri më sot një studim i kësaj natyre mungon në gjuhën shqipe dhe ky punim do të ndihmojë në njohjen e letërsisë moderne turke e veçanërisht të romanit, i cili i ka zanafillat e tij në letërsinë e Tanzimatit. Me anë të paraqitjes së romaneve dhe studimit të personazheve do të përpiqemi të japim kontributin tonë në njohjen e romaneve të para turke.*

### OBJEKTI I PUNIMIT DHE HIPOTEZAT

*Tema e punimit “Romani, një gjini e re në letërsinë e Tanzimatit” ka si objekt trajtimi fillimet e romanit në letërsinë turke. Ndonëse ka shumë punime në lidhje me romanin e periudhës së letërsisë së Tanzimatit, ato janë të fokusuara mbi një shkrimtar ose mbi disa romane të veçanta. Punimet e bëra mbi gjithë romanet e kësaj periudhe janë të pakta. Mund të përmendim atë të bërë nga amerikani Robert P. Finn<sup>1</sup> në fundin e viteve 1970, botuar në turqisht në vitin 1984. Një pjesë e studiuesve i kanë trajtuar romanet si pjesë e gjithë prodhimit letrar të periudhës së Tanzimatit, duke mos i kushtuar një rëndësi të posaçme.*

*Studimi i një numri të konsiderueshëm të romaneve të para, duke filluar nga i pari, “Dashuria e Talatit dhe Fitnatit”, botuar në vitin 1872, të cilin e pasojnë romanet “Intibah” dhe “Felatun Beu dhe Rakip Efendi” do jetë një përpyetje për të nxjerrë në pah zhvillimin e romanit, por edhe atë që është më e rëndësishme, formimin e personazheve kryesorë të tij, duke i larguar në pjesën më të madhe nga personazhet karakteristikë të prozës turke.*

<sup>1</sup> Finn, Robert P. “Türk Romanı (İlk Dönem: 1872-1900), Stamboll, 1984.

*Do të studiohen personazhet kryesorë të romaneve të autorit Ahmet Mid'hat Efendit, i cili për nga prodhimtaria e madhe në këtë fushë është konsideruar si babai i romanit turk. Në të njëjtën kohë do të studiohen në hollësi edhe personazhet e romaneve të autorëve të tjerë të kohës, siç janë Namik Kemal, Mizanxhi Murat, Fatma Alije Hanëm, Rexhaizade Ekrem etj.*

*Gjatë studimit do të jepen karakteristikat e personazheve duke specifikuar veçoritë e tyre, sidomos tek tipi i intelektualit ose ai i shkencëtarit dhe gruas punëtore, duke nxjerrë në pah risinë që sjellin autorët e romaneve të para në letërsinë turke.*

*Romani është një gjini e re e cila përfshihet në letërsinë turke më tepër si shkak i zhvillimeve politiko-shoqërore, sesa si një nevojë e vetë letërsisë. Megjithatë, ardhja e romanit nuk mund të konsiderohet si detyrim pasi, në njëfarë mënyre letërsia e deriatëhershme turke kishte filluar të konsumohej për shkak të mospërshtatjes të saj me zhvillimet politiko-shoqërore, si dhe të rregullave të ngurta të cilat nuk e lejonin të ndryshonte, ndaj mund të themi se ishte në kërkim të diçkaje që do ta rigjallëronte.*

*Ndonëse si gjini romani do të futet si një trup i huaj në letërsinë turke, ai do të marrë materialin bazë nga proza apo ajo që do e quajmë tregimi i vjetër turk. Tematika, një pjesë e konsiderueshme e personazheve dhe ambienti në shumicën e rasteve do të jetë i njëjtë me ato të tregimeve turke para periudhës së Tanzimatit.*

*Në të njëjtën kohë futja e personazheve të rinj dhe ndonjëherë largimi nga ambienti tradicional turk për t'i pozicionuar ngjarjet e romanit në Evropë, bëjnë që një pjesë e romaneve të para të mos kenë pothuajse asnjë lidhje me tregimin turk.*

*Duke u nisur nga këto pika do të ngremë hipotezën nëse është e vërtetë që romani turk ashtu siç pretendojnë një pjesë e studiuesve turq është një produkt pothuajse tërësisht i importuar nga Evropa Perëndimore apo kanë të drejtë pjesa tjetër e studiuesve turq më të rinj, të cilët i shohin rrënjët e romanit në tregimin e vjetër turk dhe ndikimin perëndimor si një ndikim anësor në të. Tematika dhe personazhet e romanit turk të kësaj periudhe janë të huaj apo janë të njohur për lexuesin?*

## STRUKTURA E PUNIMIT

*Punimi “Romani, një gjini e re në letërsinë turke të Tanzimatit” është konceptuar në 5 kapituj, të paraprirë nga hyrja dhe të ndjekur nga përfundimet e bibliografia.*

*Në kreun e parë kemi dhënë një panoramë të prozës (tregimit) në letërsinë turke që nga fillimet e saj duke, u përpjekur të paraqesim veçoritë që kanë, duke e ndarë në grupe. Zhvillimi i tregimit në letërsinë turke para periudhës së Tanzimatit është i lidhur në mënyrë të pashmangshme me letërsinë e Divanit, por edhe me letërsinë mistike fetare të teqeve. Të dyja këto letërsi janë të lidhura ngushtë me letërsinë arabe dhe perse. Kjo sjell edhe ndikimin e fortë të letërsisë arabe dhe perse në këtë tregim. Ambienti ku zhvillohet ngjarja, personazhet dhe stili janë ndikuar nga këto letërsi.*

*Një pjesë e tregimeve të kësaj periudhe janë variante të ndryshuara të tregimeve origjinale arabe dhe perse, por që i kanë tejkaluar duke u bërë më të famshme se origjinalet, siç është rasti i “Lejla dhe Mexhnun” i poetit të famshëm Fuzuli. Një veçori e tregimit të kësaj periudhe është edhe tregimi në vargje në letërsinë popullore.*

*Në kreun e dytë do të japim një renditje të përkthimeve të romaneve nga letërsia perëndimore duke dhënë edhe shpjegime për mënyrën e përkthimit dhe përzgjedhjen e këtyre romaneve.*

*Në kreun e tretë të punimit do të jepen jetët dhe veprat e romancierëve të parë turq. Paraqitja e jetës, principeve, karakterit dhe veprave të shkrimtarëve në kompleksitetin e tyre jep një pasqyrë të gjerë të zhvillimit të romanit në fazat e para në letërsinë turke.*

*Edukimi dhe arsimimi i Sami Frashërit, Namik Kemalit, Ahmet Mid’hatit dhe shkrimtarëve të tjerë tregon arsyen se pse këta shkrimtarë i jepnin një rëndësi të veçantë edukimit të lexuesit nëpërmjet veprave të tyre. Nëpërmjet jetës së bërë dhe veprave të shkruara ata do të jenë pasqyra e vërtetë e ideve në të cilat besojnë ku në plan të parë është humanizmi. Humanizmi si ide ka ekzistuar në fenë islame sidomos tek poetët e sektit Mevlevi apo edhe tek sekte të tjera, por tek këta shkrimtarë të shekullit XIX gjejmë një humanizëm të bazuar në rilindjen Evropiane. Pjesëmarrja e shkrimtarëve në mënyrë aktive jo vetëm në jetën artistike dhe intelektuale por edhe në atë politike është një tipar që e karakterizon gjithë këtë periudhë. Shkrimtarët e kësaj periudhe përveç se merren me letërsi, japin mendimet e tyre edhe në fusha të tjera si ekonomia, tregtia, administrata publike (burokracia), drejtësia (të drejtat e njeriut, në veçanti të femrës), skllavëria, bujqësia, kultura etj. Parë nga kjo pikëpamje këta shkrimtarë janë të gjithë iluministë.*

*Në kreun e katërt kemi paraqitur romanet e para turke duke i renditur sipas tematikës. Pasi të japim një paraqitje të fillimit të romanit të parë turk në vija të përgjithshme do të japim përmbledhjet e romaneve duke dhënë nga një shpjegim të shkurtër në fillim të çdo përmbledhjeje. Për shkak të numrit të madh të romaneve jemi përpjekur të japim përmbledhjet e atyre romaneve që sjellin një të re në letërsinë turke siç janë romanet romantik, historik, policesk etj. Shumica e romaneve janë të shkrimtarit Ahmet Mid’hat Efendi pasi ai e ka merituar me të vërtetë titullin “babai i romanit turk” me gati 36 romane të shkruara gjatë dyzet viteve të jetës së tij artistike (rreth 30 gjatë periudhës së letërsisë së Tanzimatit).*

*Duke dhënë përmbledhjet e romaneve do të kemi përfuar një panoramë të përgjithshme të kësaj gjinie të re në letërsinë turke. Në përmbledhjet e romaneve do të shohim si ndikimin e tregimit të vjetër në letërsinë turke, ashtu edhe ndikimin e letërsisë perëndimore, sidomos të asaj franceze.*

*Në kreun e pestë do të studiojmë tipologjinë e personazheve në romanet e hershme turke duke i grupuar sipas veçorive të tyre. Grupi i parë i personazheve është ai i intelektualit. Me cilësitë e tij të shumta ai është pa diskutim tipi dominues në romanet e para të letërsisë turke. Si një personazh ku mblidhen gjithë cilësitë më të mira të njeriut ai është*

*përfaqësuesi i njeriut ideal që romancierët e parë turq dëshirojnë t'ia imponojnë shoqërisë osmane të kohës. Një personazh i edukuar si me mënyrën lindore, ashtu edhe me mënyrën perëndimore duke marrë më të mirat nga të dyja qytetërimet. Tipi i intelektualit është i zgjuar, i edukuar, i sjellshëm, i kulturuar, mendjehapur, tolerant, i ndjeshëm etj.*

*Tipi i gruas ideale është krijuar për të plotësuar personazhin ideal. Ajo ka të njëjtat cilësi me të por në një nivel më të ulët. Përgjithësisht ajo edukohet nga personazhi intelektual sipas të njëjtës mënyrë.*

*Prindi është në shërbim të edukimit të personazhit intelektual. Ai mund të mos jetë i arsimuar por ka një besim të fortë në lidhje me mënyrën se si duhet të edukojë fëmijën. Përgjithësisht përfaqësohet nga nëna ose dadoja dhe në disa raste edhe nga kushërinjtë. Tipari kryesor i tij është shpirti sakrifikues.*

*Tipi i gruas punëtore është shumë i rralla në romanet e para turke. Kjo ndoshta për shkak të mentalitetit të kohës që nuk lë shumë vend për të shfaqur idetë e shkrimtarëve. Megjithatë ky tip është një prurje e re në letërsinë turke të Tanzimatit.*

*Tipi i sipërmarrësit është një personazh i ndikuar nga letërsia perëndimore dhe ka detyrën e sensibilizimit të shoqërisë Osmane për të marrë në dorë frenat e tregtisë dhe industrisë. Kontrollin e të cilës e kishin jomuslimanët.*

*Tipi i trimit është një personazh me historik të gjatë në letërsinë turke. Rrënjët e tij arrijmë deri në letërsinë e hershme turke të periudhës para pranimit të fesë Islame. Por personazhi i tanishëm në vend të shpatës preferon penën. Ai lufton për atdheun dhe popullin, mbron të varfërit dhe të pambrojturit. Në fakt ky personazh i ngjan shumë intelektualit, por dallohet nga misioni që merr përsipër.*

*Një tip tjetër i marr nga tradita është personazhi romantik. Ky personazh nuk ka ndonjë ide për të transmetuar. Ai është një personazh i dashuruar që ia dedikon gjithë jetën dashurisë pa e vrarë mendjen për pasojat. Ky është një tip me ndikim të madh nga letërsia e Divanit por në të mund të dallohen edhe tipare të romantikut Evropian.*

*Tek studimi që bëjmë mbi personazhet negativ dallojmë dy tipa kryesor. Personazhin negativ të arsimuar sipas mënyrës perëndimore por që e merr përciptazi duke u bërë gazi i botës dhe personazhin që edukohet sipas mënyrës tradicionale por që mbetet peng i besëtytnive. Që të dy këto personazhe kanë si detyrë kryesore të nxjerrin më në pah personazhet pozitivë të përfaqësuar me personazhin intelektual.*

*Në fund të punimit do të japim përfundimet të cilat do të përmbledhin gjithë punën e bërë duke nxjerrë në pah veçoritë e fillimeve të romanit turk duke u bazuar mbi personazhet e studiuar.*

*Për shkak të temës, e cila është fokusuar e gjitha në një pjesë specifike të letërsisë turke gjithë bibliografia e shfrytëzuar ka qenë turke përveç disa veprave të autorëve të huaj por që janë shfrytëzuar nëpërmjet përkthimeve të tyre në turqisht pasi janë botime të cilat nuk kemi mundur t'i gjejmë në origjinal.*

## HYRJE

*Periudha e Tanzimatit është një nga periudhat më të rëndësishme të letërsisë turke pasi përfaqëson fillimin e ndikimit të letërsisë perëndimore në këtë letërsi. Kjo periudhë e merr emrin për shkak të dekretit perandorak të shpallur më 3 nëntor 1839. Tanzimat do të thotë riorganizim dhe është një tentativë e Perandorisë Osmane për të riorganizuar sistemin e saj administrativ dhe qeverisës. Kjo përpjekje për riorganizim nuk ka qenë e para dhe as e vetmja në historinë e shtetit osman. Reformat në fushën ushtarake kanë filluar shumë më herët.*

*Pas marrëveshjes së Karlofçës në vitin 1699 Perandoria Osmane fillon të marrë të tatëpjetën. Deri atëherë marrëdhëniet mes shtetit osman dhe Perëndimit kishin qenë të kufizuara. Gjatë shekujve XVI-XVIII shteti osman pothuajse kishte mbetur në vend numëro, ndërsa Evropa Perëndimore kishte filluar të ndryshonte gjithmonë e më me shpejtësi duke u zhvilluar me hapa galopantë. Ndonëse zhvillimet në Evropë nuk ishin të fshehta ndaj shtetit osman ato ishin parë me indiferentizëm. Vëzhgimet e para në Evropë i bëjnë Evlija Çelebi, gjatë kohës që shërbente si sekretar pranë Kara Mehmet Pashai, gjatë udhëtimit të tij si ambasador i Sulltanit në Vjenë dhe Çelebi Mehmeti XXVIII që shkon si ambasador në Paris gjatë sundimit të Sulltanit Ahmeti III (viti 1694).*

*Perandoria Osmane, pasi kuptoi nevojën për ndryshim dhe adaptim të zhvillimeve të reja, fillon një sërë reformash pa ndonjë plan të detajuar, shumicën e të cilave në ushtri. Shumë dështime i pasojnë këto tentativa për reforma gjatë shekullit XVIII. Vetëm pas mbylljes së repartit të jeniçerëve në vitin 1826 hapet mundësia për të kryer reforma më të thella.*

*Përveç reformave në ushtri hapen shkolla në fusha të ndryshme të shkencave. Me shpalljen e dekretit perandorak të Tanzimatit që ndryshe quhet edhe Gülhane Hatt-ı Hümayun (Dekreti i kopshtit me trëndafila, për shkak të shpalljes së tij në këtë kopësht), popullsisë turke por edhe pakicave u jepen disa të drejta që i ishin mohuar më parë.*

*Rëndësia e këtij dekreti, më shumë se tek të drejtat që jep, është tek fryma e re dhe evropiane që sjell. Qytetërimi perëndimor do fillojë të depërtojë në venat e shoqërisë Osmane pak nga pak. Hapen shkolla sipas sistemit evropian siç janë Encümeni Daniş (Akademia e Shkencave), shkolla e administratës apo shkolla e Gallatasarait etj.*

*Ajo që do t'i hapë rrugën zhvillimit të letërsisë nën ndikimin perëndimor do të jetë hapja e gazetave. Gazeta e parë e hapur në vitin 1860, Tercüman-ı Ahval do të vazhdojë të botohet me ndërprerje derë në vitin 1896. Gazeta të tjera si Tasvir-i Efkar, Muhbir, İbret, Devir dhe Tercüman-ı Hakikat do të hapen e mbyllen, por për aq kohë sa do të jenë të hapura do të jenë një derë e hapur për shkrimtarët për të transmetuar mendimet e tyre nëpërmjet veprave si dhe informimin e shoqërisë<sup>2</sup>. Pikërisht në këto gazeta do të rriten dhe do të formohen romancierët e parë si Sami Frashëri, Ahmet Mid'hati dhe Namik Kemali.*

*Gazetat e hapura kanë një rol shumë më të rëndësishëm sesa formimin e shkrimtarëve. Gazetat krijojnë dhe më pas formojnë publikun e nevojshëm për të thithur të rejtat që do të sjellin këta romancierë. Pa këtë shtresë lexuesish asnjë nga shkrimtarët turq nuk do të arrinte të transmetonte mendimet e tij.*

---

<sup>2</sup> Korkmaz, R. Yeni Türk Edebiyatı 1839-2000, Ankara, 2007, f. 27.

Megjithatë, nuk duhet të presim shumë nga kjo shtresë lexuesish. Ndonëse shkrimtarët janë në një nivel më të lartë intelektual shtresa e lexuesve është ende shumë e ndikuar nga tradita lindore. Për këtë arsye shkrimtarët e periudhës së Tanzimatit ishin të detyruar t'i përshtateshin kushteve të kohës.

Letërsia e Tanzimatit ka një rëndësi të veçantë në letërsinë turke. Pas më shumë se dhjetë shekujsh ndikim nga letërsia perse dhe arabe, letërsia turke hapet ndaj një letërsie të re, asaj perëndimore. Për të kuptuar sa më mirë rëndësinë e kësaj letërsie duhet të hedhim një vështrim të shkurtër mbi zhvillimin e letërsisë turke.

Letërsia turke fillon që në kohët e lashta por dokumentat e para të shkruara i gjejmë në shekullin VIII. Në disa obeliskë në fushat e Mongolisë së sotme gjejmë të shkruar me një alfabet unik "Shkrimet e Gökturkve" ku përveç se jepen të dhëna historike kemi edhe pasazhe me poezi dhe tregime. Pas këtyre shkrimeve kemi shkrimet të periudhës Ujgure<sup>3</sup> në mesin e shekullit VIII deri në mesin e shekullit IX. Nëse "Shkrimet Gokturke" ishin produkt i pastër i letërsisë turke, duke filluar nga Ujgurët, në letërsinë turke do të shohim gjithmonë ndikimin e letërsive të tjera. Në letërsinë Ujgure dallohet ndikimi Tibetin pasi shteti Ujgur pranon fenë budiste dhe manehiste. Megjithatë zhvillimin më të madh letërsia turke do ta marrë pasi populli turk të fillojë të pranojë fenë islame në shekujt X-XI. Me pranim e fesë islame letërsia turke do të futet nën ndikimin arab dhe pers. Për herë të parë letërsia turke do të pësojë një ndarje brenda saj. Letërsia turke ndahet në dy degë të rëndësishme.

1.Letërsia e Divanit ose e thënë ndryshe letërsia e kastës së lartë apo letërsia e përzgjedhur.

2.Letërsia Popullore e cila vetë ndahet në tri pjesë:

2.1.Letërsia e Teqes dhe Misticizmit

2.2.Letërsia e Ashikëve. (Letërsia popullore)

2.3.Letërsia Anonime.

Kjo ndarje sjell edhe ndryshime në mënyrën e bërjes letërsi për gjatë 10 shekujve deri në fillimet të shekullit XX. Ndikimi pers dhe arab do të mbizotërojë si në stil ashtu edhe në përmbajtje. Një gjuhë e mbushur me fjalë arabe dhe perse si dhe një rregull i fortë në strukturën e letërsisë do të mbizotërojë në këtë periudhë. Divan, mesnevi, gazel, kaside janë disa nga stilet e reja të poezisë të futura në letërsinë turke.

Me hapjen e shtetit ndaj ndikimit perëndimor në mesin e shekullit XIX do të fillojë edhe prurja e fundit e madhe në letërsinë turke. Hapja ndaj qytetërimit perëndimor do të sjellë futjen e letërsisë perëndimore në shtetin osman. Gjini të reja do të futen në letërsinë turke. Këto janë: romani, teatri, kritika letrare, poezia dhe tregimi sipas modelit evropian.

Fillimet e këtij ndikimi dallohen për herë të parë në letërsinë e periudhës së Tanzimatit. Ndonëse letërsia e Tanzimatit nga shumë studiues përcaktohet mes viteve 1860-1896, ajo vazhdon deri në 1900-1901. Pas periudhës së letërsisë së Tanzimatit vijnë me radhë "Serveti-Funun" (1896-1901), "Fecri At-i"(1909-1912), "Milli Edebiyat" (1911-1923) dhe e

---

<sup>3</sup> Shteti ujgur ka ekzistuar në vitet 740-840 në Lindjen e Mesme dhe është një nga shtetet e para turke i cili zëvendësoi shtetin gökturk.



*fundit "Periudha e Republikës" (1923 e në vazhdim) e cila do të ndahet më pas në grupe të tjera më të vogla.*

*Detyra kryesore që do të marrë përsipër letërsia e Tanzimatit është përgatitja e lexuesit turk për këtë lloj të ri letërsie. Veprat e kësaj periudhe janë të karakterizuara nga dëshira e shkrimtarëve për të edukuar shoqërinë. Kjo dukuri ndodh pasi shkrimtarët janë njëkohësisht edhe iluministë.*

*Romani është një nga gjinitë më të përdorura për të transmetuar mendimet e shkrimtarëve për edukimin e shoqërisë Megjithatë, romani i kësaj periudhe nuk është akoma një roman tipik që mund të krahasohet me romanet evropiane apo edhe me ato të Evropës lindore. Ai është në hapat e parë, për më tepër romani nuk kishte një themel të shëndoshë ku të zhvillohej. Shoqëria Osmane nuk ishte e formuar mbi të njëjtat klasa që ishte formuar shoqëria perëndimore. Në fenë Islame nuk pranohej marrëdhënia shoqërore që qëndron në themelin e romanit. Ndërsa në roman kemi njeriun në qendër të ngjarjeve, në letërsinë turke vendin kryesor e zinte fataliteti. Romani në letërsinë Evropiane lind pak nga pak gjatë periudhës kur Evropa kalonte nga feudalizmi në borgjezi. Kjo gjë nuk kishte ndodhur në shoqërinë Osmane pasi klasa borgjeze jo vetëm që nuk krijohet pak nga pak me kalimin e kohës por është e huaj ndaj konceptit perëndimor borgjez. Kjo, pasi klasa borgjeze e formuar në Turqi, përbëhet nga funksionarë shteti apo pasanikë pronash, dhe jo nga tregtarë të mirëfilltë. Ndoshta për këtë arsye romanet e para turke ngjajnë më shumë me tregimet sesa me romanet e mirëfillta.*

*Gjatë punimit do të shohim se romanet e para turke kanë ngjashmëri me tregimet popullore. Kjo ngjashmëri ndodh për dy arsye kryesore. E para, lexuesi i ri turk vetëm duke përdorur tregimet tradicionale si pikë reference mund të ambientohet me këtë gjini të re dhe e dyta është vetë edukimi i marrë nga romancierët e parë turq që i bënë ata më të predispozuar për t'u mbështetur tek tradita e tregimit në letërsinë turke.*

*Me gjithë mbështetjen tek tregimi tradicional turk, romancierët e parë në veprat e tyre do të fusin tipare të romanit perëndimor, sidomos tek personazhet kryesorë. Ndikimi perëndimor do të jetë i dyfishtë. Nga njëra anë do pranohen të mirat e Perëndimit duke ia veshur këto cilësi personazheve pozitive dhe nga ana tjetër do goditen të këqijat e tij duke ia veshur cilësitë e këqija personazheve negativë.*

*Me këtë punim synojmë të sjellim një paraqitje sa më të gjerë të fillimeve të romanit në letërsinë turke të periudhës së Tanzimatit duke u fokusuar në dy pika. Në tematikën e prekur nga romancierët e parë turq dhe në personazhet tipikë që dallojmë në këto romane sipas veçorive të përbashkëta të tyre.*

*Si përfundim, do doja të falënderoja udhëheqësen shkencore të punimit, Prof.As.Dr. Ludmilla Myrtajn, për ndihmën e dhënë në realizmin e këtij punimi.*

## KREU I

### TREGIMI SI NJË PARARENDËS I ROMANIT NË LETËRSINË E HERSHME

Në letërsinë e vjetër turke tregimi, ndryshe nga poezia që ndahej sipas klasave shoqërore,<sup>1</sup> zë një vend të veçantë, qoftë për nga lashtësia, ashtu edhe për nga shtrirja në të gjithë masën e lexuesve. Megjithatë, për fatin tonë të keq, në ditët e sotme nuk kanë arritur shumë dokumente të shkruara, pasi edhe ato pak shkrime të letërsisë së vjetër turke që janë gjetur a zbuluar deri më sot, përgjithësisht janë në vargje.

Shkaku kryesor i kësaj gjendjeje është jetesa nomade që bënëin fiset turke duke mos pasur vendbanime të përhershme ku mund të zhvillohej shkrimi, deri në fillimet e shekullit VII. Në krye të herës tregimet mbijetonin në formën e përrallave, legjendave ose eposeve duke kaluar gojë më gojë nga njëri brez në tjetrin. Ndryshimi rrënjësor fillon me pranimin e fesë islame.

Pas pranimit të fesë islame nga pjesa më e madhe e popullsisë turke, në fillim të shekullit X<sup>2</sup> dhe me përdorimin e alfabetit arab nga shkrimtarët turq kemi një përmirësim në lidhje me këtë zhanër të letërsisë. Bashkë me pranimin e fesë islame dhe përdorimin e alfabetit arab, për fatin e saj të keq letërsia turke futet edhe në një proces ndikimi të pashmangshëm, madje gati të një asimilimi të plotë nga letërsia perse dhe arabe, duke bërë që letërsia turke të humbasë një pjesë të identitetit të saj shekullor. Ndonëse poezia dhe proza turke humbën disa nga tiparet kombëtare të tyre (për shembull krijimi i një varianti sipas islamit i eposit të Oğuz Kağanit i cili është një nga eposet më të vjetra në letërsinë turke) ato fituan shumë nga trashëgimia dhe eksperiencia shekullore e letërsisë perse dhe asaj arabe.

Nga fillimi i shekullit të XI kemi shkrimet e para me alfabet arab në letërsinë turke. Duke filluar nga kjo periudhë ne kemi mundësinë të shohim edhe zhvillimin e letërsisë turke në përgjithësi dhe të prozës në veçanti. Shkrimet e para janë Kutatgu Bilig, Divan-i Lugat-it Türk ve Atabetül Hakayık.

Tipari kryesor i kësaj letërsie turke, të ndikuar nga letërsia arabe dhe perse, është ndarja për herë të parë e saj në dy grupime të mëdha; letërsia turke e kastës së lartë, e cila nga një pjesë e studiuesve përcaktohet si letërsia e Divanit<sup>3</sup> ose letërsia klasike dhe letërsia popullore. Tiparet kryesore ku ndryshojnë këto dy grupime të letërsisë turke janë ambienti ku zhvillohen dhe gjuha e përdorur.

Letërsia e Divanit zhvillohet pranë medreseve dhe shkollave të qyteteve nga persona të mirëpërgatitur. Ata përveç turqishtes që e kishin gjuhën amtare dinë shumë mirë arabisht dhe persisht, kurse letërsia popullore zhvillohet në fshatra dhe pranë

---

<sup>1</sup> Poezitë e Divanit ose thënë ndryshe poezitë klasike, pëlqeheshin dhe kuptoheshin vetëm nga klasa e dijetarëve dhe e pushtetarëve të arsimuar mirë; poezitë e ashikve ishin për masat e gjëra të popullit, ndërsa letërsia e teqeve ishte më tepër për klasën fetare.

<sup>2</sup> Për pranimin e fesë islame nga popullata turke përgjithësisht pranohet viti 910, kur kryetari i shtetit të karahanëve pranoi konvertimin në fenë islame e bashkë me të e pranuan edhe 10 000 çadra, ose përafërsisht 40 000 njerëz.

<sup>3</sup> E quajtur kështu për shkak të librit ku mblidheshin veprat e poetëve të kësaj letërsie që quhej Divan.

teqeve, në rastin më të mirë nga persona që dinin shkrim e këndim, por që në përgjithësi ishin analfabetë ose autodidaktë. Nga kjo ndarje vjen edhe tipari tjetër kryesor që i dallon këto dy degë të letërsisë turke që është gjuha e përdorur. Në letërsinë e Divanit shohim një ndikim të madh të gjuhës perse dhe asaj arabe, madje deri në atë pikë sa në periudha të veçanta zor se dallohet gjuha turke. Në letërsinë popullore dallojmë një gjuhë më pranë popullit. Edhe kjo letërsi popullore me kalimin e kohës ndikohet nga gjuhët arabe dhe perse, por asnjëherë në atë nivel të letërsisë së Divanit.

Tregimet e para të letërsisë popullore turke në Turqinë e sotme përgjithësisht pranohen se janë në fillimet e shekullit XV<sup>4</sup>. Tregimet popullore përgjithësisht pranohen si pasardhës të eposeve dhe si paraardhës të romanit, duke luajtur rolin e romanit në letërsinë turke deri në shekullin XIX.<sup>5</sup> Tregimet që rrëfohen nëpër kafenetë e qyteteve janë shumë të ngjashme me romanet e para turke.

E parë nga ky këndvështrim tregimtaria turke deri në periudhën e Tanzimatit mund të klasifikohet ashtu siç ka bërë Mustafa Ozon:

1. Tregimet në vargje të letërsisë klasike turke (Letërsia e Divanit)
2. Tregimet në prozë (shkrim i drejtë, jo në vargje) të letërsisë klasike turke
3. Tregime popullore të shkruara
4. Tregime popullore gojore
5. Tregime të ndryshuara sipas nevojave të shoqërisë<sup>6</sup>

Edhe pse i ndajmë në këtë mënyrë, ne shohim se tregime të grupeve të ndryshme kanë marrëdhënie mes njëri-tjetrit, megjithëse dallohen në veçori të tjera, si tematika ose përndarja gjeografike. Sipas tematikës ato ndahen në tri grupe. Tregimet me temë dashurinë, me temë trimërinë (heroizmat), aventurën dhe me temë të përzier dashuri dhe trimëri.<sup>7</sup>

Po ashtu edhe brenda të njëjtit grupim mund të gjejmë nëndarje si për shembull tregimet popullore të kaluara gojë më gojë mund t'i ndajmë në tregime popullore, përralla dhe tregimet Meddah<sup>8</sup>.

---

<sup>4</sup> Türkmen, F. Aşık Garip Hikayesi Üzerinde Mukayeseli Bir Araştırma, Ankara, 1974, f. XII.

<sup>5</sup> Türkmen, F. Aşık Garip Hikayesi Üzerinde Mukayeseli Bir Araştırma, Ankara, 1974, f. XI.

<sup>6</sup> Özön, M. Türkçede Roman, Stamboll, 2009, f. 46.

<sup>7</sup> Oguz, M. Ocal (grup autorësh), Turk Halk Edebiyatı El Kitabı, Ankara, 2005, f. 139.

<sup>8</sup> Tregime të rrëfyera nëpër kafenetë e qyteteve.

## 1.1 Tregimet në vargje në letërsinë e vjetër turke

Tregimet në vargje janë një produkt i letërsisë turke i ndikuar pothuajse tërësisht nga letërsia perse, pasi turqit pranuan në masë fenë islame. Me pranim e fesë islame turqit filluan të pranonin edhe qytetërimin islam duke hequr dorë pak nga pak nga mënyra e tyre e vjetër e jetesës., por edhe brenda qytetërimit islam kemi dy ndarje të mëdha: qytetërimin islam sipas mënyrës arabe dhe atë sipas mënyrës iraniane. Turqit pranuan modelin iranian që e kishin më pranë gjeografikisht. Bashkë me qytetërimin, në fillimet e tyre, ata pranuan më shumë letërsinë iraniane (perse), sesa atë arabe.

Letërsia iraniane ndikoi shumë në poezi duke bërë ndryshime radikale në formë dhe në përmbajtje, por përveç kësaj ajo solli edhe një formë të re tregimi, i cili quhet tregimi në vargje. Tregimi në vargje ishte i ndikuar nga rregullat që përdorshin dhe kërkoheshin në poezinë klasike. Po ato teknika dhe mënyra që një poet i përdor për t'iu drejtuar të dashurës së tij, është i detyruar të përdorë edhe tregimtari në veprën e tij.

Mustafa Nihat Özön në librin e tij “Türkçede Roman” e shpreh kështu këtë rregull:

“Është e pamundur t'i ndajmë këto tregime nga botëkuptimi i poezisë së letërsisë tonë klasike. Në një gazel<sup>9</sup>, poeti tregon me mjeshtërinë e tij në përdorimin e fjalëve dhe shprehjeve të duhura, dashurinë, dhembjen për ndarjen nga e dashura, një pamje frymëzuese ose emocionin e bashkimit me të dashurën. Po ashtu në mesnevi<sup>10</sup> ku ke mundësi të shprehesh më gjerë e gjatë je i detyruar të përdorësh të njëjtat rregulla. Madje në një gazel duke qenë se nuk ka një detyrim mbi bashkimin e temës mund të ketë edhe ndonjë gabim të vogël në shkrim, por kjo do të binte menjëherë në sy tek një mesnevi.”<sup>11</sup>

Tipari kryesor i këtij lloji tregimi në vargje është ndikimi shumë i madh i tregimeve perse dhe arabe tek tregimet turke. Në një pjesë të rasteve shkrimtarë të mëdhenj turq kanë shkruar variante të ndryshme të një tregimi arab ose pers ndonjëherë duke dhënë edhe versione më të mira ose më të famshme siç është rasti i mesnevisë “Lejla dhe Mexhnuni”, një tregim arab i shekullit X, të shkruar nga Fuzuli në vitin 1535. Edhe sot e kësaj dite varianti i Fuzulit mbahet si më i arriri.

Tregimet e letërsisë së Divanit janë : Lejla dhe Mexhnun, Jusufi dhe Zylejla, Hysrevi dhe Shirini, Hysniu dhe Dashuria, Trëndafili dhe Bilbili, Vamiku dhe Azra, Shahu dhe Geda, Mihri dhe Mah, Trëndafili dhe Nevruzi, Edemi dhe Huma, Vejsi dhe Ramini, Xhani dhe Xhanani, Ëndrra dhe Dashuria, Shemi dhe Perivani, Ahmeti dhe Mahmuti.

Këtu do të japim përmbledhjet e disa prej tregimeve më të spikatura:

<sup>9</sup> Poezi e shkurtër në letërsinë klasike që përgjithësisht ka në qendër të saj dashurinë.

<sup>10</sup> Tregim i gjatë në vargje në letërsinë klasike turke.

<sup>11</sup> Özön, M. Türkçede Roman, Stamboll, 2009, f. 46.

## **Bukuria dhe Dashuria**

Në fisin e Bisedës jetonte një djalë me emrin Dashuri dhe një vajzë me emrin Bukuri. Ata ndiqnin mësimet e Molla Xhynunit në shkollën e Etikës. Shëtisnin në kopshtin e mirëkuptimit duke i rënë rreth e qark shatërvanit të shkollimit. Pronari i këtij kopshti ishte Fjala. Ajo i ndihmonte të kuptoheshin dhe t'i shprehnin hallet njëri-tjetrit. Herë herë u futej në mes Çudia dhe i ndalonte të flisnin. Dadoja e Bukurisë quhej Ndershmëri ndërsa dadoja (Lala) e Dashurisë quhej Durim. Ato mundoheshin t'i ngushëllonin. Dashuria me Bukurinë dëshironin të martoheshin, por të parët e fisit thoshin se nuk mund të bëhej menjëherë dhe se duhet të kalonin disa prova.

Ata vihen në prova shumë të vështira. Në fillim njihen me Dyshimin, pastaj me Xhelozinë dhe më pas i ndjek Braktisja dhe Urrejtja, por në fund takohen me Faljen dhe Pajtimin dhe Zoti i bashkon edhe pse ndjek një rrugë shumë të vështirë e të përpjetë.

## **Lejla dhe Mexhnuni**

Djali me emrin Kajs nga fisi i Ben Amirit dhe vajza me emrin Lejla duheshin që në bankat e shkollës fillore. Kur familja e Lejlasë mëson për këtë dashuri, e largon atë nga shkolla. Kajs tronditet shumë nga kjo gjë dhe fillon të sillet çuditshëm. Për shkak të kësaj sjelljeje dhe për shkak se familjet e dy të rinjve ishin në hasmëri, familja e vajzës nuk pranon t'ia japë Kajsit Lejlën për grua. Kjo bën që Kajs të bëhet edhe më keq. E dërgojnë edhe te varri i profetit, por ai nuk përmirësohet. Kur e shohin që nuk ka më shpresë për ta shëruar, e lënë në punë të vet. Kajs duke marr emrin Mexhnun fillon të shëtisë nëpër shkretëtirë.

Edhe Lejlaja vuan nga ndarja, por është e detyruar të martohet me Ibn Selamin, burrin që ia kishte gjetur babai. Gjatë shëtitjeve nëpër shkretëtirë ai njihet me Nevfelin, kryetarin e një fisi, i cili i ndikuar nga poezitë shumë të dhimbshme të Mexhnunit vendos t'i kërkojë babait të Lejlasë dorën e vajzës për Mexhnunin. Kur ai nuk pranon, Nevfeli i shpall luftë fisit të Lejlasë. Edhe pse po të fitonte, Nevfeli do bashkohej me Lejlanë, Mexhnuni nuk mund të pranojë që fisi i Lejlasë të mundet dhe lutet që të fitojë fisi i saj. Zoti ia dëgjon lutjen dhe fisi i Lejlasë fiton.

Pas kësaj lufte Lejlaja martohet me Ibn Selamin, por ajo nuk pranon të flejë me burrin e saj. Mexhnuni dëshpërohet shumë kur mëson për martesën e Lejlasë, por i vjen buzëqeshja kur mëson se ajo nuk prante të shkonte pranë burrit të saj. Falë lutjeve të tij të dëshpëruara Ibn Selami vdes. E lirë pas vdekjes së burrit të saj Lejla fillon të kërkojë Mexhnunin., por kur ajo e gjen, ai i verbuar nga dashuria platonike nuk e njeh Lejlanë njerëzore. E shkatërruar shpirtërisht Lejlaja kthehet në shtëpi dhe pak kohë më pas vdes nga dëshpërimi. Mexhnuni kur e dëgjon lajmin i shkon tek varri dhe vdes mbi varrin e saj. Zejdi, shoku i Mexhnunit i varros bashkë dy të dashëruarit dhe ndërton një tyrbe mbi ta. Në ëndërr ai sheh që dy të dashëruarit bashkohen në parajsë.

## **Jusufi dhe Zylejhaja**

Profeti Jakob (Jakup) kishte dymbëdhjetë djem, por më i preferuari nga këta ishte Jusufi (Jozefi). Përveç se ishte i preferuari i babait, ai kishte gjithë shenjat që do të ishte profeti i ardhshëm. Vëllezërit nuk e duronin dot dhe një ditë e kapin dhe e hedhin në pus. Babait i thonë se e hëngri ujku., por fati nuk e braktisi Jusufin. Disa tregtarë kalojnë andej dhe e shpëtojnë. Pastaj shkojnë në Egjipt ku e shesin si skllav tek ministri i faraonit.

Gruaja e ministrit të faraonit, Zylejhaja, që kur ishte vajzë e re në familjen e babait të saj mbretit të Magripit<sup>12</sup>, e kishte parë në ëndërr dhe ishte dashuruar me të. Zylejhaja i shpreh dashurinë Jusufit, por ai nuk ia kthen. E zemëruar nga refuzimi Zylejhaja e akuzon se ka tentuar ta përdhunojë dhe Jusufi përfundon në burg ku kalon shtatë vjet. Gjatë këtyre viteve ai bëhet i famshëm si interpretues ëndrrash. Faraoni e shfrytëzon këtë dhunti të tij dhe i kërkon që të interpretojë ëndrrat e tij. Kur parashikimet i dalin të sakta e liron nga burgu dhe pastaj e bën ministër në vend të burrit të Zylejhasë që dënohet me vdekje për vjedhje të thesarit të faraonit. Ndërsa Zylejhaja për shkak të të keqes që kishte bërë sëmuret dhe shëmtohet. Pas lutjeve të Jusufit që nuk e mbante inat për çfarë i kishte bërë ajo shërohet. Me kalimin e kohës Jusufi fillon të dashurohet me Zylejhanë.

Një nga ëndrrat e faraonit të interpretuara nga Jusufi ishte se pas shtatë viteve bollëk do vinin shtatë vite thatësirë. Kështu që faraoni merr masa duke mbledhur grurin në magazina të mëdha. Kur kudo pllakos uria, vëllezërit e Jusufit vijnë në Egjipt për të blerë grurë. Jusufi i njëj dhe u merr vëllanë e vogël peng pa u treguar kush ishte. Ai u vë kusht që të sjellin babanë e tyre plak për të vërtetuar historinë e tyre. Kur Jakupi vjen në Egjipt, Jusufi i tregon kush ishte në të vërtetë dhe Jakupit i vjen përsëri drita e syve që kishte humbur kohë më parë. Më pas gjithë fisi i Jakupit shpërngulet në Egjipt. Gjatë shpërnguljes vdes si Jakupi ashtu edhe Jusufi. Kur Zylejhaja mëson për vdekjen e Jusufit, shkon të qajë mbi varrin e tij dhe aty jep shpirt.

Ky është një tregim i marrë nga Bibla, por i përshtatur sipas fesë islame.

## **Husrevi dhe Shirini**

Husrevi është djali i Hyrmyzit, mbretit Sasanid<sup>13</sup>. Ai kishte një mik me emrin Shavur, që kishte mësuar të pikturonte në Kinë. Një ditë duke shëtitur me njëri-tjetrin Shavuri i tregon për bukurinë e mbesës së mbretit Armen, Shirinit. Husrevi i kërkon të niset menjëherë që ta gjejë dhe t'ia sjellë.

Shavuri i bën një pikturë Husrevit dhe ia dërgon Shirinit që bie në dashuri me të. Shirini niset drejt kryeqytetit Sasanid ndërsa Husrevi niset drejt Armenisë nga padurimi. Edhe pse shkëmbehen rrugës ata nuk e njohin njëri tjetrin. Njerëzit e Husrevit e presin mirë Shirinin. Po ashtu edhe Husrevi pritet mirë në Armeni., por pas arritjes në Armeni ai mëson se babai i tij është rrëzuar nga fronti dhe është verbuar. Husrevi përpiqet të kthehet në shtëpi që të shpëtojë babanë, por nuk ia arrin. Shirini kthehet në Armeni ku dy të dashuruarit platonikë takohen.

<sup>12</sup> Magrip quhet gjithë Afrika Veriperëndimore.

<sup>13</sup> Mbretëria Sasanide ka ekzistuar atje ku ndodhet Irani i sotëm në shekujt III-VII të erës sonë.

Me kalimin e kohës Husrevi fillon të mendojë si të kthehet në pushtet. Ai i kërkon ndihmë perandorit bizantin. Perandori pranon, por me kushtin që Husrevi të martohet me vajzën e tij Marian. Husrevi pasi dëshiron të ulë nga fronin Behram Çybinin që i kishte zënë vendin babait të tij detyrohet ta pranojë kërkesën e perandorit Bizantin. Pasi një luftë të ashpër me ndihmën edhe të ushtrisë Bizantine ai hipën në fron. Edhe pse ia arrin qëllimit nuk është i lumtur pasi është larg Shirinit. Ndërsa Shirini nga ana e saj hipën në fronin e Mbretërisë Armene.

Një djalë i ri i cili merrej me ndërtimin e ujësjellësit për pallatin e Shirinit bie në dashuri me shikim të parë. Ky djalë quhej Ferhat. Këtë dashuri e mëson edhe Husrevi. Xheloz për këtë dashuri ai përfiton nga rasti kur Ferhati po punonte në një mal të largët dhe i dërgon disa njerëz që i thonë se Shirini kishte vdekur. Me të dëgjuar këtë gjë Ferhati hidhet nga maja e malit ku po punonte dhe vdes.

### **Trëndafili dhe Bilbili**

Trëndafili ishte vajza e mbretëreshës Pranverë. Një ditë kur sheh pasqyrimin e fytyrës së vet në ujin e lumit, dashurohet me të. Era e lehtë ia tregon bukurinë e saj Bilbilit. Bilbili bie në dashuri me Trëndafilin. Ai fillon të qajë hallin e tij me Lumin dhe Selvinë. I ankohet Natës dhe Dritës së Hënës., por Trëndafili nuk do t'ia dijë për ndjenjat e Bilbilit dhe vazhdon të mburret me bukurinë e tij. Narcisi dhe Zymbyli i japin këshilla Bilbilit., por kur e shohin që ai nuk u vë veshin këshillave ankohen tek Gjembu. Gjembu ia tregon këtë gjë nënës së Trëndafilin, mbretëreshës Pranverë. Pranvera e kap Bilbilin dhe e burgos në një kafaz.

Mbreti Korrik vjen nga Lindja duke djegur çdo gjë dhe kërcënon mbretëreshën Pranverë. Ai ia zë fronin e vendit të trëndafilave., por edhe sundimi i tij nuk zgjat shumë, pasi vendin ia zë mbreti Vjeshtë. Edhe ai nuk mundet të mbretërojë për shumë kohë pasi vjen mbreti Dimër që e shkatërron gjithë vendin.

Pak më vonë, atëherë kur çdo gjë mendohej e humbur del në horizont mbretëresha Pranverë e cila me ndihmën e mbretit Nevruz hipën në fronin e vendit të trëndafilave duke përzënë mbretin Dimër. Trëndafili kujtohet për Bilbilin që e dashuronte dhe me anë të Erës i kërkon mbretëreshës Pranverë ta lirojë nga kafazi. Ajo i jep leje dhe Bilbili është prapë i lirë që të dashurojë Trëndafilin.

### **Hurshiti dhe Feruhshati**

Ky tregim është shkruar nga poeti Shehoglu në shekullin XIII.

Vajza e shahut Sijavus, sulltanësja Hurshit, duhej shumë nga babai i saj, si për bukurinë fizike ashtu edhe për atë shpirtërore. Edhe pse kishte shumë xhelozë dhe smirë ndaj saj në pallatin mbretëror, ajo nuk e kishte humbur dashurinë që kishte i ati për të. Babai i saj e mbushte me dhurata për çdo rast. Një ditë ai i dhuron një vreshtë me një kopsht të madh. Atje Hurshiti jetonte në një vilë shumë të bukur së bashku me dadon e saj.

Pranë vilës ishte varri i një poeti shumë të njohur. Herë pas here Hurshiti së bashku me dadon shkonin ta vizitonin këtë varr. Në një nga këto shëtitje ajo njihet me Feruhshatin, djalin e mbretit të Afrikës veri perëndimore dhe shokun e tij Azat. Feruhshati ishte i dashuruar me Hurshitin pasi kishte dëgjuar për bukurinë

mahnitëse të saj. Edhe Hurshiti me të parë Feruhshatin bie në dashuri me shikim të parë. Në të njëjtën kohë mbreti i një vendi të largët i kërkon babait të Hurshitit që të martohet me të. Sijavusi nuk pranon dhe kështu që fillon lufta. Lufta po shkonte keq për Sijavusin. Pasi humb disa beteja ai ishte gati për t'u dorëzuar. Feruhshati dhe Azati futen fshehtas në kampin e ushtrisë së mbretit armik dhe e vrasin. Kështu ata shpëtojnë edhe fronin e Sijavusit edhe Hurshitin nga një martesë e padëshiruar.

Me t'u kthyer në vendin e tij Feruhshati i kërkon babait të tij që ta martojë me Hurshitin. Babai i tij zemërohet shumë me këtë kërkesë të djalit. Ai e burgos djalin në burgun e pallatit mbretëror. Pak kohë më pas mbreti vdes dhe Feruhshati i zë vendin. Kështu që largohet edhe pengesa e fundit për të bashkuar dy të dashuruarit. Feruhshati dhe Hurshiti martohen dhe jetojnë të lumtur.

Siç e shohim nga tregimet, temat kryesore që prekin janë dashuria mes njerëzve, dashuria ndaj Zotit dhe tregimet në lidhje me cilësitë dhe virtytet e njerëzve, por nuk preken fare jeta reale ose problemet sociale të shoqërisë së kohës.

## **1.2 Tregimet në prozë në letërsinë klasike turke**

Krahas tregimeve në vargje që ishin edhe stili kryesor i tregimeve në letërsinë klasike turke kemi edhe tregimet në prozë. Këto tregime kanë dy veçori kryesore: e para është përdorimi i Sexhi<sup>14</sup> në stilin e shkrimit dhe e dyta janë tematika të cilat ndryshe nga tregimi në vargje prekin tema më pranë njeriut, në një farë mënyre janë më realiste.

Sexhi është një mekanizëm i tërë në shkrimin e prozës. Për shkak të përpjekjes për të gjetur fjalë me rimë që t'i përshtaten fjalës që duan të thonë, shkrimtarët detyrohen të sajojnë fjalë të tjera pa kuptim. Kjo e bënte leximin e tregimit shumë të vështirë madje edhe nga lexuesit me një kulturë të gjerë., por kuptimi i lehtë i tregimit nuk ishte qëllimi kryesor i shkrimtarëve poetë. Qëllimi i tyre kryesor ishte forma.

### **Dashuria ndaj ndihmësit**

Ky tregim është i ndarë në disa pjesë dhe ka si temë vuajtjet dashurore të personazheve kryesorë.

Në vitet e para të shekullit XI në një vend diku në jug të maleve Kaukaz jetonte një i ditur që gjatë gjithë pesëdhjetë viteve që kishte dhënë mësim kishte pasur mbi pesëqind nxënës (pasues).

Një ditë pushimi duke shëtitur me ta ai vë re që një nga nxënësit e tij të rinj po qëndronte mënjanë i mërzitur. Ai e pyet se çfarë e shqetësonte dhe a mund ta ndihmonte. Nxënësi i thotë se kishte rënë në dashuri me djalin shumë të bukur të një shitësi vere. Dijetari pasi merr disa nga nxënësit më të fuqishëm i shkon në dyqan shitësit të verës i merr djalin me forcë dhe e sjell përpara nxënësit të tij të

---

<sup>14</sup> Ka kuptimin e rimës mes kuptimit në prozën e vjetër. "Sexhitë në letërsinë perse kanë rimës mes shprehjeve apo kuptimeve ose në disa raste edhe mes fjalive duke përdorur fjalët e fundit të fjalisë për të bërë rimë." (Özön, M. Türkçede Roman, Stamboll, 2009, f. 73).



dashuruar. Pasi e lë ta sodisë sa dëshiron bukurinë e djalit e kthen përsëri tek dyqani i të atit.

Edhe pse ishte një dijetar i njohur dhe i respektuar për njohjen e principeve dhe traditës, ai e kishte një cen. Ai ishte i dashuruar pas një djali të quajtur Ibrahim. Ai kishte disa vite që digjej nga dashuria për të. Nga mëngjesi deri në darkë shëtiste rreth shtëpisë dhe dyqanit ku punonte djali., por një ditë djali largohet nga qyteti. Dijetari bëhet shumë keq që nuk e sheh më Ibrahimin dhe sëmuret rëndë. Nxënësit e tij kur e shohin se sa keq bëhet dijetari dalin ta kërkojnë djalin, por nuk e gjejnë. Atëherë dijetari i përmalluar dhe i djegur nga dëshira për ta parë vdes duke thënë emrin e tij.

Duhet të kemi parasysh se kur themi dashuria ndaj djalit duhet ta shohim më shumë si dashuri platonike sesa një dashuri fizike. Pasi ky është tipar i letërsisë klasike turke e cila vlerëson bukurinë si koncept dhe jo bukurinë si diçka fizike e prekshme.

### **Bukuria dhe Gjuha**

Në kohën e dijetarëve të vjetër grekë jetonte një mbret i quajtur “Mendje” i pajisur me fuqinë e Aleksandrit të Madh dhe dijen e Platonit, që sundonte mbi një kështjellë të quajtur “Kështjella e trupit”. Ai sundonte me drejtësi. Në mbretërimin e tij asnjëri nuk mund të bënte padrejtësi ose të mburrej. Secili mbante vendin që i takonte. E vetmja gjë që i mungonte atij ishte një djalë., por në fund u martua me Shijen dhe në jetë sollën djalin me emrin Gjuhë.

Sa më shumë rritej Gjuha, aq më shumë kurioz bëhej. Ai pyeste vazhdimisht të diturit. Një ditë Syri i Keq, një nga të diturit, e pyet Gjuhën për shkakun e zemërngushtësisë. Për të gjetur një përgjigje për këtë pyetje, Gjuha nis të kërkojë kuptimin e jetës.

Në një nga mbretëritë e Lindjes jetonte një mbret me emrin Dashuri dhe vajza e tij e quajtur Bukuri. Kjo vajzë jetonte në qytetin Didar pranë malit Kaf. Bukuria kishte një saksu lulesh të quajtur Gjuha dhe një flamurtar të quajtur Qamet. Një ditë Nazja nis të takojë Bukurinë., por rrugës atë e burgosin. Ajo arrin t'i mashtrtojë ata duke u thënë se dinte sekretin e prodhimit të arit dhe arratiset. Rrugës i ngatërrohen këmbët në fijet e Favoritit<sup>15</sup>. Favoriti e merr dhe vendos në një shesh të zbukuruar me gonxhe shumëgjyreshe. Më pas i jep disa qime floku dhe i thotë se kur të mërzhitet ose të ketë nevojë ta thërrasë.

Më pas Nazja nis për rrugë dhe arrin në qytetin Didar. Këtu takohet me Gjendjen, një njeri me fytyrë të zezë, por me një erë shumë të mirë, që ishte një nga njerëzit e Bukurisë. Bëhet mik me të dhe e shëtisin qytetin cep më cep. Gjatë shetitjes ata takohen me rojën e Bukurisë, Qeshjen, që kishte pseudonimin “Mushkëri shpues”. Me të parë Nazen ai i sulet për ta vlarë., por sapo bëhet ta godasë me shpatë sheh një gur të çmuar në veshin e Nazes të njëjtë me atë që mbante në këllëfin e shpatës së tij. Nga këtu kuptohet që Nazja me Qeshjen ishin vëlla e motër.

---

<sup>15</sup> Pjese e flokëve që zgjatet mes syrit dhe veshit.

Qeshja e dërgon Nazen para Bukurisë. Aty ai i tregon Bukurisë pjesën e gurit të çmuar. Aty Nazja kupton që ajo është foto e Gjuhës, pronarit të saj, dhe ia paraqet Bukurisë duke e mburrur. Bukuria bie në dashuri me Gjuhën dhe i kërkon t'ia sjellin.

Nazja i tregon se kjo është e pamundur pasi babai i saj, Mendja, e kishte fshehur në kështjellën e Trupit., por meqë Gjuha ishte në kërkim të Jetës ajo mund të dërgonte ndonjë nga besnikët e saj që ta gënjente duke i premtuar gjetjen e Jetës dhe ta largonte nga kështjella. Për këtë qëllim ajo i jep Nazes një nga shërbëtoret e saj, Ëndrrën, e cila ishte edhe një piktoreshë e aftë.

Nazja me Ëndrrën shkon dhe takon Gjuhën. Pasi i tregon aventurat që kaloi Nazja i thotë Ëndrrës t'i tregojë Gjuhës një pikturë të Bukurisë. Gjuha bie në dashuri me shikim të parë. Që të tri largohen nga kështjella e Trupit dhe nisen drejt mbretëreshës së dashurisë, Bukurisë. Largimi i Gjuhës diktohet nga ministri i Mendjes, Dyshimi, i cili informon menjëherë mbretin.

Mendja urdhëron që Gjuha, Nazja dhe Ëndrra të burgosen. Bukuria i kishte dërguar Gjuhës një unazë që po ta fusje në gojë bëheshe i padukshëm., por Gjuha që nuk e dinte këtë veti ja kishte dhënë për ta ruajtur Nazes. Në çastin e arrestimit Nazja e fut në gojë unazën dhe zhduket nga sytë duke shkuar në kopshtin e parajsës ku ndodhej burimi i jetës. Duke tentuar të pijë ujë, asaj i bie unaza në burim i cili bëhet i padukshëm.

Nazes që i humbet unaza e gjen veten në vendin e Kundërshtarit. Ai e kap dhe e burgos. Në atë çast Nazja nxjerr një nga qimet që i pat dhënë Favoria. Ai e merr dhe e dërgon në Didar, para Bukurisë. Bukuria pasi mëson për burgosjen e Gjuhës dhe besnikes së saj, i jep urdhër Qeshjes dhe Nazes të përgatisin një ushtri dhe t'i shpëtojnë të burgosurit.

Kur Mendja sheh ushtrinë para kështjellës së tij, e nxjerr nga burgu Gjuhën dhe i thotë që për t'u bashkuar me Bukurinë ai duhet të mposhtë ushtrinë e Sulltanit të Dashurisë. Gjuha nis të bashku me ushtrinë e Mendjes për luftë.

E informuar për ushtrinë e Mendjes ajo i kërkon babait të saj Dashurisë t'i japë një ushtri më të madhe. Gjatë luftës ushtria e mendjes edhe pse pëson humbje të mëdha nuk dorëzohet., por më pas Bukuria i bën një kurth dhe komandantët e Mendjes së bashku me të bien rob të ushtrisë së Dashurisë. Së bashku me të bie rob edhe Gjuha. Bukuria së bashku me Nazen vendosin që ta burgosin për pak kohë Gjuhën para se të takohen. Ato e burgosin në burgun e Zgjuarsisë., por pas pak kohe Bukuria nuk duron dot mallin që ka për Gjuhën dhe jep urdhër të lirohet.

Gjuhën e dërgojnë në një kopsht përrallor ku nga mahnitja i bie të fikët. Në atë çast vjen Bukuria që fillon të qajë nga gëzimi dhe lotët e saj bien mbi Gjuhën. Ai hap sytë, por i bien përsëri të fikët pasi sheh Bukurinë. Bukuria largohet e mërzhitur. Pas disa ditësh ajo dëshiron përsëri ta shohë. Kështu që dërgon një nga shërbëtorët që i jep të pijë verë dhe pasi e zë gjumi ajo e shikon dhe kënaqet.

Një nga njerëzit e Dashurisë, Smira, vajza e Kundërshtarit, sheh lëvizjet e dyshimta të Bukurisë dhe e ndjek nga pas. Sheh Gjuhën dhe bie në dashuri me të. Me anë të intrigave bën që Gjuha të gjendet i shtrirë në të njëjtin krevat me të.

Bukuria vjen dhe i shikon. Smira arratiset tek pallati i babait të saj. Ndërsa Gjuha futet në burg nga Bukuria e zemëruar për tradhtinë e bërë. Më pas e dëbon nga burgun e pallatit dhe e dërgon në burgun e vuajtjes., por më vonë mëson se ai ishte viktime e komplotit të thurur nga Smira. Kur shkon ta lirojë Gjuhën nga burgun mëson se babai i Smirës e kishte marrë Gjuhën dhe e kishte mbyllur në burgun e tij. Bukuria dërgon një ushtri me në krye ish komandantin e Mendjes, Durimin dhe e shpëton. Më në fund Bukuria martohet me Gjuhën.

Siç edhe duket nga tregimi ky është një tregim i mbushur me nënkuptime madje aq shumë sa bëhet edhe i lodhshëm për ta ndjekur rrjedhën e ngjarjeve., por nëse e lexon me kujdes do të shohim se me anë të këtyre ngjasimeve jepen këshilla në lidhje me mënyrën e jetesës.

### **1.3 Tregimet gojore**

Tregimet gojore do t'i japim më poshtë tek Tregimet popullore të shkruara, pasi edhe pse janë trashëguar gojë më gojë vetëm pasi janë hedhur në shkrim kanë arritur të vijnë deri në ditët tona. Po ashtu këto lloj tregimesh ngjasojnë edhe nga tematika edhe nga gjuha e përdorur me tregimet popullore të shkruara.

### **1.4 Tregimet popullore të shkruara**

Në këtë grup futen gjithë tregimet që nuk janë pjesë e tregimeve në vargje dhe nuk bëjnë pjesë të përrallat dhe legjendat. Si tregimet e trashëguara gojë më gojë si ato të shkruara në Xhönke<sup>16</sup>, ose në libra të tjerë siç është libri më i famshëm me tregime “Dede Korkut Hikayeleri”<sup>17</sup> (Tregimet e Gjyshit Korkut) të shekullit XIV-XV kanë rëndësinë e tyre pasi janë paraardhësit e romanit turk.

Ndryshimi kryesor i këtyre tregimeve nga tregimet e letërsisë klasike turke është gjuha e përdorur. Edhe pse e ndikuar nga persishtja dhe arabishtja ajo është më e pastër sesa tek tregimet e letërsisë klasike. Këto tregime nuk zbatojnë rregullat e Sexhit siç detyrohen të zbatojnë tregimet e letërsisë së Divanit. Një ndryshim tjetër është tematika e përdorur. Në përgjithësi tek tregimet e sipërpërmendur tema është e përgjithshme, dashuria ose këshillime në lidhje me mënyrën e jetesës. Ndërsa tek këto tregime kemi një afrim më pranë realitetit ku preken tema të përditshme, të prekura nga njerëzit. Nga ana tjetër nuk mund të themi që nuk ndikohen nga “Një mijë e një netët” ose “Një mijë e një ditët”<sup>18</sup> që janë baza e tregimtarisë arabe. Megjithatë tregimet popullore turke kanë pavarësinë e tyre për sa i përket origjinalitetit që kanë. Me kalimin e kohës tregimi popullor fillon gjithmonë e më shumë të bëhet i pavarur, ashtu siç do e shohim edhe tek përmbledhjet e disa nga tregimeve më në zë.

---

<sup>16</sup> Revista të kohës që jepnin përmbledhje tregimesh të shkrimtarëve të ndryshëm ose të një shkrimtari të shkruara me fletë lëkure.

<sup>17</sup> Në këtë libër janë mbledhur shumë tregime të zonës së Turqisë Lindore, Azerbajxhanit, Iranit dhe Irakut verior.

<sup>18</sup> Që të dy janë libra me tregime të shkruara nga arabët.

## Veziri i trishtuar

Bedredin Lulu, qeverisësi i Damaskut kishte një vezir me emrin Atijulmuluk. Ai ishte gjithmonë serioz, fytyrë ngrysur dhe nuk i qeshte asnjëherë buza. Pas këmbënguljes së qeveritarit ai i tregon historinë e tij.

Emri i tij i vërtetë ishte Hasan dhe ishte djali i një argjendari në Bagdad. Edhe pse ishte një student i mirë dhe e mbaroi shkollën me rezultate shumë të mira, ai si djalë i një babai të pasur nuk kujdesej për shpenzimet, duke e harxhuar pasurinë e të atit. Babai kur e sheh që nuk po i dëgjonte këshillat e tij, i thotë fjalët e fundit para se të vdesë. “Pasi të shpenzosh gjithë paratë shko dhe var veten në atë pemë para se të poshtërohesh nga të tjerët”, duke i treguar një pemë në kopsht.

Pas vdekjes së babait ai i shpenzon gjithë paratë dhe kur sheh që gjithë miqtë i kthejnë kurrizin vendos të varë veten tek pema që i tregoi babai., por kur po varte veten pema thyhet dhe nën të del një qyp i mbushur me gurë të çmuar.

Duke menduar se tani kishte fituar eksperiencën e duhur ai bashkë me disa miq të vjetër të babait vendosin të nisen për në Hormuz për të bërë tregti., por ortakët e tij i marrin gjithë gurët e çmuar dhe e hedhin në det.

Atë e shpëton një njeri. Pas shumë mundimesh dhe peripecirash arrin në Hormuz, por nuk arrin ta vërtetojë fajësinë e ortakëve të tij dhe kështu që përfundon vetë në burg. Njeriu që e kishte ndihmuar të shpëtonte në det e shpëton përsëri duke e liruar nga burgu., por ai tani ishte i varfër pa një qindarkë. Për të shkuar deri në Shiraz ai futet si shërbëtor në një karvan. Kur arrin atje ai fillon të kërkojë punë. Për fat të mirë atje kalon kryeshërbëtori i pallatit perandorak të Shah Tahmaspit dhe e merr si shërbëtor në haremin<sup>19</sup> e pallatit.

Një ditë duke shëtitur në kopshtin e haremit ai kupton që kishte ardhur koha të largohej pasi aty do shëtisnin gratë. Ai nuk arrin të largohet dhe gratë e haremit e marrin dhe pasi e veshin si grua e dërgojnë tek dhoma e vajzës së Shahut.

Zylehja, vajza e shahut i thotë të zgjedhë një nga vajzat që i pëlqen më shumë. Në fakt Hasani kishte kohe që shkëmbente shikimet me një nga vajzat e haremit që quhej Hale., por në fakt Hale ishte Zylehja dhe Zylehja ishte Hale. Ai e kupton këtë gjë dhe takohet përsëri me Zylehjan., por një ditë mëson se Zylehja kishte vdekur. Hasani i trishtuar largohet nga Shirazi pasi nuk kishte asgjë që ta mbante lidhur me atë qytet.

Rrugës takohet me një dervish. Në fakt ky nuk ishte një dervish i vërtetë, por një matrapaz që bënte rolin e një dervishi për të fituar para. Hasani bëhet shërbëtori i tij duke mësuar çdo lloj marifeti të mundshëm. Pas disa kohësh ata shkojnë në Kandahar.

Gjatë qëndrimit atje ata shkojnë për vizitë në pallatin mbretërorë. Atje një nga shërbëtorët e shahut e njeh Hasanin. Pak më vonë ai e thërret dhe lënë një takim në një shtëpi të braktisur. Atje Hasani për habinë e tij sheh Halen. Ajo i tregon që ata kishin bërë sikur kishte vdekur duke përdorur një lloj bari që të bën si të

---

<sup>19</sup> Kur themi harem duhet të kuptojnë pjesën e pallatit mbretëror ku jetojnë gratë e pallatit përfshirë fëmijët dhe shërbëtorët.

vdekur për disa orë, por më pas ato nuk e kishin gjetur Hasanin edhe pse e kishin kërkuan gjithë andej. Gjatë kërkimit ato i kishin rrëmbyer dhe i kishin shitur në pallatin mbretëror të Kandaharit.

Ata fillojnë të takohen fshehtas, por një ditë ata kapen. Dervishi i kishte spiunuar tek shahu Firuz. Në çastin që do vareshin ata i tregojnë identitetin e vërtetë. Shahu ngaqë nuk dëshiron të futet në luftë me shahun e Shirazit dhe pranon t'i lëshojë.

Hasani së bashku me Zylehjan shkon në Bagdat ku vendosen për të jetuar. Aty Hasani arrin të demaskojë ish ortakët e tij. Ata dënohen, por arratisen nga burgu. Një ditë kur ai kishte shkuar tek një mik për vizitë ata shkojnë në shtëpinë e Hasanit duke vrarë gjithë shërbëtorët dhe rrëmbejnë Zylehjan.

Hasani pas kësaj ndodhie largohet nga Bagdadi duke shkuar në Musul<sup>20</sup> ku bëhet edhe Vezir., por për shkak të intrigave detyrohet të largohet edhe nga aty duke shkuar në Damask. Atje vazhdonte të jetonte duke shpresuar të takonte përsëri Zalehjan.

### **Maliku dhe Melikzade Shirin**

Maliku ishte djali i një tregtari shumë të pasur. Një ditë një i huaj i tregon për një sënduk që mund të fluturonte. Pasi e merr këtë sënduk fillon të fluturojë me të nëpër vende të ndryshme.

Në një nga këto vende jetonte një mbret me një vajzë shumë të bukur të quajtur Shirin. Mbreti ishte paralajmëruar nga astrologët e tij se vajzën mund t'ia rrëmbejnë dhe për t'u siguruar ai e kishte mbyllur atë në një kullë të lartë. Maliku i shtyrë nga kërshtëria shkon në kullën burg dhe e ndalon sëndukun në majë të saj duke u hequr si engjëll para Shirinit. Ai arrin të gënjejë edhe mbretin. Një nga mbretërit fqinjë i kërkon atij të martohet me Shirinin, por mbreti e refuzon. Kështu që mbreti fqinj e sulmon me ushtrinë e tij.

Maliku e mbush sëndukun e tij me gurë dhe fluturon sipër ushtrisë së armikut duke hedhur gurë nga qielli dhe duke përhapur panik tek ata. Ushtria armike e frikësuar largohet me rrëmujë., por sapo fiton luftën dhe bëhet i pazëvendësueshëm për mbretin, i digjet sënduku gjatë festës së bërë për fitoren.

I dëshpëruar që nuk do kishte mundësi të takohej më me Shirinin ai largohet drejt Damaskut ku jeton i trishtuar.

### **Ëndrrat e Aziz Efendiut**

Tregimi ndahet në disa pjesë. Ne do të japim vetëm përmbledhjen e pjesës së parë të marr nga libri “Türkçede Roman”<sup>21</sup> i studiuesit Mustafa Nihat Özön:

Kamerxhani është djali i Shahut Xhyxha. Ai besonte se gratë ishin të pabesa dhe kishte vendosur të mos martohet kurrë, por detyra ndaj shtetit e kërkonte që të

---

<sup>20</sup> Qytet në veri të Irakut

<sup>21</sup> Özön, M. Türkçede Roman, Stamboll, 2009, f. 100.

martohej dhe kështu të mbronte vazhdimësinë e dinastisë Harzemshahe. Babai kur e sheh që ai me dëshirë nuk po pranonte të martohej e fut në burg.

Në burg zanat i bëjnë një lojë dhe i sjellin vajzën e perandorit kinez, Gylruh. Ai nuk beson se është e vërtetë dhe ndryshon unazën e tij me të vajzës, edhe vajza nuk beson se është e vërtetë dhe kur ai po flinte i ndryshon unazën me të veten.

Të nesërmen Kamexhani i kërkon babait ta martojë me vajzën që kaloi natën. Edhe pse nuk i besojnë ata fillojnë kërkimet. Pas shumë kërkimesh e mundimesh e gjejnë se kush është vajza. Kemerxhani niset dhe e merr vajzën. Rrugës duke u kthyer ai ndjek një zog të bukur dhe largohet nga karvani që e shoqëronte. Karvani pasi pret disa kohë dhe nuk e sheh të kthehet vazhdon rrugën. Gylruhu vesh rrobat e Kemerxhanit.

Karvani kalon nga Basra ku mbreti i këtij vendi ngul këmbë që të martojë vajzën e tij Feruh me Kemerxhanin (Gylruhun e veshur si Kemerxhan). Gylruh detyrohet të pranojë që të mos dalë sekreti, por natën e dasmës i tregon Feruhut të vërtetën.

Nga ana tjetër Kemerxhani duke ndjekur zogun arrin në Indi. Atje njihet me një kopshtar të vjetër mysliman. Pas disa kohësh ai largohet prej atje dhe vjen në Basra. Aty takon gruan e tij të parë dhe merr edhe Feruhun. Aty ai lind dy djem: Asilin me njëren grua dhe Nesilin me gruan tjetër. Ai e drejton vendin me drejtësi për shumë vite. Pasi fëmijët rriten ata e ndihmojnë babanë në qeverisjen e vendit, por një nga vezirët me anë të intrigave bën që djemtë të dërgohen tek gjyshërit e tyre.

Këtu fillojnë aventurat e djemve. Asili niset për në Kinë pranë gjyshit të tij. Para se të niset për tek gjyshi futet në thesarin e babait për të marrë paratë e nevojshme për udhëtim., por aty gjen një kuti të vogël ku shkruhej “ këtu ka diçka që nuk mund ta blejë asnjë thesar në botë”. Pasi e hap gjen një unazë bakri me një vulë mbi të. Edhe pse habitet e merr dhe e vendos në gisht. Pastaj niset për udhëtim.

Gjatë udhëtimit anija i fundoset dhe ai mezi shpëton bashkë me kujdestarin e tij Sait duke dalë në një ishull. Kur zgjohet Asili sheh një pallat dhe i afrohet. Para derës kishte një dry shumë të rëndë. Sapo ai e prek thyhet. Shëtiti nëpër pallat, por nuk gjen njeri derisa sheh një vajzë duke fjetur. E thërret, por ajo nuk zgjohet. Pastaj ai prek një tabelë që i thyhet njësoj si dryni dhe vajza zgjohet. Ajo i tregon që ishte Shirvezati, vajza e mbretit Abdylsam, që e kishte rrëmbyer mbreti i xhinëve. Ai e kishte mbyllur në këtë pallat të magjepsur. Në atë çast vjen xhini. Kur dy të rinjtë po dridheshin nga frika xhini vjen dhe i përulet para këmbëve Asilit. Arsyeja ishte se unaza prej bakri kishte vulën e Solomonit. Dhe me të kontrolloheshin të gjithë xhinët.

Asili i kërkon ta dërgojnë Shivezatin tek babai i saj dhe xhini e bën menjëherë. Më pas Asili martohet me të.

Ndërsa Nesili niset për në Isfahan. Gjatë rrugës i sulmojnë grabitësit dhe mezi shpëton. Edhe pse kalon disa peripeci ai arrin në Isfahan., por një ditë gjatë festës një indian sjell një kalë prej floriri që fluturonte. Kur Nesili hipën mbi të ai

fluturon pa e pyetur dhe shkon e ulet mbi tarracën e një pallati. Nga aty ai kalon në një dhomë ku sheh një vajzë shumë të bukur. Ajo ishte Alemara, vajza e mbretit indian Hyryzym. Ai martohet me të. Kur po ktheheshin në Isfahan përballen me disa xhinde që e njohin kalin e artë që ishte vjedhur nga thesari i tyre. Ata i burgosin Nesilin me Almeran, por kur i nxjerrin para pronarit të tyre Asilit ai e njeh vëllanë e tij dhe e shpëton nga burgu. Pasi e mbush me shumë dhurata dhe e nis për në Isfahan.

### **Gruaja me thikë**

Në kohën e sulltanit Murati IV<sup>22</sup> jetonte një njeri shumë i pasur në Stamboll. Ai kishte një djalë shumë të bukur të quajtur Sulejman. Shumë Ashik kishin rënë në dashuri me të, por babai i tij Halit Beu e ruante si sytë e ballit. Megjithatë vjen një ditë që Halit Beu sëmuret rëndë dhe pasi i lë amanetet e fundit mikut të tij të vetëm Ibrahim Beut vdes.

Pas varrimit njerëzit nuk arrijnë ta shkëpusin djalin nga varri i të atit dhe largohen. Ashikët të gëzuar që tani Sulejmani ishte vetëm dhe i pambrojtur i sulen duke u shtirur si njerëzit e babait të tij e mashtrojnë dhe e marrin të shuajnë dhimbjen duke pirë.

Me kalimin e kohës ata e mësojnë djalin të pijë dhe të shëtisë me femra duke shpenzuar shuma të mëdha. Pasi nuk i mbeten më para për të harxhuar sepse ja kishin ngrënë miqtë e rremë ai shet vilën e tij dhe nëna e tij largohet duke shkuar tek miku i familjes Ibrahim beu. Ibrahim beu mundohet të ndalojë Sulejmanin të shpenzojë paratë, por nuk ia arrin.

Një vit më pas ai fillon të shëtisë i varfër duke lypur pasi nuk kishte më asnjë qindarkë. Asnjë nga miqtë e tij të argëtimit nuk i flet më. Kur Ibrahim e sheh që Sulejmani nuk kishte ku të binte më poshtë e merr dhe e fut në punë në një dyqan në Bedesten<sup>23</sup>. Për shkak të bukurisë së tij ai mbledh shumë ashikë që vinin të blinin vetëm prej tij, por Sulejmani nuk u përgjigjej kërkesave të tyre.

Një ditë duke ecur në rrugë Sulejmani sheh një karrocë shumë të bukur. Brenda saj ndodhej një zonjë dhe përballë saj një shërbëtore edhe më e bukur. Sulejmani bie në dashuri me shërbëtoren ndërsa zonja bie në dashuri me Sulejmanin. Zonja e fton Sulejmanin në shtëpinë e saj.

Sulejmani pas një dyshimi vendos të shkojë. Ai fillon një lidhje me këtë zonjë, por nga ana tjetër flirton edhe me shërbëtoren të quajtur Kamer. Një ditë Zonja sheh Sulejmanin duke u puthur me Kamerin. Pasi Sulejmani largohet ajo e torturon Kamerin, madje pasi kujton se ka vdekur e hedh në një pyll të errët. Kameri shpëton dhe ruhet nga kafshët e pyllit. Ajo nuk i vë faj Sulejmanit duke u justifikuar që mashkulli është mashkull, fajin e ka femra.

Sulejmani kur nuk e sheh Kamerin në shtëpi fillon të shqetësohet dhe mëson vendin ku e kishin hedhur. Ai e merr në shtëpi, por tek futen brenda zonja e sheh dhe e kupton që Sulejmani e dashuron Kamerin. Zonja vendos t'i vrasë të dy. Ajo

---

<sup>22</sup> Sulltan Osmani që mbretëroi në vitet 1623-1640.

<sup>23</sup> Treg i mbyllur.

bën një plan që ta vrasë Sulejmanin gjatë rrugës për të shkuar në ishujt e Stambollit.

Shoku i sulltanit Murati IV, Tifliu<sup>24</sup>, duke shkuar me varkë në ishull sheh zonjën që pasi i bërtet Sulejmanit nxjerr thikën që mbante gjithmonë nën fustan dhe e godet. Pastaj e hedh në det. Tifli e shpëton Sulejmanin. Pasi e shëron Sulejmanin për ta shpëtuar nga hakmarrja e zonjës me thikë e dërgon në fillim në Egjipt pastaj në Trabzon dhe në fund në kufirin iranian. Gjatë kësaj kohë ai gjen mundësinë dhe ia tregon historinë sulltanit i cili pasi e dëgjon dënon fajtoresh dhe shpëton Sulejmanin.

### **Keremi dhe Asllë**

Ngjarjet fillojnë në Isfahan ku mbreti i vendit së bashku me thesarmbajtësin e tij të krishterë kishin të njëjtin hall. Asnjëri nga ata nuk arrinte të bënte fëmijë. Pas shumë përpjekjesh dhe lutjesh Mbreti lind një djalë të quajtur Ahmet Mirza ndërsa thesarmbajtësi lind një vajzë të quajtur Karasulltan. Mbreti dhe thesarmbajtësi i japin fjalën njëri-tjetrit që kur të arrijnë moshë madhore t'i martojnë bashkë fëmijët, por pas disa kohësh thesarmbajtësi pendohet për fjalën e dhënë pasi ata ishin të feve të ndryshme. Për të penguar martesën ai bën sikur i vdes vajza. Pastaj duke u justifikuar se ishte plakur i kërkon mbretit leje të dalë në pension. Më pas vendoset në një fshat tri ditë larg Isfahanit.

Ahmet Mirza rritet dhe një ditë në ëndërr sheh Karasulltanin dhe bie në dashuri me të. Një ditë vendos që të dalë për gjah me shokun e tij Sofu. Ata shkojnë në fshatin ku jetonte thesarmbajtësi plak. Në kopshtin e shtëpisë së plakut ai sheh Karasulltanin. Menjëherë e kupton që ajo është vajza e ëndrrës.

Pas këtij takimi ata ndryshojnë emrat dhe Ahmet Mirza bëhet Kerem ndërsa Karasulltan bëhet Asllë.

Keremi fillon të tretet nga dashuria për Asllën. Mbreti pas shumë përpjekjesh e mëson hallin e djalit të tij dhe dërgon njerëz të kërkojnë dorën e vajzës. Ish thesarmbajtësi bën sikur pranon nga frika se mos e burgosin, por me të ikur lajmëtarët i dërgon gruan dhe vajzën në një vend tjetër.

Keremi pasi e mëson këtë gjë së bashku me mikun e tij Sofu niset në kërkim. Ata shëtisin pothuajse gjithë qytetet e mëdha të kohës duke kaluar peripeci të shumta deri sa më në fund e gjejnë Asllën me familjen e saj në Kajseri ku babai i saj ishte gardian burgu ndërsa nëna e saj hiqte dhëmbë. Keremi duke bërë si i sëmurë shkon në shtëpinë e tyre. Pasi vendos kokën në prehrin e Asllës ai hap gojën dhe kur nëna e Asllës i thotë cili dhëmbë të dhëmbë ai i heq që të tridhjetë e dy dhëmbët vetëm që të qëndrojnë pranë Asllës. Asllë e kupton që ai ishte Keremi kur po fshinte gjakun me shami. Ajo i tregon babait dhe nënës së saj. Keremi kur sheh që vajza nuk ndiente gjë për të i lutet Zotit që një të katërtën e dashurisë që ai kishte t'ia jepte Asllës. Zoti ia plotëson lutjen menjëherë pasi ishte lutje e pastër. Asllëja i hidhet Keremit në qafë, por babai i saj e burgos Keremin, madje i ofron para qeveritarit të qytetit që ta vrasë. Qeveritari nuk pranon pa i bërë një gjyq të drejtë. Në këtë çast ndërhyjnë motra e qeveritarit që kërkon të bëjë një provë. Ajo

---

<sup>24</sup> Personazh i vërtetë që ka jetuar dhe ka qenë një nga shokët e sulltanit Murati IV.



vesh dyzet vajza njësoj, një nga të cilat Asllëja, dhe i kërkon Keremit t'i shohë., por Keremi shikon vetëm Asllën dhe nuk interesohet për vajzë tjetër. Atëherë qeveritari e liron Keremin.

Në kohën që do martoheshin babai i saj e merr Asllën dhe largohet fshehtas për në Halep. Keremi i ndjek dhe arrin t'i gjejë edhe atje. Babai i saj ankohet tek pashai i vendit. Pashai e thërret Keremin, por në vend që ta dënojë e ul pranë vetes, pasi ai ishte një nga shërbëtorët e vjetër të Keremit që ishte bërë pasha. Ai vendos t'i martojë, por babai i Asllës përsëri nuk tërhiqet dhe gjatë përgatitjeve të dasmës i kërkon pashait që vajza të veshë një fustan që ia qëndis ai.

Pas dasmës Keremi me Asllën tërhiqen në dhomën e tyre. Keremi përpiqet të hapë kopsat e fustanit të nuses, por atyre u ishte bërë magji. Sapo Keremi arrinte tek dy kopsat e fundit ato mbërtheheshin përsëri. Keremi përpiqet gjithë natën për t'i zbërthyer, por nuk ia arrin. Me daljen e rrezeve të para të mëngjesit mbi kodër Keremi nga turpi fillon të digjet. Asllëja mundohet ta shuaj, por nuk ja arrin dhe Keremi digjet i tëri duke u kthyer në hi. Pashai kur e mëson këtë gjë e burgos dhe më pas e vret babanë e Asllës.

Asllëja nuk pranon të largohet nga hiri i Keremit dhe për dyzetë ditë i qëndron pranë. Kur hiri fillon të shpërndahet nga era që fryn ajo mundohet ta mbledhë me flokët e saj. Flokët i marrin zjarr dhe ajo digjet e tëra.

### **Aventurat e Kaliopit**

Ky tregim është një nga rrëfenjat gojore. Në shkrim e hedh për herë të parë Tahir Abdiu në mesin e shekullit XIX.

Ngjarjet zhvillohen në vitet e para të pushtimit të Konstandinopojës nga sulltani Mehmeti II. Një nga vezirët e sulltanit kishte një djalë shumë të bukur të quajtur Ziver. Pas vdekjes së tij djali shkante çdo ditë për të qarë tek varri i të atit. Një ditë gjatë kthimit nga varrezat ai sheh një vajzë shumë të bukur greke. Vajza ishte nga Edirneja<sup>25</sup>. Babai i saj, kryeshërbëtori i pallatit perandorak bizantin kishte vdekur gjatë pushtimit të Stambollit. Edhe ajo ashtu si djali vinte çdo ditë tek varri i babait të saj. Pasi mësojnë emrat e njëri-tjetrit ata përshëndeten dhe largohen.

Vëllai i Kaliopit, Kostandini, kur e sheh motrën e vet duke folur me një djalë të një feje tjetër vendos ta largojë. Pasi e godet dhe e vesh me rroba të vjetra e fut në një sënduk dhe e hipën në një anije. Kaliopi vjen në vete kur anija ishte larguar nga porti. Atë e lënë në një ishull të vogël të Egjeut. Ziveri pasi mëson se Kaliopin e kanë larguar nga Stambolli nisat në kërkim të saj. Kur kalon para ishullit ku mbahej Kaliopi mundohet të takohet me të, por njerëzit e ishullit e largojnë përsëri atë duke e dërguar në Egjipt. Ziveri pasi mëson se ku ndodhet përsëri i vihet nga pas., por fati nuk do që të takohen përsëri. Kaliopi tani e veshur si burrë kishte hipur në një anije në Detin e Kuq. Pas disa ditësh udhëtim anija fundoset nga stuhia dhe ajo mezi shpëton duke dalë në bregun e një ishulli.

---

<sup>25</sup> Adrianopoli i vjetër. Kryeqyteti i parë i Osmanlinjve në Ballkan. Rreth 250 km larg Stambollit.

Në ishull, mbreti i atyshëm nuk donte të martohet me asnjë vajzë vendase. Kur e sheh Kaliopin i hyn në zemër edhe pse nuk e dinte që ishte femër. Kaliopi nuk ja tregon identitetin e saj të vërtetë, por mbreti nuk e linte të largohej nga ishulli. Një natë fillojnë trazirat në ishull dhe mbreti humbet fronin dhe në vend të atij në fron hipën Kaliopi., por as ajo nuk qëndron shumë në fron pasi në ishull fillojnë përsëri trazirat dhe detyrohet të arratiset.

Ndërkohë Ziveri vazhdon pa pushim të kërkojë Kaliopin. Kaliopi pas arratisjes kalon shumë peripecira për t'u kthyer në Stamboll. Detyrohet të bëhet shërbëtores në një karvan. Nga aty mundohet të shpëtojë nga disa grabitës., por më në fund arrin në Stamboll. Pas disa kohësh takon Ziverin dhe pasi kthehet në myslimane duke marrë emrin Nedime martohet me Ziverin.

### **Beteja e kështjellës Kan**

Një nga njerëzit më të rëndësishëm të Medines, Saad Ibn Ubabi do bënte synet djalin e tij. Aliu, i cili ishte ftuar në festë nuk kishte dhuratë me vete. Një natë pa i treguar njeriu ai i hip kalit të tij Dyldyl, dhe duke marr me vete shpatën, Zylfikarin<sup>26</sup>, largohet nga shtëpia. Kur e dëgjon këtë gjë Profeti dërgon Halid Bin Velion që t'i gjejë. Aliu bën një rrugë të gjatë për ditë të tëra. Rrugës sheh një tendë nomade ku ushqehet dhe pastaj nis përsëri për rrugë. Më pas arrin në një çadër rrëzë një mali. Ky vend ishte dyzet ditë larg Medines.

Atje ai përleshet me një trim të quajtur Ebu Muhsin. Ai e fiton përleshjen. Pas kësaj Ebu Muhsini së bashku me popullin e tij pranojnë fenë islame. Aliu nuk i pranon dhuratat që i jep Ebuja. Atëherë Ebu Muhsini i tregon për kështjellën Kan që ndodhej dyzet ditë larg. Atje ndodheshin thesaret më të çmuara në botë.

Pasi dëgjon këto fjalë Aliu nuk pret më dhe nis për rrugë edhe pse Ebu Muhsini i lutet të qëndrojë. Ai udhëton për shtatë ditë e shtatë net. Ditën e tetë një demon në formën e një pleshti të bardhë i del përpara. Ky demon pasi e gënjen me fjalë të bukura e bind Aliun që ta ndjekë. Aliu e ndjek, por demoni pasi e sjell përpara kështjellës Lak zhduket nga sytë. Në këtë kështjellë ishte një ushtri prej treqind mijë ushtarësh e komanduar nga Emiri Tarik Zengi. Demoni tani i shfaqet Tarikut dhe e nxit të luftojë me Aliun. Tariku nuk guxon dhe dërgon vëllanë e tij, Tama Zengi., por edhe Tama nuk guxon të dalë përballë Aliut dhe dërgon Kumaz Aliun të luftojë me të. Aliu e vret Kumazin së bashku me 140 trima të tjerë. Pas kësaj emiri Tarik Zengi bashkë me njerëzit e tij kthehet në fenë islame. Edhe ai i ofron dhurata, por Aliu nuk pranon.

Aliu nis përsëri për rrugë. Tarik Zengiu e shoqëron për tri ditë e tri net pastaj kthehet në kështjellën e tij. Pasi udhëton edhe disa ditë të tjera Aliu arrin para një lumi që ishte gjysmë i kuq dhe gjysmë i zi. Ai përpiqet të gjejë një rrugë kalimi dhe më në fund sheh një urë për të kaluar dhe shkuan në kështjellën Kan. Ura ishte e mbushur me krijesa të frikshme dhe përbindështa. Pasi e sheh që nuk ka rrugë kalimi Aliu i lutet Zotit dhe ai i hap një rrugë kalimi sa për dy veta. Aliu kalon në anën tjetër duke vlarë disa përbindështa dhe duke i prishur gjithë magjitë me Zylfikarin e tij. Kahkaha, sulltani i kështjellës Kan, kur sheh që Aliu i ka vlarë

---

<sup>26</sup> Shpatë e madhe e cila në majë ndahet në dy maja. Shpata e famshme e shenjtit Ali.

përbindëshat dhe ka prishur magjitë dërgon vezirin e tij Kajtas me ushtri që të luftojë me Aliun.

Kajtasi nuk guxon të luftojë me Aliun kur sheh fuqinë e tij. Ai mundohet t'ia mbushë mendjen me të mira. Aliu pranon të bisedojë me Kajtasin dhe më pas nisen bashkërisht për në kështjellën Kan. Rrugës shohin që njerëzit adhuronin Kahkahan si një Zot. Ndërsa Kahkaha adhuronte diellin. Atje kishte aq shumë bollëk sa Aliu tregonte se iu duk sikur kishte gjetur parajsën dhe ferrin në të njëjtin vend. Aliu u prezantohet atyre si Vamik Ibn Vexh një trajnues ushtarak që shëtiste vend më vend duke ofruar shërbimin e tij.

Kur arrijnë në kështjellën Kan Aliu sheh që qyteti ishte rrethuar me mure të larta. Muret e qytetit ishin aq të gjata sa duhej të vrapoje me kalë për tetëmbëdhjetë ditë që të shkoje nga një anë në tjetrën. Kishte shtatë kulla prej floriri të kuq dhe 360 porta. Rreth e qark rridhnin lumenj të vrullshëm dhe mes lumenjve kishte kopshte dhe vreshta të panumërt. Kjo kështjellë ishte bërë nga ciklopë të urdhëruar nga Solomoni.

Kahkaha i jep urdhër Kajtasit që ta mbajë vetëm tri ditë Aliun në kështjellë. Gjatë kësaj kohe Halid Bin Velidi që ishte nisur të kërkonte Aliun takohet me Ebu Muhsinin. Ata nisen të dy të kërkojnë Aliun.

Gjatë tri ditëve në kështjellë Aliu shëtit në thesarin e Kahkahasë, që ishte i pafund. Më pas shëtit në kopshtin e tij, që quhej ndryshe edhe parajsa, dhe aty sheh vajzën e sulltanit Nigarin. Ajo në ëndërr ishte kthyer në myslimane, por e mbante të fshehtë këtë fakt nga frika e burgosjes. Më pas ushtarët e dërgojnë të shohë ferrin, burgun e pallatit. Atje ai sheh djaj të zinj me topuzë në duar.

Duke u kthyer për në pallat kalon nga një portë 61 metra të lartë, e gjitha prej ari të pastër. Kur arrijnë në pallat kalojnë nga nëpër një shkallë të lartë. Treqind e dyzet shkallëzat ishin prej abanozi të zi dhe në çdo shkallë qëndronte nga një ushtar dhe një përbindësh. Në fund të shkallëve ishte një derë e gjerë 73 metra. Pas saj vinte pallati i mbushur me flori dhe gurë të çmuar. Kahkaha e ul Aliun afër vetes dhe shtron një banket të madh. Në banket merr pjesë edhe Tamruçi, një trim që pretendonte të martohej me Nigarin. Ai thotë që ka sjellë kokën e prerë të Aliut. Aliu ngrihet dhe i thotë që e njihte Aliun dhe se koka e sjellë nuk ishte e Aliut.

Tamruçi zemërohet dhe e fton në dyluftim. Aliu ngrihet dhe me tri lëvizje e mposht dhe më pas e pret në dysh me Zylfikarin e tij. Kur godet me shpatë ai godet edhe një gong që dëgjohet deri në Medinë. Kahkaha e kupton që ky është Aliu i vërtetë dhe urdhëron ushtarët ta vrasin. Aliu lufton shtatë ditë e shtatë net pa ndërprerje. Në ditën e tetë i vjen në ndihmë Hasan Bin Velidi së bashku me Ebu Muhsinin dhe Tarik Zengiun me ushtritë e tyre. Beteja vazhdon edhe 28 ditë të tjera dhe në fund i mposhtin ushtarët e Kahkahas. Në fund të betejës Aliu vret edhe Kahkahanë. Ata që mbeten gjallë kthehen në myslimanë. Aliu vendos si qeveritar të vendit Ebu Muhsinin dhe Tarik Zengiun si vezir të tij. Më pas pasi merr Nigarin me vete niset për në shtëpi. Rrugës përballet me fiset avk dhe kajtan. Fisi kajtan kthehet në mysliman. Më pas arrijnë në Medinë shëndoshë e mirë. Aliu i jep Nigarin si nuse Profetit. Pas kësaj me 500 thasët e mbushur plot e përplot me gurë të çmuar që i pat marrë nga thesari i Kahkahas shkon tek shtëpia e Saad Ibn

Ubadi dhe ia jep si dhuratë për festën e synetit të djalit. Ndërsa Saad Ibn Ubadi e shpërndan këtë pasuri tek të varfrit.

### 1.5 Tematika në tregimet popullore turke

Gjatë gjithë periudhes së ekzistencës së saj deri në mesin e shekullit të XIX vëmë re se tematika e prekur në tregimin turk ka qenë e fokusuar në dy drejtime kryesore. Tema e dashurisë dhe ajo e trimërisë. Këto tematika për nga rëndësia i ndjek aventura. Në një pjesë të tregimeve tematikat e prekura ndërthuren me njëra-tjetrën. Megjithë përpjekjet e studiuesve turq të kohëve të fundit për të treguar se tregimet turke i ngjajnë romaneve të shkruara në vendet evropiane<sup>27</sup>, këto tregime nuk arrijnë ta pasqyrojnë jetën reale të popullit dhe janë larg të qënurit romane me kuptimin e plotë të fjalës. Arsyet për këtë distancë të madhe Ahmet Hamdi Tanpënar e justifikon me ndryshimin që kishte në këndvështrimin e fesë islame ndaj botës, ndryshe nga ajo e Evropës së krishterë. Zhvillimi i borgjezisë në Evropën Perëndimore ndryshe nga Perandoria Osmane ishte një arsye tjetër për këtë mos zhvillimin e romanit në letërsinë turke.<sup>28</sup> Tregimet turke të ndikuara shumë nga letërsia perse nuk patën mundësi të zhvilloheshin dhe të dilnin jashtë këtij ndikimi si nga përmbajtja ashtu edhe nga stili.

#### Dashuria

Tema e dashurisë në tregimet turke është lëvruar më shumë nga të gjithë temat e tjera. Duke filluar që nga fillimet e saj, letërsia turke i drejtohet kësaj ndjenje të fuqishme që e drejton jetën në shumë nga fushat e saj. Dashuria që tregohet në këto tregime është në përgjithësi platonike dhe më pak njerëzore e prekshme. Përgjithësisht edhe pse vlerësohet dashuria e djalit ndaj vajzës në fakt kjo dashuri është një dashuri ndaj të bukurës dhe të përsosurës. Kjo gjë bie më shumë në sy në tregimet **Lejla dhe Mexhnuni**, ose **Kerem dhe Asllë** ku dashuria në fakt i kalon caqet njerëzore dhe kthehet në një dashuri platonike ndaj së bukurës. Personazhet që dashurohen janë të shtresave të ndryshme shoqërore. Djali i një mbreti, pashai ose të pasuri dashurohet me vajzën e shërbëtorit, një punëtori të thjeshtë ose edhe të një njeriu me besim fetar të ndryshëm, siç është në rastin e **Kerem dhe Asllë**, por ndodh që janë edhe të një rangu të njëjtë shoqërorë, përgjithësisht fëmijë pasanikësh ose mbretërisht si në rastin e tregimit **Ëndrrat e Aziz Efendiut**. Dashuria nuk është vetëm për bukurinë. Në disa raste kjo dashuri është e drejtuar edhe drejt cilësive që duhet të kenë njerëzit në kohën kur janë shkruajtur. Dashuria ndaj ndershmërisë, dhembshurisë për të përvuajturit, ose ndaj miqësisë së vërtetë pa hile dhe intriga, shpalosen në disa nga tregimet në kohë të ndryshme gjatë historisë së letërsisë turke. Këtë e shohim në tregimet **Dashuria dhe Gjuha** ose **Trendafili dhe Bilbili**. Tema e dashurisë, e cila siç e thamë më sipër është prekur gjerësisht në tregimet turke, me kalim e shekujve fillon e bëhet më e prekshme dhe më njerëzore. Në tregimet që botohen duke ju afruar shekullit të XIX, shohim se tema e dashurisë fillon e bëhet më njerëzore. Me tipare më të afërta me jetën e përditëshme ku përfshihen edhe ndjenjat e xhelozisë ose tradhtia. Në tregimin **Gruaja me Kamë** dashuria nuk është më diçka e përsosur, por është njësoj ashtu si jemi mësuar ta shohim në kohët e sotme me xhelozitë, intrigat dhe marrëzitë që bëhen nga njerëzit e dashuruar.

<sup>27</sup> Turinay, N. Hece Dergisi, "Türk romanı özel sayısı", f. 440, botimi 2, Stamboll, 2010.

<sup>28</sup> Po aty, f. 441.

## Heroizmi

Tema më e lëvëruar në tregimet turke pas dashurisë është heroizmi ose trimëria. Që nga tregimet e para trimëria ose heroizmi ka ngjallur gjithmonë kureshtjen dhe interesimin e popullit. Heronjtë janë parë gjithmonë ndryshe nga populli dhe të gjithë do të donin të ishin të tillë. Për këtë arsye shkrimtarët i kanë përfshirë në veprat e tyre. Përgjithësisht këto tregime bazohen në personazhe të vërtetë historikë, por ato mund të bazohen edhe në personazhe fiktivë, por që i bazojnë ndodhitë në ngjarje të vërteta historike. Heroizmat përgjithësisht bëhen për hir të besimit siç ndodhin në tregimet **Beteja e Kështjellës Kan** ose tregimet që mund të përfshihen edhe në legjenda siç janë **Batallgazi** ose **Koroglu**. Në këto tregime shohim që personazhet kryesorë janë të pajisur me aftësi të rralla madje të mbinatyrshme me anë të të cilave ja dalin të fitojnë mbi armiqtë. Përgjithësisht tregimet me bazë trimërinë janë të shoqëruar me tema nga dashuria. Heroi kryesor i tregimit përveç luftës për besim ose për të shpëtuar popullin e tij nga skllavëria lufton edhe për të dashurën e tij e cila mund të jetë edhe e një feje tjetër, por që në fund pranon fenë islame.

## Aventura

Pas Dashurisë dhe Heroizmit tema më e prekur në tregimet popullore turke është ajo e aventurës. Aventurat në tregime janë nga më të ndryshmet. Populli turk në përgjithësi ka qenë një popull nomad i cili shëtiste gjatë gjithë kohës në kërkim të kullotave më të mira për bagëtitë dhe kuajt e tyre. Duke filluar nga shekulli VIII, por më shumë pas pranimit të fesë Islame në shekullujt X-XI filloi të ndërtojë ose të vendoset në vendbanime të përhershme. Megjithatë dashuria për udhëtim dhe aventura nuk u shua. Për këtë arsye tregimet me aventura ku personazhet kryesorë udhëtojnë në vende ekzotike të largëta duke kaluar peripeci të ndryshme janë të shumta, siç është tregimi **Veziri i trishtuar**, ku ngjarjet zhvillohen në shumë vende duke përfshirë situata nga më të ndryshmet. Edhe tregimi **Kerem dhe Asllë** i cili në plan të parë ka dashurinë në fakt brenda vetes ka edhe shumë aventura të cilat i kalon Keremi për t'u bashkuar me Asllën.

Megjithatë duhet të themi që të treja këto tematike ndërthuren shpesh me njëra-tjetrën duke e bërë shumë herë të vështirë në disa tregime të dallohet se cila nga këto tematika ka peshën më të madhe në një tregim.

Tipari kryesor që bie në sy në tregimet popullore është mos prekja e problemeve të përditshme të jetës së popullit. Nuk jepet asnjë shpjegim ose ngjarje që të tregojë në lidhje me mënyrën e jetesës së kohës. Gjithë ndodhitë ose zhvillimet janë në funksion të personazhit kryesor dhe nuk kanë ndonjë rol tjetër. Pasqyrimi i një ambienti, përgjithësisht pallatet mbretërore, bëhen për të treguar pasurinë dhe fuqinë e familjes së personazhit kryesor ose të armiqtëve që ai arrin t'i mposhtë duke ngritur vlerat e personazhit. Duke e kufizuar zhvillimin e ngjarjeve vetëm tek personazhet kryesorë, tregimi turk humbet mundësinë për tu kthyer në roman si një proces normal letrar i pandikuar nga jashtë. Do të duhet një ndërhyrje politike në shoqërinë turke të shek. XIX që ajo të hapte dyert ndaj romanit duke e bartur atë nga Franca në shtetin osman.

## Përfundime

- Në këtë kapitull për shkak se nuk janë qëllimi kryesor i këtij punimi janë dhënë vetëm disa nga ato tregime që përfaqësojnë krijimet më tipike të një periudhe të gjatë të letërsisë turke që fillon në shekullin e XI dhe vazhdon deri në shekullin XIX.
- Tregimet janë pothuajse të gjitha të ndikuara nga letërsia perse dhe arabe. Tematika e prekur po ashtu dhe shumica e vendeve ku zhvillohen ngjarjet janë të njëjta me tregimet perse dhe arabe.
- Tregimet që i ndamë në pesë grupe sipas M. Ozon duke u bazuar sipas mënyrës së shkrimit mund të mblidhen në dy grupe kryesore, tregimet e letërsisë së Divanit dhe tregime të letërsisë popullore. Diferencimi kryesor mes këtyre dy grupimeve është gjuha e përdorur. Në letërsinë e Divanit kemi tregimet në vargje dhe tregimet në prozë, por që të dyja të ndikuara shumë nga rregullat gjuhësore të poezisë perse. Këto tregime kanë një gjuhë të rëndë dhe të sofistikuar, të pakuptueshme nga shtresat e mesme dhe të ulëta të shoqërisë turke. Ndërsa në letërsinë popullore tregimet janë të një gjuhe më të thjeshtë dhe të kuptueshme.
- Rreth fillimeve të shekullit XIX kemi zhvillim në letërsinë popullore që dallohet tek tregimi i treguar nëpër kafenetë e qyteteve ku shohim një largim nga tema tradicionale dhe prekja e ngjarjeve të ndodhura në Stamboll në një kohë më të re siç është rasti i tregimit “Gruaja me thikë” që flet për personazhe që jetonin në periudhën e sulltanit Murati IV ose tregimi “Aventura e Kaliopit”. Kjo i bën këto tregime më realiste. Këto tregime janë paraprijës të romanit sipas stilit perëndimor.
- Gjatësia e tregimeve është e ndryshme. Sidomos tek mesnevitë e letërsisë së Divanit gjatësia shkon deri në mijëra rreshta. Këto ndoshta mund të quhen edhe romanet e hershme të letërsisë turke. Pasi plotësojnë edhe shumë nga kushtet për një roman.
- Tregimet janë të mbushura me ngjarje të mbinatyrshme ose me ngjarje që mund të ndodhin shumë rrallë në jetën normale. Kjo gjë bëhet për të bërë tregimin më interesant, por edhe për të shpëtuar personazhet nga situata shumë të vështira.
- Tek disa nga këto tregime njihemi me personazhin e trimit i cili do të na dalë përpara edhe tek romanet e para turke, por me disa ndryshime thelbësore.
- Gjithë personazhet kryesorë pozitivë janë njerëz me cilësi të larta. Janë njerëz të përsosur si nga ana fizike ashtu, edhe nga ana shpirtërore, por që kanë edhe nga një të metë të vogël si çdo njeri. Përgjithësisht këto të meta të vogla bëhen shkak për vuajtjet e tyre të mëdha. Këto cilësi do të dallohen edhe në romanet e para turke.

- Për sa i përket tematikës ajo është shumë e kufizuar. Dashuria, heroizmi dhe aventura janë temat kryesore të prekura në tregimet turke. Në këto tregime nuk përfshihen problemet sociale ose ndryshimet shoqërore dhe politike të kohës, duke i lënë jashtë zhvillimeve historike.

## KREU II

### NDIKIMET E LETËRSISË BOTËRORE

Në fillimet e letërsisë turke të periudhës së Tanzimatit tentativat e para për të prezantuar letërsinë perëndimore bëhen me përkthimet e romaneve<sup>29</sup>. Arsyet e përkthimit të romaneve janë sepse ato ishin më të lehta sesa poezitë për t'u përkthyer dhe nuk kërkonin një nivel të lartë njohjeje të gjuhës së huaj. Një pjesë e përkthyesve janë edhe vetë shkrimtarët e kësaj periudhe, ndërsa një pjesë tjetër e shihnin vetëm si një mjet për të fituar para. Ata përkthyes që janë edhe shkrimtarë, si Sami Frashëri, Ahmet Mid'hati ose ndonjë tjetër e shihnin edhe si një mënyrë për të praktikuar dhe perfeksionuar aftësitë e tyre në gjuhën frënge.

Duhet të kemi parasysh që këto përkthime nganjëherë ishin në një nivel shumë të dobët dhe shumë larg origjinalit. Megjithatë tema e punimit tonë nuk janë përkthimet dhe niveli i tyre. Për këtë arsye nuk do të qëndrojmë gjatë mbi këtë argument. Pasi të japim një pasqyrim shumë të shkurtër zhvillimit historik të romanit do të japim përkthimet e romaneve francez deri në fund të shekullit XIX. Romanet e përkthyer janë renditur sipas rendit kronologjik. Në këtë mënyrë do të shihet më qartë zhvillimi i përkthimeve të romanit në atë periudhë kohore.

#### 2.1 Romani në Perëndim

Burim i romanit perëndimor gjatë periudhës së Mesjetës ishin romancat. Më pas me shfaqjen e shoqërisë borgjeze, kjo klasë e re u bë një mjet shprehës në letërsi. Romani ishte një produkt i ndryshimeve shoqërore duke filluar nga fundi i Rilindjes evropiane në fillimet e shekullit XVI. Romani dhe tregimet për vite me radhë ekzistuan së bashku dhe kur u kalua nga tregimet në roman kuptohet që u përdor i njëjti koncept.

Po të bëjmë një historik të shkurtër të zhvillimit të romanit në perëndim do të shohim këtë zhvillim:

Shkrimtari francez François Rabelais (1490-1553) vuri në përdorim mirësinë-keqdashjen dhe ndjenjën e dashurisë në romanet e titulluara *Gragantua* dhe *Pantagruel*.

Honore d'Ufre (1568-1625) shkroi romanin me titull *Astree* ku shpjegonte jetën e vajzës çobane me emrin Astree.

Miguel Servantes Savedra (1547-1616) shkroi romanin me titull *Princesha e Seviljes* ku theksonte ndjeshëm ndjenjat e virtytit.

Feneloni (1651-1715) shkroi romanin me titull *Telemaque* i cili ishte një libër edukativ.

Alain-Rene Lesage (1668-1747) shkroi romanin me titull *Gil-Blasi'1* i cili shpjegonte shturjen në jetën Spanjolle në shekullin e tetëmbëdhjetë.

Daniel de Foe (1661-1731) shkroi romanin e titulluar *Robinson Kruzo*, i cili ishte një roman aventuresk..

---

<sup>29</sup> Së bashku me romanet kemi edhe pjesët teatrale, që konsiderohen grup së bashku me romanin. Në këtë punim nuk do të prekim pjesët teatrale.



Jonathan Swift (1667-1745) shkroi romanin *Udhëtimet e Gulliverit* (1726) i cili ishte një tregim që argëtonte fëmijët dhe fuste në mendime të moshuarit.

Abbe Prevost (1697-1763) shkroi romanin me titull *Manon Lescaut* i cili nga disa cilësohet si romani i parë në Evropë. Ky është një tregim që flet për pasionin e dashurisë.

Pierre de Chamblain de Marivaux (1688-1763) shkroi romanin me titull *Jeta e Marianës* që është një roman me karakter realist.

Samuel Richardson (1696-1761) me romanet *Clarise Harlowe*, *Pamela*, *Historia e z. Charles Grandison* nxorri në pah shembullin e borgjezisë dhe jetën e familjeve borgjeze në Angli.

Marie Anne Radcliffe (1764-1829) ishte shkrimtarja e parë që shkroi llojet e romanit me shpirt të këqinj, me xhinde dhe me fantazma. Një nga këto vepra ishte dhe romani me titull *Shato Udolphe*.

Jean Jacques Rousseau (1737-1814) me romanet me titull *Julie*, *Nouvelle Heloise* (1761) dhe romani i Gëtes (1749-1832) *Werther* (1774) u cilësuan si romanet e para të romantizmit.

Bernardin de Saint-Pierre (173-1814) shkroi romanin me titull *Paul et Virginie* (1787). Ky roman paraqiste natyrën e lumturisë dhe vlerësonte virtytet e punës.

Walter Scott (1771-1832) cilësohet si themeluesi i romanit historik. Romanet e tij më të rëndësishme janë : *Waverly*, *Rob Roy*, *Legjenda e Montrosës*, *Burgu i Edinburgut*, *Antikuari*, *Guy Mannering*, *Aivanhoe*.

Victor Hygo (1802-1890) shkroi romanet *Notri Dame de Paris* (Katedralja e Parisit) dhe *Les Misérables* (Të Mjerët).

Alphonse Karr (1808-1890) shkroi romanet me titull *Nën Bli*, *Rruga më e shkurtër*, *Shëtitje rreth kopshtit tim*.

Xavier de Montepin (1826-1902) shkroi romanet me titull *Mulliri Kuq*, *Misteri Indian*, *Magjistari kuq*, *Vajza cigane*, *Simon dhe Mari*.

Ponson de Terril (1829-1871) shkroi romanet *Udhëtarët e natës*, *Dashuria Gastonit*.

Emile Richebourg (1833-1898) shkroi romanet *Gruaja me perçe*, *Nënëmadhja* .

Emile Zola (1840-1904) shkroi romanin *Assomoir*.

Rene Chateaubriand (1768-1848) shkroi romanet *Atala*., *Rene*.

Alphonse de Lamartine(1790-1869) shkroi romanet *Raphael*, *Genevieve*, *Grazilla*<sup>30</sup>

---

<sup>30</sup> Kolcu, A. Ihsan, *Tanzimat Edebiyatı 2*, Ankara, 2005, f. 80-81

## 2.2 Fillimet e përkthimeve të romaneve perëndimore

Shkrimtarët Osman gjetën mundësinë për ta njohur romanin perëndimor në dy mënyra. Mënyra e parë ishte që ata që dinin frëngjisht ose anglisht dhe mund të lexonin romane në gjuhën origjinale, ndërsa mënyra e dytë ishin përkthimet. Mes shkrimtarëve Osman, ata që dinin frëngjisht ishin të shumtë në numër. Midis tyre ishte Namik Kemal, Ziya Paşa, Ali Suavi, Sami Paşazade Sezai që jetuan në Francë në periudha të ndryshme. Shkrimtarët si Ahmet Mithat Efendi, Şemseddin Sami (Sami Frashëri), Muallim Naci, Rezaizade Mahmud Ekrem, Ahmet Rasim e kishin mësuar frëngjishten në shkollat e krishtera në Turqi ose në mënyrë autodidakte. Duke lënë mënjanë ata që njihnin gjuhën, e gjithë mënyra e takimit të romanit me lexuesin Osman është bërë nëpërmjet përkthimit. Disa nga shkrimtarët dhe përkthyesit e romaneve të përmendur nga shtypi në letërsinë perëndimore të shekullit të nëntëmbëdhjetë janë :

### ***Viti 1862***

Nga Feneloni - Përktheu :Yusuf Kamil Paşa, *Tercüme-i Telemak*.

### ***Viti 1863***

Nga Feneloni- Përktheu : Yusuf Kamil Paşa, *Tercüme-i Telemak*

### ***Viti 1864***

Nga Daniel de Foe- Përktheu : Kronisti Ahmet Lütfi, *Përkthim i Tregimit Robenson*

### ***Viti 1867***

Nga Feneloni- Përktheu: Yusuf Kamil Paşa, *Tercüme-i Telemak*

### ***Viti 1866***

Nga Daniel de Foe- Përktheu: Kronisti Ahmet Lütfi, *Përkthim i Tregimit Robenson*

### ***Viti 1869***

Nga Feneloni- Përktheu: Yusuf Kamil Paşa, *Tercüme-i Telemak*

### ***Viti 1871***

Nga Voltaire- Përktheu: Ali Bey, *Tregimi Filozofik Mikromega*. Ahmet Vefik Paşa, *Hikaye-i Feylesofiyye-i Mikromega*.

### ***Viti 1872***

Nga Chetaubriand- Përktheu: Rezaizade Mahmud Ekrem, *Atala*.

Nga La Sage- Përktheu: Kadri, *Topal Şeytan*.

### ***Viti 1873***

Nga Langus- Përktheu: Kamil, *Danfni ile Kloe'nin Hikaye-i Taaşukları*.

Nga Bernardin de Saint-Pierre- Përktheu: Sıddık, *Pol ve Virjini*. Ali Bey, *Evlenmek İster Bir Adam*

Nga Anne Radcliffe- Përktheu: Abdullah Macit Paşa, *Sergüzeşt-i Adelin*

Nga Ponson de Terrail- Përktheu: Süleyman Vehbi dhe Gümüştüyan Manok, *Gece Yolcuları*

Nga Alexandre Dumas- Përktheu: Teodor Kasap, *Monte Kristo*

**Viti 1874**

Nga Daniel de Foe- Përktheu: Kronisti Ahmet Lütfi, *Përkthim i Tregimit Robenson*

**Viti 1875**

Nga Victor Hygo- Përktheu: Azize Hanim, nga *Notri Dame de Paris tek Garip Nine*

Nga Xavier de Montepin- Përktheu: Süleyman Vehbi dhe Gümüştüyan Manok, *Esrar-ı Hint*

Nga Eugene Sue- Përktheu: Paşayan, *Esrar-ı Paris*

**Viti 1876**

Nga Xavier de Montepin- Përktheu: Suhipi, *Esrar-ı Saray-ı Krali*

**Viti 1877**

Nga Paul de Kock- Përktheu: Ahmet Mithat Efendi dhe Ebüzşşya Tefvik, *Üçyüzlü Bir Kadın*

Nga Daniel de Foe- Përktheu: Kronisti Ahmet Lütfi, *Përkthim i Tregimit Robenson*

**Viti 1878**

Nga Bernardin de Saint-Pierre- Përktheu: Osman Senai, *Pol ve Virjini*

Nga Paul de Kock- Përktheu: Mehmed Ata, *Madam Blakizof ose Fitne-i Cihan*

Nga Frederic Soulie- Përktheu: Şemseddin Sami, *Şeytanın Yadigarları*

Nga Jules Verne- Përktheu: Yusuf Neyyir, *Graziella*

**Viti 1876-1878**

Nga Xavier de Montepin- Përktheu: Süleyman Vehbi, *Kırmızı Değirmen*

**Viti 1879**

Nga Xavier de Montepin- Përktheu: Mehmed Hilmi, *Paris Batakhaneleri*

Nga Pierre Zaccone- Përktheu: Vasilaki, *Londra Biçareganı*

Nga Alexandre Dumas-Fils- Përktheu: Ahmet Mithat Efendi, *La Dame aux Camelias*

**Viti 1880**

Nga Alexandre Dumas- Përktheu: Mehmet Tahir, *İncili Hanım* Ahmet Ata, *Binbir Hayal A.A, Kadınlar Muharebesi*

Nga Victor Hygo- Përktheu: Şemseddin Sami, *Sefiller*

Nga Chetaubriand- Përktheu: Tahir, *Ibn-i Serac-i Ahir*

Nga Octave Feuillet- Përktheu: Ahmet Midhat Efendi, *Bir Fakir Delikanlının Hikayesi*

Nga Alexandre Dumas- Fils- Përktheu: Ahmet Midhat Efendi, Antonin

**Viti 1881**

Nga Feneloni- Përktheu: Ahmet Vefik Paşa, *Telemak tercümesi*

Nga Alexandre Dumas- Fils- Përktheu: Ahmet Midhat Efendi, *Bir Kadının Hayatı*

**Viti 1882**

Nga Eugene Sue- Përktheu: Mihalaki, *Şikemperveri*

Nga Emile Richebourg- Përktheu: Ahmet Midhat Efendi, *Peçeli Kadın*

**Viti 1883**

Nga Voltaire- Përktheu: Ahmet Mithat Efendi, *Volter 20 yaşında*

Nga Eugen Sue- Përktheu: M. Arifi, *Tembeller Muaşakası*

Nga Emile Richebourg- Përktheu: Ahmet Midhat Efendi, *Merdud Kız*

Nga Octave Feuillet- Përktheu: Ahmet Ata, *Dul Kadın*

**Viti 1884**

Nga Daniel de Foe- Përktheu: Şemseddin Sami, *Robinson*

Nga Eugene Sue- Përktheu: M. Ş. *Muahabbet Çacuklar*

Nga Alexandre Dumas- Përktheu: Ahmet Mithat Efendi, *Fransuva Piko*

Nga Emile Gaboriau- Përktheu: Ahmet Midhat Efendi, *Orsival Cinayeti*

Nga Alexandra Dumas- Fils- Përktheu: Halil Edib, *Bir Mektup Paketi, Sezarın*

Nga Pierre Delcourt- Përktheu: A. Nihad, *Müstağnilığın*

**Viti 1885**

Nga Alexandre Dumas- Përktheu: Ali Nihad, *Amori*

Nga La Sage- Përktheu: Ahmet Vefik Paşa, *Gil-Bilas Santillani' nin Sergüzeşti*

Nga Xavier Montepin- Përktheu: Karabet Panosyan, *Asniyer Cenayeti*

Nga Jules Verne- Përktheu: Mehmed Emin, *Merkez-i Arza Seyehat*

Nga Alphonse de Lamartine- Përktheu: *Halil Edib, Geneniev*

### **Viti 1884-1885**

Nga Eugene Sue- Përktheu: M. Tevfik, *Serseri Yahudi*

### **Viti 1886**

Nga Victor Hygo- Përktheu: Selanikli Tevik, *Claude Geux-Obur Klod Ali Nihad, Bir Mahkumun son günü*

Nga Paul de Kock- Përktheu: Ali Nihad, Dostun Pifar Mehmed Fahri, *Lorantin ose Saadet Yüzünden Felaket Ahmet Mithat Efendi, Kamere Aşk*

Nga Edmon Tarbe- Përktheu: Selanikli Tevfik, *Katil Bernard*

Nga Eugene Sue- Përktheu: Ahmet İhsan Tokgöz, *Bambuş*

Nga Fortune du Boisgobey- Përktheu :Selanikli Tevfik, Mösyö Lekok'un İhtiyarlığı

### **Viti 1887**

Nga Eugene Sue- Përktheu: Yusuf Besim, *Şeytan Kayası Burnu Fazlı Necib, Familya Çocukları*

Nga Emile Gaboriau- Përktheu: Hüseyin Rahmı Gürpınar, *113 Numaralı Cüzden*

Nga Jules Mary- Përktheu: Selanikli Tevfik, *Menfur Roje*

Nga Jules Verne- Përktheu: Mehmed Emin, *Beş Hafta Balonla Seyehat*

Nga Georges Ohnet- Përktheu: Bogos, *Son Aşk Ahmet İhsan Tokgöz, Demirhane Müdürü*

Nga Hector Malot- Përktheu: Ahmet Midhat Efendi, *Bilgiç Kız Serafen, Kimyagerin Encamı*

### **Viti 1888**

Nga Eugene Sue- Përktheu: Halil Edibi, *Mis Meri ose Mürebbiye*

Nga Feneloni- Përktheu: Faik Reşad, *Hikaye-i Aristeneus*

Nga Emile Richebourg- Përktheu: Ahmet İhsan Tokgöz, *İki Valide*

Nga Emile Gaboriau- Përktheu: Mahmud Sakık, *Mösyö Lekok*

Nga Fortune du Boisgobey – Përktheu: Diran, *Marsel ose Yeni Paris Sevdaları D. K. Şeytanın Arabası*

Nga Leon de Tinseau- Përktheu: Ahmet Midhat Efendi, *Papazdaki Esrar*

Nga Jules Verne- Përktheu: Ahmet İhsan Tokgöz, *Kaptan Hartas'ın Seyehati*

Nga Georges Ohnet- Përktheu: Ahmet İhsan Tokgöz, *Kruvamor Kadınları*

### **Viti 1889**

Nga Paul de Kock- Përktheu: Mehmed Ata, *Üç Fıstanlı Kız Hafı, İki Güverci, Hemşire Ann*

Nga Xavier de Montepin - Përktheu: Ali, *Simon ve Mari, Kızıl Sihirbaz, Atamyın Mecnuneler Tabibi, Ahmet İhsan Tokgöz Ekmekçi Kadın, Ali Rıza Elams Tüccarı, Selanikli Tevfik Paris Faciaları*

Nga Eugene Sue- Përktheu: Halil Edibi, *Paris Esrarı*

Nga Emile Richebourg- Përktheu: Vassaf, *Büyük Valide*

Nga Emile Gaboriau- Përktheu: Hüseyin Rahmı Gürpınar, *Batinyolu İhtiyar Mehmed Ata, Loruj Davası*

Nga Lapointe- Përktheu: Ahmet İhsan Tokgöz, *Karnaval Cinayeti*

Nga Fortune du Boisgobey - Përktheu: Raif, Mustafa Fazıl, *Kedi Gözü Vassaf, Cinayetler*

Nga Alexis Bouvier- Përktheu: Ali Kemal, *Bir Mahkumun İzdivacı ose İstikad Köprüsü Cinayeti*

Nga Adolphe Belot- Përktheu :Andon, *Cinayet Çiçeği*

Nga Anne Radcliffe- Përktheu: Ahmet Midhat Efendi, *Odolf Hisarı*

Nga Jules Verne- Përktheu: Ahmet İhsan Tokgöz, *Kaptan Grant'in Çocukları, Selanikli Tevfik Üç Rus ve Üç İnglizin Afrika'da Seyehati, Safaren Bir Doktorun Rüyası*

Nga Octave Feuillier- Përktheu: Mahmud Sadık, *Müteveffiyeye*

Nga Geroges Ohent- Përktheu: Ahmet İhsan Tokgöz *Kontes Sara, Fatma Aliye Merarm*

Nga Emile Zola- Përktheu: Muallim Naci, *Therese Raquin*

### **Viti 1890**

Nga Voltaire- Përktheu: İbnü'l Kamil, *Küremizde seyehat*

Nga Alexandre Dumas- Përktheu: Ahmet İhsan Tokgöz *Meçhul bir Gemi, Suleyman Nazif Sevdanın Meyusiyeti yahud İnkişaf-ı Esrar*

Nga Paul de Kock- Përktheu: Ahmet İhsan Tokgöz *Tahuf Bir Hane, Ahmet İhsan Tokgöz Kaybolmuş Bir Zevc, D. M. Tevfik Kaybolmuş Bir Zevc*

Nga Xavier de Montepin- Përktheu: Ali Rıza, H. S. Tevfi dhe Mehmed Tevfik *Gece Kraliçesi, Ali Rıza dhe Halil Edib 13 Numaralı Araba, Ali Rıza dhe Halil Edib Jan Jödi, Süleyman Nazif Asniyer Facası, Mehmed Şakir Büyük İkramiye,*

M. Rif'at *Piyasada Bir Çiçek*, Şefik *İki Sevda ose Vahşi*, Ali Selahaddin *Bir Facire*, K. S Çingene Kızı, Selanikli Tevfik, *La Vikontes Jermen*

Nga Ponson de Trail- Përktheu: H. S. Tevfik, *Meç Arkadaşları*

Nga Pierre Zaccone- Përktheu: H. M. A. *Kolonel Rober ose Belvildeki Şahs-ı Meçhul*, Selaniki Tevfik *7 Numaralı Hapishane Odası*, Mehmed Halid *Bir Kontun Cinayetleri*

Nga Emile Gaboriau- Përktheu: Hüseyin Rahmı Gürpınar, *Bir Kadının İntikamı*

Nga Jules Mary- Përktheu: Mehmed Tal'at *Bir Tabanca Darbesi*, Hüseyin Vassaf *Biçare Familya*, İbraim Nuri *Zavallı Klotilt*

Nga Jules Verne- Përktheu: Ahmet İhsan Tok göz *Gizli Ada*, *Deniz Altında 20.000 Fersah Seyahat*, Ahmet İhsan Tokgöz ve Mazhar *Kaptan Hatras'ın Seyehati*, Çin'de *Seyahat*, *Cevv-i Havada Seyahat*, *Siyalı Hindistan*, Selanikli Tevfik *Elmaspare*, Ali Selahaddin *Şehr-i Seyyar*

Nga Alexandre Dumas-Fils- Përktheu: Ahmet İhsan Tokgöz, *Tek mi Çift mi?*, *Hermin*

Nga Octave Feuillet- Përktheu: Ahmet İhsan Tokgöz, *Bir Kadının Ruznamesi*

Nga Georges Ohne- Përktheu t: Ahmet İhsan Tokgöz *Hırsız Kadın*, Mahmud Sadık *Çeyisiz Kız*, Muzaffer Gıyaseyddin *Nesis*

Nga Hector Malot- Përktheu: M. Tevfik, *Bikes ose Familyadan Mahrumiyet*

Nga Guy de Maupassant- Përktheu: *Seyyad Zeynel*, *Zeytinlik*

### **Viti 1891**

Nga Paul de Kock- Përktheu: Mehmed Ata *İşret*, Mehmed Ata *Kumar*, *Nisvan Belası*, Ahmet İhsan Tokgöz *Sütçü Kızı*, İsmail Hakkı *Edmond ve Nişanlısı*, Mustafa Refik *Laridoni'un Sergüzeşti*

Nga Xavier de Montepin- Përktheu: Mustafa Refik *Tunçtan Kızlar*, Mehmet Şakir *Güzel Anjel*

Nga Jules Mary : Selanikli Tevfik, *Cazibeli*

Nga Jules Verne- Përktheu: Ahmet İhsan Tokgöz *Mihver-i Arz*, *Araba İle Devr-i Alem*, Mustafa Refik *Hayal İçinde Hakikat*

Nga Georges Ohnet- Përktheu: Muzaffer Gıyaseyddin *Suziş*, Leskovikli Hayredin *Sevda ose Kuğu Nağmes*

Nga Guy de Maupassant- Përktheu: Amir Tevfik, *Ziyet*

Nga Tolstoy- Përktheu: Günar de Lebedef, *İlyas*, *Familya Saadeti*

**Viti 1892**

Nga Xavier de Montepin- Përktheu: Muzaffer Gıyaseddin, *Fakirler Tabibi*

Nga Jules Mary- Përktheu: A.Kemal, *İzabel*

**Viti 1893**

Nga Alexandre Dumas- Përktheu: D. Karakin, *Tasadiif*

Nga Chetaubriand- Përktheu: Mehmed Celal, *Rene*

Nga Fortune du Boisgobey- Përktheu: İbrahim Nuri, *Biçare Rober*

Nga Jules Verne- Përktheu: İsmail Hakkı, *Balonada Facia*

Nga Alphonse de Lamartine- Përktheu: İsmail Hakkı, *Raphael*

**Viti 1894**

Nga Emile Richebourg- Përktheu: Nusret Hilmi, *Musibetli Gurur*

Nga Jules Mary- Përktheu: Mustafa Refik, *Kalb-i Cerihadar*

Nga Georges Ohnet- Përktheu: Tefik, *Piyer'in Ruh*

**Viti 1895**

Nga Emile Richebourg- Përktheu: Ali Nusret, *Köy Muaşakaları*

Nga Alphonse Daudet - Përktheu: Ahmet İhsan Tokgöz, *Genç Fromon ve İhtiyar Reisler*

**Viti 1896**

Nga Jules Mary- Përktheu: Mustafa Refik, *Gaston'un Muaşakası*

Nga Xavier de Montepin- Përktheu: Selanikli Tefik, *Para Kuvveti*

Nga Alphonse de Lamartine- Përktheu: M.S, E.L, *Raphael*

Nga Guy de Maupassant- Përktheu: Ali Muzaffer, *Toplu İğne*

**Viti 1897**

Nga Frederic Soulie- Përktheu: Reşad Midhat, *Netice-i Garam*

Nga Paul de Kock- Përktheu: Ali Bey, *Evlenmek İster Bir Adam*

**Viti 1896-1897**

Nga Xavier de Montepin- Përktheu: Selanikli Tefik, *Sevda Faciaları*



***Viti 1898***

Nga Alphonse de Lamartine- Përktheu: İskender Fahri dhe Müstecabizade İsmet,  
*Raphael*

Nga Paul Borget- Përktheu: Ahmet İhsan Tokgöz, *Sevda-i Hakiki*

***Viti 1899***

Nga Paul Borget- Përktheu: Ahmet İhsan Tokgöz, Mavi Düşes

## Përfundime:

- Siç edhe konstatohet nga renditja, gjëja e parë që bie në sy është përkthimi disa herë i të njëjtit libër nga i njëjti përkthyes siç është rasti i romanit “Telemak” i Fenelonit nga përkthyesi Yusuf Kemal Pasha që e përkthen katër herë brenda disa viteve, ose rasti i përkthimit të të njëjtit libër nga disa përkthyes të ndryshëm siç është rasti i “Të mjerët” i Viktor Hygos (një nga përkthyesit e tij është edhe Sami Frashëri) Arsyet duhen parë në përkthimet e dobëta që bëhen tek përkthimet e para dhe përmirësimet që u bëhen në variantin pasardhës.
- Një tipar tjetër që bie në sy është rrëmuja e përkthimeve. Përkthimet janë bërë pa asnjë kriter. Përgjithësisht përkthyesit e parë përkthenin librat që gjenin vetë ose që u pëlqenin. Ata nuk kishin ndonjë mundësi të madhe zgjedhjeje. Vetëm nga fundi i viteve 70 kemi një shtim të përkthimeve që tregon edhe shtim të numrit të romaneve franceze në Stamboll. Arsyetja e shtimit të përkthimeve mund të gjendet edhe tek largimi nga Stambolli i një grupi intelektualësh drejt Parisit dhe Londrës në fillimet e viteve 70 për shkak të persekutimit nga shteti dhe kthimi në atdhe në mes të viteve 70. Me kthimin e tyre intelektualët jo vetëm që sjellin një bibliotekë të pasur, por krijojnë edhe lidhje me shtëpitë botuese duke bërë që të mbajnë korrespondencë me ta. Në këtë periudhë fillon edhe përzgjedhja e romaneve duke preferuar romane që kanë sukses në perëndim.
- Përkthyesit e këtyre romaneve në shumicë janë vetëm turq (ose e thënë më ndryshe, mysliman, pra njerëz nga etni të ndryshme, por të fesë islame), por kemi edhe përkthyes armen, shqiptarë, grek ose çifut.
- Rëndësia që kanë këto përkthime edhe pse jo shumë të arrira nga pikëpamja përkthimore është përgatitja e lexuesit Osman për romanet turke që do të fillojnë të vijnë disa vite pas përkthimit të parë.
- Romanet e përkthyer pasqyrojnë Evropën e kohës duke bërë që një pjesë e shoqërisë të mundohet të imitojë mënyrën e jetesës Evropiane. Nga këta imitues kemi edhe daljen e një sërë personazhesh që do shohim në romanet e para turke.

### KREU III

#### ROMANCIERËT E PARË NË LETËRSINË TURKE

Fillimet e romanit në letërsinë turke ashtu si e pamë edhe më sipër ndodhën në një periudhë të ndryshimeve rrënjësore në shoqërinë e atëhershme Osmane ku përfshiheshin shumë popuj të ndryshëm që bashkëjetonin në shtetin Osman. Megjithatë, gjithë të rejtat që silleshin ose pranoheshin nga shoqëria ndodhin vetëm në Stamboll dhe vetëm pas kësaj mund të përcillen nëpër qytet e tjera të provincave të shtetit. Fatkeqësisht edhe kur arrinin të dilnin jashtë Stambollit ato mbeteshin në një rreth shumë të ngushtë intelektualësh. Kjo mënyrë e njohjes me të rejtat që vinin nga jashtë vazhdoi deri në krijimin e republikës së Turqisë në mesin e viteve 1920. Kështu që kur të flasim për romanin si gjini të re letrare në letërsinë turke duhet të kemi parasysh vetëm Stambollin si epiqendër të zhvillimeve letrare. Lexuesi kryesor ishte ai i Stambollit. Kështu që edhe romanet në tematikën e tyre preknin probleme të cilat edhe pse mund të ishin më të përgjithshme për shoqërinë përsëri ishin në variantin e parë në Stamboll.

Studimet e para të rëndësishme në lidhje me fillimet e romanit në letërsinë turke kanë filluar rreth gjysmë shekulli pas daljes së romaneve të para turke. Një nga studimet e para të mirëfillta është libri i Mustafa Nihat Özön “Türkçede Roman” i botuar në 1936. Në këtë libër pasi jepet një historik i përgjithshëm i rrymave letrare në Evropën perëndimore jepet zhvillimi i tregimtarisë turke në shekuj. Më pas jepet një përmbledhje e Ahmet Mid’hat Efendit, një nga romancierët e parë turq të cilin do e trajtojmë edhe më poshtë. Pas tij studim tjetër, por më i përgjithshëm në lidhje me letërsinë turke të shekullit të XIX është ai i Ahmet Hamdi Tanpınar botuar në 1949. Megjithëse romanin e prek vetëm në një kapitull të librit të tij ai vë bazat e studimit të fillimeve të romanit duke qenë se edhe sot e kësaj dite ky libër merret si pikë referimi nga gjithë studiuesit e kësaj fushe. Pas këtyre dy studimeve kemi një interesim të studiuesve turq në lidhje me romanin dhe fillimet e tij në letërsinë turke.

Duke filluar nga vitet 1950 studiues të rinj jo vetëm që e studiuuan, por edhe kontribuan në hapjen e horizonteve të reja madje duke sjellë edhe zbulime të veprave të reja më të hershme në lidhje me fillimet e romanit në letërsinë turke. Fillojnë studimet më të detajuara në autorë të veçantë ose në vepra të veçanta. Siç është rasti i Guzin Dino që studion në mënyrë të hollësishme romanin e kësaj periudhe duke vënë theksin tek romani “Intibah” të shkrimtarit Namik Kemal.

Të gjitha punimet e bëra në lidhje me fillimet e romanit startojnë nga dy pika të njëjta për të gjithë studiuesit. E para është lidhja që ka fillimi i romanit me prozën ose tregimin e letërsisë turke të mëparshme. E dyta është lidhja që ka me letërsinë franceze ose më mirë me romanin francez të shekullit të XIX duke e filluar nga përkthimet e para në gjuhën turke.

Në fakt kjo është logjike duke qenë se asnjë zhanër i ri në një letërsi nuk del nga hiçi, por është një variant i ri ose i ndryshëm i asaj që ekziston. Përpara se të kalojmë në prezantimin dhe analizimin e romaneve të para në letërsinë turke do ishte më me vend të njiheshim me autorët që i kanë shkruar këto romane, jetën dhe pikëpamjet e tyre jo vetëm për artin, por edhe për shoqërinë, politikën dhe kulturën në përgjithësi pasi vetëm kështu do të kemi një paraqitje më të plotë dhe të kuptueshme të fillimit të romanit në letërsinë turke. Jeta e këtyre shkrimtarëve ka ndikuar drejt për së drejtë në veprat e tyre.

### 3.1 Sami Frashëri (1851-1904)

#### Jeta:

Sami Frashëri (Şemsettin Sami) lindi në fshatin Frashër të Përmetit i cili ishte pjesë e prefekturës së Janinës në vitin 1850. I ati ishte Halit Frashëri, pronar i madh tokash ndërsa e ëma quhej Emine. Samiu i përket një familjeje me rëndësi të veçantë në historinë e Shqipërisë. Së bashku me vëllanë e madh Abdylin dhe Naimin ata kontribuan në ngritjen dhe zhvillimin e rilindjes shqiptare. Megjithatë duhet të pranojmë që Sami Frashëri ka dhënë më shumë vepra në gjuhën dhe kulturën turke sesa për atë shqiptare.

Arsimin fillestar e mori në Frashër nga Mahmut Efendi nga Tepelena. Babai i vdes në moshë të re (rreth moshës nëntë vjeçare) pak vite më vonë i vdes edhe e ëma. Për këtë arsye ai rritet nga vëllai i tij i madh Abdyl Frashëri, i cili së bashku me familjen e tij të madhe në vitin 1861 zhvendoset në Janinë. Një nga arsyet kryesore të zhvendosjes ishte për të shkolluar më mirë vëllezërit e tij.

Me vajtjen në Janinë, Samiu së bashku me Naimin regjistrohen në gjimnazin grek "Zosimea". Përveç shkollës Samiu merr mësimë private nga Jakup Efendiu. Në gjimnazin grek Samiu mëson greqishten e re, greqishten e vjetër, frëngjishten dhe italishten. Përveç tyre ai merr mësimë mbi gjeografinë, historinë, filozofinë, astronominë, matematikën, anatomicën dhe historinë e natyrës.<sup>31</sup> Pasi mbaron shkollën punon për një vit në Janinë dhe pastaj shkon në Stamboll ku futet në zyrën e shtypit në vitin 1871. Menjëherë fillon të shkruaj një histori të përgjithshme, por nuk e boton. Në vitin 1873, pas një periudhe të shkurtër si gazetar në gazetën Kandili (Sirac), merr përsipër të drejtë gazetën Kopshti (Hadika). Gazeta mbyllet pas numrit 42.

Sami vazhdon të punojë në zyrën shtypit, por pasi dëgjon se kërkohet një gazetar për të drejtuar gazetën Vilajeti në Tripoli nis për në Libi duke kaluar nga Janina, Korfuzi, Brindizi, Napoli, Mesina dhe Malta.<sup>32</sup> Merr detyrën në 18 Qershor 1874 dhe e mban këtë detyrë deri në 4 Mars 1875. Më pas kthehet sërish në Stamboll. Në fillim të vitit 1876 boton 4 numra të revistës Shkrimtari (Muharrir). Në 8 mars 1876 fillon të botojë gazetën Mëngjesi (Sabah) të cilën e vazhdon deri në 3 janar 1877. Po atë muaj shkon si sekretar i Sava Pashës i cili ishte emëruar si prefekt i Algjerisë. Pas pesë muajsh largohet nga kjo detyrë dhe punon për disa muaj në Janinë si kryesekretar i Abedin Pashës i cili ishte kryetar i "Komisionit të Logjistikës" të krijuar për shkak të luftës me Rusinë. Në fund të vitit 1877 kthehet në Stamboll ku fillon të punojë si gazetar në gazetën Interpreti i Lindjes. Shkrimet e tij në këtë gazetë vazhdojnë deri në 5 nëntor 1878.

Në këtë periudhë perandori Osmane po kalonte një nga çastet e saj më të vështira. Humbja e luftës me Rusinë kishte sjell humbje të territoreve të mëdha dhe rrezikun e humbjes së territoreve të tjera. Një nga territoret që mund të humbeshin ishin edhe trojet me shumicë shqiptare. Për këtë arsye ai përfshihet në një debat të ashpër në lidhje me gjendjen që ndodheshin shqiptarët. Në vitin 1879 krijohet Shoqëria e Shkronjzave Shqip në Stamboll ku Sami Frashëri është anëtarë. Në të njëjtin vit boton revistën Familja (Aile) dhe në vitin 1880 revistën Java (Hafta). Në vitin 1881 emërohet sekretar në Komisionin e Inspektimit Ushtarak.<sup>33</sup> Në vitin 1884 martohet me Eminenë,

<sup>31</sup> A. S. Levend, Şemsettin Sami, Stamboll, 2010, f.35

<sup>32</sup> A. S. Levend, Şemsettin Sami, Stamboll, 2010, f.36

<sup>33</sup> A. S. Levend, Şemsettin Sami, Stamboll, 2010, f.37

vajzën e Sadettin Efendit, një qeveritari të lartë nga Edremiti<sup>34</sup>. Pas martesë transferohet në vilën verore të vjehrrit, në Kandili të Stambollit. Kjo periudhë është shumë produktive nga ana e botimeve të veprave të ndryshme. Në vitin 1893 ngrihet në detyrë nga sekretar në kryesekretar të Komisionit të Inspektimit Ushtarak. Në të njëjtin vit i vdes e shoqja. Në vitin 1894 martohet me Ballkëzin, vejushën e Abdyl Frashërit, vëllait të tij, i cili kishte vdekur 2 vjet më parë. Arsyeja e martesës ishte sepse i vëllai i kishte lënë amanet djalin Mit'hatin (Mit'hat Frashëri) dhe vajzën Eminenë. Samiu sëmuret nga nervi shiatik gjatë qëndrimit në vilën në Kandili. Në të njëjtën periudhë fillon ndërtimin e një vile për veten dhe familjen në Erenkoj të Stambollit. Fillon të banojë aty në vitin 1896 para se të mbarojë përfundimisht.<sup>35</sup> Gjatë kësaj periudhe edhe pse paguhej nga shteti për detyrën e tij ai dënohet me arrest shtëpie nga Sulltan Abdylhamiti, dënim që i zgjati deri në vdekje në vitin 1904. Është i çuditshëm fakti që edhe pse ishte i dënuar me arrest shtëpie, Sami Frashëri merr disa dekorata nga vetë Sulltan Abdylhamiti për kontributin e dhënë në kulturën Osmane me librat e ndryshëm që botoi.

### **Karakterit dhe principet:**

Sami Frashëri u përfshi në jetën intelektuale të shtetit Osman në një moshë fare të re, por me një përgatitje shumë të fortë për shkak të arsimimit të tij në gjimnazin Zosimea. Duke qenë sistematik në marrjen e dijeve Sami Frashëri ndryshe nga bashkëkohësit e tij ishte i pajisur me dije të forta si nga qytetërimi perëndimor ashtu dhe nga ai lindor. I vetmi problem për Samiun në fillimet e tij ishte turqishtja e cila nuk ishte në nivelin e duhur. Këtë gjë ai arrin ta përmirësojë duke punuar si gazetar dhe duke botuar romanin e parë turk. Megjithatë edhe pse me njohuri në fusha të shumta duhet të themi se këto njohuri nuk ishin shumë të thelluara dhe ky është një tipar i të gjithë intelektualëve të kohës. Në vitet e para të shkrimeve të tij ai boton pjesë teatrale, romanin e vetëm, dhe disa përkthime nga frëngjishtja. Me anë të këtyre veprave ai përmirëson veten si në gjuhët e huaja ashtu edhe në turqisht. Vlen për të theksuar se Sami Frashëri vetë shprehet se nuk i pëlqen të shkruaj roman.<sup>36</sup> Një nga arsyt kryesore pse Samiu mund të ketë shkruar romanin dhe pjesët teatrale mund të jetë edhe mungesa e këtyre gjinive letrare në letërsinë turke të kohës.

Sami Frashëri në vazhdim të jetës së tij pas fillimit në fushën letrare kalon në fushën e kulturës së përgjithshme duke botuar një sërë librash xhepi me tematika nga fusha të ndryshme. Kjo gjë bëhej edhe nga shkrimtarë të tjerë, por Sami Frashëri prek edhe tema të tjera që nuk ishin prekur më parë si në fushën e gjuhësisë ose shenjave të pikësimit. Përveç këtyre librave ai merret dhe me probleme gjuhësore si të turqishtes ashtu dhe të shqipes e arabishtes si dhe me fjalorët frëngjisht–turqisht dhe turqisht–frëngjisht. Pas kësaj periudhe shumë frytdhënëse për sa i përket volumit Samiu kalon në periudhën e pjekurisë ku boton dhe dy nga veprat e tij më të rëndësishme. Fjalorin e gjuhës turke dhe enciklopedinë e përgjithshme.

Gjatë gjithë jetës së tij letrare 34 vjeçare, Samiu u shqua jo vetëm për një punë voluminoze, por edhe për risitë që solli qoftë në letërsinë turke ashtu

<sup>34</sup> Qytet në brigjet e detit Marmara .

<sup>35</sup> A. S. Levend, Şemsettin Sami, Stamboll, 2010, f.37

<sup>36</sup> Kështu i ka thënë vajza e Samiut, Samija, gazetarit Hikmet Feridun Es në intervistat e botuara në gazetën Aksham në fund të dhjetorit 1944 dhe fillim të janarit 1945.

edhe në hapjen e tematikave të reja në gjuhë dhe gazetari. Një nga cilësitë e tij më të rëndësishme ishte puna sistematike. Vetëm me anë të kësaj cilësie ai arriti i vetëm të botonte vepra voluminoze si enciklopedia dhe fjalori i turqishtes në një kohë relativisht të shkurtër. Një cilësi tjetër e tij ishte edhe këmbëngulja me të cilën punonte në fushat e paprekura siç ishte fusha e shenjave të pikësimit në gjuhën turke si dhe në fushën e fjalorit. Për fatin tonë të keq Sami Frashëri ka kontribuar më shumë në kulturën dhe gjuhën turke sesa në atë shqipe duke hedhur bazat e gjuhës së re turke. Ndonëse Sami Frashëri është një iluminist dhe kërkon edukimin e masës së gjerë ai ka dhënë kontributin më të madh në gjuhën turke. Jo vetëm me fjalorin e gjuhës turke, por edhe me studimet që bëri mbi shkrimet e para turke të Shkrimet e Orhunit, libri Kutatgu Bilig dhe studimi mbi dialektet e turqishtes në Egjipt<sup>37</sup> si dhe shkrimet e tjera nëpër gazeta ai hodhi dritë mbi lashtësinë e gjuhës turke duke qenë një nga studiuesit e parë që solli në vëmendjen e lexuesit turk se gjuha turke jo vetëm ishte e lashtë, por edhe shumë e pasur dhe e ndryshme nga persishtja dhe arabishtja. Sami Frashëri edhe pse ka debatuar për shumë tema, nganjëherë edhe politike, kurrë nuk ka qenë një politikan i zjarrtë ashtu siç do ta shohim një tjetër intelektual të njohur të kohës që është Namik Kemali. Megjithatë ai nuk i shpëton censurës së shtetit, e cila më vonë kalon deri në kontrollin edhe të jetës së tij duke e mbajtur në arrest shtëpie për një kohë shumë të gjatë deri në vdekjen e tij.

### **Veprat e Sami Frashërit:**

#### **Përkthimet :**

1. Tarih-i Mücmel-i Fransa (1872)
2. İhtiyar Onbaşı (1873)
3. Galatee (1873)
4. Şeytanın Yadigarları (1878)
5. Sefiller (1880)
6. Robenson (1885)
7. Hikmetü'l-Himam fi Neşrü'l-İslam (1885)
8. Hurde-Çin (1885)
9. Tatbikat-ı Arabiyye (1901)
10. Ali İbn Ebi Talib Kerremallahu Vechehu ve Radiyallahu anh Efendimizin Eş'ar-ı Mütehabeleri ve Şerh ve tercümesi (1902)

#### **Romani :**

1. Taaşşuk-ı Tal'at ve Fitnat (1872)

#### **Pjesët teatrale :**

1. Besa yahut Ahde Vefa (1875)
2. Seydi Yahya (1875)
3. Gave (1876)

---

<sup>37</sup> Edhe pse këto punime mbetën në dorëshkrime deri në vdekjen e Samiut.

**Seria Libraria e Xhepit :**

1. Medeniyet-i İslamiyye (1879)
2. Esatir (1879)
3. Gök (1879)
4. Yer (1879)
5. İnsan (1879)
6. Emsal (1879)
7. Letaif (1883)
8. Yine İnsan (1886)
9. Lisan (1886)
10. Usul-i Terkip ve Tertib (1886)

**Fjalorët :**

1. Kamus-i Fransevi (Frëngjisht-Turqisht) (1882)
2. Kamus-i Fransevi (Turqisht-Frëngjisht) (1885)
3. Küçük Kamus-i Fransevi (1887)
4. Kamus-i Arabi (1895)
5. Kamus-i Türki (1899/1900)

**Anciklopedi :**

1. Kamusu'l Alam (1889/1899)

**Veprat didaktike :**

1. Tasrifat-ı Arabiyye (1887)
2. Yeni Usul Elifba-yi Türki (1891 )
3. Nev-Usul Sarf-ı Türki (1891)
4. Tatbikat-ı Arabiyye ( 1900)
5. Alfabeti i Shqipës

**3.2 Namik Kemal (1840-1888)****Jeta:**

Namik Kemali lindi në Tekirdag. Një qytezë rreth 100 km larg Stambollit në anën Evropiane të shtetit Osman në 21 dhjetor të vitit 1840. Nga ana e babait ai rridhte nga një familje e madhe komandantësh dhe studiuesish. Babai ishte Mustafa Asim Beu, kryeastrologu i pallatit perandorak ndërsa nëna ishte Fatma Zehra Hanim. Me vdekjen e nënës në moshë të vogël ai dërgohet për tu rritur pranë Abdylatif Pashës, gjyshi nga ana e nënës. Duke qenë se rritet pa kontrollin e prindërve bën një jetë të lirë dhe pa shumë detyrime si në vogëli ashtu edhe në rininë e hershme. Arsimin në fëmijëri e merr nga mësues privatë pranë gjyshit. Po ashtu ai jeton në Kars në lindje të perandorisë Osmane dhe në Sofje e cila në atë kohë ishte ende pjesë e perandorisë Osmane duke qenë se gjyshi i tij ishte emëruar me detyrën e guvernatorit. Duke qenë se nuk mori dot një arsimim të rregullt ai edukoi veten në mënyrë autodidakte.

Gjatë qëndrimit në Sofja martohet në moshën 16 vjeçare me Nesimenë. Nga kjo martesë ai ka dy fëmijë, vajzën Feride të lindur në 1864 dhe djalun Aliun të lindur në 1867. Në vitin 1857 kthehet në Stamboll. Pas kthimit në Stamboll fillon të ndjek me entuziazëm zhvillimet letrare të kohës.

Gjatë kësaj periudhe njihet me poetë të famshëm të rrymës “Encüment Şairleri” që ishte një rrymë e letërsisë së Divanit si Leskofçallë Galib, Hersekli Arif Hikmet, Kazëm Pasha, Sadullah Pasha etj. Ai bëhet mik me shumë nga

këta poetë, madje mahnitet nga stili i Leskofçallë Galibit për shkak të shqetësimeve sociale që ai përfshinte në poemat e tij. Kjo gjë mund të shihet edhe në ndikimin që pati në poemën e famshme “Liria” (Hürriyet Kasidesi) të Namik Kemalit.

Në të njëjtën periudhë ai futet në punë në “Zyrën e përkthimeve”. Në këtë zyrë ai njihet me persona të cilët e njihnin mirë dhe ishin të pasionuar pas qytetërimit dhe kulturës perëndimore. Nga këtu atij i lind dëshira për të lexuar nga origjinali veprat dhe shkrimet e botës perëndimore dhe për këtë arsye fillon të mësojë frëngjisht. Ai bën përkthimet e para të Montesquieu nga frëngjishtja që para se të njëjtojë me Shinasiun, i cili luan një rol të rëndësishëm në formimin e tij intelektual.

Përkthimi i Montesquieu nuk ishte një rastësi. Së bashku me kolegët e tij, ai gjatë gjithë jetës do të ndikohet nga filozofët J.J. Rousseau, Voltaire dhe Montesquieu të cilët frymëzuan revolucionin Francez të vitit 1789.

Në fakt vetëm pas njohjes me publicistin Shinasi, rreth vitit 1863 ai fillon të jetë më shumë aktiv në jetën publike të vendit duke botuar mendimet e tij në gazetën Tasvir-i Efkâr. Gazeta e parë private e botuar nga Shinasiu. Kjo është një pikë kthese e aktivitetit të Namik Kemalit. Pas problemeve që pati Shinasiu me shtetin dhe largimit të tij drejt Parisit, Namik Kemali merr përsipër botimin e gazetës duke u bërë drejtori i saj.

Me entuziazmin që do e karakterizojë gjatë gjithë jetës së tij ai e kthen gazetën në një përfaqësues të mendimeve dhe problemeve të popullit. Për shkak të shkrimeve të ashpra që kërkonin shtypjen me egërsi të kryengritjes së grekëve në ishullin e Kretës në vitin 1866 gazeta e tij konsiderohet si gazetë patriotike nga shumica e turqve., por për këtë dhe për shkak të shkrimeve që botonte kundër grekëve të Bejoglusë (zonë ku jetonin me shumicë grekët e Stambollit) të cilët flisnin kundër turqve, ai do të konsiderohej edhe si poet kombëtar.

Megjithatë për shkak të shkrimeve të ashpra ndaj qeverisë, të cilën e kritikonte për paaftësinë e saj për zgjidhjet e problemeve si të brendshme ashtu edhe të jashtme, gazeta mbyllet dhe ai dërgohet si një lloj internimi në Erzurum me detyrën e inspektorit. Bashkë me të do të dërgoheshin me detyra të tilla edhe Zija Pasha dhe Ali Suavi, të cilët e kishin bezdisur qeverinë me shkrimet e tyre. Të tri këta intelektualë ishin pjesë e shoqërisë së fshehtë “Xhonturke” ose e thënë ndryshe Osmanët e rinj. Kjo shoqëri e sponsorizuar nga princi Mustafa Fazëll Pasha i Egjiptit kishte si synim krijimin e një kushtetute, krijimin e një parlamenti dhe drejtimin e shtetit nga një monarki parlamentare.

Të tri këta intelektual në vend që të shkojnë në detyrat e caktuara emigrojnë në Paris dhe më pas në Londër ku Namik Kemali së bashku me Zija Pashën nxjerrin gazetën Muhbir dhe Hürriyet (1867-1868) ku sulmojnë qeverinë Osmane.

Pas disa mendime ndryshe që pati me anëtarët e tjerë të shoqërisë dhe pas një korrespondence që pati me kryeministrin e atëhershëm, i cili i premtoi falje, Namik Kemali kthehet në Stamboll në vitin 1870.

Pas kthimit në Stamboll Namik Kemali, së bashku me Ebuzzija Tevfik dhe dy miq të tjerë nxjerr gazetën Ibret. Në këtë gazetë ai ndjek një politikë që sulmonte kolonizimin nga perëndimi dhe mbronte ideologjitë e panislamizmit dhe panosmanizmit. Për shkak të këtyre shkrimeve, ku kërkonte pavarësinë ndaj shteteve perëndimore, gazeta mbyllet pas numrit të 19. Ai dërgohet në



internim në Gelibolu. Në këtë periudhë (viti 1873) ai shkruan pjesën teatrale “Vatan yahut Silistre” e cila e kthen atë në një hero kombëtar për popullin e thjeshtë, por i sjell atij edhe internimin e radhës këtë herë në Maguza të Qipros. Këtë herë jo me një detyrë shtetërore, por me burgim, ndonëse nuk ishte burgim i mirëfilltë pasi lejohej të shëtiste nëpër qytet dhe të mbante korrespondencë me miqtë e tij në Stamboll. Ky internim vazhdon deri në 1876 kur pas rrëzimit nga fronti të Sulltan Abdylazizit rikthehet në Stamboll.

Me ardhjen në pushtet të Sulltan Abdylhamitit merr disa poste të rëndësishme ku bie në sy pjesëmarrja në komisionin që përgatit kushtetutën. Në të njëjtën kohë bëhet deputet i parlamentit të parë në shtetin Osman. Kjo gjendje nuk zgjat shumë dhe pas mbylljes së parlamentit nga Sulltani ai largohet përsëri nga Stambolli me detyra të ndryshme duke u dërguar në fillim në ishullin e Midilit dhe pastaj në ato të Rodosit dhe të Sakëzit ku edhe vdes në vitin 1888. Megjithëse ka edhe disa spekulime se mund të jetë helmuar nga pushteti për shkak të ideve të tij.

### **Karakteri dhe principet e Namik Kemalit**

Namik Kemali ishte një person i dashuruar me lirinë dhe zgjedhjen e lirë të njeriut. Gjithë ato që ai bëri dhe shkroi si në politikë ashtu edhe në fushën sociale lidhen me këto pikëpamje. Namik Kemali ishte një njeri i kompletuar për kohën kur jetoi dhe kjo më shumë falë aftësisë dhe vullnetit të tij për të mësuar sesa nga arsimimi që mori. Këto aftësi për të thithur të renë, ai i përdori edhe për ti transmetuar tek të tjerët. Aftësia e tij si lider bën që ai të bëhej i famshëm në një kohë të shkurtër. Në një periudhë kohore gati 30 vjeçare ai dha kontributin e tij në shumë fusha të publicistikës duke filluar nga kritika politike dhe sociale e deri tek romani, pjesët teatrale, poezitë, librat historik dhe monografitë.

Në gjithë shkrimet e tij dallohen ato mendime që ai kishte në lidhje me shoqërinë dhe drejtimin që duhet të kishte qeveria e shtetit Osman. Principet e tij kryesore ishin dashuria për atdheun, dashuria për lirinë, parlamentarizmi si një nga mënyrat më të mira qeverisëse, panosmanizmi që më pas u kthye në panturanizëm (panturkizëm), panislamizëm, edukimi dhe arsimimi i popullit. Megjithatë shpërndarja në gjithë këto fusha bëri që Namik Kemali të mos arrinte të thellohej tek të gjitha. Kjo ishte mënyra sesi mundoheshin intelektualët e periudhës së parë të Tanzimatit për t’iu afruar problematikave të mëdha që kishte shteti dhe shoqëria e kohës.

Sipas fjalëve të Jahja Kemalit, një intelektual tjetër i madh turk, Namik Kemali ishte “një njeri i mejdanit” domethënë një njeri i sfidave<sup>38</sup>. Gjithë qenia e tij sociale, letrare dhe politike përmbledhet brenda këtij përkufizimi shumë të gjetur. Ai do të bëhet edhe një shembull për brezat pasardhës. Këtë e shpreh shumë qartë me një fjali të vetme një poet tjetër turk, Sylejman Nazif, “Bizi yaratan Allah, yetiştiren Namık’dır.” (Ne na krijoi Zoti, na formoi Namik Kemali.<sup>39</sup>) Në çdo fushë që shkroi ai futej vullshëm duke sjellë energjinë e tij të pashtershme dhe ajo që është më e rëndësishme ide të reja dhe revolucionare për kohën dhe shoqërinë osmane. Shkrimet e tija i sollën shumë probleme me shtetin. Një pjesë të madhe të jetës së tij e kalon në arrati,

<sup>38</sup> Ahmet Kabaklı, Türk Edebiyatı, Völlimi 3, Stamboll, 1994. f. 47

<sup>39</sup> Po aty

internime ose burg. Këto pengesa nuk e ngadalësuan vrullin e tij. Ai vazhdoi të mbronte atë që ai besonte.

### **Veprat e Namik Kemalit:**

#### **Poezitë :**

1. Divan (1868)

#### **Romanet :**

1. Intibah (1874)
2. Cezmi (1880)

#### **Pjesët teatrale :**

1. Vatan yahut Silistri (1874)
2. Akif Bey (1874)
3. Zavallı Çocuk (1874)
4. Gülnihal (1876)
5. Celaleddin-i Harzemşah (1876)
6. Kara Bela (botuar pas vdekjes) (1911)

#### **Shkrime mbi letërsinë dhe kritika letrare :**

1. Bahar-ı Danış (1885)
2. Tahrib-i Harabat (1887)
3. Takib (1887)
4. İrfan Paşaya Mektub (1888)
5. Son Pişmanlık (-1888)
6. Celal Mukaddimesi (1888)
7. Mes Prisons Muahezenamesi (1886)
8. Renan Madafaanamesi (botuar pas vdekjes) (1911)
9. Makalat-ı Siyasiyye ve Edebiyye (botuar pas vdekjes) (1912)
10. Namık Kemalın mektupları (botuar pas vdekjes në katër vëllime nga Fevziye Abdullah Tansel)
11. Talim-i Edebiyat (botuar pas vdekjes nga Nexhmettin Halil Onan)

#### **Librat me tematikë historike :**

1. Devr-i İstila (1872)
2. Barika-i Zafer (1873)
3. Evrak-ı Perişan (1873)
4. Kanije (1875)
5. Osmanlı Tarihi (1888)
6. Silistri Muhasarası (1874)

### **3.3 Ahmet Mid'hat Efendi (1844-1912)**

#### **Jeta:**

Ahmet Mid'hat Efendi lindi në një familje me të ardhura mesatare në Stamboll. Humbet babanë në moshë shumë të vogël. Për këtë arsye detyrohet të punojë që në moshë të vogël duke punuar si çirak në një dyqan. Më pas shkon pranë vëllait nga babai që punonte drejtor tatimesh në prefekturën e Vidinit (Bullgaria e sotme) ku edhe bën shkollën fillore. Shkollën tetëvjeçare e

vazhdon në Stamboll dhe Nish. Edukimin dhe kompletimin kulturor e merr kur ishte nëpunës në Rusçuk dhe Bagdat.

Ahmet Mid'hati e fillon punën si nëpunës në Rusçuk (Prefektura e Tunës, Danubit, ), kjo edhe falë ndihmës së vëllait të tij. Në një kohë të shkurtër ai bëhet i preferuari i Mid'hat Pashës, guvernatorit të zonës. Nën mbrojtjen e tij, i cili i dha edhe emrin Mid'hat (diçka e zakonshme për kohën ku një person i fuqishëm merrte pranë vetes të rinj me të ardhme dhe i arsimonte) Ahmet Mid'hati pati mundësinë të përparonte në studimet e tij.

Nga njëra anë mësonte mbi kulturën turke dhe islame në mësimet që jepeshin në xhami dhe nga ana tjetër mësonte frëngjisht nga një nëpunës me emrin Dragon.

Në këtë periudhë boton shkrimet e tij të para në gazetën Tuna. Duke qenë se Mid'hat Pashait i pëlqejnë shkrimet e tij, emërohet kryeredaktor i gazetës. Këtu Ahmet Mid'hati mëson si përgatitet dhe botohet gazeta.

Në 1868 shkon në Bagdat duke qenë se Mid'hat Pashai emërohet guvernator atje. Ashtu si edhe në Rusçuk drejton gazetën lokale të quajtur Zevra.

Gjatë kësaj periudhe njihet me dy persona të cilët i hapin dy botë të ndryshme. I pari është Hamdi Beu, një piktor i famshëm i sapo kthyer nga Evropa. Ky person e njeht Ahmet Mid'hatin me botimet e huaja. I dyti është një filozof lindor me emrin Muhammed Khan Muattar. Falë tij Ahmet Mid'hati njihet më në thellësi me kulturën dhe filozofinë e pasur orientale.

Me vdekjen e vëllait, Ahmet Mid'hati detyrohet të marr familjen e tij të madhe dhe të kthehet në Stamboll. Qëllimi i tij është që të fitojë jetesën me anët të tregimeve që shkruante dhe të mos punonte më si nëpunës.

Merr një shtëpi me qira dhe aty ngre një shtypshkronjë të vogël ku punon familjarisht për të shtypur librat me tregime që shkruante vetë.

Që nga kjo kohë (viti 1871) e deri në vdekje fillon periudha e prodhimit të Ahmet Mid'hatit. Ndonëse për arsye kohore ai nuk është romancier i parë turk, për nga prodhimtaria dhe shumëllojshmëria ai mund të quhet padyshim babai i romanit dhe prozës turke.

Ndonëse ishte tip që nuk përzihej me politikë, në vitin 1873 internohet nga Stambolli së bashku me Namik Kemalin dhe shumë të tjerë. E dërgojnë në Rodos ku pas një periudhe të shkurtër burgimi lejohet të shëtis nëpër ishull. Në vitin 1876 me shpalljen e parlamentit falet dhe kthehet në Stamboll. Në fakt Ahmet Mid'hati asnjëherë nuk ishte bërë pjesë e grupeve opozitare, kështu që me ardhjen në fron të Sulltan Abdylhamitit ai kërkon mundësinë që ta mbaj mirë me të. Mesa duket ja arrin qëllimit sepse jo vetëm që nuk internohet më, por emërohet edhe në poste të rëndësishme shtetërore. Gjatë kësaj periudhe boton një nga gazetatat më në zë të kohës Tercüman-ı Hakikat. Pas kësaj periudhe për Ahmet Mid'hatin fillon një periudhë relativisht e mirë financiare. Blen disa prona dhe një vilë në Bejoglu. Më pas bën një shëtitje 3 mujore në Evropë në vitin 1888. Merr detyra të ndryshme shtetërore në nivele drejtorie. Pas vitit 1908 vazhdon të jap mësim në lëndët e historisë së përgjithshme dhe historisë fetare. Vdes në vitin 1913.

### **Karakterit dhe principet e Ahmet Mid'hatit.**

Ahmet Mid'hati fillon të botojë veprat e tij që në vitin 1871. Për 43 vite ai botoi pa pushim artikuj, kritika, përkthime, kujtime, tregime, romane dhe pjesë teatrale. Botoi mbi 200 artikuj dhe libra me tema të tilla si letërsi,

histori, filozofi, fe, gjeografi, biologji, astronomi, fizik, matematik, ekonomi, muzikë, mitologji etj. Duke parë shumëllojshmërinë e fushave ku ka shkruar Ahmet Mid'hati mund të arrihet shumë lehtë në konkluzionin e shprehur edhe më parë për shkrimtarët e parë të romanit të cilët ishin njëkohësish të pajisur me ideale iluministe. Ai prek shumë fusha, por në mënyrë sipërfaqësore. Ahmet Mid'hati ashtu edhe si shkrimtarët e tjerë të kohës besonte se populli vetëm nëpërmjet leximit, ngritjes së kulturës dhe mentalitetit do mund të ecte përpara në rrugën e përparimit. Megjithatë tek Ahmet Mid'hati nuk shohim entuziazmin dhe vrullin e Namik Kemalit. Ai më shumë se një luftëtar i vijës së parë parapëlqente të ishte më i përlur dhe më i fshehur. Këtë ai e tregon edhe në tregimet e para të cilat i nënshkruante me pseudonimin “Hace-i Evvel”, mësuesi i filllores.<sup>40</sup> Xhenap Shahabettin, një shkrimtar i njohur i kohës shkroi këto rreshta për vdekjen e Ahmet Mid'hatit.

*“I ndjeri ishte kampion i shkrimit në Turqi. Makinat e sotme të shkrimit prej çeliku nuk janë asgjë në krahasim me gishtat e tij. Nuk e di kush e ka krahasuar me furrat e larta të Anglisë ku gjithmonë rrjedh mineral. Ai kishte vetëm një dashuri në këtë botë. Të shkruaj, të shkruaj sa më shumë të jetë e mundur.”<sup>41</sup>*

Vetë Ahmet Mid'hati e shprehte që kishte dëshirë të shkruante më shumë.

*“ Po të përfshijë edhe kohën prej 4 vitesh e gjysmë që kam harxhuar duke u marrë me punë burokratike kam shkruar 3500 faqe nën pseudonimin “Hacel-i Evvel” dhe 2500 faqe nën Hasan Mellah pra gjithsej 6000 faqe. Po ti llogaris me ditë i bie të kem shkruar 5 faqe në ditë., por e dini edhe ju që unë kam kapacitet për të shkruar 32 faqe në ditë.”*

Ahmet Mid'hati ishte një person me këmbë në tokë. Nuk ishte një njeri ëndërrimtar. Ai i kishte provuar të gjitha. Nga botues, në tregtar ose politikan. Nga burgu në brendësi të pallatit perandorak. Ishte shoqëruar me njerëz të shtresave të ndryshme. Duke i bashkuar edhe një kujtesë të fortë ai arrinte të kishte një material të bollshëm për tregimet dhe romanet e tij.<sup>42</sup>

Ahmet Mid'hati si shumë intelektual të kohës ishte autodidakt. Për këtë arsye ai kishte informacion dhe kulturë të përgjithshme dhe jo të përqendruar në një fushë. Ky lloj intelektual shkruan në fusha të ndryshme. Mundohet që ato që ka përvetësuar t'ia transmetojë lexuesit dhe ajo që është më e rëndësishme gjithë shoqërisë .

### **Veprat e Ahmet Mid'hat Efendit:**

#### **Tregimet:**

1. Sü-i Zan-Esaret (1871 )
2. Gençlik Teehhül (1871 ),
3. Felsefe-i Zenan (1871 ),
4. Gönül (1871)
5. Mihnetkeşan (1871 ),
6. Firkat (1871 ),
7. Ölüm Allahın Emri (1873 )
8. Bir Gerçek Hikaye (1876)

<sup>40</sup> Kabaklı, A. Türk Edebiyatı, Acar Matbaacılık, Stamboll 1994, f. 93

<sup>41</sup> Po aty

<sup>42</sup> Po aty, f. 94

9. Fitnekar (1876 )
10. Bekarlık Sultanlık mı Dedin? (1876 )
11. Kıssadan Hise (1883)
12. Çingene (1887 )
13. Çifte İntikam (1887 )
14. Para (1887 )
15. Kısmetinde Olanın Kaşığına Çıkar (1887 )
16. Diplomalı Kız (1890)
17. Dolaptan Temaşa (1890 )
18. İki Hud'akar (1893 )
19. Emanetçi Sıdkı (1893 )
20. Can Kurtaranlar (1893 )
21. Bir Acibe-i Saydiyye (1893 )
22. Ana Kız (1893 )

**Romanet :**

1. Yeniçeriler (1874 ),
2. Hasan Mellah yahut Sır İçinde Esrar (1874 ),
3. Dünyaya İkinci Geliş yahut İstanbul'da Neler Olmuş (1874 ),
4. Hüseyin Fellah (1875 )
5. Yeryüzünde Bir Melek (1875 )
6. Karı Koca Masalı (1875 )
7. Felatun Bey İle Rakım Efendi (1875 )
8. Paris'te Bir Türk (1876 )
9. Süleyman Musli (1877 )
10. Kafkas (1877 )
11. Çengi (1877 )
12. Belliyat Müdhike (1878 )
13. Karnaval (1881)
14. Henüz Onyediyi Yaşında (1881 )
15. Acaib-i Alem (1882 )
16. Dürdane Hanım (1882 )
17. Vah! (1299- )
18. Volter Yirmi Yaşında (1884 )
19. Esrar-ı Cinayet (1884 )
20. Cellat (1884 )
21. Hayret (1885 )
22. Bahtiyarlık (1887 )
23. Demir Bey yahut İnkişaf-ı Esrar (1887 )
24. Arnavutlar-Solyotlar (1888 )
25. Fenni Bir Roman yahut Amerika Doktorları (1888 )
26. Haydut Montari (1888 )
27. Gürcü Kızı yahut İntikam (1888 )
28. Rikalde yahut Amerika Vahşet Alemi (1889 )
29. Diplomalı Kız (1889 )
30. Müşahedat (1890 )
31. Hayal ve Hakikat (bashkë me Fatma Aliye Hanım) (1891 )
32. Ahmet Metin ve Şirzat yahut Roman içinde Roman (1891 )
33. Taahhüf (1895 )
34. Gönüllü (1896 )

35. Mesail-i Muğlaka (1898 )
36. Altın Aşıkları (1899 )

**Pjesët teatrale :**

1. Eyvah (1875 )
2. Açıkbash (1875)
3. Ahz-ı Sar yahut Avrupa'nın Eski Medeniyeti (1875 )
4. Hükm-i Dil (1875 )
5. Furs-i Kadimde Bir Facia (1885 )
6. Çengi yahut Dabiş Çelebi (1885 )
7. Çerkes Özdenler (1886 )

**Kujtime, kritika, letra:**

1. Üss-i İnkılab, Ese (1878 )
2. Müdafaa, Kritikë (1882 )
3. Müdafaa, Kritikë (1883 )
4. Muhaberat ve Muhaverat, Letra mes tij dhe Muallim Naci (1881 )
5. Müdafaaya Mukabele ve Mukabeleye Müdafaa, Kritikë (1884 )
6. Avrupa Adab-ı Muaşeretı yahut Alafranga (1890 )
7. Niza-ı İlm ü din I, II, Kritikë (1898 )

Përveç këtyre veprave shkrimtari ka edhe shumë artikuj në gazeta dhe revista të ndryshme të kohës.

### **3.4 Rexhaizade Mahmut Ekrem (1847-1914)**

**Jeta:**

Rexhaizade Mahmut Ekrem lindi në vilën Rexhai Efendi<sup>43</sup> në Kadikoy më 1 mars 1847 si fëmija i dytë i një familjeje të njohur të periudhës së Tanzimatit. Në fillim u rrit mes një kulture lindore. Mori mësimet e para të arabishtes dhe persishtes nga babai i tij. Babai kërkonte ta arsimonte sa më mirë dhe e dërgon në fillim në Rushdijen “Beyazit” dhe më pas në “Mekteb-i Irfan”. Pasi merr arsimim të mirë në këto shkolla më 1858 e dërgon në shkollën “Harbiye Idadisi” ku dallohet sidomos në lëndët shkencore. Fillon të dallohet që ka interes edhe ndaj letërsisë. Provon të shkruaj gjëra të vogla. Më pas sëmuret dhe e lë shkollën në mes. Babai i tij e rregullon që të punojë në “Harixhije Mektubu Kalemi” (1862) në ministritë e jashtme. Gjatë punës në këtë detyrë ai njihet me personazhe të njohur të kohës në letërsi si Namik Kemal, Leskofçali Galip, Hersekli Arif Hikmet dhe Ayetullah. Bashkë me ata merr pjesë në mbledhjet e Enxhumen-i Shura. Fillon të botojë shkrimet e para në gazetën Tasvir-i Efkâr, Terakki dhe Hakayiku-l Vekayi. Gjatë kësaj kohe afrohet më shumë me Namik Kemalin. Kur Namik Kemali largohet për në Paris më 18 maj 1867 ja lë drejtimin e Tasvir-i Efkâr shkrimtarit Rexhaizade Mahmut Ekrem. Pas numrit 465 ai është drejtor i gazetës.

Gjatë të njëjtës periudhë Rexhaizade Ekrem përparon edhe në punën e tij si nëpunës. Në fillim lëviz në drejtorinë “Maliye Esham Kalemi” dhe pas 3

---

<sup>43</sup> Emërtimi i vilave fillon me periudhën e Tanzimatit duke ju përshtatur stilit evropian. Deri atëherë vetëm pallatet e njerëzve me poste të rëndësishme mund të merrnin emra, sidomos të sadrazamëve (kryeministrave), vezirëve (ministrave), pashallarëve.

muajsh kalon në “Tahrir-i Emlak Kalemi” (1868). Në fund të po atij viti emërohet në “Şura-yı Devlet Muavinliği”.<sup>44</sup>

Gjatë kohës që punon në institucionet shtetërore martohet me Gyziden vajzën e xhaxhait të tij, Arif Efendit. Në vitin e dytë të martesës i lind fëmija i parë Piraye, por i vdes gjatë lindjes. Gjatë këtyre viteve ai përparon dukshëm në mësimin e frengjishtes dhe fillon të njohë më nga afër letërsinë Franceze. Provon të bëjë përkthime. Madje duke shfrytëzuar literaturën perëndimore shkruan edhe një dramë. Pjesa teatrale “Afife Anjelic” është libri i parë që botoi (1870). Një vit më pas boton me titullin Nağme-i Seher përzgjedhje të poezive që kishte shkruar sipas stilit të vjetër dhe disa pjesë në prozë. Në 1872 boton përkthimin e romanit Atala të Chateaubriand dhe më 1873 boton poemën e gjatë Zadigar-i Şebab ku flet për vitet e rinisë. Fillimet e Rexhaizade Ekremi në letërsi janë goxha aktive për nga prodhimtaria. Në të njëjtin vit romanin Atala e përshtat për teatër. Një vit më vonë më 1874 boton përkthimin e pjesës teatrale “Mes Prisons” me titull në turqisht “Süreksiz Sevinç” (Gëzim i pavazhduar).

Përparimi i dukshëm në letërsi i dha mundësinë të jepte mësim në “Mekteb-i Mulkiye” (shkolla e shkencave politike) dhe Gallatasaray Sulltanisi. E fillon këtë detyrë më 4 tetor 1878. Fillimi si mësues në këtë shkollë është edhe fillimi i periudhës së dytë letrare të Rexhaizade Ekremi. Gjatë periudhës që jep mësim atje përgatit një libër për mësimdhënien e letërsisë që ishte ndryshe nga mënyra e mësimdhënies së atëhershme, Talim-i Edebiyyat (1879). Ky libër më pas do të ribotohet disa herë gjatë viteve 1882-1914. Në të njëjtën kohë fillon shkrimin e librit me poezi “Zemzeme” të cilin e mbaron disa vite më vonë. Botimi i pjesës së parë bëhet më 1883, i pjesës së dytë më 1884 dhe i pjesës së tretë më 1885. Sukseset e tij në letërsi nuk janë të njëjta me punën e tij në zyrë ku ka disa probleme. Megjithatë lindja e fëmijës së dytë Mehmet Nijad (por i pari që i jeton) në vitin 1883 e lidh me jetën përsëri. Pas një viti e gjysmë i lind edhe fëmija i tretë Ahmet Kemal Ercument.

Megjithatë problemet në punë e ndjekin. Largohet nga mësimdhënia në shkollën Mekteb-i Mulkiye dhe Gallatasaray Sulltanisi. Arsyeja e largimit është sulmi që i bën Muallim Naci dhe grupi i tij si dhe presioni që bënte administrata e Sulltan Abdylhamitit. Këto zhvillime ndikojnë në anën letrare të tij. Tashmë nuk merret aq shumë me poezinë, por drejtohet drejt prozës duke u marrë me tregimin e shkurtër. Bën një fillim të mirë me tregimin Saime (1888) të cilën fillon ta botoj në gazetën Saadet me pjesë, por kundërshtarët e sulmojnë me arsyetimin se bie ndesh me moralin e shoqërisë dhe i censurohet duke ja lënë në mes botimin.<sup>45</sup> Me gjithë sulmet që i bëhen nuk dorëzohet dhe tregimin e dytë “Şemsa” (Shemsa) e boton në fillim në gazetën “Asir” (Shekulli) që del në Selanik dhe më pas e boton si libër në vitin 1897. Në vitin 1895 ndihmon në daljen e revistës letrare “Servet-i Fünun” e cila botohet nga ish nxënësi i tij në shkollës Gallatasaray Sulltanisi, Ahmet Ihsan<sup>46</sup>. Kjo gazetë për 4 vitet që botohet ndikon shumë në zhvillimin e letërsisë së kohës. Aq shumë sa hyn në historinë e letërsisë turke si një periudhë e veçantë. Në këtë revistë ai boton disa poezi dhe artikuj me tematika të ndryshme.

<sup>44</sup> Tanzimat Edebiyatı, kordinator: İsmail Parlatır, Ankara, 2006, f. 292

<sup>45</sup> Tanzimat Edebiyatı, kordinator: İsmail Parlatır, Ankara, 2006, f. 293./ Ali Ihsan Kolcu, Tanzimat Edebiyatı 2 Hikaye ve roman, botimi 2,2005, Ankara, f.234.

<sup>46</sup> Tanzimat Edebiyatı, kordinator: İsmail Parlatır, Ankara, 2006, f. 294

Megjithatë ditët e vështira vijnë pas kësaj kohe. Goditjen e parë e me merr në vitin 1898 me vdekjen e fëmijës së tij më të dashur Nijad. Kjo është një goditje nga e cila nuk arrin ta marrë me veten. Po atë vit fillon të shkruaj një libër me kujtime për Nijad'in. Shkruan poezi për të. Mbaron vëllimin e parë të librit Nijad Ekrem. Po atë vit për shkak të mosmarrëveshjeve mes Fikret'it dhe Ali Ekremit, ky i fundit largohet nga Servet-i Funun. Bashkë me të fillon edhe rrënimi i revistës e cila sjell shpërndarjen e atij grupi të cilin Rexhaizade Ekrem e kishte mbështetur dhe rritur. Pas shpërndarjes së grupit Rexhaizade Ekrem tërhiqet në vilën e tij në Büyükdere. Atje mbaron së shkruari vëllimin e II të librit Nijad Ekrem.

Në vitin 1907 i kërkon kryeministrit të kohës, Arnavut Ferid Pashës të dalë në pension. Kërkesa nuk i pranohet dhe detyrohet të qëndrojë në detyrë. Shpallja e Meshrutijetit të dytë (Parlamentit të dytë) në vitin 1908 sjell një lloj emocioni dhe gjallërie tek intelektualët e kohës. Ata mendojnë se kanë marrë fund ditët e zeza të censurës së sulltan Abdylhamitit II. Rexhaizade Ekrem përfshihet në këtë atmosferë dhe duket sikur ai rilind. Në qeverinë e Kamil Pashait që krijohet pas shpalljes së parlamentit (7 gusht 1908) atij i ofrohet posti i ministrit të Zhvillimit. E refuzon postin e ofruar duke qenë nuk mund të duronte të dilte çdo të premte përpara sulltan Abdylhamitit (në mbledhjen javore të qeverisë). Po në të njëjtin vit pas 3 muajsh, në qeverinë e dytë të formuar më 22 nëntor 1908 atij i ofrohet përsëri një post, ai i ministrit të arsimit. Edhe ndaj këtij posti ai përsëri nuk tregon interes. Pas kësaj në dhjetor të po këtij viti ai zgjidhet në "Ayan azaliği" (Senato) post që do ta mbajë deri në vdekje.

Rexhaizade Mahmut Ekrem vdes më 31 janar 1914. Ai nderohet me ceremoni funerale shtetërore. Ministri i arsimit e shpall pushim ditën e ceremonisë mortore që nxënësit të merrnin pjesë në funeral.

### **Veprat e Rexhaizade Mahmut Ekrem:**

#### **Librat me Poezi :**

1. Nağme-i Seher, (1871)
2. Yadigar-ı Şebab, (1873)
3. Zemzeme I, (1883)
4. Zemzeme II, (1884)
5. Zemzeme III, (1885)
6. Tefekkür (poezi dhe prozë e përzier), (1886)
7. Pejmürde (poezi dhe prozë e përzier), (1895)
8. Nijad Ekrem (poezi dhe prozë e përzier) 2 vëllime, (1910)
9. Nefrin, Stamboll, (1916) pas vdekjes.

#### **Pjesët teatrale:**

1. Afiffe Anjelic, pa datë (1870?)
2. Atala (e përshtatur për teatër nga romani i Chateaubriand me të njëjtin emër, të cilin e ka përkthyer më parë), (1872)
3. Vuslat, (1874)
4. Çok bilen çok yanılır, (1916) pas vdekjes



**Tregimet dhe romanet:**

1. Saime (e lënë përgjysëm gjatë botimit në gazeta) tregim
2. Muhsin Bej, tregim (1891)
3. Şemsa, tregim (1896)
4. Araba Sevdası, roman (1897)

**Shkrimet mbi letërsinë:**

1. Talim-i Edebiyyat (1883)
2. Takdir-i Elhan (1886)
3. Takrizat, (1897)
4. Kudemadan birkaç Şair, (1888)

**Përkthimet:**

1. Atala, (1871)
2. Mecmua-i Edebiyye, (1874)
3. Mes Prisons (kujtimit e burgut të Silvio Pellico), (1876)
4. Naçiz, (përzierje të përkthimeve në poezi dhe prozë), (1886)

**3.5 Nabizade Nadim (1862-1893)****Jeta:**

Shkrimtari Nabizade Nazim, emri i vërtetë i të cilit ishte Ahmet Nazim lindi në Stamboll. Në moshë shumë të re humbet prindërit. Rritet nga gjyshja. Kalon një fëmijëri të vështirë. Shkollën fillore e kryen në të njëjtin qytet në shkollën e Tophanes. Pasi mbaron gjimnazin ushtarak me nota shumë të mira pranohet në shkollën e lartë ushtarake të forcave tokësore në degën e inxhinierisë. Diplomohet në vitin 1884 si toger artilerie. Pranohet në akademinë ushtarake tokësore. Në vitin 1886 diplomohet në akademi duke marr gradën kapiten shtatmadhorie<sup>47</sup>. Jep mësim në të njëjtën shkollë ku u diplomua.

Në vitin 1888 dërgohet në Siri me detyrën e zbuluesit. Pas dy vitesh kthehet në Stamboll. Martohet me të dashurën e tij. Pas një viti vdes nga tuberkulozi i kockës.

Hyrja e tij në botën e letrave ndodh në vitin 1880, kur ai ishte ende një nxënës, me shkrimin e tij të titulluar “Skllavëria” në gazetën Vakıf. Gjatës jetës së shkurtër letrare që pati për shkak të vdekjes në moshë të re ai pati një prodhimtari të konsiderueshme letrare. Ai është edhe një nga shkrimtarët e parë në gazetën Servt-i Funun e cila më vonë do të merrte një hov të madh. Tregimet e tij botohen në gjithë revistat letrare më në zë të kohës siç janë Hazine-i Evrak, Mir'at-i Aem, Rehber-i Fünun, Afak, Berk, Manzara Tercüman-ı Hakikat, Servet, Mürüvvet. Nabizade Nazim mbahet si një romantik i vërtetë në poezi, por me romanin e tij “Zehra” hedh hapat e parë të romanit realist dhe natyralist.

**Poezitë :**

1. Heves Ettim (1885)
2. Minimini-yahut-Yine Heves (1886)

---

<sup>47</sup> Titulli i shtatmadhorisë i jepej oficerëve që mund të bëheshin gjeneralë.

**Tregimet :**

1. Yadigarlarım (1886)
2. Zavallı Kız (1890)
3. Bir Hatıra (öykü,1890)
4. Karabibik (1891)
5. Sevda (1891)
6. Hala Güzel (1891)
7. Haspa (1891)
8. Seyyie-i Tesamüh 1892)

**Romani :**

1. Zehra (1896)

**Të ndryshme :**

1. Mini Mini Mektepli (1891) pjesë për shkrim dhe lexim
2. Esatir (mitoloji,1892) mitologji
3. Aynalar (fizik kitabı,1892) fizikë.

**3.6 Halit Zija Ushakllëgil (1866-1945)****Jeta:**

Halit Zija Ushakllëgil (Uşaklıgil) mbahet si romancieri i parë i madh në letërsinë turke dhe si një nga mjeshtrit më të mëdhenj të rrymës letrare “Servet-i Funun”. Ai vinte nga një familje shumë e pasur dhe e njohur tregtarësh. Lindi në Stamboll. Pasi mori mësimet e para në shkollën tetëvjeçare dhe shkollën e mesme ushtarake Fatih së bashku me familjen transferohet për të banuar në Izmir, një qytet në brigjet e detit Egje nga ku zhvillohej një tregti e madhe me Evropën. Këtu gjyshi i tij merrej me tregtinë e qilimave. Vetëm për të mësuar frëngjishten, duke qenë se i kishte mundësitë financiare, futet në gjimnazin e priftërinjve armen “Mecchitaristes”.

Dëshira për përkthimin dhe shkrimin i fillon pikërisht në vitet e gjimnazit. Me mbarimin e gjimnazit së bashku me një mikun e tij themelon gazetën Nevruz. Në të njëjtën kohë punon si mësues i frëngjishtes dhe nëpunës në banka të huaja.

Në vitin 1893 fillon punë si drejtor në një zyrë shtetërore në Stamboll. Pas mbështetjes që i dha Rexhaizade Ekremi bashkohet me grupin e mbledhur rreth revistës “Serveti Funun”. Në këtë revistë boton me pjesë nga romanet e tij të famshëm “Mai ve Siyah” dhe “Aşk-ı Memnu”. Me mbylljen e revistës për shkak të luftës mes dy grupeve letrare dhe fitores së grupit kundërshtar, më radikal dhe tradicional, nga mbyllja e revistës në vitin 1901 e deri në 1908 nuk boton asgjë.

Në vitin 1908 bashkohet me partinë Bashkim dhe Progres (İttihat ve Terakki) Në të njëjtën kohë jep mësim në universitetin e Stambollit në lëndët e estetikës dhe historinë e letërsisë perëndimore. Në vitin 1909 merr detyrën e kryesekretarit të drejtorisë së komunikimit pasi sulltani Mehmeti V (Reshiti) hipën në fron. Qëndron për 4 vite në këtë detyrë dhe largohet me dëshirën e tij. Gjatë Luftës së I Botërore bën disa udhëtime në Evropë për llogari të qeverisë. Pas shpalljes së Republikës Turke në vitin 1923 tërhiqet në vilën e tij në Yeşilköy. Vdekja e djalit të tij të madh, i cili ishte me detyrë në ambasadën Turke në Shqipëri, në vitin 1937 e trondit shumë. Mbyllet në vetvete dhe bëhet

pesimist. Këtë e pasqyron edhe në veprat e tij të fundit. Vdes në 27 mars 1945 në Stamboll.

### **Personaliteti dhe principet**

Halit Zija Ushakllëgil ishte fëmijë i një familje shumë të pasur. Kjo bëri që ai të kishte një jetë pa probleme financiare dhe një jetë të lehtë studentore. Ai përfitoi edhe nga fakti që shtëpia e familjes së tij ishte një pikë grumbullimi i intelektualëve të kohës me të cilët pati kontakte të ngushta. Dëshira për t'u marr me gazetari duke botuar gazeta dhe revista u mbështet nga mundësitë financiare të familjes. Gjatë jetës së tij ai shëtiti nëpër Evropë, punoi në pozicione të mira pune si dhe punoi me shumë të huaj. Kjo bëri që të njihej nga afër me mënyrën e jetesës perëndimore. Jetoj në një mënyrë të përafërt. Kjo gjë bëri që ai të mos e njihte pothuajse fare jetën e shtresës së mesme dhe të varfër të shoqërisë turke. Jetesën e kësaj shtrese të shoqërisë e njohu vetëm nëpërmjet shërbëtorëve. Me gjithë pasurinë e madhe që zotëronte Halit Zijai pati një jetë të rregullt familjare me gruan e tij të cilën e quante "Shoqja ime e jetës". Nuk u dha pas kënaqësive dhe qejfeve që jepeshin shumë fëmijë të familjeve të pasura turke. Për fatin e tij të keq katër fëmijë i vdiqën në moshë të re. Kurse humbjen më të madhe e pati kur i vdiq djali në moshën 27 vjeçare.

Halit Zijai ishte një person i rezervuar dhe i kujdesshëm edhe ndaj miqve të tij më të afërt. Vlerësonte shumë vlerat morale. Këtë gjë e pasqyronte edhe në shkrimet e tij. I pëlqente komforti, të vishej mirë si dhe i pëlqente të ishte ceremonial. Si në jetë ashtu edhe në veprat që shkroi ndihet dukshëm ndikimi perëndimor. Letërsia dhe stili që krijoi mund të meritojnë me të vërtetë titullin Xhentilmen. Halit Zija ishte më i kulturuar nga të gjithë anëtarët e grupit Servet-i Funun. Dinte anglisht, arabisht, frëngjisht, italisht dhe persisht. Lexonte shumë. Pasi i lexoi me një frymë veprat turke të periudhës së parë të letërsisë së Tanzimatit ju drejtua letërsisë së huaj, sidomos asaj Franceze nga të cilët preferonte vëllezërit Goncourt, Stendhal, Flaubert, Balzac, Daudet, Emile Zola ndërsa nga anglezët i pëlqente Charles Dickens.

Në fillim Halit Zija fillon të bëjë përkthime të ndryshme sidomos nga frëngjishtja. Kjo bëri që ai ta njihte mirë letërsinë franceze dhe të shkruante i ndikuar shumë nga ajo. Ky ndikim solli edhe veçoritë kryesore të veprave të Halit Zijas që janë principet e realizmit dhe natyralizmit. Ai i gërsheton me mjeshtri këto principe të rrymave perëndimore me traditën turke duke e merituar nga shumë studiues titullin mjeshtri i romanit turk. Ai futi për herë të parë në prozë tematikën e "zhgënjimit". Romanet turke të deriatëhershme ishin shumë më të përciptë. Me romanet e tij Halit Zija solli një frymë të re. Me të romani turk hyn në një fazë të re më të pjekur. Tashmë romani turk e tejkalon ngjashmërinë që kishte me tregimin, gjë që e ndoqi për gati 30 vitet e para që nga fillimi i tij.

### **Veprat e Halit Zija Ushakllëgilit:**

#### **Romanet:**

1. Nemide, 1889
2. Bir Ölünün Defteri, 1889
3. Ferdi ve Şürekâsı, 1894

4. Mai ve Siyah, 1896
5. Aşk-ı Memnu, 1900
6. Kırık Hayatlar, 1923

**Tregimet:**

1. Bir Muhtıranın Son Yaprakları, 1888
2. Bir İzdivacın Tarih-i Muaşakası, 1888
3. Heyhat, 1894
4. Solgun Demet, 1901
5. Sepette Bulunmuş, 1920
6. Bir Hikâye-i Sevda, 1922
7. Hepsinden Acı, 1934
8. Onu Beklerken, 1935
9. Aşka Dair, 1936
10. İhtiyar Dost. 1939
11. Kadın Pençesinde, 1939;
12. İzmir Hikâyeleri, (pas vdekjes.) 1950

**Pjesë Teatrale :**

1. Kabus, 1918.

**Kujtime:**

1. Kırk Yıl, 1936
2. Sara ve Ötesi, 1942
3. Bir Acı Hikâye, 1942.

**Poezitë:**

1. Mensur Şiirler, 1889.

**Shkrime të tjera:**

1. Sanata Dair, 3 vëllime, 1938-1955.

### **3.7 Fatma Alije Hanëm (1862-1936)**

**Jeta:**

Lindi në Veznexhiler të Stambollit në vitin 1862. Ishte fëmija i dytë i Ahmet Xhevdet Pashës, juristit, historianit dhe studiuesit të famshëm të shtetit Osman gjatë periudhës së Tanzimatit. Edukimin e merr nga mësuesit privat që siguronte babai për vëllanë e saj. Nuk ndjek shkollat shtetërore të zakonshme që ndiqeshin nga fëmijët. Arsyeja e mos vajtjes në shkollat e shtetit lidhet me faktin që babai i saj ndryshonte shpesh qytet për shkak të detyrave shtetërore që merrte.

Kjo pengesë nuk e kufizoi Fatma Alijen që të ecte përpara. Mësuesit që vinin ish-in nga më të mirët e mundshëm pasi babai i saj duke qenë vetë një studiues i njohur kishte kontakte të vazhdueshme me intelektualët e kohës dhe i njihte mirë ata mësues që i punësonte për edukimin e djalit në fillim dhe të vajzave të tjera më pas.

Fatime Alije mëson gramatikë, letërsi, histori. Përveç tyre mëson edhe astronomi. Nga mësuesi i pianos ajo mëson frëngjisht. Një fakt interesant është se kur ishte e vogël në vend që të qëndronte në Haremlik (pjesa e

shtëpisë e ndarë për femrat) ajo qëndronte në Selamllik (Dhoma e pritjes për burrat). Këtu ajo mëson shumë nga bisedat e babait të saj me intelektualët e kohës.

Në këtë kohë fillon letërkëmbimin me Ahmet Mid'hat Efendin, të cilin e konsideron si babanë e saj shpirtërorë. Në vitin 1878 duke pranuar dëshirën e babait martohet me Faik Beun.

Gjatë gjithë kësaj kohe është shumë e dhënë pas letërsisë si vendase ashtu edhe të huaj. Në vitin 1889 përkthen romanin "Volonte" të George Ohnet me titullin turqisht Meram. Në libër shkruan përktheu "Një grua". Ky ishte një sukses i madh për kohën. Bashkë me suksesin vjen edhe dyshimi. Në shumë qarqe letrare nuk besohet që përkthimi të ishte bërë nga një femër. Për këtë arsye ajo detyrohet të jap shpjegime duke e shpallur hapur emrin e saj. Këtë e bën jo pa frikë, pasi druhej nga ndikimi që do kishte tek pozicioni i babait të saj, por ndodh e kundërta. Ahmet Xhevdet Pasha jo vetëm që e përgëzon, por i krijon mundësinë edhe të vazhdojë studimet në filozofi dhe histori.

Në vitin 1890 boton së bashku me Ahmet Mid'hat Efendin romanin "Hayal ve Hakikat". Në të njëjtin vit boton romanin Muhadarat të cilin e firmos Fatma Alije. Në të njëjtin vit boton Nisvan-i Islam, një lloj bibliografie. Kjo vepër do të përkthehet edhe në arabisht, frëngjisht dhe anglisht.

Në vitin 1893 i vjen një letër e cila i shpjegon se emri i saj do të shkruhej në katalogun "The woman's library of the world's fair". Librat që ajo dërgon jashtë shtetit tërheqin vëmendjen e lexuesve. Për shkak të këtij sukcesi ajo pritet në një takim të veçantë nga Sulltani Abdylhamiti II.

Pas kësaj fame vazhdon të shkruajë romane, tregime dhe për shkak të akuzave që i bëhen babait të saj detyrohet të shkruaj një libër me titull "Ahmet Xhevdet Pasha dhe periudha ku jetoi".

Ajo shkruan edhe në shumë gazeta e revista të kohës për çështje të ndryshme që preknin jetën e femrave në shtetin Osman. Shkruan edhe disa poezi.

Gatishmërinë për të ndihmuar në mbrojtje të grave ajo e shpreh duke marrë pjesë në shumë shoqata me karakter social. Gjatë luftës Greko-Turke të vitit 1897 merr pjesë në fushatën për mbledhjen e ndihmave për të plagosurit e luftës. Për këtë arsye ajo merr një dekoratë nga Abdylhamiti II.

Pas shpalljes së Meshrutijetit II<sup>48</sup> merr pjesë në shoqatën Gjysmë Hëna e Kuqe duke u bërë gruaja e parë që dekorohet për ndihmën e saj në mbledhjen e ndihmave për familjet e të rënëve gjatë luftërave Ballkanike dhe luftës së Libisë. Gjatë Luftës së I Botërore jep shumë konferenca në lidhje me arsimimin dhe edukimin e grave.

Nga martesja me Faik Beun ajo lindi katër vajza. Aishe, Hatixhe, Nimet dhe Zybje Ismet. Largimi i vajzës së vogël dhe kthimi i saj në një murgeshë ndikon shumë në shëndetin e shkrimtares. Me vdekjen e burrit të saj Faik Beut në vitin 1928 ajo pothuajse i shkëput lidhjet me botën e jashtme dhe vdes pas 8 vitesh më 13 korrik 1936.

### **Personaliteti dhe karakteri :**

Që në fëmijëri bie në sy dëshira e madhe e Fatma Alijes për leximin dhe studimin. Edhe pse në moshë të vogël ajo ndiqte me shumë dëshirë

---

<sup>48</sup> Ngritja për herë të dytë e parlamentit në vitin 1908.

mësimet që bënte vëllai i saj. Dëshira e saj për të mësuar do e ndjekë për pothuajse gjithë jetën.

Përveç dëshirës për arsimim ajo kishte edhe një dëshirë të madhe për të ndihmuar njerëzit në vështirësi. Kuptohet që pjesa më në vështirësi e shoqërisë Osmane ishin femrat. Ato nuk gëzonin shumë të drejta. Madje mund të themi që ato pothuajse nuk kishin fare të drejta përveç disa femrave me pushtet nga familja ose që ishin martuar me njerëz në pushtet. Për më tepër gratë mbanin barrën e mbajtjes së familjes si gjatë kohës kur burrat ishin në luftë ashtu edhe kur burrat ktheheshin të plagosur dhe ishin të paaftë për punë ose vdisnin në fushën e luftës.

Për të ndihmuar sado pak në emancipimin e femrës ajo përdor shkrimet e saj qoftë letrare ashtu edhe ato me tematikë sociale që i shkruan në gazetatat dhe revistat e kohës. Ndihmesa e saj në këtë fushë ishte shumë e rëndësishme. Ajo bëhet pjesë aktive e shoqatave për të mbështetur gratë e të rënëve në luftërat e ndryshme ku u përfshi shteti Osman gjatë fundit të shek. XIX dhe fillimit të shek XX.

Për sa i përket anës letrare Fatma Alije ishte nën mbrojtjen e një nga shkrimtarëve më produktiv të kohës, Ahmet Mid'hat Efendit. Kuptohet që edhe pikëpamjet e saja janë të ndikuara shumë nga principet e tij. Njësoj si babai shpirtëror ajo i drejtohet më shumë prozës. Talenti i saj shprehet më shumë në roman. Atje ajo ndihet më e aftë të shprehë ato pikëpamje që kishte në lidhje me problemet shoqërore të kohës.

Për sa i përket një pike tjetër të rëndësishme që debatohej për romanin e kohës, gjuhën, ajo është përpjekur të shkruaj me një gjuhë më të thjeshtë sesa bashkëkohësit, kjo e ndikuar nga principet e Ahmet Mid'hatit, për ta bërë sa më të kuptueshme për masën më të madhe të lexuesve dhe për ta përdorur letërsinë si një mjet edukimi të shoqërisë.

Në qendër të ideve të shkrimtares kemi përpjekjen për emancipimin e gruas. Për këtë arsye ajo vlerësohet jo vetëm brenda vendit, por edhe jashtë tij.

## **Veprat e Fatma Alije:**

### **Romanet:**

1. Muhadarat (1892)
2. Hayal ve Hakikat (1894)
3. Ref'et (1898)
4. Levaiih-i Hayat (1898)
5. Udi (1899)
6. Enin (1910)

### **Përkthimet**

1. Meram (1890)

### **Artikujt**

1. Namdaran-ı Zenan-ı İslamıyan (1895)
2. Osmanlıda Kadın: "Cariyelik, Çokeşlilik, Moda" (1895)
3. Taaddüd-i Zevcat, së bashku me Mahmud Esad,
4. Nisvan-ı İslam (1896)
5. Teracim-i Ahval-ı Felasife (1900)
6. Tedkik-i Ecsam (1901)

7. Ahmed Cevdet Paşa ve Zamanı (1914)
8. Kosova Zaferi / Ankara Hezimet: Tarih-i Osmaninin Bir Devre-i Mühimmesi (1915)

### 3.8 Emine Semije Hanëm. (1864-1944)

#### Jeta:

Emine Semije ishte fëmija më i vogël i juristit dhe historianit të njohur të periudhës së Tanzimatit Ahmet Xhevdet Pashës dhe i Advije Rabies. Lindi në lagjen Veznexhiler në vitin 1866<sup>49</sup>. Disa studiues mendojnë se ajo ka lindur në vitin 1868 dhe disa të tjerë në vitet 1864 ose edhe 1862<sup>50</sup>.

Ndryshe nga të dhënat e shumta që kemi për motrën e saj të madhe Fatma Alije, në lidhje me fëmijërinë e Emine Semijes nuk kemi shumë informacione. Megjithatë duke u bazuar mbi fëmijërinë e motrës së saj më të madhe Fatma Alije ne mund të arrijmë në disa përfundime.

Emine Semije arsimimin e fillon ashtu si vëllai dhe motra e saj me mësues privat që i sillte babai i saj. Me kalimin e kohës fillon të ketë një tendencë në rritje ndaj letërsisë dhe arteve të bukura. Nuk ishte shumë e interesuar për historinë dhe mësimin e fesë.

Emine Semije gjithë jetën e saj ia dedikon arsimit. Për këtë punon në detyra që kishin lidhje me me arsimin. Në fillim punon si inspektore në Shkollën “Inas Mektebi” në Selanik. Në të njëjtën periudhë merr përsipër të bëhet kryeredaktorja e gazetës “Mutalaa” që del në Selanik. Duke qenë se kjo gazetë del në vitin 1895 mund të themi se në vitet 1895-96 Emine Semije ka punuar në Selanik si inspektore arsimit.

Më pas për shkak të emërimit të burrit të saj Reshid Pashës me detyrë në Serez kalon katër vite atje duke u dhënë mësim vajzave të funksionarëve të zonës. Me shpalljen Meshrutijetit të II dhe me ngjarjet e 31 marsit<sup>51</sup> ajo merr pjesë aktive në partinë Ittihat ve Terakki (Bashkim dhe Progres)

Në këtë periudhë i shkruan motrës së saj Fatma Alije duke i shpalosur mendimet në lidhje me emancipimin e gruas dhe pesha që u bie mbi supet për të marr përsipër këtë detyrë fisnike. Për shkak të mendimeve dhe të mbështetjes që i jep Partisë Bashkim dhe Progres përplasat me burrin e saj i cili ishte Prefekti i Edirnesë në atë kohë.

Me fillimin e luftës së I Ballkanike në vitin 1912 ajo fillon të punojë në mënyrë vullnetare në spitalin Etfal në Shishli të Stambollit. Për shkak se njihej si mbështetëse e partisë Bashkim dhe Progres akuzohet nga disa doktorë se bënte propagandë në spital dhe largohet nga puna që bënte. Më pas largohet për në Paris edhe pse miqtë e saj i kërkojnë të mos largohet.

Në fakt largimi i saj mund të ketë ndodhur edhe për shkak të ndjekjes që i bëhej nga disa njerëz të shtetit të cilët mendonin ta burgosnin. Qëndrimi në Paris kalon mes sëmundjeve ku romantizma shpeshherë e detyronte të kalonte kohë të gjata në shtrat.

<sup>49</sup> Në lidhje me datën e saktë të lindjes së shkrimtares ka disa hipoteza, por ne po marrim këtë datë si më të besueshmen.

<sup>50</sup> Enginün, İ. “Emine Semiye”, Türk Dili ve Edebiyatı Ansiklopedisi, vëll 3, f. 33; Özkirimli, A. “Emine Semiye”, Türk Edebiyatı Ansiklopedisi, Stamboll, 1982, vëll 2, f. 440; Banarlı, N. Sami, Resimli Türk Edebiyatı Tarihi, v Resimli Türk Edebiyatı Tarihi, 1983, Stamboll, vëll. 2 f. 994

<sup>51</sup> Ngjarjet e 31 marsit 1908 ishin në fakt një grusht shteti i dështuar nga mbështetësit e Sulltanit, por që përfundon me ardhjen e ushtrisë së shpëtimit nga Selaniku.

Një pjesë të periudhës së luftës së I Botërore e kalon në Paris. Në vitet 1916-1917 jep mësim në Siri së bashku me Halide Edip Adëvar, një shkrimtare përparimtar të asaj kohe.

Edhe pse nuk dihen datat e sakta dimë që studion për psikologji dhe sociologji për katër vite në Paris dhe dy vite në Zvicër.<sup>52</sup> Po ashtu mëson persisht dhe fe nga Shehu i Teqesë Karababa në Selanik. Emine Semije në një letër të saj shprehet se në vjeshtë të vitit 1919 ndodhej në Gjeneve të Zvicrës e ftuar nga një mike.<sup>53</sup>

Për shkak të gjendjes jo të mirë financiare detyrohet të punojë si mësuese edhe në moshë të madhe. Del në pension në 1928. Vdes në vitin 1944.

Emine Semije është martuar dy herë dhe ka pasur 4 fëmijë, tri djem dhe një vajzë. Vajza dhe një nga djemtë i vdesin në moshë të vogël.

### **Personaliteti dhe karakteri :**

Emine Semije për shkak të rritjes në një familje intelektuale dhe me tradita i mësoi që në vogëli të drejtat që duhet të kishin femrat. Ashtu si dhe motra e saj ajo u bë flamurtare e të drejtave të tyre. Ndryshe nga motra e saj Fatma Alije ajo ishte e dhënë më shumë pas arsimit. Për këtë arsye ajo edhe e praktikoi profesionin e mësuesit disa herë.

Një tjetër ndryshim nga e motra ishte se Emine Semije ishte shumë më energjike në luftën për të drejtat e njeriut. Ajo e kritikon motrën e saj në letërën e çuar në vitin 1912 duke i thënë se me veprën e saj Nisvan-ı İslam ajo fliste vetëm për femrat e shoqërisë së lartë dhe nuk i prekte aspak problemet dhe shqetësimet e femrave në të gjithë shtresat e shoqërisë.

Karakterit i saj rebel dallohet edhe në pjesëmarrjen e saj në mënyrë të flaktë në politikë duke u pozicionuar edhe kundër dëshirës së burrit të saj në partinë Bashkim dhe Progres.

Duke u marrë me politikë ajo mori përsipër edhe persekutimin, por nuk u tërhoq nga idealet e saja. Përveç pjesëmarrjes në politikë Emine Semije ishte shumë aktive edhe në shoqërinë civile. Me ngritjen e shoqatave të ndryshme për të mbështetur femrën e kohës ajo ishte një pioniere në këtë fushë së bashku me motrën e saj.

Për sa i përket letërsisë ajo ashtu si edhe motra e saj e konsideronin letërsinë si një mjet për të edukuar shoqërinë dhe jo një mjet argëtimi. Për këtë arsye në të gjithë veprat e saja pjesa moraliste dhe edukuese bie më shumë në sy.

Edhe ajo si motra e saj më shumë preferonte prozën. Sidomos romanin. Emine Semije gjithmonë tregonte kujdes që tematika e romanit të përshtatej me qëllimin ku dëshironte të arrinte shkrimtarja. Personazhet e saj janë o të mirë o të këqij dhe shumë rrallë ndryshojnë pozicion. Një tipar tjetër është përdorja e letrave nga personazhet për të zgjidhur problemet.

---

<sup>52</sup> Uraz, M. Kadın Şair ve Muharrirlerimiz, Stamboll, 1940, f. 469, Özkırmılı A. Emine Semiye, TEA, vëll 2 Stamboll, 1980 ; Banarlı, N. Sami, Resimli Türk Edebiyatı Tarihi vëll 2, f. 994; Tuncor, F. Ragip, Emine Semiye, Önyasa, nr. 41 1969, Ankara, f. 16-17.

<sup>53</sup> Emine Semiye, "Hayatta kakinin hisse-i İstirak" 1919, f. 5-6



## **Veprat e Emine Semije:**

### **Romanet:**

1. Terbiye-i Etfâle Ait Üç Hikâye (1895-1896)
2. Hiss-i Rekâbet (1896)
3. Bîkes (1897)
4. Sefâlet (1897)
5. Muallime (1899)
6. Hürriyet Kokuları (1899)
7. Gayyâ Kuyusu (1920)

### **Shkrime të tjera:**

1. İktitaf
2. Kalem Tecrübeleri
3. Hülâsa-i İlm-i Hisap (1887)

### **Pjesët teatrale:**

1. Dilşâd Sultan

### **Kujtime:**

1. Selânik Hâtıraları (1907)

## **3.9 Mizanci Murat, (Mehmet Murat Bey, 1854-1917)**

### **Jeta:**

Lindi në vitin 1854 në Dagestan<sup>54</sup>. Babai i vë emrin Murat për nder të Haxhi Muratit, luftëtarit të lirisë në Dagestan. Pasi mbaron shkollën fillore në vendlindje shkon në Sevastopol për të vazhduar gjimnazin. Pas mbarimit të shkollës në vitin 1873 shkon në Stamboll. Atje futet nën mbrojtjen e Shirvanzade Rushtu Pasha. Kur ai emërohet guvernator në Halep i shkon nga pas. Pas vdekjes së tij kthehet në Stamboll ku punësohet si mësuesi i fëmijëve të Sait Mollës.

Duke qenë se dinte rusisht dhe frëngjisht fillon punë në ministrinë e jashtme. Në vitin 1877 martohet me vajzën e Hilmi Mollës, Hasiben. Jep mësimë historie dhe gjeografie në shkolla të ndryshme. Në vitin 1882 emërohet në komisionin e kontrollit në ministrinë e arsimit.

Në vitin 1876 fillon të shkruaj rregullisht nëpër gazeta në lidhje me politikën. Në vitin 1886 hap gazetë "Mizan". Tematika kryesore e kësaj gazete ishte liria dhe kushtetuta. Për këtë arsye ishte gjithë kohës nën kontroll dhe presion nga censura shtetërore. Në vitin 1890 i mbyllin gazetën.

Fillon punë në drejtorinë e borxheve të jashtme. Punon për katër vite në këtë detyrë. Aty përgatit një projekt reformë për të ngritur ekonominë e rrënuar Osmane. Propozimi i tij nuk merret parasysh nga sulltani.

Ai vendos të largohet jashtë shteti dhe me anë të njohjeve që kishte krijuar me të huaj shkon në Paris, atje njihet me Xhonturqit. Mban lidhje të

---

<sup>54</sup> Tani është një nga republikat autonome brenda Federatës Ruse në zonën e Kaukazeve.

ngushta me shumë nga eksponentët opozitar të sulltanit. Arrin të bëhet kryetar degës së partisë Bashkim dhe Progres<sup>55</sup> për degën e Evropës në vitin 1896.

Në vitin 1897 sulltan Abdylhamiti vendos të thërras kundërshtarët e tij politikë në Stamboll me qëllim mbylljen e revistave dhe gazetave opozitare në Evropë. Mizanxhi Murati pranon ofertën që i bëjnë dhe kthehet në Stamboll ku fillon punë në komisionin e inspektimit të financave. Këtë detyrë e mban deri në vitin 1908.

Në vitin 1908 pas ndryshime që ndodhin largohet nga detyra dhe hap përsëri gazetën “Mizan”. por tani është kundërshtar i partisë Bashkim dhe Progres. Pas një tentative për grusht shteti të quajtur “Ngjarja e 31 Marsit” më 13 prill 1909<sup>56</sup> ai akuzohet si bashkëpunëtorë dhe dënohet me internim të përgjithshëm në Rodos. Atje boton shtatë nga dymbëdhjetë vëllimet e librit “Tarih-i Ebulfaruk” që tregon për historinë e Osmanlinjve.

Në vitin 1912 kthehet në Stamboll pasi përfiton nga falja e përgjithshme. Shkon në Francë dhe Zvicër për t’u kuruar. Më pas kthehet në Stamboll ku edhe vdes në vitin 1917.

### **Veprat e Mizanxhi Muradit:**

#### **Librat për historinë:**

1. Târîh-i Umûmî (1880-1882)
2. Muhtasar Târîh-i Umûmî (1885)
3. Muhtasar Târîh-i İslâm (1890)
4. Devr-ı Hâmidî-Âsârı (1891)
5. Târîh-i Ebulfâru (1909-1916)

#### **Romani:**

1. Turfanda mı Turfa mı? (1892)

#### **Librat ideologjik :**

1. Le Palais de Yıldız et la Sublime Port (1896)
2. Müdâfaa Niyetine Bir Tecâvüz (1896)
3. La Force et la Faiblesse de la Turquim (1897)
4. Hürriyet Vadisinde bir Pençe-i istibdâd (1908)
5. Mücâhede-i Milliye (1908)
6. Enkaz-ı Istibdâd içinde Zügürdün Tesellîsi (1911)
7. Tatlı Emeller Acı Hakikatler (1912)
8. Taharrî-yı Istikbâl (1913-1914).

#### **Pjesë teatrale :**

1. Tencere Yuvarlandı Kapağını Buldu (1908)

---

<sup>55</sup> “İttihat ve Terakki partisi” ishte partia që në vitin 1908 bën të mundur rrëzimin e sulltan Abdylhamitit dhe shpalljen e monarkisë parlamentare II.

<sup>56</sup> Quket ngjarja e 31 marsit për shkak se atëherë ishte akoma kalendari hënor që i përket datë 31 mars 1325.

## Përfundime:

Periudha gjatë së cilës kanë jetuar romancierët e parë turq ka ndikuar dukshëm në formimin e tyre. Shpallja e fermaneve perandorake në vitet 1839 dhe 1856 ishin vazhdimi i përpjekjeve shumë vjeçare për reformim dhe hapje ndaj perëndimit. Hapja e perandorisë Osmane ndaj perëndimit dhe futja e risive bëri që të ndryshonte një herë e përgjithmonë mentaliteti i shoqërisë Osmane. Hapja e shkollave të huaja në qytete të ndryshme të perandorisë i dhanë mundësi njerëzve me ideale të merrnin një edukim më të gjerë dhe duke dalë jashtë guaskës tradicionale të edukimit oriental të njiheshin me qytetërimin perëndimor. Përfaqësues kryesor të këtij lloj edukimi janë Sami Frashëri dhe Halit Zija Ushakllëgil. Një mundësi tjetër për njohjen e qytetërimin perëndimor ishte edhe dërgimi i studentëve në Evropë për studime. Një pjesë e tyre sjellin edhe letërsinë perëndimore. Përfaqësuesi më i spikatur është Ibrahim Shinas, i cili nuk është pjesë e këtij studimi pasi ka dhënë kontributin e tij në fushën e gazetarisë dhe poezisë.

Shkrimtarët e kësaj periudhe mund t'i ndajmë në dy grupe të mëdha. Shkrimtarët që kanë marr një arsimim të mirë dhe shkrimtarët autodidakt., por që të dy këto grupe bashkohen në disa pika.

Veçoritë kryesore të romancierëve të parë në letërsinë turke të Tanzimatit janë

:

- Të gjithë shkrimtarët janë të mirëedukuar dhe njohës të problemeve sociale të kohës.
- Përveç Halit Zija Ushakllëgilit të gjithë romancierët kanë në qendër të tematikës së tyre problemet shoqërore. Martesa me shkesi (pa dëshirën e të rinjve), skllavëria, vuajtjet e femrave, varësia e meshkujve ndaj bixhozit, alkoolit dhe argëtimit me femra të përdala si dhe shumë probleme të ngjashme janë materiali bazë i përdorur në romanet e tyre.
- Të gjithë janë njohës të mirë të një gjuhe perëndimore si dhe të arabishtes me persishten. Përgjithësisht gjuha perëndimore është frëngjishtja.
- Përveç Halit Zija Ushakllëgilit të gjithë marrin përsipër rolin e mësuesit. Ata i shohin romanet e tyre si vepra edukative me anë të së cilave kërkojnë të edukojnë popullin turk.
- Shumica e tyre mbështesin idenë e një gjuhe të thjeshtë dhe të kuptueshme për shtresën e gjerë të popullit. Megjithatë nuk arrijnë ndonjë sukses të madh në këtë fushë.
- Ata janë të ndikuar nga letërsia e vjetër turke dhe asnjëherë nuk arritën të dalin jashtë këtij ndikimi. Kjo gjë ndodh më shumë për shkak të ndrojtjes që kanë shkrimtarët ndaj reagimit që mund të kenë nga lexuesi tradicional turk.
- Me gjithë dëshirën e mirë dhe tentativat për të arritur nivelin e romanit evropian romancierët turq nuk arrijnë një nivel të lartë artistik.
- Shumica e romancierëve të parë në letërsinë turke nuk ishin romancierë të mirëfilltë. Sami Frashëri, Namik Kemal, Mizanxhi Murat, Rexhaizade Mahmut Ekrem dhe Nabizade Nazim shkruan nga një ose dy romane dhe u drejtuan në fusha të tjera të letërsisë ose të shkencës.

## KREU IV

### TEMATIKA NË ROMANET E HERSHME

Përpara se të fillojmë studimin e personazheve të romaneve të para në letërsinë turke do të jetë më me vend të japim përmbajtjet e përmbledhura të këtyre romaneve sipas tematikës për të krijuar një panoramë më të përgjithshme të tematikës së prekur në këtë gjini letrare të re që u fut pa një pretendim të madh në letërsinë turke.

Romani turk në fillimet e tij, si çdo e re që futet në kulturën e një populli, ishte një përzierje e të resë (me tipare perëndimore) dhe traditës shumë shekullore (të tregimit me letërsinë turke). Duke lexuar përmbledhjet e romaneve do të shohim me vëmendje se si fillon të ndryshojë mënyra e logjikimit të romancierëve turq nga fillimet e romanit në fillim të viteve 1870 e deri në fund të shekullit kur romani fiton karakteristikat e tij të plota.

Tipari kryesor që bie në sy në këto romane është përfshirja e një shtrese të vetme të caktuar të shoqërisë. Shtresa e mesme, por edhe shtresa e mesme ndahet në disa nivele. Shtresa e mesme më e pasur dhe ajo më pak e pasur. Marrëdhëniet që ka ajo me shtresën e pasur dhe me shtresën e varfër të shoqërisë.

Problemet sociale me të cilat përballen pjesëtarët e kësaj shtrese. Lufta për të mbijetuar ndaj goditjeve që pësonin si nga pjesëtarët e të njëjtës shtresë ashtu edhe ndaj mashtrimeve të bëra nga pjesa e varfër e shoqërisë që synonte t'u zinte vendin. Kuptohet që kur themi shtresa e varfër duhet të kemi në mendje ata pjesëtarë të kësaj pjese të shoqërisë që për hir të pak pasurie ishin gati të bënin gjithçka nga mashtrimi deri në vrasje.

Edhe problemet sociale dhe historike të kohës janë pasqyruar në këto romane. Përveç tematikave të mësipërme kemi edhe tentativa për të shkruar romane të ndikuara nga letërsia Evropiane.

Në romanet e para turke ashtu siç edhe do e shohim në përmbledhjet e mëposhtme nganjëherë kemi një lloj mbingopjeje me ngjarje të shumta që vijnë njëra pas tjetrës pa të dhënë mundësi të kapësh lehtë fillin e romanit. Arsyeja e mbushjes me ngjarje është frika e shkrimtarëve për të mos i klasifikuar veprat e tyre si tregime. Zgjatja nganjëherë më shumë se ç' duhet e ngjarjeve bëhet me qëllimin për ta bërë më voluminoz librin që të futet në gjininë e romanit më shumë nga sasia dhe numri i faqeve sesa nga stili dhe brendësia e tij.

Një problem i romanit në fillimet e tij është ngatërrimi i tregimit me romanin. Madje në fillimet e tija romanet klasifikoheshin si tregime të gjata "uzun hikaye". Vetëm më vonë fillojmë të kemi një ndarje gjithmonë e më të thellë mes tregimit dhe romanit. Një fakt interesant është që edhe sot e kësaj dite shumë nga studiuesit turq i ndajnë në mënyrë të ndryshme romanet dhe tregimet e Ahmet Mid'hat Efendit. Gjatë mbledhjes së materialeve kam rastisur në faktin që në një studim një vepër e tij konsiderohej si roman ndërsa në një tjetër punim e njëjta vepër konsiderohej si tregim.

Të njëjtin problem e konstatojmë edhe me romanin "Dashuria e Talatit dhe Fitnatit" të shkrimtarit Sami Frashëri të cilin një pjesë e studiuesve e konsiderojnë si një roman të dobët ndërsa një pjesë e konsiderojnë si një tregim të gjatë., por edhe pse nuk e pranojnë hapur, konsiderimi si tregim mund të ketë edhe arsyen pak të debatuar që një pjesë e studiuesve duan të quajnë Namik Kemalin, një turk të pastër, si

romancierin e parë turk dhe jo një shkrimtarë me origjinë shqiptare. Edhe pse Sami Frashëri do të jetë një nga themeluesit e gjuhës së sotme turke me fjalorin e tij turqisht.

Studimet e fundit të bëra mbi fillimin e romanit kanë si qëllim të gjejnë ndonjë libër tjetër që të ulë datën e shkrimit të romanit të parë turk. Kështu në një punim të Tietze në vitin 1991<sup>57</sup> flitet për Akabi Hikayesi, një vepër të shkruar turqisht, por me gërma armene në vitin 1851 nga Vartanyan Pasha, një armen. Kjo vepër sipas tij mund të jetë romani i parë turk duke e çuar kështu me njëzetentjetë vjet më herët romanin e parë turk. Inci Enginün në librin e saj “Yeni Türk Edebiyatı Tanzimat’tan Cumhuriyete” i rendit kështu kandidatët për romanet e para turke. Turqisht : Muhayyelat i shkruar në vitin 1796 nga Aziz Efendi nga Kreta ku gjejmë disa tipare të romanit. Turqisht, por me gërma armene (alfabet) : Akabi Hikayesi e përmendur më sipër. Turqisht me gërma greke (alfabet) Temaşa-ı Dünya ve Cefakar u Cefakeş, i shkruar në vitet 1871-1872 nga Evangelios Misailidis.<sup>58</sup>

Dyshimi nëse është një tregim ose një roman në tridhjetë vitet e para të romanit në letërsinë turke do t’i ndjek gjithmonë nga pas romanet e dala në këtë kohë. Vetëm në fillim të shekullit XX ndryshimi do të jetë i qartë dhe i pangatërrueshëm.

Në çdo fillim romani do të jepet nga një shpjegim i shkurtër për të bërë një prezantim sado modest në lidhje me romanin. Romanet do të ndahen në fillim sipas një ndarjeje të madhe që ka periudha e letërsisë së Tanzimatit. Më pas do t’i ndajmë sipas tematikave që prekin.

Letërsia e periudhës së Tanzimatit ndahet në dy periudha të kushtëzuara nga zhvillimet historike të kohës. Letërsia e periudhës së Tanzimatit fillon në vitin 1860 me hapjen e gazetës së parë private “Tercüman-ı Ahval”. Ndërsa për sa i përket mbarimit të periudhës së parë kemi mendime të ndryshme nga studiuesit. Një pjesë e studiuesve pretendojnë se është viti 1876<sup>59</sup>, vit i shpalljes së parlamentit të parë. Ndërsa një pjesë tjetër pretendojnë se është viti 1880<sup>60</sup>, periudha kur fillon censura nga ana e sulltan Abdylhamitit pasi e mbyll parlamentin në vitin 1878.

#### **4.1.Periudha e parë e letërsisë së Tanzimatit. (1860-1880)**

Kjo periudhë e letërsisë së Tanzimatit që fillon në vitin 1860 është hapja e parë e letërsisë turke ndaj letërsisë perëndimore. Megjithëse fillon rreth 12 vite para daljes së romanit të parë ajo ka një rëndësi të veçantë pasi ashtu siç e thamë edhe më sipër me hapjet e gazetave dhe shkrimet e intelektualëve ajo përgatit lexuesin për ardhjen e romanit. Ndonëse zhvillimet letrare të kësaj kohe lidhen pandashmërisht me situatën politike ato ishin të varura edhe nga dëshirat dhe mendimet e shkrimtarëve. Tiparet kryesore të kësaj periudhe janë dëshira e shkrimtarëve për të përdorur një gjuhë më të thjeshtë dhe të kuptueshme nga një shtresë sa më e gjerë lexuesish dhe prekja e problemeve shoqërore të kohës. Duke qenë të ndikuar nga letërsia perëndimore ata do të tregojnë edhe pjesë të këtij ndikimi në romanet e tyre të para. Romanet e periudhës së parë të letërsisë së Tanzimatit do të ndajmë sipas tematikës për të treguar më qartë

<sup>57</sup> Tietze, A, Vartan Paşa, Akabi Hikayesi, 1991, Stamboll, f. X

<sup>58</sup> Enginün, İ, Yeni Türk Edebiyatı Tanzimat’tan Cumhuriyete, 2010, botimi V, f. 168-172

<sup>59</sup> Tanpınar, Ahmet H. 19. Asır Türk Edebiyatı Tarihi, 1997, botimi VIII, f. 151

<sup>60</sup> Kabaklı, A. Türk Edebiyatı, Stamboll, 1994, f.11

zhvillimin e romanit në fillimet e tij. Kuptohet që në një shoqëri në ndryshim siç ishte shoqëria Osmane ajo që bie më shumë në sy është përplasja mes të resë dhe të vjetrës. Në të njëjtën kohë edhe përplasja mes pranimit të stilit të jetesës sipas qytetërimit perëndimor dhe atij lindor është një temë shumë e prekur. Ndonëse në këtë periudhë nuk kemi shumë romane ato mjaftojnë për të na dhënë një pasqyrë të fillimit të romanit.

#### **4.1.1. Romanet me tematikë shoqërore**

Tematika më e përdorur nga romancierët e parë turq janë marrëdhëniet sociale në shoqërinë Osmane. Romanet që e marrin tematikën nga marrëdhëniet shoqërore ku përfshihet martesja, miqësia, familja dhe puna janë një risi në letërsinë turke. E reja konsiston në prekjen e problemeve në këto fusha. Deri më atëherë në letërsinë turke nuk prekej asnjë problem i shoqërisë Osmane. Me futjen e romanit dhe tregimit prekja e problemeve shoqërore dhe goditja e fenomeneve negative kthehet në qëllimin kryesor të shkrimtarëve dhe intelektualëve të kohës. Güzin Dino shprehet kështu në lidhje me ndryshimin që sjellin romancierët e parë turq. “Një nga shkrimtarët që del kundër letërsisë tradicionale të mbushur me cilësi të mbinatyrshme, të këputur nga jeta reale, të trilluar, që e kishte gënjyer për shekuj të tërë lexuesin, ishte Namik Kemali.<sup>61</sup>” Dashuria është në epiqendër të këtyre mardhënieve, por mënyra e trajtimit të saj ndryshon nga trajtimi i bërë në tregimet popullore të mëparshme. Ajo është me e prekshme, më tokësore dhe pa shumë cilësi të mbinatyrshme.

#### **Dashuria e Talatit dhe Fitnatit (1872)**

Romani Dashuria e Talatit dhe Fitnatit është romani i parë dhe i vetëm i shkrimtarit, publicistit, hulumtuesit dhe studiuesit të madh Sami Frashëri (Şemsetin Sami). Përveç se është romani i parë dhe i vetëm i shkrimtarit ai mbahet edhe si romani i parë në turqisht. Arsyeja që e shtyu Sami Frashërin atëherë vetëm 21 vjeç, për ta shkruar ishte dëshira e tij për të praktikuar turqishten të cilën nuk e njihje shumë mirë.<sup>62</sup> Me gjithë kundërshtitë për nivelin e romanit ose tentativat për të nxjerr ndonjë vepër tjetër, ende sot e kësaj dite romani i Sami Frashërit mbahet si tentativa e parë serioze në gjininë e romanit në letërsinë turke.<sup>63</sup>

Romani fillon me bisedën në familjen e Talatit mes nënës së tij dhe shërbëtores. Ato i kërkojnë Talatit t’u tregojë një tregim që u pëlqente, por ai nuk e ka mendjen aty dhe largohet i hutuar. Nëna Saliha dhe shërbëtorja arabe Aishe kujtojnë kohët kur ajo u dashurua me Rifatin burrin e saj që në vogëli. Ajo i tregon për peripecitë që hoqën kur babai i saj donte ta martonte me një burrë të pasur dhe jo me Rifatin pasi babai i tij ishte një pijanec dhe kumarxhi që kishte humbur gjithë pasurinë. Pastaj Aishja i tregon për fëmijërinë e saj dhe rrëmbimin në moshë të re. Për peripecitë që kaloi nga Arabia ku ishte vendlindja e saj në Egjipt, Tunizi dhe pastaj në Stamboll. Salihaja tregon për dashurinë që kishte për Talatin, besimin që kishte ajo në karakterin e tij që nuk do binte në rrugë të keqe.

<sup>61</sup> Dino, G. Türk Romanın Doğuşu, botimi II, 2008, Stamboll, f.23

<sup>62</sup> Servet-i Fünun (6 Qershor 1312 nr. 11 f. 275) Şemsettin Sami, Ağah Sırrı Levent, 1969, Ankara (f. 77)

<sup>63</sup> Levent, A. Sırrı, Şemsettin Sami, 1969, Ankara (f. 77)

Talati ishte një djalë me veti të mira qoftë nga pamja e jashtme ashtu dhe nga karakteri., por edhe pse ishte një djalë i qeshur, i dashur dhe i sjellshëm ai kohët e fundit pa u kuptuar shkaku kishte pësuar një ndryshim në sjellje. Arsyeja e këtij ndryshimi kuptohet kur ai shkon në dyqanin e Haxhi Mustafës që e thërrisnin Haxhibaba, njerikut të Fitnatit. Talati shikon për herë të parë Fitnatin në verandën e shtëpisë së Haxhibabës, e cila ishte pjesë e dyqanit ku ai shiste duhan.

Talati bie në dashuri me shikim të parë me Fitnatin. Ai nuk e ka më mendjen në vend. Gjithçka që mendon është si të shohë përsëri atë vajzë të bukur. Asnjë nga miqtë dhe familja nuk arrijnë të kuptojnë ndryshimin në sjelljen e tij.

Fitnati ishte një vajzë e bukur në moshën 15 vjeçare. Ajo rritej nga njerku pasi nëna e saj kishte vdekur që kur ajo ishte një vjeçe. Njerku, Haxhi Mustafa ishte martuar me nënën e Fitnatit pasi ajo i kishte thënë se ishte e ve dhe burri i kishte vdekur. Nëna e Fitnatit para se të vdiste i var një nuske në qafë dhe i kërkon njerkes së Haxhi Mustafës, një plake të fortë, por që i pëlqenin shumë përrallat, ta hapte nuskën kur Fitnati të mbushte 18 vjeç.

Haxhi Mustafa ishte një njeri zemërak dhe i rreptë. Ai nuk e linte Fitnatin të dilte nga shtëpia pasi kishte frikë se mos e ngacmonin meshkujt rrugës dhe binte në rrugë të keqe. Megjithatë ai e donte shumë vajzën dhe asnjëherë nuk i bërtiste. Ndoshta edhe sepse Fitnati ishte një vajzë e dëgjuar që nuk hapte probleme.

Gjithë jeta e Fitnatit deri në shikimin e Talatit ishte mes katër mureve të shtëpisë duke qëndisur. Ajo ishte e dhënë shumë pas qepjes dhe qëndisjes dhe nuk mendonte për gjë tjetër. Njerëzit e vetëm me të cilët fliste ishte Emineja, njerka e Haxhi Mustafës, znj. Sherife, mësuesja e qëndisjes dhe njerku i saj Haxhi Mustafa.

Një ditë ajo shikon Talatin duke ecur në rrugë dhe ndjen një dëshirë të madhe ta shoh përsëri. Fillon të qëndrojë në dritare për të parë përsëri kur kalon Talati. Që nga kjo ditë Fitnati nuk interesohet më për qëndisjen, por fillon të mendojë se kush mund të ishte ai djalë.

Znj. Sherife kur sheh se Fitnati nuk është më si më parë i kërkon njerikut të saj që ta lërë të dal dhe të takohet me njerëz të tjerë pasi kështu ajo do të sëmuret. Haxhi Mustafa edhe pse nuk i pëlqen kjo gjë i thotë se mund ta lejojë të takohet me ndonjë vajzë tjetër për të bërë shoqëri, por kjo mund të ndodhte në shtëpinë e tij. Znj. Sherife largohet e kënaqur që i ka marrë leje, por mendon se kë mund t'i sjellë në shtëpi Fitnatit.

Kur znj. Sherife del nga shtëpia e Fitnatit për të shkuar në shtëpinë e saj Talati, i cili po kalonte andej, e ndjek për të parë se kush ishte me shpresën që të gjente ndonjë mundësi për t'u takuar me Fitnatin. Ai mëson se Sherifeja jepte mësimë qëndisjeje dhe vendos të vishet si vajzë dhe të shkoj të bëj kurs tek ajo me shpresën që të takojë Fitnatin aty. Pasi blen rroba për femra dhe një paruke, duke përfutur se ishte akoma një djalë i ri dhe nuk i kishte dalë mjekra, shkon dhe prezantohet tek Sherifeja si një vajzë me emrin Ragibe që kishte dëshirë të mësonte qëndisje. Ajo e habit Sherifen me njohuritë që kishte. Ragibe i hyn në zemër Sherifes dhe ajo mendon se ka gjetur vajzën e duhur për ta sjell tek Fitnati. Kështu Fitnati do mësonte shkrim dhe lexim nga Ragibja kurse Ragibeja do mësonte qëndisje nga Fitnati.

Kur znj. Sherife i thotë Ragibes (Talatit) a dëshiron të shkosh në shtëpinë e një vajze me emrin Fitnat ai mrekullohet pasi nuk priste që t'i vinte rasti për takim kaq shpejt. I lumturuar ai largohet nga Sherifeja, por në rrugë i ngjitet një koleg i zyrës duke kujtuar se ai ishte një femër e bukur. I tronditur nga fyerjet që pësojnë femrat në rrugë ai shkon në shtëpinë ku ndryshon veshjen. Ndërsa kolegu i tij e ndjek deri në derën e shtëpisë.

Fitnati gëzohet kur mëson se do vijë një vajzë në shtëpi. Si ajo edhe Talati presin me padurim takimin e parë. Vetëm se Talati e di me kë do takohet. Ndërsa Fitnati gëzohet që do ketë një shoqe që di më shumë për jetën jashtë mureve të shtëpisë.

Në takimin e parë Talati dridhet nga emocionet. Ai nuk arrin ta shoh në sy Fitnatin që e merr përdore dhe e ul pranë vetes. Kurse Fitnati habitet nga ngjashmëria që ka Ragibeja me djalin që ajo shihte të kalonte në rrugën para dritares së saj., por ajo ka frikë ta pyes. Më pas znj. Sherife u thotë se tani që u njohën ato mund të takohen vetë dhe të punojnë me njëra-tjetrën dhe ikën. Ato flasin me njëra-tjetrën duke u miqësuar shpejt. Fitnati e pyet nëse ka ndonjë vëlla dhe Talati, i cili e kupton arsyen e kësaj pyetje i thotë që ka një vëlla një vit më të madh i cili i ngjan shumë. Pasi flasin për shumë kohë ato ndahen duke u puthur.

Talati kthehet në shtëpi i lumtur që ka marr një puthje nga vajza që do. Kurse Fitnati është e dyzuar mes dashurisë që ka ndaj djalit që ka parë në rrugë dhe ndjenjës që ka për Ragiben. Sikur ta dinte që janë i njëjti person do ishte e qetë, por kështu ndihet e turbullt.

Në takimin e dytë pasi qëndisin për një orë ato kalojnë në mësimin e shkrimit. Gjatë bisedës që bëjnë Fitnati e pyet për vëllanë e saj., por Talati kujton se e kanë zbuluar që është djalë dhe e shikon i frikësuar. Kurse Fitnati kujton se Ragibe ka kuptuar që ajo ndjen diçka për vëllanë e saj dhe e frikësuar nuk thotë gjë në lidhje me ndjenjat e saj. Megjithatë ato vazhdojnë të flasin miqësisht.

Në të njëjtën ditë znj. Sherife shkon për të dhënë mësim qëndisjeje tek një xharije<sup>64</sup> e re në moshë në një vilë shumë të madhe në Yskydar<sup>65</sup>. Atje jetonte një njeri i pasur me emrin Ali. Edhe pse kishte shumë shërbëtore ai nuk ishte i martuar. Arsyeja pse ai nuk ishte i martuar është se para 16 vjetësh ai kishte qenë i martuar me një vajzë të re, por duke qenë se ishte një tip nevrrik dhe inatçi ai e kishte dëbuar atë gjatë një zënke. Më pas ishte penduar, por nëna e vajzës nuk e kishte lënë vajzën të kthehej tek ai. Më pas vajza ishte martuar me një burrë tjetër duke lindur edhe një vajzë të cilën burri e pranon si vajzën e saj. Z. Ali që prej asaj dite rrinte i pikëlluar dhe nuk mendonte më për tu martuar.

Znj. Sherife pasi flet me një nga shërbëtoret e vjetra të vilës dhe mëson arsyen pse nuk ishte martuar shkon dhe i flet. Aliu në fillim nuk pranon të bisedojë për martesë. Kur znj. Sherife fillon t'i tregojë për një vajzë me të njëjtat karakteristika si të ish gruas fillon dhe interesohet. Në fund ai i thotë që do ta mendojë

---

<sup>64</sup> Femër e blerë në treg (skllave) që mbahet në shtëpi për të bërë punët e shtëpisë, por që përdoret edhe për argëtimin e të zotit të shtëpisë. Nganjëherë arrin të martohet me të zotin e shtëpisë dhe bëhet zonja e shtëpisë.

<sup>65</sup> Lagje e Stambollit në anën Aziatike.



propozimin e saj. Vajza për të cilën i kishte folur Znj. Sherife nuk ishte askush tjetër përveç se Fitnatit.

Znj. Sherife menjëherë pasi merr një gjysmë fjale nga Aliu shkon dhe takon Haxhi Mustafën duke i treguar për pasuritë dhe vilën e madhe që kishte Aliu dhe i kërkon që t'ia japë Fitnatit për grua. Haxhi Mustafa duke menduar për të mirën e Fitnatit pranon pa e pyetur atë.

Lajmi se do të martohet me një burrë të pasur që nuk është Talati bën që Fitnatit t'i bien të fikët. Kur ajo ja tregon Ragibes që të dyja fillojnë të qajnë. Talati nuk duron më dhe i tregon se kush është në të vërtetë duke hequr parukën. Dy të dashuruarit përqafohen duke u ankuar për fatin e tyre të keq. Ata premtojnë se do vetëvriten nëse nuk gjejnë dot një mënyrë që të jenë bashkë., por fati ka vendosur që ata të ndahen. Fejesa është bërë pa aprovimin e Fitnatit. Kur vijnë shkesët në vend të saj përgjigjet vajza e fqinjit që pranon të fejohet.

Fitnati e dëshpëruar fillon të tretet. Talati nuk i vjen më dhe ajo kujton se mos ka vrarë veten. Dëshpërimi i Fitnatit bie në syrin e Emines, njerks së Haxhi Mustafës dhe ajo i thotë Haxhi Mustafës që nëse vazhdon kështu ajo do të sëmuret dhe do të vdesë. Haxhi Mustafa mendon se ka bërë gjënë e duhur dhe se me kalimin e kohës do qetësohet, por kur e sheh që Fitnati nuk po përmirësohet vendos të bëjë një hile të vogël. I shkon dhe i thotë se e kanë anuluar martesën. Pastaj flet me Eminenë dhe përgatisin planin. Ata do i thonë që do shkojnë për verim tek një vilë në Yskydar. Ata mendojnë se kur të shkojnë në shtëpinë e Aliut ajo do të shoh pasurinë dhe Aliun dhe do ndryshojë mendje.

Edhe pse beson se martesë është anuluar Fitnati nuk ndihet mirë pasi nuk ka asnjë lajm nga Talatit. Një ditë para se të largohet për në vilën verore (në fakt për në vilën e z. Ali, burrit të ardhshëm) znj. Sherife i sjell një letër nga Ragibeja. Aty Talati i tregon për sëmundjen që e kapi dhe nuk e linte të ngrihej nga krevati. Aq rëndë ishte sëmurë ssa nëna e tij i kishte humbur shpresat se do jetonte. Fitnati gëzohet që Talati është gjallë dhe i dërgon një letër po me anë të Sherifes për t'i thënë se po shkonte për verim në Yskydar dhe se e priste në vilën ku do qëndronte.

Ditën që do shkojnë për verim, Emineja me Haxhi Mustafën i thonë që të vishet bukur pasi do shkojnë në një shtëpi të ngritur dhe nuk bën të shkojë e veshur normalisht. Fitnati, që nuk dyshonte asgjë, vishet me rrobat e saja më të bukura. Kur Fitnati hipin në traget për të kaluar në Yskydar habitet kur sheh që të gjithë gratë që ishin aty po e vështronin me kureshtje. Edhe një vajzë e vogël e ulur pranë saj e shikon tërë kërshëri pa marr guximin ta pyes., por kur zbresin nga traget kjo vajzë e vogël të cilën Fitnati nuk e njohte, e merr për dore dhe e hip në një karrocë. Edhe gratë e tjera hipin në karroca dhe nisen të gjitha bashkë. Fitnati pyet Eminenë çfarë janë këto që po ndodhin., por kur Emineja mundohet t'i shmanget pyetjes e kupton që po e çonin tek burri i saj dhe i bien të fikët.

Pasi e fusin në shtëpi ajo vendoset në një dhomë së bashku me Serfirazenë, vajzën e vogël që e kishte hipur në karrocë. Aty Fitnati qan me dënësë dhe nuk arrin t'ia shpjegojë arsyeën e hidhërimit të saj Serfirazesë.

Në darkë në dhomë vjen Aliu. Ai habitet me ngjashmërinë që kishte Fitnati me ish gruan e tij të ndjerë të vdekur para 15 vitesh. Edhe pse i flet Fitnatit ai nuk e

prek me dorë, por shkon dhe fle në një dhomë tjetër. Me shpirtin e trazuar ai e kupton që Fitnati dashuron një tjetër. Aliu ndihet i zënë në kurth mes dëshirës për të bashkuar Fitnatin me të dashurin e saj duke e bërë Fitnatin të lumtur dhe dashurisë që ai ndjen për të.

Pasi kalojnë disa ditë vjen znj. Sherife dhe Fitnati i jep një letër tjetër për t'i treguar Talatit çfarë ka ndodhur. Në të njëjtën ditë Aliu i kërkon Fitnatit ta dashurojë sepse po çmendet., por Fitnati i thotë se mund ta donte si baba ose si vëlla, por jo si burrin e saj. Aliu i tronditur i vendos dorë në gjoks për ta puthur, por Fitnati tërhiqet dhe Aliut i ngel në dorë nuska që Fitnati kishte të varur.

Aliu largohet i mërzhitur nga dhoma. Fitnati mbyll derën e dhomës me çelës. Aliu hap nuskën dhe aty lexon që Fitnati, gruaja e tij, në fakt ishte vajza e ish gruas së tij të parë. Domethënë ishte vajza e tij.

I tronditur ai vrapon tek dhoma e Fitnatit duke bërtitur “Fitnat, unë jam babai yt”, por dera nuk hapet. Dëgjohen vetëm disa rënkime. Pasi e shpërthen derën ai shikon Fitnatin në një pellg gjaku duke dhënë shpirt. Fitnati kishte ngulur një thikë në gjoks. Ajo i kërkon babait të saj të lajmërojë Talatin. Në atë çast vjen Talati i maskuar si Ragibe dhe shikon Fitnatin të mbuluar në gjak. Pak çaste më vonë Fitnati vdes. Kur njerëzit e shtëpisë merren me Fitnatin edhe Talatit vret veten. Aliu çmendet. Gjatë varrimit ai ecën këmbëzbathur pas trupave që çohen në varreza. Pas varrimit atë e fusin në çmendinë. Gjashtë muaj më pas vdes në çmendinë nga hidhërimi.

### **Intibah (Pendimi i fundit) (1874)**

Romani Intibah i shkrimtarit, publicistit dhe politikanit Namik Kemal është një nga romanet e para për nga viti i botimit, por i pari për shumë studiues për nga përmbajtja dhe stili i shkrimit që e afronte më shumë me një vepër letrare të tillë sesa ato shkrime të tjera që pranohen si romane, por që janë të një date më të hershme edhe pse luajnë vetëm me një periudhë kohore prej një viti ose më pak. Ky roman është botuar në vitin 1876. Për shkak të trajtimit të temës ai është romani më i spikatur nga romanet e parë të shkruajtur në vitet 1873-1876<sup>66</sup>. Emri i romanit u ndryshua nga Son Pişmanlık (Pendimi i fundit) në Intibah për shkak të shqetësimeve që pati nga ministria e arsimit për emrin e parë. Qëllimi kryesor i Namik Kemalit ashtu si edhe i Sami Frashërit, në shkrimin e këtij romani ishte për të shkruar një vepër në këtë gjini letrare të pa eksploruar shumë në letërsinë turke.

Aliu, është djali i vetëm i një familjeje shumë të pasur dhe të mirë. Prindërit e tij janë shumë të kujdesshëm në edukimin e djalit të tyre. Që në moshë të re ai merr një arsimim shumë mirë dhe mëson disa gjuhë të huaja., por ata bëjnë një gabim. Duke u përqendruar vetëm tek arsimimi nuk u kujdesën për karakterin e tij dhe ai zhvillon një karakter me një temperament nervoz dhe pasionant. Babai i tij pasi e vë re këtë temperament të djalit mundohet që ta drejtojë drejt librave për ta ndryshuar., por kjo gjë thjesht i jep një drejtim tjetër dhe nuk ja ndryshon temperamentin Aliut. Deri në vdekjen e babait, Aliu bënë një jetë të rehatshme mes shtëpisë, punës dhe librave. Pa u preokupuar për gjë tjetër. Kur babai i vdes rreth moshës 20 vjeçare, gjithë mënyra e jetesës me të cilën ishte mësuar

---

<sup>66</sup> Dino, G. Türk Romanın Doğuşu, botimi II, 2008, Stamboll, f. 22

shkatërrohet. Babai për Aliun ishte boshti mbështetës në jetë. Me humbjen e këtij boshti Aliu ndihet i zbrazët dhe pa mbështetje.

Ai kalon shumicën e kohës i mbyllur në dhomën e tij. Nëna e tij e shqetësuar për gjendjen ku ndodhet Aliu e këshillon të dalë shëtitje në shëtitoren Çamllëxha. Këshillat e nënës bëjnë punë dhe nga shëtitjet e bëra Aliu fillon dhe e merr veten. Aliu, si shumë të rinj të shtresës së lartë në Stamboll punonte në zyrat shtetërore. Kur ai u tregon për shëtitjet ata i kërkojnë që t'i marr me vete. Kështu që vendosin që një ditë pushimi, që ishte e premtja, ata të shkojnë të shëtisin. Në ditët e pushimit në Çamllëxha dilnin për shëtitje edhe gratë. Në fakt kjo ishte edhe arsyeja pse shokët e Aliut dëshironin të shkonin në shëtitore.

Sapo fillojnë të kalojnë karrocet me femra, shokët e Aliut fillojnë t'i ngacmojnë dhe t'u bëjnë shenja. Aliu, i pamësuar me këto lloj sjelljesh për të mos u dukur diletant fillon të bëjë të njëjtat shenja ndaj një karroce që po kalonte aty pranë pa e ditur kuptimin. Gruaja që ishte në karrocë i bën një shenjë që do të thoshte “nuk mundem për momentin se ka njerëz rreth e rrotull.”, por Aliu i cili nuk e dinte kuptimin shqetësohet sepse mendon që ka bërë një gjë shumë të keqe. Pasi kalon disa ditë i shqetësuar dhe pagjumë ai del përsëri për të parë karrocën duke e pritur në vendin që e kishte parë për herë të parë. Pas pak kalon karroca pa ndaluar. Aliu e ndjek karrocën e cila ndalon në një vend paksa të fshehur nga syri i njerëzve.

Nga karroca zbret një femër shumë e bukur me emrin Mehpejker. Ajo që Aliu nuk di është se ajo ishte edhe një nga prostitutat më të famshme të Stambollit. Aliu mbetet gojë hapur para bukurisë së Mehpejkerit dhe nuk flet dot. Mehpejkeri, e rrahur me vaj e me uthull në këto lloj takimesh futet vetë e para në bisedë.

Mehpejkeri është një grua e shtresës së ulët, por me aftësitë dhe këmbënguljet e saj ajo mëson të shkruaj e lexojë. Duke përdorur bukurinë arrin të bëhet pjesë e një kaste të respektueshme dhe të lartë të shoqërisë së kohës. Bukuria dhe pafajësia e Aliut e bëjnë të dashurohet pas tij. Që të mos i shpëtojë rasti Mehpejkeri fillon t'i thotë Aliut që i ka pëlqyer që ditën e parë që e pa dhe se ka rënë në dashuri me të. Mehpejkeri, edhe pse ishte një prostitutë e cila shkonte me meshkujt në këmbim të parave, u dashurua me të vërtetë me Aliun. Për këtë arsye ajo hiqet si një grua e ndershme para Aliut që mos e bëjë atë të kuptojë fytyrën e vërtetë të saj. Aliu bie kokë e këmbë brenda këtij kurthi që i ngre Mehpejkeri. Duke qenë se nuk kishte njohur femër tjetër përveç nënës së tij gjatë gjithë jetës së tij ai nuk arrin ta kuptojë kurthin. Ai i beson çdo gjëje që thotë Mehpejkeri dhe i propozon për martesë., por Mehpejkeri nuk kishte si qëllim martesën, por thjeshtë të argëtohej me Aliun. Aliu nuk arrin ta besojë pse Mehpejkeri nuk pranon për martesë dhe fillon të dyshojë se ajo nuk e do mjaftueshëm., por Mehpejkeri me aftësitë e saja arrin ta bind dhe lënë një takim tjetër.

Pas fillimit të miqësisë me Mehpejkerin, Aliu ndryshon rrënjësisht. Fillon të gënjejë të ëmën dhe të mos shkojë në punë. Ai beson tek dashuria e Mehpejkerit deri sa një ditë mëson të vërtetën gjatë një debati me shokët, të cilët e ngacmojnë Mehpejkerin para syve të tij në Çamllëxha. Edhe pse nuk dëshiron ta besoj Aliu e mëson të vërtetën e hidhur në lidhje me të dashurën e tij dhe tronditet thellësisht. Aliu pret ditën e takimit për t'i treguar Mehpejkerit se e ka mësuar të fshehtën e saj dhe për ta braktisur.

Por në takim, për shkak të bukurisë së Mehpejkerit, Aliu nuk arrin të thotë gjë tjetër përveç se nuk e priste një gjë të tillë. Mehpejkeri i tregon për të shkuarën dhe varfërinë ku ishte rritur. I thotë se nuk mundi t'ia tregonte që në fillim nga frika se mos e humbiste. Aliu i beson fjalëve të Mehpejkerit dhe zbutet. Ndërsa Mehpejkeri i betohet që nuk do pranojë më asnjë mashkull tjetër përveç Aliut. Më këtë premtim ajo ja prish mendjen Aliut dhe nga një dashuri normale lidhja e tyre kthehet në një lidhje epshi duke ndikuar në psikologjinë e tij.

Tashmë Aliu fillon të mashtrojë rregullisht të ëmën për të shkuar në shtëpinë e Mehpejkerit ku kalon net të shfrenuara argëtimi dhe epshi. Ky ndryshim i shpejt i Aliut e shqetëson nënën e tij. Pasi takon shokët e Aliut ajo mëson të vërtetën e hidhur në lidhje me djalin e saj. Daja i shokut më të ngushtë të Aliut, Mesut Efendi i jep disa këshilla për ta shpëtuar Aliun nga kthetrat e Mehpejkerit. Këshilla kryesore është që të blejë një skllave të bukur për Aliun.

Nëna e Aliut, Fatma, paguan një shumë të madhe parash për të blerë një skllave shumë të bukur dhe të edukuar. Dilashubi është një femër jo vetëm shumë e bukur, por edhe e ndjeshme. Kjo nuk mjafton që ta bëjë Aliun të harrojë Mehpejkerin. Aliu nuk tregon asnjë interes për Dilashubin. E zemëruar, nëna e Aliut debaton me atë. Aliu i nevrikosur largohet nga shtëpia dhe nis për tek shtëpia e Mehpejkerit.

Një nga dashnorët e shumtë të Mehpejkerit është edhe Abdullah Efendi, një tregtarë i madh nga Siria. Ai e kishte fituar pasurinë e tij të stërmadhe me punë të pista dhe ishte një njeri shumë hakmarrës dhe intrigant. Ai ishte shumë i dhënë pas femrave, por duke qenë se ishte në moshë shumë të madhe, mbi 70 vjeç, nuk arrinte ti bënte femrat të vinin tek ai me dëshirë, por i mbulonte me dhurata dhe para. Kështu bënte edhe me Mehpejkerin. Duke i dhënë para dhe dhurata të shtrenjta. Megjithatë ai nuk arrinte ta bënte Mehpejkerin të ishte vetëm e tija, por e lejonte të rrinte edhe me meshkujt të tjerë.

Abdullahi rastisi të vinte në Stamboll gjatë kohës që Mehpejkeri u njoh dhe filloi lidhjen me Aliun. Mehpejkeri donte të ndahej nga Abdullahi pa e marr vesh Aliu, por kishte frikë nga hakmarrja e tij dhe donte të ndahej miqësisht. Për këtë arsye pasi i thotë Aliut të shkojë të qëndrojë në shtëpinë e të ëmës për disa ditë nis të takojë Abdullahin në Stamboll., por takimi me Abdullahin zgjat shumë dhe Mehpejkeri nuk arrin të kthehet në vilën e saj në Kuzunxhu që ndodhej në anën tjetër të Bosforit. Aliu, pasi debaton me nënën e tij nis për në shtëpinë e Mehpejkerit. Kur nuk e gjen Mehpejkerin në shtëpi tërbohët nga inati pasi mendon që ajo ka shkuar tek ndonjë nga dashnorët e saj të vjetër. Ai vendos ta presë për ti shfryrë në fytyrë të gjithë mllefën që ka përbrenda dhe pastaj të iki.

Mehpejkeri përpiket të sqarojë Abdullahin për vendimin që kishte marr., por Abdullahi në fillim nuk pranon. Më pas ai zbutet dhe i jep kohë gjashtë muaj që të kalojë me të dashurin e saj të ri dhe pastaj të vazhdojnë përsëri bashkë. Mehpejkeri e gëzuar që ka fituar kohë të mjaftueshme kthehet në shtëpi të nesërmen në mëngjes ku shikon Aliun që po e priste tek pragu i derës. Aliu i mbushur me urrejtje shpërthen duke e sharë dhe ofenduar dhe pasi i hedh disa kartëmonedha në fytyrë largohet pa i dhënë mundësi të shpjegohet.

Aliu kthehet në shtëpi dhe i kërkon të falur nënës. Fatimja me Dilashubin janë të gëzuara që ai është kthyer në shtëpi. Aliu ja plotëson nënës dëshirën dhe

martohet zyrtarisht me Dilashubin dhe fillon të bëjë një jetesë normale. Ndërsa Mehpejkeri kujton se zemërimi i Aliut ishte thjeshtë i përkohshëm dhe se pasi të qetësohej do kthehej përsëri tek ajo. Kur sheh që Aliu edhe pse kalon shumë kohë nuk bëhet i gjallë ajo fillon t'i dërgojë letra dashurie. Kur nuk merr përgjigje ajo fillon t'i shkruaj letra kërcënuese. Aliu i kthen përgjigje duke i thënë që ka gjetur një grua të ndershme për të kaluar jetën dhe se nuk dëshiron që ta shqetësojë më. Dashuria ose tërheqja, sido të quhej ndjenja që kishte Mehpejkeri për Aliun tani kthehet në një urrejtje dhe dëshirë për hakmarrje.

Në fillim ajo mëson se kush është gruaja e Aliut. Pastaj përpiqet ta shohë me sytë e saj. Kur e sheh impresionohet nga bukuria, rinia dhe zgjuarsia e saj., por kjo nuk bën gjë tjetër përveç se i tregon se nuk ka shanse që Aliu të kthehet përsëri tek ajo. Kjo i shton edhe më shumë dëshirën për tu hakmarrë. Për këtë arsye shkon të takojë specialistin e hakmarrjeve Abdullain. Se bashku me të ajo thur një plan.

Në fillim me anë të shërbëtoresh në shtëpinë e Aliut mëson ditët dhe hamamin ku shkon Dilashubi. Pasi e mëson shkon dhe e vëzhgon me kujdes trupin e Dilashubit ku dallon dy nishane. Po ashtu duke paguar shërbëtoresh e shtëpisë së Aliut mëson se Dilashubi mbante një ditar dhe se një ditë kur Aliu kërkon ta lexojë ajo i gris faqet e ditarit. Pasi merr informacion të saktë ajo hidhet në veprim. Dërgon një djalë simpatik në kafenenë ku ulej Aliu duke i treguar se çfarë të thoshte. Djali simpatik mburret para shokëve me zë të lartë në kafenenë ku ishte ulur edhe Aliu se ka një lidhje të fshehtë me një grua të martuar. Ai tregon shtëpinë, nishanet në trupin e Dilashubit, madje edhe se si i kishte grisur fletët e ditarit ajo kur Aliu kishte kërkuar për ta lexuar. Aliu nuk i beson veshëve për atë që dëgjon dhe mezi e merr veten.

Ai kthehet në shtëpi dhe e rreh Dilashubin. Nga tërbimi Aliu i bien të fikët dhe për shkak të temperamentit të skajshëm sëmuret nga një sëmundje mendore. Kur vjen në vete kërkon largimin e Dilashubit nga shtëpia. Nëna e Aliut edhe pse është e sigurt për ndershmërinë dhe moralin e Dilashubit për hir të shëndetit të djalit e shet Dilashubin. Blerësi i Dilashubit ishte porositur që më parë nga Mehpejkeri dhe pasi e blen e dërgon menjëherë tek vila e saj. Mehpejkeri e blen Dilashubin për veten e saj dhe e përdor si shërbëtoresh., por qëllimi kryesor i saj është ta kthejë Dilashubin në një prostitutë si vetja e saj., por me gjithë torturat dhe përpjekjet e bëra Dilashubi nuk pranon të bëhet prostitutë dhe e kërcënon Mehpejkerin se do të vetëvritet. Edhe pse mërzhitet që nuk ia del Mehpejkeri e lë Dilashubin të qetë për momentin.

Aliu tashmë i sëmurë nga mendja edhe pse shërohet fizikisht nuk është më i njëjtë. Mundohet ta largojë mendjen duke bredhur nëpër mejhane. Kalon gjithë ditën i pirë dhe nuk shkon më në punë. Duke jetuar kështu ai shpenzon gjithë pasurinë e trashëguar nga i ati. E ëma e tij edhe pse mundohet ta këshillojë që të ndryshojë jetë nuk ja arrin sepse Aliu e quan fajtorë për futjen e Dilashubit në jetën e tij. Nëna e tij nga hidhërimi tretet dhe vdes., por as kjo gjë nuk e zbut zemërimin e Aliut ndaj nënës së tij. Nuk i shkon as në varrim.

Pasi shpenzon edhe qindarkën e fundit të pasurisë Aliu fillon të bëjë çdo punë që gjen për të nxjerr paratë për të pirë. Kur nuk arrin të gjejë punë mundohet të mashtrojë ose të vjedhë. Mehpejkeri, akoma shpresonte për një bashkim me Aliun dhe e rregullon që të takohet me të gjatë një darke., por Aliu jo vetëm që e

refuzon, por edhe e ofendon para të gjithëve. Ky ofendim para të gjithëve e tërbon në maksimum Mehpejkerin që vendos të hakmerret duke e vrarë Aliun.

Mehpejkeri së bashku me Abdullain thur një plan të ri. Aliu do të ftohet në një gosti në një vend jo shumë të populluar dhe aty do të vritej nga një vrasës me pagesë që e kishte gjetur Abdullai. Mehpejkeri gjen një vilë me një vresht në të dalë të Uskudarit për të realizuar planin e saj. Ajo shkon edhe vetë për ta parë me sytë e saj vrasjen dhe merr me vete edhe Dilashubin. Dilashubi dëgjon bisedën mes Mehpejkerit dhe vrasësit dhe shkon me vrap tek Aliu për ta paralajmëruar. Aliu i beson Dilashubit dhe nisët me vrap drejt postës së policisë për të kërkuar ndihmë.

Dilashubi e lodhur vesh pallton e Aliut që e kishte lënë në dhomë dhe ulet në një qoshe. Vrasësi vjen dhe nga errësira nuk e dallon mirë se kush është nën pallto dhe e godet Dilashubin me thikë duke menduar që ishte Aliu. Në këtë çast vjen Aliu me policinë. Vrasësi largohet me vrap dhe policia e ndjek. Aliu shkon t'i kërkojë falje Dilashubit që është e plagosur rëndë. Mehpejkeri në vend që të largohet fshihet tek dollapi që ndodhet në dhomë dhe kënaqet pamasë kur sheh Aliun të shkatërruar nga dhimbja. Ajo del nga dollapi dhe i thotë që të gjitha këto gjëra ja ka bërë ajo. Aliu rrëmben thikën që kishte lënë vrasësi dhe vret Mehpejkerin. Abdullai vdes nga infarkti në zemër, ndërsa vrasësi vdes gjatë marrjes në pyetje. Aliu futet në burg për disa muaj. Herë pas here merr leje për të shkuar në varreza për të vizituar varrin e nënës dhe Dilashubit. Pas disa muajsh edhe ai vdes nga trishtimi. Në fund të librit jepet ideja kryesore ku thuhet "Pendimi i fundit nuk ka vlerë."

### **Felaton Beu dhe Rakim Efendi (1876)**

Romani "Felaton Beu dhe Rakim Efendi" është një nga veprat e para të shkrimtarit Ahmet Mid'hat Efendi. Me shkrimin e këtij romani shkrimtari përpiqet të japë një pasqyrë të jetës në Stambollin e atëhershëm duke bërë kritika mbi stilin e jetesës sipas mënyrës perëndimore që jetonin një pjesë e shoqërisë dhe duke ngritur lartë stilin e jetesës sipas mënyrës tradicionale, domethënë traditën Osmane të jetesës.

Ngjarjet fillojnë me prezantimin e familjes së Felaton Beut. Babi i tij, Mustafa Meraki Efendi, ishte një burrë tek të 45'at. Ai ishte martuar nga babai pa u marr pëlqimi i tij që gjashtëmbëdhjetë vjeç me një vajzë dymbëdhjetë vjeçare. Këta të rinj kishin lindur një djalë të cilit i vënë emrin Felaton. Pak kohë më vonë edhe pse mbetet shtatzënë nëna e tij e dështon fëmijën e dytë. Edhe pse me rrezik për jetën e saj ajo përsëri mbetet shtatzënë dhe lind një vajzë të cilës i vënë emrin Mihriban. Pak pas lindjes nëna e re vdes. Mustafa Meraki Efendi vendos të mos martohet më dhe merret me rritjen e dy fëmijëve.

Duke qenë një njeri që ndiqte modën perëndimore, Mustafa Meraki Efendi merr në punë disa shërbëtore për t'u kujdesur për rritjen e fëmijëve. Merr një shërbëtore si dado për vajzën, një shërbëtore greke për pastrimin e shtëpisë dhe një shërbëtore armene si kuzhinierë. Kjo dëshirë për të bërë një jetë allafrenga pasqyrohej edhe në edukimin dhe arsimimin që marrin fëmijët. Ata mësojnë me mësues privat.

Pasi arrin moshë madhore Felatun Beu fillon punë në një zyrë shtetërore., por edhe pse bën sikur punon ai nuk shkon shpesh në punë dhe i kalon ditët duke shëtitur dhe duke takuar njerëz si vetja e tij që ishin të pasionuar të jetonin sipas mënyrës Evropiane. Edhe pse nuk është shumë çapkën ai përpiqet të japë një përshtypje të tillë tek të tjerët. Ai është i dhënë shumë edhe pas kënaqësive të tjera të kohës.

Në këtë pjesë të romanit futet Rakim Efendi. Ndryshe nga Fetatun Beu, Rakim Efendi kishte humbur babanë që në moshë të vogël dhe ishte rritur nga e ëma dhe shërbëtorja e tyre arapja Fedai.

Me vdekjen e burrit të saj nëna e Rakimit e konsideron shërbëtoren Fedai si një pjesëtare të shtëpisë. Ajo i thotë asaj se ato tani ishin si dy motra dhe jo në pozicionin zonjë shtëpie shërbëtoare. Shërbëtorja Fedai e shikon Rakim Efendin si djalin e saj dhe përpiqet me të gjitha mundësitë të ndihmojë në mbajtjen e shtëpisë. Pasi arrin moshën madhore Rakim Efendi merr përsipër mbajtjen e shtëpisë duke punuar. Pak kohë më vonë i vdes nëna dhe i vetmi njeri ku mund të gjejë mbështetje i mbetet shërbëtorja Fedai e cila zë vendin e nënës për të.

Fedai fillon të ngul këmbë që Rakim Efendi të martohet., por Rakim Efendi nuk pranon këtë kërkesë dhe në vend të kësaj vendos të marr një shërbëtoare për të ndihmuar dadon e tij e cila ishte plakur shumë tani. Rakim Efendi nis për tek tregtari i skllëve me mendimin për të blerë një skllave arape., por kur shkon tek ai në vend që të marr një skllave arabe ai merr një skllave të re Çerkeze (Gjeorgjiane) e cila kushtonte më shumë para sesa kishte me vete Rakim Efendi., por bie dakort me tregtarin që t'ia sjellë pjesën e mbetur të parave më vonë dhe e merr me vete skllaven e re. Edhe Fedais i pëlqen shumë kjo vajzë e re dhe i vënë emrin Xhanan. Në këtë pjesë të romanit Rakim Efendi ka arritur nga varfëria në një pozicion të mirë shoqëror., por ai nuk mjaftohet me kaq, por i vë qëllim vetes të edukojë dhe arsimojë Xhananin. Ai së bashku me dadon Fedaji përpiqen të edukojnë Xhananin e cila ishte e pa edukuar dhe arsimuar.

Në skenë futet edhe një familje e tretë shumë e ndryshme nga dy familjet e para. Kjo është një familje angleze. Kjo familje përbëhet nga z. Ziklas, gruaja e tij dhe dy vajzat Xhejn dhe Margaret. Kjo është një familje shumë e pasur që jeton në Stamboll. Duke qenë shumë të pasur ata nuk kishin nevojë të punonin, por e kalonin kohën sipas dëshirës së tyre.

Rakim Efendi punësohet nga kjo familje për t'u mësuar dy vajzave turqisht. Në të njëjtën kohë Rakim Efendi kishte filluar t'i mësonte turqisht edhe Xhananit. Qëllimi ishte që t'i vinte këto dy vajza në garë me Xhananin.

Duke dhënë mësim private Rakimi Efendi edhe shton të ardhurat e tij edhe fiton një reputacion më të madh. Në të njëjtën kohë ai njihet edhe me mënyrën Evropiane (allafrënga) të jetuarit. Gjatë mesimdhënies në këtë shtëpi Rakim Efendi njihet edhe me Felatun Beun i cili ishte një nga të njohurit e familjes angleze dhe i vizitonte shpesh ata. Ngjarjet në roman tregojnë tri botëkuptime të ndryshme të kohës nëpërmjet tri familjeve me mentalitet dhe tradita të ndryshme. Gjatë qëndrimit në shtëpinë e familjes angleze bashkohen tri botëkuptime të ndryshme. Familja angleze Ziklas, që jeton me stilin perëndimor, Felatun Beu i cili ka mbetur i dyzuar mes dy stileve të jetës, asaj perëndimore dhe asaj lindore

dhe Rakim Efendi i cili njihet me stilin e jetesës perëndimore, por që merr gjërat më të mira të saj dhe i vë në përdorim në mënyrën lindore të jetës së tij.

Me fillimin e mësimit, nga vajzat angleze nga një anë dhe nga Xhanani nga ana tjetër fillon edhe gara se kush do mësojë më shpejt. Në të njëjtën kohë Rakim Efendi njihet më nga afër me familjen Ziklas dhe vajzat e saj., por ndryshe nga vajzat angleze që mësojnë vetëm turqisht Xhanani mëson edhe si të mbajë një shtëpi dhe gjëra të tjera të nevojshme. Rakim Efendi me anë të mikes së tij madamë Jozefina i mëson Xhananit piano. Xhanani merr edhe mësimë frëngjishteje. Gjatë këtyre mësimeve Rakim Efendi afrohet me madamë Jozefinën. Lidhja e tyre nuk ishte sipërfaqësore dhe për më tepër që të dy nuk dëshironin të bëhej e ditur kjo gjë pasi i prishte punë.

Gjatë kësaj kohe Fedajia fillon t'i kërkojë Rakim Efendit që të marr në konsideratë martesën me Xhananin e cila sa vinte dhe bëhej më e bukur dhe e edukuar. Pak nga pak edhe Rakim Efendi fillon të mendojë seriozisht për këtë gjë.

Nga ana tjetër Felatun Beu me sjelljet e tij vihet gjithmonë në pozita qesharake para familjes Ziklas. Me përpjekjet e tij për të vënë në pozitë të vështirë Rakim Efendin ai përfundon që të tregojë paaftësinë dhe injorancën e tij edhe pse hiqej si i emancipuar dhe i ditur. Përveç kësaj Felatun Beu fillon të ngacmojë kuzhinieren franceze të familjes Ziklas. Kjo e bën të bëhet i padëshirueshëm nga familja Ziklas. Edhe pse përpiqet shumë ai nuk arrin të pranohet në familjen Ziklas dhe përjashtohet nga ata. I dëshpëruar ai fillon t'i shpenzoj paratë e familjes me femra të huaja duke u munduar të dukej sa më modern. Ai jepet sidomos pas një femre me nam jo të mirë të quajtur Polin. Përveç kësaj ai fillon të poshtërojë femrat dhe kulturën Osmane. Në fakt ai nuk ka edhe shumë faj kur vjen fjala për xharijet. Gratë që bliheshin si skllave nga tregtarët dhe përdorshin në shtëpitë e të pasurve për të gjitha punët e shtëpisë duke përfshirë edhe kënaqësitë e pronarëve të tyre.

Motra e Felatun Beut, Mihribani edhe pse nuk ka një rol në roman tregohet se martohet me një ushtarak dhe pasi merr pjesën që i takon nga pasuria e babait që i vdes jeton një jetë të qetë familjare si zonjë shtëpie.

Familja Ziklas fillon e miqësohet gjithmonë e më shumë me Rakim Efendin. Sidomos vajzat janë shumë të dhëna pas tij. Kjo miqësi shtohet edhe më shumë kur një pasdite pas shëtitjes së zakonshme familja Ziklas shkon për vizitë në shtëpinë e Rakim Efendit. Tema kryesore e bisedës gjatë vizitës është Xhanani. Familja angleze habit me bukurinë dhe kulturën e Xhananit, por më tepër habiten me vlerën që i jep familja asaj duke e edukuar. Kjo ishte diçka që nuk konceptohej dot nga anglezët.

Gjatë këtij takimi bie në sy edhe xhelozia që përfshin Xhejnin në lidhje me dashamirësinë që tregonte Rakim Efendi ndaj Xhananit. Ajo e kupton që nuk ka shumë shpresa përballë bukurisë së Xhananit. Në fakt të njëjtën xhelozie ndjen edhe Xhananin ndaj vajzave angleze që sillëshin kaq lirshëm me Rakim Efendin.

Pak ditë pas vizitës Xhejni sëmuret rëndë, por asnjëri nuk arrin të japë një diagnozë të saktë në lidhje me sëmundjen. Pas shumë përpjekjesh doktori i familjes kur sheh sjelljen e Xhejnit pranë Rakim Efendit deklaron që sëmundja e vajzës është “ rënia në dashuri”. Ndërsa mjekimi i vetëm ishte martesa e saj me Rakim Efendin.



Familja Ziklas vihet në një pozitë shumë të vështirë. Nga një anë dëshira për të shëruar vajzën. Nga ana tjetër paragjykimi që do të kishin nga fisi dhe miqtë nëse do ta martonin vajzën me një turk. Për më tepër që ai ishte mësuesi i vajzës.

Por frika e humbjes së vajzës që dergjej e sëmurë i detyron prindërit e Xhejnit t'i kërkojnë Rakim Efendit të martohet me të. Së bashku me këtë kërkesë ata i ofrojnë edhe gjysmën e pasurisë për ta bërë më ndjellëse kërkesën e martesës.

Rakim Efendi gjendet në një pozitë shumë të vështirë., por ai nuk toleron nga principet e tij. Dashuria që kishte për Xhananin, edhe pse ajo ishte ende xharije, e bën që ta refuzojë këtë ofertë. Me këtë refuzim ai refuzon njëkohësisht edhe stilin perëndimor të jetesës dhe një pasuri të madhe. Megjithatë, për shkak të respektit që kishte për familjen Ziklas, ai premtun që do bëjë sa të ketë mundësi për të shëruar Xhejnin.

Për këtë arsye ai pranon edhe të bëj sikur është i dashuri i Xhejnit për ta shëruar atë., por Xhejni e kupton lojën. Ajo nuk mund ta pranonte që dashuria e saj të ndërhynte në mes të dashurisë së sinqertë që kishte Rakim Efendi me Xhananin.

Rakim Efendi habitet me sjelljen e Xhejnit kur e kupton që ai po luante lojën që ta shëronin. Ai beson se ajo ka mësuar nga librat të filozofisë lindore që ka lexuar. Ai ndihet i lumtur që mësimet e tij kanë dhënë frytet që priste.

Nga ana tjetër Felatun Beu shkon nga dështimi në zhgënjim. Me jetën e dhënë pas qejfeve ai shpenzon një pasuri shumë të madhe dhe mbetet trokë. E dashura e tij, Polini, kur sheh që mbetet pa pasuri, e braktis. Motra e tij nuk e pranon në shtëpi. Vetëm një mik i vjetër i familjes pranon ta ndihmojë duke i gjetur një punë në Algjeri.

I dëshpëruar dhe i penduar për jetën e bërë ai hipën në një anije ku ndodhej edhe Margareti, motra e Xhejnit, e cila shkonte në Aleksandri. Rakim Efendi kishte ardhur të përshëndeste Margaretin si mik i familjes që ishte. Margaret i shpreh dashurinë që kishte Rakim Efendit duke i thënë që i kishte fshehur ndjenjat e saja për hir të dashurisë që kishte motra e saj Xhejn ndaj tij. Për më tepër që ajo i kishte pranuar të vërtetat duke qenë se ishte më e pjekur dhe më e vendosur se motra e saj.

Gjatë kësaj kohe Xhejni shërohet nga “sëmundja e dashurisë” madje pranon edhe të martohet më një kushëri të largët që jetonte në Izmir. Në dasëm familja fton edhe Rakim Efendin. Në të njëjtën kohë edhe Margareti fejohej me një kushëri të saj in nga Halepi. Pas dasmës Rakim Efendi mëson se Xhanani ishte shtatzënë. Gjashtë muaj më pas ajo lind një djalë dhe nga e dashura e Rakim Efendit, ngjitet në pozitën e zonjës së shtëpisë.

#### **4.1.2. Romanet me tematikë historike**

Romanet me temë nga historia ndonëse nuk janë të shumtë në fillimet e letërsisë turke dalin në skenë që në fillimet e saj. Në periudhën e parë të letërsisë së Tanzimatit kemi dy romane me temë nga historia. Jeniçerët i Ahmet Mid'hat Efendit dhe Xhezmi i shkrimtarit Namik Kemalit. Ndonëse të dy romanet janë me tematikë nga historia ato kanë një përqsje të ndryshme. Në romanin Jeniçerët goditet një e keqe që e kishte prekur shoqërinë turke të kohës. Jeniçerët ishin

kthyer në një kangrenë e cila po e grryente nga brenda shoqërinë turke. Ndërsa në romanin Xhezmi kemi historinë e një heroi që lufton për miqësinë dhe për atdhedashurinë.

### **Jeniçerët (1874)**

Romani Jeniçerët i shkrimtarit Ahmet Midhat Efendi është romani i parë historik në letërsinë turke.<sup>67</sup> Ky është romani i vetëm i Ahmet Midhatit i botuar në serinë e librave Letaif-i Rivayat. Në këtë roman tregohet jeta e ushtarëve jeniçerë në fundin e shekullit 18 dhe fillimit të shekullit 19, gjatë periudhës kur në fron ishin Sulltan Abdylhamiti I dhe Selimi III. Ky roman ka një vlerë të veçantë për sa i përket paraqitjes së shoqërisë dhe mentalitetit të kohës.

Osman Çorbaxhiu<sup>68</sup> ishte djali i Sejfulla Agës, një prej Agallarëve<sup>69</sup> më me emër në repartin e Jeniçerëve. Pas vdekjes së babait ai merr pozicionin e tij në ushtri. Atij nuk i pëlqen të qëndrojë në këmbësori dhe kalon në repartin e topçinjve duke u bërë një artiljer i famshëm. Në të njëjtën kohë ai martohet me Aishen, vajzën e Hysen Çorbaxhiut, një komandanti tjetër të famshëm të Jeniçerëve. Edhe pse martohet me dashuri të madhe ata për disa vite nuk arrijnë të kenë fëmijë. Osmani mërzohej që nuk po kishin fëmijë, por e donte shumë gruan e tij dhe nuk e jepte veten, por tregohet i dashur ndaj Aishes. Pas pesë vitesh Osmani për shkak të detyrës nis të bashkojë me ushtrinë e Sulltanit në një fushatë në Ballkan.

Pas largimit nga Stambolli, Osmani merr pjesë në betejat të ndryshme duke treguar trimëri në fushën e betejës, por në të njëjtën kohë Jeniçerët, pjesëtar i të cilëve ishte edhe Osmani bëjnë shumë vjedhje dhe trazira në zonat ku kalojnë. 11 muaj pas largimit nga Stambolli Osmanit i vjen një letër ku i thuhet se gruaja e tij e dashur ka lindur një djalë. Osmani edhe pse gëzohet nga lajmi fillon të dyshojë se gruaja e tij e ka tradhtuar pasi sipas llogarive të bëra Aishja duhet të kishte mbetur shtatzënë gjatë kohës që ai ishte larguar nga Stambolli, por në fakt i gjithë problemi qëndron në faktin që në letërën e shkruar nuk është vënë data kur është nisur letra. I verbuar nga xhelozia Osmani vendos të kthehet në Stamboll dhe të largohet nga fushata ushtarake ku merrte pjesë. Ai merr me vete edhe mikun e tij më të mirë Hasan Pehlivanin.

Gjatë rrugës ai i tregon Hasanit për çfarë ka ndodhur dhe për planin e tij. Ai ka vendosur që ta vrasë gruan e tij e cila sipas mendjes së tij e ka tradhëtuar, por duke qenë se e donte shumë gruan e tij nuk mund ta vriste vetë. Për këtë arsye i kërkon Hasanit që ta vrasë. Hasani, miku i tij më i mirë në fillim mundohet t'ia mbushë mendjen që të mos e bëjë një gjë të tillë, por kur e sheh që Osmani është i vendosur nuk ia prish dhe pranon ta vrasë.

Kur arrijnë në Stamboll ata shkojnë në shtëpinë e Osmanit. Sipas planit Osmani sillet ftohtë ndaj Aishes. Aishja kujton se kjo është për shkak të lodhjes nga lufta dhe rruga e gjatë. Osmani i thotë gruas që do shkonte deri në Kadikoj për të çuar një amanet që i ka dhënë një shoku i tij i luftës. Për këtë arsye e lë nën shoqërinë e Hasanit dhe largohet. Në fillim Aishja nuk e kupton arsyen e sjelljes

<sup>67</sup> Ahmet Hamdi Tanpınar, 19. Asır Türk Edebiyatı Tarihi, f. 286

<sup>68</sup> Gradë ushtarake në perandorinë Osmane

<sup>69</sup> Aga këtu përdoret me kuptimin komandant

së Osmanit në këtë mënyrë, por kur Hasani e sjell në një lëndinë të shkretë ajo kupton gjithçka.

Ajo i lutet Hasanit që t'ia shpjegojë arsyen pse burri që ajo dashuron kishte vendosur ta vriste. Hasani i tregon të vërtetën në lidhje me dyshimin që kishte për tradhtinë e saj. Aishja e kupton dhe në fakt i jep të drejtë pasi edhe ajo ashtu do mendonte po t'i ndodhte e njëjta gjë si i kishte ndodhur Osmanit. Ajo i shpjegon Hasanit si ishte e vërteta. Hasani i beson atyre që thotë Aishja. Ai i bën një propozim Aishes. Hasani i mahnitur nga bukuria e Aishes i thotë se nëse pranon të martohet me të ai do t'ia kursente jetën. Kushti tjetër i Hasanit që t'ia kursente jetën Aishes ishte që të braktiste djalin e saj. Pa asnjë mundësi tjetër për të jetuar, Aishja pranon., por para se ta braktisë djalin ajo i bën djalit të vogël një shenjë me thikë në kurriz.

Pas shumë vitesh shohim një djalë të bukur dhe të fuqishëm që punonte si varkëtarë mes Stambollit dhe Yskydarit. Ai njëkohësisht ishte edhe pjestarë i reparteve të jeniçerëve. Ky djalë sympatrembur dhe i fort quhej Xhivelek Hysni. Xhivelek Hysniu ishte djali i Aishes me Osman Çorbaxhiun. Atë e kishte gjetur një njeri i mirë i cili e kishte rritur si djalin e tij. Hasan Pehlivani ishte martuar me Aishen dhe kishin një vajzë me emrin Shahap.

Duke përfituar që ishte një jeniçer, Xhivelek Hysniu ishte kthyer në një njeri që tallte njerëzit dhe sillej ashpër me ata që hipnin në varkë., por njerëzit të trembur ngaqë ishte jeniçer nuk nxirrnin zë. Fundja komandantë të jeniçerëve silleshin edhe më keq me popullin. Ata u merrnin haraç tregtarëve, kërkonin privilegje nga nëpunësit e shtetit dhe nëse u kundërviheshe nuk e kishin problem të vrisnin.

Një natë, kur po bëhej gati të mbyllte varkën e tij në mol i afrohen një nënë me vajzën e saj dhe i kërkojnë të shkojnë në Yskydar. Xhivelek Hysniu pranon edhe pse po binte nata. Gjatë vozitjes për t'ia kaluar në anën tjetër të ngushticës Xhivelek Hysniu fillon bisedën me gruan duke e pyetur pse kishte mbetur kaq vonë për t'u kthyer në shtëpi. Ajo i tregon se kishin dalë për të parë një nuse të re, por ishin vonuar duke biseduar dhe nuk e kishin vënë re sa vonë ishte bërë. Kjo grua që po fliste ishte Aishja, nëna e Xhivelek Hysniut. Ndërsa vajza e re pranë saj ishte gjysmë motra e tij, vajza e Aishes dhe Hasan Pehlivanit.

Xhivelek Hysniu nuk di asgjë nga këto gjëra. Ai pasi e shikon bukurinë e Shahapit në fillim me shaka, por pastaj seriozisht i kërkon dorën për martesë Shahapit. Aishja, nëna e Shahapit, pranon vetëm e vetëm që ta heqë qafe këtë djalë që nuk i rrinte goja rahat. Xhivelek Hysniu i jep një byzylyk argjendi si shenjë të fejesës dhe i përcjell deri në shtëpi dy gratë.

Të nesërmen Xhivelek Hysniu shkon në mejhanen Apostol në lagjen Tophane, vendin ku mbledheshin jeniçerët. Në këtë mejhane ishim mbledhur shumë agallarë të jeniçerëve dhe shumë cuba. Një pjesë e madhe e jeniçerëve gjatë kohës që nuk luftonin për të përfituar më shumë para vinin gjoba dhe bënë presione ndaj tregtarëve duke përfituar nga forca që kishin. Xhivelek Hysniu gjatë qëndrimit në mejhane përplasat me fjalë me Xhelat Hasanin dhe Mustafa Gjakatarin. Xhelat Hasani ishte burri i Aishes i cili më parë quhej Hasan Pehlivani., por pas shumë bëmave dhe vrasjeve që kishte bërë kishte marrë llagapin Xhelat. Xhelat Hasani i

vjen keq për djalin dhe e ndalon përplasjen mes Mustafa Gjakatarit dhe Xhivlek Hysniut.

Ai e merr pranë vetes Xhivlek Hysniun dhe fillojnë të bisedojnë. Xhivlek Hysniu e pyet pse jeniçerët aty ishin shumë të nevikosur dhe të ngrysur. Xhelat Hasani i thotë se Sulltani kishte vendosur të krijonte një ushtri tjetër që do të zëvendësonte jeniçerët.<sup>70</sup> Jeniçerët ishin ndarë në dy grupe. Një grup jeniçerësh që ishin besnikë ndaj shtetit dhe Sulltanit ishin pro këtij vendimi ndërsa një grup tjetër dëshironte të vazhdonin me mënyrën e vjetër dhe nuk donin të disiplinoheshin dhe të futeshin nën komandën e të tjerëve. Xhelat Hasani i thotë që dy grupet kanë vendosur të përballen nesër me njëri-tjetrin në Okmejdanë. Xhivlek Hysniu vendos të bashkohet me grupin e Xhelat Hasanit. Të nesërmen në shesh plas një sherr i vërtetë ku nxirren armët dhe vriten e plagosen shumë veta. Xhivlek Hysniu pas trimërive të mëdha që bën në sheshin e sherrit plagoset dhe Xhelat Hasani e tërheq nga sheshi duke e çuar në shtëpinë e tij. Lufta në shesh vazhdon gjatë dhe derdhet shumë gjak., por përplasje mbaron pa asnjë fitues.

Pas përplashes Xhelat Hasani së bashku me Osman Çorbaxhiun, mikun e tij të vjetër, vjen në shtëpi për të mësuar për gjendjen e Xhivlek Hysniut., por gjendja e Xhivlek Hysniut po përkeqësohet. Gjatë ndërhyrjes kirurgjikale që i bëhet Hysniut, Xhelat Hasani sheh shenjën që i kishte ai në shpinë. Ai e kupton që ai është djali i Osmanit. Në këtë çast hyn në dhomë Osman Çorbaxhiu i cili donte të shihte këtë djalë trim që ja kishte mburrur Xhelat Hasani. Xhelat Hasani i tregon Osmanit se ky djalë trim në fakt ishte djali i tij. Në këtë çast Aishja, e cila po i shihte nga pas perdes futet në dhomë dhe i bërtet Osmanit duke i treguar se ai ishte shkaktari i kësaj tragjedie me gabimin që bëri vite më parë duke mos i besuar gruas së tij. Ajo me këtë rast zbraz edhe gjithë dufin që kishte ndaj gjithë jeniçerëve. Pak më vonë Xhivlek Hysniu vdes. Shahapi çmendet kur i thonë se i fejuari i saj ka vdekur, por nuk e mëson se ai në të njëjtën kohë ishte vëllai i saj nga nëna.

### **Xhezmi (1880)**

Romani Xhezmi, është romani i dytë dhe i fundit i shkrimtarit Namik Kemal. Namik Kemali e fillon shkrimin e romanit kur ishte me detyrë në Midilli në vitin 1877. Pasioni që kishte autori për historinë dhe personazhet historike të shtetit Osman paraqitet këtu. Në këtë roman flitet për luftën mes perandorisë Osmane dhe asaj Iraniane në shekullin e XVI. Xhezmiu në të njëjtën kohë është edhe një personazh historik i vërtetë që ka ekzistuar. Namik Kemali kishte menduar të vazhdonte me një vëllim të dytë, por që fatkeqësisht nuk mundi ta shkruante.

Ngjarjet fillojnë në kohën kur Sadrazam (Kryeministër) ishte Sokollu Mehmet Pasha, një nga kryeministrat më të famshëm në perandorinë Osmane. Xhezmiu është një kalorës shumë i mirë. Për shkak të kësaj dhuntie ai njihet me Ahmet Pashën, një komandant i famshëm i ushtrisë Osmane i cili po shkonte të luftonte me Safevijtë (Iranianët). Gjatë një darke që organizon Ahmet Pasha, Xhezmiu përveç aftësive të tija në hipizëm shpalos talentin edhe në poezi. Për këtë arsye ai

---

<sup>70</sup> Bëhet fjalë për Sulltan Selimin e III i cili pas problemeve që kishte pasur me mosbindjen e jeniçerëve në fushën e betejës vendos të krijojë Nizam-i Xhediye (Ushtrinë e re) e cila do t'i zëvendësonte jeniçerët dhe do të krijonte një ushtri moderne që të mund t'u bënte ballë ushtrive evropiane.

takohet me Nevin. Një nga poetët më të mëdhenj të shekullit të XVI në Perandorinë Osmane.

Në vitin 1570 fillon lufta mes Osmanëve dhe Safevijëve (Iranianëve) dhe një ushtri niset drejt kufirit Iranian. Xhezmiu del vullnetar të marr pjesë në këtë fushatë. Gjatë kësaj fushate Xhezmiu shfaq një trimëri të rrallë dhe me veprimet që bën bie në sy. Madje gjatë fushatës ndihmon nga mbyjtja në lumë një ushtar iranian me emrin Pertev. Për këtë arsye ai bëhet mik i ngushtë me Pertevin që ishte një nga ushtarët më trima të ushtrisë iraniane. Në një rast tjetër ai njihet me Adil Girain. Adil Girai ishte vëllai i Kaganit (Mbretit) të Tatarëve të Krimeas. Ai kishte ardhur me ushtarët e tij për të mbështetur ushtrinë Osmane kundër Safevijve pasi Tatarët ishin vasal të perandorisë Osmane. Me trimëritë që tregon gjatë betejave fiton respektin e Adil Girait.

Në një nga betejat e zhvilluara Adil Girai së bashku me vëllanë e tij Gazi Girai kapen rob nga Safevijtë për shkak të një tradhtie. Hamza Mirza, djali i Shahut të Iranit, pasi i kap këta dy komandantë të famshëm të ushtrisë Osmane i dërgon në kryeqytetin Iranian për të fituar famë dhe prestigj. Qëllimi i tij ishte të fitonte pëlqimin e popullit që më pas ta përdorte për të ardhur në pushtet. Pasi i sjellin në kryeqytet, Adil Girai dhe Gazi Girai mbahen në dy burgje të ndryshme. Gazi Girai futet në një burg ishull të quajtur “Burgu Kahkaha” ku nuk kishte asnjë mënyrë për t’u arratisur ose për të komunikuar. Ndërsa Adil Girai burgoset në burgun e pallatit perandorak.

Arsyeja pse Adil Girai mbahet në burgun perandorak dhe jo në burgun tjetër të sigurisë së lartë është sepse gruaja e perandorit Iranian, Shehrijari, bie në dashuri më Adilin që në çastin e parë që e sheh dhe nuk do që Gazi Girai ta mësojë dhe të shkaktojë probleme. Shehrijari, është një grua intrigante e cila mundohet të kontrollojë çdo gjë në pallatin perandorak. Lakmia e saj për pushtet nuk ka kufi. Shehrijari thur lloj lloj intrigash për t’u takuar me Adilin. Më në fund ja arrin qëllimit duke u justifikuar që do të flasë me Adil Girain që t’i mbush mendjen atij për ta hipur në fron në Krimea në vend të vëllait tij. Kështu që Tatarët jo vetëm që nuk do ndihmonin Osmanët në luftë kundër tyre, por do ktheheshin në aleatë dhe do ta sulmonin shtetin Osman nga veriu duke u krijuar vështirësi të mëdha.

Në kohën që Adil Girai ishte i burgosur në shtetin Iranian ishte në fron një Shah i verbër. Djali i tij, Hamza Mirza interesohej vetëm për luftërat. Drejtimi i pallatit dhe qeverisja e shtetit ishte në duart e Shehrijarit dhe motrës së tij Perihanit. Që të dyja ishin në luftë të fshehtë për pushtet., por ndryshe nga Shehrijari, e cila ishte një intrigante dhe smirëzezë, Perihani përveç se ishte një femër shumë e bukur kishte edhe një zemër të pastër.

Perihani kërkon që të marr edhe ajo pjesë në takimin me Adilin për të diskutuar në lidhje me marrëveshjen që duhet të bënin., por Shehrijari duke pasur frikë se Adili mund të bjerë në dashuri me Perihanin mundohet ta ndalojë takimin e tyre. Në fillim ajo ja arrin qëllimit dhe gjatë takimit të parë që bën me Adilin i shpreh dashurinë. Në të njëjtën kohë ajo ia prezanton Perihanin shumë më ndryshe nga se është me të vërtetë.

Adili bën sikur luan lojën e Shehrijarit me qëllimin që të dalë nga burgu bashkë me vëllanë Gazin dhe të kthehet në vendin e tij. Perihani gjen një mënyrë për të takuar Adilin sepse dyshon në qëllimet e Shehrijarit. Që në takimin e parë

Perihani bie në dashuri me Adilin ashtu si kishte rënë edhe Shehrijari. Ndërsa Adili edhe pse nuk ia sheh fytyrën Perihanit në takimin e parë, e kupton që ajo nuk ishte ashtu si e kishte përshkruar Shehrijari dhe se kishte një zemër të madhe.

Dashuria e pastër e Perihanit dhe dashuria me interes e Shehrijarit i përplas të dy gratë me njëra tjetrën. Shehrijari e kupton që diçka nuk shkon tek sjellja e Adilit dhe fillon ta ruajë. Spiunët e saj i tregojnë që Perihani takohet fshehtas me Adilin dhe gjatë takimeve ata i shprehin dashurinë njëri-tjetrit. Nga xhelozia Shehrijari nuk di ç'të bëjë. Pastaj kur e sheh që nuk ka asnjë shpresë që dashuria e saj të marr përgjigje pozitive nga Adili vendos t'i vrasë që të dy. Për këtë arsye ajo thur një plan.

Në këtë kohe Xhezmiu mëson se miku i tij Adili është kapur rob dhe niset për ta shpëtuar. Pasi kalon disa peripeci ai arrin të futet në qelinë e Adilit. Së bashku bëjnë plane që të arratisen dhe pastaj të gjejnë një mënyrë që të shkatërrojnë shteti Iranian dhe në vend të tij të krijojnë një shtet tjetër me Adilin në krye., por gjatë kësaj kohe Shehrijari e ka përgatitur planin. Ajo e vë në zbatim, por ngaqë nuk e kishte përgatitur me kujdes ajo dështon dhe vetë mbetet e vrarë. Perihani shkon të shpëtojë të dashurin e saj, por tashmë ata janë të rrethuar nga ushtarët e Shehrijarit. Perihani me Adilin luftojnë me trimëri duke vrarë shumë ushtarë, por në fund mposhten të dy dhe vdesin në krahët e njëri-tjetrit.

Edhe pse vdesin dashuria e tyre nuk shuhet. Xhezmiu i cili arrin të arratiset nga burgu i varros së bashku dy të dashuruarit. Pastaj duke u maskuar kthehet i trishtuar në vendin e tij.

#### **4.1.3. Romanet aventurore**

Romanet me aventura janë një gjini sa e re ashtu edhe e prekur në letërsinë turke. Në kaçitullin e parë kemi disa tregime si “Kerem dhe Asllë” ose “Veziri i trishtuar” të cilët kanë tipare të njëjta me këto romane. Shkrimtari i vetëm i këtyre romaneve është Ahmet Mid’hat Efendi. Megjithatë këto romane i ngjasojnë më shumë romaneve aventureske evropiane sesa tregimeve të mësipërme.

#### **Hasan Mellah (1874)**

Ky është një nga romanet e parë të shkruar nga shkrimtari Ahmet Mid’hat Efendi dhe është një roman aventuresk i ndikuar nga romani “Konti i Monte Kristos” i shkrimtarit francez Aleksandër Duma Babai.

Hasan Mellah është djali i Sejdi Osmanit, vëllait të Hamdanit, një nga vezirëve të Sulltanëve të Marokut. Sejdi Osman ishte ortak në një shoqëri tregtare me Pavlosun nga Kartaxha<sup>71</sup>. Kjo ishte një kompani shumë e madhe që merrej me tregëti. Kompania kishte pesë ortakë dhe të gjithë përdornin firmën Pavlos. Ndryshimi mes firmave ishin yjet që i vendosnin pas firmës. Firma me një yll ishte e Pavlos të vërtetë që ishte edhe i vetmi që i njihte katër ortakët e tjerë. Sejdi Osmani përdorte firmën me tri yje ndërsa atë me pesë yje e përdorte një tregtarë shumë i zgjuar nga Roma, por edhe aq dinak dhe hileqar i quajtur Domeniko Badja.

---

<sup>71</sup> Qytet në bregdetin lindor të Spanjës

Në Marok shpërthen një kryengritje e sponsorizuar nga Badja. Gjatë trazirave vritet si Hamdani ashtu edhe Sejdi Osmani. Hasani, i cili kishte mbaruar shkollën e marinës në Kartagjenë, arrin të shpëtojë në çastin e fundit nga kryengritësit dhe hipën në anijen e dy piratëve të quajtur Zerni dhe Pietro. Ai arrin t'i bindë piratët që të mos e vrasin. Për shkak të aftësive të tij në det bëhet i famshëm me emrin Hasan Mellah (Detari). Në anije Hasani bëhet mik me Alonson. Ai ishte ish shërbëtori xhaxhait të tij Hamdan. Në anije ndodhej edhe një djalë nga Korsika që e kishte emrin Ilia. Ai kishte vrarë babain, nënën dhe motrën pasi babai i tij i kishte ofruar si dhurata ato për të fituar postin e guvernatorit të Korsikës.

Anija e tyre shkon në qytetin Kadiks<sup>72</sup>. Në këtë qytet port jetonte një Spanjoll i pasur i quajtur Senjor Alfonso. Ai kishte një vajzë shumë të bukur të quajtur Zhizel. Domeniko Badja me emrin Pavlos vjen në Kadiks dhe kërkon të martohet me Zhizel. Senjor Alfonso tundohet nga pasuria e pamatë e Pavlos, por Zhizel nuk pranon pasi nuk i pëlqen. Ndërsa Badja nuk heq dorë nga qëllimi i tij. Piratët e ardhur në port vendosin të grabisin shtëpinë e Senjor Alfonsos. Hasani është i detyruar të shkojë.

Gjatë natës ai futet në shtëpi, por dritarja nga ku ai hyn është e dhomës së Zhizelit. Me ta parë Zhizeli e njeh sepse ajo kishte një album me studentët e akademisë detare të Kartagjenës ku ishte edhe fotoja e Hasanit. Ajo e dashuronte Hasanin edhe pse nuk e kishte parë asnjëherë në jetën e saj. Edhe Hasani bie në dashuri me shikim të parë.

Tentativa për grabitje zbulohet dhe të gjithë piratët që merrnin pjesë në grabitje përveç Hasanit arrestohen. Zhizela e fsheh Hasanin së bashku me dadon e saj Maria. Zhizele e kishte humbur që në moshë të re nënën dhe ishte rritur nga murgeshat. Nëna e saj e kishte tradhtuar babain e saj kur ai ishte në një udhëtim larg Kadiksit. Asaj i lind një djalë nga kjo tradhti., por një ditë ajo mëson se i dashuri e tradhtonte me një grua tjetër dhe nga xhelozia e vret të dashurin. Kur kthehet nga udhëtimi Alfonso, babai i Zhizelit vendos të vrasë gruan tradhtare dhe djalin e saj. Gruaja vritet, por djali shpëton i plagosur. Ky djalë ishte Alonso.

Domeniko Badja kthehet përsëri në qytet duke e ripërtërirë kërkesën e tij për martesë me Zhizelin., por ajo përsëri e refuzon. Në këtë kohë mësohet se Hasani po fshihej në shtëpinë e Alfonsos si një murg. Hasani bie dakort të arratiset me Zhizelin., por Badja e rrëmben Zhizelin dhe përhap fjalë se e kishte rrëmbyer Hasani.

Hasani tani fillon të ndjekë Badjon që ka rrëmbyer Zhizelin. Hasani blen një anije të quajtur "Pranvera e dashurisë". Ai shkon në Korsikë. Atje njihet me gruan e Ilias dhe dëgjon historinë e saj. Gruaja i kërkon ta ndihmojë të gjejë burrin dhe ai e merr me vete në anije. Nga Korsika shkon në Marsejë dhe prej andej në Paris. Në Paris mëson se Badja jetonte atje duke u hequr si një tregtarë Tunizjan me emrin Ali. Edhe pse i afrohet shumë nuk arrin ta kap dhe të shpëtojë Zhizelin. Badjo largohet dhe Hasani detyrohet përsëri të niset në kërkim. Gjatë udhëtimit gruaja e Ilias gënjehet nga timonieri Trilo dhe fillon një lidhje me të. Më vonë ajo e gjen Ilian në një manastir. Ilia nuk e njeh në fillim., por më vonë Alonso e merr në anije Ilian. Gruaja e Ilias kishte mbetur shtatzënë me Trilon dhe nga ndjenja e fajit hidhet në det duke u vetëvuarë. Ndërsa Trilo arratiset.

---

<sup>72</sup> Qytet në bregdetin lindor të Spanjës

Gjatë udhëtimit anija e Hasanit sheh një anije piratësh që po përpiquej të grabiste një anije mallrash. Hasani e fundos anijen e piratëve me një të shtënë topi. Piratët që shpëtojnë merren në anije. Një nga ata ishte edhe Pietro. Të gjithë piratët përveç Pietros betohen të heqin dorë nga pirateria. Pietro që nuk betohet vritet. Duke ndjekur Badjan anija arrin në Egjipt ku lufta për pushtet mes fisnikëve kishte arritur kulmin.

Murat Beu ishte guvernatori i Egjiptit, por ishte në një pozitë të vështirë pasi nuk dinte kujt t'i besonte. Një informacion i tregon se një nga fisnikët mbështetës të tij e tradhtonte. Ai dërgon një nga njerëzit e tij, Xhanurin, që ta vrasë. Si shpërblim do ta lejonte të zgjidhte një nga skllavet e tija., por pak pasi e nis me detyrë mëson se informacioni ishte i rremë. Atëherë ai dërgon Sarë Jakupin, një nga njerëzit e tij më të besuar që ta lajmëronte Xhanurin për anulimin e urdhërit. Edhe këtij i premton të njëjtën gjë.

Kur ata kthehen që të dy i kërkojnë t'u japë Esmanë, skllaven Çerkeze që ishte e preferuara e Murat Beut. Në fillim Murat Beu nuk do që ta japë, por më pas pranon me zemër të thyer. Tani del problemi se cili nga ata të dy do ta merrte. Me anë të një gjyqi vendoset që të bëhet një garë dhe më i afti ta fitonte vajzën. Në këtë garë merr pjesë edhe Hasani me shokët e tij. Me anë të aftësive të tij në artileri ai fiton dhe e merr vajzën.

Më pas Hasani nis drejt Stambollit. Esmaja ishte një vajzë Çerkeze e rrëmbyer nga tregtarët e skllavëve. Para se të rrëmbehej Esmaja ishte dashuruar me djalin e një Beu të quajtur Timur. Ata e dinin që nuk mund të martoheshin pasi ishin nga shtresa të ndryshme shoqërore. Kur Esmaja rrëmbehet Timur u shkon nga mbrapa tregtarëve dhe e shet veten si skllav.

Edhe pse hiqen si kushërinj ata nuk arrijnë të qëndrojnë bashkë. Esmaja shitet në Egjipt kurse Timuri, i cili tani quhet Asllan, shitet tek një familje në Stamboll. Asllani mëson të shkruaj e lexojë si edhe disa gjëra në art. Ai bën që vajza e martuar e shtëpisë të dashurohet me të. Vajza e shtëpisë kërkon të ndahet nga burri dhe Asllani përfundon në polici për shkak të kësaj gjëje., por vajza e shtëpisë deklaron që nuk është faji i tij. Kështu që Asllani lirohet dhe më pas shitet në një shtëpi tjetër.

Hasani kur vjen në Stamboll bën të mundur që dy të dashuruarit të bashkohen. Më pas vazhdon kërkimin e Zhizelës. Bdja në këtë kohë kishte kaluar në Siri. Me të marr këtë informacion Hasani me shokun e tij Alonso nisen për në Damask. Arrin të shpëtojnë Zhizelën, por Badja arratiset. Më pas Hasani kalon në Bejrut dhe prej andej dhe shkon në Kartagjenë. Më pas ia dorëzon Zhizelin babait të saj dhe pas disa kohësh martohen.

Pas martesë ata shkojnë në Marok. Atje Hasani kap dhe dënon vrasësit e babait dhe xhaxhait. Romani mbaron këtu., por për shkak të reagimit të lexuesve për mbylljen shumë të paqartë Ahmet Mid'hati detyrohet të shtojë edhe një kapitull.

Në këtë kapitull Hasani shpëton nga vdekja një djalë të quajtur Numan. Më pas ai dëgjon historinë e tij. Numani ishte dashuruar me Inshirahun, një skllave në haremin e Zylfikar Beun, një njeri me pushtet në Algjeri. Në fillim Zylfikar Beu dhe gruaja e tij nuk e pëlqejnë këtë gjë pasi mendonin ta martonin Inshirahun me



Xhasimin, vëllain e Zylfikarit., por më pas e pranojnë martesën e Numanit me Inshirahun. Xhasimi pret rastin të hakmerret. Pas vdekjes së Zylfikarit ai me anë të dëshmitarëve të rremë bën që Numani të ndahet me Inshirahun. Për këtë arsye Numani donte të vdiste. Hasani me shokët e tij sulmojnë shtëpinë e Zylfikarit.

Në gjyqin që zhvillohet Hasani e refuzon Kadiun<sup>73</sup> e çështjes që ishte i korruptuar. Kadiu tjetër që vjen i jep të drejtë Numanit. Numani bashkohet sërisht me Inshirahun dhe së bashku me familjen largohet për në Damask. Ndërsa Alonso me shokët vazhdon të lundrojë nga një port në një tjetër nëpër Mesdhe. Ai arrin në ishullin e Maltës ku njihet me Xhulian një vajzë jetime të cilën e merr në mbrojtje. Me kalimin e kohës Alonso dashurohet me të. Në të njëjtën anije me Alonso ishte edhe Ilia i cili po digjej nga dëshira për t'u hakmarr për gruan e tij. Me ndihmën e Alonsos dhe Zernos e gjejnë Trilon dhe pasi e nxjerrin nga burgu ku ishte burgosur e marrin në anije. Për t'u treguar i drejtë Ilia e fton Trilon në duel. Gjatë duelit Trilo vritet.

Gjatë udhëtimeve një ditë ndalojnë në një port ku po qëndronte edhe Badja. Badja pasi e njeh anijen e Hasanit duke menduar se aty ishte Zhizeli futet fshehtas, por kapet para derës së dhomës së Xhulias nga Alonso. Kur kthehet në Port Alonso ja dorëzon Badjan Hasanit., por Hasani ia lë Zotit që ta dënojë Badjan për vrasjen e babait dhe të këqijat që i ka sjellë dhe e lë të lirë. Shokët e tij habiten nga kjo zemërgjerësi e Hasanit.

Pasi lirohet, Badja vazhdon të merret me punë të pista. Këtë herë bashkohet me Xhasimin, armikun e Hasanit., por gjithë intrigat e tij prishen nga Hasani. Badja detyrohet përsëri të arratiset për në Egjipt.

Tani në Egjipt është periudha e Mehmet Aliut nga Kavala. Badja fillon të bëjë intriga me Francezët. Pasi gënjen një vajzë arabe me emrin Shehame mundohet ta fusë atë deri në dhomën e gjumit të Mehmet Aliut për ta helmuar., por Mehmet Aliu i kishte vënë një spiun nga mbrapa Badjas dhe mundohet ta bëjë Shehamen të flasë. Ai i fut Badjan dhe Shehamen në një dhomë, por Shehame nuk e tradhton pronarin e saj. Mehmet Aliu për shkak të besnikërisë së Shehames e fal Badjan i cili menjëherë largohet për në Itali.

Por edhe në Itali ai vazhdon të merret me punë të pista. Atje bashkëpunon me një mafioz me emrin Karbonari. Atje ai përpiket të martohet me një Konteshë, burrin e të cilës e kishte vrarë pikërisht Karbonari. Karbonari i thotë që nuk mund të martohet me konteshën, por Badja vazhdon planin e tij. Karbonari e kap dhe e detyron të betohet që nuk do të martohet me konteshën. Badja betohet nga frika se do zbatojë urdhërat e Karbonarit, por sapo i jepet rasti arratiset.

Pas disa kohësh atë e gjejmë përsëri në Damask, por këtë herë si Ali Abasi Beu, pasardhës i dinastisë Abase. Numani, i cili gjendej në Damask, lajmëron Alonso. Në të njëjtën kohë një njeriu i Karbonarit kishte rënë në gjurmët e Badjas dhe kishte ardhur edhe ai në Damask.

Ushtarët dhe populli rrethojnë shtëpinë e Badjas. Badja arrin të shpëtojë nga ata, por kapet nga njeriu i Karbonarit. Me nxitjen edhe të Alonsos turma e masakron me thika Badjan i cili vdes i mbuluar me gjak. Numani ia pret kokën

---

<sup>73</sup> Gjykatës në perandorinë Osmane.

Badjas dhe ia dërgon Hasanit si dhuratë. Kështu që të këqinj të marrin dënimin e merituar.

### **Hysein Fellah (1876)**

Romani Hysein Fellah është një nga romanet e para të shkrimtarit Ahmet Mid'hat Efendi. Në këtë roman bëhet fjalë për femrat e një familjeje dikur të pasur e cila ishte rrënuar.

Ngjarjet fillojnë në fillimet e muajit qershor në një lagje të Stambollit. Në një natë të errët dhe me shi një nënë dhe vajza e saj gjendeshin në Gallata, në Kanllë Burç duke menduar të vetëvriteshin. Këto ishin znj. Hesna dhe vajza e saj Shehlevend, gruaja dhe vajza e Ismail Agës, komandantit të spahinjve<sup>74</sup>.

Znj. Hesna në rini të saj kishte qenë një vajzë shumë e bukur dhe nga një familje e pasur. Edhe pse e dëshironin shumë djem, një nga të cilët Bekir Efendi, ajo dashuronte Ismail Agën dhe martohet me të.

Pak pas martesë atyre u lind një vajzë të cilën e quajnë Shehlevend. E lumtur me martesën dhe vajzën, znj. Hesna jetonte si mos më mirë në vilën e saj.

Një nga pretendentët e saj, Bekir Efendi, nuk kishte hequr dorë nga pasuria dhe bukuria që kishte znj. Hesna. Ai vazhdonte t'i dërgonte mesazhe me anë të ndërmjetësve të ndryshëm që ajo të bëhej e dashura e tij., por Hesna i refuzonte këto kërkesa të shpeshta.

Pak kohë më vonë Ismail Aga dërgohet me detyrë në veri të Ballkanit. Bekir Efendi duke përfitur nga mungesa e Ismail Agës arrin të manipulojë Hurshidin, shërbëtorin e shtëpisë. Me anë të tij ai mëson për të gjithë letërkëmbimin mes Ismail Agës dhe znj. Hesna. Në një çast të përshtatshëm me një letër të rremë ai i lajmëron znj. Hesna vdekjen e Ismail Agës.

Me hapjen e lajmit të vdekjes së Ismail Agës, znj. Hesna trishtohet shumë dhe e lë pas dore drejtimin e shtëpisë. Shërbëtorët dhe ndihmësit duke përfituar nga kjo gjë fillojnë të vjedhin dhe pask pak kohe pasuria e familjes fillon të pakësohet dhe shtëpia të rrënohet. Znj. Hesna kur e kupton që s'mund të drejtonte më shtëpinë. Për të shpëtuar nga rreziku i Bekir Efendit vendos të martohet prej hallit me Safa Efendin.

Pas disa kohësh Ismail Aga kthehet nga lufta dhe kur shkon në shtëpinë e tij sheh që Hesna kishte mbetur shtatzënë nga Safa Efendi. Si znj. Hesna, si Ismail Aga pësojnë një tronditje të thellë kur e mësojnë çfarë ka ndodhur.

Ata i drejtohen gjykatës, por znj. Hesna nuk pranon të qëndrojë me asnjërin dhe ndahet me të dy. Pak kohë më vonë Ismail Aga i turpëruar vret veten.

Ndërsa znj. Hesna së bashku me Shehlevendin shkojnë tek shtëpia e Koxha Veliut, një nga shërbëtorët e tyre të vjetër. Djali i Veliut, Osmani, sillej shumë mirë me femrat që i kishin ardhur në shtëpinë e babait për shkak të respektit që kishte i ati.

---

<sup>74</sup> Repart ushtarak në ushtrinë Osmane. Ishte reparti më i fuqishëm pas Jenieçerëve.

Një ditë një nga shërbëtorët e vjetër të znj. Hesna, Hurshidi, i njëjti shërbëtor që ishte përdorur nga Bekir Efendi për të shkatërruar martesën e znj. Hesna, shkon në shtëpinë e Koxha Veliut dhe i kërkon Osmanit që t'i bindet atij dhe t'i përzërë femrat nga shtëpia e tij. Nëse do ta bënte një gjë të tillë ai do të shpërblehej me para dhe do ti gjenin një skllave të re. Osmanit i erren sytë nga urrejtja për këtë njeri mosmirënjohës ndaj pronares së vjetër dhe e godet me thikë duke e plagosur atë dhe një shërbëtor të Bekir Efendit. Për këtë plagosje ai dënohet me burgim të përjetshëm nga gjykata. Pak kohë më vonë babai i tij Koxha Veliu vdes nga hidhërimi duke i lënë nënë e bijë pa asnjë mbështetje. Edhe pse të varfra ato nuk ankohen nga gjendja e tyre., por janë të frikësuara për mospasjen e një mbështetësi.

Pa asnjë shpresë për një jetë normale, nënë e bijë, vendosin të vetëvriten. Për këtë arsye shkojnë në Kanllë Burç. Kur po bëheshin gati të hidheshin në ujërat e errëta të ngushticës së Bosforit ato dëgjojnë një zhurmë. Një djalë i rrahur dhe i therur me thika nga disa njerëz po rënkonte në një qoshe. Sulmuesit duke kujtuar se e kishin vrarë ishin larguar me shpejtësi. Djali u kërkon ndihmë. Nënë e bijë e marrin këtë djalë të ri dhe e dërgojnë në shtëpinë e tij., por e lënë në derë nuk futen brenda. Ato mbeten të vetme në errësirën e rrugës.

Për shkak të urisë vajza vendos të lypë. Në mëngjes ajo shkon para xhamisë dhe fillon të lypë me duart e saj të vogla. Para vajzës kalon Llaz<sup>75</sup> Mehmet Aliu. Ai pasi e shikon bukurinë e vajzës i propozon të bëhet xharia e tij. Duke bërë këtë ajo do shpëtonte nënën e saj nga varfëria. Ai do t'i blinte një shtëpi dhe do ti jepte një rrogë mujore të kënaqshme. Për hir të nënës Shehlevendi pranon të shesë lirinë e saj., por nënës i thotë që do të martohej me djalin e Llaz Mehmet Aliut. Edhe pse nëna në fillim del kundër pranon kur mendon që do shpëtojë nga varfëria dhe vajzës do t'i dalë një fat i mirë. Pasi merr një shtëpi të vogël dhe 500 kurush si pagesë ajo e lë vajzën të largohet.

Pas shitjes së vajzës, nëna, znj. Hesna, fillon të jetojë në shtëpinë e dhënë, por paratë i mbarojnë shpejt. Ajo shkon te Llaz Mehmeti për të kërkuar para të tjera., por ai bën sikur nuk e njeh dhe kur ajo vazhdon të këmbëngulë i thotë që është zënë me djalin dhe e ka përzënë nga shtëpia.

Znj. Hesna tani më është në varfëri ekstreme. Ajo lyp nëpër komshinjtë. Kur sheh që nuk ka shpresë vendos të vrasë veten. Fati e ndihmon sërish. Hoxha i lagjes, i cili e kishte vëzhguar nga larg, vendos ta ndihmojë. Pasi i shlyen borxhet që kishte nëpër tregtarë ai i gjen edhe një burrë i cili ishte gati ta merrte për grua., por znj. Hesna nuk pranon dhe i kërkon hoxhës që ta ndihmojë të shkojë në Egjipt ku ishte vajza e saj. Hoxha i dhimbsur e ndihmon të hip në një anije që do të shkonte në Egjipt duke i paguar biletën.

Por fatkeqësitë e gruas së moshuar nuk kanë fund. Gjatë udhëtimit anija sulmohet nga piratët të udhëhequr nga algjeriani Kurdoglu. Të gjithë pasagjerët kapen robër.

Nga ana tjetër Shehlevendi që kur zbriti në Egjipt filloi të sillej si një memece për të mbrojtur nderin e saj. Tani ajo është një skllave memece. Për herë të parë shitet tek Ahmet Beu i cili jetonte në Algjeri. Marrja e një skllaveje memece i

---

<sup>75</sup> Pseudonim që u jepet banorëve në brigjet e Detit të Zi në gadishullin e Anadollit.

interesonte Ahmet Beut sepse ai para popullit hiqej se ishte një njeri i ditur dhe i dhembshur., por në fakt ai ishte kryetari i një çete grabitësish.

Në të njëjtën kohë Ahmet Beu sjell në pallatin e tij edhe një djalë të ri si ndihmës. Ky i ri quhej Xhivelek Mustafa. Një djalë i ri që kishte kryer vrasje të shumta në Stamboll. Për t'i shpëtuar ndjekësve, ai ishte larguar për në Algjeri ku ishte futur nën shërbimin e Ahmet Beut. Ky djalë ishte djali i shpëtuar nga znj. Hesna dhe Shehlevendi atë natë të errët qershori në Stamboll., por si Mustafai, ashtu edhe Shehlevendi nuk e dinë këtë gjë. Si Ahmet Beu ashtu edhe Xhivelek Mustafai përpiqen t'ia prishin mendjen kësaj xharije të bukur dhe memece., por vajza në mënyrë të prerë i kundërshton.

Një nga kundërshtarët më të fuqishëm të Ahmet Beut dhe miqve të tij hajdutë ishte Hysein Fellahu. Për të eliminuar konkurrencën, por edhe për të parë një mundësi bashkëpunimi me Hysein Fellahun, Ahmet Beu e fton atë në një darkë për t'i propozuar bashkëpunim. Megjithatë duke qenë se nuk i kishte shumë besim, Ahmet Beu bën edhe një plan rezervë për ta vrarë Hysein Fellahun nëse ai nuk do të pranonte. Shehlevendi e paralajmëron Hysein Fellahun për vdekjen që e priste duke folur për herë të parë që nga zbritja e saj në Egjipt. Falë ndihmës së Shehlevendit Hyseini arrin të largohet nga pallati i gjallë.

Shehlevendi me ndihmën e Xhivelek Mustafait arrin ta shpëtojë Hysein Fellahun edhe dy herë të tjera nga atentatet që i bën Ahmet Beu. Hysein Fellah bie në dashuri me Shehlevendin ashtu si edhe Xhivelek Mustafa., por Shehlevendi nuk afron asnjërin nga këta duke u sjellë korrekte me të dy.

Gjatë kësaj periudhe Hysein Fellah mëson për tragjedinë e Shehlevendit. Një ditë ai duke u thënë që do nisej për një udhëtim pune në Spanjë niset fshehurazi për në Stamboll me qëllim të gjejë znj. Hesna. Me gjithë përpjekjet e bëra nuk e gjen dot znj. Hesna, por arrin të shpëtojë Omerin i cili po kalonte jetën në burg. Edhe pse del nga burgu qëllimi i vetëm i Omerit ishte të hakmerrej ndaj Bekir Efendit, shkaktarit të vetëm të gjithë fatkeqësive të znj. Hesna dhe Shehlevendit. Duke e kërkuar e gjen atë të shtruar në një çmendingë. Duke menduar që e ka gjetur dënimin e merituar Omeri largohet pa u hakmarrë. Më pas shkon dhe gjen Hurshidin, shërbëtorin e vjetër të znj. Hesna, i cili e kishte tradhtuar besimin e saj. E masakron keq me thikë dhe largohet duke e lënë në grahmat e fundit të jetës. Pasi mbaron edhe këtë punë që të dy nisen për në Algjeri.

Gjatë kësaj kohe në Algjeri kishin ndodhur zhvillime të tjera. Ahmet Beu së bashku me miqtë e tij kusarë thur një plan tjetër. Këtë herë ai synon të plaçkit pallatin e Kurdoglu. Kurdoglu ishte pirati i cili kishte plaçkitur edhe anijen me të cilën udhëtonte znj. Hesna kur po shkonte në Egjipt. Për ta bërë planin sa më të suksesshëm Ahmeti fut Xhevelek Mustafain në shtëpinë e Kurdoglu .

Shehlevendi mëson për planin që po thur Ahmet Beu. Rastësisht ajo mëson se nëna e saj ishte shërbëtoreshë në shtëpinë e Kurdollu. Me anë të Xhevelek Mustafait, i cili tashmë kishte hyrë në pallat, ajo bën një marrëveshje me Kurdollunë. Ditën e sulmit Ahmet Beu me njerëzit e tij pësojnë një disfatë të thellë dhe detyrohet të largohet. Gjatë arratisjes Ahmet Beu sheh Shehlevendin të veshur si burrë duke folur., por tani nuk ka çfarë të bëjë. Duhet të luftojë për të shpëtuar jetën e tij.

Me një goditje të vetme Shehlevendi edhe kishte shpëtuar veten nga presionet e Ahmet Beut dhe kishte fituar lirinë e nënës së saj. Pas përfundimit me sukses të planit të saj Shehlevendi së bashku me nënën dhe Xhevelek Mustafain vendoset në çifligun e Hysein Fellahut në Xhuja. Pas pak në çiflig arrin edhe Hysein Fellahu me Omerin nga Stambolli.

Tashmë, e vetmja gjë që ka mbetur është të kuptohet se ke do të zgjedhë Shehlevendi. Ajo nuk dëshiron të bëjë një zgjedhje mes këtyre tri burrave të cilët i kishte dashur në periudha të ndryshme kohore. Ajo propozon që të ishin të tri si vëllezër për të. Hysein Fellah dhe Omeri e pranojnë, por Xhevelek Mustafai jo. Sepse ai jo vetëm që ishte betuar të martohet me vajzën që e kishte shpëtuar nga vdekja atë natë të errët qershorin në Stamboll, por edhe sepse duke qëndruar pranë Shehlevendit ishte dashuruar vërtetë me të. Hysein Fellah tërhiqet pasi takon ish të dashurën e tij dhe martohet me të.

Mosvendosja e Shehlevendit për shkak të ardhjes së Omerit nga Stambolli, e shkatërron Mustafain. Pa shpresë për bashkimin me Shehlevendin, ai vetëvritet. Ajo edhe pse mban zi për Mustafain, pas tri vitesh martohet me Omerin, ashtu siç e kishte lënë amanet Mustafai.

## **4.2. Periudha e dytë e letërsisë së Tanzimatit (1880-1896)**

Periudha e dytë e letërsisë së Tanzimatit fillon pas mbylljes së parlamentit të parë turk në vitin 1878 dhe përgjithësisht pranohet që mbaron në vitet 1895-1896 në të njëjtën kohë që fillon ajo që në letërsinë turke njihet si periudha e Servet-i Fünun (1895-1901). Ashtu si periudha e parë e cila ndihkohet nga zhvillimet politike edhe kjo periudhë pëson të njëjtin fat.

Ndryshe nga periudha e parë në këtë periudhë kemi shtimin e censurës nga ana e shtetit i cili nuk toleronte më atë hapje ndaj ideve të reja dhe shprehjes lirshëm të mendimit nga pikëpamja politike. Një tipar tjetër i kësaj periudhe është kthimi i shkrimtarëve drejt gjuhës së vjetër më të ndërlikuar në krahasim me periudhën e parë. Ndonëse kanë ideale të njëjta në lidhje me shkrimin e romanit dhe edukimin e shoqërisë, ata nuk i mbahen principit të një gjuhe sa më të thjeshtë që do të sillte një numër më të madh lexuesish.

Me kalimin e kohës pak nga pak romanet i largohen idealeve të para dhe bëhen gjithmonë e më letrarë, duke anashkaluar dëshirën për të edukuar lexuesin. Në fakt në këtë periudhë lexuesi për shkak edhe të shtimit të përkthimeve të romaneve fillon të jetë më kërkues ndaj shkrimtarëve turq duke bërë të mundur ngritjen e nivelit të veprave letrare. Zhvillimet politike dhe historike nuk duket se ndikojnë shumë në preferencat e lexuesit. Lexuesi vazhdon të kërkojë intrigën në marrëdhëniet shoqërore. Megjithatë në këtë periudhë kemi edhe botimin e romanit të parë ideologjik nga Mizanxhi Murati.

### **4.2.1. Romanet me tematikë shoqërore**

Si në periudhën e parë edhe në periudhën e dytë të letërsisë së Tanzimatit tematika kryesore e prekur janë marrëdhëniet shoqërore të mbizotëruar nga

dashuria dhe xhelozia. Megjithatë kemi shtim të tematikave. Problemet sociale si prostitucioni, skllavëria, mashtrimi, i shtohen problemeve të trajtuara më parë si martesë me shkesi, ose dashuria e humbur. Goditja e fenomeneve të këqija, siç janë keqtrajtimi i femrës ose njerëzve të pambrojtur vazhdon të ruajë rëndësinë në shumicën e romaneve. Po ashtu vazhdon të ketë një rëndësi të veçantë përplasja mes qytetërimeve. Shkrimtarët vazhdojnë të kërkojnë një njeri ideal që i plotëson kushtet për të qenë një njeri i edukuar me vlerat më të mira të qytetërimit lindor duke marrë nga qytetërimi perëndimor ato vlera universale të cilat qytetërimi lindor i kishte lënë pas dore siç është dëshira për të renë dhe zhvillimin dhe prosperitetin. Në këtë periudhë dashuria fillon ta humbë rëndësinë që ka në romane dhe shpesh herë del në vend të dytë duke ja lënë vendin temave të mësipërme.

### **Ende shtatëmbëdhjetë vjeç (1881)**

Ky është një nga romanët më interesant të shkrimtarit Ahmet Mid'hat Efendi. Kjo për faktin se ai prek një temë shumë delikate për kohën e cila është jeta në një bordello dhe shpëtimi nga aty i një vajze. Me prekjen e kësaj teme shkrimtari kërkonte të prekte një fenomen shumë shqetësues në shoqërinë e kohës. Përveç kësaj ai jep edhe një panoramë të marrëdhënieve të myslimanëve dhe jo myslimanëve gjatë periudhës Osmane të shekullit të XIX. Një tipar tjetër i këtij romani është se shkrimtari pretendon se ngjarjet janë marrë nga jeta e përditëshme. Domethënë ai e konsideron si një roman realist.

Dy shokë, Ahmeti dhe Hulus Efendi, një dark shkojnë në teatrin francez pasi kishin darkuar në një nga restorantet në Bejoglu. Pas teatrit fillon një shi i madh dhe shokët nuk arrijnë të lëvizin asgjëkund. Atëherë ata vendosin të ulen në kafenenë Kristal.

Të mërzitur po mendojnë si do e kalojnë natën jashtë. Hulusi bën një propozim. Nata ishte e ftohtë dhe nuk do ishin rehat as po të shkonin në hotel. Pse të mos shkonin në një shtëpi publike? Ahmet Efendi pranon edhe pse në fillim nuk e pëlqen këtë ide. Pasi i kërkojnë njërit nga kamerierëve që t'i adresojë në ndonjë shtëpi publike aty pranë, nisen duke biseduar.

Shtëpia ku shkojnë drejtohej nga një grua e moshuar armene. Ahmet Efendi merr një femër të re të quajtur Kaliopi. Kurse Hulusi zgjedh një femër me emrin Avagni. Ahmeti edhe pse shkon në dhomë me Kaliopin nuk bën asgjë, vetëm fle.

Kur zgjohet në mëngjes, Ahmetit i neveriten të gjitha ato që sheh. Orenditë e dhomës, muret në dukje të pastra në fakt ishin të përlyera nga kjo dëshirë e ulët mishtore që zinte vend në këtë ndërtesë. I lind dëshira të pijë një cigare., por nuk kishte me vete. Del jashtë dhomë për të gjetur një. Një kat më poshtë sheh dy femra që po bisedonin me njëra-tjetrën. Njëra nga ato ishte femra që ishte larguar shokun e tij Hulusi. Ajo i tregon shoqes së saj se si i kishte mashtruar dy nga klientët e saj.

Pasi kthehet në dhomë fillon të pyes vajzën që kishte në shtrat. Ajo ishte një vajzë e keqtrajtuar. Shenjat e dhunës i dukeshin qartë mbi trupin e saj të brishtë. Nxirje, pickime, kafshime dalloheshin lehtësisht në lëkurën e saj të bardhë., por edhe me këto shenja ajo prapë të jepte pamjen e një vajze të bukur. Vajza kthente përgjigje të shkurtra. Quhej Kaliopi e vogël. E thërrisnin e vogël pasi ishte vetëm

17 vjeç. Kjo e vërtetë e hidhur i shton kureshtjen dhe fillon të interesohet më shumë.

Ai mëson se në këtë lloj pune kishte vajza me moshë edhe më të vogël, 12-13 vjeçare. Një pjesë e tyre shiteshin nga vetë prindërit për përfitime ekonomike. Ndërsa vetë Kaliopi ishte shitur me dëshirën e saj. Ahmet Efendit i duket shumë interesante jeta e kësaj vajze dhe vendos ta kaloj edhe një natë tjetër në shoqërinë e saj. Edhe vetë Kaliopi e kuptoi që ky klientë nuk ishte si shumica e klientëve që kishte pasur. Ajo sillet me dashuri ndaj këtij klienti të çuditshëm dhe herë pas here i tregon pjesë nga jeta e saj.

Në këtë shtëpi kishte ardhur para nëntë muajsh., por biseda e tyre ndërpritet pasi në homë vjen Hulusi me Avagnin. Pas largimit të tyre fillojnë përsëri bisedën. Gjatë bisedës ata flasin për klientët, punonjësit e shtëpisë publike dhe për vetë shtëpinë publike., por përsëri Ahmet Efendi nuk arrin të dëgjojë ndonjë histori pikante në lidhje me jetën e Kaliopit.

Pasi Ahmet Efendi largohet nga shtëpia publike fillojnë të dalin në pah të palarat. Fillojnë përplasjet për pagesën. Avagni pretendon që të gjithë klientët janë njësoj dhe duhet t'u merren sa më shumë para. Ajo madje mendon se vetëm gomarët mund të vijnë të harxhojnë para në këto shtëpi.

Pasi kalojnë një farë kohe duke u marr me punët e tyre Ahmet Efendi me shokun e tij Hulusi shkojnë përsëri në shtëpinë publike., por këtë herë pasi shkojnë në shtëpinë publike Ahmeti me Hulusin i marrin vajzat dhe dalin jashtë për një shëtitje. Gjatë shëtitjes Ahmeti sheh se Kaliopi ishte veshur me të zeza dhe e pyet përse mbante zi.

Kaliopi i tregon se kishte pasur një motër të madhe të quajtur Marjola. Ajo ishte e fejuar me një djalë që kishte shkuar të punonte në Selanik. Duke qenë se ishin të varfër ajo me motrën e saj punonin duke larë nëpër shtëpi të ndryshme. Në një nga këto shtëpi jetonte Ligori. Ligori bie në dashuri me Marjolën dhe i kërkon të martohen., por kur Marjola e refuzon ai e godet me thikë dhe e lë të vdekur.

Edhe pse për momentin nuk guxon ta pyes, pasi kalojnë pak çaste Ahmet Efendi e pyet vajzën nëse kishte qenë e virgjër kur kishte ardhur në këtë shtëpi publike. Ajo i thotë jo. Ahmeti e pyet nëse ishte martuar. Kaliopi i kthen përgjigjen edhe po edhe jo. Biseda mbyllet këtu., por kurioziteti i Ahmetit nuk ndalohet.

Pas një vizite tjetër në shtëpinë publike ai mëson nga Avagni se Kaliopi i ishte dhënë për grua një burri, madje një burri mysliman. Kurioziteti i Ahmetit arrin kulmin., por edhe pse përpiqet ai nuk arrin ta mposhtë Kaliopin dhe ta bëjë të tregojë më shumë për këtë gjë.

Por Ahmeti nuk heq dorë. Pas këmbënguljeve të shumta Kaliopi fillon të tregojë jetën e saj. Ajo ishte vajza e një tregtari duhani me emrin Jorgaq. Pasi dështon në tregtinë e duhanit Jorgaqi hap një kafene në fshat. Vëllai i Kaliopit punonte duk ndihmuar të atin në kafene. Motra e madhe, Marjola, ishte fejuar me një djalë shqiptar. Djali për shkak të punës largohet për në Selanik. Pas një farë kohe nuk vijnë më lajme nga i fejuari shqiptar. Në të njëjtën kohë edhe vëllai i Kaliopit sëmuret dhe babai i saj shpenzon gjithë paratë e tij për shërimin e djalit.

Në këtë periudhë Kaliopi kishte mbushur 15 vjeç dhe ishte bërë një femër e vërtetë. Megjithëse ishte rritur ajo vazhdonte të shkonte në kafenenë poshtë për të ndihmuar babanë. Edhe pse nëna i dilte kundër asaj i pëlqente të merrej me njerëzit. Edhe pse shumica e tyre ishin pijanecë dhe njerëz të ulët.

Një nga klientët e kafenesë ishte edhe një djalë mysliman me emrin Jymny. Atij i kishte vdekur babai duke i lënë një pasuri të madhe së bashku me vëllezërit e tij. Edhe pse kishte shpenzuar një pjesë të madhe të pasurisë ai prapë mund të quhej një njeri i pasur.

Jymny kishte një shok që i qëndronte gjithë kohës nga pas me emrin Nikolidis. Ky shok i shkoi Kaliopit duke i thënë se Jymny ishte i dashuruar me të dhe se ishte gati të ofronte flori dhe diamante për të.

Ndonëse pse në moshë të vogël dhe e paditur për këto gjëra, Kaliopi kishte frikë. Frika e saj nuk vinte nga lidhja që do kishte. Ajo kishte një frikë tjetër. Si do t'i fshihte dhuratat e çmuara që do të merrte.

Përveç kësaj edhe shoku i Jymnys, Nikolidisi, i vardiset Kaliopit duke i premtuar që do ta marr për grua pasi t'i hanë gjithë paratë Jymnyt. Këtë kërkesë të Jymnyt, Kaliopi ja tregon motrës së saj më të madhe. Duke qenë më e zgjuar, Marjola i thotë të pranojë pasi bën llogari për fitimet që do kenë. Pasi fillojnë të shihen, Jymny i ofron Kaliopit disa dhurata si varëse, byzylykë, vath.

Por Jymny sillet si një zotëri i vërtetë. Edhe pse takohen ai nuk i jep më shumë se disa puthje Kaliopit. Jymni e kishte seriozisht, por Marjola, motra e Kaliopit edhe pse i thotë që do e ndihmojë dhe do i thotë babait për të nuk e bën nga frika se do humbisnin dhuratat. Kur Jymny e kupton që ajo s'do t'i thoshte babait për Kaliopin i propozon kësaj të fundit të arratisen. Kaliopi nuk pranon. Në këtë kohë pothuajse gjithë fshati ka filluar të dyshojë për lidhjen e tyre.

Gjatë një dasme në fshat, duke përfutur nga largimi më herët i motrës, Nikolidis i mbush mendjen ta përcjell Kaliopin në shtëpi., por gjatë rrugës ai ja prish mendjen që të shkojnë në shtëpinë e Jymnys. Tashmë Kaliopi në sytë e botës ishte rrëmbyer. Në shtëpinë e Jymnys i prisnin hoxha dhe dëshmitarët të cilët menjëherë bënë martesën zyrtare. Kaliopi ishte pak më shumë se pesëmbëdhjetë vjeçe në këtë kohë.

Babai i Kaliopit detyrohet të pranojë këtë lidhje pasi vajza ishte larguar me dëshirën e saj. Madje ai i kthen edhe gjithë dhuratat që i kishte dhënë vajzës., por tashmë lajmi kishte marr dhenë. Për më tepër në fshat ishte përhapur fjala që Kaliopi ishte kthyer në myslimane. Jorgaqi mundohet të tregojë se sipas ligjeve Osmane një vajzë e krishterë mund të martohej me një mysliman pa e ndryshuar fenë., por në fshat asnjëri nuk i beson. Njerëzit vazhdojnë t'i përgojnë edhe më shumë.

Populli i krishterë fillon të kërcënojë se nëse Kaliopi nuk ndahet nga Jymny ata do ta vrisnin. Nëse do ndahej ata do t'i jepnin dymijë lira dhe do t'i gjenin një burrë të mirë. Kaliopi, më shumë nga frika e vdekjes sesa nga oferta për para pranon të deklarojë që nuk e donte Jymnyn. Pasi ndahet nga Jymny ajo nuk kthehet në fshat, por shkon në Kasëmpasha ku disa të afërm i premtojnë të kujdesen për të., por kjo familje e cila mezi ja dilte të nxirrte muajin e vë në punë



të rënda që t'u sillte para në shtëpi. Një ditë i vjen për vizitë motra Marjola e cila i tregon për gjendjen e vështirë në të cilën ndodhej familja.

Familja e Jorgaqit jo vetëm që nuk merr paratë e premtuara, por humbet edhe atë biznes të vogël që kishte pasi fshatarët nuk i shkojnë më në kafene. Pa një shpresë për të ardhmen familja e Jorgaqit transferohet në Kasëmpasha.

Në këtë periudhë futet në lojë edhe Ligori. Familja vazhdon të jetojë në varfëri të plotë. Kaliopi po jetonte një jetë mizerabël pas ndarjes nga Jymni. Të gjithë premtimet ishin të kota. Të gjithë u kishin kthyer kurrizin.

Një ditë u vjen për vizitë një kushërirë me emrin Amela. Ajo punonte si rrobaqepëse në Bejoglu. Ajo i thotë Kaliopit se nëse dëshironte mund ta merrte edhe atë me vete të punonte atje. Kaliopi pranon. Përveç se punonte si rrobaqepëse Amela bënte edhe një punë tjetër. Ajo punonte si prostitutë kur i kërkohej.

Kaliopi habitet kur e mëson një gjë të tillë., por Amela nuk e vret mendjen. Madje i propozon Kaliopit që edhe ajo të bëjë të njëjtën punë. Një natë Amela shkon për të dërguar një porosi tek një burrë dhe e merr me vete edhe Kaliopin. Kaliopi kalon një natë shumë të turbulltë dhe me dhimbje.

Pasi kthehet në shtëpi Kaliopi mundohet t'ia shpjegojë atë që bëri Marjolës., por habitet shumë kur dëgjon se Marjola jo vetëm e dinte, por kishte qenë ajo që e kishte ftuar Amelën që ta merrte me vete. Ndërsa si arsyetim nxjerr faktin se ajo vetë ishte e fejuar. Kurse Kaliopi kishte qenë femra e një turku. Tashmë asnjëri nuk do ta merrte atë.

E zhgënjyer nga loja që i kishte bërë motra e saj, Kaliopi vazhdon të punojë në këtë profesion të ri., por problemet nuk e lënë të qetë. Motra e saj vritet nga Ligori. Vdekja e saj sjell edhe më shumë varfëri në familjen që edhe ashtu ishte shumë e varfër. Shtimi i borxheve e sjell familjen në pikën më të ulët. Për të paguar borxhet e mbledhura Kaliopi së bashku me nënën e saj vendosin që Kaliopin ta shesin në një shtëpi publike dhe kështu të paguanin borxhet.

Pasi i dëgjon gjithë këto peripeci që kishte kaluar Kaliopi, Ahmet Efendi vendos që ta ndihmojë për të shpëtuar nga kjo jetë që bënte., por i kërkon vajzës që t'i jap fjalën se nuk do të kthehej kurrë më në këtë profesion. Kaliopi i jep fjalën. I lumtur që do të ndihmonte të shpëtonte një vajzë të përvuajtur të shpëtojë nga një jetë të keqe, Ahmet Efendi, së bashku me shokun e tij mbledhin paratë e nevojshme për ta larguar nga kjo shtëpi publike.

Pasi e shpëtojnë nga shtëpia publike, Ahmeti së bashku me Kaliopin dhe Hulusin shkojnë në shtëpinë e saj. Atje njihen me prindërit e saj dhe habiten shumë. Sepse në familjen e tyre nuk dallohej ndonjë vuajtje prej varfërisë, vdekjes së Marjolës ose shitjes së vajzës tjetër në bordello. Sidomos babai ishte një njeri i shëndetshëm dhe i fortë i cili mund të punonte shumë mirë. Megjithëse zemërohet shumë, Ahmet Efendi e mban veten dhe nuk thotë gjë. Ulet dhe flet me prindërit e Kaliopit duke u treguar se qëllimi kryesor i tyre ishte që Kaliopi të mos kthehej më në shtëpinë publike. Ata i japin fjalën që nuk do e shisnin më.

Me ndihmën e Ahmet Efendit dhe Hulusit familja e Kaliopit fillon ta rimarr veten. Marrin një shtëpi në një zonë më të mirë të Stambollit. Pasi kalojnë disa

muaj Ahmet Efendi së bashku me Hulusin, për të mësuar nëse prindërit e Kaliopit do e mbanin fjalën i dërgojnë një njeri të besuar për t'u bërë një ofertë për të blerë Kaliopin.

Kur shohin që as familja as vajza nuk pranojnë këtë ofertë e kuptojnë që ata e kanë mbajtur fjalën e dhënë. Ahmet Efendi e ndihmon Jorgaqin që të fillojë një biznes të tijin duke i siguruar një kapital të mjaftueshëm. Jorgaqi jo vetëm që ja kthen borxhin shumë shpejt, por edhe fillon të fitojë mjaftueshëm.

Tetë muaj pas takimit të parë me Kaliopin, Ahmet Efendi i gjen asaj një burrë të përshtatshëm. Një djalë grek që punonte si ndihmës i një kushëririt të tij. Me dasmën e Kaliopit mbyllet edhe romani.

### **Vah (1881)**

Ky roman ashtu si edhe disa romanë të tjerë të shkrimtarit Ahmet Mid'hat Efendi ka si temë kryesore dashurinë dhe xhelozinë.

Romani fillon me pasthirmat "vah" dhe "ah" si dhe arsyet pse nxirren këto pasthirra nga njerëzit. Një person që thotë "vah" është në një gjendje të pashpresë dhe duhet të na vij keq për të.

Kështu fillon edhe ngjarja. Në një traget, në një të diel vere. Dy shokë, Nexhati dhe Behxheti shohin një femër të gjatë dhe të bukur që hipën në tragetin që do i çonte në anën tjetër të ngushticës së Bosforit. Ajo që binte më shumë në sy tek kjo femër ishte lirshmëria e sjelljeve të saj.

Pa e vrarë mendjen fare pi cigare para meshkujve dhe i shikon në sy pa pikën e turpfit. Me provokimet e saja ajo tërheq vëmendjen e meshkujve në traget duke përfshirë edhe Behxhetin. Kurse Nexhati ndihet keq nga provokimet e saj.

Behxheti i mahnitur pas kësaj gruaje që dukej e lehtë për t'u kapur i ngjitet nga pas. Ai e di që ajo femër nuk do pranonte t'i fliste në rrugë., por po të gjente adresën e shtëpisë do e kishte të sigurt takimin me të.

Për t'ia arritur qëllimit pasi zbresin nga trageti, Behxheti ndahet nga Nexhati dhe i vihat nga pas. E ndjek për një kohë të gjatë derisa ajo futet në një shtëpi. Ai pyet dyqanxhiun e lagjes dhe mëson se ajo ishte shtëpia e Hoxha Kutbedinit. Në darkë gruaja del nga shtëpia. Behxheti që e kishte pritur gjithë ditën tani e ndjek përsëri. Në fund ai arrin ta mësojë se ku banon kjo grua, por tashmë është shumë vonë për të bërë ndonjë gjë dhe largohet pasi e mban shënim adresën.

Pas kësaj ndjekjeje shkrimtari na njeh më nga afër me këta dy shokë. Behxheti është një djalë 26 vjeçar i cili pas vdekjes së babait trashëgon një pasuri mjaft të madhe., por ai e shpenzon pasurinë e babait me dëshirën e tij për t'u dukur modern. Ai është një djalë i përkëdhelur dhe i ndjeshëm. Ishte arsimuar në një shkollë të mirë dhe ishte i dhënë pas letërsisë.

Ndërsa Nexhati ishte një njeri tek të tridhjetë e pestat, i ndershëm dhe me moral të lartë. Ai e fitonte jetesën duke punuar vetë. Fal përpjekjeve dhe studimit serioz ai kishte arsimuar veten. Edhe atij i kishte vdekur babai. Ai punonte si nëpunës në një zyrë shteti. Nuk ishte i martuar. Jetonte me një motër më të vogël

që ishte e martuar. Kishte një teze të moshuar e cila kishte një vajzë të birësuar në moshën 20 vjeçare. Nexhati i mbante të gjithë këta pasi ishte i vetmi që sillte para.

Pasi mëson shtëpinë Behxheti me anë të motrës së pronarit të pallatit përpiqet të mësojë ndonjë gjë për këtë femër. Despino, motra e Petraqit, pronarit të pallatit ishte një femër shumë e shkathët.

Informacionet që sjell ajo janë shumë interesante. Kjo grua e re dhe e bukur ishte një femër pa komplekse. Njihet për lidhjet që kishte me disa ambiente të pasura të shoqërisë së Stambollit. Edhe pse quhej Ferdane, burri i saj i kishte vënë emrin Samurkash.

Por më interesantja nga të gjitha është martesja e Ferdanes. Si kishte ndodhur që një grua kaq e bukur të martohej me një njeri kaq të shëmtuar. Për më tepër që ky njeri i shëmtuar ishte xheloz në maksimum.

Në fakt burri i saj nuk kishte qenë gjithmonë kaq i shëmtuar. Ferdane dhe Talati ishin kushërinj të afërt. Familjet e tyre kishin vendosur t'i martonin që në djep. Në Fakt Talati ishte goxha simpatik, por një vit para martesës e zë sëmundja e lisë. Për shkak të sëmundjes fytyra e tij prishet. Duke e ditur në çfarë gjendje ishte mendon se Feridania nuk do t'u martonte me të.

Por ndryshe nga sa mendohej Ferdane martohet duke thënë se ai njeri ishte fati i saj., por problemet sapo kishin filluar. Si do mund ta ruante gruan e tij kaq të bukur? Ai bëhej shumë xheloz dhe shpesh herë e ndiqte gruan e tij për të kontrolluar nga shkonte.

Një ditë Nexhati shkon në një teatër. Ashtu siç ishte bërë zakon kohët e fundit djemtë që e mbanin veten për modernë fillojnë të ngacmojnë vajzat që ndodheshin në teatër. Një nga këto vajza ishte edhe Ferdania. Pas mbarimit të teatrit ngacmimet shtohen dhe fillon një zënkë. Nexhati, si një njeri me moral ndërhy, madje njërin nga djemtë e qëllon me karrige në kokë. Arrestohet nga policia.

Kur del në gjyq djemtë e tërheqin padinë, por sapo do lirohej ndërhy Talati, burri i Ferdanes i cili me ankesat e tij bëhet objekt talljeje në sallë.

Ndihma që Nexhati i dha Ferdanes bën që ajo të ketë një lloj tërheqjeje ndaj tij. Ajo i shkruan një letër falënderimi Nexhatit, së bashku me të i dërgon edhe një foto. Letrën ia dërgon Despino. Kjo bën të shtohet interesi i Nexhatit ndaj Ferdanes., por përveç tij kemi edhe Bexhetin që është i interesuar ndaj saj.

Problemet që Ferdania kishte nga xhelozia e burrit po ja nxinin jetën. Despina, e cila ishte shumë e lidhur me të, i propozon që të gjejë një mënyrë për të hequr mërzinë. Për këtë arsye i rregullon një takim me Nexhatin., por Nexhati si vend takimi lë një vend jo shumë të fshehtë pasi nuk donte të keqkuptohej.

Letra me gjithë foton që duhet t'i jepej Ferdanes humbet, ose më mirë të themi vidhet nga Bexheti. Bexheti po fillonte të bëhej xheloz për shkak të kësaj marrëdhënieje.

Takimet mes Nexhatit dhe Ferdanes vazhdojnë të shtohen gjithmonë e më shumë., por në këtë pikë ndërhy Bexheti. Edhe ai kërkon të ketë vëmendjen e

Ferdanes. Ai i thotë Despinës se nëse Ferdania nuk do të pranonte ai do ia jepte letrën dhe foton që kishte burrit të Ferdanes.

Por Ferdania nuk i kthen fare përgjigje duke e injoruar. Kjo bën që tek Bexheti të lind edhe ndjenja e hakmarrjes nga ky poshtërim i bërë. Në të njëjtën kohë Bexheti fillon të interesohet për artin e fotografimit. Ai hap edhe një studio në fshehtësi.

Ai i dërgon Ferdanes foton dhe letrën që kishte., por Ferdania e rrahur me vaj e me uthull me këto lloj lojrash e kupton menjëherë që foto është një kopje e asaj që i kishte dërguar Nexhatit. Po ashtu edhe letra nuk ishte e saja. Ajo ia kthen ato Bexhetit pa asnjë përgjigje.

Bexheti kur sheh që me Ferdanen nuk i ecën puna i drejtohet Nexhatit. I dërgon Nexhatit një kuti ku sipër shkruhej Ferdane dhe brenda ishte një foto e Ferdanes e montuar me pjesën e sipërme të zhveshur. Nexhati i cili nuk e kupton kurthin i mërzhitur ja dërgon foton së bashku me një letër fyese Ferdanes., por Ferdania nuk i kthen përgjigje.

Por Bexheti nuk ndalet me kaq. Një ditë e merr Nexhatin dhe gjasme duke shëtitur ndalojnë para një dyqani ku ndodhej fotografia pothuajse e zhveshur e një gruaje. Kjo grua ishte Ferdania. I tërbuar nga xhelozia Nexhati e blen foton dhe ia nis Ferdanes së bashku me një letër shumë më fyese se hera e fundit.

Por letra e dërguar gabimisht përfundon në duart e burrit të Ferdanes, Talatit. Marrëdhënia burrë e grua edhe pa këtë problem ishte shumë e rënduar. I tërbuar nga xhelozia Talati e ndan Ferdanen. Për shkak të gjithë këtyre ndodhive Talati sëmuret rëndë dhe zë shtratin.

Ferdane e cila kishte heshtur deri atëherë i shkruan një letër duke ja shpjeguar të gjitha Nexhatit. Më pas për shkak të stresit të madh që kishte kaluar e shpërftyron fytyrën e saj pasi e konsideron si shkaktaren e gjithë të këqijave. Nexhati pasi e kupton gabimin që kishte bërë hidhet në veprim. Shkon në ministrinë e drejtësisë ku kërkon ndihmë.

Policët gjejnë studion e fshehtë të Bexhetit dhe e arrestojnë pasi ty gjejnë shumë foto të shtypura të Ferdanes dhe shumë foto të tjera jo të hijshme me të cilat ai bënte manipulimet e fotove të Ferdanes.

Talati vdes nga sëmundja e rëndë. Ferdane është ende nën kontrollin e doktorit. Bexheti dënohet me shtatë vjet burg. Ndërsa Nexhati martohet me Ferdanen e cila nuk është më e bukur.

### **Zonja Durdane (1881)**

Romani “Zonja Durdane” i shkrimtarit Ahmet Mid’hat Efendi është një roman që prek një problem tjetër të shoqërisë turke, fëmijët e lindur nga marrëdhëniet jashtë martesore dhe problemet që lindin nga kjo gjë. Tipari kryesor i këtij romani është se personazhi kryesor është një femër e ve. Diçka e re për romanin turk.

Ishin ditët e para të vjeshtës. Mejhanet e Gallatës ishin të mbushura me klientë si zakonisht., por ndryshe nga më parë klientët e tanishëm nuk ishin më ata njerëz të respektuar dhe me pamje të rregullt, por klientë më pak qytetarë dhe më të

mefshtë. Edhe vetë Mejhanet kishin ndryshuar. Tani ato e përzielin pijen me ujë për të përfituar më shumë. E vetmja gjë që nuk kishte ndryshuar ishin ndodhitë. Ato ishin ende të njëjta.

Njerëzit e parë që njohim në këtë ambient janë varkëtari Çerkez Sohbet Aga, i cili po priste Axhem Ali Beun, dhe një mashtrues dhe hajdut ordiner me emrin Papazoglu.

Këta dy miq të vjetër po flisnin për Axhem Ali Beun. Papazoglu i thotë që ky pasanik i ri ishte një preh e lehtë për tu kapur., por Sohbet Aga i thotë se nuk ishte edhe aq i lehtë për t'u kapur pasi ishte i fuqishëm dhe i zgjuar. Ai e kishte parë në veprim dhe e këshillonte të ishte i kujdesshëm.

Ali Beu vjen dhe e takon Sohbet Agën në Gallata dhe i thotë që pas disa ditësh do kishin një punë bashkë. Pastaj të dy bashkë shkojnë për t'u argëtuar në një hotel. Pas argëtimit dhe pasi kishin pirë mirë e mirë një nga femrat i ofrohet që të kalojnë natën bashkë., por Sohbet Aga e refuzon duke thënë se nuk mund të shkonte me femra që e shisnin veten lirë.

Të dy shokët, Sohbet Aga dhe Axhem Ali Beu flenë në të njëjtën dhomë. Gjatë natës Sohbet Agës i del gjumi dhe ngrihet për të pirë një cigare.

Duke pirë cigaren ai sheh nga Ali Beu i cili dukej sikur poshtë fanellës që kishte veshur kishte dy pjepër. Nga kurioziteti afrohet edhe më shumë pranë tij. Kur sheh se në veshët e tij kishte vrima për të mbajtur vathë e kupton që në fakt Ali Beu ishte një femër. Edhe pse çuditet shumë ai nuk i tregon njeriu për këtë gjë.

Të nesërmen në mëngjes, Axhem Ali Beu largohet, pasi e bën Sohbet Agën që të betohet se s' do i thotë njeriu për punën që do të bënin pas dy ditësh.

Në kapitullin tjetër ne mësojmë për një ngjarje shumë të çuditshme që i ndodh një mamie shumë të njohur në Stamboll. Një ditë mami Aishja zhduket në mënyrë të mistershme. Pas pesë ditësh gjendet përsëri në shtëpinë e saj ashtu si zhduket, sikur nuk kishte ndodhur gjë.

Mamia Aishe rrëmbehet nga shtëpia e saj nga tri persona dhe dërgohet në mënyrë të fshehtë në një vilë jo shumë larg Stambollit. Atje ndihmon në lindjen e një gruaja me emrin znj. Durdane. Gjëja më e çuditshme është që edhe njerëzit e vilës nuk i njihnin maminë dhe personat që e shoqëronin.

Pasi u futën në vilë ata ndihmuan në lindjen e një djali që u quajt Ataullah. Ky fëmijë i sapolindur largohet menjëherë nga vila.

Personat që e ndihmuan znj. Durdane ishin Ali Beu, Sohbet Aga dhe Papazoglu. Ali Beu përveçse i betohet znj. Durdane për fshehtësi i thotë edhe se mund të merrte hak ndaj Megub Beut që e kishte sjellë në këtë gjendje. Edhe pse qëndrojnë bashkë për një kohë të shkurtër mamia Aishe bie në dashuri me Ali Beun.

Pasi u pa se znj. Durdane ishte mirë me shëndet mami së Aishe i vjen koha të kthehet në shtëpi. Nisen me të njëjtën fshehtësi siç edhe erdhën. Gjatë rrugës Aishja i shpreh dashurinë Ali Beut., por Ali Beu i merr dorën dhe ia fut poshtë këmbës së tij. Aishja e kupton që Aliu është një femër ashtu si edhe ajo.

Në kapitulin e tretë flitet për znj. Ulvije të njohur si “Egjiptiana”. Për shkaqet politike ajo së bashku me babanë e saj ishin larguar nga Egjipti., por burri i saj kishte qëndruar në Egjipt dhe kishte vdekur pas disa kohësh. Pak vite më vonë i vdes edhe i ati. Kështu që përveç se e ve mbetet edhe jetime. Ajo jetonte në një shtëpi jo shumë të madhe së bashku me nënën e moshuar dhe shërbëtoret.

Zonja Ulvije ishte një femër e bukur rreth njëzet e pesë vjeçe. Miku i vetëm ishte një doktor anglez i moshuar që kishte qenë mik i familjes. Ulvija ishte shumë e dhënë pas letërsisë dhe lexonte çdo libër që dilte në shitje dhe mbante korrespondencë me disa nga shkrimtarët. Kjo gjë madje kishte bërë të dilnin edhe thashetheme në lidhje me marrëdhëniet që kishte me ata.

Shtëpia e Ulvijes ishte pranë vilës së Halveti Efendit, babait të znj. Durdane. Duke qenë se ishte komshi, Ulvije ishte kurioze për atë çfarë ndodhte në vilën e znj. Durdane. Në fillim e vëzhgon me një shkallë që e vendos pranë dritares së dhomës së znj. Durdane. Më pas me ndihmën e një telefoni që ia gjen doktori anglez i dëgjon gjithë sekretet.

Znj. Durdane kishte rënë në dashuri me një djalë të quajtur Mergub, i cili e kishte mashtruar duke i thënë se donte të martohej me të. Pasi kishin kaluar netë të bukura bashkë në shomën e znj. Durdane, ajo kishte mbetur shtatzënë. Mergubi nuk kishte pranuar ta njihte fëmijën dhe i kishte kërkuar ta abortonte.

Gjithë kjo lojë që kishte filluar nga kurioziteti i Ulvijes tani kthehet në një dëshirë për të ndihmuar znj. Durdane që ishte mashtruar nga Mergubi. Po ashtu Ulvija kishte edhe dëshirën për t’u hakmarrë ndaj tij. Duke qenë se si femër nuk do kishte mundësi t’i realizonte këto dëshira ajo vishet si mashkull duke u kthyer në Axhem Ali Beun.

Pasi krijon Ali Beun, Ulvija përpiqet ta bëjë të besueshëm këtë tip. Duke qenë një femër shumë e fuqishme ajo nuk e ka të vështirë të krijojë një tip burri të fuqishëm. Duke shëtitur nëpër vendet ku shkojnë burrat ajo në një kohë të shkurtër njihet dhe bëhet mik me Sohbet Agën një burrë të përvuajtur, por të ndershëm. Me ndihmën e atij ajo do të vërë në jetë planin e saj. Megjithatë Ulvija nuk i tregon, Sohbet Aga e kupton që Aliu është femër.

Që të hakmerret ndaj Margebit për të keqen që i kishte bërë znj. Durdane, në fillim Ulvija duhet ta gjente Margeb Beun. Për këtë arsye ajo fillon të frekuentojë vendet ku mund të shkonte. Një ditë të premtë duke u veshur si grua ajo shkon të shëtis në një shëtitore ku shkonte shpesh edhe Margeb Beu. Margeb Beu pasi e sheh fillon t’i vardiset. Në një kohë shumë të shkurtër ajo e bën Margeb Beun të dashurohet me të.

Nga një anë luan lojën me Margeb Beun, nga ana tjetër vazhdon të përgjojë takimet që ka znj. Durdane me të në dhomën e saj.

Lidhja e filluar mes Marbeg Beut dhe Ulvijes fillon të trashet dhe një ditë ata lënë një takim., por takimi nuk kalon ashtu si priste Margeb Beu. Në takim Ulvije ia përplas në fytyrë të gjitha gënjeshttrat. Për më tepër ajo e kërcënon. Nëse nuk do të martohej me znj. Durdane ajo nuk do të mbante përgjegjësi për çfarë do t’i ndodhte.

Margeb Beu i tërbuar nga kërcënimi i bërë nga një grua tenton të nxjerr pistoletën nga brezi, por turpërimi i tij nuk ka fund. Ulvija me forcën e saj ja merr nga dora dhe e përplas përtokë.

Kur Ulvija sheh se Margeb Beu nuk e mban fjalën e dhënë ajo i vihet punës për të zbatuar planin e hakmarrjes., por para se ta bëjë këtë ajo do ndihmojë znj. Durdane që të mos vuaj nga kjo gjë. Për këtë gjë ajo rrëmben mami Aishen dhe ndihmon znj. Durdane të lind një fëmijë të shëndetshëm.

Në këtë pikë Ali Beu pa i treguar emrat e vërtetë i kërkon Sohbet Agës për çfarë kishte ndodhur dhe për planin e hakmarrjes. Nëse edhe ai do ta pranonte do ta zbatonin të dy planin., por Sohbet Aga, i cili ishte më i kujdesshëm i thotë të mos nxitohet pasi jo çdo gjë mund të jetë ashtu si duket. Për të vërtetuar këtë ai i tregon për historinë e jetës së tij.

Sohbeti kishte qenë shërbëtor i besuar i një Agai. Për shkak të zgjuarsisë dhe kujdesit që tregonte kishte fituar besimin e Agait dhe gruas së tij. Duke kursyer paratë që i jepnin kishte arritur të mbledhte një shumë të mirë. Kuptohet që asnjëri nuk i dinte këto para të mbledhura. Nga ana tjetër, për shkak të dashurisë që kishte ndaj tij, Agai i kishte premtuar ta martonte me mbesën e tij Lutfije.

Xhemal Aga i cili punonte në të njëjtën punë me Again e tij kishte qëllime të turpshme ndaj këtij djali të ri dhe simpatik., por sjellja e ndershme dhe kujdesi që ai tregonte e tërbon Xhemal Agën që nuk ja arrin qëllimit.

I zemëruar në kulm ai i ngre një kurth Sohbetit. Në fillim mëson për paratë që Sohbeti kishte kursyer duke bërë të duket sikur i kishte vjedhur. Pastaj me disa intriga të tjera arrin ta dëbojë djalin nga vila. Më pas atë e arrestojnë për vjedhje.

Sohbeti i tërbuar shkon dhe e plagos me thikë Xhemal Agën. Kapet dhe dënohet me pesëmbëdhjetë vjet burg në Vidin.<sup>76</sup> Kalon dy vite atje, duke përfituar nga një trazirë arratiset. Dy vite më pas, pasi i kishte humbur gjurmët kthehet në Stamboll dhe fillon të punojë si varkëtarë.

Ajo që mundohet t'i tregojë Ali Beut (Ulvijes) është se në pamje të parë zotëria i tij kishte të drejtë që e kishte dëbuar., por në fakt ishte fajtor. Xhemal Aga me gjithë të këqijat që kishte bërë shëtiste i lirë. Ndërsa atij vetë i ishte shkatërruar jeta pa pasur asnjë faj. E njëjta gjë mund të ishte edhe mes Margeb Beut dhe znj. Durdane. Ndoshta mund të kishte gjëra që nuk i dinin në lidhje me marrëdhënien e tyre.

Pasi shpreh keqardhjen për vuajtjet që kishte kaluar Sohbet Aga, Ali Beu vendos të mësojë gjithçka në lidhje me këtë lidhje. Pasi i jep disa para dhe e këshillon të mësojë çdo gjë Ali Beu largohet. Para se të largohet Sohbeti i hedh disa fjalë duke aluduar se ai e dinte që ishte femër.

Një muaj më vonë Sohbeti shkon të takojë Ali Beun. Informacioni që kishte mbledhur tregonte një pamje tjetër nga ajo që dinte Ali Beu. Kishte qenë znj. Durdane që e kishte ngacmuar Margeb Beun kur ai shkonte për peshkim pranë vilës së saj. Për më tepër znj. Durdane ishte e fejuar me një doktor ushtarak të

---

<sup>76</sup> Qytet që ndodhet në Bullgarinë Veriore në kufi me Serbinë. Në kohën e ngjarjeve ndodhej brenda kufijve të perandorisë Osmane.

quajtur Memduh Bej. Në një kohë shumë të shkurtër znj. Durdane dhe Margeb Beu bëhen miq. Margeb Beu mendon se znj. Durdane është e lehtë për t'u kapur.

Znj. Durdane në fakt i tregon se ajo ishte e fejuar me Memduh Beun, por që nuk e donte. Ajo donte Margeb Beun., por Margeb Beu duke dyshuar se ajo mund të kishte pasur edhe lidhje të tjera si ajo që kishin tani, heziton t'i premtojë për martesë.

Znj. Durdane nga ana tjetër i dërgon një letër të fejuarit ku i thotë se nuk e do pasi dashuronte një tjetër dhe se do ndaheshin. Memduh Beu pëson një tronditje të fortë dhe tenton disa herë të vetëvritet pasi e dashuronte me të vërtetë znj. Durdane.

Sohbet Aga takohet me Memduh Beun. Ai e kupton që ndodhet në mes të një lidhje dashurore shumë komplekse. Memduh Beu edhe pse e dashuron znj Durdane, nuk e kapërdin faktin që ajo nuk e dashuron. Po ashtu e pranon edhe faktin që Margeb Beu nuk mund të qëndronte i pa interesuar ndaj bukurisë së saj. Madje do ishte gabim po të mos ndjente gjë. Prandaj dhe nuk kishte dëshirë të hakmerrej.

Ali Beu dhe Sohbeti janë në një dilemë. Që të gjithë janë fajtorë nga pak. Që të gjithë janë të pafajshëm nga pak, por problemi akoma nuk është zgjidhur. Zgjidhja e këtij problemi ndodhej tek znj. Durdane. Përgjigjia që do të jap ajo do të sqarojë njëherë e mirë këtë gjë. Ulvija shkon tek znj. Durdane si femër dhe e pyet. Znj. Durdane i thotë se do të flasë edhe një herë me Margeb Beun duke i kërkuar të martohet me të. Nëse ai do të refuzonte atëherë le të vinte në zbatim planin e saj.

Në takim Margeb Beu i kërkon pak më shumë kohë për t'u menduar., por pasi largohet ai i shkruan një letër ku i thotë se nuk mund të martohet me të. Znj. Durdane i kërkon edhe një mundësi të fundit për t'u takuar me Margebin dhe pastaj mund të zbatonte planin. Ulvije e bindur se po bënte diçka të drejtë i jep fjalën që do e sjellë Margeb Beun.

Me ndihmën e Sohbetit ajo e rrëmben Margeb Beun nga shtëpia e tij dhe e sjell në dhomën e znj. Durdane. Znj. Durdane është e veshur me të zeza dhe e zbehtë. Ka marr edhe fëmijën nga shtëpia e Ulvijes dhe ia lë të atit në prehër., por Margeb Beu vetëm sa ndihem më në siklet. Pas pak znj. Durdane rrëzohet në tokë. Ajo kishte pirë shumë ilaçe dhe vdes nga helmimi.

Kalojnë gjashtë muaj. Sohbeti është martuar me Ulvijën. Tani janë në një ceremoni mortore. Është ceremonia mortore e Margeb Beut.

### **Karnaval (1881)**

Ky roman i Ahmet Mid'hat Efendit paraqet një nga ndikimet e shumta perëndimore që filluan të shfaqen në shoqërinë Osmane gjatë shekullit XIX. Shkrimtari me këtë roman tallet hapur me këto ndikime që nuk kanë asgjë të përbashkët me traditën dhe kulturën turke. Tema është pak a shumë e njëjtë me romanin "Felatun Beu dhe Rakim Efendi"



Në fillim njihemi me Izzet Efendin, një nga njerëzit më në zë për sa u përket festimeve në Shehzadebashë. Ky plak shumë i pasur dhe qejfli kishte një djalë tek të njëzetat me emrin Zekai.

Plaku ishte shumë i dhënë pas djalit të tij dhe i kushtonte shumë vëmendje jo vetëm në edukim. Djali gjithmonë do të dilte i shoqëruar nga shtëpia. Ky djalë ishte një i ri i zgjuar, por pa asnjë kontakt me jetën jashtë vilës. Shoku i vetëm i Zekait ishte Resmi Efendi. Ai kishte marr lejen dhe bekimin nga Izzet Efendi që t'i qëndronte pranë Zekait.

Resmi Efendit i kishte vdekur babai që në moshë të vogël. Vëllai i tij i madh e humbet gjithë pasurinë e trashëguar nga babai duke pirë dhe duke luajtur bixhoz. Vëllai i tij vdes nga pirja e tepërt e alkoolit. Resmiu mbetet i vetëm me nënën plakë.

Nëna plakë për të ruajtur atë pak pasuri që i kishte mbetur dhe për t'i siguruar një të ardhme sa më të mirë djalit shet edhe pronën e fundit që kishte dhe ato para që fiton i kthen në monedha floriri duke thyer çdo muaj nga një monedhë për të jetuar. Me shpresën që të shtynte jetesën deri sa të rritej Resmiu dhe të mbante veten me punë.

Resmiu e tregon veten dhe që në moshë të re fillon të fitojë para. Madje shkrintari shkruan se nëse do kishte lindur në Francë, Resmiu do ishte bërë i famshëm dhe i pasur që në moshë të vogël., por ai kishte lindur në Stamboll.

Resmiu me forcat e tij arrin të mësojë greqisht dhe frëngjisht. Pikërisht në çastet që Resmiu po bëhej i aftë të punonte i vdes e ëma. Duke qenë se ishte ende i vogël detyrohet që Hesnan, të cilën ia kishte lënë amanet e ëma ta çoj në pallatin e Bahtijar Pashës.

Përveç gjuhëve të mësipërme Resmiu me vullnetin e tij mëson edhe gjermanisht, ruisht dhe anglisht. Për më tepër që ishte një gjeni i lindur në shumë fusha të tjera.

Një ditë e dërgojnë të rregullojë një organo në një kishë në Bejoglu. Gjatë rregullimit ai njihet me një familje të pasur armene dhe bëhet miq me ta.

Familja Arslangozjan ishte një nga familjet më të respektueshme në shoqërinë armene. Hamparsun Arslangozjan ishte një njeri që kishte kaluar rininë e tij në qendrat e argëtimit të Stambollit, por edhe të kryeqyteteve të tjera të Evropës si Paris, Vjenë, Shën Petërsburg. Edhe pse kishte shpenzuar shumë para, kur kthehet në Stamboll ai prapë ishte mjaft i pasur sa të futej në shoqërinë e lartë të kohës. Në moshë të thyer ai martohej me një vajzë të re shtatëmbëdhjetë vjeçare që kishte mbaruar një kolegji francez në Stamboll. Ngaqë që të dy e njihnin stilin e jetesës perëndimore edhe shtëpinë e tyre e kishin rregulluar në të njëjtën mënyrë dhe jetonin me të njëjtin stil jetese si francezët.

Vajza e re ishte martuar me Hamparsunin, i cili ishte afër të pesëdhjetave, për paratë që kishte dhe jo për gjë tjetër. Edhe Hamparsuni e dinte këtë gjë, por nuk është se e vriste mendjen. Madje Hamparsuni si një njeri i dalë, jo vetëm që nuk e mbante gruan të mbyllur, por e nxiste të vishej sa më bukur dhe me sa më shumë pompozitet. Si rregull i jetesës së shoqërisë së lartë franceze ata flinin në dhomat ndryshme.

Vajza e re ishte jo vetëm shumë e bukur, por edhe me shumë stil pasi kishte mbaruar një shkollë franceze. I vetmi cen i gruas së Hamparsunit ishte se qeshte me të madhe vend e pavend.

Resmiu e fton Zekain të njihet me këtë familje të shquar. Pasi njihen me familjen ata bëhen miq., por Zekai bie në dashuri me gruan e Hamparsunit. Duke menduar që gruaja nuk do ta refuzonte dot pasi e mbante veten si shumë simpatik dhe të kulturuar ai i shkruan një letër ku i shpreh dashurinë që kishte për të., por ndryshe nga parashikimet e tij ajo jo vetëm që e refuzon, por edhe i kërkon në mënyrë të kulturuar që të mos e provonte më një gjë të tillë., por Zekai nuk i jep shumë rëndësi këtij refuzimi duke e quajtur thjeshtë një naze të kësaj vajze të re.

Në të njëjtën kohë njihemi më pallatin e Bahtijar Pashës. Bahtijar Pasha ishte një njeri i pasur me katër gra. Ai ka një vajzë shumë të shëmtuar, Shehnazi, e cila mendon se është e bukur. Ajo është rritur mes gjithë të mirave me mësues privat dhe shërbëtorë. Një nga shërbëtorët është edhe Hesnaja që ja ka lënë amanet Resmiu.

Edhe Shehnazi edhe Hesna janë të dhëna pas leximit të romaneve., por që të dyja kanë interesa të ndryshme në leximin e romanit. Shehnazi duke lexuar romanet fantazon gjëra jo të këndshme. Kurse Hesna mundohet të nxjerr mësim nga ato që lexon.

Pas këtyre shpjegimeve fillojnë edhe ngjarjet kryesore. Një mikeshë e zonjës Hamparsun i tregon Resmiut se kishin dalë fjalë që ai ishte i dashuruar me zonjën dhe se kishin një lidhje. Resmiu ndihet në siklet pasi ai e dinte që ishte e pavërtetë dhe se ishin thashetheme.

Me bisedat që zhvillohen në vilën e Hamparsunit fillojnë të dalin në pah diferencat mes mentalitetit që kishin shoqëria jo myslimane e kohës me atë myslimane. Edhe pse autori nuk shpreh preferencë. Në të njëjtën kohë ne kemi edhe një vështrim të atyre që ndodhin nëpër dhomat e gjumit të shërbëtorëve jo mysliman në pallatin e Bahtizar Pashës duke treguar për orgjitë që ndodhnin mes tyre.

Ndërsa Resmiu ndihej në siklet për fjalët e përhapura, znj. Hamparsun nuk e vret fare mendjen. Zekai, i cili dëgjon thashethemet e dala i bën presion se do e zbulojë para të gjithëve lidhjen e tyre nëse nuk merr atë që dëshiron., por znj. Hamparsun prapë nuk e vë ujë në zjarr dhe e vazhdon shoqërinë me Resmiun.

Një pjesë e ngjarjeve të romanit kalojnë edhe në Kagëthane. Një vend i preferuar për kohën nga shoqëria e Stambollit. Zekai, i cili nuk po ia arrinte qëllimit të tij me znj. Hamparsun fillon të shoqërohet me Elenin. Eleni ishte një konkubinë e njohur e cila gjatë natës ishte e dashura e Nizamit, një njeri të pasur, por të martuar. Ndërsa gjatë ditës shoqërohej me Zekain.

Gjatë kësaj kohe në pallatin e Bahtijar Pashës po thureshin intriga të reja. Mësuesja e Shehnazit po mundohet të rregullonte Zekain që t'i propozonte për martesë. Ndërsa Zekai shkonte në pallatin e Bahtijar Pashës për një qëllim tjetër. Ai ishte i fiksuar pas Hesnas., por Hesna i njihte këta tipa nga romanet që kishte lexuar dhe nuk e afron.

Një ditë letrën që Zekai ja nis Hesnas, me ndihmën edhe të Resmiut ja dërgojnë Shehnazit. Duke qenë se letra nuk kishte emër ajo mendon se ja ka nisur asaj dhe me vrap ja tregon mësueses së saj. Mësuesja, Madamë Marsak, duke përfitur nga rasti që i jepet ja jep këtë letër Pashait. Pashait i pëlqen si ide. Zekai i tronditur me zhvillimin e ngjarjeve nuk arrin të dalë kundra martesës me Shehnazin.

Lidhja e miqësisë mes znj. Hamparsun dhe Resmiut sa vjen e bëhet më e fort. Në këtë kohë fillojnë përgatitjet që bëheshin për sezonin e karnavaleve. Ata duan të shkojnë bashkë në karnavale., por ka një problem. Normalisht ajo duhet të shkojë në karnavale me burrin e saj të moshuar. Ajo nuk do arrij as të kënaqet dhe as të takohet me Resmiun. Kështu që vendos të shkojë vetë. Duke përfitur që nëpër karnavale njerëzit mbajnë maska ajo nuk do kishte problem të qëndronte lirshëm me Resmiun. Për herë të parë znj. Hamparsun fillon të thur plane duke dal nga karakteri fëmijërorë dhe i pafajshëm që kishte deri në këtë çast.

Ajo i kërkon Resmiut që ta shoqërojë në karnavale. Resmiu edhe pse e kupton sa detyrë të vështirë kishte nuk e refuzon. Për më tepër që mendon se po i bën një nder zonjës., por thellë brenda vetes edhe ai ndjen tërheqje ndaj zonjës.

Natën e ballos Resmi u merr pjesë së bashku me znj. Hamparsun dhe Kypelijan. Në ballo marrin pjesë edhe Zekai me Elenin. Zekai e njuh znj. Hamparsun. Me sy të errësuar nga inati që ajo nuk e kishte pranuar ofertën e tij ai tenton t'ia nxjerr në shesh marrëdhënien me Resmiun., por Resmiu tregohet më i shpejt dhe e pengon.

Zjn. Hamparsun largohet nga balloja me Resmiun duke shkuar në shtëpinë e saj. Atje ajo kalon natën me Resmiun. Zekai nuk dorëzohet, por këtë herë tenton të informojë z. Hamparsun për lidhjen që ka gruaja e tij me Resmiun. Z. Hamparsun nuk e merr seriozisht këtë informacion fillon të dyshojë dhe fillon ta ruaj më nga afër gruan e tij.

Por zonja e kupton dhe fillon të ruhet më shumë. Zonja e rregullon me shërbëtoren Marika dhe zonjën Kypelijan që ta fus Resmiun fshehurazi në shtëpi. Në këtë mënyrë pasi të mbaronte mësimet Resmiu do fshihej tek dhoma e Marikës dhe pasi të flinin të gjithë do të takohesh me zonjën. Në fillim Resmiu dyshon për besnikërinë e Marikës, por më pas pranon dhe kështu takoheshin tri herë në javë.

Zekai tërbohohet që nuk arrin të prishë lidhjen e Resmiut, por i ka duart e lidhura për momentin. Në të njëjtën periudhë në pallatin e Bahtijar Pashës ka zhvillime të reja.

Shehnazi i sheh mësueses së saj një libër me figura të turpshme dhe ja kërkon., por mësuesja nuk ja jep. E zemëruar Shehnazi në një çast të përshtatshëm i thyen derën e dhomës së madamë Marsakut dhe i kontrollon dhomën, por nuk gjen asgjë. Në vend të kësaj ajo gjen një raft të kyçur në dollap. E hap shikon që aty kishte veshje për ballo. Shehnazi e kupton që madamë Marsaku ka shkuar në ballo dhe kërkon që të shkojë edhe ajo.

Gjithë pallati përveç Bahtijar Pashës dhe gruas së tij e mëson këtë gjë. Një natë pasi i kishte zënë gjumi këta të dy, të gjithë me në krye Shehnazin shkojnë në karnavalet e organizuara.

Në të njëjtën ballo marrin pjesë edhe znj. Hamparsun me Resmiun. Pas një informacioni që kishte marr edhe z. Hamparsun shkon në këtë ballo. Kështu që të gjithë personazhet kryesorë të romanit mblidhen në të njëjtin vend.

Z. Hamparsun në një çast xhelozie i hidhet përsipër një gruaje që dyshon se është gruaja e tij. Resmiu e kupton menjëherë situatën dhe largon me shpejtësi znj. Hamparsun nga balloja duke e çuar në shtëpi. Ajo sillet sikur nuk ka ndodhur asgjë. Ndërsa z. Hamparsun është i mërzhitur për sjelljen e tij, por është i lumtur me faktin që gruaja e tij nuk ishte në ballo. Resmiu ishte treguar i kujdesshëm dhe pasi kishte dalë me znj. Hamparsun e kishte ndryshuar veshjen me një tjetër.

Shehnazi me shërbëtorët dhe mësuesit e saj e vazhdojnë ballon. Më pas ato marrin një ofertë për ta vazhduar festën në një apartament pak më larg. Kur shkojnë atje e kuptojnë që janë rrëmbyer. Mes rrëmbyesve ishin edhe shërbëtorët Serafino dhe Viktor Hag.

Viktor Hag i merr financierit Mosje Kodoshit çelësat e arkës së thesarit në pallat. Shkon në pallat natën dhe merr pesëmbëdhjetë mijë monedha floriri nga aty. Paratë i ndajnë. Serafino ishte i dashuruar me Madamë Marsakun dhe i propozon asaj të largohen bashkë. Duke menduar që po të kthehej në pallat do të dëbohej, e pranon ofertën.

Në pallat merret vesh për mungesën e Shehnazit, por ajo kthehet vetëm pas një dite bashkë me Mosje Kodoshin. Serafino, Viktor Hag dhe Madamë Marsak nuk gjenden. Pashai dëbon edhe Madam Gabatin dhe Sofinë. Madje ai e nxjerr për shitje edhe Hesnan pasi Shehnazi e akuzon se e ka nxjerr nga rruga e drejtë.

Resmi kalon aty pranë sikur nuk dinte gjë dhe e blen menjëherë Hesnan duke e çuar në shtëpinë e tij. Mes të dyve lind një ndjenjë afërsie, por asnjëri nuk e shpreh.

Z. Hamparsun i turpëruar nga ballo dhe i sigurt që gruaja e tij nuk e kishte tradhtuar shkon të takoj Zekain për t'i kërkuar llogari. Zekai nuk heq dorë nga mendimi i tij madje i tregon edhe për burimin e tij të sigurt për këto informacione. Ajo ishte Marijanka, shërbëtorja e zonjës. Nëse nuk i besonte le t'i ofronte para shërbëtores dhe do e shikonte me sytë e tij.

Z. Hamparsun ia prish mendjen shërbëtores duke i dhënë para. Një natë, pasi mbarojnë darkën dhe të gjithë tërhiqen në dhomat e tyre z. Hamparsun fillon të presë me durim. Në mes të natës ai i drejtohet dhomës së gruas së tij. Pasi dëgjon zëra brenda në dhomë ai tenton të futet brenda duke u përpjekur të hapë derën e mbyllur.

Resmiu me anë të një litari largohet nga dritarja. Kur z. Hamparsun futet në dhomë nuk gjen njeri., por duke qenë i sigurt që në dhomë kishte qenë një mashkull e rreh gruan e tij për vdekje.

Pas kësaj nata ai ndan gruan. Tashmë ish znj. Hamparsun është e shkatërruar si shpirtërisht ashtu edhe ekonomikisht. Mendon të vetëvritet, por e ndalon mikja e saj znj. Kypelijan. Ndërsa z. Hamparsun për të harruar dhe për ta bërë të vuaj më shumë ish gruan e tij, tenton të martohet me një vajzë tjetër më të re., por duke qenë se ishte katolik nuk ia lejon feja. Megjithatë ai e rregullon këtë gjë në mënyrë jo zyrtare duke e marrë vajzën e re në shtëpi si ndihmëse.

Nga ana tjetër ish znj. Hamparsun, nga një anë refuzon ofertat që i bëhen për lidhje, përfshi edhe Zekain, nga ana tjetër është shumë në merak për Resmiun, nga i cili nuk ka marr ende asnjë lajm dhe nuk është bërë i gjallë.

Pas shumë kohësh Resmiu del në skenë dhe vjen e takon me barelë. Atë natë, kur po largohej nga dritarja me litar, ai ishte rrëzuar dhe kishte pësuar dëmtime serioze. Ai kishte mbetur në shtrat për shumë kohë. Gjatë kësaj periudhe Hesna e kishte ndihmuar shumë duke i qëndruar natë e ditë tek koka e krevatit. Gjatë kësaj periudhe edhe ndjenjat e tyre mes njëri-tjetrit ishin shtuar.

Në të njëjtën kohë Zekai martohet me Shehnazin. Pas martesë babai i Zekait Izet Efendi mëson se në llogaritë e tij mungonin 50 000 lira. Kuptohet që këto i kishte marr Zekai. I tronditur nga vjedhja prej djalit të tij, i cili në fund të fundit do i trashëgonte të gjithë këto para pasi ishte djalë i vetëm, Izet Efendi sëmuret dhe pak më vonë vdes. Zekai bëhet shumë i pasur brenda një dite duke mos pasur asnjë njeri që t'ia kufizonte shpenzimet që dëshironte të bënte.

Zekai edhe pse martohet me Shehnazin e vazhdon lidhjen që kishte me Elenin. Madje së bashku me Elenin niset për një udhëtim në Evropë. Kjo ishte një gjë e padëgjuar më parë. Megjithatë udhëtimi në Evropë Zekait i del për hundësh. Përveç se humbet gjithë pasurinë ai humbet edhe Elenin e cila lidhet me një pasanik Amerikan dhe qëndron në Evropë.

Pasi kthehet në Stamboll Zekai mundohet të fshihet nga borxhlinjtë., por lajmëtarët e borxhlinjve nga Evropa e gjejnë edhe këtu. I shtrënguar nga ata Zekai detyrohet të grabis dhe shesë stolitë e Shehnazit. Bahtijar Pasha e kap dhe e detyron të ndahet nga Shehnazi.

I dëbuar edhe nga shtëpia e vjehrrit Zekai përfundon në çmendinë. Pasi del prej aty një ditë hipën në majën e një minareje dhe vret veten duke u hedhur nga aty.

Z.Hamparsun, i cili u përpoq të martohej me një vajzë të re, shumë shpejt pendohet. Ajo që u mundua ta merrte si grua pas vetëm disa muajsh fillon ta tradhtojë. Madje jo me një, por me dy meshkuj njëkohësisht. Z.Hamparsun e mëson në mënyrën më të turpshme të mundshme këtë gjë. Dy dashnorët e gruas përplasen me thika në shtëpinë e tij duke e marr vesh gjithë Stambolli. Pas kësaj ngjarjeje z. Hamparsun pëson një infarkt në zemër dhe vdes.

Pas vdekjes së z. Hamparsun pasuria e tij i kalon ish gruas. Znj. Hamparsun vendos t'i dhurojë për bamirësi paratë dhe vetë të bëhet murgeshë. Marrëdhënia mes saj dhe Resmiut nga lidhje dashurie ishte kthyer në miqësi. Tashmë që vendosi të bëhej murgeshë nuk do të kishin asnjë mundësi të rifillonin atë lidhje që kishin pasur. Pasi qetësohen gjërat Resmiu martohet me Hesnan që e dashuronte.

### **Dashuria për karrocën (1886)**

Romani “Dashuria për karrocën” i shkrimtarit Rexhai-zade Mahmut Ekrem u shkruajt në vitin 1886, por për herë të parë u botua në revistën Servet-i Funun me pjesë në vitin 1894-1895 (në numrat 258-291). Nga shumë studiues mbahet si romani i parë realist në letërsinë turke.

Në fillim të romanit jepet një përshkrim i detajuar i zonës Çamllëxha (një zonë e famshme e Stambollit ku zhvillohen ngjarjet edhe në disa romane të tjera turke të kohës). Më pas njihemi me Bihruz Beun.

Bihruz Beu ishte një djalë që kishte pasur çdo gjë në jetë. Ai ishte djali i një Pashai. Për shkak të detyrave që merrte i ati kishte shëtitur në shumë vende. Edhe pse kishte mësuar me mësues privatë nuk kishte arritur të ecte shumë përpara. Duke qenë fëmijë i vetëm ai ishte një djalë shumë i llastuar.

Pas vdekjes së babait atij i mbetet trashëgim një pasuri e madhe. Kështu që ai vazhdon t'ia plotësojë vetes çdo dëshirë. Bihruzit i pëlqente të kujdesej për veten, të shëtiste në vendet më në modë dhe të fliste me mësuesit e tij duke bërë si i ditur. Kur Bihruzi kthehet përfundimisht në Stamboll ai ishte rritur duke u bërë një djalosh shumë kurioz. Për të prezantuar veten sa më mirë ai shëtiti me karrocën me kalë që e ka zbukuruar me merak dhe u flet frëngjisht të gjithë atyre që njeh. Si gjithë ata që preferonin të jetonin me stilin Evropian edhe Bihruz Beu dimrin e kalonte në vilën e tij në Sulejmanije ndërsa në verë transferohej në vilën e tij në Kyçyk Çamllëxha.

Kudo që të shkonte Bihruz Beu mundohej të nxirrte në pah pasurinë dhe aftësitë që ai besonte se i kishte marr duke u treguar si modern. Për këtë qëllim ai i shpenzonte pa hesap pasuritë që i kishte trashëguar nga i ati.

Nëna e tij nuk i ndërhynte shumë në vendimet që merr dhe vetëm kur e sheh që e tepron i jep ndonjë këshillë. Gjatë kësaj kohe mësuesit e tij të arabishtes dhe persishtes, kur shohin se Bihruzi nuk kishte ndonjë dëshirë të madhe për të mësuar dhe për më tepër ishte i papërqendruar në mësim, largohen. Vetëm Mosje Pier, mësuesi i frëngjishtes, vazhdon të jap mësim frëngjishteje edhe pse Bihruzi nuk mësonte. Madje ai ishte më i interesuar që ai të mos mësonte frëngjisht pasi kështu do vazhdonte të përfitonte nga padituria dhe injoranca e Bihruz Beut.

Bihruz Beu për shkak të njohjeve të familjes së tij fillon punë në një zyrë shtetërore. Duke qenë se kishte miq ai dilte kur t'i tekej nga zyra. Madje me raste edhe nuk vinte fare në punë.

Shpenzimet e mëdha dhe pa fund që bënte Bihruz Beu bënë që pasuria e tij e madhe pak nga pak të fillonte të shkrihej. Me kalimin kohës ai jo vetëm që shet gjithë tokat që kishte trashëguar nga i ati, por shet edhe dyqanet që kishte në Bejoglu. Në fund ai mbetet vetëm me vilat dimërore dhe verore si dhe pak para nga shitja e dyqaneve.

Por edhe pse pa shumë para Bihruzi nuk e vret mendjen. Ai vazhdon me shpenzimet sipas qefit. Ai nuk mund ta kuptojë jetën pa luks dhe shpenzime. Për këtë arsye ai blen dy kuaj hungarezë (kuajt më të bukur dhe pompoz të kohës) dhe një karrocë të re të markës "Bender" marka më e shtrenjtë e kohës. Kjo karrocë përveç se ishte shumë e shtrenjtë ishte zbukuruar edhe me pjesë të tjera ekstra.

Bihruz Beut i pëlqente të shëtiste me karrocën e tij të re në vendet më në modë të Stambollit për të treguar veten. Gjatë një prej këtyre shëtitjeve në Çamllëxha ai takohet me Keshfin, një nga shokët e tij të punës dhe fillojnë të shëtisin bashkë. Gjatë shëtitjes u ngelet syri tek një karrocë shumë e bukur dhe luksoze.

Nga pamja luksoze karroca e tregonte se brenda saj ishte një femër e një sërë të lartë. Bihruz Beu hidhet menjëherë dhe shkon të shikojë kush ishte brenda. Brenda ishte një zonjë me flokë të verdha. Nga sjelljet dhe biseda që ajo zonjë bën me shoqen e saj Bihruz Beut i krijohet përshtypja që ajo është e tërhequr nga ai., por ajo nuk i përgjigjet pyetjes se kur do të vinte sërish në shëtitore.

Bihruz Beu menjëherë bie në dashuri me këtë femër të bukur. Kjo femër, e quajtur Perivesh, jo vetëm që nuk ishte e një sërë të lartë dhe nga një familje me traditë dhe fisnike, por ishte nga një familje e varfër dhe për më tepër ajo shoqërohej me znj. Çengi, një grua të ndarë nga burri që shiste trupin e saj.

Atë ditë që Bihruzi i sheh Periveshi po tallej me të., por Bihruzi i dashuruar kokë e këmbë nuk kupton asnjë nga këto tallje. Ai i interpreton sjelljet e kësaj gruaje sipas fantazive të tij dhe gëzohet ose trishtohet sipas rastit.

I dashuruar me këtë biondinë Bihruzi vendos t'i dërgojë edhe një letër dashurie., por kjo letër s'mund të ishte një letër e thjeshtë dashurie. Ai dëshiron që edhe kjo letër dashuri të mbarte në vetvete modernizmin dhe dijet Evropiane që pretendonte se dispononte. Për këtë arsye ai vendos që të përdorë pjesë nga librat Nouvelle Heloise dhe Secrateri des Amants të Jean Jacques Rousseau. Kuptohet që ai do t'i ndryshonte pak nga origjinali dhe do të linte pjesë frëngjisht në të.

Kjo letër del një katrahurë i vërtetë., por Bihruzi ja vë fajin pamjaftueshmërisë së gjuhës turke për të shprehur këtë ndjenjë të fortë. Për ta bërë sa më të pranueshme ai i vizaton një trëndafil letrës me erë të mirë që kishte zgjedhur për të shkruar. Për më tepër vendos që t'i shtojë edhe disa vargje nga një poezi dashurie që i pëlqen., por përkthimi i poezisë në turqisht del pa shumë kuptim. Ndoshta edhe për shkak të paaftësisë së tij dhe mësuesit të tij francez. I zhgënjyer nga përkthimi i poezisë Bihruz Beu i drejtohet letërsisë vendase. Gjen një libër me poezi të poetit Enderunli Vasif, të cilit i kishte dëgjuar emrin. Edhe pse nuk e kupton atë që shkruhet pasi poezitë ishin me shumë fjalë arabe dhe perse, me ndihmën e fjalorit mundohet të vendosë për një nga poezitë.

Pas përpjekjeve ja del mbanë të përgatisë një letër dashurie dhe ia jep Periveshit. Periveshi së bashku me shoqen e saj tallen haptazi me Bihruzin., por Bihruzi nuk kupton asgjë. Për ta hequr qafe, pasi ai po u rrinte nga pas, ajo pranon të marr letrën.

Bihruz Beu largohet i lumtur, duke thurur fantazi në mendjen e tij. Ndërsa gratë largohen me karrocë duke e hedhur letrën që u kishte dhënë Bihruzi.

Bihruz Beu, ditën e diel përgatit me kujdes karrocën dhe del për shëtitje në Çamllëxha. Qëllimi i tij është të takoj gruan që i kishte dhënë letrën dhe t'i shpallë asaj dashurinë., por ai nuk e takon Periveshin. I mërzitur ai ia hedh fajin mentalitetit turk që nuk është aspak korrekt.

Bihruzi nuk e mendon fare faktin që Periveshi nuk i kishte premtuar që do takoheshin. I përfshirë në fantazitë e tija Bihruzi fillon të mendojë që ka bërë gabim me letrën që i ka dhënë Periveshit. Disa nga fjalët që i ka shkruar në letër, por që nuk i kishte kuptuar i merr dhe ia tregon shokëve të punës.

Ai kupton se ka bërë një gabim, sepse një nga pjesët e poezisë edhe pse fliste për dashurinë, ishte dashuria që i shprehte një femër një mashkulli. I turpëruar ai

vendos t'i shkruaj një letër të dytë. Në letrën e dytë ai i kërkon falje për keqkuptimin., por edhe pse shëtit për 2 muaj nuk e takon Periveshin që t'i japë letrën.

Problemet nuk mbarojnë me kaq. Firma e karrocës i kërkon t'i japë pjesën e mbetur të pagesës që Bihruz Beu nuk e kishte likuiduar. Pasi kërkimet e tij mbyllën pa sukses shoku i tij Keshfi i thotë se Perishani kishte vdekur nga tifo. Në fakt Keshfi gënjen., por Bihruz Beu tronditet nga vdekja e të dashurës së tij imagjinare.

Keshfi e kishte në gjak gënjeshtren. Përveç se dëshironte të jetonte allafirënga Keshfi ishte shumë ziliqar. Ai nuk e duronte dot faktin që Bihruzi kishte një karrocë të bukur dhe për më tepër kishte një të dashur bionde.

Bihruz Beu, i përthundur në botën e tij të fantazisë fillon të besojë se vajza në fakt kishte vdekur për shkak të dashurisë që kishte pasur për të. Ndihet fajtor. Për këtë arsye ai vendos të mbajë zi për gjithë jetën. Betohet që nuk do martohet kurrë, nuk do shoh kurrë një femër tjetër, nuk do dashurohet kurrë me një femër tjetër.

Si punë të parë për të bërë ai duhet të gjejë varrin e saj. Kështu do të ketë mundësi të qaj mbi varr dhe t'i kërkojë falje. Për shkak të këtyre mendimeve Bihruz Beu fillon të ketë vegime dhe e humbet mendjen.

Një ditë gjatë kërkimeve Bihruz Beu e sheh me të vërtetë të dashurën e tij imagjinare. Gruaja ishte në anije. Ndërsa ai vetë kishte mbetur në skelë. Edhe pse përpiqet ta arrijë anijen me një barkë nuk ja arrin qëllimit. I tronditur shkon të flasë me Keshfin. Keshfi pa e prishur terezinë e gënjen përsëri duke i thënë që ajo ishte motra e saj më e madhe me të cilën ngjan si dy pika uji.

Bihruzi nuk e gjen dot varrin e të dashurës imagjinare. Për shkak të mos pagesës në kohë Bihruz Beu humbet karrocën dhe kuajt të cilat ia merr borxhliu. Me ardhjen e muajit të Ramazanit gjendja e Bihruzit përkeqësohet. Tashmë ai vendos të bëjë një jetë shumë më ndryshe se ç'kishte bërë. Fillon të falet në xhami dhe të agjërojë. Arsyeja e këtij ndryshimi është ndjenja e fajit që i ishte ngulitur në kokë. Ai beson se ishte shkaktari i vdekjes së gruas që ai dashuronte.

Një ditë Bihruzi shkëmbehet me të dashurën e tij që e mendonte të vdekur., por nuk e njeh. Tashmë ai e kishte humbur fare mendjen. Ndërsa gruaja as nuk e kishte fare idenë që personi që i kalon përpara ishte fiksuar se ishte shkaktari i vdekjes së saj nga dashuria.

I mërzhitur nga jeta Bihruzi i drejtohet leximit. Mësuesi i frëngjishtes, Mosje Pier i sjell libra të ndryshëm për të lexuar. Në një nga romanet flitet për një njeri që e humbet të dashurën e tij. Fillon të mendojë se ai ishte personazhi i këtij romani.

Një ditë ai sheh përballë Periveshin me shoqen e saj. Duke menduar se ajo është motra e gruas që dashuron i drejtohet duke i kërkuar t'i tregojë varrin e vajzës që të ketë mundësi ta vajtojë. Periveshi me shoqen e saj qeshin me të madhe dhe tallen me Bihruzin. Romani mbyllet në mënyrë të papritur me Bihruzin që mbetet në mes të rrugës me mendime të çoroditura.



## Aventura (1888)

Romani “Aventura” i shkrimtarit Samipashazade Sezai prek një temë shumë të debatueshme në shoqërinë Osmane, atë të skllavërisë. Edhe pse ligjërisht skllavëria nuk lejohej ajo lulëzonte nën emra të tjerë. Për shëmbull vajzat kur shiteshin quheshin xharije, ndërsa djemtë quheshin shërbyes., por në fakt ata shiteshin e bliheshin si skllavër.

Një vajzë e vogël së bashku me dy shoqe të tjera nga Gjeorgjia blihen nga tregtari i skllavërve Haxhi Omeri sapo anija e nisur nga Batumi<sup>77</sup> arrin në Stamboll. Tregtari i skllavërve e shet vajzën e vogël tek gruaja e një ish drejtori të taksave për dyzet florinj. Pronarja e re e vajzës i vendos asaj emrin Dilbere. Vajza e vogël merrej me punët e shtëpisë dhe e trajtonin keq. Një nga punët e vajzës ishte të shoqëronte Atifijen, vajzën e pronares në shkollë. Atje ajo fillon shoqërinë me një vajzë të quajtur Latife. Vajza e zonjës duke parë si e trajtonte e ëma dhe shërbëtori arab fillon ta trajtojë keq Dilberen. Sjelljet e këqija ndaj vajzës vazhdojnë me rrahjet dhe poshtërimet e vajzës së vogël. Pas shumë muajsh poshtërimesh dhe rrahjesh vajza e vogël vendos të largohet dhe një natë pa hënë arratiset nga shtëpia.

Natën pasi ecën pa e ditur se ku i bien të fikët. Të nesërmen kur i hap sytë e gjen veten në një krevat e mbuluar dhe një plakë pranë shtatit. Plaka ishte gjyshja e Latifes. Pasi mëson për vuajtjet e vajzës ajo shkon dhe i kërkon Mustafa Efendit, pronarit të vajzës që t’ia shesë asaj., por Mustafa Efendi i xhindosur nuk pranon. Më pas ai dërgon Hoxhën e lagjes që të marr vajzën nga plaka. Në çastin që vajza mendon se fati e ka harruar ai i buzëqesh përsëri. Mustafa Efendi, të cilin e kishin larguar nga puna me akuzën e korrupsionit, fiton gjyqin dhe emërohet nënprefekt në një provincë të largët të Anadollit. Për të përballuar borxhet dhe shpenzimet e udhëtimit ai e shet vajzën (Dilberen) tek një tregtar skllavërisht.

Në shtëpinë e madhe të tregtarit të skllavërve Dilberi kalon disa ditë pastaj shitet tek një zonjë për herë të dytë. Ndryshe nga familja e parë ku trajtohej shumë keq në këtë shtëpi të re ajo trajtohej shumë më mirë. Familja e Asaf Pashës, e cila ishte shumë më e ngritur dhe më e pasur, jetonte në një vilë të madhe dhe të bukur. Asaf pasha kishte qenë me poste të larta drejtuese në Egjipt dhe prej andej ishte kthyer me një pasuri shumë të madhe në Stamboll. Dilberi edhe pse ishte shumë më mirë në këtë familje prapë se prapë e ndjente pozitën e saj si skllave dhe për më tepër që nuk i hiqej nga mendja vuajtja që kishte kaluar në shtëpinë e parë. Këtu Dilberi nuk arrin të jetë e qetë. Ajo kthehet në një lodër e Xhelalit, djalit të shtëpisë. Xhelali ishte një djalë 23 vjeçar i përkëdhelur nga jeta. Nuk kishte vuajtur për asgjë pasi babai i tij ia kishte plotësuar gjithë dëshirat. Ai kishte studiuar disa vite në Paris për pikturë që ishte pasioni i tij më i madh.

Xhelali e përdorte Dilberen si modele për të bërë piktura të ndryshme., por gjatë këtyre çasteve kur ata qëndronin vetëm Xhelali, i cili deri më atëherë edhe pse kishte pasur lidhje me femra të ndryshme nuk kishte rënë në dashuri, fillon të ndjej diçka që nuk e kishte ndjerë më parë për një femër. Xhelali me kalimin e kohës kupton që ka rënë në dashuri me Dilberen e cila për shkak të jetesës së qetë dhe pa rrahje si dhe zhvillimit që kishte nga adoleshenca ishte zgjatur dhe zbukuruar.

---

<sup>77</sup> Qytet port në Gjeorgjinë e sotme.

Kjo dashuri është diçka e pamundur. Qoftë nëna e qoftë babai i Xhelalit mendojnë se fëmijët e tyre duhet të martohen me njerëz të sërës së tyre ose të një rangu më të lartë. Madje në të njëjtën kohë ata sapo kishin fejuar vajzën e tyre Teslijen me një pasha shumë të pasur.

Dashuria që Xhelali kishte për Dilberen ishte reciproke. Një natë Xhelali kur nuk po e zinte gjumi shkon në dhomën e Dilberes dhe e sheh që po flinte me një pikturë të tijën në krah. I lumtur që dashuria e tij pranohej nga Dilberja ai fluturon nga gëzimi. Në të njëjtën kohë mbyllet në vetvete i trishtuar pasi e dinte pamundësinë e realizimit të kësaj dashurie në martesë. Ai fillon të debatohet me nënën dhe kushërinjtë e tij duke kundërshtuar martesën e rregulluar nga prindërit pa u pyetur më parë vetë fëmija., por që të gjithë i dalin kundër duke pretenduar që nuk mund të martohet një njeri i një sere të lartë me një të një sere më të ulët.

Xhelali nuk do t'ia dijë. Në një nga netët pa gjumë që po kalonte ai zbret poshtë dhe sheh Dilberen që po qëndronte në ballkon duke parë hënën. Që të dy largohen nga vila dhe kalojnë natën në mes të natyrës duke parë njëri-tjetrin të lumtur. Ata nuk ja shprehin njëri-tjetrit dashurinë. Kur fillon të zbardh nisën për tu kthyer në shtëpi, por ishin larguar shumë. Gjatë rrugës kalojnë pranë një varreze ku shohin varrin e një vajze të re. Vajza e re dhe e varfër 18 vjeçare kishte vvarë veten pasi djali i pasur me të cilin ishte dashuruar e kishte thyer premtimin e dhënë dhe ishte martuar me një grua tjetër.

Në të njëjtën kohë nëna e Xhelalit, znj. Zehra, shikon që Xhelali nuk është në dhomën e tij të gjumit. Kur shikon se edhe Dilberja nuk ishte në dhomë asaj i bien të fikët nga zemërimi. Ajo mendon se qëndrimi i Xhelalit me Dilberen, një skllave të pavlerë, do i prishte planet për ta martuar djalin e saj me një vajzë të sërës së lartë. E tmerruar nga ky mendim ajo flet me burrin e saj dhe vendos që ta largojë Dilberen pa i treguar gjë Xhelalit.

Të nesërmen Xhelali nis për në Stamboll për një punë. Pasi ai nis znj. Zehra thërret tregtarin e skllavëve dhe i thotë të marrë Dilberen me vete pasi ajo i kishte prishur nderin dhe imazhin e familjes. Tregtarja të nesërmen në mëngjes futet në dhomën e Dilberes dhe i thotë të shkojë me të sepse e kishin shitur. Dilberja e tronditur i shkon nga pas, por para se të largohet i jep një skllaveje tjetër të unazë të thjeshtë që t'ia japë Xhelalit.

Xhelali i pa informuar për këto gjëra habitet që Dilberja nuk e takon kur kthehet në vilë. Kur skllavja vjen t'i pastrojë atelienë ai e pyet pse nuk ka ardhur Dilberja. Kur mëson se Dilberja ishte shitur ai pëson një shok dhe bie menjëherë pa ndjenja në dysheme.

Kur znj. Zehra shikon vuajtjen e Xhelalit pendohet për veprimin e kryer., por burri i saj i thotë që të mos e dorëzohet menjëherë pasi Xhelali do e marr veten. Besimi i babait të Xhelalit del i gabuar. Pasi e merr pak veten Xhelali fillon ta kërkojë Dilberin. Ai fiksohet aq shumë pas këtij kërkimi sa që me kalimin e kohës çmendet.

Ndërsa Dilberja shitet tek një tregtarë shumë i pasur në Egjipt. Ajo bëhet pjesë e haremit të tregtarit, por nuk pranon që ai të kalojë natën me të. Një nga shërbëtorët e haremit është Xhevheri. I bërë eunuk që në vogëli ai kishte mundësi të shëtiste lirshëm në haremin e tregtarit.

Edhe pse eunuk ai bie në dashuri me Dilberin dhe mundohet ta ndihmojë. Pasi mëson se Dilberi ishte e dashuruar me një tjetër vendos që ta ndihmojë të arratiset., por fati nuk e ndihmon Dilberin. Fakti që nuk shkoi në shtrat me pronarin e saj bën që ajo të burgoset në një dhomë të errët të pallatit ku jetonte tregtari. Megjithatë Xhevheri gjen një mundësi dhe arrin të futet nga dritarja dhe ta nxjerrë Dilberin prej andej., por gjatë arratisjes Xhevheri vdes. Dilberi e mbetur pa mbështetje në Egjipt vendos të vrasë veten përpara se të bëhet pre e dëshirave të pronarit të saj. Ajo hidhet në ujërat e Nilit dhe vdes.

### **Mushahedat (1890)**

Për romanin “Mushahedat” shkrimtari Ahmet Mid’hat Efendi shprehet se është një përpjekje e tij për të bërë një roman të rrymës natyraliste. Romani është i përbërë nga 8 kapituj (libra) dhe çdo kapitull ka nga një ngjarje kryesore që i jep emrin këtij kapitulli. Shkrimtari jep shumë hollësi dhe informacione të cilat ndoshta do ta lehtësonin shumë volumin e romanit po të hiqeshin.

Romani fillon në tragetin që lëviz nga Bejkozi në Stamboll. Shkrimtari edhe pse ka në mendje të shkruaj një roman natyralist nuk interesohet fare për ambientin përreth. Pasi futën në traget ulën në një pjesë ku ishin ulur tri gra. Edhe pse një nga gratë u tha se është pjesë ku ulen vetëm femrat ata nuk lëvizën.

Përballë tyre janë ulur dy vajza të reja, njëra bionde dhe tjetra ezmere dhe një grua e moshuar që qëndron në mes. Duke menduar që shkrimtari nuk di frëngjisht fillojnë të flasin mes tyre. Biseda e tyre i tërheq vëmendjen shkrimtarit. Sidomos kur pas një fjale vajza ezmere ngrihet dhe shkon në pjesën e pasme të tragetit dhe pasi e godet disa here me shpulla një zotëri simpatik kthehet sikur s’ka ndodhur gjë në vendin e saj. Shkrimtari dëshiron të flas me këto femra, por në traget nuk gjen mundësi. Pasi zbresin në tokë shkrimtari i ndjek dhe pasi i sheh të futen në një shtëpi në rrugicat e pasme të Bejoglu i dërgon gruas një kartëvizitë duke kërkuar një takim.

Gruaja e cila kishte lexuar më parë librat e shkrimtarit pranon të takohet. Emrin e kishte Siranush dhe ishte Armene. Në fillim flasin rreth letërsisë. Pasi ndahen ata vendosin të takohen përsëri ditën tjetër. Pas bisedës në përgjithësi ata flasin për ngjarjen në traget. Për të pasur një panoramë sa më të gjerë dhe të besueshëm ai vendos të flasë edhe me personazhet e tjerë të ngjarjes.

Një ditë tjetër shkrimtari shkon të takojë Refetin, ndihmësin e një tregtari. Pa i thënë që kishte folur me Siranushin hap bisedën në lidhje me ngjarjen e ndodhur. Refeti jo vetëm që ia konfirmon ngjarjen ashtu si i kishte thënë Siranushi, por i plotëson edhe disa pjesë të tjera të ngjarjes. Madje Refeti i thotë se nëse dëshironte mund ta prezantonte me Siranushin. Shkrimtari mbetet keq pasi nuk i kishte treguar që e njihte. Pasi takohet prapë me Siranushin bie dakort me të që t’i thonë Refetit që janë takuar një herë rastësisht. Siranushi i tregon shkrimtarit për lidhjen që kishte shoqja e saj Avagni me Refetin.

Gjatë takimit shkrimtari të cilit kishte filluar t’i pëlqejë Refeti i tregon të vërtetën. Madje në këtë takim ai i tregon që e di edhe për lidhjen e tij me Avagni. Shkrimtari i kërkon të mësojë edhe historinë e Avagnit.

Shkrimtari vazhdon me shkrimin e romanit paralelisht me punën e tij në gazetë. Informacionet që merr i shkruan në shtëpinë e tij në Bejkoz. Gjithë informacionet e mbledhura ja tregon grave në një takim tjetër. Në të njëjtin takim mëson për jetën e Avagnit që nga fëmijëria.

Babai i Avagnit ishte një italian i quajtur Antonio Kolario. Ai martohet me një vajzë të re Armene të fesë katolike të quajtur Novart. Pas martesë ai mëson se Novarti është shtatzënë me një tjetër burrë. Për shkak të fesë nuk e ndan gruan, por jetojnë në dhoma të ndryshme.

Novart pasi lind fëmijën e parë që quhet Karnik mbetet prapë shtatzënë me një tjetër mashkull. Këtë herë ajo sjell në jetë një vajzë që e quan Takuhi. Pasi mëson për tradhtinë e dytë Antonio tërbohohet nga inati. Ai fillon të jetojë me shërbëtoreshën e shtëpisë, Marian. Nga lidhja e tyre lind një vajzë me emrin Avagni. Pas vdekjes së Antonios pasuria e tij ndahet mes Novartit dhe Maries.

Maria e cila ishte një grua e ndershme e dërgon vajzën në një shkollë murgeshas dhe pastaj tërhiqet nga jeta publike duke bërë një jetë eremiti. Kur Avagni mbush dymbëdhjetë vjeç Maria vdes. Deri në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare Avagni jeton në shkollën e murgeshave.

Më pas ajo jeton në një hotel. Pasi arrin moshën tetëmbëdhjetë vjeçare ajo mbaron shkollën dhe merr pasurinë që i takonte duke shpëtuar nga jeta ndrydhëse që kishte bërë në shkollën e murgeshave. Ajo fillon të jetojë argëtimet dhe kënaqësitë e kohës.

Shkrimtari e kishte mbyllur këtu jetën e Avagnit., por ajo i jep informacion tjetër. Ajo i tregon për fatin që patën Novarti dhe fëmijët e saj.

Novarti shumë shpejt vuan pasojat e jetës së shthurur dhe pasi sëmurët vdes. Djali Karniku dërgohet pranë Sejid Mehmet Numanit si çirak. Kariku tregohet i zgjuar dhe mëson shumë pranë tij. Ndërsa vajza Takuhi pëson të njëjtin fat si e ëma. Pas kalon një jetë të shthurur në Bejoglu edhe ajo vdes në moshë të re.

Avagni njihet me Karnikun në jetën e natës që frekuentojnë të dy. Edhe pse nuk kanë lidhje gjaku ata ligjërisht janë vëlla e motër. Madje për të përfituar ndonjë para ai fillon ta vizitojë shpesh Avagnin. Avagni e merr nën kujdes Karnikun. Gjatë këtyre vizitave Karniku bie në dashuri me shoqen e motrës, Siranushin. Madje ai i kërkon të martohen.

Shkrimtari, për shkak të interesit të tij si gazetar dhe romancier natyralist menjëherë vendos të njihet me Sejid Mehmet Numanin, mjeshtrin ku punonte Karniku.

Pasi takohet me të mëson mbi jetën e tij. Sejid Mehmet Numani ishte një tregtarë që ishte martuar disa herë dhe kishte lindur shumë fëmijë, por vetëm njëra i kishte mbijetuar. Ferideja., por edhe ajo ishte një vajzë e dobët, e shëmtuar dhe e sëmurë shumicën e kohës. Karniku merr parasysh edhe të kthehet në mysliman vetëm e vetëm që të martohet me Feriden.

Sejid Mehmeti ishte i rrahur me jetën dhe e kuptonte shumë mirë që Karniku kishte si qëllim paratë e tija. Për më tepër që dinte lidhjen e Karnikut me

Siranushin. Ai e ndihmon Karnikun duke i dhënë para që të martohet me Siranushin.

Bëhen përgatitjet për dasëm. Karniku pasi merr paratë e Sejid Mehmetit dhe gjithë pasurinë e Siranushit largohet drejt Evropës me një grua të moshuar Armene.

Siranushi jo vetëm është lënduar shpirtërisht, por është në gjendje të keqe edhe ekonomikisht. Sejid Mehmeti e quan veten përgjegjës për këtë ngjarje dhe i lidh vajzës një rrogë mujore dhe e ndihmon që të shkojë në shtëpinë e Avagnit. Që nga ajo kohë dy vajzat jetonin në dhoma të ndryshme në të njëjtën shtëpi.

Sejid Mehmeti merr rolin e një engjëlli mbrojtës për Siranushin., por ai nuk e njihnte personalisht atë. Pasi mëson për punën e shkrimtarit i kërkon që të lexojë tregimin. Madje merr përsipër që ta shkruaj në të pastër.

Shkrimtari tani i drejtohet jetës së Siranushit. Një mëngjes të ftohtë, roja i kishës në Bejoglu gjen para portës një fëmijë të porsalindur. Roja ja jep fëmijën një tregtari të pasur për ta mbajtur. Të nesërmen vjen një polic tunizian i cili pretendon se ajo është fëmija e tij e quajtur Siranush. Ai e dërgon tek e ëma që ishte e dashura e tij Armene.

Pas pesë vitesh ai vdes. Pasurinë ja lë vajzës dhe nënës së tij. Përveç kësaj ai lë edhe një letër në Patrikanën Armene për t'iu dhënë vajzës kur të mbushte njëzet e një vjeç. Dy vite më vonë vdes edhe nëna e Siranushit. Siranushi deri në moshën katërmëdhjetë vjeçare qëndron në shkollë. Më pas dërgohet në të njëjtin hotel ku kishte jetuar edhe Avagni. Aty njihet me Avagnin dhe bëhen shoqe.

Më vonë ajo dërgohet në shtëpinë e Vartov Dudu dhe Bogus Agës. Atje mëson të qepë. Në këtë periudhë njihet me Karnikun. Pa e njohur mirë vendos të martohet. Në këtë pikë të historisë shkrimtari mëson edhe dy fakte të reja. E para është se njeriu që Siranushi qëllon me shpullë në traget ishte një person që me anë të Karnikut i kishte propozuar që të bëhej dashnorja e tij. Dhe e dyta që vajza e Sejid Mehmetit, Feride, ishte e dashuruar me Refetin. Këtë gjë e mëson nga Vartov Dudu që hynte e dilte shpesh në shtëpinë e Sejid Mehmetit., por Refeti nuk kishte asnjë dijeni në lidhje me këtë ndjenjë.

Shkrimtari i tregon Refetit për ndjenjat e Ferides., por Refeti i thotë se për disa arsye ai nuk mund të ndiente gjë për Feriden. Ai ishte i lidhur me Avagnin, Feride ishte vajza e pronarit dhe për më tepër ajo ishte e sëmurë dhe e shëmtuar.

Megjithatë në një çast dobësie, për të shprehur respektin dhe falënderimin ndaj Sejid Mehmetit ai pranon të martohet me Feriden, ndërhyrja e Avagnin e bën ta ndryshojë mendjen.

Feride tani është e gatshme për çdo gjë që të arrij Refetin. Me anë të një çifuti i dërgon Refetit një letër ku i shpreh dashurinë e sajë, por letra në vend të Refetit dorëzohet tek shkrimtari.

Planet që kishte thurur Feride kuptohen më vonë. Një natë kur Refeti, Avagni dhe Siranushi po shëtisnin, Avagni bie në det gjatë hipjes në traget. Një njeri, i cili më vonë del që është çifuti që solli letrën, hidhet për ta shpëtuar, por zhduken që të dy në valët e zeza të detit.

Shkrimtari dyshon dhe pas një investigimi dyshimi i tij del i saktë. Feride kishte paguar që Avagni të vritej. Edhe Sejid Mehmeti kishte dijeni për këtë gjë., por shkrimtari nuk i tregon njeriu për këtë gjë.

Pas vdekjes së Avagni Siranush shkon në shtëpinë e Vartov Dudu. Me ndihmën e shkrimtarit i cili kishte zënë vendin e babait fillon të japë mësimë private.

Nga ana tjetër Feride sëmuret nga një sëmundje misterioze. Asnjëri nuk e kupton sëmundjen, por shkrimtari beson së kjo është një brejtje e ndërgegjes për vrasjen e kryer. Feride e cila edhe pa këtë sëmundje ishte shumë shëndet lig vdes. Babai Sejid Mehmeti e humbet dëshirën për të jetuar pasi i vdiq edhe fëmija vetëm që kishte ngelur. Ai tërhiqet nga tregtia dhe vendos të shkojë në haxh.

Shkrimtari nëpërmjet një gazete franceze që lexon mëson për fundin e Karnikut. Pasi kishte shëtitur nëpër Evropë duke u marr me krime të shumta përfshirë edhe vrasjet ai ishte kapur dhe ishte dënuar me varje në litar.

Sejid Mehmeti duke mbledhur rrobat në kasafortën e tij gjen një zarf të vulosur. Ky zarf hap një faqe të re për jetën e Siranushit. Ky zarf do ndihmonte në marrjen e zarfit që ishte lënë në Patrikanën Armene në lidhje me prejardhjen e Siranushit.

Zarfi shpjegonte arsyen pse polici Tunizian dhe Sejid Mehmedi ishin kujdesur për Siranushin. Pasi marrin letrën në Patrikanë Siranushi mëson se babai i saj ishte Ali Topuzi, miku i ngushtë i Sejid Mehmetit. Në zarf ishte një foto e tij dhe një letër ku babai i saj e ftonte vajzën të kthehej në myslimane. Edhe nëse nuk pranonte ajo prapë do të ishte vajza e tij.

Pasi mëson këtë gjë Siranushi i shpreh dashurinë Refetit. Për sa kohë ishte gjallë Avagni ajo e kishte mbajtur të fshehtë këtë ndjenjë. Ata duan të martohen., por për respekt vendosin që të martohen pas nisjes së Sejid Mehmedit.

Disa ditë para se Sejid Mehmedi të niset për në Mekë, Siranushi shkon ta takojë. Sejid Mehmedi e përqafton si bijën e tij dhe i pëshpërit diçka në vesh. Që të dy qajnë.

Pas largimit të Sejid Mehmedit shkrimtari e pyet se çfarë i tha. Siranushi i thotë që i kishte kërkuar të martohej me Refetin dhe të kthehej në myslimane. Sejdi u kishte lënë mjaftueshëm para që të dyve.

Siranushi kthehet në myslimane dhe martohet me Refetin. Pas një viti e gjysmë Refeti gjatë një udhëtimi në Egjipt mëson për vdekjen e Sejid Mehmedit dhe ja shkruan me një letër Siranushit.

### **Muhadarat (1891)**

Ky është romani i Fatma Alije Hanëm, një nga dy shkrimtaret femra të romanit në periudhën e Tanzimatit. Ky roman është i ndërtuar mbi katër kapituj (libra) dhe bën fjalë për edukimin e të rinjëve që të kenë një martesë të mirë. Megjithatë prek edhe tematika të tjera. Më tepër mund të themi që është një roman edukues.

Romani fillon në një shtëpi ku po zhvillohet një dasmë. Një nga pjesëmarrësit është edhe Fadila.

Fadila ishte vajza e Sai Efendit, një burri që vinte nga një familje e pasur dhe me emër në Stamboll. Nëna i kishte vdekur në moshë të re. Ajo kishte edhe një vëlla më të vogël të quajtur Shefik. Një vit pas vdekjes së nënës së Fadiles, Sai Efendi martohet me znj. Xhalibe. Pak më vonë znj. Xhalibe sjell në vilë vëllanë Nebi dhe ish të dashurin e saj, djalin e xhaxhait Syha.

Znj. Xhalibe që e vogël ishte mësuar të ishte ambicioze. Aq ambicioze sa që edhe pse e dashuronte djalin e xhaxhait nuk e pranon propozimin e tij për martesë pasi ai nuk ishte shumë i pasur.

Syha pranohet në vilën e Sai Efendit me justifikimin që ishte vëlla qumështi me Xhaliben. Me këtë justifikim ishin fashitur edhe dyshimet që mund të lindnin për ndonjë lidhje mes tyre.

Syha në fillim nuk pranon të vij në vilë, por duke qenë pa para ndryshon mendim dhe pranon të jetojë aty deri sa të mbarojë shkollën. Pas pak kohësh Syha i propozon përsëri Xhalibes. Ajo përsëri e refuzon. I lënduar për herë të dytë ai përsëri mendon të largohet nga vila, por Xhalibe e ndalon. Edhe pse në fillim mendon të hakmerret ndaj Xhalibes më vonë ai ndryshon mendim dhe bëhet bashkëpunëtori i saj.

Znj. Xhalibe ishte një njeri me dy fytyra. Fëmijët i keqtrajtonte, por para njerëzve bënte sikur i donte. I vetmi person që e kupton këtë sjellje të Xhalibes është komshija e tyre, njëkohësisht edhe mikesha e nënës së tyre znj. Mynever. Znj. Mynever ishte njëkohësisht edhe nëna e Mukadem Beut, djalit që mendohej se do të martohej me Fadilen.

Për të mbrojtur fëmijët dhe të ardhmen e tyre znj. Mynever kthehet në një engjëll mbrojtës për to., por intrigat sapo kishin filluar. Xhalibe dhe Syha si qëllim të parë kanë të prishin martesën mes Fadiles dhe Mukademit.

Në fillim marrin një femër të lehtë të quajtur Reftar si shërbëtore të Nebiut, vëllait të Xhalibes, i cili e kalonte gjithë kohën kot. Më pas Nebiu e josh Reftarin. Reftari bie kokë e këmbë brenda me Nebiun. Xhalibe bën sikur nuk di gjë në fillim, por më pas i thotë Reftarit se mund ta ndihmonte të dilte nga kjo gjendje., por për këtë gjë duhet të bënte çfarë i kërkonte ajo. Reftari pranon.

Nga ana tjetër përgatitjet për dasmë vazhdojnë. Një natë Mukademi vjen për darkë në shtëpinë e Sai Efendit. Pasi bëhet shumë vonë ai e kalon natën në shtëpinë e tyre. Ky ishte rasti që Xhalibe po priste. Syha i thotë Sai Efendit se dhëndëri i ardhshëm kishte pirë mbi një shishe alkool në darkë. Xhalibe duke bërë si e përvuajtuar me pak pahir bën sikur nxjerr një të fshehtë. Mukademi gjatë natës që kishte kaluar në vilë kishte joshur Reftarin. Madje për këtë gjë sjell dëshmitare edhe Reftarin e cila betohet.

Sai Efendi i tërbuar nga kjo që mëson e prish menjëherë fejesën. Sado që znj. Mynever dhe Mukademi përpiqen të sqarohen ai nuk ndryshon mendim.

Syha që kur kishte ardhur në vilë ishte përpjekur ta ngacmonte Fadilen me shikime. Tani duke përfitur edhe nga largimi i Mukademit tenton të afrohet me qëllimin e fshehtë për t'u martuar.

Ndërsa Nebiu kishte si qëllim të martohej me Fevkijen, shoqen e Fadiles. Ai e di që familja e Fevkijes nuk do pranojë ta martojë me të pasi nuk është i një sere të lartë. Për këtë arsye ai i kërkon Fadiles që ta ndihmojë. Vajza e re nuk e pranon një gjë të tillë të ulët.

Megjithatë Nebiu nuk dorëzohet. Ai gjen një vajzë tjetër që t'i dërgojë letrat e dashurisë. Ai arrin t'ia fitojë zemrën Fevkijes. Kur familja e saj e mëson është tepër vonë. Fevkija ishte një kapriçoze e cila nuk tërhiqej deri sa t'i plotësohej dëshira. Familjarët e saj edhe pse kundër dëshirës së tyre pranojnë të shpallin fejesën mes Nebiut dhe Fevkijes.

Nga ana tjetër Xhalibe me Syhanë vazhdojnë intrigat e tyre. Ata i thonë Sai Efendit që Fadile i shkruante letra Mukadimit dhe takohej fshehurazi me Myneverin. Ata ja mbushin mendjen Sai Efendit që ta martojë sa më shpejt Fadilen.

Një ditë Sai Efendi kthehet më herët në shtëpi dhe i thotë Fadiles të shkojë të thërras Xhaliben. Kur shkon në dhomën e saj ajo shikon Xhaliben duke bërë dashuri me Syhanë, por nuk i vë rëndësi dhe nuk thotë asgjë.

Tashmë për Xhabilen largimi i Fadiles nga shtëpia kthehet në një domosdoshmëri. Ajo i dërgon Syhanë i cili duke ju përgjyruar i kërkon që të martohen, por Fadile prapë refuzon.

Megjithatë Xhalibe nuk dorëzohet. Ajo i propozon Sai Efendit që ta martojë Fadilen me Syhanë. Këtë kërkesë e paraqet sikur ishte një sakrificë që po bënte Syha. Edhe pse ja kërkon babai i saj Fadile përsëri nuk pranon të martohet me Syhanë.

Për ta bërë më të besueshëm nevojën për martesë të Fadiles, Xhalibe i jep Sai Efendit një letër sikur ja kishte dërguar Mukademi Fadiles. Situata del jashtë kontrollit. Sai Efendi nga tërbimi për herë të parë në jetë godet Fadilen dhe Shefkiun që futet për ta ndaluar.

Shefkiu kalon një sëmundje të rëndë dhe më pas Sai Efendi e dërgon në një shkollë me konvikt. Fadile mbetet e vetme dhe e izoluar në shtëpi. Pasi i kërkojnë dorën nga një familje e pasur ajo pranon për të shpëtuar nga ky izolim i skajshëm. Një arsye tjetër që pranoi ishte se dhëndri do pranonte që me ta të jetonte edhe Shefkiu.

Fadile martohet me Remziun, një mashkull tek të tridhjetat që kishte pasuri dhe një edukim të mirë. Ndërsa Xhalibe është e lumtur pasi i ka larguar si Fadilen ashtu edhe Shefkiun nga vila. Kurse Nebiu largohet duke shkuar në shtëpinë e gruas së tij.

Tashmë në shtëpi kemi vetëm dy të dashuruarit Xhalibe me Syhanë, Sai Efendi dhe Reftari.



Burri i Fadiles, Remziu kishte trashëguar një pasuri të konsiderueshme nga babai i tij koprac., por me vdekjen e babait ai, ndryshe nga i vëllai që vazhdon të bëjë të njëjtën stil jetese, fillon të bëjë një jetë sipas stilit perëndimor.

Fadile, e merr me shumë optimizëm martesën pasi shpëton nga intrigat e shtëpisë së babait. Madje ajo fillon ta dashurojë burrin e saj., por për fatin e keq burri i saj fillon të ndryshojë. Ai nuk interesohet më për të dhe fillon të frekuentojë jetën e natës duke shëtitur me femra me nam jo të mirë.

Ndërsa në vilën e Sai Efendit gjërat po ndryshojnë. Në vend që të ndihej e qetë tani që ja arriti qëllimit, Xhalibe fillon të ndjejë pasojat e sjelljes së saj. Reftari nuk e afron sepse pas martesës së Nebiut kupton që ishte përdorur. Ajo shpresonte të martohej vetë me Nebiun.

Edhe Syha fillon të mos interesohet më për Xhaliben dhe të afrohet me Reftarin nga inati për refuzimin i dyfishtë për martesë që i kishte bërë. Xhalibe s'mund të bënte asgjë kundër Reftarit pasi ajo i dinte të gjithë intrigat e thurura. Gjatë bisedave me Syhan ajo kupton që ai kishte filluar ta urrente. Madje Syha fillon ta përdorë Reftarin kundër saj.

Në momentin që Xhalibe mendonte që kishte arritur gjithçka, pasuri, stoli dhe të dashurin, ajo kupton që nuk ishte e lumtur.

Pas pak kohe Syha martohet dhe largohet nga shtëpia. Ndërsa Fadile fillon të jetë gjithmonë e më e trishtuar. Martesa e saj nuk po funksionon. Fëmija i cili mund të ishte një urë lidhëse nuk po vinte. Pas disa kohësh me aprovimin e saj dhe vjehrrës marrin një vajzë të re për t'i bërë shoqëri Remziut<sup>78</sup>. Kalojnë gjashtë muajsh dhe ajo nuk kishte mbetur shtatzënë. Blejnë një skllave tjetër, por edhe ajo nuk mbetet shtatzënë. I martojnë duke u dhënë nga një pajë të mirë të dyja këto vajza të cilat mbesin shtatzënë tek burrat e rinj. Kjo gjë tregon që problemi ishte tek Remziu.

Remziu nuk e mban fjalën edhe pse i premtonte që nuk do vazhdojë jetën e shthurur që bënte. Fadile tenton të kthehet në shtëpinë e të atit., por Xhalibe i del përsëri kundër dhe ja mbush mendjen Sai Efendit që t'i thotë të qëndrojë në shtëpinë e burrit.

Pa asnjë mundësi ku të jetojë Fadile mendon të vetëvritet. Një ditë kur i vjen vëllai në shtëpi i lë një letër ku i shpjegon që do të vrasë vete. Ata e kërkojnë Fadilen, por nuk e gjejnë në asnjë vend. Të nesërmen buzë detit pranë disa shkëmbinjve gjejnë një shami dhe një varëse të saj.

Vdekja e Fadiles ndikon si tek Shefkiu i cili mbetet fillikat i vetëm edhe tek Mukadimi i cili sëmuret rëndë. Për këtë arsye atë e dërgojnë në Bejrut për të ndryshuar klimë.

Në Bejrut njihemi me familjen e Muhterem Efendit. Së bashku me ta njihemi edhe me Pejmanin, një shërbëtoreshë e re.

---

<sup>78</sup> Në fakt mund të quhet një grua e paguar për të bërë fëmijë.

Vajza e Muhteremit, Enise, një vajzë e re dhe e bukur, gjatë shëtitjeve në qytet bie në dashuri me një djalë. Pejmani e këshillon të ketë kujdes nga kjo ndjenjë, por pranon ta shoqërojë në shëtitje.

Gjatë shëtitjes djali kalon me karrocë, por për çudi, Pejmani njih djalin dhe djali e njih Pejmanin. Këta nuk ishin tjetër përveç se Mukadimi dhe Fadile që kishte ndryshuar emrin dhe quhej Pejman.

Fadile ishte larguar nga shtëpia me qëllim të vetëvritej., por në çastin e fundit përr shkak të besim ajo heq dorë.<sup>79</sup> Në fillim mundohet të jetojë duke shitur unazën., por pas pak kohe i mbarojnë paratë. Ajo detyrohet të shesë veten. Në fillim shkon në Egjipt dhe pastaj përfundon në Bejrut.

Mukademi gëzohet që e ka gjetur Fadilen dhe shpreson të martohet me të. Fadile i thotë që ajo është ende ligjërisht e martuar me Remziun. Megjithatë ai mund të martohet me Enisen, vajzën të cilës i shërbente. Kështu që ata përsëri do të ishin pranë njëri-tjetrit. Mukademi edhe pse nuk është dakord në fillim duke qenë se do jetojë në të njëjtën shtëpi me Fadilen pranon. Mukademi martohet me Enesin.

Djali i shtëpisë, Shebibi edhe pse nuk qëndronte shumë në shtëpi për shkak të udhëtimeve të shpeshta për punë fillon të ndjenjë për Pejmanin. Me kalimin e kohës kjo ndjenjë kthehet në dashuri.

Pas disa kohësh ai i kërkon të ëmës që t'ia bëjë Pejmanin shërbëtore dhomë<sup>80</sup>, por Pejmani nuk pranon. Që të mos ja thyente zemrën ajo i thotë që t'i jap pak kohë për t'iu përgjigjur. Pak më vonë nga gazetatat Pejmani (Fadile) mëson se Remziu kishte vdekur.

Kjo kishte larguar pengesën e Fadiles për t'u martuar. Mukademi fillon të shpresojë përsëri, por Fadile, e cila i donte shumë si Mukademin ashtu edhe Enesin dhe vajzën që sapo u kishte lindur mezi arrin ta bindë që ai mos divorcohet nga Enesi.

Në këtë kohë Mukademit i vjen lajmi që Sai Efendi ishte paralizuar dhe ishte në shtratin e vdekjes. Pasi mendojnë për vështirësinë për t'u treguar njerëzve të shtëpisë gjithë historinë dhe që të merrnin aprovimin e tyre vendosin të largohen fshehtas nga Bejruti.

Një natë që të dy largohen nga shtëpia. Familjarët dyshojnë se ata të dy kanë një lidhje. Për këtë arsye natën tjetër Shebibi nisat pas tyre për t'u hakmarrë.

Sapo Fadile dhe Mukadimi zbresin në skelë përballen me një lypëse. Nga unaza që ka në dorë ata e kuptojnë që është Reftari. Fati kishte filluar t'i dënonte gjithë njerëzit që kishin bërë të këqija.

Pas largimit të saj Xhalibe me Reftarin fillojnë të shkojnë nëpër festa duke u argëtuar me meshkuj të ndryshëm. Në një nga këto festa mashkulli që kishte

---

<sup>79</sup> Në fenë islame vetëvrasja është e ndaluar pasi është vetëm Allahu ai që ta dhuron dhe ta merr jetën.

<sup>80</sup> Kjo ishte një formë e marrjes së shërbëtore për të kryer marrëdhënie seksuale. Lejohej me ligj në atë kohë.

kaluar natën me to nuk pranon t'i lë të shkojnë. Ato largohen duke e përbuzur. Ai i gjëmon nga pas dhe i rrëzon nga shkallët e shtëpisë.

Xhalibe dëmtohet aq shumë në fytyrë sa nuk shihej dot. Ndërsa Reftari verbohët nga një goditje e marrë në sy. Kur e mëson këtë gjë Sai Efendi vrapon për të parë Xhaliben. Atij i hapen sytë pasi e kupton ç'kishte ndodhur aty. Arrin të mësojë të gjithë të vërtetën. Divorcohet nga Xhalibe, kurse Reftarin e dëbon. Xhalibe përfundon duke jetuar tek dhoma e shërbëtove në shtëpinë e Syhasë.

Sai Efendi sëmuret rëndë nga pendimi për vuajtjet që u kishte bërë fëmijëve. Shefiku fillon të shkojë ta takojë babanë pasi i vinte keq për gjendjen ku kishte përfunduar. Në këtë pikë Fadile arrin në shtëpi., por para se të futet në shtëpi vjen Shebibi. Ai dëshironte ta vriste duke u hakmarrë, por ata i tregojnë të vërtetën dhe ai e lëshon Fadilen.

Në familje ka një gëzim të madh. Ardhja e Fadiles ndikon për mirë në shëndetin e Sai Efendit. Fadila me Shebibin vendosin të martohen. Nëna e Shebibit së bashku me vajzat Enesi dhe Ryvej vijnë në Stamboll për dasmën. Shebib pas martesës i kalon gjithë punët e tij në Stamboll. Nëna e tij kthehet në Bejrut, por Ryvejin e lë në Stamboll. Tri vite më vonë Shefiku martohet me Ryvejin.

### **Zehra (1895)**

Romani Zehra i shkrimtarit Nabi-zade Nazim në fillim botohet me pjesë në revistën Servet-i Funun. Në kohën kur u shkruajt u quajt një roman modern. Në të preket tema e xhelozisë. Si roman është nga romanët e parë me tipare realiste dhe natyraliste në letërsinë turke.

Romani fillon në një ditë të ngrohtë pranverë pranë një fshati në rrethinat e Stambollit. Dy të dashuruar po shikonin të përqafuar rrjedhën e lumit. Vajza quhej Zehra, ndërsa djali Syhpi.

Syhpiu ishte një djalë i zgjuar dhe i arsimuar. Babai i tij që para se të vdiste e kishte dërguar si ndihmës pranë një tregtari të madh. Ky tregtar është Shevket Efendi, babai i Zehras.

Shevket Efendi ishte rritur njësoj si Syhpiu. Me punë dhe zgjuarsia kishte arritur të bëhej një nga tregtarët më të mëdhenj të Stambollit. Ishte martuar me një vajzë të re që i kishte dhënë dy vajza Zehranë dhe Bedrien. Pas vdekjes së gruas ai jetonte në një shtëpi të madhe me dy vajzat e tij., por kishte një problem shumë të madh. Zehra kishte një natyrë shumë xheloze.

Shqetësimet që kishte për Zehranë ai i ndante herë pas here me Syhpiun të cilin e quante edhe mik përveç se ndihmësin e tij më të mirë.

Një ditë Syhpiu shkon në shtëpinë e Shevket Efendit dhe sheh Zehran. Syhpiut i pëlqen Zehraja dhe asaj i pëlqen Syhpiu. Me aprovimin edhe të Shevket Efendit, i cili e vlerësonte shumë Syhpiun si njeri i mirë dhe i qetë, ata martohen.

Për Zehranë fillon një jetë e re dhe e bukur. Xhelozia që e ndiqte gjithmonë nga pas sikur ishte zhdukur. Vera kalon shumë bukur, por në fillim të vjeshtës

xhelozia e Zehrasë fillon të duket përsëri. Familja e kalon dimrin në një vilë në Stamboll.

Gjatë dimrit Syhpiu disa herë kalon pasditen me shokët në Bejoglu. Kjo bën që xhelozia e Zehras të shtohet. Me ardhjen e pranverës ata transferohen në një vilë buzë ngushticës dhe fillojnë të përjetojnë përsëri ditë romantike mes tyre.

Në këto çaste ne i shohim të dashuruarit duke parë detin.

Nëna e Syhpiut ishte një grua e vjetër që i respektonte traditat dhe zakonet. Për të bërë që djali dhe nusja të ishin sa më të qetë ajo mendon që të marr një shërbëtore që të ndihmojë shërbëtoren plakë Nazikter. Për këtë arsye ajo blen në tregun e skllëve një skllave të re dhe të bukur të quajtur Sërëxhemal.

Zehraja sapo e sheh skllaven xhelozet shumë. Kjo ishte një gjë që pritej, por ajo mundohet ta mbajë përbrenda këtë xhelozë. Megjithatë Syhpiu, duke qenë se e njihte shumë mirë gruan e tij, mundohet të mos i bjerë shumë në sy.

Përpyekjet e Zehrasë nuk sjellin ndonjë përmirësim. Tani Zehraja e kalon gjithë kohën mes xhelozisë së saj. Kuptohet që gjithë xhelozia e saj është e drejtuar ndaj Sërëxhemal. Ajo e fyen dhe silllet shumë keq ndaj saj. Duke mos pasur besim e kontrollon gjatë gjithë kohës. Këtë detyrë ja jep Nazikterit. Nazikteri e bën me dëshirë këtë detyrë pasi ishte për vete xhelozë ndaj Sërëxhemalit sepse kishte frikë mos i zinte vendin.

Sërëxhemali e kupton që ajo është shkaktarja e xhelozisë së zonjës. Për këtë arsye mundohet sa më shumë që të mos u dal para syve Zehrasë dhe Syhpiut. Madje i propozon zonjës edhe që ta shesë, por Zehraja duke bërë sikur nuk kishte asgjë e refuzon këtë kërkesë.

Përveç xhelozisë Zehraja tani fillon ta shohë edhe si konkurrenë Sërëxhemalin dhe nuk e ka gabim. Xhelozitë e saj të shumta janë duke e shtyrë Syhpiun drejt shërbëtore. Me kalimin e kohës Syhpiu me të vërtetë fillon ta pëlqejë Sërëxhemalin.

Një ditë kur nuk kishte njerëz në shtëpi ja shpreh ndjenjat e tij Sërëxhemalit. Sërëxhemal i shpreh të njëjtat ndjenja zotërisë së saj.

Me fillimin e lidhjes me Syhpiut Sërëxhemal fiton besim në vetvete dhe silllet më ndryshe në shtëpi. Përplasjet me Syhpiut dhe Zehrasë e shtojnë këtë të fundit më shumë drejt shërbëtore. Pas disa kohësh ajo mbetet shtatzënë.

Në të njëjtën kohë vjehri i Syhpiut vdes. Pa kaluar shumë kohë Syhpiu dëbon nga shtëpia Nazikterin pasi ajo mbante anën e Zehrasë dhe ishte një rrezik për të dhe Sërëxhemalin. Nëna e Syhpiut me vonesë e kupton gabimin që kishte bërë duke marr një shërbëtore të re për djalin., por tani është shumë vonë.

Zehraja tani është e detyruar të luftojë kundër Syhpiut, Sërëxhemalit dhe fëmijës që do të lindë., por ndryshe nga sa mund të mendohet kjo gjë asaj i jep kënaqësi pasi do të ketë mundësi të shprehë xhelozinë e saj hapur.

Përplasjet mes dy femrave sa vijnë e shtohen. Zehraja përpiqet që të dëmtojë fëmijën në bark, por Sërëxhemal tregohet e kujdesshme dhe Zehraja nuk ja arrin qëllimit.

Kur nuk ja arrin këtij qëllimi Zehraja ndryshon strategji. Ndoshta po të lindte një fëmijë me Syhpinë ai do e harronte Sërëxhemalin. Para se të arrijë ta josh Syhpiun dy gratë përplasen duke u zënë para Syhpiut. Syhpiu jo vetëm që nuk ndërhyr, por ndihet edhe i përkëdhelur nga fati që dy femra po ziheshin për të.

Duke qenë se dy femrat nuk mund të qëndronin më nën të njëjtën çati Syhpiu me Sërëxhemalin largohet duke shkuar në një shtëpi tjetër. Zehraja mbetet në shtëpi me znj. Mynire, nënën e Syhpiut. Pak më vonë ajo e rimerr në punë Nazikterin.

Xhelozia, e cila ishte bërë shkak për këto ndodhi rikthehet përsëri, por tani tek Sërëxhemali. Ajo nuk i ka besë Syhpiut dhe dyshon që do ta lërë ashtu siç bëri me Zehranë.

Zehraja tani ka të drejtë edhe morale që të hakmerret ndaj Syhpiut dhe dashnores së tij. Për këtë arsye ajo paguan pa sukses disa gra deri sa arrin të gjejë një grua të përdalë greke e cila bën që Syhpiu të bjerë në rrjetën e saj.

Tashmë Sërëxhemalit frika i kthehet në realitet. Syhpiu e harron fare atë dhe fillon ta kalojë gjithë kohën me Uranin, gruan greke. Sërëxhemal në fillim nuk e di për Uraninë. Ajo kujton se Syhpiu e tradhtonte me Zehranë, ish gruan e tij. Për këtë arsye shkon në shtëpinë e Zehras, por nuk e gjen atje. Zehraja qesh e kënaqur kur e sheh Sërëxhemalin duke vuajtur kështu.

E shkatërruar nga braktisja e Syhpiut, Sërëxhemal mundohet të gjej rrugën që ta kthej përsëri tek ajo, por nuk ja del. Për më tepër duke nxjerr ujë nga pusi humb fëmijën. Kjo ishte lidhja më e fortë që mund ta mbante të lidhur Syhpiun. Me këtë gjë ajo i kishte humbur shpresat. Pas disa tentativave për vetëvrasje një ditë ja arrin qëllimit dhe vdes.

Zehraja arrin të korrë fitoren e parë.

Ndërkohë lidhja mes Uranit dhe Syhpiut vazhdon. Urani ishte një femër e cila ishte trajnuar që e vogël nga teza e saj që të shfrytëzonte meshkujt. Ajo dinte ta bënte më së mirë këtë punë. Syhpiu edhe pse e kuptonte që Urani nuk e dashuronte nuk arrinte të shkëputej nga kthetrat e saj. Shpenzimet e tij vazhdonin të rriteshin.

Zehraja fillon me pjesën e dytë të planit. Ajo dëshironte që ta varfëronte Syhpiun. Për këtë arsye ajo martohet me ndihmësin e Syrihut, Muhsinin. Me anë të tij arrin ta largojë Syhpiun nga dyqani. Syhpiu nuk bëhet xheloz për martesën e saj me Muhsinin.

Urani e braktis Syhpiun pasi ja harxhon gjithë pasurinë. Syhpiu i rënë në varfëri të plotë një ditë sheh Uranin në karrocë me një të huaj. Pasi e ndjek e pret gjithë natën poshtë shtëpisë. Nën ndikimin e alkolit të shumtë që kishte konsumuar i sulmon dhe i vret të dy sapo Urani del nga shtëpia me të huajin.

Policia e arreston si të dyshuarin kryesorë, por duke qenë se nuk kishin dëshmitarë nuk arrijnë ta dënojnë., por përsëri ai dërgohet me internim në Trablusgarp<sup>81</sup>.

Gjithë këto zhvillime Zehraja i mëson nga Marika, mikja e Uranit. Edhe pse ia arriti qëllimit, Zehraja nuk ndihet mirë. Muhsini, burri me të cilin ishte martuar për inat të Syhpiut, nuk bëhej fare xheloz për të. Zehra fillon të ndjejë pendim për ato që kishte bërë.

Pas disa kohe ajo mbetet shtatzënë, por disa ditë pas lindjes fëmija i vdes. Pas disa muajsh i vdes edhe Muhsini. Tashmë ajo është një vejushë e pasur, por e trishtuar. Një ditë ajo sheh një plakë të varfër që vdes në rrugë. Ajo ishte znj. Mynire, nëna e Syhpiut.

Për shkak të gjithë këtyre ndodhive të trishtueshme Zehraja bie në shtrat e sëmurë. Nuk pranon të marrë ilaçe dhe pas disa ditësh vdes.

### **Tri tregime mbi edukimin (1895)**

Romani i shkrimtares Emine Semije është i ndarë në tri pjesë ose e thënë më ndryshe në tri tregime të cilat së bashku formojnë një roman. Në fakt vetë shkrimtarja nuk e quan roman, por bashkim tregimesh.

#### **Tregimi I : Havf**

Mutekiti ishte një fëmijë i rritur mes gjithë të mirave. Kur nuk i plotësoheshin dëshirat ai bëhej shumë nervoz. E vetmja që mund ta qetësonte ishte dado Zevkjar. Dadoja e kishte pranuar këtë punë shumë stresuese vetëm prej rrogës së majme që merrte. E vetmja mënyrë për ta bërë të pushonte të qarën fëmijën ishte t'i thoshe se do vinte Lugati t'i merrte lodrat.

Një ditë së bashku me dado Zevkjarin dalin nga kopshti dhe i afrohen malit. Mes shkëmbinjve gjejnë një shpellë. Mutekiti kërkon me ngulm që të futet brenda. Kur e shohin që me fjalë nuk ja prishin mendjen i thonë që aty brenda ishte Lugati. Fëmija frikësohet menjëherë dhe largohen. Pas kësaj ndodhie Lala<sup>82</sup> fillon t'i tregojë histori me xhinde dhe zana.

Me kalimin e kohës Mukiti bëhet shumë i heshtur. Nëna e tij znj. Hanife mendon se ai ishte bërë i urtë falë edukimit të marr nga Lala., por në fakt fëmija ishte sëmurë me një sëmundje të quajtur “nevrozë”. Gjatë natës ai zgjohej nga makthet që shihte. Me përsëritjen e këtyre maktheve ai fillon të ketë spazma.

Gjyshja e dërgon në shumë doktorë dhe hoxhallarë. Doktorët i thonë që të mos e frikësojnë fëmijën, por gjyshja nuk beson se e ka nga kjo. Kurse hoxhallarët i thonë se mund ta kenë marr më sysh. Gjyshja i bën nuska dhe kur e sheh që bëhet pak më mirë beson se është shëruar nga syri.

Ndërsa Lala kur lodhej duke u marr me fëmijën i tregonte historia me lugetër dhe gogolë. Këto tregime ja tregonte kur shkonin pranë shpellës. Me këtë rast fëmija nuk fliste fare dhe Lala gjente kohë për t'iu vardisur dados.

<sup>81</sup> Qytet në brigjet e Afrikës veriore.

<sup>82</sup> Mësues i djemve të vegjël në familjet e pasura.

Kur djali fillon shkollën dado hiqet nga puna. Për të mos u larguar nga vila dado ishte e detyruar të martohej me Lalën. Kështu që dado do vazhdonte të merrej me edukimin e Mukitit. Në fakt dados i interesonte vetëm rahatia e saj dhe jo fëmija.

Një ditë znj. Hanife shkon për vizitë tek komshiu që kishin fëmijën të sëmurë me linë e dhëve. Me vete merr dhe Mukitin i cili nuk e kishte bërë vaksinën. Pas kthimit nga vizita Mukiti sëmuret. Doktorët arrijnë ta shërojnë madje ai përmirësohet edhe nga spazmat, por për fatin e tij të keq fytyra i bëhet me vraje. Një nga shërbëtoret, Feraseti i thotë znj. Hanife se e pat paralajmëruar që t'i bënte vaksinën. Znj. Hanife i premtonte se nëse do lindte një fëmijë tjetër ajo do bëhej dado i fëmijës.

Pas një viti znj. Hanife lind një vajzë me emrin Fevzije dhe Feraseti bëhet dado e saj. Feraseti ishte e kundërta e Zevkjarit. Ajo ishte e zgjuar dhe e dhimbshme.

Feraseti kërkon menjëherë që të vaksinohet Fevzijen, por Zevkjari nga inati i del kundër dhe ja mbush mendjen Zylali Beut, babait të saj që të mos vaksinohet. Feraseti kur mëson se doktori do vinte të bënte vaksinën tek një komshi aty pranë e merr Fevzijen dhe ja bën vaksinën fshehtas.

Fëmijët rriten dhe ditën që Mukiti bëhet synet Fevzija fillon shkollën. Me fillimin e shkollës Feraseti duhet të largohet nga vila. Ndërsa Zevkjari arrin të martohet me Lalën. Znj. Memnune e cila kishte rregulluar edhe martesën e Zevkjares i thotë znj. Hanife për sjelljet e këqija të Zevkjares ndaj Ferasetit. Znj. Hanife ndihet keq dhe e shpëton Ferasetin nga shitja në tregun e sklleverve dhe e dërgon tek komshinjtë.

Zevkjari martohet me Lalën, por me t'u martuar i fillojnë edhe fatkeqësitë. Lala sëmuret dhe zë shtratin. Pas 2 vitesh lëngimi në shtrat vdes. Sapo mendon se shpëtoi nga shërbimi i të sëmurit nga fshati i Lalës vjen Beshiri djali i madh i tij që ishte një gangster. Me anë të frikës dhe mashtrimit ai i rrëmben Zevkjares shtëpinë që e kishte blerë me kursimet e dhjetë viteve dhe gjithë paratë që kishte.

Me largimin e Zevkjares në vilë bie një qetësi e këndshme. Znj. Memnune merr përsipër mbajtjen e Mukitit. Me kalimin e kohës fëmijët bëhen për tu martuar. Fillojnë të kërkojnë nuse për Mukitin, por pamja e tij e shëmtuar e bënte të vështirë gjetjen e një nuseje për të. Megjithatë duke përfituar nga bukuria e Fevzijos ata arrijnë të mashtrojnë një familje dhe e gjejnë një nuse për të. Ditën kur Mukiti shkon të puth dorën e vjehrrit për bajram dallohet shëmtia e tij. Menjëherë familja e vajzës e prish fejesën.

Mukiti sëmuret rëndë nga kjo ndodhi. Pas shumë përpjekjesh për të gjetur një nuse familja përfundon që gjen një shërbëtoreshë (xharije) për të. Nga ana tjetër shkuesit për Fevzijen venin e vinin. Në fund vendosin t'ia japin Xhedit Beut. Ky i ri dukej si një djalë i edukuar me kulturë dhe i ndershëm. Xhedit Beu gjen shumë mangësi në sjelljen e Fevzies që ishte vetëm pesëmbëdhjetë vjeçe.

Pas martesës Safdili, gruaja e Mukitit mundohet ta pranojë shëmtinë e tij pasi kishte shpëtuar nga skllavëria. Ajo sillet shumë mirë me të dhe me vjehrrën. Ndërsa Xhedit Beu fiton dashurinë e gjithë familjes përveç vjehrrës. Gjatë festës

që bëhet me rastin e lindjes së vajzës së Mukitit, Xhedidi jo vetëm që këndon, por edhe e tepron me pijen bashkë me vjehrrin. Kjo ishte pika e fundit që mbush kupën për znj. Hanife. Ajo debaton me motrën e Xhedid Beut, znj. Myxheded dhe e përzë nga shtëpia.

Fevzija lind një vajzë që e quan Mihri. Për shkak të mbesës znj. Hanife pranon të pajtohet, por ndërhyt shumë në edukimin e mbesës. Madje kur mëson se do i marrin një dado franceze tërbohohet nga inati. Zylal Beu e ndan vajzën duke e çuar në një shtëpi tjetër.

Këtu del në pah diferenca mes edukimit perëndimor që Xhedid Beu i bën Mihrisë dhe vajzës tjetër Dyrin, dhe edukimit tradicional plot besëtytni që i jepet Fatines vajzës së Mukitit.

Me kalimin e kohës vajzat rriten dhe fillojnë të vijnë shkesët. Ndërsa për Mihrien dhe Dyrin vijnë shumë shkesë për Fatinen e cila jo vetëm që ishte rritur shëndetlig për shkak të stilit të jetës, por edhe me një karakter shumë të keq nuk vjen njeri. Megjithatë pas ndërhyrjes së Xhedid Beut ajo fillon të përmisohet. Vijnë disa shkues, por kur Safdili ngre zërin për mënyrën se si e kanë katandisur Fatinen, znj. Hanife bashkë me znj. Memnune dhe znj. Zevkjare i kërkojnë Mukitit ta ndaj gruan se do t'i gjejnë një tjetër më të mirë që nuk e kthen fjalën. Mukiti pranon, por ndërhyt Fevzija dhe ai nuk e ndan. tani Safdilin nuk e pyet më njeri dhe e shohin si një skllave.

Megjithëse vijnë shkesë asnjëri nuk kthehet për herë të dytë të shoh Fatinen. Më në fund arrijnë t'i prishin mendjen me anë të pasurisë një jetimi. Pas martesës znj. Hanife fillon përsëri të mendojë se Sabri Beu, burri i Fatinas, është shumë allafrënga ashtu siç kishte menduar edhe për Xhedid Beun. Ajo fillon ta trajtojë keq Sabriun. Pas nëntë muajsh Fatina mbetet shtazënë, por sëmuret. Sabriu thërret doktorin, por plakat e familjes nuk e lënë. Fëmija dështon.

Pas kësaj ndodhie ata e akuzojnë Sabriun që s'i kishte ndejtur pranë Fatines dhe e dëbojnë nga shtëpia. Në fakt ato kujtojnë se ai do të kthehej duke u lutur, por ai jo vetëm që nuk kthehet, por kur i dërgojnë fjalë të kthehet ai shprehet se falënderonte Zotin që e kishte shëptuar nga ato plaka.

Fatina sëmuret dhe plakat e familjes për ta argëtuar mendojnë të bëjnë disa lojëra. Një nga këto do ishte të trembnin gjyshe Eshrefin. Ato vishen si lugetër dhe në çastin që do trembnin gjyshen kalon para tyre Mukiti i cili i sheh dhe vdes në vend nga frika. E dëshpëruar znj. Hanife i dëbon Memnunen dhe Zevkjarin.

## Tregimi II: Felaket

Hidajet Efendi ishte arsimuar në Evropë. Kur i vjen mosha e martesës martohet me Myxhedetin, vajzën jetime të një ekonomisti. Pas martesë ajo merr pranë vetes edhe vëllanë e saj të vogël Xhedid.

Pasi kalon pesë vite në Janinë, me vdekjen e prindërve ja lë drejtimin e çifligut xhaxhait dhe shkon me një detyrë të lartë në Stamboll. Kur shkojnë atje u vdes vajza. Pa kaluar këtë dhimbje mësojnë për vdekjen e xhaxhait në Janinë. Xhaxhai kishte lënë tri vajza dy të martuara dhe një të fejuar si dhe djalin Kahraman.



Hidajet Efendi pasi marton edhe vajzën e tretë e mer Kahramanin në Stamboll. Kahramani me kalimin e kohës miqësohet me Xhedidin. Pas shkollës Hidajet Efendi i dërgon të dy në Evropë për të vazhduar arsimimin.

Myxhededi e mësuar me njerëz në shtëpi mërzhitet, por pas pak kohe lind një vajzë me emrin Muhsine. Duke qenë se kishte një dado franceze deri në moshën pesë vjeçare ajo nuk fliste turqisht. Me kërkesën e Xhedidit dhe Kahramanit i marrin një Lala që t'i mësonte turqisht.

Hidajetit nuk i pëlqen arsimimi që kishte marr Kahramani dhe e dërgon përsëri për studime në Evropë. Për më tepër i premton që kur të rritet Muhsine do e martonte me të. Myxhededi zemërohet shumë për këtë gjë dhe i premton vetes që s' do e lejojë këtë gjë.

Më pas mësojmë për martesën e Xhedidit që ndodh në tregimin e parë. Kahramani mbaron shkollën dhe emërohet diplomat në Paris. Herë pas here vjen në shtëpinë e Hidajetit dhe atje interesohet për Muhsinen. Edhe Muhsines i pëlqen Kahramani.

Muhsine mëson shumë mirë frëngjishten dhe persishten, por çalon në arabisht, më vonë vendosin që të mësojë edhe anglisht. Gjatë një vizite tek daja ajo fillon të agjërojë. Kur kthehet në shtëpi e ëma bëhet shumë keq dhe mundohet me çdo kusht që ta ndalojë, por ajo nuk pranon. Pastaj vjen Kahramani dhe me një fjalë e bën Muhsinen që të mos agjërojë. Kjo ishte më keq se vdekja për Myxhededin.

Mësuesja anglishtes sheh që Muhsine fillon të flirtojë me djemtë që i vijnë rrotull. Myxhededi e toleron këtë gjë vetëm e vetëm që të mos përfundonte me Kahramanin., por Hidajeti i cili deri atëherë e kishte llastuar nevrkoset.

Në këtë kohë ata do shkojnë në shtëpinë në Moda të cilën e kishin marr me qera për shëndetin e Fatines. Musine nuk dëshiron të shkojë atje pasi nuk i pëlqente., por në fund detyrohet të shkojë. Gjatë qëndrimit ajo flet keq për Fatinen dhe Memnune e dëgjon. Fatine kur e merr vesh betohet se do hakmerret.

Tani Musine kishte arritur të tetëmbëdhjetat, por nuk e lejonin të martohej pa mbushur njëzetë vjeç. Përveç Kahramanit të cilin ajo e donte në skenë del Behiçi një djalë që e njihte që në vogëli dhe ishte edukuar sipas modelit perëndimor. Ai i shprehte dashurinë Muhsine, por ajo nuk i përgjigjej. Behiçi kishte edhe mbështetjen e nënës së saj që donte të mos martohej me Kahramanin.

Edhe pse i kalon të njëzetat Muhsine nuk po martohej dot pasi e ëma i dilte kundër martesës me Kahramanin. Kur e pyet për arsyen ajo i thotë se Kahramani donte paratë e saj dhe jo atë, prandaj ajo s' duhet ta donte atë, por Behiçin. Fjalët e saj i bëjnë përshtypje Muhsines që pranon të martohet me Behiçin.

Kahramani kur sheh që Muhsine i sillet ftohtë e kupton që ka diçka dhe duke folur me Muhsinen i vërteton që e donte me të vërtetë dhe jo për interes. Muhsine mbetet mes dy zjarreve. Pasi Kahramani përplasat me Behiçin duke i thënë që Muhsine do atë, Behiçi i kërkon që të zgjedhë. Muhsine i thotë se zgjedh Kahramanin.

Kur nëna e saj mëson se çfarë ka bërë tërbohet dhe ja shpjegon Hidajet Beut problemin. Hidajeti menjëherë vendos ta fejojë me Kahramanin., por Kahramani

në fillim nuk pranon duke u justifikuar me edukimin e keq që i ka dhënë e ëma. Pas këmbënguljes së Hidajet Beut detyrohet të pranojë, por marrëdhëniet e tyre nuk janë më si më parë. Ata mezi i flasin njëri tjetrit. Hidajeti përplasat ashpër me Kahramanin. Pas kësaj Kahramani së bashku me Muhsinen largohen nga vila. Janë në vështirësi ekonomike. Kahramani ftohet fare me gruan e tij dhe kalon gjithë kohën jashtë. Muhsine bie në varfëri ekstreme. Edhe pse lind një djalë nuk arrin ta bëjë të kthehet Kahramanin në shtëpi. Ajo sëmuret rëndë. Në çastet e fundit nëna e saj vjen dhe bën sikur pajtohet me Kahramanin., por sapo vdes ata prap nuk i flasin njëri tjetrit. Kurse Hidajeti kishte kohë që ishte bërë eremit dhe nuk merrej më me asgjë.

### Tregimi III Zekavet

Myejet Beu dëshironte të shkonte për studime në Evropë. Edhe pse babai e mbështeste nëna i dilte kundër dhe detyrohet të mos shkojë. Ndonëse e kishin llastuar gjatë fërisëmij ai ishte një djalë i zgjuar dhe i edukuar. Nëna e tij së bashku me motrat nuk u pëlqente të lodheshin me arsimim, ndërsa Myejet Beu ishte kundra këtij mendimi të prapambetur.

Pas vdekjes së babait Myejet Beu vë rregull në pasurinë e familjes dhe fillon të mendojë për t'u martuar. Ai dëshironte një vajzë me shkollë dhe të edukuar dhe jo vajzë me pasuri të madhe. Me këshillën e Kahramanit, shokut të tij të punës, ai njihet me Mihinë, vajzën e Xhedid Beut. Pasi i pëlqen vendos të martohet.

Dy vite pas martesë Xhedid Beu ishte larguar nga vila e vjehrrit dhe kishte filluar të jetonte një jetë më allafrenga (moderne) Megjithatë, për shkak se gruaja e tij Fevzije ishte besimtare vajzat edukoheshin si me stilin Evropian ashtu edhe me atë tradicional duke marrë më të mirën nga të dyja. Kjo lloj mënyre e rritjes së tyre shkaktonte një xhelozë të madhe tek Fatine, kurse Muhsine bëhej xhelozë që nuk i arrinte dot në mësim.

Myejeti pasi martohet me Mihrijen nuk arrin të besojë që është me kaq fat që ka gjetur një grua kaq të mirë. Mihrija me kalimin e kohës ambientohet me familjen e re.

Pas martesës së Mihrisë shtohen edhe kërkesat për martesë për Dyrin. Dy më këmbëngulësit ishin Muhlis Beu, një djalë i pasur dhe simpatik, por me një edukim të pakët, ndërsa tjetri ishte Shexhi Beu, një djalë i varfër dhe jetim, por simpatik dhe me një edukim të mrekullueshëm. Ndërhyrja e znj. Hanife së bashku me shërbëtoret e saja Memnune dhe Zevkjare të cilat dëshironin Muhlis Beun bënë që Dyri të fejojë me të. Mihrija e kupton se Dyri nuk donte dhe e prish planin e tyre duke i thënë babait të saj. E prish fejesën me Muhlis Beun dhe e fejon me Shexhi Beun.

Pas vdekjes së Mutekitit znj. Hanife kishte dëbuar Memnunen dhe Zevkjaren. Ato edhe pse përpiqen të kthehen nuk ja dalin t'i prishin mendjen. Memnune përfundon në shtëpinë e djalit të saj. Kurse Zevkjare mbetet rrugëve.

Memnune e merr në shtëpi Zevkjaren kur ajo sëmuret, por djali i saj me anë të një hamalli e dërgon dhe e lë para derës së znj. Hanife. Fatine, e cila ishte shkaktarja e vërtetë e dëbimit të tyre pa e futur në shtëpi e dërgon në një spital plakën e sëmurë. Memnune kalon paralizë dhe Mihri së bashku me dadon,

Ferasetin, shkojnë për t'i dhënë ndonjë gjë për të ngrënë. Kur e shohin gjendjen e saj u vjen keq dhe e marrin në shtëpi.

Shexhi Beu fejohej me Dyrinë para se të niset për studime në Gjermani. Me rastin e fejesës znj. Hanife shkon në vilën e tyre dhe sheh Zevkjarin. Ajo akuzon Ferasatin se e kishte bërë me qëllim. Në fakt Zevkjare edhe pse në prag të varrit vazhdonte të ngatërronte gjërat dhe t'i mërzieste njerëzit e familjes.

I vetmi trishtim në çiftin Mihri-Myejet ishte mosbërja e një fëmije. Myejeti e shpreh në çdo rast këtë gjë dhe Mihrija i thotë që mund të bënte një fëmijë me ndonjë xharije., por Myejeti nuk pranon. Një natë kur kthehet në shtëpi Myejeti gjen një letër të shkruar nga Mihrija. Ajo i shkruante që ishte larguar për në shtëpinë e babait dhe e kishte lënë të lirë të lidhej me një xharije për të bërë fëmijë. Myejeti dëshpërohet shumë dhe në mes të natës me shi i shkon në shtëpi vjehrrit. Ai i kërkon falje gruas dhe arrin ta bind që të kthehet në shtëpi.

Në këtë kohë Shexhi Beu kthehet nga Gjermania dhe fillojnë përgatitjet për martesë. Fatina, e cila kishte mbetur pa burrë, mundohet të mësojë frëngjisht dhe piano duke shpresuar që kështu do kishte ndonjë shans. Madje ajo edhe lyhet e përlyhet me kremra që të dukej më e re dhe e bukur, por me sjelljen dhe pamjen e saj bëhet gazi i botës para të gjithëve.

Dyri një vit pas martese lind një vajzë. Kjo bën që Myejet Beun të dëshpërohet edhe më shumë për mos pasjen e një fëmije. Mihrija zë shtratin dhe Fatina gëzohet shumë., por gëzimi nuk zgjat shumë sepse mësohet që Mihrija ishte shtatzënë me binjakë.

Mihrija lind një djalë dhe një vajzë. Myejet Beu bën kurban me këtë rast. Me rastin e lindjes së fëmijëve shtrojnë një drekë të madhe. Aty ata diskutojnë me njëri-tjetrin se si duhet të rriteshin dhe edukoheshin fëmijët. Zylal Beu thotë që s'duhen rritur me përralla gogolëshe lugetërish siç ishte zakoni. Xhedid Beu i thotë që s'duhet të rriteshin sipas modelit Evropian.

Myejet Beu u thotë se për rritjen dhe edukimin e fëmijëve duhet të ndiqnin rrugën e mesme duke i mësuar edhe traditën edhe modernen. Të gjithë e pranojnë këtë mendim.

## **Bikes**

Romani Biktes i shkrimtares Emine Semije është i ndarë në pesë kapituj ose libra të cilat tregojnë marrëdhëniet mes dy miqëve dhe fëmijëve të tyre duke theksuar vlerën e miqësisë.

### **Kapitulli I Mukatebe**

Në këtë kapitull janë vetëm katërbëdhjetë letra të shkruara nga katër burra mes njëri-tjetrit. Këta katër burra janë Mystefid Junusbejzade, miku i tij Mystakim Bin Hixhabi, djali i Mystakimit, Muti dhe djali i Mystefidit, Raxhih. Letrat mes dy baballarëve dhe djemve të tyre japin informacione në lidhje me ngjarjet që ndodhin më pas. Po ashtu ndihmojnë që ngjarjet të shihen nga katër këndvështrime të ndryshme.

Këtu flitet për miqësinë që kishin Mystefidi me Mystakimin që nga bankat e shkollës dhe fjala që i japin njëri tjetrit për të martuar fëmijët e tyre bashkë. Raxhih djali i Mystefidit do martohet me Memune, vajzën e Mystakimit. Ndërsa djali i Mystakimit, Muti do martohet me Tevexhyh, vajzën e Mystefidit.

Dy miqtë ishin ndarë pas shkollës, Mystefidi në fshat në çifligun e tij kurse Mystakimi në qytet. Mystakimi ishte martuar me Gylshenin, por martesë nuk kishte shkuar mirë. Edhe pse kishin katër fëmijë. Në letër Mystefidi i kërkon të vijë në shtator në çifligun e tij që të çmалleshin dhe të njihnin fëmijët me njëri-tjetrin. Ndërsa Mystakimi i thotë se do vinte në prill pasi kishte probleme me gruan Gylshenin.

Gylsheni përveç Tejisen, vajzën e mesit, i urrente gjithë fëmijët e tjerë. Për shkak të përplasjeve Muti largohet nga shtëpia. Mystefidi mundohet ta ngushëllojë Mystakimin. Më pas në letër i tregon për problemin e tij. Vajza e motrës së tij Xhevahirja kishte rënë në dashuri me djalin e tij Raxhih. Familja e tij donte t'i martonte dhe ta prishte fejesën me Memunen. Mystakimi edhe pse e dinte që Memune do mërzitej e këshillon që ta prishin fejesën në mënyrë që Mystefidi mos kishte probleme në familje. Fundja Memune kishte një nënë të keqe dhe do e kuptonte arsyen që do i tregonte. Mystefidi në letrën e tij i thotë që martesë do bëhet pasi edhe Raxhihi dëshironte të martohet me Memunen.

Vetë Raxhih mundohet t'i gjejë burrë Xhevahirit. Ajo jo vetëm që nuk pranon asnjë nga kandidatët, por sëmuret keq. Mystefidi i shkruan për këtë gjë Mystakimit dhe i tregon që Raxhih i qëndron gjithë kohës tek koka. Kjo letër nuk merr përgjigje nga Mystakimi.

Më pas Mystefidi i shkruan një letër tjetër kur i thotë se doktorët nuk i jepnin shumë shpresa se Xhevahirja do të jetonte nëse nuk martohet dhe i shpreh mendimin që ta martojnë me djalin e Mystakimit, Muti., por përsëri nuk merr përgjigje.

I shqetësuar Mystefidi i shkruan se nëse nuk i kthen përgjigje nuk do t'i shkruaj më. Pak më vonë i vjen një letër, jo nga Mystakimi, por nga djali i tij Muti. Ai i tregon se kur ai ishte në Evropë motra e tij Temine ishte mbytur në det. Gylsheni, e ëma akuzon Memunen që e kishte shtyrë. Memune ishte larguar së bashku me dadon. Ditën e varrosjes së Temines, Mystakili paralizohet dhe as nuk flet as nuk shkruan. Muti, pasi i kishte kërcënuar Gylshenin me Tejisen e kishte mësuar të vërtetën, por nuk po e gjente motrën.

Bashkë me letrën e tij Muti i dërgon edhe letrën që kishte shkruar babai para se të paralizohet, por që nuk kishte mundur t'ia niste. Në të tregoheshin për dyshimet e tij në vdekjen e Temines, për hyrjen fshehurazi të një njeriu në shtëpi. Muti i thotë se e plagosi, por njeriu misterioz kishte arritur të largohet. Më pas i tregon për kërkesën ndaj Memunes për të treguar të vërtetën, për mashtrimin që bën Gylsheni me Tejisen dhe për heshtjen e Memunes që bie në rolin e fajtorit.

Një muaj pas kësaj letri Mystefidi merr një letër tjetër. Muti i tregon se po shkruan amanetet e babait. Në letër shkruhet se vdekja e Temines, arratisja e Memunes dhe paralizimi i Mystakimit ishin planet e Gylshenit e cila pas kësaj ishte larguar nga shtëpia me të dashurin e saj duke marrë gjithë paratë me vete. Tejise pranon vrasjen e Temines kështu që pafajësia e Memunes vërtetohet. I

dashuri i Gylshenit gjendet i masakruar. Babai Mystakim pas këtyre ndodhive sëmuret edhe më keq dhe para se të vdes i lë amanet t'i shkruaj këto gjëra Mystefidit.

Letra e fundit shkruhet nga Raxhih, djali i Mystefidit, i cili i shkruan se pas marrjes së letrës së fundit babai ishte sëmurë nga dhimbja dhe kishte vdekur. Raxhih e mbyll letrën duke shkruar që po nisej së bashku me Xhevahiren për ndryshim klime që të shërohej.

## Kapitulli i II Musahabe.

Një familje shqiptare vendoset pranë vilës ku një djalë i bënte shoqëri një vajze të sëmurë. Djali ishte Raxhih ndërsa vajza e sëmurë ishte Xhevahire.

Raxhipi edhe pse nuk kishte lajme për të fejuarën nuk pranonte të martohej me Xhevahiren. Në vilën pranë, i zoti i shtëpisë keqtrajtohte një shërbëtore të re bionde pasi e akuzonte që nuk i bënte mirë punët.

Të nesërmen dy vajzat e familjes së bashku me dy plaka vijnë për vizitë. Një nga vajzat Natika ishte e arsimuar dhe i pëlqen Xhevahires. Gjatë bisedës ata e pyesin për vajzën bionde. Ajo ishte një shërbëtore jetime e quajtur Bikes, të cilës i pëlqenin librat dhe muzika. Për këtë arsye keqtrajtohej nga shërbëtorët e tjera më të mëdha. Bikesi jo vetëm që ishte e bukur dhe e zgjuar, por dinte të luante një vegël muzikore dhe të këndonte shumë bukur.

Pas disa kohësh familja e komshiut transferohet në Stamboll pasi i zoti i shtëpisë kishte marr një detyrë shtetërore. Bikesi nuk dëshiron të largohet nga aty dhe pas shumë përpjekjesh e lënë të shërbejë pranë Xhevahirit.

Xhevahire sheh që Raxhih interesohet shumë për Bikesin dhe mundohet ta mbajë larg nga ajo. Ajo mendon t'i tregojë Bikesit arsyen e sëmundjes së saj., por nuk i beson plotësisht Bikesit pasi ajo rrinte shumë e heshtur sikur fshihte diçka. Një ditë një nga shërbëtorët që e kishte inat Bikesin i gjen një foto të fshehur asaj. Ajo ja jep Xhevahires e cila e tronditur kupton që Bikesi në fakt ishte Memune. Xhevahire, e cila i dinte përmbajtjet e letrave të shkruara merr një nga ato dhe ja tregon Bikesit duke i thënë që ajo kërkohet nga policia për vrasje. Ajo i thotë edhe që nëse do i qëndronte besnike dhe s' do largohet kurrë atëherë nuk do e spiunonte.

Raxhih, i cili kishte filluar të ndjente për Bikesin nuk arrin të marr të njëjtën ndjenjë nga ajo. Me përparimin e sëmundjes doktorët vendosin që Xhevahire të vazhdojë mjekimin në shtëpinë e saj. Ata që kthehen në çiflig duke marr edhe Bikesin me vete.

## Kapitulli III Imate

Katër muaj më vonë Xhevahiri është më rëndë. Ajo i shpreh dashurinë Raxhihit duke i thënë se ai ishte shkaku i sëmundjes së saj. Raxhih i thotë se ai s'mund të martohej me të pasi e konsideronte si motër. Atëherë Xhevahiri i kërkon të betohet që s' do martohet me asnjë tjetër përveç Memunes nëse do e gjente. Raxhih as për këtë nuk pranon të betohet.

Atëherë Xhevahiri lë amanet që Bikes të largohet nga shtëpia dhe të dërgohet në Janinë, nëse Raxhih do martohej të jetonte në dhomën e saj dhe të vizitonte çdo

ditë varrin e saj. Raxhih ndërhyr dhe nuk e lë Bikesin të largohet. Xhevahiri duke menduar të bënte një të mirë para se të vdiste i thërret Bikesin dhe Raxhihun në krevatin e vdekjes, por në vend që t'u tregojë të vërtetën zemërohet dhe nuk u thotë gjë.

#### Kapitulli IV Su-i Zan

Pesë muaj më pas Bikesi është martuar me Raxhih. Motra e Raxhih, Tevexhyh është bërë mike me Bikesin. Tezja e Raxhih e kalon kohën në varrin e vajzës dhe mundohet të shajë Bikesin të cilën e konsideron shkaktare të vuajtjeve të saj. Fjalët e Shahides, tezës së tij dhe ndjenja e fajit që kishte lënë të vdiste një vajzë të sëmurë pa ja plotësuar dëshirën e fundit po e shtypnin Raxhihun përditë e më shumë. Ndërsa Bikesi ende vuante ndjenjën e fajit dhe mundohej të mbante të fshehur identitetin duke menduar se nëna me babain e saj ende jetonin bashkë. Bashkëjetesa mes të dyve ishte kthyer në një varr për të dy.

Raxhih e kalonte kohën duke gatuar për të varfrit. Motra Tevexhyh i dërgonte këto ushqime tek gjyshe Kurshunxhu që ja ndante të varfërve. Një ditë tek shtëpia e gjyshe Kurshunxhu gjen një djalë të sëmurë. Ajo i thotë që është djali i tyre i kthyer nga lufta, por Tevexhyh nuk e beson pasi ai ishte i mirë edukuar.

Disa ditë më vonë pasi kishin krijuar afrimetet djali i thotë që ishte nga një familje fisnike. Ai i shpreh ndjenjat, por Tevexhyh i thotë që babai e ka fejuar me një djalë të quajtur Muti dhe s'mund të martohej me të.

Në fakt ky i ri ishte vetë Muti. Ai e ndjek vajzën deri në shtëpi, por atje sheh Shahiden dhe ikën. Shahide shkon i thotë Raxhih që Bikesi e tradhton dhe bën sikur djali që kishte ndjekur Tevexhyhin kishte ndjekur Bikesin. Raxhih edhe pse në fillim nuk dyshon duke parë sjelljet e çuditshme të Bikesit i beson dhe e godet Bikesin me shpullë, por menjëherë pendohet dhe i kërkon të falur.

Të nesërmen Muti i dërgon një letër Tevexhyhit duke i thënë se do të vijë. Tevexhyh dhe Bikesi secila për arsye të ndryshme janë të shqetësuara. Të nesërmen Bikesi i afrohet lumit dhe pasi flet me veten vendos të vrasë veten. Muti, i cili po kalonte aty e dëgjon dhe kupton se ajo është Memune. Bikesi hidhet në ujë për të vdekur. Muti hidhet nga pas për ta shëtpuar. Atë e ndihmon Rusheni dhe kur dalin në breg Bikesi, e cila e njeh vëllanë i thotë që është e pafajshme dhe i lutet të mos e dorëzojë në polici. Muti i thotë se e di të vërtetën dhe se do ia tregojë në shtëpi.

Raxhih kur nuk e gjen Bikesin merakoset. Tezja Shahide, të cilës i vjen rasti në dorë i thotë që Bikesi po vjen me të dashurin e saj në shtëpi. Raxhih i tërbuar rrëmben pushkën dhe i qëllon Bikesit dhe Mutit kur ata po futeshin në shtëpi. Për fat të mirë plumbat nuk i kapin. Ata largohen me qëllimin që t'ia shpjegojnë të gjitha me një letër.

#### Kapitulli V Tehyin-i Hakikat

Muti dhe Memnune vendosen në vilën e babait të tyre në Yskydar. Pasi e riparojnë i hapin dyert për të ndihmuar miqtë dhe të varfrit. Një ditë atje kalon një grua me shërbëtoren e saj. Ajo ishte Natika. Zëri i Memunes i duket si zëri i Bikesit. Memune i tregon kush ishte në të vërtetë dhe gjithë historinë.

Në të njëjtën kohë Muti pasi kishte vënë punët në vijë i dërgon një letër Raxhih dhe Tevexhyh duke i ftuar në vilë. Pas tri javësh Raxhih vjen me gjithë motrën. Memune në fillim takoh Tevexhyh dhe i tregon të vërtetën. Ndërsa Muti flet me Raxhih i cili i tregon për tradhtinë e Bikesit. Në atë çast futet brenda Memune me Tevexhyh. Raxhih tenton të godas Bikesin (Memunen), por Muti ndërhyr duke i treguar gjithë historinë.

Raxhih kërkon falje nga Memune dhe ribashkohen. Ndërsa Muti martohet me Tevexhyh dhe romani mbaron me realizimin e dëshirave të prindërve të tyre.

### **Bluja dhe e Zeza (1896)**

Romani “Bluja dhe e Zeza” i shkrimtarit Halit Zija Ushakllëgil mbahet si pika e kthesës në romanin turk. Me këtë roman shumë studiues turq mendojnë se romani turk e kalon periudhën kur mund të quhej fillestar dhe futet si një gjini letrare e konsoliduar në letërsinë turke., por sipas mendimit tonë edhe pse ka një strukturë më të mirë organizuar ai nuk ndryshon shumë nga romanet e tjerë për nga rrjedha e ngjarjeve.

Me rastin e dhjetë vjetorit të gazetës Mir’at-i Suun shtatë gazetarët e kësaj gazete mblidhen për të festuar. Këta janë Ahmet Xhemil, Sait, Raxhi, Hysein Baha, Ahmet Shevki, Saib dhe Ali Sekip.

Gjatë darkës Ahmet Xhemili mbron shokun e tij të fëmijërisë Hysein Nazmiun nga kritikën e pabaza që i bëhen sipas tij. Madje ai pretendon se me poezitë e tij ai kishte hapur një faqe të re në poezinë turke., por asnjë nga pjesëmarrësit e tjerë, sidomos Raxhi, nuk i mbështet këto mendime.

Pas festës duke u kthyer në shtëpi Ahmet Xhemili ndalet poshtë një peme dhe pasi shtrihet aty zhytet në ëndërrime. Ëndërron të ishte i shumë famshëm, poet, pronar i një gazete dhe i një shtëpie botuese, burri i një gruaje të dashur dhe i martuar lumturisht.

Edhe pse kishte vetëm një vit që ishte në botën e botuesve ai kishte parë shumë xhelozë dhe urrejtje mes botuesve. Megjithatë ai kishte arritur të respektohej nga të gjithë. Ndërsa Raxhi ishte një njeri që e kishte filluar çdo gjë nga zero dhe synonte të bëhej një poet i famshëm. Varfëria e tij e kishte bërë të ishte një njeri xheloz dhe i mbushur me urrejtje ndaj të tjerëve, sidomos të pasurve dhe njerëzve me talent.

Kryeredaktori Ali Sekip, ishte një njeri modest, fjalë pak dhe shumë i zgjuar. Saiti ishte një njeri që kopjonte sjelljet e të tjerëve pasi nuk kishte një karakter të tijin. Saibi ishte një i ri thatim që informohej për çdo gjë. Ndërsa administratori Ahmet Sevki dhe financuesi Hysein Baha ishin njerëz zemër bardhë që nuk ngatërroheshin me njeri.

Ahmet Xhemil jetonte i lumtur me nënën, motrën Ikbal dhe shërbëtoren Seher në shtëpinë e blerë nga babai në lagjen Sylyjmanie. Deri në moshën katërmëdhjetë vjeçare kishte studiuar në shkollë me konvikt. Atje ai ishte njohur me Hysein Nazmi.

Së bashku lexonin poezi ose bënin përkthime. Hysein Nazmi ishte shumë i pasur. Ndërsa Ahmet Xhemil pas vdekjes së babait ishte detyruar të mbante

shtëpinë. Në fillim punon si përkthyes librash për shtëpitë botuese, por nuk fiton aq sa të mbaj shtëpinë.

Një ditë ai mëson se në gazetën Mir'at-i Suun kërkonin një përkthyes për një roman. Ahmet Xhemil shkon atje dhe kështu fillon punën në gazetë. Pas kthimit nga shkolla ai përkthente pothuajse gjithë ditën. Kështu që fillon të marr nota jo të mira në shkollë. Për më tepër tani nuk takohet shumë me Hysein Nazmi pasi njëri studionte ditën kurse tjetri ishte me konvikt.

Ahmet Xhemil synon të krijojë një shtëpi botuese dhe të bëhet poet. Për këtë arsye ai punon vazhdimisht. Madje tri herë në javë jep mësim për një djalë të vogël. Me gjithë këto punë që bënte ai arrin të marr diplomën.

Të nesërmen në mëngjes kur kthehet në gazetë Ahmet Xhemili gjen para derës gruan dhe djalin e Raxhiut. Raxhi kishte kohë që kthehej në shtëpi i dehur. Për më tepër dilte me femra të tjera. Gruaja ishte e shqetësuar për të ardhmen e djalit.

Saiti dhe Saibi i thonë Ahmet Xhemilit që kishin parë Raxhiun me një këngëtare gjermane. Pasi dëgjojnë për këtë gjë Ahmet Xhemil dhe Ahmet Sevki vendosin të flasin me të.

Atë ditë pas pune Ahmet Xhemil shkon në shtëpinë e Hysein Nazmiut. Tek dera e pret motra e vogël e tij Lamia. Ai i tregon shokut të tij për kritikën ndaj poezive që shkruan., por Hysein Nazmi nuk e vret mendjen shumë.

Në të njëjtën kohë Ahmeti po punonte të shkruante një poezi mbi jetën. Ai kërkonte të përziente tradicionale me moderne. Kur ja thotë këtë gjë Hysein Nazmiut ai i premtonte që do të bëjë një festë kur ta mbarojë. Më pas ata dëgjojnë Lamian të luaj piano.

Të nesërmen Ahmet Sevki Efendi i kërkon Ahmet Xhemilit të shkojnë në Bejoglu për të kontrolluar për Raxhiun. Edhe pse nuk e duan Raxhin atyre u vjen keq për gruan dhe djalin e tij.

Ata e gjejnë Raxhin në një lokal me muzikë. Atje këndonin femra nga Evropa. Ai ishte dashuruar me një këngëtare gjermane, por ajo nuk ja varte. Kështu që ai pinte nga mërzia. Në këtë kohë djali i Raxhiut, Nedimi fillon të punojë në gazetë. Atë e duan të gjithë përveç babait të tij.

Një ditë maji Ahmet Sevki i kërkon Ahmet Xhemilit të flasë në lidhje me motrën e tij Ikbale. Ai mendonte të martonte Ikbalen me Vehbi Beun, djalin e pronarit të shtypshkronjës. Ahmet Xhemilit nuk i pëlqen të ketë një njeri të huaj si kunat, por edhe mundësia që ta martojë motrën me një njeri të pasur i pëlqen, pasi motra do jetonte një jetë të mirë.

Ikbali pranon dhe e martojnë. Pas martesës Ahmet Xhemili për pothuajse një javë nuk vjen në shtëpi duke qëndruar tek Hysein Nazmiu. Kur kthehet në shtëpi ndihet i huaj. Për këtë arsye fillon të jap më shumë mësim në darkë. Kthehet shumë vonë në shtëpi dhe largohet shumë herët., por pas dy muajsh një mëngjes nëna i thotë se Ikbali qante fshehtas dhe ishte e trishtuar. Ahmet Xhemili e pyet, por ajo nuk tregon gjë.



Në të njëjtën ditë kur shkon në shtypshkronjë mëson se Tevfik Beu, babai i Vehbi Beut ishte martuar me një vajzë gjashtëmbëdhjetë vjeçare.

Atë vit, sidomos dimri kalon shumë i lodhshëm për Ahmet Xhemilin. Nga një anë puna në shtypshkronjë dhe gazetë, nga ana tjetër mësimet private, mos pëlqimi i kunatit dhe përpjekja për të mbaruar librin me poezi e sjellin në pikën e fundit të durimit.

Por me mbarimin e librit me poezi qetësohet. Një ditë niset t'ia tregojë poezitë Hysein Nazmiut, shokut të tij. Rrugës takohet me Lamian të cilën kishte gati një vit pa e parë. Lamia kishte ndryshuar shumë dhe nga një vajzë e vogël ishte kthyer në një zonjushë të vërtetë. Ai fillon t'i flasë për poezitë që kishte shkruar. Ahmet Xhemili i tregon për dashurinë që kishte kërkuar gjatë shkrimit të poezive., por gjatë bisedës Ahmet Xhemili kupton që në fakt ato poezi i kishte shkruar për Lamian. Ai dashurohet marrëzisht me të.

Një natë vonë dëgjohej trokitje në derë. Një shërbëtor i lajmëron se Tevfik Beu, babai i Vehbi Beut ishte paralizuar. Që të nesërmen në mëngjes Vehbi Beu shkon në shtypshkronjë dhe merr kontrollin. Fillon të kërkojë llogari dhe sillet keq me të gjithë.

Të nesërmen kur shkon në shtypshkronjë nga Nedimi mëson se Raxhi ishte shumë keq pasi këngëtarja gjermane as nuk i hidhte sytë dhe nga pija po tretej përditë e më shumë.

Ali Sekip duke e ditur që Vehbi Beu donte ta largonte nga bordi drejtues me disa para që do të merrte nga kunati po mendonte të hapte një dyqan. Vehbi Beu nuk ndalet me kaq. Ai kërkon të largojë edhe Hysein Bahan. Ai mendon t'ia lë drejtimin e gjithë gazetës Ahmet Xhemilit dhe nuk dëshiron të paguaj njerëz kot. Gjithë punën do e bëjnë Ahmet Xhemil, Saiti dhe Saibi.

Në fund ai i kërkon Ahmet Xhemilit të bëhet ortak në shtypshkronjë duke vënë në hipotekë shtëpinë dhe duke blerë me paratë e marra disa makineri. Me anë të makinerive do e paguanin lehtësisht borxhin.

Me makineritë e blera ata me të vërtetë fitojnë shumë para., por Ahmeti me Saitin dhe Saibin i kalojnë netët me radhë në gazetë.

Ahmet Xhemili e kishte mbaruar së përgatituri librin dhe Hysein Nazmi e mban fjalën dhe përgatit një pasdite letrare duke ftuar miqtë e tij dhe disa shkrimtarë të tjerë. Gjatë leximit të poezive shokët e tij e dëgjojnë edhe me habi edhe me pak xhelozë, por me seriozitet.

Gjatë leximit të poezive futet brenda Lamia dhe Ahmet Xhemilit i mbahet zëri, por e kalon shpejt këtë hutim. Pas poezive Raxhi e akuzon se Vehbi e kishte pushuar nga puna për shkak të tij. Ahmet Xhemili mërzhitet shumë prej kësaj akuze. Gjatë një çasti që i kalon Lamia pranë mendon t'i shpreh dashurinë, por më pas heq dorë. Rrugës për në shtëpi sheh që nuk ka librin. Kthehet dhe e gjen në dhomën e ngrënies.

Të nesërmen Ahmet Xhemil dëgjon të qarat e Ikbalit. Kur e pyet motrën për shkakun ajo nuk i tregon gjë. Në dhomë vjen Sabihaja, nëna e Ikbalit dhe i tregon që Ikbali është shtatzënë, Vehbi Beu ngacmon shërbëtoren Seher, për më tepër

poshtëron Ikbalin dhe disa herë kishte kaluar natën me nusen e re të babait të paralizuar.

Ahmet Xhemili vendos që të vazhdojë të punojë në shtypshkronjë sa të zhbllokojë hipotekën e shtëpisë, pastaj do martohet me Lamian dhe do e ndaj Ikbalin nga Vehbiu dhe kështu do jetojnë të lumtur. Në fund të librit me poezi Ahmet Xhemili lexon fjalët të lumtë të shkruara nga Lamia.

Të nesërmen kur kthehet në gazetë ai sheh që shokët po talleshin me poezitë që lexoi në darkë. Në gazetën e mëngjesit Raxhi kishte shkruar një kritikë tallëse. Edhe pse mundohet të mos e shpreh Ahmet Xhemili trishtohet kur mendon që këto gjëra do i lexojë Lamia.

Ahmet Sevkiu e këshillon të mendojë për motrën për momentin. Ai i thotë të durojë dhe të punojë në shtypshkronjë deri sa të fitojë paratë e nevojshme. Duke punuar mes makinerive Ahmet Xhemili sheh Raxhin në gjendje shumë të keqe dhe e dërgon në spital.

Kur kthehet në shtëpi dëgjon debate mes Vehbi Beut dhe të motrës për shkak të shkrimit në gazetë. Të nesërmen Ahmet Sevki Efendi me një shkrim në gazetën Mir'at-i Suun deklaroi që kryeredaktori i gazetës ishte Osman Tajar dhe jo Ahmet Xhemil.

Ahmet Xhemili mendon të marr makinat dhe t'i jap me qira, por nuk ka asnjë mundësi pasi nuk ka para. Ai është i detyruar të punojë për Vehbi Beun, por duke mos dashur ta shikojë me sy nuk shkon në shtypshkronjë.

Vehbi Beu përfiton nga kjo gjë dhe fillon të abuzojë edhe më shumë me Ikbalin duke thënë që tani ai i mbante me bukë. Një ditë e godet aq fort Ikbalin sa ajo shtrihet në tokë pa ndjenja. Ahmet Xhemil i sulet Vehbi Beut ta godasë, por e ndalon e ëma.

Duke parë që kështu nuk shtyhej Ahmeti shet florinj të e të ëmës që ta shpëtonte shtëpinë. Kur kthehet me paratë me vete shërbëtorja i tregon se Ikbali po humbiste gjak. Doktorin u thotë që fëmija kishte dështuar. E keqja nuk mbaronte me kaq. Ikbali sa vinte e përkeqësohej. Pas disa ditësh Ikbali vdes në krahët e Ahmetit. Ahmeti plakët sikur të ishte 50 vjeç.

Pasi e varros Ikbalin i trishtuar shkon të takojë Ali Sekipin tek dyqani i tij. Atje takon edhe Ahmet Sevki Efendin. Duke biseduar shohin Nedimin duke shitur gazeta dhe vendosin të shkojnë të takojnë Raxhin në spital. Atje shohin që Raxhi ishte shumë keq dhe po i afrohej vdekjes.

Kur kthehet në dyqanin e Ali Sekipit shohin një letër tek xhami. Hysein Nazmi i shkruan se duhet të takohen sepse ka lajme të këqija. Ahmet Xhemili shkon me nxitim në vilën e tij. Kur e takon shokun ai i thotë se do nisej për në Evropë me një detyrë shtetërore, ndërsa Lamia do martohet me një oficer. Ahmet Xhemili tronditet shumë. Ai pendohet që nuk e kishte kërkuar dorën e Lamias që më parë, por e dinte që nuk kishte mjaftueshëm para për ta bërë një gjë të tillë.

Pas këtij lajmi ai shkon dhe qan në varrin e motrës. Në kthim takohet me granën e Raxhit. Ajo po shkonte të shiste aksionet e trashëguara nga babai për të

shpëtuar Raxhiun. Ahmeti mendon se gratë janë njerëz me të vërtetë hyjnore pasi falin edhe gabimet më të mëdha.

Duke kaluar në një rrugë përballet me Vehbi Beun i cili i zgërdhiet para syve. Nuk duron dhe e godet në fytyrë me sa ka fuqi. Tani ishte qetësuar.

Shkon në dyqanin e Ali Sekipit. Atje takon Hysein Bahan. Edhe ai ishte përplasur me Vehbiun pasi nuk i jepte pjesën e tij. Vehbi Beu po falimentonte. Ndoshta do e mbyllte shtypshkronjën.

Pesë vite pas vdekjes së babait Ahmet Xhemili kishte vrapuar pas shumë ëndrrave, por kishte përjetuar dhimbje të mëdha prej këtyre ëndrrave. Kishte humbur Ikbalin dhe Lamian. E vetmja gjë që i kishte mbetur në dorë ishte libri me poezi. Fillon ta grisë faqe për faqe dhe ta hedhë në zjarr.

Me një fije të fundit shprese mendon një tentativë të fundit. Do të largohet larg. Në një vend të largët. Fundja kishte diplomën. E ëma pranon pa dëshirë. Duke u nisur për në anije takon Hysein Nazmiun. Ai po largohej për në Evropë ndërsa Ahmeti drejt detit të kuq në një vend rrethuar me shkretëtira.

Pasi i vendos në dhomë të ëmën dhe shërbëtoren Seher del në kuvertën e anijes dhe bën llogarinë e jetës së tij. Ishte një natë e zezë. Në mendje i vjen ajo pema në Haliç ku kishte thurur ëndrrat në një natë blu nën shiun e yjeve.

Fillon të bëjë krahasimin mes asaj nate blu dhe kësaj nate të zezë.

Bluja dhe e zeza.

Ai shikon detin. Një det i zi. Mendon të hidhet dhe të shpëtojë nga kjo jetë mizore., por në çastin që do hidhte hapin përfundimtar dëgjon zërin e nënës. Vendos të largohet nga kjo natë e zezë dhe të vazhdojë jetën.

#### **4.2.2. Romanet aventurore**

Romanet me aventura në periudhën e dytë të letërsisë së Tanzimatit vazhdojnë të kenë interesimin e shkrimtarit Ahmet Mid'hat. Ndryshe nga periudha e parë e letërsisë së Tanzimatit ku e merr temën nga ngjarjet dhe personazhet vendase këtë herë ai përdor personazhe të huaj, perëndimorë, dhe ngjarjet i zhvillon jashtë shtetit. Për nga ana letrare ato vazhdojnë të lenë për të dëshiruar, por në thelbin e tyre kanë dy pikësnyime. Argëtimin e lexuesit, mundësisht duke e edukuar.

#### **Hajdut Montari (1888)**

Ky roman i shkrimtarit Ahmet Mid'hat Efendi edhe pse është roman policesk ndryshon nga romanet e tjerë të shkruar më parë. Ndryshimi qëndron në faktin se edhe ngjarjet edhe personazhet nuk janë turq. Për më tepër ngjarjet ndodhin diku në Itali dhe jo në territoret Osmane.

Angelina, Madamë Del Castelnora, vazhdonte të mbante zi edhe pse kishin kaluar dhjetë vjet nga vrasja e babait. Ajo jetonte me hallën e saj.

Me rastin e dhjetë vjetorit të vrasjes së babait të saj ajo mban një meshë në kishë së bashku me miqtë e familjes. Gjatë kthimit në shtëpi Xhorxhio, një njeri që ishte bërë një tregtarë i pasur pasi e kishte filluar punën si timonier në anijet tregtare të Kontit të Castelnorës, i kërkon dorën për t'u martuar. Angjelina përveç se nuk e dashuronte Xhorxhion dëshironte të zbatonte amanetin e fundit të babait të saj Kontit Xhovani i cili ja kishte premtuar vajzën e tij Angjelinën, Andreas, djalin të kryegjuetarit të tij Nikola Satanja.

Familja e Angjelinës edhe pse kishte qenë shumë e pasur kishte filluar të humbiste pasurinë e saj për shkak se nuk kishin një mashkull që ta drejtonte. Pas një kontrolli që bëjnë njerëzit e taksave del që ishin bërë gabime në pagesat e taksave dhe se familja e kontit duhet të paguante një shumë të madhe parash të papaguara.

Kjo ishte goditja e fundit. Familja detyrohet të shpall falimentin dhe të shesë kështjellën ku jetonte. Xhorxhio e blen kështjellën për shumë pak para. Për të treguar dashamirësinë e tij ai ja dhuron Angjelinës kështjellën dhe i premtonte që do kujdeset për jetesën e saj.

Në fakt Xhorxhio ka tri arsye se pse e bën këtë gjë. E para duke blerë kështjellën dhe duke ja dhuruar përsëri Angjelinës ai shpreson të fitojë dashurinë e saj. E dyta ai ka mundësi të dëbojë nga kështjella Andrean, konkurrentin e tij në dashuri dhe e treta me martesën me Angjelinën ai shpreson të ngrihet në rangjet e fisnikërisë së zonës. Fundja edhe pse të falimentuar titulli i kontit prapë kishte vlerë.

Në të njëjtën ditë kur Xhorxhio dëbon Andrean nga kështjella ai takon ruajtësin e qenve të kështjellës. Ky njeri mendohej se kishte vdekur së bashku me kontin shumë vite më parë. Ky person i njihte vrasësit e kontit pasi edhe atë vetë e kishin lënë duke e kujtuar për të vdekur pasi kishin vrarë kontin.

Ai i tregon Andreas se vrasësit e kontit ishin Xhorxhio dhe Gargula. Pas vrasjes së kontit ata të dy me anë të mashtrimit kishin marr gjithë pasuritë e kontit. Tani Xhorxhio ishte një njeri shumë i pasur dhe asnjëri nuk mund t'i kundërvihet.

Andrea e dinte shumë mirë fuqinë që të jepte paraja. Për t'iu kundërvënë Xhorxhios ai duhet të bëhej më i pasur se ai. Për t'ia arritur qëllimit ai bën disa plane., por ai duhet të largohet nga vendi pasi aty ai nuk do kishte mundësi të bënte ndonjë gjë pa e marrë vesh Xhorxhio.

Para se të largohet ai flet me Angjelinën. I thotë se ajo duhet ta presë edhe po nuk mori ndonjë lajm sepse ai do të vijë dhe do ta shpëtojë nga intrigat e Xhorxhios. Angjelina nuk dëshiron që ai të ikte, por detyrohet të pranojë.

Andrea largohet nga vendi, por Xhorxhio, i cili ishte dyshues për çdo gjë, nuk kënaqet dhe i vë nga pas një nga njerëzit e tij. Vetëm pas disa përpjekjeve Andrea arrin të zhduket pa lënë gjurmë.

Xhorxhio pasi bindet se Andrea nuk do të kthehet më fillon të jetojë më lirshëm. Ai ndërton një pallat shumë të bukur në Napoli dhe fillon të jetojë aty me motrën e tij, vejushë Margaritën. Margarita ishte rreth të pesëdhjetave.

Xhorxhinio nuk dinte që Margarita ishte nëna e Andreas. Shumë kohë më parë Margarita kishte qenë e dashuruar me kryegjahtarin e Kontit, Nikola Satanjan. Pasi kishte mbetur me barrë dhe kishte lindur një djalë asaj ja kishin marrë djalin dhe ajo nuk e kishte parë më me sy. Nikola Satanja kishte mbetur i vrarë në të njëjtin kurth ku ishte vrarë edhe konti.

Margarita edhe pse nuk kishte asnjë ide se ku mund të ishte djali i saj prapë se prapë shpresonte që një ditë do ta shihte përsëri. Në shtëpinë e Xhorxhios dhe Margaritës vinte shpesh Gagula miku i Xhorxhios. Gjatë vizitave ai shpreh më shumë se një herë dëshirën që të martohet me Margaritën., por Margarita e refuzon në mënyrë të prerë.

Gjatë vizitave që bënte Gagula në shtëpinë e Xhorxhios nganjëherë flisnin edhe për vrasjet që kishin bërë. Kuptohet që këto biseda i bënin nën zë dhe larg syve të njerëzve.

Në këtë periudhë fillojnë të dalin fjalë për një hajdut famë keq. Ky hajdut i quajtur Montari dërgonte letra ku kërkonte ti paguheshin shuma të mëdha. Në këmbim ai nuk i prekte njerëzit që paguanin rregullisht., por nëse ti nuk paguaje atëherë ai jo vetëm që të grabiste gjithë pasurinë, por edhe të vriste.

Një ditë kur këta të dy ishin duke biseduar fshehtas vjen një lypsar i quajtur Xhordino i cili i sjell Xhorxhios një letër nga Hajdut Montari. Hajdut Montari i kërkonte njëzetë mijë livre haraç.

Xhorxhio në fillim frikësohet., por pastaj mendoj të thur një plan. Hajdut Montari dukej se kishte spiunë kudo pasi i njihnte mirë pasuritë e njerëzve dhe mund t'i gjente kudo ku ata shkonin të fshiheshin. Duke i dhënë paratë Hajdut Montarit ai do e përdorte atë për të hequr qafe një herë e mirë Andrean. Me këtë qëllim ai fillon të mbajë lidhje të shpeshta me anë të lypësit Xhordino.

Lypsi Xhordino fillon të vijë më shpesh në shtëpinë e Xhorxhios. Gjatë vizitave ai mëson se Margarita kishte një fëmijë. Pas disa kërkimeve ai mëson se ky fëmijë ishte Andrea. Pasi e mëson këtë gjë ja tregon Margaritës dhe i merr një deklaratë ku ajo e pranon që është nëna e Andreas.

Pak nga pak planet që kishte thurur Andrea po vihen në zbatim. Në fakt Hajdut Montari dhe lypësi Xhordino janë i njëjti njeri, Andrea. Andrea duke u hequr si Hajdut Montari jo vetëm që u grabit shuma të mëdha parash mashtruesve dhe njerëzve të këqij, por edhe mëson shumë fakte të cilat më vonë do t'i përdorë si prova kundër Xhorxhios.

Plani që Xhorxhio kishte përgatitur për vrasjen e Andreas i kthehet kundër. Andrea pasi ja dorëzon gjithë faktet policisë bën të mundur që të arrestohen Xhorxhio dhe Gagula.

Në përfundim të gjyqit që zhvillohet Xhorxhio dënohet me vdekje. Ndërsa Gagula dënohet me burgim të përjetshëm pasi i kishte pranuar krimet e bëra. Në të njëjtën kohë Andrea më në fund takohet me nënën e tij që nuk e kishte njohur kurrë. Pas përfundimit të gjyqit dhe dënimit të fajtorëve Andrea martohet me Angjelinën që e kishte pritur me dashuri.

## Konkurenca (1896)

Në këtë roman shkrimtarja Emine Semije i zhvillon ngjarjet në Evropë duke i kaluar nga një shtet në një tjetër.

Në kapitullin e parë të romanit kemi vetëm biseda mes atyre që më pas do jenë personazhet e ngjarjeve. Në kapitullin e dytë fillojmë të njihemi me personazhet.

Ngjarjet zhvillohen mes tri familjeve aristokrate Italiane, Franceze dhe Angleze. Metofi An, vajza e madhe e Markezit Francez De Brian, martohet me Sër Tomsonin, një fisnik anglez. Ndërsa vajza e vogël Diana martohet me kontin Italian De Villanora.

Metofi An largohet në Angli ku pas pak kohësh lind një vajzë me emrin Klaris. Klarisa rritet mes gjithë të mirave, por pas disa kohësh i vdesin si nëna dhe i ati.

Ndërsa Diana largohet për në Itali ku lind një djalë me emrin Eduart. Pas vdekjes së motrës me burrin e saj Diana shkon në Paris dhe takohet me Klarisën duke e marr pranë vetes. Për hir të edukimit të Klarisës ata jetojnë për disa kohë në Paris.

Kur Klarisa arrin moshën madhore ajo martohet me Eduartin, djalin e tezes. Gjatë një ballo me maska që bëhet në Paris një grua e maskuar i thotë disa fjalë Klarisës që e bën atë të dyshojë. Të nesërmen ajo e takon këtë grua që quhej Lavinien, në një ekspozitë, por nuk e njeh. Eduarti sapo i sheh duke folur e largon menjëherë Klarisën nga aty.

Dy muaj më vonë ata largohen për në Itali. Ata vendosen në Napoli së bashku me tezen e Klarisës, nënën e Eduartit. Shqetësimet nuk e lënë të qetë as këtu. Fillon të marr letra anonime ku e këshillojnë që ta mbaj Eduartin larg një gruaje të ve spanjolle të quajtur Madam Baron Blank De Marselo.

Ngjarja në Paris dhe këto letra anonime ia prishin qetësinë shpirtërore Klarisës. Ajo fillon të mos besojë tek Eduarti. Me kalimin e kohës ajo fillon ta bezdisë me pyetjet dhe me kontrollet që i bën.

Gjatë një shëtitjeje nëpër qytet Eduarti me Klarisën hyjnë në një kishë për të shikuar pikturat. Për çudinë e të dyve atje gjendet Lavinia e cila po varte pikturën e një shenjtoreje që nga fytyra i ngjante Klarisës. Eduarti përshëndetet me Lavinian. Klarisa e sheh dhe dyshon. Kur e pyet të nesërmen se nga e njihnte atë femër Eduarti i tregon se para se të bëhej piktoresh Lavinia kishte qenë një soprano shumë e famshme që e njihnin të gjithë.

Tashmë shqetësimet e Klarisës në lidhje me tradhtinë e Eduartit bëhen edhe më të mëdha. Një natë mësojnë se një nga çifligjet e tyre kishte marr zjarr. Eduarti largohet dhe nuk po kthehej. Klarisës i vjen një pusullë ku i thuhet se nëse dëshironte të shihte me sytë e saj tradhtinë e Eduartit le të vinte në mesnatë në një vend të fshehtë.

Klarisa e tronditur dhe e zhgënjyer nga besnikëria që pretendonte Eduarti të kishte për të, nisat më herët dhe fillon të presë në vendin e caktuar. Duke menduar çdo bënte pasi të mësonte të vërtetën ajo mendon të vrasë veten.

Në orën e caktuar shfaqet një zonjë e maskuar. Ajo i thotë Klarisës se Eduarti e kishte tradhtuar me znj. Blank De Marselo dhe se ajo kishte fakte të cilat do ja tregonte Eduartit., por dëshironte që edhe ajo të ishte prezent aty kur t'ia jepte. Në atë çast gruaja e mbuluar heq maskën duke treguar fytyrën e vërtetë. Ajo ishte Lavinia. Pikërisht në këtë çast vjen Eduarti. Ai i thotë se për pak ishte duke rënë në kurthin e Lavinies.

Pasi e dëbon Lavinia ai i shpjegon se me Lavinian kishte pasur një lidhje të shkurtër para se të martoheshin., por ai dashuronte Klarisën dhe i kishte dhënë fund lidhjes me të. Ndërsa Madam Blansh De Marselo i kishte shprehur dashurinë para se të martohej me Klarisën. Kur ai nuk ia kishte kthyer dashurinë që ajo ndiente, kishte filluar ta ngacmonte me letra dhe ngaqë e urrente gruan e tij i kishte dërguar letra që ta bënte të dyshonte.

Më pas Eduarti ia tregon me fakte këto që tha. Klarisës i shuhet dyshimi dhe çifti jeton i lumtur.

### **4.2.3. Romanet policore**

Romanet policeske ishin një e re absolute në letërsinë turke dhe janë nën ndikimin e plotë të letërsisë perëndimore. Shkrimtari i vetëm që merr guximin të shkruaj një roman të tillë është Ahmet Mid'hat Efendi i cili shquhet për guximin e tij për të shkelur në fusha të paprekura më parë në letërsi.

#### **Një vrasje misterioze (1884)**

Ky roman i shkrimtarit Ahmet Mid'hat Efendi është një nga romanët e parë për të mos thënë i pari nga romanët policesk në letërsinë turke. Arsyen e shkrimit të këtij lloj romani mund ta gjejmë shumë thjeshtë në dëshirën e shkrimtarit për të prekur çdo lloj stili të romanit që shkruhej në atë kohë në perëndim.

Në gazetën e Stambollit ishte shkruar mbi një vrasje të ndodhur në anën e Detit të Zi të Ngushticës së Bosforit në zonën Oreke e cila ishte e mbushur me shkëmbinj. Në lajmin e dhënë në gazeta shkruhej se peshkatarët gjatë kthimit nga peshkimi në det të hapur duke kaluar pranë Orekes kishin gjetur tri trupa njerëzish të shtrirë mes shkëmbinjve. Një nga trupat i përkiste një femre të re rreth gjashtëmbëdhjetë shtatëmbëdhjetë vjeçe. Ndërsa dy trupat e tjerë ishin meshkuj më të rritur.

Për hetimin e këtij krimi dërgohet hetuesi Osman Sabri, një nga hetuesit më të mirë të komisariatit të policisë së Bejoglusë. Osman Sabriu shkon në vendngjarje dhe sheh se trupat e vdekur ishin lëvizur nga vendi dhe nuk ishin ashtu siç duhet të ishin sipas mendimit të tij. Megjithatë ai arrin të gjejë disa të dhëna të rëndësishme në lidhje me ngjarjen.

Ai i shkruan në raport këto të dhëna dhe ja dorëzon shefit të tij, Mexhdedin Pashës. Gjatë dorëzimit të raportit aty ndodhet një gazetar i cili kërkon ta bëjë publik lajmin. Mexhdedin Pasha pranon, madje ai ja jep ta lexojë gjithë raportin., por Osman Sabri i kërkon gazetarit që të mos shkruaj për të dhënat që kishte gjetur ai. Gazetari pranon dhe kështu fiton mirënjohjen e Osman Sabriut.

Me nxjerrjen e lajmit në gazetë edhe vetë gazetari bëhet pjesë e hetimit. Më tepër nga kurioziteti sesa nga ndonjë interes personal. Osman Sabriu vihet pas të dhënave që kishte gjetur. Me anë të rrobave që kishte gjetur në trupin e vajzës ai gjen se ku ishin blerë. Rrobaqepësi në fillim mundohet ta fshehë se ku e kishte shitur veshjen, por dorëzohet pas presionit të bërë nga Osman Sabriu se po pengonte hetimin dhe do futej në burg.

Veshja ishte porositur nga familja e të ndjerit Kemanizade Mustafa Beu. Personi që e kishte porositur ishte znj. Hedije. Kur Osman Sabriu informon për këtë zbulim shefën e tij, ai i nevrkosur i kërkon ta mbyll këtë çështje ose do ta largonte nga puna. Arsyeja e këtij nervozizmi ishte marrëdhënia dashurore që kishte Mexhdedin Pasha me znj. Hedije.

Osman Sabriu edhe pse bën sikur nuk do merret me këtë çështje, fshehtas i vazhdon hetimet. Për të marr sa më shumë informacione në lidhje me znj. Hedije ai përdorë një nga spiunët e tij. Nexhmiu, spiuni i tij i veshur si grua futet në haremin e znj. Hedije duke u hequr si shitëse diamantesh. Diamantet, Osman Sabriu i kishte marr hua nga disa argjendarë.

Pa kaluar një muaj ndodh një vetëvrasje, ose të paktën në pamje të parë dukej kështu. i varuri ishte Halil Suri, një tregtarë shumë i pasur nga Siria., por ajo që në pamje të parë dukej si një vetëvrasje pas kontrollit të kujdesshëm që i bën Osman Sabriu vendit të ngjarjes, del se ishte një vrasje.

Për më tepër kjo vrasje kishte lidhje me vrasjen e ndodhur në Oreke. Informacionin e gjetur ai e ndan me disa miq të tij., por habitet kur sheh se znj. Hedije ishte e interesuar për këtë informacion.

Me nuhatjen e një hetuesi të vërtetë ai e kupton që edhe në këtë vrasje kishte gisht ose të paktën informacion të rëndësishëm edhe znj. Hedije. Kjo gjë i hap shumë telashe. Shefi i tij Mexhdedin Pasha i nevrkosur për lidhjen që i kishte bërë vrasjeve me znj. Hedije e pushon nga puna Osman Sabriun.

Argjendarët që kishin dhënë hua diamantet e tyre kur marrin vesh se Osman Sabriu ishte pushuar nga puna, shkojnë të kërkojnë stolitë, por diamantet e tyre ishin në shtëpinë e zjn. Hedije.

Osman Sabriu përfiton nga kjo ngjarje e re që në pamje të parë dukej si një problem i madh për të. Ai i këshillon argjendarët që të ankohen në gjykatë për diamantet që nuk i kishte kthyer. Me ankesën në gjykatë ngjarjet ndjekin me shpejtësi njëra tjetrën.

Tani çështja i ka kaluar një nivel më të lartë dhe Mexhdedin Pasha nuk ka më fuqi të ndërhyjë në mbrojtje të znj. Hedije. Së bashku me kërkesën për kthimin e diamanteve hapet edhe çështja e vrasjeve. Osman Sabriu duke përfituar nga kjo gjë nxjerr para gjykatësve edhe gjithë provat që ai kishte mbledhur, por që nuk kishte pasur mundësi ti nxirrte më parë për shkak të kërcënimeve të Mexhdedin Pashës.

Znj. Hedije merret në pyetje për diamantet. Gjatë pyetjeve ajo përveç diamanteve nxjerr edhe disa të dhëna të tjera. Në fakt znj. Hedije ishte pjesë e një grupi të madh falsifikatorësh që prodhonte para fallco. Prej asaj hetuesit arrijnë tek kryetari i grupit Mustafai. Znj. Hedije kishte edhe një rol tjetër. Duke pasur një



marrëdhënie dashurie me Mexhdedin Pashën ajo kontrollonte çdo hetim që mund të fillonte policia ndaj tyre. Pra ishin të sigurt në punën e tyre.

Në fund të gjyqit znj. Hedije dhe grupi i saj dënohen. Znj. Hedije dënohet me tri vjet punë të detyrueshme., por dënimi i dhënë ndaj saj ishte shumë pak sipas gazetarit. Ai shpresonte që edhe pse gjykata e dënoi pak ajo do të merrte dënimin e merituar nga Zoti. Disa vite më pas e shohim znj. Hedije të plakur duke lypur para një xhamie.

Kryetari i grupit të falsifikatorëve Mustafai kishte arritur të shpëtonte nga policia. Ai ishte arratisur në Vjenë. Pasi kalon pak kohë ai duke shpresuar që të ishte harruar kjo ndodhi niset për t'u kthyer përsëri në Stamboll. Gjatë udhëtimit ai pëson një aksident kur po kërkonte të vidhte ca arra në një fshat. Bie nga pema dhe vdes.

Edhe pse Mexhdedin Pasha nuk dënohet nga gjykata pasi sipas fjalëve që tha nuk kishte asnjë lidhje me falsifikatorët atë e dënon opinionin publik. Gazetari me shkrimet e tij bën që të gjithë të njohin se kush ishte në të vërtetë ky njeri i pushtetshëm. Ai detyrohet të largohet nga Stambolli. Me dënimin në mënyra të ndryshme të fajtorëve mbyllet edhe romani.

### **Çudia (1885)**

Romani “Çudia” i shkrimtarit Ahmet Mid’hat Efendi është në vazhdimësi të romanit “Një vrasje misterioze”. Këto kemi një roman policesk.

Ngjarjet fillojnë në ishullin Byjykada<sup>83</sup>. Princi Indian Safa Kok Sanç, së bashku me vajzën Mihriban, djalin Rizavend dhe gruan e tij Akasof vjen për të shëtitur Stambollin dhe vendoset në një hotel në Byjykada., por vendosja në hotel nuk ishte aq e lehtë pasi Princi kishte sjell me vete shumë sende. Megjithatë pas shumë pune ai vendoset në dhomat e hotelit.

Princi dhe familja e tij shëtisin Stambollin dhe vendet rreth e përqark duke shijuar jetën., por gjatë këtyre shëtitjeve dhe dëfrimeve një natë ndodh një grabitje. Hajdutët futen në dhomën e Princit.

Pasi e zgjojnë Princin nga gjumi, e detyrojnë të firmosë një letër. Më pas ata duan që ta vrasin, por kanë mosmarrëveshje mes tyre. Njëri nga hajdutët nuk është dakord me këtë gjë. Gjatë debatit ata dëgjojnë një zë që u thotë të mos e vrasin Princin.

Hajdutët mundohen të gjejnë nga vjen zëri, por nuk ja dalin. Hajduti me emrin Xhani, një italian, vendos ta vrasë dhe e godet me thikë., por thika thyhet në dy pjesë. Edhe hajdutët e tjerë tentojnë ta godasin, por u ndodh e njëjta gjë. Të frikësuar nga kjo gjë, ata ia mbathin.

Princi kur kishte ardhur në Stamboll e kishte modeluar dhomën sipas dëshirës së tij. Në një nga faqet e murit të dhomës ai kishte vendosur pikturën e Brahmas, Zotit Indian. Hajdutët kishin kujtuar se ndërhyrja mbinatyrore në mbrojtjen e Princit kishte ardhur pikërisht nga kjo pikturë.

---

<sup>83</sup> Ishulli më i madh nga shtatë ishujt që ndodhen përballë Stambollit në detin Marmara.

Princit i shtohet edhe më shumë besimi që kishte. Me gjithë mbështetjen që beson se i dha Zoti ai është i mërzitur për shkak të letrës që ka firmosur. Për më tepër pas ndjekjes së hajdutëve kthehet në dhomë vë re i llahtarisur se piktura e Brahmas ishte zhdukur. Ai denoncon menjëherë humbjen e pikturës në polici.

Nën drejtimin e shefit të policisë fillon ndjekja e hajdutëve. Njëri nga hajdutët kapet dhe pranon të bashkëpunojë. Policia gjen edhe pikturën e humbur dhe ja dorëzon Princit. Megjithatë dy hajdutët e tjerë, italianin Xhani dhe turkun Azmi arrijnë të largohen pa u kapur.

Pasi gjetjes së pikturës policia nuk i kushton më vëmendje. Për këtë arsye e lirojnë hajdutin e kapur. Princi ndihet i zhgënjyer nga kjo gjë dhe ankohet në ambasadën Angleze., por Princi bën një gabim dhe u thotë funksionarëve të ambasadës Angleze për zërin e çuditshëm dhe thyerjen e thikave që do ta vrisnin. Me të dëgjuar këto fjalë funksionarët e ambasadës mendojnë se Princi është çmendur dhe e përcjellin me fjalë të bukura, por pa u merakosur për të bërë ndonjë ankesë në policinë turke.

Pak ditë më vonë Princi merr një letër nga “një mik që i do të mirën”. Ai nuk ja tregon asnjëri se çfarë shkruhej në atë letër, por menjëherë bën gati valixhet dhe me gjithë familjen niset me anije në drejtim të Napolit.

Ngjarjet zhvillohen në Napoli. Gjithë Napoli është kurioz për këtë familje princërishe nga India. Në gjithë mbrëmjet e organizuara nga fisnikëria e qytetit Princi së bashku me familjen e tij do të ishte i ftuar dhe do të ishte në qendër të vëmendjes.

Në sallonet e fisnikërisë së Napolit del në skenë Mosje Sarpson. Ky person kishte vite që e ndiqte nga pas familjen e Princit për shkak të vajzës së tyre Mihriban. Një person tjetër që del në skenë në festat e organizuara për familjen e Princit është Mirza Ismail. Ky ishte një xhongler cirku që hiqej se komunikonte me shpirtrat e botës së përtejme.

Një ditë në një shfaqje që po bëhej në teatrin e famshëm të Sain Charles ai tregon sekretin e letrës që kishte firmosur Princi në dhomën e hotelit në Byjykada. Në këtë letër të firmosur me pahir Princi deklaronte se e lejonte vajzën e saj Mihriban të ndryshonte fe dhe të kthehej në kristianizëm.

Përveç kësaj, duke u hequr sikur po komunikonte me shpirtrat e botës së përtejme, Mirza Ismail deklaronte se porositësi i kësaj letre ishte Mosje Sarpson i cili në të njëjtën kohë ishte një vrasës dhe mashtrues.

Mirza Ismaili nuk mjaftohet me deklaratat në skenën e teatrit, por i boton këto edhe nëpër gazetën e qytetit. Mosje Sarpson detyrohet të arratiset. Megjithatë Mihribani, e cila ishte rritur me edukatën Angleze e kishte të pamundur të besonte këto akuza.

Në fakt arsyeja e vërtetë që Mihribani, një vajzë e zgjuar, nuk dëshironte të besonte këto akuza, ishte se ajo kishte ndjenja për Mosje Sarpsonin dhe nuk donte ta pranonte brenda vetes se kishte gabuar me gjykimin e saj ndaj këtij personi në dukje të dashur dhe të kulturuar.

Por e vërteta nuk do të vonojë të dalë hapur. Mosje Sarpsoni kapet në Paris për një krim që kishte bërë kohë më parë atje. Gjykata i dërgon një letër thirrjeje Princit dhe Mirza Ismailit për të dëshmuar në gjyqin e hapur ndaj Mosje Sarpsonit.

Për këtë arsye Princi së bashku me familjen e tij dhe Mirza Ismaili shkojnë në Paris. Gjatë rrugës për në Paris Mirza Ismaili i tregon Mihribanit për krimet që kishte kryer Mosje Sarpsoni duke përdorur emrat të ndryshëm. Përveç kësaj ai i tregon edhe arsyen përse dëshironte të merrte hak ndaj Mosje Sarpsonit. Mirza Ismaili me shfaqjet që zhvillon në teatrot e Parisit tregon edhe më shumë fakte ndaj Mosje Sarpsonit.

Disa ditë para gjyqit Mirza Ismaili shkon të vizitojë Mosje Sarpsonin në burg. Atje Mosje Sarpsoni i thotë që me mbrojtjen që ka bërë do të dalë i pafajshëm, aty ai edhe nënkupton që e kishte rregulluar me gjykatësin., por Mirza Ismaili i thotë se edhe nëse do të dilte i pafajshëm nga gjyqi ai do ta vriste sapo të dilte nga gjykata.

Ai i jep Mosje Sarpsonit një shishe me helm dhe e këshillon që të vriste veten para se të fillonte gjyqi. Mosje Sarpson tronditet nga gjakftohtësia e Mirza Ismailit. Duke e njohur mirë atë, pasi ai nuk ishte tjetër veçse Azmiu, një nga bashkëpunëtorët e tij në vrasjet e bëra, Mosje Sarpsoni pi helmin dhe vdes.

Në fakt Azmiu ishte një njeri zemër mirë i cili kishte qenë i detyruar të merte pjesë në këto krime. Pas këtyre ngjarjeve Mihribani ndjen një afrimitet me Mirza Ismailin. Pas dy vitesh ajo kthehet në fenë Islame dhe martohet me të.

#### **4.2.4. Romani Politik**

Romani politik gjatë gjithë periudhës së letërsisë së tanzimatit pothuajse nuk ka ekzistuar. Deri në vitin 1908, kohë kur hapet parlamenti i dytë, përveç romanit të Mizanxhi Mehmetit nuk kemi asnjë tentativë tjetër për shkak të censurës së egër shtetërore. Pas mbylljes së parlamentit të parë Osman sulltan Abdylhamiti fillon të ushtrojë një censurë gjithmonë e në rritje ndaj çdo lloj botimi. Ky roman është një shkrim shumë i guximshëm pasi kritikon shumë rëndë burokracinë.<sup>84</sup>

#### **Turfan ose Turfa? (E reja ose e vjetra) (1891)**

Ky është romani i parë dhe i vetëm i shkrimtarit Mizanxhi Mehmet Murat. I shkruar në fillim të viteve 1890 ky roman kishte si qëllim të ishte një roman patriotik (nacionalist). Mes shumë romaneve të përkthyer dhe të shkruar në lidhje me tema sociale shkrimtari Mehmet Murat synon të tregojë një temë pak si më ndryshe për kohën. Megjithatë studiuesi Birol Emin, i cili e përkthen romanin me shkronja latine shprehet se ky roman nuk përmban asnjë nga cilësitë që duhet të ketë romani, por mban vetëm ide dhe mendime patriotike (nacionaliste)<sup>85</sup>.

<sup>84</sup> Kolcu, A. Ihsan, Tanzimat Edebiyati, Ankara, botimi II 2005, f. 218

<sup>85</sup> Birol, E. Mizanci Mehmed Murat Bey ve romanına dair, Stamboll, 1980 f. XXV

Ngjarjet zhvillohen rreth 20-25 vite më parë.<sup>86</sup> Në Stamboll vjen një i ri me emrin Mansur Beu. Mansur Beu është djali i Ebul Mansurit që vinte nga fisi i Ibn Galibit në Algjeri. Mansuri së bashku me vajzën e xhaxhait Zehranë, pas rënies dëshmorë të babait dhe xhaxhait vijnë në Stamboll pranë xhaxhait të tyre të madh Ahmed Nasri.

Ata fillojnë mësimin së bashku me fëmijët e xhaxhait. Që në fillim shohim një lloj konkurrence mes të dyve. Mansuri përpiqet të mësojë më shumë se Zehra e cila përveç se ishte e zgjuar ishte dhe shumë punëtore. Për shkak të kësaj konkurrence Mansuri del i pari i klasës dhe fiton të drejtën e një burse për në Francë.

Zehra pasi rritet pak kërkohet nga një oficer francez. Xhaxhai është gati ta martojë, por Zehra nuk ka dëshirë dhe e kundërshton.

Mansuri kthehet nga Franca i diplomuar si doktor. Periudha e gjatë që ka kaluar nuk e ka shuar xhelozinë që kanë Mansuri me Zehran.

Kur kthehet në Stamboll në fillim Mansur Beu shkon të jetojë në shtëpinë e xhaxhait të tij Sheh Salih Efendit. Atje njihet edhe me vajzën e tij Sabihanë. Salih Efendi me gruan e tij mendojnë se Mansur Beu mund të jete një burrë i mirë për Sabihanë. Edhe vetë Sabihaja e dashuron këtë djalë që ka studiuar në Paris. Madje ajo fillon edhe të thur plane që t'ia prishë mendjen., por gjithë këto tentativa nuk arrijnë t'ia prishin mendjen Mansur Beut.

Jeta në vilën e Salih Efendit nuk i pëlqen Mansurit. Djali i Salih Efendit me gruan e tij dhe vajza Sabiha dalin shëtitje pothuajse çdo ditë. Bisedojnë me njerëz që nuk i njohin, këmbëjnë letra me ta. Në një nga këto shëtitje ata marrin edhe Zehran me vete., por edhe Zehra nuk e pëlqen këtë lloj jetese. Nga ana tjetër marrëdhëniet mes djalit të Salih Efendit, Ismail Beut dhe gruas së tij ishte shumë e hapur. Ata nuk kishin asnjë lloj xhelozie ndaj njëri tjetrit. Madje gruaja e Ismail Beut qeshte kur ndonjë grua i afrohej burrit të saj dhe flirtonte.

Në të njëjtën kohë Mansur Beu së bashku me shokun e tij Mehmet Efendi nga Çankëreja<sup>87</sup> hap një klinikë mjekësore. Mansuri njihet edhe me motrën e Mehmet Efendit, Fatmën. Fatma ishte një vajzë nga Anadolli e cila edhe pse i kishte kaluar moshën dhe kishte mbetur beqare ishte e sjellshme dhe e kulturuar.

Mansur Beu përveç punës në klinikë jep edhe mësim në fakultetin e mjekësisë. Madje me ndihmën e xhaxhait fillon punë edhe në ministrinë e jashtme. Kur sheh që të gjithë në zyrë nuk mendonin të punonin, por rrinin kot, jep dorëheqjen. Në këtë pjesë kritikohet edhe burokracia shtetërore.

Salih Efendi kishte dy gra. Gruaja e dytë Myzejeni, e cila ishte edhe më e re, kishte një vëlla të quajtur Rashit Efendi. Rashit Efendi ishte një njeri smirëzi dhe shumë i keq. Me anë të intrigave kishte bërë të mundur martesën e Salih Efendit me Myzejenin., por ky ishte vetëm fillimi. Ai kishte në plan të zhdukte të gjithë ata që do të pengonin që fëmija e Myzejenit të trashëgonte gjithë pasurinë e Salih Efendit. Për t'ia arritur këtë qëllim ai do të përdorte gruan e tij Eminenë, që më

---

<sup>86</sup> Para botimit të librit. Pra rreth viteve 1865-1870.

<sup>87</sup> Qytet i vogël në qendër të Anadollit.

parë kishte punuar si prostitutë në shtëpi publike, motrën Myzejen dhe Ibrahim Agën, një njeri me të shkuar të errët.

Rashit Efendi në fillim lidh Sabihanë me një djalë të quajtur Kamil Beu. Ai mundëson që ata të takohen në shtëpinë e tij dhe Sabihaja mbetet shtatzënë. Më pas bën që Ismaili, djali i vetëm i shtëpisë të vdesë në një aksident me karrocë. Pas vdekjes së Ismailit përpiqet të helmojë Sabihanë që ishte shtatzënë jashtë martesë., por tentativa e tij pengohet nga ndërhyrja e Mansur Beut.

Kur kupton që gjithë plani i tij është duke u kuptuar Rashit Efendi së bashku me ndihmësin e tij Ibrahim Agën i vënë zjarrin shtëpisë. Përsëri Mansur Beu ndërhyr dhe arrin të kap Ibrahim Agën i cili vritet.

Më pas përpiqet të ndihmojë në shpëtimin e njerëzve të shtëpisë nga zjarri. Edhe pse shpëtohen të gjithë Sabiha vdes në mëngjes nga plagët e shumta. Myzejeni pëson të njëjtin fat. Ajo vdes pas 6 ditësh.

Rashit Efendi arrin të arratiset, por Mansuri e ndjek dhe në fund edhe Rashiti merr dënimin që meriton dhe vdes duke rënë në det. Salih Efendi paralizohet.

Gjatë gjithë këtyre ndodhive Mansur Beu dhe Zehra takohen shpesh, por nuk gjejnë mundësi të shprehin ndjenjat që kanë për njëri-tjetrin. Znj. Fatma mundohet t'i afrojë, por asnjëri nuk pranon të ulë kokën dhe t'i hap zemrën tjetrit.

Salih Efendi vdes pas disa ditësh. Para se të vdiste ai i lë trashëgiminë Mansurit duke këshilluar Zehran që të martohet me të.

Duke filluar nga këtu Mansur Beu fillon të jetojë një jetë sociale dhe politike shumë ndryshe. Ai fillon të luftojë për bashkimin myslimanëve nën mbrojtjen Osmane. Ai mendon se edhe në jetën e përditëshme njerëzit duhet të jetojnë sipas modelit islam, por duke punuar sipas mënyrës Evropiane. Qëllimi i tij është të ndryshojë mentalitetin që ekzistonte në burokracinë e shtetit Osman.

Duke e ditur që ndryshimi nuk mund të vijë menjëherë Mansur i dedikohet arsimimit. Edhe pse përpiqet shumë ai vë re se lehtësirat që i krijoheshin të krishterëve nuk i krijohen edhe atij. Madje atë e pengojnë. I zemëruar nga kjo gjë ai shkruan artikuj të ndryshëm në gazeta.

Në këtë periudhë znj. Fatma martohet me Nuri Efendin. Mansur Beu kur sheh që shteti po e pengon në aktivitetin që kryen vendos të luftojë me mundësitë e veta. Largohet për në çifligun e tij në fshatin Veler në Ajdin. Fillon të përmirësojë gjendjen e zonës. Edhe pse i dalin shumë pengesa ja arrin qëllimit.

Pas kësaj ai fton ortakun e tij Mehmet Efendin, znj. Fatma me bashkëshortin Nuri dhe Zehranë në çifligun e tij. Pas takimit në Ajdin ky grup miqsh kalon një kohë shumë të bukur.

Gjatë një shëtitjeje në natyrë fillon një furtunë. Mansur Beu mbetet poshtë një peme të rrëzuar nga një rrufe. Zehra i shkon në ndihmë dhe kjo kthehet në një mundësi për të shprehur ndjenjat ndaj njëri tjetrit. Ata pasi i shprehin dashurinë njëri tjetrit vendosin të martohen.

Martohen. Pak kohë më vonë fillon lufta me Rusinë. Mansuri shkon vullnetarë në luftë. Zehra mbetet në Stamboll pranë Mehmet Efendit. Mansuri vjen ta takojë për pak kohë, por largohet përsëri. Asnjëri nga të dy nuk ankohet. Zehra lind një djalë që e quajnë Mahmut.

Masur bënë shumë armiq rreth vetes pasi nuk ka frikë të kritikojë për çdo gabim që bëjnë komandantët në ushtri. Lufton në shumë fronte.

Në letrën e fundit ai i lë amanet djalin dhe Zehran Mehmet Efendit dhe znj. Fatma. Pak ditë më vonë vjen lajmi i vdekjes së tij. Romani mbyllet pa një fund të mirëfilltë duke lënë çdo gjë të hapur.

## Përfundime

Romanet e para turke janë një produkt i lëvizjeve politike të filluara rreth 40 vite para daljes së romanit të parë në vitin 1872. Shpallja e fermanit të Tanzimatit në vitin 1839 e pasuar me fermanin e reformave të vitit 1856 ishin tentativat e para të suksesshme të implementimit të ideve perëndimore në shoqërinë Osmane.

Kaq të rëndësishme ishin këto reforma sa arrijnë t'i japin edhe emrin një periudhe të letërsisë turke, asaj që në letërsinë turke e quajnë "Letërsia e Tanzimatit", e cila fillon në vitet 1860 dhe mbaron në fund të shekullit.

Ndryshimet ndodhin në jetën e përditshme, në zyrat e shtetit, në zakonet e reja që futen në fillim nga shtesa e lartë e shoqërisë dhe më pas edhe nga shtesa e mesme. Një nga të rejat më të rëndësishme dhe me më ndikim në shoqërinë Osmane që sollën këto reforma ishte hapja e gazetave dhe revistave.

Me daljen e gazetave dhe revistave jo shtetërore (private) duke filluar nga viti 1860 kemi një zhvillim të madh të letërsisë si në fushën e poezive që ishin gjinia kryesore letrare në letërsinë turke ashtu edhe në lindjen e gjinive të reja letrare siç janë romani, teatri dhe kritika letrare. Romanet e para turke botohen në fillim në këto gazeta me pjesë dhe më pas botohen si libra të veçantë. Bashkë me reformat për t'iu përshtatur zhvillimeve perëndimore në shoqërinë Osmane lind edhe dëshira për ta kundërshtuar atë duke e justifikuar me prishjen e moralit shoqëror dhe fesë islame.

Romancierët e parë turq si Sami Frashëri, Namil Kemal, Ahmet Mid'hat Efendi ose edhe romancierja e parë turke Fatma Alije Hanim kishin si qëllim primar edukimin e shoqërisë. Kështu që edhe veprat e tyre i shkruajtën mbi këtë parim themelor.

- Romanet e para turke në shumicën e tyre janë romane që temën e marrin nga marrëdhëniet shoqërore të kohës në perandorinë Osmane.
- Tipari kryesorë i gjithë romancierëve të parë në letërsinë turke është theksi që ata vendosin në problemet e shoqërisë Osmane të kohës.
- Sami Frashëri me romanin e tij "Dashuria e Talatit dhe Fitnatit" mes të tjerash denoncon martesën me shkesi të vajzave të reja me njerëz të moshuar vetëm për hir të përfitimeve financiare pa e menduar fare se çfarë pasojash do të ketë për vajzën.
- Namik Kemali me romanin e tij "Intibah" vë theksin në mos edukimin e rinisë që prishet e degjeneron duke u dhënë pas qejfeve dhe kënaqësive të mishit duke harruar moralin, traditën dhe zakonet e shoqërisë dhe ç'është më e rëndësishmja familjen duke u bërë pre e keqbërësve ose femrave të përdala. Këtë gjë e shohim edhe tek romanet e Ahmet Mid'hat Efendi tek personazhet dytësorë (negativë) si Felatun Beu tek romani "Felatun Beu dhe Rakim Efendi" ose Zekai tek romani "Karnavalet"
- Ahmet Mid'hat Efendi në shumë nga romanet e tij prek probleme të ndryshme shoqërore si dështimi në kopjimin sipërfaqësor të stilit të jetesës evropiane duke braktisur ato vlera të qytetërimit lindor (Islam) që mbanin peshën kryesore në shoqërinë Osmane.
- Shkrimtarja Emine Semije prek prapambetjen e shoqërisë Osmane që fshihet pas besëtytnive si dhe mënyrën e edukimit sipas mënyrës

evropiane pa kriter në romanin “Tri tregime në lidhje me edukimin” ku bën një krahasim mes dy mënyrave të edukimit të fëmijëve, asaj perëndimore dhe asaj lindore duke treguar pikat e këqija të secilës mënyrë dhe duke mbrojtur një ndërthurje të cilësive më të mira nga të dyja mënyrat duke krijuar një tip të ri modern, por edhe tradicional njëkohësisht. Kjo është edhe pika ku dëshirojnë të arrijnë shkrimtarët (intelektualët) e kësaj periudhe.

- Mes romaneve të fillimit shohim tentativat e romancierëve për të imituar romancierët perëndimorë sidomos ata francez pasi kontaktet më të shumta shkrimtarët turq i kishin me Francën. Këtu mund të përmendim “Hasan Mellah” që i ngjan romanit “Monte Kristo”<sup>88</sup> ose romanin “Intibah” që i ngjan romanit francez “Zonja me Kamelie”<sup>89</sup>.
- Dallojmë ndikimin e rrymave letrare të kohës ndonëse nganjëherë pak me vonesë siç janë rrymat romantike, realiste dhe natyraliste. Romani “Mushahadat” është një tentativë për një roman natyralist nga ana e shkrimtarit Ahmet Mid’hat Efendi i cili shprehet vetë në parathënien e romanit se ky roman është një përpjekje e tillë. Kurse romani “Dashuria për karrocën” i shkrimtarit Rexhai-zade Ekrem mbahet si një nga romanet e parë realist nga shumë studiues turq.
- Përveç romaneve që prekin problemet e shoqërisë ose që janë të ndikuar nga romanet ose rrymat letrare të kohës kemi edhe romanet policore si “Një vrasje e misterhme” dhe “Hajdut Montari”. Këtu bie në sy që në këto romane ambientet ku zhvillohen ngjarjet përgjithësisht vendosen në Evropë dhe jo në Turqi.
- Duke filluar nga periudha e dytë e Tanzimatit romani turk fillon e shkëputet pothuajse totalisht nga tradita e tregimit popullor. Dashuria dhe heroizmi nuk janë më temat më të rëndësishme të prekura nga shkrimtarët.
- Përveç romaneve policeske në të gjitha romanet e para vendi kryesor ku zhvillohen ngjarjet është Stambolli me rrethinat e tij dhe më pak gjejmë provincat në Ballkan, Anadoll ose Afrikën e Veriut të cilat më shumë kanë një rëndësi dytësore për të plotësuar dhe bërë më interesante romanet. Edhe këtu shohim se shkrimtarët janë shkëputur nga tradita e cila i vendoste ngjarjet në lindjen e mesme ose të largët.
- Në mes të shumëllojshmërisë të tematikave gjejmë edhe romanet me karakter historik të cilët kanë për qëllim ngritjen e ndjenjës patriotike në një kohë kur humbjet luftërave të zhvilluara të ndjekura me humbjet e provincave e kishin ulur shumë moralin e popullit dhe shtetit. Këto romane janë “Xhezmi” dhe “Jeniçerët”
- Romani “Turfan ose Turfa?” është tentativa e parë për një roman nacionalist.
- Një pikë tjetër shumë e rëndësishme në romanet e para turke është mos prekja pothuajse fare e problemeve politike të kohës. Arsyeja mund të gjendet tek censura dhe përndjekja që bënte administrata e atëhershme ndaj shkrimtarëve që merreshin me politikë. Nuk duhet të harrojmë se Namik Kemali, një nga shkrimtarët më aktiv në politikë vdes në internim.

<sup>88</sup> Kolcu. A. I, Tanzimat Edebiyatı, Ankara, 2005,(botimi 2) f. 113

<sup>89</sup> Tanpinar. A, XIX. Asır Türk Edebiyatı Tarihi, Stamboll, 1997 (botimi 8), f. 403



## KREU V

### TIPOLOGJIA E PERSONAZHEVE

Në romanet e para turke kemi disa tipe personazhesh të cilët i gjejmë pothuajse në çdo njërin prej tyre. Këto tipe personazhesh edhe pse veprojnë në romane të ndryshme kanë veçori të përbashkëta me anë të të cilave ne mund t'i dallojmë lehtësisht. Duke qenë se romanet e para turke mbartnin në vetvete dëshirën e mirë të shkrimtarëve të tyre për të edukuar shoqërinë e asaj kohe edhe personazhet e këtyre romaneve do të mbartin po këto ideale.

Tiparet kryesore të këtyre personazheve përfaqësojnë njëkohësisht edhe pjesë të caktuara të shoqërisë turke të periudhës së Tanzimatit.<sup>90</sup> Me gjithë ndryshimet e ndodhura në shekullin e XIX në perandorinë Osmane padyshim që ndryshimet në shoqëri ishin ato që do të dalloheshin më shumë. Ky dallim kuptohet që do të vërehej edhe në letërsi e cila është pasqyra e zhvillimit shoqëror.

Ndryshimet e pësuar në shoqëri kuptohet që nuk është se priten me krahë hapur nga i gjithë populli. Një pjesë e madhe e shoqërisë e mësuar me mënyrën tradicionale të jetës, kjo ndikuar edhe nga kasta fetare e cila çdo ndërhyrje nga jashtë e konsideronte si prekje të interesit dhe mënyrës së tyre të jetesës, e paragjykon dhe dënon. Për shkak të ndërhyrjes së tyre shumë nga reformat që u përpoqën të vinin në zbatim sulltanët dështuan gjatë gjithë shekullit XVIII dhe fillimit të shekullit XIX.

Për shkak të këtij mentaliteti tentativat e një shtrese të lartë për të jetuar sipas stilit Evropian shiheshin si mëkat nga shumica e popullit<sup>91</sup>. Megjithatë një pjesë e popullit edhe pse nuk shprehej e kishte zili këtë lloj jetese. Ndoshta për këtë arsye shumë nga shkrimtarët i tregonin këta njerëz që preferonin të jetonin sipas stilit Evropian si njerëz të paaftë të vlerësonin vlerat e vërteta të njeriut dhe që jetonin një jetë fallco dhe jo reale. Ata në të njëjtën kohë shprehnin mendimin se shoqëria Osmane duhet të përfitojë nga gjërat e mira të kulturës perëndimore, por pa përfunduar në kopjimin pa kriter të saj. Prandaj në romanet e tyre gjejmë personazhe që paraqesin këto ndikime perëndimore, por të ndërthurura me elementë të kulturës lindore.

Në këtë kapitull do analizojmë personazhet pozitivë që janë më të shumtë, por edhe personazhet negativë për të bërë një krahasim sa më të plotë të veçorive që kanë në romanin turk.

Arsyeja e zgjedhjes së analizimit të tipave të personazheve është për të paraqitur zhvillimin nëpër të cilin kalon romani turk në fillimet e tij gjatë letërsisë së Tanzimatit.

---

<sup>90</sup> Me termin periudhë e Tanzimatit duhet të kuptojmë periudhën kohore nga vitet 1850 deri në fundin e shekullit XIX.

<sup>91</sup> Edhe sot e kësaj dite një pjesë e madhe e shoqërisë turke vazhdon të ketë të njëjtën sjellje ndaj ndikimit Evropian

## 5.1 Intelektuali.

Me hapjen e shoqërisë Osmane ndaj qytetërimit Evropian periudha e Tanzimatit pati një rëndësi të veçantë për prezantimin dhe pranimin deri në një farë pike të këtij qytetërimi. Për këtë arsye ashtu siç e thamë edhe më sipër shkrimtarët e kohës me anë të veprave të tyre u munduan të edukonin shoqërinë dhe të rrisnin një brez të ri duke u treguar atyre këtë kulturë.

Shkrimtarët e kohës u përpoqën të pasqyrojnë personazhet me këto cilësi në romanet e tyre. Fundja në çdo periudhë të historisë turke ka pasur personazhe të idealizuar në letërsinë turke. Gjatë periudhës kur turqit jetonin si nomadë në stepat e Azisë ishte tipi Alpit (trimi) që luftonte kundër armiqve, por që ishte edhe i ditur dhe i urtë. Pas pranimit të fesë Islame dhe ardhjes së një pjesë të madhe të fiseve turke në Lindjen e Mesme dhe Anadoll kemi daljen në pah të personazheve si Gazi (veteran lufte), luftëtarë që lufton për kauzën e shenjtë të Islamizmit ose Veliu (i dituri) që studion mbi fenë dhe jetën.

Personazhet që do të studiojmë në romanet e periudhës së Tanzimatit ndjekin pikërisht këtë traditë të letërsisë turke. Duke i paraqitur lexuesit personazhe me ideale të larta dhe me principe të forta shkrimtarët e kohës u munduan t'i drejtojnë drejt të mirës, të bukurës, të vërtetës dhe trimërisë. Tipi intelektual që shfaqet në periudhën e Tanzimatit është një nevojë për t'iu përshtatur kushteve të kohës.

Tipi i intelektualit përdoret nga shumica e romancierëve të kohës, por sidomos nga Ahmet Mid'hat Efendi, i cili e përdor pothuajse në të gjithë romanet. Ahmet Mid'hat Efendi në romanet e tij ka gjithmonë një personazh që ka marrë edukim si në shkollat e lindjes ashtu edhe në perëndim<sup>92</sup>. Personazhi di të paktën një gjuhë perëndimore përveç gjuhëve tradicionale lindore si persishtja dhe arabishtja.

Këto personazhe i gjejmë të përballen me kundërshtarët e tyre që paraqiten në dy variante. Varianti i personazhit tipik të degjeneruar me karakteristikat më të këqija të kulturës lindore ose varianti tjetër i personazhit nën ndikimin më të keq të kulturës perëndimore.

Intelektualët kanë si karakteristikë të përgjithshme përdorimin e logjikës dhe mendjes duke u bazuar si në filozofinë lindore ashtu edhe në atë perëndimore. Ata përpiqen edhe në çastet më të vështira të vazhdojnë edukimin duke qenë mendje hapur.<sup>93</sup> Gjithashtu ata e vlerësojnë punën dhe e respektojnë atë. Këta lloj personazhesh i marrin gjërat me radhë. Në fillim arsimimin dhe pastaj mendojnë të punojnë e të fitojnë para. Shpeshherë janë të detyruar t'i bëjnë të dyja njëkohësisht. Ndërsa për sa i përket personazhit intelektual femër përveç këtyre cilësive duhet të shtojmë edhe aftësinë tradicionale për punime dore. Përveç se janë të afta në detyrën e tyre tradicionale për të mbajtur shtëpinë ato përpiqen të arsimohen me çdo kusht.

Gjuha perëndimore që mësojnë përgjithësisht është frëngjishtja, e cila ose mësohet duke shkuar për studime në Evropë ose e mësojnë me anë të mësuesve ose në mënyrë autodidakte. Përveç frëngjishtes gjuhët e tjera Evropiane që mësohen janë anglishtja dhe gjermanishtja, por me një diferencë të madhe nga e para. Ndërsa personazhet femra e mësojnë me anë të mësuesve privat. Vajtjen në Evropë të

<sup>92</sup> Bëjnë përjashtim romanet policesk apo romanet ku ngjarjet nuk zhvillohen në Turqi.

<sup>93</sup> Duhet të kemi parasysh që kur themi mendje hapur duhet ta konceptojmë sipas kohës kur jetojnë.

personazheve meshkujt personazhet femra e plotësojnë me edukimin që marrin në muzikë ku mësojnë të luajnë piano ose ndonjë vegël tjetër.

Ndonëse në një mënyrë ose tjetër ata e marrin arsimin perëndimor, duke studiuar atje ose duke studiuar në mënyrë autodidakte në vend, këta tipa nuk largohen nga traditat dhe zakonet e shoqërisë ku janë rritur. Ata asnjëherë nuk largohen nga rrënjët e tyre dhe nuk e përbuzin prejardhjen. Këtë gjë nuk e shohim të ndodh me ato personazhe që mundohen të kopjojnë stilin e jetesës perëndimore në mënyrë të plotë. Tipi intelektual mundohet të marr më të mirën e qytetërimit perëndimor, shkencën e përparuar, por pa u shkëputur nga tradita dhe duke e vënë në shërbim të shoqërisë këtë dije. Ata janë të lidhur fort me kulturën e tyre. Këto lloj personazhesh respektohen edhe nga perëndimorët intelektualë. Kështu që ky lloj personazhi intelektual bëhet njëkohësisht edhe një përcjellës i anëve të mira të kulturës perëndimore duke u aprovuar nga vetë perëndimorët.

Një tipar i intelektualëve të romaneve të para është prekja e temës së martesave mes myslimanëve dhe të krishterëve. Pranimi i myslimanizmit nga vajzat e reja të krishtera që martohen me personazhet intelektualë në fakt sipas shkrimtarëve turq përfaqësojnë bashkimin e dy qytetërimeve. Ky bashkim kuptohet që do të anoj nga qytetërimi lindor. Ndërsa kritikohet qytetërimi perëndimor në përgjithësi dhe bëhet objekt talljeje në të njëjtën kohë edhe të qënurit i gjithi lindor në mentalitet konsiderohet si injorancë dhe prapambetje. Sado përparimtarë të ndihen shkrimtarët e romaneve të para turke ata nuk duan ose nuk mund të pranojnë që qytetërimi lindor ishte në grahmat e tij të fundit për shkak të mbylljes shekullore që i kishte bërë vetes ndaj të resë dhe zhvillimit.

Një pikë tjetër interesante që shohim gjatë paraqitjes së personazheve intelektualë është prezantimi familjes para se të prezantohet personazhi. Edukimi familjar është një vlerë shumë e respektuar nga romancierët e parë. Ata mendojnë se arsyeja e drejtimit të personave drejt një imitimi të keq të qytetërimit perëndimorë është mosdhënia e vlerave familjare dhe kulturës Osmane në mënyrë të saktë. Personazhet intelektual, ideal, marrin një edukim familjar tradicional. Një tipar tjetër i familjes së personazhit intelektual është humbja e nënës ose babait në moshë të vogël. Sidomos kemi shumë personazhe që humbasin babanë dhe rriten nga nëna duke u edukuar me ndjenjën e përgjegjësisë dhe pa shumë mundësi financiare. Sipas studiuesit Jale (Zhale) Parla shkrimtari Ahmet Mid'hat Efendi mospasjen pranë të babait në rritjen dhe edukimin e personazhit gjatë fëmijërisë e kompenson me një gjë tjetër.

“Ahmet Mid'hat Efendi mungesën e babait në shumicën e rasteve e kompenson me edukimin Islam që ai merr. Kjo është më mirë sesa të kesh baba me ide të ngatërruara me dëshirën për t'u Evropianizuar. Një ndërtim i tillë është një zgjidhje praktike që gjen Ahmet Mid'hati duke u ndarë nga shkrimtarët e tjerë të periudhës së Tanzimatit të cilët e shihnin në mënyrë tragjike humbjen e babait.<sup>94</sup>”

Në fakt Parla mendon se ky imazh i personazhit pa baba është një kërkim i romancierëve për të shprehur pakënaqësinë që kanë për boshllëkun e një autoriteti të fuqishëm në drejtimin e shtetit Osman në atë kohë. Në fakt këta romancierë, të cilët ashtu siç i pamë edhe më sipër në kapitullin e dytë ishin edhe intelektual iluministë, që kishin si qëllim të ringrinin Perandorinë në ditët e saj të lavdishme duke marrë

---

<sup>94</sup> Parla, J. Babalar ve oğullar Tanzimat Romanının Epistemolojik Temelleri, 1993, Stamboll, f. 30

rolin e babait edukues ndaj shoqërisë Osmane, arrijnë deri diku me shkrimet e tyre t'i bëjnë një shërbim të vyer shoqërisë.

Këtë mendim e mbështet edhe Parla kur thotë : “Namik Kemali kishte rolin e një babai për shkrimtarët e Tanzimatit. Ata e përvetësuan këtë rol duke marr si model Namik Kemalin.”<sup>95</sup>

Namik Kemal përveç se konsiderohet si babai i periudhës së Tanzimatit ishte edhe babai i shkrimeve të veta. Ai u tregoi edhe shkrimtarëve të tjerë si të jenë baba për shkrimin e tyre. Shumica e shkrimtarëve përveç Ahmet Mid'hat Efendit vendosën që humbja e babait të sillte shkatërrimin e djalit. Ahmet Mid'hati i rrit personazhet e tij kryesor pa baba pasi edhe ai vetë është rritur pa baba dhe ka edukuar veten në mënyrë autodidakte. Në fakt nuk do e kishim gabim po të thoshim se Ahmet Mid'hati personazheve u bashkëngjiti pjesë të jetës së tij dhe për këtë gjë ai është një fenomen më vete.

Këta personazhe nuk e kanë frikë të përballen me problemet e jetës dhe të fitojnë pasi janë sprovuar që në fëmijëri me këto vështirësi dhe kanë marr një edukim familjar tradicional shumë të fortë për të përballuar vështirësitë e ndryshme.

Ashtu siç e pamë edhe në kapitullin e mësipërm romanet e para turke flasin për shtresën e mesme të shoqërisë kështu që edhe personazhet do jenë nga e njëjta shtresë. Nuk gjejmë shumë personazhe kryesore të pasur në këto romane. Përgjithësisht kemi personazhe që vijnë nga shtresa e mesme, por që për një arsye ose tjetër kanë rënë në varfëri dhe më pas me shumë punë e përpjekje arrijnë të pasurohen përsëri. Një nga arsyet pse shkrimtarët i mëshojnë shumë këtij fakti është për të krijuar tek shoqëria idenë se me punë dhe përpjekje edhe një njeri i thjeshtë mund të arrijë gjëra të mëdha.

Personazhet intelektual në romanin e Tanzimatit janë mbrojtësit dhe përfaqësuesit e moralit Osman. Përveç sjelljes dhe pamjes së jashtme ata janë të pajisur me njohuritë dhe kulturën perëndimore dhe duken si Evropianë. Ata ndryshojnë nga personazhi i një Evropiani për sa i përket moralit dhe guximit që kanë. Për shkak të këtij morali dhe ndershmërie ata arrijnë të bëjnë gratë Evropiane të dashurohen me ta. Ata nuk mundohen të përfitojnë nga kjo gjë. Kjo bën që ata të vlerësohen më shumë nga këto vajza Evropiane që janë të ngritura dhe nuk i përkasin atij llumi të grave të krishtera që shesin trupin e tyre nëpër lagjet e argëtimit në Stamboll. Këto personazhe femërore intelektuale evropiane kanë një moral të lartë dhe një edukim shumë të mirë. Megjithatë shkrimtarët (myslimanë) nuk arrijnë ta pranojnë faktin që ato janë të krishtera dhe nga fundi i romanit ose i nxjerrin me një baba mysliman ose i bëjnë që për hir të dashurisë që kanë ndaj një djali mysliman të ndryshojnë fe dhe të kthehen në myslimane. Kjo është edhe një mënyrë që shkrimtari të pëlqehet nga shtresa e lexuesit që janë mysliman dhe që e kanë pikë të ndjeshme identitetin fetar.

Personazhet meshkuj në krahasim me ato femra janë paraqitur ndryshe. Në shoqërinë Osmane ashtu si në gjithë shoqëritë e kohës meshkujt kishin privilegje më të shumta se femrat. Ata ishin më të lirshëm si në sjellje ashtu edhe në të drejtat që kishin për t'i shfrytëzuar këto të drejta. Për shkak të sistemit shoqëror personazhet femra kanë më pak mundësi të shprehin kompleksitetin e tyre. Shkrimtarët i paraqesin

---

<sup>95</sup> Parla, J. Babalar ve oğullar Tanzimat Romanının Epistemolojik Temelleri, 1993, Stamboll, f. 54

shumë thatë personazhet femra. Megjithatë në vlerësimin e tyre mund të mbështetemi tek ndershmëria, morali dhe edukimi që marrin.

Shembulli i parë i personazhit intelektual gjendet në romanin “Felatun Beu dhe Rakim Efendi” në personin e Rakim Efendit. Në këtë roman përballë një imituesi të stilit të jetesës perëndimore siç është Felatun Beu, ne njihemi me Rakim Efendin, një njeri që ka edukuar dhe arsimuar veten në mënyrë autodidakte mes shumë problemesh dhe vështirësish duke respektuar kulturën tradicionale lindore. Me këtë lloj personazhi Ahmet Mid’hati krijon një prototip të edukuar me traditën dhe moralin lindor, por të arsimuar me sistemin arsimor perëndimor.

Rakim Efendi gjatë gjithë romanit është në konflikt të vazhdueshëm me Felatun Beun për shkak të mendimeve të ndryshme që kanë. Felatun Beu shumë herë bëhet qesharak me përpjekjet e tij për tu dukur Evropian. Ndërsa kur ai përpiqet të poshtërojë Rakim Efendin para të tjerëve tregon injorancën e tij. Kjo bën që të bjerë më shumë në sy aftësia e Rakim Efendit në njohuritë e shumta të tij mbi gjuhën, kulturën, historinë dhe moralin. Berna Moran thotë një të vërtetë kur shprehet se : “Ahmet Mid’hat Efendi mundohet të nxjerrë para lexuesit një xhentilmen ideal që e kupton shumë mirë kulturën perëndimore me anë të Rakim Efendit përball një Felatun Beu që e keqkupton dhe e merr në mënyrë të gabuar këtë kulturë.”<sup>96</sup>

Ndërsa Mehmet Kaplan shprehet se : “Këto dy personazhe do të kenë një lidhje shumë të ngushtë me njëri-tjetrin në ndryshimet e mëdha që filloi të ndjente shoqëria turke pas shpalljes së Tanzimatit. Felatun Beu përfaqëson njerëzit që e kopjojnë në mënyrë sipërfaqësore perëndimin ndërsa Rakim Efendi përfaqëson “njeriun e ri turk” ashtu siç mundohet të jete edhe vetë Ahmet Mid’hati. Nga vetë edukimi i Ahmet Mid’hatit mund të kuptojmë se Rakim Efendi nuk i ngjan tipave mbizotërues të shoqërisë turke që ishte një Gazi, Veli ose Efendi i dhënë pas rahatisë.

Rakim Efendi nuk është një Xhonturk siç kishte qenë Ahmet Mid’hati në rininë e tij. Ai të kujton një borgjez Evropian që përpiqet të zërë vendin e tij në botë duke punuar, por megjithë atë Rakimi mbetet një “Osmanli”. Ai është serioz, i sjellshëm, xhentëlmen, një person që mbron personalitetin e ti, një “Osmanli” të cilin e respektojnë edhe Evropianët.<sup>97</sup>”

Rakim Efendi rritet në shtëpinë e vogël të trashëguar nga babai. Babi i vdes që në moshën një vjeçare dhe ai rritet me vështirësi të mëdha nga nëna dhe dadoja. Këta dy njerëz janë burimi i edukimit të mirë dhe moralit të lartë që merr Rakim Efendi.

Pas mbarimit të shkollës fillore ai futet në shkollën Valide Rushtije me bursë. Në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare ai pranohet në medrese. Rakim Efendi nuk rresht së përmirësuar veten e tij. Në këtë kohë atij i vdes e ëma dhe mbetet vetëm me dadon, Fedai Kallfa. Ndonëse dado i jep para çdo ditë për nevojat personale, ai nuk i shpenzon, por i kursen.

“Në mëngjes shkonte në medresenë në Sylejmanie. Pasi studionte atje deri në orën katër, shkonte në Kalem. Atje studionte frëngjisht. Për të përmirësuar veten edhe më shumë, më pas shkonte tek një mjek në Gallata ku e ndihmonte, pastaj shkonte t’i

<sup>96</sup> Moran. B, Türk Romanına Eleştirel Bir Bakış I, 2000. Stamboll, f. 39

<sup>97</sup> Kaplan. M, Türk Edebiyatı Üzerinde Araştırmalar, 1997, Stamboll. F. 101

jepte mësim një Armeni dhe në këmbim përfitonte nga biblioteka e tij e pasur duke shfletuar librat frëngjisht. Pra për çfarë i duheshin paratë këtij djali?<sup>98</sup>”

Rakim Efendi edhe ditët e pushimeve i kalon duke studiuar. Pas një studimi të tillë për katër vjet ai arrin të mësojë poezitë dhe shkrimtarët më të mirë Pers dhe Arab. Në të njëjtën kohë njihet me dijet perëndimore. Ai e di shumë mirë frëngjishten. Nga miku i tij doktor mëson mbi mjekësinë dhe kiminë. Ndërsa nga Armeni mëson historinë, gjeografinë, drejtësinë.

Puna e tij e madhe në fund jep frytet e veta. Fitimi i parë i vjen nga përkthimi i një romani nga frëngjishtja. Ai fiton njëzetë monedha të cilat ja jep të gjitha dados. Me këtë rast shkrimtari na tregon edhe sa i çiltër dhe i sinqertë është Rakim Efendi. Nuk është rastësi që fitimin e parë e ka nga pena, sepse personazhet idealë në letërsinë e Tanzimatit nuk mbajnë shpatë si Gazi ose Alpi, por mbajnë penë. Shumica e personazheve intelektualë të krijuar nga shkrimtarët janë në shumicën e rasteve shkrimtarë ose poetë.

Rakim Efendi vazhdon punën. Ai shkruan në gazeta, përkthen libra ose ndihmon miqtë e tij të huaj. Për disa vite ai vazhdon kështu duke fituar deri 30 monedha në muaj. Rakim Efendi ka një mënyrë jetese shumë strikte. Ai i kushton gjumit, qetësisë dhe ngrënies shtatë orë në ditë ndërsa shtatëmbëdhjetë orët e tjera i kalon duke punuar. Këtu ne shohim një nga tiparet kryesore të personazhit intelektual, rëndësia që i jep punës. Me anë të parave që fiton ai e mobilon shtëpinë shumë mirë madje, krijon edhe një bibliotekë të pasur. Për më tepër merr edhe një skllave me emrin Xhanan për të ndihmuar dadon e tij. Ai e trajton Xhananin si vajzën e shtëpisë. Në fakt shkrimtarët e Tanzimatit gjithmonë kanë treguar se sa mirë janë trajtuar skllavet nga personazhet intelektuale, qofshin këto skllavet e vetë personazheve ose e të tjerëve.

Rakimi përveç se përkthyes është edhe mësues. Duke përfituar nga kjo gjë ai u mëson turqisht vajzave të familjes angleze Ziklas. Ai ka një mënyrë shumë të veçantë dhe frytdhënëse të mësimi të turqishtes. Këtë mund ta paralelizojmë me faktin se Ahmet Mid’hati ishte për vete mësues i turqishtes dhe se ai ka zhvilluar metoda të reja të mësimdhënies.

Që të dy vajzat Xhejn dhe Margaret, të cilave ai u jep mësim, bien në dashuri me të. Madje Xhejn dhe sëmuret nga kjo dashuri për Rakim Efendin. Për ta shpëtuar vajzën nga sëmurdja, zoti Ziklas është gati t’i jap gjysmën e pasurisë Rakimit. Për Rakimin kjo tentativë për ta blerë është një fyerje. Ai është gati të ndihmojë për shërimin e Xhejnit, por këtë ai e bën sepse e respekton dhe jo për përfitim. Këtu del në pah morali dhe edukimi i mirë që ka marr Rakim Efendi që në vogëli. Ai nuk është interesaxhi dhe përfitues nga situata. Rakim Efendi edhe pse kaq ideal është një njeri si gjithë të tjerët dhe ka disa cene. Nganjëherë pi raki dhe ka një lidhje të fshehtë me mësuesen e pianos, Jozefinën.

Ahmet Mid’hati e justifikon kështu këtë sjellje të tij: “Po zotërinj! Ju thamë që ne nuk po paraqesim një engjëll para jush. Ai që e mbron nderin jeton si njeri. Po tregojmë për një djalë të ri që jeton në jetën moderne. Po të na tregoni një djalë tjetër që do të sillej ndryshe në atë pozitë që ishte Rakimi atë natë do ju tregoja për të. Nëse

---

<sup>98</sup> Mid’hat A. Felatun Bey ve Rakim Efendi, 2004, Stamboll, f. 36

do të kërkonit një njeri që i bën gjërat nën rrogë, që mundohet të fsheh gjurmët në borë, atëherë mund të shkoni të shikoni Felatun Beun.<sup>99</sup>”

Edhe pse shkrimtari mundohet ta mbrojë Rakimin ai e pranon që lidhja nuk është lidhje e një nate. Ai e takon rregullisht Jozefinën dhe kalon net të nxehta me të. Në të njëjtën kohë Rakimi fillon të ndjejë edhe për skllaven e tij Xhanan. Ndryshe nga lidhja me Jozefinën, ku konsumohet menjëherë edhe lidhja fizike, Rakimi sillet ndryshe me Xhananin. Pas shprehjes reciproke të dashurisë ata nuk bëjnë asgjë. Pas kësaj Rakimi e ndërpret lidhje me Jozefinën. Tanpënari e konsideron Rakim Efendin si një njeri të krijuar në përputhje me librin. Arsyen e krijimit të këtij personazhi me disa të meta në fakt mund ta gjejmë tek rinia e Ahmet Mid’hatit i cili ka kaluar një pjesë të rinisë pas femrave dhe argëtimit.

Ky nuk është rasti i vetëm ku personazhi paraqitet me disa dobësi njerëzore. Madje Ahmet Mid’hati e quan deri në një farë pike si të moralshme pasjen e një dashnoreje, por me kushtin që të mos mburresh dhe të mos e marr vesh njeri. Po ashtu ai e pranon që një djalë i ri të argëtohet, por pa e kaluar masën dhe pa rënë shumë në sy.

Në fund të romanit Rakimi martohet me Xhananin duke lindur edhe një djalë të shëndetshëm. Këtë fund të lumtur e shohim edhe në romanet e tjera të Ahmet Mid’hatit i cili e shpërblen punën e palodhshme dhe moralin e Rakimit. Nga ana tjetër fundi i Felatun Beut që nuk e dinte ç’ishte puna dhe morali është që të largohet i shkatërruar si ekonomikisht ashtu edhe shpirtërisht.

Si përfundim mund të konfirmojmë thënien e Mehmet Kapllanit që shprehet : “Rakim Efendi, personazhi që përshkruhet me kaq pasion dhe lartësohet kaq shumë i ngjan vetë shkrimtarit në shumë pika. Edhe shkrimtari kishte arritur suksesin dhe kishte fituar para me djersën e ballit dhe duke punuar shumë. Ndërsa familja angleze, Jozefina dhe Felatun Beu ka shumë mundësi të jenë njerëz, jetën e të cilëve e ka njohur nga afër. Ideja kryesore e romanit, arritja e suksesit dhe qetësisë shpirtërore me punë, është një ide e fituar nga eksperiencia e vetë Ahmet Mid’hatit.”<sup>100</sup>

Në romanin Karnaval ne gjejmë pothuajse të njëjtët personazhe si edhe tek Felatun Beu dhe Rakim Efendi. Në vend të Felatun Beut kemi Zekai Beun dhe në vend të Rakim Efendit kemi Resmi Efendin. Ndarja mes Beu dhe Efendi në fakt e ka një arsye. Beu përdorej për njerëzit që e mbanin veten për modern (allafrënga) ndërsa Efendi përdorej nga populli dhe personifikonte lindjen.

Si Rakim Efendi ashtu edhe Resmi Efendi rriten pa baba, por ndryshe nga Rakim Efendi, Resmi Efendi lind i pasur, ai varfërohet pasi vëllai i tij i madh i harxhon paratë në kumar dhe alkool e pastaj vdes. Nëna e tij shet pronat dhe i kthen në 50 flori duke shpenzuar nga një flori në muaj për të bërë të mundur rritjen e Resmi Efendit.

Resmiu nuk i nxjerr bosh shpresat e të ëmës. Edhe pse rritet në kushte të vështira financiare ai përpiqet të mësojë sa më shumë. Mëson greqisht nga njerëzit në rrugë dhe Frëngjisht nga djali i komshiut. Mëson shumë shpejt dhe nuk e harron një fjalë të dëgjuar një herë. Kjo bën të mësojë gjuhët e huaja shumë shpejt. Ai mëson të

<sup>99</sup> Midhat. A, Felatun Bey ve Rakim Efendi, 2004, Stamboll, f. 59

<sup>100</sup> Kaplan. M, Türk Edebiyatı Üzerinde Araştırmalar, 1997, Stamboll. F. 94

ndreq orë dhe të punojë si marangoz. Me këto profesione ai jo vetëm që nxjerr shpenzimet e tij, por ndihmon edhe familjen.

Në të njëjtën periudhë kohe si tek Rakim Efendi, në çastin që djali fillon të dalë në jetë, nëna e Resmiut vdes. Resmi Efendi tani jeton me dadon dhe shërbëtoreshen e shtëpisë Hasnan. Ndonëse nuk ka mundësi të ndjekë një arsimim të rregullt, Resmi Efendi, falë përpjekjeve të tij, arrin të jetë në një nivel më të lartë se bashkëmohatarët. Resmi Efendi paraqitet edhe si një gjeni në fushën e letërsisë.

Resmiu është vetëm njëzetetri vjeç dhe di greqisht, frëngjisht, gjermanisht, anglisht, rusisht dhe armenisht. Ai është i shkathët, mund të montojë pa asnjë problem një makineri që sheh për herë të parë. Ndonëse Resmiu nuk ka një profesion të mirëfilltë ai është i aftë në shumë fusha. Shtëpinë e ka si një fabrikë. Di të rregullojë orë, është marangoz, gdhendës, qëndistarë, piktor dhe di të bëjë shumë gjëra të tjera. Ai skicon një makinë qepëse. Ai njihet me znj. Arslangozjan, me të cilën do të ketë një lidhje intime, pikërisht prej aftësive të tij. Resmiu riparon një organo të kishës Armene të cilën nuk merrte përsipër ta rregullonte askush. Burri i znj. Arslangozjan ishte kryetari i këshillit mbikëqyrës të kishës dhe mahnitet nga aftësitë e Resmiut duke e ftuar në shtëpi dhe e bën mik.

Resmi Efendi është një djalë normal, as simpatik as i shëmtuar, por është shumë i zgjuar, i sjellshëm dhe me aftësitë e tij arrin të bëjë femrat të mahniten pas tij. Në të kundërt Zekai Beu ndonëse ka marr një arsimim të mirë dhe ka para me shumicë nuk arrin të josh asnjë femër përveç se atyre që i afroshin për shkak të pasurisë së tij. Ai është xheloz për suksesin e Resmi Efendit. Madje ata bëhen konkurrentë pasi znj. Arslangozjan pëlqen Resmi Efendin përpara Zekai Beut. Zekai Beu mundohet të dekonspirojë lidhjen e të dyve, dhe në fund ja del edhe pse zgjuarsia e Resmi Efendit i shpëton disa herë nga kapja në flagrancë.

Sipas shkrimtarit Resmi Efendi është një njeri i përsosur, por kjo nuk e pengon të lidhet me një grua të martuar. Fundja edhe Resmi Efendi është një personazh me dobësi njerëzore. Në fund të romanit edhe Resmi Efendi martohet me shërbëtoreshen e tij Hasna dhe romani ka një fund të lumtur.

Një personazh tjetër intelektual në romanet e para turke është Shefiku në romanin “Një engjëll në tokë”. Shefiku ishte djali i një dijetari. Ai ishte arsimuar në mënyrën më të mirë nga i ati. Babai i tij vdes pasi i lë amanet të studiojë për mjekësi në Paris.

Pronari i shtëpisë ku jetonte Shefiku e dërgon atë në Paris të studiojë për mjekësi kurse djalin e tij Kamerudin të studiojë për inxhinieri. Këtu kemi dy baballarë që mundohen t’u japin arsimimin më të mirë fëmijëve të tyre.

Shefiku, gjatë kohës në Paris, studion papushim dhe nuk di të argëtohet asnjëherë. Në fakt në jetën e Shefikut ka vend vetëm për dashurinë ndaj Razijes, motrës së Kamerudit dhe ndaj profesionit të mjekut. Këtu na del edhe një veçori tjetër që e shpreh shumë mirë studiuesi Orhan Oktay.

“Shumica e të rinjve që shkojnë për studime në Evropë i harrojnë traditat dhe zakonet myslimane dhe zhyten në kënaqësitë e perëndimit, por personazhi Shefikut në romanin “Një engjëll në tokë” i romancierit Ahmet Mid’hat bën përjashtim. Shefiku kalon shumë kohë në Evropë, por nuk shkon asnjëherë në lagjet me drita të kuqe. Ai e



kalon kohën vetëm në universitet. Shefiku është ende një i ri i ndikuar nga jetesa e Stambollit.”<sup>101</sup>

Me kthimin në Stamboll Shefiku mëson se Razija është martuar. Ai arrin të takohet me të, por bisedojnë si dy miq pa e hapur fare bisedën në fusha të tjera. Për shkak të shpifjeve Shefiku dërgohet në internim në Vidin ndërsa Razija ndahet nga burri dhe përfundon duke larë rrobat e të tjerëve.

Shefiku në tri vitet që qëndron i internuar u jep mësim fëmijëve të burokratëve vendas dhe mjekon njerëzit në nevojë. Kjo e bën të fitojë miq dhe para. Pasi kthehet në Stamboll e gjen Razijen dhe martohet me të duke e mbyllur romanin me fundin e lumtur.

Ndërsa Shefiku shpërblehet për punën e palodhshme dhe karakterin e tij të fortë dhe moralin e lartë e kundërta ndodh me Kamerudinin. Ai në vend të studimit i shpenzon paratë nëpër festa dhe kthehet në Stamboll i varfër dhe i shkatërruar nga morali dhe nderi.

Edhe në këtë rast kemi këshillën e shkrimtarit për të marrë dijet dhe anët e mira të perëndimit dhe të mos merren veset e këqija dhe të degjeneruara.

Një roman tjetër ku një pjesë e ngjarjes kalon në Paris është edhe romani “Një turk në Paris”. Personazhi kryesor Nasuh nuk shkon për studim në Paris. Ai ka marr një arsimim shumë të mirë në Stamboll. Ai shkon atje për të shëtitur. Duket sikur shkrimtari e dërgon posaçërisht Nasuhun në Paris të përjetojë aventura dhe të mahnisë Parizienët duke mbrojtur Islamin dhe shtetin Osman.

“Nasuh di shumë mirë frëngjisht, arabisht dhe persisht. Ai është një njeri i drejtë, i sjellshëm dhe i ndershëm. Ai flet pak, por në mënyrë bindëse dhe me peshë. Ai është i mahnitur ndaj shpikjeve të perëndimit për të mirën e njerëzimit dhe mund të quhet një intelektual i vërtetë. Ai u shpjegon të huajve poligaminë dhe se feja në Islam nuk është një fe e prapambetur.”<sup>102</sup>

Nasuh, një i ri i pasionuar pas aventurës dhe udhëtimit kur e kupton që nuk ka mundësi financiare për të arritur qëllimin e tij që të shëtiste nëpër Evropë, bie dakort me një shtëpi botuese dhe nisët si gazetar për në Paris.

Që në nisje me anije ai i habit miqtë që zë me zgjuarsinë, njohuritë dhe sjelljen e tij. Ai di shumë mirë persisht, arabisht, frëngjisht dhe anglisht si dhe i njeh mirë letërsitë e tyre. Kartise, një franceze shprehet kështu për Nasuh : “Ky djalë është më i zgjuar, më i kulturuar, dhe më i ditur se shumë nga njerëzit që kam njohur jo vetëm në këtë anije, por në gjithë jetën time.”

Nasuh pasi shëtiti në qytetet Marsejë, Lion dhe Paris kthehet në Stamboll.

Nasuh edukohet në mënyrën më të mirë të mundshme nga babai i tij që ishte një njeri i ditur dhe i arsimuar për vete. Për shkak të kujtesës së tij të fortë (një tipar që e gjejmë edhe tek Resmi Efendi) ai nuk harron asgjë që dëgjon. Pasi humbet babanë në moshën trembëdhjetë vjeçare rritet nga doktor Hell, një mik i babait. Ndërsa në moshën njëzet vjeçare humbet edhe doktorin. Ai mendon se ku mund të filloj punë

<sup>101</sup> Okay. Orhan, *Batı Medeniyeti Karşısında Ahmet Midhat Efendi*, 1991, Stamboll, f. 30

<sup>102</sup> Çetin. N, *Tanzimat Döneminde Türk Romanı*, Hece Dergisi, 2002, f. 28

pasi i njihte mirë të gjitha profesionet, por nuk vendoste se ku të punonte pasi duke punuar në një profesion do të kufizohej brenda atij profesioni dhe do qëndronte larg dijës nga fushat e tjera.

Pasi mendohet mirë e mirë vendos të bëhet shkrimtar sepse në këtë mënyrë do kishte mundësi të prekte çdo fushë të jetës dhe çdo profesion pa pasur nevojë të fokusohet në një të vetëm. Shkrimet e tij edhe po nuk u pëlqyen në kohën kur do jetojë ndoshta do kishin mundësi të pëlqeheshin në një të ardhme të afërt ose të largët pasi shkrimi mbetet.

Ai mendon që nuk është shumë i aftë në këtë fushë dhe fillon të shëtisë nëpër çdo medrese, manastir ose teqe ku mendon se mund të përfitojë diçka.

Për shkak të edukimit që kishte marr si nga babai ashtu edhe nga doktor Hell, ai ishte i hapur ndaj çdo lloj informacioni. Ai futet në çdo skutë dhe njihet me çdo lloj njeriu. Shëtiti nëpër mejhane dhe bordello, merr pjesë në lloj lloj festash me pije ose me femra, por nuk ndikohet nga kjo lloj jetese. Punon si punëtor skene në teatro dhe njihet me artistë të skenës. Për të mësuar gjuhë të huaja shoqërohet me familje Evropiane. Njihet edhe me familje të shoqërisë së lartë Osmane. Në këtë mënyrë ai njihet me të dyja kulturat. Ai kalon tri vite në këtë mënyrë dhe me shkrimet që boton mbi këto tema bëhet i famshëm.

Pasi e kupton që nuk i ka mbetur çfarë të mësojë në Stamboll, ai firmos një kontratë me një shtëpi botuese dhe nisat për në Paris si gazetar. Kur shkon në Paris njihet me aristokracinë, popullin e varfër dhe studentët e Parisit. Nasuh përshtatet me çdo ambient dhe e vlerëson çdo takim dhe njohje të re si një mundësi për të pasuruar botën e tij të brendshme.

Duke u nisur nga ngjarje të vërteta që i kishte parë me sytë e tij, ai shkruan një teatër, i cili bëhet shumë i famshëm dhe i sjell fitime të mëdha. Fati nuk e braktis edhe kur luan kumar. Madje pas lojës ai përleshet me dy persona që tentojnë ta grabisin duke i dorëzuar në polici. Bëhet edhe më i famshëm kur për këtë ngjarje shkruajnë gazetatat Pariziene. Megjithatë jo të gjithë e adhurojnë. Ashtu si edhe në romanet e tjera të Ahmet Mid'hatit kemi një kundërshtar. Zeka Beu, i cili kishte udhëtuar me anije së bashku me Nasuh, ishte një zotëri allafirënga që bëhej shumë xheloz për famën që fitonte Nasuh. Ai mundohet të hedh baltë mbi të dhe të thur intriga, por njerëzit në Paris e duan Nasuh.

Në mbledhjet e zhvilluara ai mbron idealet Islame dhe traditën Osmane. Duke mbrojtur mendimet e tij ai arrin të mposhtë sulmet që i bëhen nga dashakeqët e Islamit dhe shtetit Osman.

Pas vetëvrasjes së Simon Angot, një personi që dashuronte Polinin e cila nga ana e saj dashuronte Nasuhun, ai vendos të kthehet në Stamboll. Gjatë kthimit merr me vete edhe Virgjininë. Virgjinia konvertohet në myslimane dhe martohet me Nasuhin. Ajo beson se këto cilësi të larta të Nasuhut vijnë si pasojë e edukimit që ka marr nga feja Islame.

Duke vazhduar me personazhet intelektualë kemi Nexhatin në romanin "Vah". Në ndryshim nga personazhet e tjerë Nexhati nuk ka një profesion të mirëfilltë përveçse punon në një zyrë shteti, por shkrimtari e quan atë filozof. Në fakt të gjithë personazhet e Ahmet Mid'hatit janë nga pak filozofë, por tek Nexhati shkrimtari ka

vendosur ta bëjë atë një filozof të mirëfilltë. Në fakt filozofia është e rëndësishme për Ahmet Mid'hatin pasi ajo shpreh veçoritë e njeriut ideal që dëshiron të transmetojë në veprat e tij.

Nexhati ka të njëjtat tiparet të njeriut që arsimohet me forcat e veta, të cilit babai i vdes i ri, punon shumë për të mbajtur familjen, ka moral të lartë, por nuk e ka problem të lidhet me një grua të martuar me të cilën në ndryshim nga personazhet e tjerë martohet në fund. Edhe Nexhati ka një kundërshtar. Madje ky është shoku i tij Behxheti. Ai bëhet xheloz që Feridane zgjedh Nexhatin para tij. Behxheti po ashtu si personazhet e tjerë negativ trashëgon pasurinë nga babai, por e harxhon duke u përpjekur të jetojë sipas stilit Evropian, por e bën vetëm në mënyrë sipërfaqësore. Kështu që plotësohet dyshja që dallohet në pothuajse çdo roman të tij.

Një tipar që e veçon Nexhatin nga personazhet e tjerë është edhe moshja. Nexhati është rreth 35 vjeç, ndryshe nga personazhet e tjerë që janë jo më shumë se 30 vjeç, pra janë ende djem dhe jo burra. Kjo bëhet për ta vendosur personazhin në një pozicion më serioz dhe të pjekur. Ai përpiket të përmirësojë veten duke marr pjesë në çdo mësim që mundet. Është i dhënë pas astronomisë, misticizmit, filozofisë. Nuk pi as cigare as alkool. Ai mundohet të mos i bëjë keq asnjëri. Ky është një tipar tjetër i personazheve të Ahmet Mid'hatit.

Një tipar tjetër në këtë personazh ndryshe nga personazhet e tjerë është fakti që edhe pse ka një lidhje me një grua të martuar ai nuk e konsumon atë. Lidhja e tij është lidhje platonike. Madje kjo bie në sy më qartë kur ai martohet me Feridanen, e cila e tronditur nga problemet që kalon dhe vdekja e burrit të saj përçudnon fytyrën.

Kjo tregon se personazhet e Ahmet Mid'hatit preferojnë bukurinë e brendshme më shumë se bukurinë e jashtme. Kjo e lartëson personazhin duke i dhënë atij karakteristika të vlerësuara nga gjithë shoqëria. Në fakt këtë veti të sakrificës e gjejmë edhe tek Feridane. Ajo vendos të martohet me të fejuarin e saj edhe pse ai sëmuret me linë e dhenve dhe shpërfytyrohet. Ndonëse një grua e bukur e martuar me një burrë të shëmtuar dhe xheloz ajo nuk u kthen përgjigje ofertave të shumta për tu lidhur që i bëhen nga meshkuj të shumtë. Në të njëjtën kohë Feridane është një femër e zgjuar dhe e arsimuar. Ajo i shpëton kurthit që i ngre Behxheti me foto montazhet pasi e kishte lexuar më parë në një revistë franceze këtë lloj teknike. Feridane pranon të përgojohet nga bota dhe të mbetet e pastër në veten e saj sesa të pranojë shantazhin e bërë.

Mospranimi i shantazhit tregon se Feridane ashtu si Nexhati kishin të njëjtën filozofi (mendim) në lidhje me shantazhin. Ai nuk duhet pranuar. Këtë e shohim edhe kur që të dy shkojnë dhe e denoncojnë në prokurori Behxhetin. Siç ndodh gjithmonë në romanet e Ahmet Mid'hatit kemi një fund të lumtur pas dënimit të fajtorëve. Nexhati martohet me Feridanen e cila edhe pse nuk është më e bukur nga pamja e jashtme është e bukur nga brenda.

Një roman tjetër ku e shohim personazhin e intelektualit është romani i vetëm i shkrimtarit Mizanxhi Murad "Turfan ose Turfa?" Në fakt në këtë roman kemi më shumë se një personazh intelektual një personazh idealist. Për më tepër në këtë roman gjejmë si personazhin intelektual mashkull ashtu edhe atë femër.

Personazhi më i idealizuar intelektual kuptohet që është edhe personazhi kryesor i romanit, Mansuri. Duke qenë se shkrimtari është një nga ata intelektualë

idealiste që synon të shpëtojë nga rrënimi perandorinë, ai edhe romanin e shkruan për këtë qëllim.

Në fakt romanin mund ta konsiderojmë edhe si një autobiografi të autorit, ku ai shpreh ideologjinë, personalitetin, pikëpamjet letrare dhe këndvështrimin që ka ndaj jetës. Kështu që personazhi Mansur përfaqëson vetë shkrimtarin.

“Personazhi Mansur mbart shenjat e jetës personale të shkrimtarit, ai është një sintezë e vetëdijes së vlerave fetare dhe kombëtare në kombinim me dijet moderne perëndimore. Me anë të këtij personazhi tregohen gjithë të këqijat dhe problemet në çdo fushë në shtetin Osman. Ai propozon zgjidhje për të ringritur përsëri nga themeli shoqërinë dhe shtetin.”<sup>103</sup>

Mansuri rridhte nga familja Ibni Galib, një familje turke e cila me kalimin e kohës ishte arabizuar. Me vdekjen e babait ai fillon të jetojë me xhaxhanë e tij Ahmed El-Nasir. Xhaxhai i tij ishte një simpatizant i Francës dhe jo vetëm që nuk ndjente ndonjë ndjenjë besnikërie ndaj perandorisë Osmane, por edhe mendon se shteti Osman i ka ardhur fundi dhe duhet të rresht së ekzistuari. Ndërsa Mansuri, me këshillat dhe mbështetjen edhe të nënës, e mbron deri në fund ekzistencën e shtetit Osman, sepse babai i Mansurit ishte një nga të rënë të luftës për mbrojtjen e vendit nga Francezët.

Mansuri, jo vetëm që merr arsimimin më të mirë nga mësuesit privat, por për shkak të mundësive financiare dhe zgjuarsisë së tij shkon të studiojë për mjekësi në Paris të Francës. Pasi mbaron me nota shumë të mira universitetin, ai refuzon ofertën e pedagogëve të tij për të dhënë mësim atje si asistent. Kjo pasi ashtu si shprehet në roman “Mansuri ishte një mysliman me besim dhe vullnet në vetvete, ai ishte edukuar me ndjenjën e sakrificës dhe me kapacitetin për të kuptuar virtytet e kombit dhe që e kishte shpenzuar gjithë jetën e tij duke menduar për gjendjen dhe të ardhmen e kombit.”<sup>104</sup> Mansuri nuk mund të qëndronte duarkryq dhe të shijonte frytet e arsimimit të tij kur shteti Osman kishte nevojë, prandaj ai kthehet në Stamboll, kryeqytetin e një perandorie që kishte filluar të shpërbëhej, në vend që të kalonte një jetë të mirë dhe të rehatshme në Paris, një kryeqytet në ngritje i një perandori në kulmin e fuqisë së saj.

Pas kthimit në Stamboll, pa dëshirën e tij detyrohet të jetojë tek familja e xhaxhait tjetër Sheh Salih Efendit. Për shkak të gjuhëve të huaja që dinte dhe prej shkollës që kishte kryer jashtë shteti fillon punë në ministrinë e jashtme. Mansuri fillon të punojë me mish e me shpirt në këtë zyrë shtetërore si një idealist i vendosur që i kishte kushtuar gjithë qenien e tij atdheut. I zhgënjyer, ai nuk gjen atë që priste tek një zyrë shteti. Sapo fillon punën, për shkak të xhaxhait të tij i japin grada dhe pagë të majme pa e merituar. I tronditur nga padrejtësitë që bëheshin për shkak të miqësive dhe ndereve, që u bëheshin të pa aftëve kur të aftët mbeteshin në të njëjtin vend për vite me radhë, ai largohet nga puna.

Më pas ai fillon të punojë si mjek në një klinikë që e hap bashkë me shokun e tij Mehmet Efendin duke i kuruar të varfrit pa pagesë. Në fakt shkrimtari e përfytyron Mansurin si një tip intelektual ideal pa asnjë të metë.

<sup>103</sup> Çetin, N. 2002, Tanzimat Döneminde Türk Romanı, Stamboll, f. 40

<sup>104</sup> Mizanci Murat, 1980, Turfanda mı yoksa Turfa mı, Stamboll, F. 6

Kur Mansuri e sheh se nuk ka mundësi të vazhdojë punën ashtu siç dëshiron në Stamboll largohet prej atje dhe vendoset në çifligun e xhaxhait në Ajdin. “Mansuri vjen në Stamboll me ideale dhe ëndrra të mëdha. Kur sheh që nuk arrin qëllimet e tij në qendrën politike, sociale dhe kulturore të vendit, si dhe kupton që nuk mund të ndryshojë mentalitetin e burokratëve hijerëndë, tërhiqet në çifligun Veliler, në nënprefekturën e Manisës, të prefekturës së Ajdinit për të vënë në jetë idealet e tij. Atje hap shkolla moderne, bën hapa përpara në modernizimin në fushën e bujqësisë dhe ekonomisë. Qetësinë që nuk mundi ta gjejë në qytet e gjen në fshat.”<sup>105</sup>

Mansuri në çifligun e tij edukon të rinjtë, u jep këshilla fshatarëve, u tregon mënyra të reja për t’i përdorur në bujqësi, i ndihmon të krijojnë kooperativa për të shitur produktet e tyre bujqësore sa më mirë. Madje ai arrin të hap edhe një fabrikë mëndafshi. Nga kjo pikëpamje shkrimtari bën një hapje të perspektivës për t’u drejtuar drejt Anadollit. Gjë që do të ndodhë rreth 30 vite më pas nga shkrimtarët e tjerë gjatë luftës për çlirim në vitet 20 të shekullit XX. Anadulli do të hap horizonte të pafund si për lëndë të parë ashtu edhe për ide të reja tek shkrimtarët e mëvonshëm.

“Mansuri gjen rrugën e saktë që duhet ndjekur për të shpëtuar nga shkatërrimi shtetin Osman. Rivlerësimin e arsimit. Ideali i Mansurit është ky: “Qëllimi kryesor është të hapim shkolla, të edukojmë njerëz dhe me anë të këtyre njerëzve të iluminojmë 100 milion myslimanët e mbytur nga injoranca dhe varfëria që nga ngushtica e Mozambikut deri në ngushticën e Guinesë dhe t’i lidhim ata me qendrën e Kalifatit<sup>106</sup>. (fq. 175)” Ai beson së është dija dhe arsimit, jo shpata që do sjellë bashkimin e Islamit. “Në vend të luftës duhet të ndihmojmë vëllezërit sipas fesë, në vend të gjyleve dhe plumbave të flasim, të tregojmë të vërtetat hyjnore dhe shkencore, në vend të armiqësisë të ofrojmë vëllazëri. (fq. 176)”<sup>107</sup>

Në këto mendime shohim se shkrimtari jo vetëm që vendos në gojën e personazhit idetë e tija për të ardhmen e shtetit Osman, por edhe idenë e përgjithshme të bashkimit të gjithë myslimanëve nën një drejtim që do të sillte forcimin dhe përparimin e gjithë myslimanëve në botë.

Një personazh tjetër intelektual në roman është edhe shoku i Mansurit, Mehmet Efendi. Mehmet Efendi është nga Çankëreja, një qytet në zemër të Anadollit, një turk i pastër, i shëndoshë, jo i pashëm, por tip babaxhani rreth tridhjetë e pesë vjeç.

Mehmet Efendi, ndryshe nga Mansuri, të cilit i vdes babai që i vogël, e humbet babanë pasi ka mbaruar shkollën e mjekësisë. Pas vdekjes së babait ai merr përsipër të kujdeset për nënën dhe motrën e tij. Mundohet t’i mësojë që të dyja, por nëna për shkak edhe të moshës nuk përparon. Ndërsa e motra përparon dhe kthehet në një grua të arsimuar dhe me mendime të hapura ndaj përparimit dhe modernes. Me anë të këtij veprimi që bën personazhi Mehmet Efendi, shkrimtari përpiqet të jap idenë se edukimi dhe arsimimi i shoqërisë fillon nga familja dhe për më tepër nuk ka kufij moshe.

<sup>105</sup> Çetin, N. 2002, *Tanzimat Döneminde Türk Romanı*, Stamboll, f. 46

<sup>106</sup> Qendra e Kalifatit është Stambolli pasi që nga viti 1518 Perandoria Osmane me pushtimin e tokave të Shenjta Mekë dhe Medine bëhet edhe udhëheqësi shpirtërorë i gjithë botës Islame. Kuptohet në teori pasi kishte vende myslimane që ishin në luftë me perandorinë Osmane dhe nuk e pranonin. Kalifati merr fund në vitin 1923 me shpalljen e republikës Turke.

<sup>107</sup> Çetin, N. 2002, *Tanzimat Döneminde Türk Romanı*, Stamboll, f. 43

Pas mbarimit shkëlqyeshëm të shkollës, Mehmet Efendi dërgohet të studiojë për dy vite në Paris. Duke qenë një njeri besimtar që falet pesë herë në ditë Mehmet Efendi nuk ngatërrohet fare me jetën e Parisit, por kthehet në përfundim të dy viteve me të njëjtat mendime dhe ide me të cilat kishte shkuar. Kjo është edhe arsyeja që shkrimtari e quan Efendi dhe jo Bej.

Megjithëse një njeri shumë besimtar, Mehmet Efendi është njeri i hapur ndaj të resë dhe zhvillimit. Për këtë arsye ai beson në arsimimin e gruas. Njësoj si Mansuri edhe ai është një njeri i idealeve. Ai beson se arsimimi i gruas në mënyrë të drejtë për drejtë ndikon në arsimimin dhe edukimin e shoqërisë pasi është nëna që kontribuon në edukimin e fëmijës që i vogël.

Mehmet Efendi ndryshe nga Mansuri, është më i dhënë pas të tashmes dhe nuk prete shumë nga e ardhmja. Ai synon të bëjë sa më mirë punën e tij dhe nuk ngatërrohet me gjëra të cilat nuk beson se do i bëjë ashtu siç duhet.

Një personazh tjetër intelektual gjejmë edhe në romanin Muhadarat të romancieres së parë turke Fama Alije. Ndonëse ajo i jep rëndësi më shumë personazheve femërore tek ky roman kemi disa personazhe intelektualë që shkrimtarja mendon t'i martojë me Fadilen.

Shebibi, personazhi që në fund do të martohet me Fadilën, është një djalë shumë simpatik. Ai ka marrë një arsimim të mirë dhe flet frëngjisht shumë mirë. Ai është njeri shumë punëtorë dhe ishte bërë shumë i pasur duke u marr me tregti. Kur arriti në moshë për martesë nëna e tij kërkon t'i gjej nuse, por Shebibi nuk interesohet për këtë gjë dhe i refuzon pretendentet e gjetura nga e ëma. Megjithatë duke e njohur pak e nga pak ai fillon të ndjejë për Fadilën në mënyrë graduale. Kjo e bën atë një personazh që interesohet jo vetëm për pamjen e jashtme, por dhe për mendimet dhe idetë e një femre. Këtu kemi një fakt të ri në paraqitjen e personazheve intelektuale në përgjithësi femrat edhe pse vishen me cilësi të mira pëlqehen nga personazhet meshkuj nga pamja e jashtme dhe jo nga karakteri që ato kanë.

Ai i propozon për martesë, ndonëse e di që Fadila është një skllave dhe martesa me të do të ishte një turp për familjen. Këtu del një tipar tjetër i personazhit intelektual që nuk e gjejmë tek personazhet e tjerë, ai nuk pranon të bëjë ashtu siç bënin meshkujt e kohës të cilët shkonin me skllavet e tyre dhe martoheshin vetëm nëse ato bënin fëmijë. Ai e respekton Fadilen si një femër dhe respekton dëshirat e saj duke mos e ngacmuar siç bëjnë burrat e kohës.

Ai e pranon përgjigjen e Fadiles që i kërkon kohë për t'i kthyer përgjigje, por e ndjek me fanatizëm nga pas deri në Stamboll për shkak të dashurisë që ka. Ndonëse Fadila ishte arratisur me Mukadem Beun, ai nuk dorëzohet dhe vazhdon të shpresojë në dashurinë që ka ndaj saj. Kjo dashuri shpërblehet në fund me martesën me Fadilën.

Një personazh tjetër është edhe Mukadim Beu, i cili është i dashuruar që në fëmijëri me Fadilën. Edhe ai rritet pa baba sepse e ka humbur që në vogëli. Ai rritet në mënyrën më të mirë nga nëna e tij që është një grua Osmane me veti të mira. Nuk ka asnjë të zakon të keq, respektohet dhe duhet nga të gjithë që e njohin. Ai di frëngjisht dhe është i dhënë pas muzikës dhe letërsisë. Me këto veti i ngjan shumë personazheve të Ahmet Mid'hatit. Megjithatë edhe ai nuk do shpëtojë nga një e metë, dashuria që ka për Fadilen, për shkak të saj ai do të sëmuret rëndë.

Kjo veti tek personazhet meshkuj mund të quhet një hakmarrje që bën shkrimtarja ndaj personazheve meshkuj të kohës, pasi deri atëherë ishin vetëm gratë që sëmureshin për dashuritë e tyre të pashpresa siç është rasti i Xhejn në romanin “Felatun Beu dhe Rakim Efendi”. Për më tepër që shkrimtarja nuk i lë në asnjë çast personazhet e saj femra të vuajnë nga dashuritë. Personazhet femra e kontrollojnë pothuajse gjatë gjithë kohës ndjenjën me anë të trurit.

Në romanet e Fatma Alijes shohim edhe personazhin e mashkullit ideal. Ai është i arsimuar në mënyrën më të mirë të mundshme, nuk ka përjetuar asnjë aventurë me ndonjë femër dhe është besnik ndaj gruas së tij. Ai më shumë se mashkull ideal është një mashkull perfekt që vështirë se mund të gjendet në jetën e përditshme, por kjo nuk e pengon shkrimtaren ta vendosë në romanet e tij.

Personazhi i fundit intelektual që do studiojmë është Ahmet Xhemili në romanin “Blu dhe e zezë” e shkrimtarit Halit Zija Ushakllëgil. Ahmet Xhemili në fillim merr një arsimim të mirë pasi babai i tij përpiqet shumë për ta shkolluar. Ai është një student shumë i mirë. Përveç mësimeve ai mëson edhe frëngjisht në nivel shumë të mirë.

Me vdekjen e të atit atij i prishen gjithë planet. Ai detyrohet të punojë duke përkthyer libra nga frëngjishtja dhe më pas fillon të punojë edhe si gazetar. Ëndrra e tij e ngelur në sirtar për momentin është të bëhet një poet i famshëm dhe pronar i një shtypshkronje. Për të rritur të ardhurat ai fillon të jap edhe mësime private pas mbarimit të shkollës. Ahmet Xhemili është një njeri punëtorë dhe i ndershëm. Martesa e motrës me djalin e pronarit të shtypshkronjës që nisat si një martesë e mirë do t'i ndryshojë gjërat për keq. Ai tenton të bëhet bashkëpronar duke vënë shtëpinë në hipotekë për disa makineri, por pas përplasjeve me kunatin detyrohet të punojë edhe më shumë.

Fati i keq nuk i largohet. Kunati i rreh motrën e cila më pas vdes. Pasi arrin të mbarojë librin me poezi ai kritikohet shumë nga kolegët e tij të punës që e kishin zili. Për më tepër, vajza e cila ishte muza frymëzuese për të, motra e shokut të tij Hysein Nazmi, martohet me një ushtarak. Me gjithë këto fatkeqësi ai nuk ndryshon karakter. Edhe pse Raxhiu, shoku i tij i punës e kishte sulmuar me kritikën për poezitë e tij, gjë që kishte sjell largimin e tij nga drejtimi i gazetës, ai shkon ta vizitojë në spitalin ku ishte shtruar.

Pas humbjes së motrës, vajzës që dashuronte dhe shtëpisë së trashëguar nga babai ai mendon të vrasë veten. Në fund ai vendos të filloj çdo gjë nga fillimi, por në një vend të largët. Kështu që edhe pse i zhgënjyer dhe i dështuar në realizimin e ëndrrave ai e gjen forcën të rinis çdo gjë nga e para, pa pasur shumë pretendime për të ardhmen. Ndonëse tregon dobësi në mos marrjen e vendimeve në çastin e duhur, Ahmet Xhemili i beson arsimimit që ka marr. Me anë të këtij arsimimi shpreson të fillojë një jetë të re. Këtu shkrimtari tregon edhe për dobinë e arsimit të marr.

Shkrimtarët e periudhës së Tanzimatit janë fokusuar edhe në arsimimin e femrës. Arsyeja është e thjeshtë. Njerëzit e brezit të ardhshëm edukohen nga nëna, por edhe pse janë të gatshëm të arsimojnë femrën ata nuk mund t'i lejojnë femrat e kohës, qofshin edhe intelektualet, që të punojnë në punë të ngritura. Femra duhet të jetë një grua për shtëpi dhe një nënë e mirë që edukon fëmijët në mënyrën më të mirë të mundshme. Ata qëndrojnë larg personazheve femra që punojnë dhe marrin pjesë aktive në jetën shoqërore.

E vetmja mënyrë për të vënë një personazh femër të punojë është kur ajo bie në varfëri të plotë dhe punon për të mbajtur veten dhe fëmijën, por punët që bën janë punë të rëndomta.

“Arsimimi i vajzave nuk kishte asnjë qëllim tjetër përveç se ta bënë femrën më të kulturuar në Turqinë e asaj kohe. Të mësojnë një profesion është një ëndërr që dukej shumë e largët për t’u realizuar në atë kohë. Ahmet Mid’hati shpreson që një ditë kjo do të kthehet në realitet. Në romanin “Vajza me diplomë”, Xhuli, edhe pse mbaron universitetin përfundon si një luleshitëse, por edhe kur shet lule ajo vendos mes tufave të luleve poezi të shkurtra Franceze ose reciton poezi. Ajo bëhet e pasur nga shitja e luleve. Kështu që një vajzë edhe sikur të shesë lule duhet të studiojë.”<sup>108</sup>

Ahmet Mid’hati nuk e merr guximin që ta vendosë personazhin në Stamboll, por e vendos si një personazh të huaj në Paris. Kjo ndodh pasi tentativa për të vendosur një personazh femër myslimane duke punuar në Stamboll dhe duke e bërë të pasur do të sillte një reaksion të fortë nga shumë pjesë radikale të shoqërisë Osmane të kohës.

Nga gjithë romancierët e kohës ai që i ka përdorur më shumë nga të gjithë personazhet e femrave intelektuale në romane ka qenë Ahmet Mid’hat Efendi. Nuk duhet të presim ndonjë ndryshim total në paraqitjen e këtyre personazheve, por edhe vetë përpjekja e tij për ta trajtuar si çështje vlen për t’u lavdëruar.

Personazhet femërore në shumicën rasteve edukohen nga personazhet intelektuale meshkuj. Këto personazhe janë femra që mësojnë shpejt, të zgjuara, të sjellshme dhe me moral të lartë. Megjithatë, në fund ato kanë vetëm një detyrë. Të jenë bashkëshortet e personazheve intelektual meshkuj dhe të kontribuojnë në krijimin e një familje ideale. Të lindin fëmijë dhe t’i rrisin duke i edukuar sa më mirë.

Një tipar tjetër i këtyre lloj femrash intelektuale tek romanet e Ahmet Mid’hat Efendit është që ato janë të huaja (të krishtera). Siç është rasti i Zhizel tek romani “Hasan Mellah” ose i Siranushit në romanin “Mushahadat”. Në fund të romanit ato ose dalin me një baba mysliman ose pranojnë të konvertohen në fenë islame për hir të dashurisë ose sepse pranojnë që ajo është feja e vërtetë.

Tek personazhet intelektuale femra të shkrimtares Fatma Alije gjejmë një lloj tjetër të gruas. Personazhet e saj janë turke, të arsimuara dhe edukuar mirë, të bukura dhe të sjellshme, por që në të njëjtën kohë nuk fluturojnë pas ëndrrave, që vlerësojnë principet dhe jo gjykimet e shoqërisë. Ato janë të pavarura dhe ndryshe nga personazhet e tjera femërore nuk përulen përpara meshkujve.

Një nga përfaqësueset më tipike të personazheve intelektuale femra është Razija tek romani “Një engjëll në tokë” të Ahmet Mid’hat Efendit. Ajo edukohet në të njëjtën mënyrë si edhe Shefik, djali i mësuesit të saj Mehmet Singapuri, duke marrë arsimimin më të mirë të mundshëm në atë kohë.

“Singapuri nuk kishte asnjë detyrë tjetër përveç se të mësonte natë e ditë këta dy fëmijë. Kështu që duke mos pasur asnjë detyrë tjetër dhe shumë kohë në dispozicion ai u mëson dy fëmijëve gjithë njohuritë e kohës duke u dhënë arsimimin

---

<sup>108</sup> Okay, O. Batı Medeniyeti Karşısında Ahmet Midhat Efendi, 1991, Stamboll, f. 319



më të mirë që mund të merrej duke i rritur këta fëmijë me një kulturë dhe sjellje të pëlqyeshme.”<sup>109</sup>

Razija është një vajzë shumë e bukur. Ajo me Shefikun duhen që nga fëmijëria. Largimi i Shefikut në Paris për studime i ndan. Pas largimit të Shefikut, Razija martohet nga i ati me një burrë tjetër pa dëshirën e saj. Ndonëse e martuar ajo nuk e do burrin e saj dhe e ka mendjen tek Shefiku. Megjithatë ajo mundohet ta kënaqë burrin pasi është mësuar me ndjenjën e përgjegjësisë dhe mundohet të përmbushë detyrat e saj bashkëshortore.

Pas kthimit të Shefikut në Stamboll ata takohen, por për shkak të pozitës ku gjendet tani Razija, ata nuk flasin për ndjenjat e tyre. Këto takime i japin mundësinë Arifes, një gruaje të përdalë që dëshiron të martohet me burrin e Razijes, të vër në jetë planin e saj për ta ndarë Razijen nga burri. Pas shpifjeve të saj burri e ndan Razijen. Razija edhe pse mbetet pa para nuk e humbet nderin e saj. Ajo punon si larëse rrobash, por nuk bie pre e intrigave të Arifes që donte ta kthente në një prostitutë.

Razija, e cila i jep edhe emrin romanit “Një engjëll në tokë” është një vajzë e bukur me karakter të papërlyer. Falë këtij karakteri ndonëse e dashuruar, për shkak të pozicionit të saj si grua e martuar nuk bie në mëkat. Megjithëse bie preh e shpifjeve që thuhet pas takimeve të saj të pafajshme me Shefikut dhe kalon shumë vuajtje, në fund të romanit ajo shpërblehet për ndershmërinë që ka dhe martohet me të dashurin e saj të zemrës. Si gjithmonë në fund të romanit do të gjejmë edhe dënimin e të këqijve. Arife pasi e sheh Razijen të lumtur nuk duron më dhe vret veten.

Këtu ne shohim një personazh femëror jo vetëm intelektual, por edhe të pajisur me të gjitha vetitë e një gruaje të ndershme dhe të sjellshme. Ajo nuk pranon të humbasë nderin për shkak të vështirësive materiale.

Personazhi tjetër femëror intelektual është Zehra në romanin “Turfanda ose Turfa?” i shkrimtarit Mizanxhi Murad. Ky personazh me mënyrën e rritjes, edukimin, sjelljen, personalitetin dhe mendimet e saj përfaqëson një personazh intelektual ideal femërorë. Ky lloj personazhi ishte shumë më lartë se kërkesat e kohës për një personazh të tillë.

“Edhe Zehra njësoj si Mansuri besonte se zhvillimi i vendit nuk do të vinte nga lart, por nga poshtë, nga fshati. Për këtë arsye punon vetë në institucionet e ndryshme moderne që hapin (shkollë fillore, shkollë profesionale, fermë) në fshatin modern që e krijon së bashku me Mansurin. Kjo femër e re e kulturuar, që di frëngjisht, t’i bjerë pianos, e dliirë dhe me karakter...”<sup>110</sup>

Zehra e dashuron Mansurin, por nuk përpiqet ta bëjë për vete. Ajo nuk dëshiron ta pengojë Mansurin që ja ka dedikuar jetën atdheut dhe shpëtimit të shtetit Osman. Madje ajo bëhet bashkëlufëtare me të në këtë ide dhe e mbështet.

Edhe Zehra ashtu si djali i xhaxhait të saj Mansuri ka trashëguar nga i ati i rënë dëshmorë guximin, trimërinë dhe dashurinë për atdheun dhe kombin.

Arsimin Zehra e kishte filluar së bashku me fëmijët e xhaxhait. Pasi tallet nga Mansuri i cili bëhej xheloz për përparimin e saj e lë ndjekjen e mësimeve., por nuk

<sup>109</sup> Mid’hat, A. Yeryüzünde Bir Melek, 2000, Stamboll, f. 32

<sup>110</sup> Kerman, Z. 1998, Yeni Türk Edebiyatı İncelemeleri, Ankara, f.268

rresht së mësuari fshehtas. Xhaxhai i saj e kishte hapur derën e shtëpisë për francezët të cilët qëndronin aty si në shtëpinë e tyre. Zehrasë nuk i pëlqen kjo gjë, por mundohet të përfitojë për të praktikuar frëngjishten. Asaj nuk i pëlqen aspak mënyra evropiane e jetesës. Ajo refuzon kërkesën për martesë të një oficeri francez dhe kur xhaxhai i saj ngul këmbë që të pranojë, largohet nga shtëpia duke shkuar të jetojë tek xhaxhai tjetër Sheh Salih Efendi.

Zehra është e zgjuar, e kulturuar, punëtore, e drejtë, me vullnet dhe me një mision në jetë. Për këtë arsye ajo nuk ka frikë t'ia thotë në sy gabimet dhe të metat njerëzve. Po ashtu ajo përpiqet të përhap mendimet dhe idetë e saj mbi nderin duke debatuar me shumë njerëz. Ajo nuk ka shumë miq, por nuk është se e vret mendjen shumë. Ajo ka principin që më mirë një mik me karakter dhe principe si të sajat sesa shumë miq me mendime të gabuara.

Zehra është shumë e dhënë pas nderit të femrës. Mundohet të mbrojë Sabihanë, vajzën e xhaxhait, nga ngacmimet e meshkujve. Po ashtu ajo është shumë kritike edhe mbi mënyrën sesi femrat u flasin meshkujve të panjohur nëpër bulevard. Ajo nuk mund ta pranojë që gra e burra të panjohur të shkëmbejnë letra të hedhura nëpër karroca ose të këmbëjnë shenja në bulevard. Për këtë arsye ajo është e gatshme të qëndrojë pa u martuar sesa të gjejë burrë në një mënyrë të tillë.

Zehra e kalon shumicën e kohës duke lexuar dhe vrarë mendjen mbi zhvillimin e shkencës dhe kulturës. Ajo nuk i mëson këto gjëra vetëm që të jetë një grua e mirë për burrin e saj ose që të jetë një nënë e mirë për fëmijët. Ajo ndihet e shqetësuar nga pozicioni që ka gruaja në familje.

“Mos vallë grua do të thotë të shtrosh krevatin dhe të stolisesh? ose do të thotë të jesh një pajisje e familjes dhe shoqërisë? Nëse grua do të thotë vetëm t’i bësh qejfin burrit dhe të kënaqësh dëshirat e tij atëherë nuk është “gruaja” një send çfarëdo në shtëpi për meshkujt?”<sup>111</sup>

Duke bërë pyetje të tilla Zehra mundohet të gjejë vendin që i takon femrës në shoqëri. Pas martesës me Mansurin, Zehra bëhet mbështetësja më e fort në luftën e tij për idealet që beson. Një nga këto ideale është bashkimi i gjithë myslimanëve nën një udhëheqje.

Zehrën me ato ideale që rritet në fëmijëri me ato ideale e gjejmë edhe në fund të romanit kur na del përpara si një nënë e ve që mundohet të rrisë fëmijët. “Zehra e romanit na prezantohet me të gjitha pikëpamjet e saj që nga koha kur ajo ishte një vajzë e re. Në fund të romanit shohim që Zehra si një nënë e ve që përpiqet të rrisë fëmijët nuk ka hequr dorë nga asnjë nga këto principe dhe besimi që kishte ndarë bashkërisht edhe me Mansurin. Po ta themi më qartë, as dashuria as të qenurit nënë nuk ndikuan të ndryshonte mendim mbi pikëpamjen ndaj jetës.”<sup>112</sup>

Zehra në çifligun në Ajdin përpiqet me gjithë shpirt të edukojë vajzat e reja. Ndërsa fëmijëve të fshatit u mëson të shkruajnë dhe të lexojnë. Ajo është një bashkëshorte ideale pranë një burri ideal që përpiqet të shpëtojë shtetin Osman. Nuk është vetëm një grua e shkëlqyer, por është edhe mbështetëse e idealeve të tij. Ajo do

<sup>111</sup> Murad, M. 1980, Turfanda mi boksa Turfada mi?, Stamboll, f. 178

<sup>112</sup> Er, M. 2000, Tanzimat Devri Türk Romanında Kadın Kahramanlar, Ankara, f. 307

të ndjekë investimin e bërë nga burri në çiflig pas vdekjes së tij dhe do të përpiqet me të gjitha fuqitë që të rrisë djalin që të bëhet njësoj si i ati.

Një personazh tjetër në të njëjtin roman është edhe Fatma, motra e Mehmet Efendit. Ajo edukohet dhe arsimohet falë përpjekjeve të vëllait të saj. Kur njihet me Fatmën, Zehra gjen një mike të vërtetë që mendon dhe sillet si ajo.

Roli kryesor i Fatmës si personazh intelektual, edhe pse është një personazh dytësorë në roman, është fakti që ajo vjen nga Anadulli. Ajo është përfaqësuese e femrës së Anadollit për më tepër intelektuale. Kjo është hera e parë dhe e vetme mes romancierëve të periudhës së Tanzimatit që futet një personazh femërorë nga Anadulli.

Fatma nuk është një grua e bukur, por me sjelljen dhe të folurën e saj e tërheq bashkëbiseduesin. Ai që flet me të nuk e kupton që flet me një femër. Njësoj si Zehra ka një karakter të fortë dhe kur flet me një burrë e lë mënjanë anën femërore dhe përballet me të me fakte duke i mbrojtur mendimet e veta me vendosmëri.

Përballë vajzave të llastuara me kulturë të vilave, në romanet e periudhës së Tanzimatit del një femër nga Anadulli që përballet me shumë vështirësi, por që nuk heq dorë nga arsimimi duke arritur të matet me to. Fatma është kurioze mbi zhvillimet e politikës dhe ndjek çdo zhvillim të ri. Këtu ne kemi për herë të parë një personazh për më tepër femërorë që interesohet për çështjet politike. Ajo kërkon të hap një shkollë për vajza, por nuk merr dot leje nga qeveria. Po ashtu ajo nuk tërhiqet nga lufta e saj për ç'ka mendon është e drejtë. Kur qeveritarët mendojnë ta internojnë Mansurin ajo personalisht shkon disa herë në pallatin perandorak duke e kundërshtuar këtë dënim dhe ja del të jetë e suksesshme.

Fatma, si një njeri human dhe i sakrificës kërkon të ndihmojë njerëzit dhe mendon më shumë për të tjerët sesa për veten e saj. Ajo kontribuon në lidhjen dhe më pas martesën e Zehras me Mansurin. Kur vëllai i gjen një doktor për t'u martuar në fillim nuk pranon pasi nuk mund të martohej me një njeri që nuk e njihnte mirë. Më pas me këmbënguljen e vëllait pranon të fejohej, por me kushtin që të njihet me doktorin më mirë dhe vetëm pastaj të pranojë ose jo të martohet.

Edhe pse ka edhe disa personazhe të tjerë që mund të analizojmë ata nuk janë aq të spikatur në lidhje me tiparet intelektuale. Disa nga ato do ti studiojmë pak më poshtë tek personazhet punëtoare.

## 5.2 Bashkëshortja ideale

Në periudhën e Tanzimatit një nga temat më të prekura në romane ka qenë tema e martesës. Preken sidomos martesat me shkesi, pa i marr mendimin të rinjve. Kjo sillte edhe probleme të shumta me pasoja. Romani i parë turk “Dashuria e Talatit me Fitnatit” ka në qendër të tij pikërisht këtë tematikë. Për shkak të kësaj martese me shkesi dy të rinj i japin fund jetës së tyre.

Në përgjithësi shkrimtarët e periudhës së Tanzimatit e prekin me një sy shumë kritik këtë fenomen dhe mundohen të japin këshilla që të mos përsëritet më. Shkrimtarët përpiqen t’i martojnë personazhet e romaneve të tyre me persona ideal që të kenë mundësi të krijojnë një familje ideale me fëmijë të lumtur.

Para se të marrim në studim këtë tip duhet të shohim se si e shihnin martesën shkrimtarët e kësaj periudhe. Ata dilnin kundër martesës së lidhur sipas dëshirës së nënës ose babait ku të rejat e shihnin bashkëshortin për herë të parë vetëm pas martesës., por ata dilnin kundër edhe ndaj mënyrës së re perëndimore të flirtimit. Ata ishin të mendimit se djali me vajzën duhet të njihen në fillim me atë me të cilin do të bashkonin jetën. Ata madje mbrojnë mendimin që edhe feja Islame e lejon deri diku një gjë të tillë.

“Nëse do e marrim si temë diskutimi, Ahmet Mid’hati nuk mbështet traditën e vjetër që e gjen zgjidhjen e një martese të lumtur vetëm në mrekullinë e fejesës. Në takimet para martese të dyja palët duhet të njohin njëri-tjetrin dhe të shohin nëse përshtaten ose jo. Në fakt kjo është një e drejtë e dhënë nga Sheriati. Marrëdhëniet para martesës nuk duhet të shkojnë më larg se qëllimi i njohjes., por tek ne marrëdhënia shoqërore para martese nuk pranohet. Sepse qëllimi ynë është të mbrojmë dliresinë dhe nderin e gruas. Ndërsa marrëdhënia shoqërore nuk dihet deri në ç’pikë mund të arrijë.”<sup>113</sup>

Cilësia kryesore e kërkuar nga personazhet intelektualë të romanit në periudhën e Tanzimatit është edukimi i mirë i gruas. Sipas Ahmet Mid’hatit një i ri i arsimuar dhe i edukuar kërkon të martohet me një femër me të njëjtat cilësi. Kjo ide e martesës mes njerëzve të të njëjtit nivel arsimor mbështetet edhe nga psikologët e sotshëm dhe tregon aktualitetin e mendimeve të Ahmet Mid’hatit. Kur këta djem nuk gjejnë vajza me këto cilësi drejtohen tek femrat e huaja., por këto martesa sjellin probleme të tjera që burojnë nga mentaliteti i familjes që bie ndesh me mentalitetin e nuses së re. Për këtë arsye merr një rëndësi të veçantë nevoja për të edukuar vajzat myslimane sipas nevojave të kohës. Ky edukim nuk duhet të jetë as vetëm perëndimor sipas Ahmet Mid’hatit. Femra duhet të edukohet me të dy edukatat, si atë lindore ashtu edhe atë perëndimore. Personazhi kur mendohet për të marr një grua përveç këtyre cilësive shikon edhe një cilësi tjetër shumë të rëndësishme, se sa e aftë do të jetë në rritjen dhe edukimin e fëmijëve gruaja që do marrë.

Ndonëse shkrimtarët turq të kohës përpiqen të jenë sa më modern në përkufizimin e një gruaje për shtëpi ata nuk i shpëtojnë dot traditës dhe zakonit që kontrollonte në detaje mënyrën e jetesës. Cilësia kryesore që kërkohet tek një femër është nderi i saj. Një grua ideale duhet të jetë një grua e ndershme dhe detyrimisht e virgjër. Nderi dhe virgjëria janë cilësitë e pandashme të një gruaje ideale. Shkrimtarët turq kanë frikë të dalin jashtë këtyre cilësive. Megjithëse tek virgjëria mund të

<sup>113</sup> Okay, O. Batı Medeniyeti Karşısında Ahmet Midhat Efendi, 1991, Stamboll, f.199

tolerojnë pak për shkak të martesës që mund të jetë e detyruar të bëjë vajza, tek nderi ata nuk tolerojnë në asnjë pikë.

Edhe pse Ahmet Mid'hati ose shkrimtarët e tjerë preferojnë të martojnë personazhet e tyre intelektualë më mirë me një të huaj të edukuar sesa me një myslimane pa edukimin e përshtatshëm, ata tregohen të kujdesshëm që kjo e huaj të jetë e ndershme. Ajo është shumë më ndryshe se shumica e shoqërisë perëndimore që paraqitet para lexuesit turk si e shthurur. Në romanin “Një turk në Paris” Virgjinia, vajza që më pas do martohet me personazhin kryesor është aq e dhënë pas nderit sa është e gatshme të vdesë se sa të humbasë nderin.

Një variant tjetër për të martuar personazhet intelektualë me një myslimane të edukuar është martesa e tyre me një skllave, por para se të martohet ai investon tek ajo duke e edukuar vetë dhe duke e sjell në një nivel në mos të njëjtë, të përafërt me veten. Shembulli më i pastër është Xhanani tek romani “Felatun Beu dhe Rakim Efendi”.

Zeynep Kerman e cilëson kështu Xhananin kur e paraqit si një grua ideale për Rakim Efendin.

“Kur i lexojmë të gjithë romanët e Ahmet Mid'hat Efendit në tërësi, shohim se personazhi i bashkëshortes model që përfaqësohet më së miri në romanet e tij është Xhanani tek “Felatun Beu dhe Rakim Efendi”.

Xhanani është e bukur, e sjellshme, mirënjohëse ndaj atij që e edukon, modeste, serioze, e sakrificës, një vajzë që ka marr edukimin Osman në të gjithë kuptimin e fjalës., por një pikë që tërheq vëmendjen sidomos tek personazhet femërore të Ahmet Mid'hatit është shpejtësia marramendëse me të cilën ai i përmirëson si në aspektin fizik ashtu edhe në atë shpirtërorë. Xhanani e sëmure e cila as nuk mund të fliste mirë turqishten kur e sollën në shtëpi, mëson në një kohë shumë të shkurtër të shkruaj dhe lexojë. Mësimi i frëngjishtes ose edhe i pianos e habit lexuesin.”<sup>114</sup>

Megjithatë ky mendim i Kermanit nuk mund të jetë përgjithësues. Në fakt Ahmet Mid'hati përveç personazheve si Xhanani që në fakt janë kokë ulura dhe pa ankesa për shkak të pozitës së tyre në shoqëri krijon edhe personazhe më kokë lartë që nuk përkulen para vështirësive dhe presioneve. Në fakt mund të themi që tipi i Xhananit është krijuar si nevojë e kushteve të kohës.

Kur shkruan romanin “Një engjëll në tokë” ai na nxjerr përpara personazhin e Razijes. Razija vazhdon të mbajë lidhjen me të dashurin e saj të fëmijërisë edhe pas martesës me një burrë tjetër. Ndonëse kjo lidhje është në nivel normal shoqëror, nga shumë shtresa të shoqërisë Osmane të kohës nuk pranohet që një myslimane të sillej në këtë mënyrë, pasi nuk ishte aspak e hijshme për një femër myslimane të martuar. Ata reagojnë ashpër ndaj këtij lloj personazhi dhe Ahmet Mid'hati nuk guxon më të vendos një personazh të tillë në romanet e tjera.

Këto presione të shoqërisë tradicionale bëjnë që Ahmet Mid'hati të përpiqet të gjejë rrugë të tjera për të arritur qëllimin e tij. “Për këtë arsye në romanin e tij “Felatun Beu dhe Rakim Efendi” Ahmet Mid'hati nga një anë nuk mundet të takojë

---

<sup>114</sup> Kerman, Z., 1998, Yeni Türk Edebiyatı İncelemeleri, Ankara, f.261

lirshëm Rakim Efendin me një myslimane, por nga ana tjetër ai nuk e pranon që një personazh intelektual si Rakim Efendi të martohet me shkesi. Këtë situatë shkrimtari e zgjidh duke e martuar atë me një skllave.”<sup>115</sup>

Të njëjtën temë prek edhe Berna Moran kur flet në lidhje me funksionin e Xharijeve (skllaveve) shprehet se Ahmet Mid’hati pa rënë në kundërshtim me vlerat fetare bën të mundur njohjen e mashkullit me femrën dhe të krijojnë një lidhje dashurore.

“Në romanin e periudhës së Tanzimatit xharija kishte edhe një funksion tjetër. Për shkak të rregullave të fesë islame të krijosh marrëdhënie seksuale mes mashkullit dhe femrës pa martesë është e palejueshme. Nuk mund të kishte miqësi, flirtim ose kontakt fizik. Për të pasur një marrëdhënie fizike mes një mashkulli dhe një femre kishte tri mundësi : mashkulli turk do shkonte me një femër greke, armene, franceze ose të një feje tjetër, do shkonte me një prostitutë turke, do kryente marrëdhënie me një xharije. Për këtë arsye, për të krijuar një dashuri të pastër shkrimtari ishte detyruar të përdorte një xharije.”<sup>116</sup>

Një variant tjetër që gjen Ahmet Mid’hati, ashtu siç e thotë edhe Berna Moran është martesë e meshkujve mysliman me vajza të krishtera. Siç është rasti i Zhizelit me Hasan Mellahun. Në fund, përgjithësisht, këto gra të krishtera kthehen në myslimane.

Ndërsa Mizanxhi Murati gjen një zgjidhje tjetër në lidhje me njohjen e bashkëshortëve para martesës. Në romanin “Turfanda ose Turfa?” ai i vendos znj. Fatma me Nuri Beun që pas celebrimi të qëndrojnë disa kohë si vëlla e motër derisa të njihen më mirë dhe vetëm atëherë i marton. Një zgjidhje në fakt komike, por në pamundësi për të gjetur një zgjidhje më të mirë duket e pranueshme nga shkrimtari pasi nuk i prek vlerat morale të kohës.

“Para martesë znj. Fatma i shkruan një letër Nuri Beut. Ajo i vë përpara kushtin që të jetojnë tri muaj si vëlla e motër për të mësuar huqet dhe zakonet e njëri tjetrit. Pas tri muajve nëse një nga palët do jetë penduar për martesën e bërë, do jetë e lirë të vendosë si të dojë.”<sup>117</sup>

Kështu që edhe pse kanë qëllim të japin mesazhet që duan ata janë të detyruar që t’i bëjnë këto duke pasur parasysh kushtet e kohës dhe duke u përpjekur të jenë sa më afër realitetit. Ata tregohen të kujdesshëm ndaj traditës dhe zakoneve që ka ndaj gruas dhe familjes shoqëria Osmane .

Të varur nga këto kushte romancierët e kohës e kanë të vështirë të krijojnë lidhje normale mes mashkullit dhe femrës sipas modelit perëndimorë. Kjo i detyronte ata të ishin në një dyzim mes dëshirës për të paraqitur mendimet e tyre hapur, pa pengesa dhe traditës, zakoneve dhe rregullave të shoqërisë nga e cila vinin. Nganjëherë ata ishin të detyruar të shpiknin situata që ne mund të na duken qesharake për të bërë të mundur të transmetojnë mendimin e tyre pa zemëruar shoqërinë ende me shumicë prapanike Osmane. Ndryshe nga romanet perëndimore ku femra me

<sup>115</sup>Gökçek, F. 2000, Tanzimat Dönemi Roman ve Hikayelerinde Kadın Erkek İlişkilerinin Düzenlenişi ile İlgili Bazı Tespitler, Türk Yurdsusu Dergisi, Stamboll, f. 153

<sup>116</sup> Moran, B. 1985, “Tanzimattan Cuhuriyet’e Roman” Tanzimattan CuhuriyeteTurkiye Ansiklopedisi, Stamboll, f. 413

<sup>117</sup> Mizanxhi Murad, 1980, Turfanda mi, Turfa mi?” Stamboll, f. 327

mashkullin nuk e kanë problem të takohen ku të duan, ata i kanë duart e lidhura në romanet e tyre të varur nga mentaliteti. Sidomos në romanet rozë ku marrëdhëniet dashurore janë epiqendra e romanit.

Për të shpëtuar nga këto kufizime të forta shkrimtarët e kohës i drejtohen shpesh herë mënyrës më të lehtë, ose i lidhin me femra të huaja jo myslimane ose me skllavet (xharijet). Kështu ata shpëtojnë nga paragjykimi i shoqërisë, por në të njëjtën kohë me aftësitë e tyre mundohen t'u veshin vlerat dhe cilësitë që duan të transmetojnë.

Tani të analizojmë disa nga këto gra të cilat do jenë bashkëshortet e personazheve kryesorë.

Xhanani është përfaqësuesja e parë e këtyre personazheve. Kur vjen në familje është një vajzë e sëmurë, e thatë dhe nuk të jep asnjë ndjesi tjetër përveç dhembshurisë. Rakim Efendi për më tepër e blen atë duke marr para borxh për të ndihmuar dadon e saj Fedai Kallfën. Në fakt është për t'u çuditur përse blihet një vajzë e tillë me kaq shumë probleme për të ndihmuar në punët e shtëpisë. Kjo ndodh pasi shkrimtarit i duhet një vajzë e cila do të ecë përpara shumë shpejt për shkak të edukimit që i jep Rakim Efendi. Pra në të njëjtën kohë ajo do të ndihmojë në konfigurimin më të plotë të vetë personazhit kryesorë Rakim Efendit.

Nën kujdesin e Rakimi Efendit dhe Fedai Kallfës, Xhanani shërohet dhe shumë shpejt del në pah bukuria e saj. Rakim Efendi fillon t'i jap mësim Xhananit. Në mësimin e turqishtes Xhanani përparon shumë më shpejt sesa vajzat e familjes Ziklas që po mësonin njëkohësisht.

Xhanani e mëson shumë shpejt edhe pianon. Ajo mëson së bashku me xharijet e tjera që janë komshie me të. Kur Rakimi dëgjon se ajo po mësonte piano i sjell një mësuese private. Nga mësuesja e pianos, Madam Jozefina, ajo fillon të mësojë edhe frëngjisht. Ndërsa Rakim Efendi i mëson arabisht dhe persisht. Arsyeja e vërtetë që ajo përpiqet të mësojë kaq shumë është prej dashurisë që ajo ka. Nuk ka ndonjë synim për t'u bërë një njeri i kulturuar dhe për ti shpërndarë tek të tjerët këto dije. Synimi i saj i vetëm është t'i pëlqejë personit që ajo dashuron.

Përveç këtyre cilësive ajo mëson të qepë dhe ndjek modën e fundit. Si Rakim Efendi edhe Fedai Kallfa sillen shumë mirë me të. Kjo sjellje e mirë në fakt mund të justifikohet nga pikëpamja që kanë shkrimtarët e periudhës së Tanzimatit ndaj skllavërisë. Ata mendojnë që edhe pse skllavë ata janë njerëz dhe duhen trajtuar si të tillë.

Xhanani nuk dëshiron të shëtisë jashtë shtëpie ose të shëtisë nëpër ambientet ku dalin të tjerët. Asaj i pëlqen të merret me lulet dhe me oborrin, të lexojë libra, të luaj në piano si dhe të qep. Asaj nuk i pëlqejnë vendet e argëtimit ku burra e gra dalin bashkërisht.

Xhanani është e dashuruar marrëzisht me Rakim Efendin, por edhe në natën kur ata i shprehin dashurinë njëri-tjetrit ajo sillen në mënyrë rigorozë. Ata nuk puthen. Fundja edhe pse një skllave ajo do jetë kandidatë për bashkëshorte dhe duhet të jetë e ndershme. Ahmet Mid'hati gjatë pothuajse gjithë romanit investon tek kjo skllave duke e kthyer në një femër të përsosur dhe ideale në çdo fushë, duke e bërë gati për ta martuar me personazhin intelektual, Rakimin.

Ahmet Mid'hat Efendit i pëlqen shumë të martojë personazhet e tij intelektual me xharijet e edukuara shumë mirë. Qofshin këto të edukuara që më parë ose të edukuara nga vetë personazhet intelektuale. Pas martesë Xhanani lind edhe një djalë të bukur. Me këtë ajo plotëson gjithë personazhin e bashkëshortes ideale duke i dhënë personazhit intelektual gjithçka që ai dëshiron.

Një personazh tjetër i ngjashëm me Xhananin në shumë pika është Hasna në romanin “Karnaval”. Në të njëjtin roman kemi edhe personazhin intelektual Resmi që është pothuajse i njëjtë me Rakim Efendin.

Hasna merret që në moshë të vogël nga e ëma e Resmi Efendit, e cila para se të vdesë ia lë amanet Resmiut. Ndryshe nga Xhananni që edukohet nga vetë Rakim Efendi, Hasna dërgohet nën kujdesin e Bahtijar Pashës dhe vihet nën shërbimin e Shehnazit, vajzës së Bahtijar Pashës. Atje ajo fillon të mësojë pranë Shehnazit, por edhe ajo si Xhanani mëson jo për veten e saj, por për t'i bërë qefin Resmi Efendit.

Hasna është një vajzë e bukur, serioze, e sjellshme dhe punëtore. Me këto cilësi ajo mëson më shpejt se Shehnazi. Shehnazi është xhelozë jo vetëm se Hasna mëson më shpejt se ajo, por edhe për shkak të kulturës së mirë dhe vlerës që i jep ndershmërisë së saj. Ajo e tregon se sa shumë e vlerëson nderin kur Zekai, një person shumë i pasur që e ka kuptuar gabim modernizmin i propozon për të pasur një lidhje të fshehtë edhe pse bënte sikur ishte i interesuar për Shehnazin. Hasna letrën që i dërgon Zekai ja vendos në dhomë Shehnazit duke e detyruar Zekain të fejojë me të dhe duke shpëtuar nga provokimet e tij.

Megjithatë Shehnazi e akuzon atë për sjellje të turpshme ndaj të fejuarit të saj dhe e dëbon nga vila. Ajo shpëton nga Resmi Efendi i cili e merr në shtëpinë e tij.

Pas dëmtimit që pëson Resmi Efendi gjatë arratisjes nga dhoma e të dashurës së tij, Hasna i qëndron pranë dhe me sjelljen e saj arrin ta bëjë Resmi Efendin të dashurohet me të.

Ashtu si dhe tek Xhanani me Rakim Efendin, Hasna në fund të romanit martohet me Resmi Efendin. Vlen për të theksuar faktin që si Hasna ashtu edhe Xhanani nuk e kanë problem që burrat e tyre të ardhshëm kanë të dashura. Për ato mjafton që ai t'i dojë dhe të pranojë të martohen. Në këtë pikë bie në sy që edhe shkrimtari i pranon për të mirëqena këto lloj sjelljesh.

Një xharije tjetër, por me një fat shumë më ndryshe nga këto të dyja është Dilashubi në romanin “Intibah” të shkrimtarit Namik Kemalit. Edhe ajo është një skllave shumë e bukur, me flokë të verdhe dhe me një lëkurë të butë, të bardhë dhe të pastër. Ajo është shumë e edukuar dhe e kulturuar. Po ashtu ajo di të luaj në piano, të qepë dhe të gatuj.

Ndryshe nga xharijet e Ahmet Mid'hatit ku ato edukohen nga personazhet intelektual, Dilashubi blihet e gatshme. Ajo i ofrohet Aliut nga e ëma për t'i hequr mendjen nga Mehpejkeri, një grua e përdalë. Ndonëse me gjithë këto cilësi të mira ajo nuk arrin të bëjë për vete Aliun i cili nuk di të vlerësojë të mirën që i ka ardhur në dorë. Megjithatë Dilashubi, edhe pse pas martesës keqtrajtohet dhe ndahet nga Aliu, tregon një besnikëri për t'u lavdëruar dhe e shpëton Aliun nga vdekja duke u vrarë në vend të tij.



Kështu që edhe pse një femër me cilësi të mira dhe një kandidate për bashkëshorte ideale ajo do të vuaj faktin që nuk martohet me një personazh intelektual që ja di vlerën një femre të tillë.

Një personazh ndryshe nga ato më sipër na del përpara në romanin “Një turk në Paris”. Kjo është Virgjinia, një e krishterë që do të martohet me Nasahun, personazhin intelektual të romanit.

Virgjinia punon si arkëtare në një restorant. Ajo është një vajzë e varfër që mundahej të kujdesej për dy vëllezërit e saj pasi nëna dhe babai i kishin vdekur. Ajo ishte një vajzë shumë e bukur dhe kishte shumë propozime, por ngaqë ishte e ndershme nuk pranonte asnjë propozim që i vinte. Gjatë shëtitjeve në Paris atë e sheh edhe Nasuhu, i cili si shumë meshkuj të tjerë i propozon, por ajo përsëri e refuzon edhe këtë propozim. Ndonëse e varfër ajo nuk pranon ndihmë nga asnjëri pasi kishte frikë se ndihma do të pasohej me kërkesa të tjera të turpshme. Megjithatë pasi Nasuhu i duket një njeri i mirë pranon deri diku të ndihmohet nga ai. Nasuhu ishte një njeri me karakter të fortë dhe shumë i zgjuar që luante me jetët e njerëzve dhe i drejtonte si t’i tekej.

Pas një sjellje të tillë ai shkakton vdekjen e Polinit dhe Simonës. I shkatërruar shpirtërisht ai shkon në shtëpinë e Virgjinisë. Gjatë kohës që qëndron në shtëpinë e Virgjinisë për të marrë veten ai fillon të ndjejë për Virgjininë dhe ajo dashurohet me të.

Kur Virgjinia mëson se Nasuhu donte të martohej me një femër të fesë së tij ajo konvertohet në myslimane dhe transferohet në Stamboll.

Ndryshe nga personazhet e mësipërm Virgjinia nuk ka një edukim perfekt dhe nuk di të luaj në piano., por ajo ka cilësitë bazë që kërkohen nga shkrimtari për ta martuar me personazhin intelektual; ndershmërinë, dashurinë e pastër, zgjuarsinë, vullnetin për të punuar dhe është mendjehapur.

Një personazh tjetër që i ngjan Virgjinias për nga prejardhja e krishterë është Zhizela në romanin Hasan Mellah. Ajo është një personazh bashkëshortor ideal për Hasanin i cili në fakt nuk është një personazh intelektual i mirëfilltë. Sipas shkrimtarit Zhizela është gruaja ideale, një ëndërr për çdo burrë. Zhizela është një vajzë e zgjuar, e sjellshme, e hijshme, e ditur, e kulturuar dhe e ndershme. Ajo dashurohet me Hasanin në një mënyrë tradicionale në letërsinë turke. Mes disa gjërave që blen babai i saj në treg është edhe një album me fotot të akademisë së marinës në Kartagenë. Aty ajo sheh edhe një foto të Hasanit dhe i pëlqen shumë fytyra e pastër dhe e ndershme e tij. Kur ai i del përpara atë natë kur do të grabiste shtëpinë ajo dashurohet menjëherë me të.

Kultura dhe dija e Zhizelit është shumë e lartë. Ajo di shumë mirë frëngjisht. Përveç dijes së saj të përgjithshme në nivel të lartë ajo është e pasionuar pas fesë dhe filozofisë. Ka një bibliotekë prej një mijë e pesëqind librash dhe një muze me shumë gjëra të rralla. Edhe pse ende gjashtëmbëdhjetë vjeçe ajo kontrollon gjithë punët në vilën shumë të madhe të babait. Shkrimtari e mburr në lidhje me mirëmbajtjen e shtëpisë dhe mikpritjen. Ai i kujton lexuesit një nga tri gratë në librin Dede Korkut<sup>118</sup> ku gruaja më e mirë ishte ajo që priste mikun në mënyrën më të mirë. Me këtë rast

---

<sup>118</sup> Libër i shekujve XIV-XV me tregime në letërsinë turke.

shkrimtari mundohet të shfaq para lexuesit se letërsia turke është shumë e vjetër dhe e rëndësishme.

Përveç këtyre cilësive Zhizeli ka një karakter të fortë. Ajo e refuzon disa herë propozimin e Domeniko Badjas dhe po ashtu i përballon me vendosmëri gjithë rreziqet dhe goditjet që merr gjatë jetës. Ndonëse rrëmbehet nga Domeniko Badja dhe mbahet nga ai për një kohë të gjatë ajo arrin ta mbrojë virgjërinë e saj dhe i vjen Hasanit e papërlyer. Me gjithë këto cilësi të mira nuk diskutohet që shkrimtari do ta kthejë në myslimane dhe do ta martojë me Hasanin duke e kthyer Zhizelin në bashkëshorten ideale për një burrë të kohës në shoqërinë Myslimane. Ajo, ashtu si bashkëshorti i saj, ndihmon njerëzit pa pritur asnjë shpërblim prej tyre.

“Edhe pse vajzë e një familjeje të krishterë, Zhizela ishte një vajzë e bukur, e sjellshme, e kulturuar, me mend në kokë, e ndershme, e kujdesshme në lidhje me moralin dhe guximtare. Ajo i plotësonte të gjitha kushtet për të qenë një bashkëshorte e një djali mysliman. Ajo di si të drejtojë një familje dhe është një grua e respektuar nga shoqëria. Edhe pse shëtit botën me një njeri si Domeniko Badja dhe kalon shumë peripeci ajo arrin ta mbrojë nderin e saj.”<sup>119</sup>

Kështu që ndonëse me një të metë të vogël, të qenurit e krishterë, Zhizeli është një bashkëshorte ideale., por edhe këtë të metë të vogël shkrimtari e rregullon duke e kthyer në myslimane para se të martohet me Hasanin. Sado që shkrimtari përpiqet të jetë asnjans në lidhje me fenë ai është i ndikuar nga feja dhe të qenurin të krishterë nuk mund ta kapërcejë lehtë.

Një personazh tjetër i bashkëshortes ideale është edhe Saniha në romanin “Taahhut” të shkrimtarit Ahmet Mid’hat., por ndryshe nga personazhet e tjera që gjatë gjithë romanit janë kandidatë për t’u martuar dhe martohen në fund Saniha na del e martuar që në fillimet e romanit me Rasihun.

Që të dy burrë e grua kanë një edukim të mirë, dinë gjuhë të huaja, janë të kulturuar dhe njerëz me mendje të hapur. Ata kanë një martesë të lumtur., por pikërisht kur ata mendojnë se kanë gjithçka martesa e tyre do të kalojë në një provë të vështirë.

Tosun Beu, shoku i Rasihut fiksohet pas Sanihas dhe mundohet me të gjitha mënyrat që t’ia prishë mendjen dhe të ketë një lidhje dashurore me të., por me gjithë këmbënguljen dhe intrigat e Tosun Beut, Saliha nuk dorëzohet. Me anë të sjelljeve të drejta dhe të ndershme shpëtohet familja. Shkrimtari në këtë roman shpreh edhe pikëpamjet e tij në lidhje me familjen. Në fakt në këtë roman Ahmet Mid’hati del jashtë stilit të tij. Gjithë ngjarjet në roman zhvillohen brenda shtëpisë. Nuk ka ngjarje të koklavitura dhe të shumta që të zgjidhen. Ai ka si qëllim të tregojë çfarë duhet për të pasur një martesë dhe një familje të lumtur dhe nuk përpiqet t’i ngatërrojë ato që mendon me ngjarje të stërholluara dhe shumë personazhe. Ai i thotë hapur dhe qartë, pa asnjë stërhollim ato që mendon.

Ashtu siç e thamë edhe më parë në këtë roman ndryshe nga romanet e tjerë që i mbaron me martesën e lumtur Ahmet Mid’hati e fillon me martesën dhe mes personazheve ideal, personazhi intelektual dhe personazhi i gruas bashkëshorte ideale,

---

<sup>119</sup> Er, M. 2000, Tanzimat Devri Türk Romanında Kadın Kahramanlar, Ankara, f. 55

futet një mashkull tjetër duke sjell në vëmendje të lexuesit detyrat dhe përgjegjësitë për të mbrojtur familjen dhe martesën.

Saniha është vajza e një qeveritari të vjetër dhe rritet me një përkujdesje të madhe. Frëngjishten e mëson që në djep bashkë me turqishten. Më vonë mëson arabisht dhe persisht. Merr leksione private nga mësuesit më të mirë të kohës. Përveç letërsisë vendase njih mirë edhe letërsinë evropiane. Di të luaj mirë në piano dhe të sillet sipas normave evropiane të sjelljes. Ka një edukim të fortë fetar. Është një njeri që dëshiron të ndihmojë dhe jo egoist. Ajo është edukuar si një vajzë perëndimore, por nuk e ka humbur identitetin e saj. Me vdekjen e babait në moshën dymbëdhjetë vjeçare merr përsipër drejtimin e gjithë punëve të tij. Në këtë pikë Saniha është i vetmi personazh femër që merr përsipër karakteristika të personazheve meshkuj, pra drejtimin e punëve të të atit.

Saniha martohet në moshën njëzetvjeçare. Që këtu autori na jep të kuptojmë që është një femër me karakter të fortë, pasi në përgjithësi femrat në atë kohë martoheshin në moshë shumë më të vogël. Pas martese ajo bie pre e provokimeve dhe propozimeve të pahijshme të shokut të burrit, Tosun Beut. Në fillim, e papërgatitur përballë një sjellje të tillë nga shoku i burrit ajo kalon një fazë depresive, por nuk lejon që të preket nderi i saj.

Saniha është personazhi femëror i kompletuar me të dyja edukimet si atë perëndimor ashtu edhe atë lindor. Është personazhi më i kompletuar në të gjithë romanet e Ahmet Mid'hatit. Kuptohet që arsyeja që e ka bërë kaq të kompletuar është sepse tani ajo është një femër e martuar dhe nuk ka si të mësojë gjëra të tjera. Ajo është në pedestalin ku të gjithë personazhet femra në veprat e tij përpiqen të ngjiten dhe e arrijnë në fund të romanit., por qëndrimi në pedestal ka edhe përgjegjësitë e veta. Duke qenë se një grua e lehtë dhe pa edukimin e duhur do të ishte një preh e lehtë për Tosun Beun që përfaqëson personazhin përfitues ai e pajis Sanihan me gjithë edukimin e mundshëm. Saniha është dëshmia më ideale e bashkimit lindje-perëndim. Falë këtij edukimi të marr ajo arrin të shpëtojë familjen dhe martesën e saj.

### 5.3 Gruaja punëtore

Një nga tiparet kryesore të periudhës së Tanzimatit në letërsi është rëndësia që i japin shkrimtarët rolit të femrës. Pothuajse të gjithë romancierët kanë trajtuar temën e rolit të gruas në shoqëri. Ata kanë mendimin që gruaja duhet të zërë vendin që i takon në shoqëri. Ata mendojnë që gruaja në shoqërinë e atëhershme kishte shumë më pak të drejta sesa duhet të kishte dhe kjo ishte e vërtetë. Me trajtimin që i bëjnë kësaj teme dëshirojnë të arrijnë të përfshijnë gruan në shoqëri me të drejta sa më të plota. Pikat ku ata fokusohen janë : e drejta e arsimimit dhe edukimit, e drejta për të refuzuar një martesë të paracaktuar të cilën nuk e pëlqejnë, e drejta të zgjedhin burrin, e drejta të shëtisin në rrugë lirisht, e drejta të argëtohen dhe më e rëndësishmja, e drejta që të punojnë. Ata besojnë se pikërisht kjo e drejtë e mohuar është një nga arsytet e prapambetjes së shoqërisë Osmane si në ekonomi ashtu edhe në industrializim dhe modernizim.

“Në jetën shoqërore moderne që po lindte në shtetin Osman u ndje nevoja e përfshirjes edhe e kontributit të gruas. Për këtë arsye duke filluar nga viti 1842 shteti filloi arsimimin e gruas. Shteti e filloi arsimimin në fushën e shëndetit dhe më pas e kaloi në fushën e industrisë dhe arsimit. Rreth mesit të shekullit të XIX shteti ishte fokusuar në një mënyrë të veçantë në lidhje me edukimin e gruas. Përveç krijimit të mundësive të arsimimit në fusha të ndryshme të jetës shteti përpiqet të kryej rregullime edhe në fushën e drejtësisë tradicionale në favor të gruas. Deri në kohën e shpalljes së Meshrutijetit I<sup>120</sup> ishin bërë përmirësime në fushën e të drejtës së gruas në lidhje me edukimin, trashëgiminë dhe pronat e patundshme. Me reformat e reja gruaja përveç se fiton të drejtën e të qenurit pjesëtare në trashëgimi fiton edhe të drejtën e të pasurit arsimimin fillor të detyrueshëm.”<sup>121</sup>

Ndryshimet në përqasjen ndaj gruas erdhën si pasojë e ndryshimeve dhe zhvillimeve sociale dhe kulturore në shtetin Osman. Edhe vetë mënyra e perceptimit nga femra në lidhje me ndryshimet në shoqëri dhe letërsi fillon të ndryshojë gjithmonë e më shumë. Madje ndryshon edhe perceptimi ndaj marrëdhënies që duhet të ketë me meshkujt.

Shkrimtarët që e godasin martesën me shkesi ose me anë të detyrimit nga familja janë Sami Frashëri, Ahmet Mid’hat Efendi dhe nxënësja e tij shpirtërore Fatma Alije. Ata kritikojnë edhe problemet që vijnë si shkak i këtyre martesave. Dy shkrimtarët e fundit përveç se e kritikojnë martesën me shkesi theksojnë edhe nevojën e edukimit dhe arsimimit të femrës duke i dhënë shanse të barabarta për të dalë në jetë me të njëjtat kushte që dalin edhe meshkujt. Ata janë të mendimit që femra duhet të ketë një pavarësi ekonomike.

Tipi i gruas që punon është një personazh i ri që futet në letërsinë turke në periudhën e Tanzimatit. Në romanet e Ahmet Mid’hat Efendit femrat që punojnë janë të gjitha të huaja. Ndërsa tek romanet e Fatma Alijes arrijmë të shohim një grua Osmane që punon dhe përpiqet të mbahet në këmbë me forcat e saj duke fituar pavarësinë ekonomike.

---

<sup>120</sup> Parlamenti i parë në Perandorinë Osmane i krijuar në vitin 1876 si pasojë e presionit të intelektualëve,, por me një jetëgjatësi shumë të shkurtër. Mbyllet në vitin 1878 nga Sulltan Abdylhamiti.

<sup>121</sup> Çaha, Ö. Açık Toplum Yazıları, Stamboll, 2004, f. 198

Në fakt femra në shoqërinë Osmane nuk është se nuk ka punuar deri atëherë. Ajo punonte duke filluar nga punët e shtëpisë e deri në bujqësi, por qëllimi i shkrimtarëve të Tanzimatit ishte ta fuste femrën në profesione të rëndësishme si shtetërore ashtu edhe në shoqëri.

Personazhin e parë të femrës që punon e gjejmë tek romani i parë i letërsisë turke “Dashuria e Talatit dhe Fitnatit”. Mjeshtrja e qëndisjes znj. Sherife ishte një grua e zgjuar dhe me talent. Ajo një pjesë të mirë të fitimeve e nxirrte duke shkuar nëpër shtëpitë e vajzave të reja dhe duke u mësuar qëndisje. Edhe pse ky personazh është një personazh dytësorë në roman, ai na shfaq për herë të parë këtë lloj femre.

Një personazh tjetër i gruas që punon është Zehraja në romanin e Mizanxhi Muradit. Edhe pse e kemi parë në personazhin intelektual femërorë ky personazh tregon edhe tipare të personazhit të gruas që punon. Për shkak të idealeve të saj ajo u jep mësim të rinjve në fshat, duke u bërë edhe gruaja e parë në letërsinë turke të Tanzimatit me profesionin e mësueses.

Një personazh tjetër i gruas punëtore gjendet në romanin “Refet” të Fatma Alijes. Personazhi kryesor i romanit që i jep edhe emrin, Refeti është një vajzë e shëmtuar, e dobët, e varfër dhe pa njeri., por edhe pse jeta ishte treguar e pashpirt duke mos i dhënë asnjë nga cilësitë që i duhet një femre që të krijojë një jetë normale ajo ka një vullnet, zgjuarsia dhe moral të lartë. Këto cilësi do ta bëjnë atë të jetë një femër punëtore, me kulturë dhe ç’është më e rëndësishmja me një profesion. Qëllimi i saj ndryshe nga shumica e personazheve femra në romanet e Tanzimatit nuk është të edukohet dhe arsimohet që të jetë një bashkëshorte e denjë për burrin, as nuk edukohet dhe arsimohet që t’i hyj në sy burrit që dashuron siç është rasti i Hasnas ose Xhananit në romanet “Karnaval” dhe “Felatun Beu dhe Rakim efendi”.

Qëllimi i saj është që në fillim të fitojë aq para sa të ketë një pavarësi financiare dhe të vazhdojë jetën e saj më të sigurt. Ajo pas shkollimit dëshiron të ndjekë dëshirat e saj dhe jo të lidhet pas një burri. Për këtë arsye nuk ka ndonjë dëshirë të madhe për t’u martuar. Pas shkollimit Refeti vendos të bëhet mësuese. Për shkak të përjashtimit që i bëjnë vëllezërit nga pasuria dhe të mos pranimit nga familjarët e tjerë ajo vuan shumë në jetë dhe vendos të mos besojë askënd dhe të qëndrojë mbi këmbët e veta.

Një personazh tjetër i gruas që punon në këtë roman është Shule, shoqja e Refetit. Ndryshe nga Refeti ajo është e bukur, e pasur, por edhe ajo nuk i ka prindërit. Për të kujdeset daja i saj. Ndërsa për nga cilësitë e tjera ajo është njësoj si Refeti; me vullnet, me moral të lartë, e zgjuar dhe me qëllimin në jetë të shkollohet dhe edukohet për veten e saj dhe jo për të impresionuar meshkujt të cilët do t’i propozojnë. Edhe ajo ka si qëllim të ndjekë dëshirat e saj në jetë dhe jo të martohet. Vetëm pasi t’i ketë arritur këto dëshira dhe të ketë fituar pavarësinë financiare ajo do të mendojë se mund të ketë ardhur koha të martohet.

Në romanin Muhadarat përballemi me një personazh tjetër edhe pse jo aq tipik i gruas që punon, Fadila. Ajo është një vajzë e bukur, e edukuar, e zgjuar, e ndershme dhe punëtore. Ndonëse vuan nga burri që e tradhtonte dhe dëshiron të vrasë veten, për shkak të besimit që ka heq dorë në çastin e fundit dhe për të mundësuar jetesën shet veten si skllave tek një familje e pasur Libaneze. Duke qenë se di mirë frëngjisht, të luaj në piano, të qëndisë dhe të pikturojë ajo nuk e ka problem të respektohet nga familja që e ka blerë duke u ngritur në detyrën e kryekujdestares së shtëpisë.

Përveç personazheve të grave punëtore myslimane kemi edhe ato jo myslimane. Një nga ato është Jozefina, mësuesja e pianos e vajzave të familjes angleze në romanin “Felatun Beu dhe Rakim Efendi”. Ajo është një femër franceze e sjellshme, e kulturuar që duhet nga të gjithë. Ndonëse ka një lidhje me Rakim Efendin ajo nuk dëshiron të bëhet publike pasi ka frikë se i prishet reputacioni që ka. Ajo e bën këtë gjë pasi e dashuron Rakimin, por njëkohësisht e di që nuk do të martohet me të. Ajo është e sakrificës dhe dashamirëse.

Kur Rakim Efendi i thotë që dashuron Xhananin ajo nuk reagon keq. Për më tepër ajo e pranon që Xhanani është e përshtatshme për Rakim Efendin. Në fakt Jozefina e cila kishte kohë që jetonte në Stamboll dhe e njihte mirë kulturën lindore pranon që ajo kulturë ishte më e mirë se kultura perëndimore. Mikpritja turke ishte shumë më lartë se mikpritja evropiane. Duke shkruar këto gjëra Ahmet Mid’hati mundohet të tregojë superioritetin e qytetërimit lindor nga pikëpamja e vlerave njerëzore edhe pse në teknologji dhe shkencë qytetërimi perëndimor ishte shumë më parë.

Edhe Zhuli në romanin “Vajza me diplomë” është një personazh i gruas që punon. Ajo është një vajzë e zgjuar, punëtore, e shkathët dhe pa paragjykime. Edhe pse nuk arrin të vërë në punë diplomën e saj ajo fillon një punë në pamje të parë të rëndomtë, shitëse lulesh, por që me durimin, vullnetin dhe dashurinë me të cilën e bën i jep frytet e saj duke e bërë të pasur., por edhe kjo femër që nuk e ka për turp të filloj nga fundi duke punuar si luleshitëse dhe të arrij majat është e huaj. Ahmet Mid’hati nuk mund të marr përsipër rrezikun dhe ta bëjë një këtë gjë me një grua myslimane.

Siranush është një personazh tjetër këtë radhë në romanin “Mushahadat” që personifikon gruan që punon. Kjo është një vajzë me nënë armene dhe e rritur si e krishtere armene, por me baba mysliman. Këtë gjë ajo do e mësojë në fund të romanit. Ajo përfiton nga shkollimi që merr në shkollën e murgeshave ku mëson përveç të tjerash frëngjishten dhe pianon. Ajo përveç frëngjishtes di shumë mirë greqishten, armenishten dhe turqishten.

Ajo e fiton jetesën duke dhënë mësimë frëngjishteje dhe pianoje. Për shkak të emrit të mirë që bën asaj i shtohen nxënësit. Ajo është e aftë të qëndrojë me këmbët e saja dhe nuk ja ka nevojën njeriu. Megjithatë edhe ky personazh i gruas që punon për shkak të pranimit të fesë islame duke përmbushur amanetin e babait dhe martesës me Refetin nuk mund ta vazhdojë më jetën e saj të mëparshme për shkak të traditës.

## 5.4 Sipërmarrësi

Një nga personazhet e reja që futen në romanet e periudhës së Tanzimatit është tipi i biznesmenit. Me hapjen ndaj perëndimit, por edhe me ardhjen e shumë kompanive të huaja në perandorinë Osmane, tregtia si brenda vendit ashtu edhe ajo me jashtë, kalon pothuajse e gjitha në duart e të huajve. Që në fillimet e shtetit Osman tregtia bëhej nga çifutë, grekë, armenë ose italianë (Venedikas, Gjenovezë). Turqit nuk merreshin me këto gjëra që dukeshin si profesion i dorës së dytë. Me kalimin e shekujve si çifutët ashtu edhe armenët me grekët filluan të pasuroheshin shumë. Me hapjen ndaj perëndimit dhe me dhënien e koncesioneve firmave të tjera franceze, angleze, amerikane ose edhe gjermane pothuajse e gjithë tregtia e shtetit Osman u fut nën kontrollin e të huajve ose e thënë ndryshe nën kontrollin e krishterë.

Romancierët e parë turq, sidomos Ahmet Mid'hati e shohin këtë fakt dhe me anë të shkrimeve të tyre mundohen të shtyjnë të rinjtë mysliman të drejtohen nga tregtia pasi vetëm në këtë mënyrë kapitali nuk do të dilte jashtë vendit, por do të ndihmonte në zhvillimin e tij. Vetë Ahmet Mid'hati gjatë gjithë jetës së tij tentoi të merrej me tregëti. Për shkak të familjes së madhe që kishte përveç shkrimit dhe profesionit të mësuesit ai kishte edhe një shtypshkronjë dhe për të ulur shpenzimet e bënte vetë edhe shpërndarjen e librave të botuar. Përveç kësaj dihet që ai ishte munduar të hapte një fabrikë tullash.

“Sapo hedh hapin e parë në Marsejë sheh tullën dhe tjegullën Marsejeze dhe fillon të mendoj për mundësitë për t’i prodhuar në Turqi. Shëtiti nëpër punishte, pyet mjeshtrit e tullës, merr informacione të hollësishme si dhe merr mostra nga toka. “Ai ka si qëllim që me lejen dhe ndihmën e Zotit të hap një fabrikë tulle dhe tjegulle në Stamboll.”<sup>122</sup>

Duke u bazuar në nevojën për të kaluar tregtinë në duart e myslimanëve Ahmet Mid'hati përdor personazhet e tij për të transmetuar mesazhin e tij. Një nga personazhet e parë që na dalin përpara është Sejid Mehmet Numani në romanin “Mushahadat”.

Sejid Mehmeti është një tregtarë i vjetër dhe me eksperiencë. Ai është egjiptian dhe kur vjen në Stamboll i ofrojnë postin e prefektit. Në vend që të pranojë një post të rehatshëm me një pagesë të mirë zgjedh të merret me tregti. Sejid Mehmeti ishte një njeri shumë i zgjuar. Ai e kishte vënë re se në perandorinë Osmane të gjithë synonin të kapnin një post shtetëror ndërsa evropianët synonin të merreshin me tregti. Kështu që ai mendon se do t’i shërbente shtetit Osman më mirë duke u marr me tregti sesa duke marr një post shtetëror. Ai mendon që shteti Osman do të shpëtojë nga rrënimi vetëm nëse do të ketë një ekonomi, industri dhe bujqësi të fortë dhe do të drejtohet nga njerëz të ditur, të shkolluar, me kulturë dhe atdhedashës.

Kur erdhi në Stamboll gjëja e parë që ai pa ishte dëshira e madhe që kishin njerëzit për të punuar në administratën shtetërore dhe mërzitet.

“Në Stambollin tonë akoma nuk kishte lindur kjo ide. Asnjëri nga njerëzit e shkolluar nuk denjonte të merrej me tregti. Ata që kishin pasuri dhe çifligje mundoheshin ti drejtonin sa për të mos falimentuar. Të gjithë e kishin syrin tek nëpunësi i shtetit. Nuk dinin asnjë variant tjetër për të ecur përpara., por si do t’i

<sup>122</sup> Okay, O. Batı Medeniyeti Karşısında Ahmet Midhat Efendi, 1991, Stamboll, f.56

ngopte thesari i shtetit këta njerëz që prisnin vetëm nga shteti? A nuk do t'i paguante me të ardhurat nga industria, bujqësia, blegtoria dhe tregtia?, por nëse këta pronarë tokash dhe kapitali, do të presin çdo gjë nga shteti si do mbushet arka e tij?”<sup>123</sup>

Sejdi Mehmet e kishte kuptuar që evropianët po bënin pasuri të mëdha duke bërë tregti në tokat e perandorisë Osmane. Për këtë arsye duke u marr me tregti shumice në çdo fushë ai mendonte që i shërbente edhe shtetit. Ai e bënte këtë punë të lodhshme edhe pse i kishte kaluar të shtatëdhjetat. Punonte ndonëse nuk kishte nevojë për para. Nga kjo anë ai ishte një idealist. Ai po ashtu ndihmonte të rinjtë të fillonin tregtinë pa pasur frikë se do e konkurrenin. Duke mos pasur syrin tek pasuria ai i ndihmonte jo vetëm me këshilla, por edhe me para të rinjtë që dëshironin të fillonin tregtinë. Ai bënte tregti me Evropën, Afrikën dhe Amerikën.

Ahmet Mid'hati i shpreh kështu mendimet në roman kur vë shkrimtarin që në fakt përfaqëson veten e tij të flasë me Sejdi Mehmetin: “Nejse, të shpresojmë që edhe tek ne të zhvillohet koncepti i tregtisë dhe të shtohen informacionet për të. Romancierët që do vijnë pas nesh duhet të përpiqen t'i shpjegojnë lexuesit rëndësinë e tregtisë dhe t'i drejtojnë drejt shkollimit në këtë fushë.”<sup>124</sup>

Edhe pse merret me tregti ai nuk ngatërrohet me argëtimet që bënin tregtarët e tjerë të pasur. Ai nuk pi alkool dhe u qëndron larg veseve të këqija. Për këtë arsye ishte i shëndetshëm edhe pse në moshë të madhe për kohën. Me këto cilësi që i jep, Ahmet Mid'hati e bën një personazh biznesmen, por të ndershëm dhe bamirës.

Personazhet biznesmenë në romanet e fillimit janë të pakët ndërsa të gjesh një personazh femër të tillë është pothuajse e pamundur. Vetëm tek romani “Një vajzë me diplomë” gjejmë Zhulinë që është pak a shumë e tillë. Arsyeja e vendosjes së këtij romani në Paris është shumë e thjeshtë. Shkrimtari nuk do kishte asnjë mundësi të vendoste një personazh të tillë në ambientet e Stambollit.

Zhuli është vajza e një larëse rrobash dhe një hekurpunuesi. Me shumë përpjekje dhe vështirësi mbaron shkollën e mësuesisë, por duke qenë se kishte radhë të madhe në listën e kandidatëve për punë nuk arrin të filloj punë si mësuese. Gjatë pritjes gjendja e saj financiare rëndohet edhe më shumë. Kjo gjendje e rëndë ekonomike bëhet shkak që ajo të nxjerr në pah shpirtin e saj tregtar. Një ditë në rrugën pranë shtëpisë së saj gjatë kalimit të një funerali nga karroca ku mbahej arkivoli bie një buqetë e madhe lulesh. Ajo e merr këtë buqetë të madhe dhe pasi e ndan në buqeta më të vogla i shet në darkë para derës së teatrit., por ajo kishte një mënyrë shumë të veçantë shitjeje që e bënte atë më të kërkuar. Kur u shiste lule klientëve ajo u recitonte poezi ose u jepte mes tufës së luleve nga një poezi dashurie. Në këtë mënyrë edhe shiste më shumë tufa me lule edhe i shiste me një çmim më të lartë. Duke ndryshuar strategji shitjeje dhe duke shtuar kapitalin e saj ajo arrin të fitojë shumë dhe brenda një muaji të kalojë familjen në një shtëpi më të mirë.

Për shkak të pamjes jo të bukur ajo nuk kishte mundësi të bënte një martesë të mirë megjithëse ishte shumë e ndershme. Falë punës dhe moralit që kishte ajo arrin të zërë një vend në shoqërinë e lartë Pariziene.

<sup>123</sup> Midhat, A. Muşahadat, Stamboll, 2005, f.133

<sup>124</sup> Midhat, A. Muşahadat, Stamboll, 2005, f.185



Një personazh tjetër biznesmen është edhe Mansuri në romanin e Mizanxhi Muradit “Turfanda mi boksa Turfa mi?” të cilin e studiuam më lartë tek personazhet intelektual. Përveç se intelektual Mansuri përpiket edhe në fushën e tregtisë dhe ekonomisë. Ai ngre një fabrikë për prodhimin e penjëve, duke futur edhe shumë familje fshatare si aksionerë për të ndihmuar në ngritjen ekonomike të zonës.

“Falë Zotit arrita të hap fabrikën e penjëve që jam përpjekur kaq shumë. Leshi dhe pambuku ynë shkon në Evropë. Ndërsa peri për të cilin kanë nevojë punishtet tona të qilimave e copërave, na vjen nga Anglia. Domethënë pambuku i papërpunuar merret nga ne për 40 qindarka dhe na kthehet i përpunuar për 5 lira. Për këtë arsye e pashë të arsyeshme dhe të nevojshme të ndërtoj këtë fabrikë peri.”<sup>125</sup>

Po ashtu ai hedh hapa edhe në bujqësi duke krijuar një lloj kooperative për mbledhjen dhe shitjen e produkteve bujqësore. Të gjitha këto ai nuk i bën për të pasur ndonjë përfitim, por për hir të idealeve që kishte për të ngritur ekonominë e vendit të tij dhe për të ndihmuar në përmirësimin e jetesës së bashkëkombësve.

Personazhë të tjerë që kanë tipare të personazhit biznesmen, por që nuk janë personazh kryesorë në romane ose janë cilësi dytësore të personazheve të tjerë janë edhe Hixhabi me Suhpiun tek “Botë e çuditshme”, Demir Beu te “Z. Demir ose një sekret i zhvillimit” ose edhe Shebibi tek romani “Muhadarat” i shkrimtares Fatma Alije Hanëm.

Këta personazh edhe pse të pakët dhe dytësorë në shumicën e rasteve kanë rëndësi pasi janë hapi i parë për të futur lexuesin turk të kohës në mendime dhe për t’i treguar që ata duhet të shohin edhe këtë fushë të jetës për të përparuar dhe fituar jetesën.

---

<sup>125</sup> Mizanxhi Murad, TUrfa mi boksa Turfa Mi?, Stamboll, 1980, f.357

## 5.5 Prindi ose i afërmi

Arsyeja pse i përfshijmë si prindërit ashtu edhe të afërmit nën të njëjtin nënkapitull është detyra e përbashkët që u binte atyre në përgjegjësinë për të edukuar fëmijët. Shkrimtarët e periudhës së Tanzimatit dhe sidomos Ahmet Mid'hati e dinin që vetëm me rritjen e një brezi të ri të arsimuar do të ekzistonte mundësia e përmbushjes së idealeve të tyre për një shtet dhe shoqëri të përparuar. Për këtë arsye në veprat e tyre ata janë përpjekur të përfshijnë edhe idetë në lidhje me edukimin e tyre.

“Ahmet Mid'hati ka shumë për të thënë në lidhje me fëmijët. Për të plotësuar mangësitë e familjes Osmane në edukimin, mirëushqyerjen dhe shëndetin e fëmijëve ai solli libra nga Franca dhe shkroi artikuj e libra. Sipas mendimit tonë ai është shkrimtari i parë që e prek në mënyrë kaq të gjerë temën e fëmijëve. Edhe sikur të lemë mënjanë librat për fëmijë që ka botuar dhe të shohim vetëm veprat që ka shkruara për prindërit do të shohim se sa rëndësi i jep edukimit të fëmijëve.”<sup>126</sup>

Për këtë qëllim ai i jep një rëndësi të veçantë shpjegimit të mënyrave të edukimit në romanet e tij. Këtë gjë ai mundohet ta transmetojë nëpërmjet tipit të prindërit ideal. Një fëmijë i mirë edukuar vjen vetëm nëpërmjet një familjeje të shëndetshme.

Sipas Ahmet Mid'hatit poshtë mrekullisë së krijimit të një perandorie nga një grup prej katërqind çadrash<sup>127</sup> duhet parë mënyra e edukimit të fëmijëve. Edhe përhapjen e Islamit, Ahmet Mid'hati e mbështet tek edukimi i mirë që i jepet fëmijëve.

Romancierët e parë e prekin shpesh temën e martesës pasi një martesë e bërë mirë është në themel të një familjeje të shëndetshme dhe një familje e shëndetshme është baza e një edukimi të mirë të fëmijëve.

Romancierët e parë, por sidomos Ahmet Mid'hati dhe Namik Kemali ja japin babait përgjegjësinë e rritjes së fëmijës. Ata mendojnë se për shkak të edukimit më të mirë që jep babai, duhet të jetë ai që të kujdeset për fëmijët. Një arsye pse ata kanë një mendim të tillë është mosedukimi i mjaftueshëm i nënave në atë periudhë. Megjithatë ata nuk e përjashtojnë nënën nga ky cikël pasi nëna është personi që i qëndron më pranë fëmijës gjatë rritjes së tij.

Ahmet Mid'hati mendonte se edukimi i fëmijës më shumë se me fjalë duhet të bëhet me vepra. Domethënë fëmija duke parë veprimet dhe sjelljet e prindërve do të mësojë më shumë sesa duke i mësuar sesi të silllet.

“Ahmet Mid'hati mendon se sjellja dhe veprimet ndikojnë më mirë në edukimin e fëmijëve. Prindërit në vend që të thonë “Mos e bëj këtë se është keq” duhet të mos i bëjnë vetë këto gjëra të këqija duke u bërë shembull. Në këtë pikë nëna ka një detyrë të rëndësishme pasi duke qenë vazhdimisht pranë fëmijës ai thotë

<sup>126</sup> Okay, O. Batı Medeniyeti Karşısında Ahmet Midhat Efendi, 1991, Stamboll, f.56

<sup>127</sup> Shteti Osman e ka zanafillën në një fis nomadë të vogël i përbërë nga katërqind çadra që zbresin në tokat perëndimore të Anadollit nga stepat e Azisë së largët në mesin e shekullit XIII.

“Fëmija imiton të ëmën në vend që të bëjë atë që i thotë babai.” Për këtë arsye nëna dhe babai duhet të jenë në harmoni me njëri tjetrin në edukimin e fëmijës.”<sup>128</sup>

Prindërit ose të afërmit e fëmijëve që marrin përgjegjësinë për t'i rritur në romanet e periudhës së Tanzimatit bëjnë çdo lloj sakrifice për shkollimin dhe edukimin e tyre. Këta prindër ideal nuk mjaftohen me edukimin e mirë që u japin, por nuk ndërhyjnë as në lidhje me martesën e tyre siç bëhej rëndom në atë periudhë. Ata ja lënë fëmijëve të zgjedhin, qofshin këta fëmijë djem ose vajza. Përveç nënës dhe babait fëmijët në romanet e kësaj periudhe edukohen edhe nga daja ose xhaxhai. Kjo për faktin që shpesh herë fëmijëve u vdes babai ose nganjëherë edhe nëna që në moshë të vogël. Përveç tyre nganjëherë kemi edhe miq të familjes ose dadot që i rrisin.

Një nga personazhet që Ahmet Mid'hati na e paraqet është babai i Shefikut, Haxhi Hafiz Singapuri në romanin “Një engjëll në tokë”. Ai është një dijetar dhe njeri i urtë. Ka shëtitur në shumë vende të botës. Është një njeri i kulturuar që ndikon për mirë tek njerëzit. Gjatë qëndrimit në Stamboll ai bëhet mysafir i Mehmet Hulusi Efendit, i cili për të përfitur nga dijet e tij të pafundme e marton me një nga xharijet e tij, pasi gruaja i lind një djalë ai detyrohet të jetojë aty.

Kur Mehmet Hulusi Efendit i lind vajza, Haxhi Hafiz Singapuri thotë se do të jetë një vajzë e bukur kur gjithë të tjerët thonë se është një vajzë e shëmtuar. Me kalimin e kohës del që ai kishte të drejtë. Në fakt ai nuk e kishte thënë kot këtë gjë, por ai dinte shumë në lidhje me fizionominë dhe fiziologjinë e njeriut.

Ai që në vogëli kujdeset për edukimin e djalit të tij Shefki dhe Razijes, vajzës së Mehmet Efendit. Ai u jep atyre edukimin më të mirë të mundshëm të kohës. Gjithë kohën e tij ai e harxhon në edukimin e tyre.

Një personazh tjetër prindëror na shfaqet tek “Xhezmi”, në romanin e dytë të Namik Kemalit. Babai i Xhezmiut, një Spahi<sup>129</sup>, pas vdekjes së nënës së tij, e rrit së bashku me vëllanë i cili ishte ushtarak. Ndonëse shkrimtari vlerëson dashurinë e nënës për një fëmijë, ai mbron idenë se dashuria e babait nuk është më pak e rëndësishme. Sidomos ai beson se mbrojtja dhe edukimi që i jep babai është më i mirë se ajo që i jep nëna. Namik Kemali e shpreh kështu rolin që duhet të ketë nëna dhe babai në rritjen e fëmijës:

“Nëse do të studiojmë historinë e njeriut, do të shohim që gjithë veprat e mëdha të sjella në jetë nga njeriu bazohen në dy pika të rëndësishme. Njëra është dhembshuria dhe tjetra është guximi<sup>3</sup>. Ndjenja e dhembshurisë në përgjithësi ushqehet dhe rritet në prehrin e nënës ose femrës ndërsa guximi dhe trimëria ushqehen dhe rriten në krahët e babait ose të burrit. Nga kjo pikëpamje parajsa ndodhet në këmbët e babait ose nën hijen e shpatave po aq sa edhe nënës në krahët. Një nënë mund ta llastojë fëmijën për shkak të kujdesit të tepërt që tregon edhe pse nuk e ka si qëllim llastimin e fëmijës.”<sup>130</sup>

Me këto mendime të dhëna shkrimtari shpreh idenë se edhe pse roli i nënës është i rëndësishëm në rritjen e fëmijës ai duhet të rritet nga babai pasi tek nëna ekziston rreziku i llastimit. Kjo do të sillte prishjen e të riut ideal. Këtë logjikë Namik

<sup>128</sup> Inci, H. “Ahmet Midhat Efendi ve Çocuk Terbiyesi” Turk Dili Dergisi, Stamboll, 1995, f.585

<sup>129</sup> Komandat i repartit të kalorsisë.

<sup>130</sup> Kemal, N. Cezmi, Stamboll, 1996, f. 38

Kemali e shprej edhe tek romani “Intibah” ku personazhi kryesor Aliu, pas vdekjes së babait përfundon në rrugë të keqe edhe pse e ëma përpiket t’i qëndrojë pranë dhe ta ndihmojë. Kjo sjell shkatërrimin e jetës së tij.

Babai i Xhezmiut nuk bën gabimet që nëna do t’i bënte për shkak të dhembshurisë.

“Nëse fëmija do qante ai do qeshte dhe do e bënte të qeshte edhe atë. Nëse fëmija do të sëmurej do të kujdesej që ta shëronte duke ruajtur shëndetin e tij.”<sup>131</sup>

Në rritjen e Xhezmiut merr pjesë edhe xhaxhai i tij. Ndërsa babai kujdeset për stërvitjen ushtarake, xhaxhai kujdesej për edukimin në fushën e shkencës. I rritur në këtë mënyrë Xhezmiu bëhet një ushtar i fortë, i fuqishëm, me karakter dhe kulturë.

Personazhi i parë femër me tipare të prindërit ideal është nëna e Talatit, znj.Saliha, në romanin e parë turk “Dashuria e Talatit dhe Fitnatit”. Ajo sakrifikon shumë për të mirën e djalit të saj. Ajo nuk na del përpara si nëna që përpiket të arsimojë dhe edukojë djalin, por me një tipar tjetër. Ndryshe nga shumë prindër që vendosnin vetë për të ardhmen e fëmijëve dhe i martonin me ata që mendonin se ishte më e mirë për fëmijën e tyre, ajo për shkak edhe të vuajtjeve që kishte kaluar në jetën e saj në lidhje me martesën, nuk pranon të kërkojë nuse për të birin. Ajo i shprehet kështu dados kur i kërkon të dalin të kërkojnë nuse për Talatin:

“Si ta njoh një vajzë vetëm me një të parë? Nuk do ja njihja as fytyrën. Pastaj a duhet të jetë nusja vetëm e bukur? Si mund ta fus një vajzë në shtëpi nëse ajo nuk është e zgjuar, e ndershme, e sjellshme? A do e pëlqejë djali atë që do pëlqejë unë dhe ti? Po thua të bëjmë siç bën e gjithë bota. Nuk po e sheh që shumica e njerëzve martohen sot ndërsa nesër ose burri ndan gruan ose gruaja ndan burrin. Turpërohen familjet. Kështu ndodh nëse merr një vajzë që nuk e njeh dhe ja jep një burri që nuk ja ke idenë si është., por a do t’u puqen karakteret? Do pëlqehen? Do duhen? I mendojnë ndonjëherë këto nëna dhe babai i tyre?”<sup>132</sup>

Me përpjekjen për ta edukuar djalin, por më e rëndësishmja me lënien të lirë në vendimet që do të marrë për jetën e tij dhe mbështetjen që i jep, ajo është personazhi i parë i ideal prindëror femëror në romanin turk.

Një personazh tjetër që na shfaqet me këto cilësi është edhe nëna e Mukadim Beut tek romani “Muhadarat” i shkrimtares Fatma Alije. Ajo arrin ta edukojë djalin në mënyrën më të mirë të mundshme duke gërshtuar edukimin tradicional dhe atë perëndimor. Ajo është një grua e fortë. Edhe pas vdekjes së burrit ajo arrin ta edukojë djalin me gjithë sakrificat që bën.

“Znj. Mynever ishte me të vërtetë një grua e fortë dhe me karakter e cila përpiquej me të gjitha forcat për edukimin dhe shkollimin e Mukadim Beut. Ajo kishte gjetur mësuesit më të mirë dhe kishte gjetur edhe një mësues frëngjishteje që t’i jepte mësim përditë. Ajo ruante gjithë pasurinë e trashëguar nga babai i Mukadim Beut përveç rrogave të mësuesve që i paguante në rregull. Ndërsa në të gjitha shpenzimet e tjera ajo tregohej shumë kurnace dhe dorështrënguar. Asnjë nga paratë e ndara për Mukadem Beun nuk harxhohej për gjë tjetër. Znj. Mynever duke qenë se kishte parë si ishte harxhuar pasuria e nënës së saj nga shërbëtorët e vilës tregohej shumë e

<sup>131</sup> Kemal, N. Cezmi, Stamboll, 1996, f. 39

<sup>132</sup> Sami, Ş. Taaşuk-ı Talat ve Fitnat, Ankara, 2003, f. 8

kujdesshme me shpenzimet. Edukimin e djalit në lidhje me moralin e kishte marr vetë përsipër. Në çdo bisedë që bënte me djalit i fliste për mirësinë dhe humanizmin, por në të njëjtën kohë i fliste edhe për njerëzit e këqij duke i ngulitur në zemër urrejtjen ndaj këtyre lloj personash. Edhe Mukadem Beu tregonte një respekt dhe dashuri të madhe ndaj nënës për shkak të këtij edukimi dhe sakrificave që ajo kishte bërë.”<sup>133</sup>

Ndryshe nga nënat e tjera të përvuajtura që na dalin përpara në romanet e para turke znj. Mynever paraqitet si një grua me karakter të fortë. Ajo përfaqëson tipin ideal të nënës. Ajo është një nënë shumë e dhënë pas djalit, por njëkohësisht si një nënë e mirë e zgjuar dhe e ditur rrit një djalë shembullor. Kjo gjë vlerësohet edhe nga komshinjtë.

Cilësitë e saj nuk mbarojnë me kaq. Ajo merr përsipër të mbrojë edhe Fadilen dhe Shefikun, fëmijët që ja lë amanet shoqja e saj. Ajo mundohet t'i mbrojë ata nga njerka e tyre Xhalibe. Madje i mbron edhe nga dadoja e tyre që i keqtrajton për të rënë në sy të Xhalibes. Me këto sjellje ajo tregon që është një nënë e mirë jo vetëm për djalit e saj, por edhe një femër e dhembshur për gjithë fëmijët e pambrojtur.

Një personazh tjetër prindëror që në fakt nuk ka lidhje gjaku është edhe Dado Fedai Kallfa në romanin “Felatun Beu dhe Rakim Efendi”. Rakim Efendi rritet që i vogël nga e ëma dhe dadoja, por më pas i vdes dhe e ëma dhe ai mbetet vetëm nën kujdesin e dados. Dadoja sakrifikon shumë për arsimimin e Rakim Efendit. Madje edhe dhënia e emrit Fedai (Sakrificë) nga ana e Ahmet Mid'hatit bëhet pikërisht për këtë arsye. Ndjenja e prindit tek Fedai Kallfa kalon edhe tek Xhanani, skllavja që blihet për ta ndihmuar në punët e shtëpisë. Sakrificat e Fedai Kallfës janë ndryshe nga sakrificat e personazheve të tjerë. Ajo nuk ka arsimim, nuk ka as para, por kujdeset për shtëpinë dhe shpenzimet duke i dhënë mundësi Rakim Efendit të shkollohet sa më mirë.

Siç e shohim, personazhet e prindit ideal qofshin ata nëna, babai, kushëriri i parë ose dado, ata kanë si qëllim që brenda kufijve të përcaktuar për personazhin në roman të bëjnë maksimumin për rritjen dhe edukimin sa më të mirë të fëmijës.

---

<sup>133</sup> Aliye,F. Muhadarat, Stamboll, 2005, f. 56-57

## 5.6 Trimi

Një nga qëllimet e shkrimtarëve të periudhës së Tanzimatit ishte lavdërimi i vlerave e qytetërimit Islam. Personazhi i myslimanit trim dhe të ndershëm është një nga këto vlera. Ndonëse romancierët mundohen të marrin sa më shumë nga qytetërimi perëndimor ata kanë një prejardhje lindore dhe nuk mund të hidhnin poshtë ato cilësi të cilat kishin bërë të mundur ngritjen e një qytetërimi dhe perandori të ndryshme. Po ashtu duhet të kemi parasysh edhe shoqërinë e kohës e cila ishte e rritur me një mentalitet të caktuar. Ende në atë kohë shumica e shoqërisë besonte se të luftosh me shpatë në dorë mund të sillte shpëtimin e vendit.

Personazhi i trimit si fillim dallohet tek romanet e Ahmet Mid'hat Efendit me karakteristikat e përgjithshme e të qënurit një njeri trim, i fortë, me karakter, mëshirues, që i ndodhet pranë të dobëtisë dhe që dënon fajtorin në proporcion me fajin që kryen. Ai nuk ka frikët të hidhet në aventura dhe nuk mendon për pasojat kur vjen rasti për të ndihmuar të dobëtisë ose të pafajshmit. Sema Uğurcan shprehet kështu për personazhet e trimit të Ahmet Mid'hatit.

“Edhe personazhet heronj të Mit'hat Efendit, ashtu si ai nuk e pëlqejnë luftën ose trazirat e brendshme dhe nuk luftojnë pa qenë të detyruar. Përgjithësisht përpiqen për të sjellë paqen, por kur nevojitet nuk tërhiqen nga lufta për të mbrojtur atdheun, fenë dhe miqtë. Tek këto personazhe janë mbledhur cilësitë e mëshirës, forcës, moralit dhe guximit. Mit'hat Efendi beson se ata kanë shpirtin e një kalorësi.”<sup>134</sup>

Personazhin e trimit e gjejmë tek romanet Hasan Mellah dhe Hysein Fellah. Romani “Hasan Mellah” ashtu siç e thamë më sipër është një roman i ndikuar nga romani “Konti i Monte Kristos”. Hasan Mellah është një marinar i idealizuar. Duke qenë se një pjesë e ngjarjeve ndodhin edhe në vende të krishtera ai në fillim duhet të përfaqësojë pikëpamjet e fesë islame dhe tolerancën që shkrimtari e thekson dhe mburr shumë.

Përveç këtyre cilësive ai ka edhe cilësitë e tjera të nevojshme për të qenë një personazh trim. Ai është i shkolluar pasi ka mbaruar akademinë e marinës, është i zgjuar, trim, i kulturuar, besnik dhe i ndershëm. Gjatë aventurave të tij ai mundohet të bëjë mirë. Bashkon familjet ose të dashurit e ndarë siç është rasti i Esmas me Timurin. Nuk prek njeri në nder dhe mbron nderin e njerëzve pa mbështetje. Ai bie në dashuri me Zhizelën. Pasi ia rrëmbejnë të dashurën ai detyrohet ta kërkojë atë duke shëtitur në të gjithë Mesdheun.

Me gjithë të këqijat e bëra ndaj tij ai përsëri nuk heq dorë nga principi që çdo fajtor të dënohet në bazë të fajit që ka kryer. Ai tregohet tolerant edhe ndaj rrëmbyesit të Zhizelit, Domeniko Badias, duke ia falur jetën.

Një cilësi tjetër që përpiket ti jap shkrimtari këtij personazhi është e investuesit të suksesshëm. Këtë mendim të shkrimtarit e përforcon edhe Berna Moran kur thotë : “... Hasani nuk përpiket vetëm të shpëtojë të dashurën e rrëmbyer dhe të marr hak ndaj atyre që i vranë babanë, por në të njëjtën kohë rrit pjesën e aksioneve në

---

<sup>134</sup> Uğurcan, S. “Ahmet Midhat Efendinin Romanlarında Tarih ve Medeniyet” Türk Dili Dergisi, Stamboll, 1995, f.562

kompani. Pasi sipas Ahmet Mid'hatit për një mashkull ideal përdorimi i mirë i pasurisë dhe shtimi i saj është një cilësi e domosdoshme.”<sup>135</sup>

Megjithatë nuk mund të themi se kjo është një cilësi që i përket vetëm personazhit të trimit, por është një cilësi që shkrimtari ia vesh të gjithë personazheve kryesorë të romaneve të tij.

Personazh tjetër që do të shohim është Shehlevendi tek romani “Hysein Fellah”. Ndonëse emri i romanit është “Hysein Fellah” personazhi kryesorë është Shehlevendi. Nuk e dimë përse shkrimtari ka bërë një gjë të tillë. Mundësia që të mos e ketë shkruar emrin e saj si titull romani prej frikës nga reagimi i shoqërisë nuk ekziston pasi kemi romane të tjerë si “Znj.Durdane” të cilat nuk patën asnjë reagim. Po ashtu në të njëjtën kohë kemi edhe tregime me emra grash. Ky personazh ashtu si edhe personazhi i mësipërm kalon shumë aventura. Pas vdekjes së të atit e ëma nuk arrin të administrojë mirë pasurinë dhe kështu bien në varfëri. Për të shpëtuar të ëmën nga kjo varfëri ajo vendos të shes veten si skllave dhe përfundon në një shtëpi në Algjeri.

Për të shpëtuar nderin ajo luan rolin e një memeceje. Ajo shitet tek Ahmet Beu që hiqej si një njeri i mirë para popullit, por që në fakt ishte një hajdut. Shehlevendi vihet në rolin e hakmarrësit të popullit pasi i pengon gjithë planet ogurzeza të Ahmet Beut.

“Zoti do që, qoftë në këtë botë qoftë në tjetrën, asnjëri të mos mbetet pa marr atë që meriton. Hakmarrja bëhet kur ai njeri jo vetëm që nuk të bën të mirë, por të bën keq edhe kur nuk ka asnjë arsye. Nëse këta njerëz që vuajnë nga këta hajdutë nuk kanë fuqi të hakmerren, atëherë do ta bëj unë.”<sup>136</sup>

Por asaj nuk i mjafton forca për t’u hakmarrë. Këtu ajo ndryshon nga Hasani i cili e ka në dorë të hakmerret, por nuk e bën. Megjithatë ajo ja lë Zotit në dorë ashtu si Hasani dhe mëson më vonë për dënimin që marrin shkaktarët e vuajtjeve. Shehlevendi, ndryshe nga Hasani, nuk ka forcë fizike, por ka zgjuarsia dhe aftësi të shkëlqyera planifikuese. Po ashtu ajo nuk ka një edukim shumë të mirë, por arrin të edukojë veten në mënyrë autodidakte me aq sa ka mundësi. Që të dy personazhet ndihmojnë ata që janë në vështirësi pa menduar për vështirësitë që do kalojnë.

Në të njëjtin roman kemi edhe personazhet e Hysein Fellahut, Xhivelek Mustafait dhe Omerit të cilët kanë disa nga cilësitë e trimit, por nuk shpalosen aq hapur sa Shelevendi.

Personazhet e trimit në letërsinë turke të periudhës së Tanzimatit janë një miksim i personazhit historik të trimit të fortë guximtarë dhe zemërbardhë me kushtet e kohës. Këta personazhe jo gjithmonë përdorin shpatën për të zgjidhur problemet, por përdorim mendjen.

Një personazh tjetër që përfshihet në këtë grupim të personazhit të trimit është edhe heroi. Personazhi heroik është një personazh që vjen nga tradita letrare turke. Ata ekzistojnë që nga eposet e para turke. Në një periudhë kur çdo gjë po shkon për keq në perandorinë Osmane, shkrimtarët e Tanzimatit të cilët në të njëjtën kohë ishin edhe intelektualë, po mundoheshin të gjenin një mënyrë për ta shpëtuar nga rrënim.

<sup>135</sup> Moran, B. Türk Romanına Eleştirel Bir Bakış I, Stamboll, 2000, f. 30

<sup>136</sup> Midhat, A. Hüseyin Fellah, 2003, Stamboll, f. 169

Një nga këto mënyra për t'i kujtuar ishte edhe ndërgjegjësimi i lexuesit turk për të shkuarën e madhërishtme si dhe për heronjtë që jetonin në të shkuarën e largët ose të afërt. Ky lloj personazhi ka besim në vete, është aq i guximshëm sa të luftojë i vetëm për të mbrojtur vendin dhe popullin e tij. Heroi ideal ku ata mbështeten në letërsinë turke është Oguz Kagani<sup>137</sup>, perandoi i parë turk i cili ishte një luftëtar që e kaloi gjithë jetën e tij mbi kalë duke luftuar për idealet e tij dhe zgjerimin e shtetit.

Kemi dy romancierë që e fusin këtë lloj tipi në romanet e tyre. Namik Kemali dhe Ahmet Mid'hati. Përfaqësuesi kryesor i këtij tipi është Xhezmiu në romanin me të njëjtin titull. "Romani historik Xhezmi i shkruajtur nga Namik Kemali është një roman me përmbajtje politike që nxjerr në plan të parë idenë e bashkimit Turko-Islam. Shkrimtari nëpërmjet romanit u paraqit lexuesve një hero me cilësitë më të mira në çdo fushë që përpiqet për të vënë në jetë këtë ideal."<sup>138</sup>

Xhezmiu ashtu si dhe personazhet e tjerë të romanit është marr nga historia e vërtetë. Ashtu si gjithë personazhet kryesorë në romanet e periudhës së Tanzimatit ai është i pajisur me gjithë cilësitë që i duhen. Di të përdorë shumë mirë armët, është një kalorës shumë i mirë, guximtarë, trim, poet dhe një i ri që beson tek ideali i bashkimit Turko-Islam. Ai rritet nga babai dhe xhaxhai pasi që në moshë të vogël humbet të ëmën. Babai dhe xhaxhai ishin kalorës të famshëm në kohën e tyre. Më pas ai merr pjesë në luftërat që bëhen mes Osmanllinjve dhe Iranianëve (Safevinjëve). Atje ai njihet me Adil Girain, vëllanë e mbretit të Tatarëve. Pasi Adil Girai kapet rob ai përpiqet ta lirojë duke kaluar aventura të shumta. Abdullah Uçman mendon se këtu shkrimtari tregon pak edhe për veten tij.

"Namik Kemali, duke paraqitur këtu personazhin e idealizuar Xhezmi, në fakt është munduar të tregojë njohuritë që morri gjatë periudhës kur jetoi në Kars siç janë kalërimi, gjuajtja me hark ose hedhja e shtizës."<sup>139</sup>

Ndërsa Ahmet Hamdi Tanpınar thekson faktin që Namik Kemali nuk zgjodhi një jeniçer<sup>140</sup>, por një spahi<sup>141</sup>. Arsyen e kësaj zgjedhjeje ai e mbështet në faktin që personazhi duhet të jetë një turk mysliman i pastër. Vetëm duke qenë një personazh i tillë që vjen nga populli turk, që ka një trashëgimi ushtarake dhe që është rritur sipas mënyrës tradicionale Osmane mund të luftojë për të shpëtuar shtetin Osman nga kjo rënie e ngadaltë, por e pashmangshme. Namik Kemali nxjerr në pah karakterin luftarak të personazhit pasi mendon se ai lloj tipi mund të jetë shpëtimi i shtetit Osman. Shkrimtari e prezanton kështu Xhezmiun kur ai del në jetë pas vdekjes së të atit.

---

<sup>137</sup> Oguz Kağan është emri i një mbreti mitik në eposin me të njëjtin emër. Shumë historianë pretendojnë se ai ka ekzistuar me të vërtetë dhe është Mete Han themeluesi i shtetit (perandorisë) të parë Hun në vitet 220 -180 para erës sonë.

<sup>138</sup> Çetin, N. "Tanzimat Döneminde Türk Romanı (1860-1878)" Hece Dergisi, Stamboll, 2002, f. 42

<sup>139</sup> Uçman, A. Tanzimat Edebiyatı, Ankara, 2006, f. 267

<sup>140</sup> Jeniçerët e asaj kohe ende rekrutoheshin sipas sistemit të vjetër. Kjo do të thotë që ata ishin fëmijë të krishterë që merreshin që të vegjël nga familjet e tyre dhe edukoheshin sipas sistemit të rreptë ushtarak Osman.

<sup>141</sup> Spahinjët ishin reparte kalorësie ku mbizotëronin ushtarët me origjinë të pastër nga fiset turke.



“Ishte aq i ri sa mund të quhej fëmijë, por në trupin e tij kishte aq shumë fuqi sa dukej se s’do plakej kurrë ndërsa shpata e trashëguar nga babai ishte aq e mprehtë sa ta mbronte nga armiqtë e tij.”<sup>142</sup>

Me këto cilësi, si dhe me cilësitë e tjera si guximi dhe trimëria na ai paraqitet me tiparet e tipit të heroit. Megjithatë në personazhet heroik gjatë gjithë letërsisë turke guximi dhe trimëria janë ndjekur pandashmërisht edhe me njeriun e ndjeshëm dhe poet pasi vetëm kështu ky tip heroik do të ishte i pranueshëm për gjithë popullin. Edhe Xhezmiu nuk i shpëton kësaj gjëje. Ky tip i rikrijuar në periudhën e Tanzimatit duhet të mbartë me vete gjithë veçoritë e heronjve të lashtë, por me përshtatjet e kohës kur u krijua.

Xhezmiu shkon në Stamboll ku njihet si me Fetah Agën ashtu edhe me poetin Nevi<sup>143</sup>. Ai i shfrytëzon këto miqësi që të merret për në fushatën ushtarake ndaj Iranit pasi nuk e merrnin për shkak të moshës së re dhe mos pasjes së eksperiencës në fushëbeteje. Gjatë luftës jo vetëm që tregohet shumë i dobishëm, por pasi bëhet mik me Adil Girain ai përpiket ta shpëtojë atë nga robëria.

Sipas Tanpënarit ky roman është një roman politik.

“... është një roman ideologjik brenda një kuadri historik. Namik Kemali i mbledh edhe njëherë pas Xhelalit mendimet në lidhje me të drejtat e njeriut, dashurisë ndaj atdheut dhe idenë e bashkimit Islamik. Është për të ardhur keq që romani nuk është mbaruar.”<sup>144</sup>

Ndonëse studiuesit turq mundohen të japin këtë ide në fakt ai nuk mund të konsiderohet një roman politik. Ky është një roman i papërfunduar. Lidhja mes një romani politik dhe një romani historik mund të gjendet gjithmonë duke nxjerr nga konteksti në pjesë të veçanta. Në këtë rast nuk mund ta konsiderojmë si një roman politik pasi bashkimi Islamik që pretendohet nuk mund të bëhet duke e justifikuar me një luftë brenda vetë myslimanëve dhe për më tepër gjatë romanit nuk kemi asnjë sfond ku të kërkohet një gjë e tillë.

Në fakt romani Xhezmi ishte konceptuar vetëm si fillimi i aventurës së Xhezmiut, por romani i dytë nuk erdhi kurrë. Kështu që letërsia turke humbi një mundësi të mirë për të pasur një roman të plotë historik. Xhezmiu ishte një personazh i vërtetë që kishte jetuar. Ai ishte shkruar i një spahiu që u vra nga shërbëtorët e tij për t’i marr paratë.

Një personazh tjetër heroik dhe njëkohësisht historik është Adil Giraj, vëllai i mbretit të Tatarëve që i bashkohen fushatës që zhvilloi perandoria Osmane. Edhe ardhjen e tij në jetë Namik Kemali e përshkruan imtësisht sipas traditës së vjetër turke.

“Disa muaj para lindjes së Xhezmiut, në një mëngjes pranveror, Adili lindi së bashku me lindjen e diellit dhe me të lindur filloi të qante sikur të dinte fundin e botës që do të vinte nga veset e njeriut.”<sup>145</sup>

<sup>142</sup> Kemal, N. Xhezmi, Stamboll, 1996, f. 40

<sup>143</sup> Poet i famshëm turk në fundin e shek. XVI.

<sup>144</sup> Tanpınar, A. 19. Asır Türk Edebiyatı Tarihi, Stamboll, 1997, f. 407

<sup>145</sup> Kemal, N. Xhezmi, Stamboll, 1996, f. 19

Adil Giraj është poet njësoj si Xhezmiu. Në moshën njëzetvjeçare ishte bërë një nga poetët më të mirë të kohës. Përveç këtij talenti ai ishte edhe një i ri simpatik, i fuqishëm, i kulturuar, besimtar dhe me integritet. Besnikëria e tij ndaj shtetit Osman nuk ndryshon edhe pse e burgosin. Besnikëria që tregon ndaj vendit dhe të dashurës së tij është një nga veçoritë që i duhen një heroi. Vdes me shpatë në dorë duke luftuar së bashku me të dashurën e tij.

Një personazh tjetër paksa më i ndryshëm është edhe Perihani. E dashura e Adil Giraj. Ndonëse femër ajo mbart të njëjtat cilësi si të Adilit ose Xhezmiut. Sipas Zejnep Kermanit personazhet e Namik Kemalit bartin të njëjtat cilësi edhe pse mund të jenë të gjinive të ndryshme.

“Namik Kemali në romanin historik “Xhezmi” e paraqet personazhin femëror, Perihanin, si një vajzë guximtare, të pafajshme, me bukuri të rrallë dhe të ndershme. Perihani ashtu si edhe Dilashubi është një femër që dashuron vetëm njëherë dhe nuk frikësohet të shkojë drejt vdekjes për hir të dashurisë që ka. Nga ky këndvështrim mund të themi se përveç portretit fizik nuk ka asnjë ndryshim mes personazhit heroik femër dhe atij mashkull.”<sup>146</sup>

Në kulturën e lashtë nomade turke gruaja zë një vend të rëndësishëm. Ajo i qëndron pranë burrit dhe ka pothuajse të njëjtat vlera si në shoqëri ashtu edhe në eposet heroike që tregojnë luftërat e zhvilluara nga ata. Ndoshta për këtë arsye Namik Kemali pranë personazhit Adil Giraj vendos një personazh femërorë me pothuajse të njëjtat cilësi. Që të dy janë të fortë dhe guximtarë. Perihani di të kalërojë si dhe të përdorë shpatën mirë. Përveç cilësive të mësipërme ajo është edhe një vajzë shumë e bukur, me një karakter dhe moral të pashoq. Ajo ka një rol të rëndësishëm në politikën shtetërore pasi është edhe vajza e Shahut. Për shkak të cilësive të mësipërme, të moralit të lartë si edhe të pushtetit që kishte meshkujt që e rrethonin i nuk dukeshin në atë nivel që të qëndronin pranë saj. Kur sheh dhe njeh më nga afër Adil Girajin ajo bie në dashuri me bukurinë jo vetëm fizike, por edhe shpirtërore të tij. Për shkak të kësaj dashurie ajo vdes duke luftuar pranë atij.

---

<sup>146</sup> Kerman, Z. Yeni Türk edebiyatı İncelemeleri, Ankara, 1998, f. 260

## 5.7. Romantiku

Një nga temat që romancierët e periudhës së Tanzimatit kanë dëshirë të prekin është tema e skllavërisë. Përgjithësisht kjo ndodh për shkak të ndikimit që kishte romantizmi dhe iluminizmi evropian tek këta shkrimtarë. Në fakt ajo që u bënte më shumë përshtypje nga rryma romantike ishte mos kufizimi i temave mbi të cilat shkruajnë. Ata prekin çdo temë që ka lidhje me njeriun dhe për më tepër arrijnë ta entuziazmojnë lexuesin kur ja përcjellin këtë gjë. Shprehja e Viktor Hygoit “kur ju flas për vetën time në fakt po ju flas për veten tuaj” ishte e parapëlqyera e romancierëve turq. Shkrimtarët turq deri në atë kohë ishin shumë të kufizuar për sa i përket tematikës që mund të prekin në shkrimet e tyre për shkak të traditës. Ata jo vetëm që mahniten nga principi “arti në dobi të shoqërisë”, por edhe mundohen ta vënë në përdorim në vendin e tyre. Kuptohet që kjo nuk ishte diçka e lehtë.

Një nga problemet që shkrimtarët mendonin se kishte shoqëria Osmane ishte skllavëria. Ata jo vetëm e përfshijnë këtë problem si pjesë të romaneve të tyre, por shkrimtari Samipashazade Sezai e bën temën kryesore të romanit të tij “Sergüzeşt”. Aty flet për Dilberin, një skllave të rrëmbyer nga Kaukazet. Ky është rasti i parë në letërsinë turke ku një skllave bëhet personazhi kryesorë i një romani. Ajo kalon aq shumë vuajtje sa që edhe kur i bëjnë një të mirë nuk mundet ta besojë. Ismail Parlatir shprehet kështu për këtë personazh :

“Pasi u morr nga prehri i nënës dhe u soll në Stamboll e deri sa vdiq Dilberi i përjetoi të gjitha vuajtjet që mund të pësonte një skllave. Ajo është menduar si një tip i idealizuar në jetë i marr nga ana këndvështrimi negativ. Është më se normale që një shkrimtar, i cili ndjen urrejtjen ndaj një prej armiqve më të mëdhenj të lirisë njerëzore, të krijojë një tip të tillë. Shkrimtari e prek në mënyra të ndryshme jetesën nën skllavëri duke filluar nga burimi i skllavërisë. Për më tepër Sami Pashazade Sezai jep mendimet e tij dhe me një ndjeshmëri që vjen nga vetë tema e prekur përfshihet në një ndjesi romantike. Pikërisht në ato pjesë ku romantizmi fillon të tregojë peshën e tij Dilberi fillon të idealizohet si tip.”<sup>147</sup>

Ajo rrëmbehet në moshë të vogël dhe i vendoset emri Dilbere pa e pyetur njeri. Që e vogël ajo torturohet duke u lënë pa bukë ose duke u rrahur me kamxhik. Për shkak të torturave të pësura largohet nga familja që e kishte blerë., por pas një dite e kapin dhe e torturojnë edhe më shumë. Pastaj e shesin në një familje tjetër. Në familjen e Asaf Pashës ajo trajtohet shumë më mirë. Përveç kësaj ajo edhe edukohet. Mëson të luaj në piano. Për shkak të trajtimit të mirë ajo sa vjen e bëhet më e bukur. Bukuria dhe sjellja e saj e mirë bëjnë që djali i familjes Xhelal Beu të bie në dashuri me të. Ndonëse nuk ka tortura fizike, zonja e shtëpisë e torturon shpirtërisht. Kur familja mëson për këtë dashuri e shet menjëherë Dilberin në Egjipt.

Ata e bëjnë këtë gjë kur Xhelal Beu shkon tek xhaxhai i tij për të kërkuar ndihmë për t’u martuar me Dilberin. Xhaxhai i tij e mbështet martesën me dashuri ashtu si edhe Xhelali, por nëna e Xhelalit ka një mendim shumë më ndryshe. Ajo mendon se martesë duhet të bëhet me një vajzë e rangut të saj si nga pozita ashtu edhe nga pasuria. Ndërsa Xhelal Beu, i cili është shkolluar në Evropë beson në njohjen e personit me të cilin do martohesh dhe si kusht kryesor sheh dashurinë dhe bukurinë shpirtërore.

<sup>147</sup> Parlatir, I. “Dilber” Türk Dili Dergisi, Ankara, 1984, f. 219

Dëshira e nënës për ta martuar me një vajzë të pasur dhe jo me Dilberen i kushton jetën djalit të saj i cili në fillim çmendet dhe pastaj sëmuret dhe vdes. Në fakt edhe Xhelal Beu është një personazh romantik. Pikëpamjet e tij mbi martesën dhe sëmundja pastaj vdekja e tij për shkak të dashurisë e bën një personazh me tipare romantike.

Edhe fundi i Dilberit është i njëjtë. Pas shitjes në Egjipt ajo nuk pranon të bëhet dashnorja e pronarit. Ky kundërshtim tregon karakterin e fortë që ka Dilberi. Zejnep Kerman dallon këto gjëra :

“Dilberi është e vendosur të mos i përkulet dëshirave të atij njeriu pavarësisht dhuratave ose kërcënimeve që i bën. Këtu ne shohim një anë tjetër të Dilberit. Ajo është aq e guximshme dhe e pa prekur nga pasuria sa të mund të refuzojë çdo lloj pasurie dhe të ardhme të sigurt.”<sup>148</sup>

Pasi e sheh që pronari i saj nuk tërhiqet nga dëshirat e tij ajo vendos të arratiset. Kur dështon në tentativën për t’u arratisur nga shtëpia e pronarit të saj ajo hidhet në ujërat e lumit Nil duke vrarë veten. Me këtë ajo shpreh tiparin më kryesor të personazhit romantik. Zgjedhjen e vdekjes përpara humbjes së lirisë.

Personazhe të tjerë me tipare romantike i gjejmë edhe në romanin e parë “Dashuria e Talatit dhe Fitnatit”. Dy personazhet kryesorë Talati dhe Fitnati me dëshirat e tyre për një jetë të lirë dhe pa kufij. Edhe ata për shkak të pamundësisë së bashkimit me njëri tjetrin preferojnë të vrasin veten.

Në romanin “Intibah” skllavja që blihet për t’u martuar Aliu, Dilashupi, në fund të romanit fillon të marr karakteristikat e një personazhi romantik. Edhe pse vuan shumë nga sjellja e Aliut, i cili e rreh dhe e dëbon nga shtëpia pas disa shpifjeve që bëhen ajo vazhdon ta dashurojë. Jo vetëm kaq, por për ta shpëtuar atë nga vdekja ajo nuk heziton t’i zërë vendin.

Personazhet romantikë në romanet e para turke dallohen për shpirtin e tyre të lirë dhe sakrifikues. Ata janë të gatshëm të vuajnë shumë për të arritur lirin e tyre, por kur e shohin që nuk është më e mundur pranojnë më mirë të vdesin sesa ti dorëzohen fatit. Ata janë personazhe që e ndjejnë dashurinë dhe vuajnë për të. Ky lloj personazhi haset shpesh edhe në letërsinë turke të më hershme. Në tregimet edhe poezitë turke kemi shumë raste kur personazhet e dashuruar vendosin të vdesin sesa të humbasin dashurinë.

---

<sup>148</sup> Kerman, Z. Yeni Türk edebiyatı İncelemeleri, Ankara, 1998, f. 43

## 5.8 Shkencëtari (studiuesi)

Një pikë tjetër ku shkrimtari Ahmet Mid'hat Efendi fokusohet në veprat e tij është edhe tema e shkencës dhe dijes. Ai i kushton një vend të rëndësishëm shkencës dhe përparimeve teknologjike. Pothuajse të gjithë personazhet kryesorë në romanet e tij janë të dhënë pas shkencës dhe dijes. Bëjnë përjashtim romanet policeske. Në këtë pikë ai mundohet të kujtojë të shkuarën e lavdishme islame dhe turke kur ata ishin në pararojë të shpikjeve dhe shkencës. Ndryshe nga koha ku jeton në të cilën perandoria Osmane ka mbetur prapa si në shkencë e dije ashtu edhe në teknologji. Shkrimtari nuk do të rigjallërojë të shkuarën, por të krijojë të ardhmen. “Ahmet Mid'hat Efendi sheh që shkencën të cilën e kemi harruar në histori e kanë marr dhe i kanë dalë për zot perëndimorët.”<sup>149</sup>

Ahmet Mid'hati kërkon që të gjithë personazhet pozitivë të merren me shkencë. Kur thotë shkencë ai e ka fjalën për shkencat ekzakte që mund të provojnë ose faktojnë atë që studiojnë. Sipas Ahmet Mid'hatit çdo gjë e ka një arsye, një shkak. “Shkencat ekzakte në fakt janë shkencat e atyre që shohim. Nga vijnë dhe si krijohen ato që hamë? Ngjyrat, lloji, shtimi, vlerat e këtyre mrekullive që i shohim në natyrën që na rrethojnë ... Gjithë këto gjëra që i shohim përditë, por që nuk mendojmë asnjëherë se si janë krijuar. Informacionet që jep Ahmet Mid'hati në lidhje me shkencat natyrore në veprat e tij janë për të tërhequr interesin lexuesve ndaj gjërave që na rrethojnë.”<sup>150</sup>

Në romanet e tij, Ahmet Mid'hat Efendi shkruan shumë në lidhje me zhvillimet e teknologjisë. Për shembull në romanin “Znj. Durdane” flitet për telefonin i cili përdorej vetëm nga disa familje në Stambollin e asaj kohe. Ulvija e shuan kuriozitetin që ka ndaj takimeve të znj. Durdane me anë të një telefoni. Ndërsa në romanin “Vah” flet për teknikat e fotomontazhit në Stamboll kur ai akoma nuk ishte njohur nga të gjithë fotografët e kohës. Në romanin “Hayret” flet për fonografin. Po ashtu flet edhe për Ismail Mirzën, një magjistar që përfiton nga shkencat natyrore për të kryer magjitë e tij.

Ahmet Mid'hati si arsyen kryesore të prapambetjes së shtetit Osman në industri thekson prapambetjen në shkencat natyrore. Ai shprehet se shkencëtarët perëndimorë mundohen të gjejnë mënyrën se si të vënë në përdorim zbulimet e shkencës në funksion të industrisë, ndërsa në Turqi ndodh e kundërta.

Ahmet Mid'hati nuk mjaftohet vetëm duke i dhënë një vend të veçantë shkencës dhe teknologjisë në veprat e tij, por tregon në mënyrë të hollësishme se si duhet të jetë një shkencëtar. “Në romanin Acayib-i Alem” (Botë e çuditshme) ai paraqit personazhin e shkencëtarit duke e pajisur me gjithë cilësitë e nevojshme.”<sup>151</sup>

Në këtë roman ai jep tri personazhe shkencëtarë nga të cilët Suhiu është më ideali. Personazhet e tjerë janë Hixhabi si dhe personazhi femër, një vajzë angleze e quajtur Haft. Arsyeja pse ka zgjedhur një vajzë angleze si shoqëruese të dy shokëve dhe jo një vajzë myslimane turke është sepse në periudhën kur shkruhet romani ishte e pamundur të mos merrte kritika nga qarqet fanatike që nuk i pranonin lehtë ndikimet perëndimore. Megjithatë Ahmet Mid'hati nxjerr një justifikim tjetër më pak të

<sup>149</sup> Okay, O. *Batı Medeniyeti Karşısında Ahmet Midhat Efendi*, 1991, Stamboll, f. 42

<sup>150</sup> Okay, O. *Batı Medeniyeti Karşısında Ahmet Midhat Efendi*, 1991, Stamboll, f. 50

<sup>151</sup> Çetin, N. 2002, *Tanzimat Döneminde Türk Romanı*, Stamboll, f. 43

besueshëm për arsyen e mos pasjes së një personazhi femëror mysliman. Në roman, kur Hicabi i thotë se për t'u nisur për në udhëtim duhet të merrte lejen nga familja Suhpiu i thotë: Po të ishin gra evropiane do vinin me dëshirë të shoqëronin burrin në udhëtim. Ndërsa gratë tona edhe për të shkuar si mysafir tek një shoqe do marrin të paketojnë gjysmën e rrobave të shtëpisë për t'i marrë me vete.

Me këtë thënie Ahmet Mid'hati shpreh edhe mendimin e tij që nuk janë pjekur ende kushtet që femrat Osmane të merren me shkencë ose të udhëtojnë për hir të shkencës. Nuk ka sesi të jetë ndryshe pasi mënyra e rritjes dhe këndvështrimi që kanë ndaj jetës femrat Osmane nuk e lejojnë një gjë të tillë.

Personazhi shkencëtarë kryesor është Suhpiu i cili jeton në një fshat pranë Stambollit. Ai është i pasionuar pas shkencave natyrore. Ky pasion për shkencën bën që ai të konsiderohet si i çmendur nga njerëzit e fshatit. Shtëpia e tij është e mbushur me libra rreth shkencës në turqisht, arabisht, frëngjisht dhe me pajisje të shumta të çuditshme. Suhpiu është i pasionuar pas çdo lloj dijeje dhe gjëje. Bën eksperimente të ndryshme çdo ditë. Një ditë mundohet të bëjë një anije, ndërsa ditën tjetër mundohet të fluturojë me një balonë. Ka një koleksion të pasur me insekte. Ai është i dashuruar pas natyrës. Së bashku me shokun e tij, Hixhabin, niset për në polin e veriut nëpërmjet Ruisë. Gjatë udhëtimit ata njihen me shumë njerëz dhe mësojnë shumë gjëra të reja. Po ashtu ata mbrojnë moralin dhe qytetërimin Islam dhe Osman.

Hixhabi ndryshe nga Suhpiu në fillim kishte mësuar vetëm shkencat Islame. Pas miqësisë me Suhpiun fillon të tregojë interes për shkencat natyrore. Me këtë gjë Ahmet Mid'hati mundohet të tregojë se Islami nuk është i mbyllur ndaj shkencave natyrore dhe të resë, por përkundrazi ai e përkrah atë. Duke qenë se nuk kishte libra shkencorë në gjuhën turke ai është i detyruar të mësojë një gjuhë të huaj. Ndryshe nga shumica vendos të mësojë gjermanisht dhe jo frëngjisht.

Që të dy personazhet janë tek të tridhjetat. Suhpiu nuk është i martuar madje nuk ka njohur asnjë femër në jetën e tij. Ndërsa Hixhabi jo vetëm që është i martuar, por ka edhe dy fëmijë. Asnjëri nga të dy nuk e di ç'është argëtimi dhe nuk e pëlqejnë alkoolin. Megjithatë ata nuk hezitojnë të provojnë nga një gotë konjak të ofruar nga një princ rus.

Hixhabi zotëron mjaftueshëm shkencat Islame ndërsa Suhpiu shkencat natyrore. Hixhabi zotëron një pasuri të madhe dhe punon në një post të rëndësishëm shtetëror. Pas njohjes me Suhpiun fillon të bëhet kurioz për shkencat natyrore, largohet nga puna dhe merr mësues privatë për të zgjeruar dijet. Në të njëjtën kohë fillon mësimin e gjuhës gjermane.

Pas shumë diskutimesh ata vendosin të nisen për një udhëtim në polin e veriut. Për të siguruar paratë e nevojshme Suhpiu shet koleksionin e insekteve dhe librarinë e tij voluminoze. Ata vendosin të nisin udhëtimin nga Rusia.

Që në fillim të udhëtimit ata njihen me znj. Haft, një vajzë angleze shumë e përgatitur. Gjatë udhëtimit Suhpiu shpalos dijet e tij të thelluara në histori. Për shkak të nevojës ata mësojnë rusisht në një nivel të mjaftueshëm për të komunikuar. Ata shëtisin në të gjithë bibliotekat dhe laboratorët që gjejnë rrugës. Gjatë udhëtimit me anë të personazheve shkrimtari jep informacione të shumta. Në një festë të princit rus Hixhabi shpalos dijet e tij në lidhje me mënyrën e sjelljes në sallonet mondane. Suhpiu që i kishte mësuar vetëm nga librat, mahnitet nga sjelljet e Hixhabit. Me anë të

kësaj ngjarjeje Ahmet Mid'hati mundohet të tregojë se nga librat mund të mësohen shumë gjëra, por e mira është t'i përjetosh personalisht.

Personazhi i tretë, znj. Haft është një vajzë angleze. Ajo përveç cilësive të kërkuara tek një femër ka edhe shumë nga cilësitë që kërkohen tek një mashkull. Ajo është vajza e një mësuesi të pasionuar pas shkencës. Rritet duke mësuar nga i ati dhe trashëgon dëshirën për të mësuar. Pas vdekjes së të atit fillon të shëtisë nëpër botë duke kërkuar të mësojë sa më shumë. Për këtë arsye ajo refuzon edhe propozimet që i vijnë për martesë. Pasi shëtit në perandorinë Osmane ajo kalon në Rusi ku edhe njihet me dy shokët. Ka njohuri të thella mbi historinë. Ahmet Mid'hati duke përfituar nga ky personazh ankohet nëpërmjet saj për këndvështrimin që ekzistonte në perandorinë Osmane ndaj historisë.

Znj. Haft ndryshe nga shumë evropianë nuk ka paragjykime ndaj perandorisë Osmane dhe myslimanëve. Për më tepër ajo është shumë e informuar rreth fesë Islame. Një tipar tjetër i znj. Haft është guximi i saj. Ajo guxon të shëtisë botën e vetme. I refuzon në mënyrë të prerë lajkat dhe propozimet për martesë në Rusi për më tepër kur kupton që është e dashuruar me Suhpiun është ajo që i propozon për martesë.

Një tipar tjetër që është tipik për personazhet femërore të Ahmet Mid'hatit është virtyti i nderit. Ajo është e papërlyer. Znj. Haft është protestante. Në fund të romanit së bashku me Suhpiun vendoset në Stamboll. Ndryshe nga martesat e mëparshme në romanet e Ahmet Mid'hatit ku nusja e krishterë pasi martohet kthehet në myslimane në këtë rast ajo e mban fenë e saj.

Arsyeja përse Ahmet Mid'hati nuk e kthen në myslimane është për të treguar tolerancën e fesë Islame ndaj feve të tjera.

Veçoritë kryesore të personazhit shkencëtarë janë kurioziteti, të qënurin objektiv pasi besojnë tek arsyeja dhe eksperimenti si dhe morali i shkencëtarit që nuk dorëzohet para vështirësive ose paragjykimeve. Edhe pse nuk është një personazh shumë i prekur dhe i rëndësishëm në letërsinë e periudhës së Tanzimatit ai meriton të studiohet pasi është një risi në letërsinë turke. Ai mbart në vetvete një mesazh shumë të rëndësishëm për kohën që është hapja e shoqërisë turke ndaj të resë dhe teknologjisë pasi vetëm kështu ajo do të ecë përpara.

## 5.9 Personazhi Negativ

Si në çdo roman edhe në romanet e para turke ngjarjet në pjesën më të madhe krijohen duke u bazuar në përplasjen e mirë – e keqe. Kështu që pandashmërisht përballë një karakteri pozitiv ose të mirë na del një i personazh negativ ose i keq. Në këtë nën ndarje do japim karakteristikat e përgjithshme të këtyre personazheve. Përgjithësisht personazhet negativë janë një kopje e keqe e personazheve pozitivë në këto romane. Ata mund të kenë marrë një arsimim të mirë, por kanë karakter të dobët. Sytë e tyre errësohen nga dëshira për t'u dukur. Smira, urrejtja, paaftësia për t'u pranuar nga shoqëria ose njerëzit që ata duan janë tiparet kryesorë të këtyre personazheve. Ata janë xheloz për arritjet e të tjerëve dhe janë të gatshëm të përdorin çdo lloj forme për t'i penguar. Duke filluar nga shpifja, mashtrimi ose akuzat e rreme e deri tek grabitja, rrëmbimi, ose edhe vrasja. Shkrimtarët e Tanzimatit ashtu siç bëjnë me personazhet pozitivë të cilët janë pothuajse idealë të njëjtën gjë bëjnë me personazhet negativë që i bëjnë negativë tradicionalë. Nuk gjejmë tek këta personazhë asnjë brengë ose brejtje ndërgjegje.

Përfaqësuesi i parë i këtij lloj personazhi është Felatun Beu tek romani “Felatun Beu dhe Rakim Efendi”. Felatun Beu është djali i një njeriu të pasur që merr një edukim të mirë perëndimorë. Edukimi që ai merr mbetet sipërfaqësorë. Ai është i dhënë pas kënaqësive dhe argëtimit të zonës së Bejoglusë që njihet për shthurjen. Megjithatë edhe pse i dhënë pas këtyre kënaqësive Felatun Beu përpara të gjithëve mundohet të duket si një zotëri i vërtetë. Pasi njihet me familjen angleze Ziklas ai përpiqet të tregohet si intelektual dhe njeri i ditur. Cektësia e treguar nga ai gjatë arsimimit dhe paaftësia e tij për të shprehur mendimet bëjnë që shpesh herë të duket qesharak para familjes Ziklas dhe miqëve të tyre.

Negativiteti i tij dallohet hapur tek xhelozia që ka ndaj Rakim Efendit. Felatun Beu fillon ta sulmojë Rakim Efendi jo vetëm sepse ai është më i ditur, por edhe sepse arrin t'i bëjë për vete njerëzit e shtëpisë dhe sidomos dy vajzat e familjes. Injoranca e bën të duket qesharak. Një ditë tenton të tregojë se Rakim Efendi nuk është i aftë në mësimdhënien e turqishtes tek vajzat e familjes. Në vend që të tregojë paaftësinë e Rakim Efendit ai ngatërrohet dhe gjithë familja Ziklas qesh me budallallëkun e tij.

Një tipar tjetër negativ në këtë personazh është imoraliteti i tij. Ai nuk njej kufij në paturpësinë e tij. Pasi e provon pa sukses me vajzat e familjes Ziklas, ai i drejtohet shërbëtorëve. Tenton të krijojë një lidhje me kuzhinieren e familjes. As këtë nuk arrin ta realizojë për shkak të paaftësisë dhe budallallëkut të tij. Shkrimtari përpiqet që ta tregojë se të dukesh sikur je i arsimuar dhe i sjellshëm nuk mjafton të arrish të bësh për vete një grua. Me një sjellje të tillë jo vetëm që nuk arrin të bësh për vete një femër të kulturuar dhe edukuar, por as edhe një femër të niveli të ulët të shoqërisë siç është një kuzhinierë.

Bashkimi i xhelozisë me imoralitetin tek Felatun Beu bën që ai të tentojë të kap edhe Xhananin, shërbëtoren e Rakim Efendit e cila më pas do të bëhet edhe gruaja e tij. I dëshpëruar nga dështimet e tij të njëpasnjëshme, kur refuzohet edhe nga një skllave ai e gjen ngushëllimin tek një femër e përdalë. Këtu ai merr dënimin e merituar. Paturpësia, xhelozia dhe imoraliteti i tij do të paguhet në mënyrën më të keqe të mundshme. Kjo femër e përdalë, e cila ishte një gjuetare e fëmijëve pasanik të llastuar si Felatun Beu do ta falimentojë atë. Pasi t'i mbarojë gjithë pasurinë Felatun Beut, kjo femër do të kalojë tek gjahu i rradhës. Felatun Beu pa asnjë para në



xhep detyrohet të pranojë një detyrë të ulët shtetërore në Algjeri që ia ofron një kushëri i largët dhe largohet nga Stambolli i turpëruar.

Një personazh tjetër shumë i ngjashëm për të mos thënë kopje e Felatun Beut është Zekai Beu në romanin “Karnavalet”. Edhe ai është djali i vetëm i një pasaniku të madh. Merr një arsimim perëndimorë të kushtueshëm nga mësuesit më të mirë., por arsimimi i dhënë në mënyrën më të mirë nuk thithet në të njëjtën mënyrë nga Zekai. Kapaciteti i tij nuk e përballon këtë gjë. Megjithatë ai i ka bazat e kulturës perëndimore dhe mundohet të hiqet si një njeri modern dhe i zgjuar.

Zekai, ashtu si Felatun Beu, është xheloz për shokun e tij, Resim Efendin. Edhe në këtë rast kemi xhelozinë për shkak të një femre. Zekai dëshiron të lidhet me znj. Hamparsun. Ajo në vend që të pranojë ofertat e tij të shtrenjta vendos të lidhet me Resim Efendin. Xhelozia e Zekait bën që ai të përpiqet disa herë të prishë këtë marrëdhënie të fshehtë duke informuar burrin e znj. Hamparsun, por nuk ja arrin qëllimit. Kur nuk ja arrin qëllimit me znj. Hamparsun synon të kap shërbëtoren e Resim Efendit, Hesnan, të cilën Resmi Efendi e kishte dërguar për disa kohë nën mbrojtjen e Bahtijar Pashës. Paaftësia dhe sjellja e tij prej fodulli këtë herë do të sjellë një zhvillim të ri.

Ai jo vetëm që nuk ia arrin qëllimit, por përfundon që të fillojë një lidhje me vajzën e shëmtuar të Bahtijar Pashës. Arsyet që ai e pranon këtë lidhje janë dy. Fitimi i pasurisë së Bahtijar Pashës dhe mundësia që të qëndrojë pranë Hesnas e cila ishte njëkohësisht edhe shërbëtorja e Shehnazit, vajzës së Bahtijar Pashës.

Xhelozia që ka i kthehet në urrejtje. Ai paguan shtrenjtë shërbëtoren e znj. Hamparsun që t’i tregojë për lidhjen e saj të fshehtë. Më pas ai vjedh edhe babanë e tij. Nga hidhërimi babai i tij vdes. Pasi nuk ja arrin qëllimit as me znj. Hamparsun as me Hesnan, hidhet në krahët e një gruaje të përdalë armene. Martohet me Shehnazin, por e kalon gjithë kohën me dashnoren e tij. Më pas nisat edhe në Evropë me dashnoren ku humbet gjithë pasurinë dhe futet në borxhe të mëdha. E njëjta gjë që i ndodh Felatun Beut i ndodh edhe Zekait. Ai humbet gjithë pasurinë me këtë femër të përdalë, e cila më pas e braktis për një pasanik tjetër. Zekai kthehet në Stamboll ku vjehri e dëbon nga shtëpia dhe e ndan nga vajza e tij. I përfunduar pa asnjë para Zekai ndryshe nga Felatun Beu vret veten duke u hedhur nga maja e një minareje.

Një nga personazhet e parë negativ në romanet turke, por që do të sjell pas vetes një vazhdimësi të asaj që përfaqëson, është edhe Mehpejkeri në romanin “Intibah”. Kjo është një femër e përdalë e cila e siguron jetesën luksoze duke ofruar veten e saj tek njerëzit e pasur. Ndryshe nga shumica e femrave të përdala që na dalin përpara në romanet e tjera, Mehpejkeri e ka edukuar veten duke e kthyer në një femër që në pamje të parë të jepte pamjen e një zonje të rëndë. Me anë të kësaj sjelljeje ajo bën që Aliu, i pastërvitur në këtë lloj loje, të dashurohet marrëzisht me të., por poshtë petkut të saj si një zonjë e rëndë ajo ishte një femër e rrahur me vaj e me uthull.

Ndryshe nga personazhet e tjerë negativ që pamë më sipër të cilët edukohen dhe arsimohen nga prindërit e tyre Mehpejkeri ka arritur vetë çdo gjë. Kjo gjë nuk e ka bërë të jetë më e dhimbshur, por përkundrazi e ka bërë më të egër dhe të pashpirtë. Edhe tek ky personazh del në pah xhelozia. Kur sheh që Aliu nuk interesohet më për të në fillim me anë të shpifjeve bën që ai të ndahet nga gruaja e tij. Më pas e blen ish gruan e tij Dilashubin si shërbëtoreshë, e torturon dhe përpiqet të vrasë Aliun.

Në fakt gjithë romani është ngritur mbi të kundërta. Zeynep Kerman shprehet kështu kur shkruan në lidhje me romanin “Intibah” në “Anciklopedia e gjuhës dhe letërsisë turke”.

“I gjithë romani është ngritur mbi përplasjet, luftën dhe dashurinë mes karaktereve me tipe të kundërta. Ali Beu është një njeri pa vullnet, por impulsiv, Dilashubi ishte e pastër dhe e pafajshme si një zanë e mirësisë. Ndërsa Mehpejkeri edhe pse është një personazh që përfaqëson të keqen është personazhi i përshkruar më me gjallëri.”<sup>152</sup>

Për Mehpejkerin morali nuk është asgjë tjetër përveçse një gjë që shkelet kur e kërkojnë kushtet. Edhe pse në roman ajo përshkruhet se është e dashuruar me Aliun ajo nuk e ka për gjë të vazhdojë lidhjen me Abdullahun, një nga të dashurit e saj që e mbajnë me para.

Edhe tek Mehpejkeri xhelozia kthehet në urrejtje. Kur shikon që nuk ja arrin qëllimit megjithë intrigat e thurura ajo vendos ta vrasë Aliun. Shkrimtari ashtu siç ndodh edhe me shkrimtarët e tjerë nuk mund ta lejojë të keqen pa e ndëshkuar. Gjatë kurthit për vrasjen e Aliut ajo bie vetë viktimë dhe merr dënimin e merituar.

Mehpejkeri ka shumë ngjashmëri me personazhin e “Gruas me thikë” në tregimin me të njëjtin titull të botuar rreth 20 vite para botimit të romanit Intibah<sup>153</sup>.

Personazhi tjetër negativ femëror është Xhalibe në romanin “Muhadarat” të shkrimtares Fatma Alije.

Xhalibe është një femër e bukur dhe e zgjuar e cila ndryshe nga personazhet e tjerë nuk ka si tipar kryesor xhelozinë, por interesin financiar. Gjithçka rreth saj sillel tek paratë. Për hir të parave ndahet nga i dashuri i saj, djali i xhaxhait Syhai, dhe martohet me Sai Efendin. Nevoja e saj për të pasur pasuri dhe pushtet e bën të martohet me një të pasur në moshë dhe me fëmijë. Megjithatë, Xhalibe ashtu si gjithë personazhet negativë nuk e ka problem imoralitetin. Ajo e vazhdon marrëdhënien me Syhainë.

Ajo që e bën një personazh negativ nuk është vetëm kjo, por sulmi që i bën Fadilas dhe vëllait të saj të vogël Shefik. Ajo fillon një sulm të paskrupullt ndaj Fadilas për ta bërë të binte nga sytë e të atit që e donte shumë. Xhalibe nuk vihet në lëvizje nga xhelozia ose urrejtja. E vetmja arsye për këtë sulm me anë të mashtrimit, shpifjes dhe akuzimit ishte nevoja për ta larguar Fadilan nga shtëpia. Kështu do të kishte gjithë pasurinë e babait të Fadilas nën kontrollin e saj.

Sulmi i asaj është i i mirë planifikuar, ajo nuk i lë vënd rastësive. Në këtë pikë ajo ndryshon nga shumë prej personazheve e tjerë negativ të cilët sulmojnë kundërshtarët pa asnjë plan. Kjo është edhe arsyeja e dështimit të tyre. Ndërsa Xhalibe ja del mbanë.

Megjithatë edhe këtu shkrimtarja do ta dënojë këtë personazh të keq. Ndonëse femër, mënyra e dënimit është pak a shumë e njëjtë me dënimin e personazheve negativë meshkuj.

---

<sup>152</sup> Kerman, Z. “Intibah”, Türk Dili ve Edebiyatı Ansiklopedisi, vëll. 4, Stamboll, 1981, f. 398

<sup>153</sup> Përmbledhja e këtij tregimi është dhënë në kreun e I të këtij punimi ku flitet për tregimin tradicional turk.

Në fillim i dashuri i saj Syha do të largohet pasi e kupton që ajo e përdorte për qëllimet e saja. Më pas ajo jepet pas jetës së shthurur. Në një nga netët që kalonte me një mashkull të panjohur debaton me të., por ndryshe nga meshkujt me të cilët ishte mësuar të merrej deri më atëherë, ky njeri i pagdhendur nuk heziton ta godasë dhe ta rrëzojë nga shkallët. Xhalibe humbet bukurinë e saj. Burri i saj e dëbon nga shtëpia pasi mëson se ku kishte shkuar. Kështu që gjithë lufta e saj për t'u bërë e pasur përfundon me dështim për shkak të babëzisë së saj. Ajo përfundon duke jetuar në një dhomë poshtë shkallëve në shtëpinë e ish të dashurit të saj si një lypsare.

Personazhi i fundit negativ femërorë që do të shohim është znj. Hanife në romanin “Tri tregime mbi edukimin” të shkrimtares së dytë femër të periudhës së Tanzimatit, Selime Alije.

Arsyeja pse e përfshimë këtë personazh edhe pse pak periferik të romanit është se ajo përfaqëson një lloj personazhi tipik negativ të prapambetur. Si tipar kryesor të këtij personazhi kemi prapambetjen e saj. Ajo është rritur me një mënyrë shumë të mbyllur. Ajo beson shumë tek besëtytnitë. Beson aq shumë sa nuk pranon jo vetëm metodat moderne të ardhura nga perëndimi, por as mjekët tradicional. Në fakt ky personazh më shumë se armik i ndonjë personazhi kryesor është një personazh negativ ndaj të gjithëve.

Znj. Hanife që në lindje të djalit fillon të kujdeset për fëmijën sipas traditës lindore., por në mënyrën më të keqe. Përfundimi i kësaj sjelljeje është një fëmijë i tronditur, i sëmurë dhe i fiksuar. Edhe tek vajza që i lind më pas ajo mundohet të silltet në të njëjtën mënyrë, por shërbëtorja që vendoset si dado arrin ta shpëtojë duke i bërë fshehtas vaksinat dhe duke e edukuar ndryshe. Negativiteti i saj dallohet më shumë kur martohet djali i saj. Për shkak të mos mjekimit kur kishte kaluar linë e dhenëve që i kishte lënë një fytyrë të shëmtuar ai ishte edhe shumë shëndetlig. Znj. Hanife e marton djalin me shkesë pa pyetur për ndjenjat e tij. Më pas e detyron gruan e tij të zbatojë urdhërat e saj në lidhje me rritjen e fëmijëve deri sa ajo nuk duron dot më dhe largohet. Me kalimin e kohës znj. Hanife fillon e bëhet poseduese edhe tek mbesa e saj Fatina. Ajo shkon aq larg sa prej injorancës nga frika se do të sëmurej nuk e nxirrte nga shtëpia. Jo vetëm kaq, por e fiksuar nga besëtytnitë ajo nuk i ndërronte as rrobat vajzës së gjorë.

Fatina kur rritet bëhet një vajzë shëndetligë, e shëmtuar të cilën nuk pranonte ta merrte njeri për grua. Duke përfituar nga pasuria e madhe që kishte ajo më në fund gjen një djalë që të martohet, por pas një farë kohe ai largohet pasi nuk e duron presionin e bërë nga znj. Hanife. Injoranca e znj. Hanife shkon deri aty sa për të argëtuar mbesën vishet si gogol bashkë me shërbëtoret për ti dalë përpara, por në vend të saj në shtëpi i hyn djali i cili kur i sheh kujton se ishin gogola me vërte dhe vdes nga infarkti në zemër. Kështu që në një farë mënyre injoranca e saj i kthehet në vetë dënimin e saj.

Personazhi i fundit negativ që do të studiojmë është Domeniko Badja në romanin “Hasan Mellah”. Arsyeja pse e lamë për në fund është se ky personazh nuk është vendali dhe për më tepër është i krishterë. Domeniko Badja njësoj si Xhalibe është një personazh negativ shumë i zgjuar. Me anë të zgjuarsisë, shkathtësisë, kurnacërisë dhe mashtrimit ai ishte bërë shumë i pasur., por ai nuk ishte vetëm një mashtrues i thjeshtë. Ai ishte edhe një njeri pa skrupuj që për hirë të interesave të tij mund të bënte çdo gjë.

Me anë të njohjeve arrin deri aty sa të fillojë një kryengritje për të rrëzuar mbretin në Marok. Gjatë kryengritjes urdhëron kryengritësit që të vrasin xhaxhanë dhe babanë e Hasan Mellahut të cilin e kishte edhe ortak në tregëti. Arsyeja ishte e thjeshtë. Me vdekjen e babait të Hasanit ai do bëhej ortaku më i rëndësishëm në kompaninë e famshme Pavlos.

Ai nuk ndalet me kaq. Ndjek Hasan Mellahun për ta vrarë. Gjatë udhëtimit ai njuh Zhizelën të cilën më pas e rrëmben. Gjatë përpjekjeve për të shpëtuar nga ndjekja që i bën Hasani, i cili ishte dashuruar vetë me Zhizelin, vazhdon të bëjë punë të pista. Në Paris përfshihet në vrasje. Më pas kalon në Egjipt, ku duke u bërë spiuni i francezëve përpiket të vrasë Mehmet Ali Pashanë që drejtonte vendin. Edhe aty ai shpëton për pak nga kapja dhe dënimi.

Pasi humbet Zhizelën, por lihet i lirë nga Hasani që e kap, ai shkon në Itali. Atje përfshihet në gjithfarë lloj punësh të pista duke u bërë bashkëpunëtorë me mafian. Ngaqë përpiket t'i mashtrojë edhe ata, detyrohet të arratiset.

Në fund ai shkon në Damask ku nuk arrin t'i shpëtojë më ndjekësve dhe përfundon që t'i paguajë fajet e tij me kokës.

Domeniko Badja paraqitet si një personazh negativ që nga fillimi i romanit e deri në fund. Përveç zgjuarsisë së lindur ai ka gjithë cilësitë më të këqija të mundura. Mashtrues, hajdut, spiun, tradhtarë, mosmirënjohës, hakmarrës janë vetëm disa nga cilësitë e tij., por siç ndodh në shumicën e romaneve ai në fund merr dënimin e merituar edhe pse për këtë gjë shkrimtari detyrohet të shkruaj një kapitull të tërë sepse fundi normal i romanit nuk e kishte dënuar ashpër. Shkak i ndryshimit të fundit të librit është reagimi jo i mirë i lexuesit.

Personazhet e tjerë negativë janë variante të këtyre personazheve që u prekën më sipër me ndryshime të vogla sipas tematikës së romanit.

## Përfundimet:

Në letërsinë e periudhës së Tanzimatit na dalin përpara dy grupe personazhesh. Nga njëra anë kemi grupin e personazheve pozitivë shumica e të cilëve janë formuar sipas idesë së ndikimit nga perëndimi, por që të gjithë kanë një formim tradicional të mjaftueshëm ose të mirë dhe janë të hapur ndaj të resë. Ndërsa nga ana tjetër kemi personazhet negativë që ndahen vetë në dy nëngrupe. Personazhet negativë të edukuar sipas sistemit perëndimorë, por që e kanë pranuar përciptas dhe personazhet negativë të edukuar sipas sistemit tradicional lindor.

Romancierët e kësaj periudhe janë të dyzuar. Nga njëra anë janë të ndikuar nga romantizmi dhe iluminizmi evropian dhe nga ana tjetër janë të lidhur fort me traditën. Në fakt ky dyzim do e ndjekë shkrimtarin turk edhe në periudhat e mëvonshme të letërsisë, por fakti që kjo është hera e parë ka një vlerë domethënëse. Ky dyzim do ndikojë dukshëm edhe tek personazhet e romaneve.

Në këtë punim pjesa kryesore është vënë në studimin e personazheve pozitivë të romaneve. Ndërsa personazhet negativë janë prekur vetëm në fund me qëllimin që të japim një pasqyrë sa më të qartë të personazheve në romanet e para pasi ata japin edhe idenë kryesore mbi zhvillimin e romanit.

- Tipi kryesor pozitiv që shihet në romanin e Tanzimatit është intelektual. Ai është një tip i edukuar, i shkolluar, i kulturuar, i zgjuar, i dhembshur dhe studiues. Ai ose arsimohet dhe edukohet falë ndihmës së familjes ose është autodidakt. Ai di minimumi një gjuhë të huaj, e cila përgjithësisht është frëngjishtja. Ai ose e ka talent ose është i pasionuar pas letërsisë. Përgjithësisht pas poezisë. Ai është pasqyrimi i vet shkrimtarëve siç është rasti i Ahmet Mid'hatit ose Fatma Alije Hanëm.
- Shumica e këtyre personazheve në romane e humbasin babanë që në moshë të vogël. Kjo ka një kuptim më të thellë se sa humbja reale e babait. Shkrimtarët e kohës humbjen e babait dhe rritjen me sakrificë, por në mënyrë të mirë e paralelizojnë me humbjen e fuqisë së shtetit, mos mbështetjen ndaj popullit, dhe detyrën ose përgjegjësinë e popullit për të edukuar dhe arsimuar veten.
- Pothuajse të gjithë këto personazhe kanë dëshirë dhe qëllim të edukojnë këdo që kanë pranë, sidomos të varfrit. Ky është një tipar që karakterizon gjithë shkrimtarët e kësaj periudhe. Pra edhe në këtë pikë shkrimtarët kanë pasqyruar veten e tyre.
- Për herë të parë në letërsinë turke përveç personazheve kryesorë të veshur mirë, të bukur ose të pashëm, me veçori fizike pothuajse perfekte kemi personazhe që nuk janë të pashëm nga ana fizike, por që kanë një botë të brendshme shumë të pasur e cila e zbeh pamjen e jashtme. Falë karakterit të mirë dhe aftësive të tyre njerëzore këto personazhe arrijnë të fitojnë respektin dhe dashurinë e njerëzve.
- Veshjet si të meshkujve ashtu edhe të femrave janë të thjeshta, por shik dhe tërheqëse.
- Këta personazhe pozitivë cilëso ndarje t'i përkasin: tipi intelektual, shkencëtar, prind ose trim, janë njerëz që dinë të sillen në çdo situatë. Ata dalin gjithmonë fitues.

- Personazhet meshkuj edhe pse kanë cilësi të larta në karakteret e tyre njohin edhe ambientet e argëtimit. Për shkak të cilësive të larta ata nuk bien pre të kësaj jete të degjeneruar. Ata, edhe nga këto ambiente marrin vetëm atë që ju duhet. Një nga gjërat kryesore që mësojnë është që edhe pse argëtohen me femra të ndryshme pas martesë ata nuk duhet të vazhdojnë më në këtë rrugë.
- Gjithë personazhet pozitivë janë në shumicën dërrmuese të rasteve nga shtresa e mesme e shoqërisë.
- Shumica e personazheve kryesorë pozitivë martohen me njëri tjetrin. Domethënë personazhi mashkull intelektual, trim ose shkencëtar martohet me gruan ideale.
- Që të gjithë personazhet si pozitivë ashtu edhe negativë janë paraqitur në mënyrë të përgjithëshme pa u futur në veçanti. Kanë pak a shumë të njëjtat cilësi të përgjithëshme. Kjo ndoshta ngaqë shkrimtarët janë munduar të paraqesin personazhet me ato cilësi të mira ose të këqija që duhet të kenë ose nuk duhet të kenë individët e shoqërisë osmane.
- Një veçori që shohim sidomos tek Ahmet Mid'hati është emërtimi i personazheve sipas cilësive që kanë. Kjo tregon rëndësinë që i japin shkrimtarët simbolizmit të personazhit me cilësitë e njeriut. Kjo është një shenjë e qartë e ndikimit të tregimtarisë turke të para periudhës së Tanzimatit.
- Ndërsa personazhet pozitivë janë filozofë personazhet negativë janë e kundërta e tyre.
- Personazhet pozitivë si meshkuj edhe femra janë shumë të prerë në lidhje me nderin ose moralin e femrës. Edhe pse tek femrat jo myslimane kjo nuk ka rëndësi, për femrën myslimane është një detyrim i padiskutueshëm. Personazhet meshkuj pranojnë të shkojnë me femra të përdala myslimane ose me femra të huaja, por kur vjen puna tek martesë ata preferojnë një femër të virgjër. Qoftë edhe e krishterë, por e virgjër. Këtu kemi një ndikim tjetër të fortë të traditës lindore.
- Ndërsa personazhet pozitivë pa asnjë përjashtim sillen mirë ndaj skllavit ose të burgosurit e kundërta ndodh me personazhet negativë.
- Personazhet pozitivë meshkuj dhe femra janë shumë të dhënë pas dashurisë. Edhe kur për shkaqe të ndryshme janë të detyruar të martohen me njerëz të tjerë ata mundohen me çdo mënyrë të bashkohen me dashurinë e vërtetë.

Si përfundim personazhet e romaneve të para janë përgjithësisht përfaqësues të principeve që duhet të ketë një shoqëri e përparuar dhe njëkohësisht me anë të personazheve negativë shkrimtarët janë përpjekur të luftojnë ato vese që nuk duhet të ketë shoqëria Osmane.

## Përfundime:

Zhvillimet politike në fillim të shekullit XIX bëjnë të mundur hapjen e shoqërisë Osmane ndaj qytetërimit perëndimor. Me shpalljen e fermanit të Tanzimatit në vitin 1839 shoqëria Osmane fillon të pësojë ndryshime të mëdha në shumë fusha të jetës. Ndryshimet në mënyrën e jetesës pasohen me njohjen e letërsisë perëndimore. Letërsia perëndimore prezantohet me gjinitë e reja që letërsia turke nuk i kishte. Një nga gjinitë e reja që prezantohen në shoqërinë Osmane është edhe romani.

Romani, së bashku me teatrin dhe tregimin, paraqitet në letërsinë turke duke filluar nga mesi i shekullit XIX si pasojë e njohjes dhe futjes së letërsisë dhe kulturës perëndimore në shoqërinë turke. Deri në periudhën e tanzimatit proza zinte një vend shumë të vogël në letërsinë turke, ndërsa proza sipas variantit perëndimor pothuajse nuk ekzistonte. Shembujt e parë në këtë fushë fillojnë të jepen me përkthimet nga letërsia perëndimore. Përkthimet janë pararojë e fillimit të romanit në letërsinë turke.

Romancierët e parë në letërsinë turke janë Sami Frashëri, Ahmet Mid'hat Efendi, Namik Kemal, Rexhaizade Mahmut Ekrem, Mehmet Murat, Masi Pashazade Sezai, Nabizade Nazim, Fatma Alije Hanëm. Emine Semije Hanëm dhe Halit Zija Ushakllëgil.

Periudha gjatë së cilës jetuan romancierët e parë turq ka ndikuar në formimin e tyre. Shpallja e fermaneve perandorake në vitet 1839 dhe 1856 ishin vazhdimi i përpjekjeve shumë vjeçare për reformim dhe hapje ndaj perëndimit. Hapja e perandorisë Osmane ndaj perëndimit dhe futja e risive bëri që të ndryshonte një herë e përgjithmonë mentaliteti i shoqërisë Osmane. Hapja e shkollave të huaja në qytete të ndryshme të perandorisë i dhanë mundësi njerëzve me ideale të merrnin një edukim më të gjerë dhe duke dalë jashtë guaskës tradicionale të edukimit oriental të njiheshin me qytetërimin perëndimor. Përfaqësues kryesor të këtij lloj edukimi janë Sami Frashëri dhe Halit Zija Ushakllëgil. Një mundësi tjetër për njohjen e qytetërimit perëndimor ishte edhe dërgimi i studentëve në Evropë për studime. Një pjesë e tyre sjellin informacionet e tyre në lidhje me letërsinë perëndimore. Përfaqësuesi më i spikatur është Ibrahim Shinasi, i cili nuk është pjesë e këtij studimi pasi ka dhënë kontributin e tij në fushën e gazetarisë dhe poezisë.

Shkrimtarët e kësaj periudhe mund t'i ndajmë në dy grupe të mëdha. Shkrimtarët që kanë marr një arsimim të mirë dhe shkrimtarët autodidakt, por që të dy këto grupe bashkohen në një pikë. Ata e përdorin romanin si një mjet për të edukuar lexuesin e kohës. Mënyra kryesore për të edukuar lexuesin kalon përmes shembujve dhe kjo bëhet me anë të personazheve. Për këtë arsye rëndësia e studimit të personazheve merr një vlerë tjetër. Duke krijuar personazhë sipas qëllimeve që kanë, romancierët i transmetojnë publikut idetë e tyre. Duke qenë se personazhet kanë vlerë për të transmetuar ide ata nuk prezantohen në mënyrë specifike me karaktere të veçanta, por paraqiten me tipare të përgjithshme. Të gjithë personazhet kanë të njëjtat tipare bazë të grupit ku bëjnë pjesë. Arsyeja është sepse vetëm kështu ata mund të transmetojnë mesazhin e dëshiruar.

Në letërsinë e periudhës së Tanzimatit na dalin përpara dy grupe personazhesh. Nga njëra anë kemi grupin e personazheve pozitivë shumica e të cilëve janë formuar sipas idesë së ndikimit nga perëndimi, por që të gjithë kanë një formim tradicional të mjaftueshëm ose të mirë dhe që janë të hapur ndaj të resë. Ndërsa nga ana tjetër kemi personazhet negativë që ndahen vetë në dy nëngrupe. Personazhet

negativë të edukuar sipas sistemit perëndimor, por që e kanë pranuar përciptas dhe personazhet negativë të edukuar sipas sistemit tradicional lindor.

Romancierët e kësaj periudhe janë të dyzuar. Nga njëra anë janë të ndikuar nga romantizmi dhe iluminizmi evropian dhe nga ana tjetër janë të lidhur fort me traditën. Në fakt ky dyzim do e ndjekë edhe në periudhat e mëvonshme të letërsisë shkrimtarin turk, por fakti që kjo është hera e parë ka një vlerë më të rëndësishme. Ky dyzim do të ndikojë dukshëm edhe tek personazhet e romaneve.

Pjesa kryesore e këtij punimi është bazuar në studimin e personazheve pozitivë të romaneve. Ndërsa personazhet negativë janë prekur vetëm në fund me qëllim që të japim një pasqyrë sa më të qartë të personazheve në romanet e para pasi ata japin edhe idenë kryesore mbi zhvillimin e romanit.

Nga studimi i bërë arrijmë në përfundimin që personazhet megjithëse kanë disa specifika të veçanta sipas romaneve ku bëjnë pjesë ndahen në disa tipe dhe nuk mund të dalin jashtë tyre. Nëse një personazh është i mirë ai vazhdon i tillë deri në fund.

Qëllimi kryesor i romancierëve të parë është të edukojnë popullin. Të bërit art mbetet gjithmonë në vend të dytë. Personazhi kryesor në romanet e para është intelektual. Ai është më i përdoruri nga shkrimtarët për shkak të cilësive të shumta që ka. Ai përshtatet me ambientin e kohës duke qenë se mbart në veten e tij si traditën ashtu edhe modernen. Në një shoqëri në ndryshim vetëm ai mund t'ia dalë. Ai mund të adaptohet në këtë kohë ndryshimi duke qenë se është i hapur ndaj të rejave, por njëkohësisht është edhe tradicionalist pasi është i lidhur me rrënjët e tij orientale.

Gjithë personazhet e tjerë janë në plan të dytë dhe janë të lidhur ngushtë me këtë personazh. Përveç personazhit romantik gjithë personazhet e tjerë ose kontribuojnë në krijimin e intelektualit ose janë bashkë udhëtarë në aventurën e tij. Personazhi i prindit ndihmon në zhvillimin e tij. Personazhi i gruas ideale ose edhe i gruas punëtore plotësojnë tabllonë e personazhit intelektual. Qëllimi i shkrimtarëve me krijimin e këtyre personazheve është krijimi i një njeri të ri në shoqërinë Osmane. Ndërsa personazhi negativ është për të krijuar një balancë. Njëkohësisht personazhi negativ rolin kryesor e luan në përforcimin e cilësive të karaktereve pozitivë, sidomos të personazhit intelektual.

Shkrimtarët në romanët e tyre i tregojnë hapur mësimet që duan të japin dhe kjo ndodh për shkak të mos besimit ndaj lexuesit të pamësuar me këtë lloj gjinie.

Personazhet e romaneve të para janë përgjithësisht përfaqësues të principeve që duhet të ketë një shoqëri e përparuar dhe njëkohësisht me anë të personazheve negativë shkrimtarët janë përpjekur të luftojnë ato vese që nuk duhet të ketë shoqëria Osmane.

Shkrimtarët krijojnë personazhe me tipare moderne dhe evropiane me rrënjë në traditën lindore, por nuk janë aq të lirë sa mund të duket. Shoqëria Osmane ndonëse kishte filluar të hapej akoma ishte shumë fanatike. Romancierët nuk guxojnë të prekin disa tema tabu siç është për shembull futja në biznes, ose dhënia e një profesioni një personazhi femër myslimane. Për të treguar një personazh femëror me profesion ose në biznes shkrimtarët parapëlqejnë të përdorin personazhe jo



myslimane. Personazhet, pavarësisht përpjekjes së shkrimtarëve, nuk arrijnë të dalin jashtë kornizave të skicuara dhe të jenë më të prekshëm ose më njerëzorë.

Personazhet e paraqitur nga shkrimtarët në disa raste janë pasqyrime të vetë jetës së shkrimtarëve. Kjo sidomos dallohet tek romanet e Ahmet Mid'hatit dhe tek romani i vetëm i Mizanxhi Muratit.

Me anë të personazheve të krijuar ne ndërtojmë një ikonë të përgjithshme të mentalitetit të shoqërisë së kohës të gjykuar nëpërmjet romancierëve.

## Bibliografia

### A- Literatura e vjelë

- Ahmed, F. 2007. Modern Türkiye'nin Oluşumu. Stamboll
- Akçura, Y. 1998. Türkçülüğün Tarihi. Stamboll
- Akçura, Y. 1978. Türkçülük. Stamboll
- Akgündüz, A. 1999. Bilinmeyen Osmanlı. Stamboll
- Akı, N. 1989. Türk Tiyatro Edebiyatı Tarihi. Stamboll
- Akıncı, G. 1961. Türk Romanında Köye Doğru. Ankara.
- Aktaş, S. 1986. Edebiyatta Üslup ve Problemleri. Ankara
- Aktaş, S. 1991. Roman Sanatı ve Roman İncelemesine Giriş. Ankara
- Akyıldız, A. 2004. Osmanlı Bürokrasisi ve Modernleşme. Stamboll
- Akyüz, K. 1970. Batı Tesirinde Türk Şiiri Antolojisi. Ankara
- Akyüz, K. 1995. Modern Türk Edebiyatının Ana Çizgileri (1860-1923). Stamboll
- Akyüz, Y. 1982. Türk Eğitim Tarihi. Ankara
- Ali, S. 1940. İçimizdeki Şeytan. Stamboll
- Alpaslan, G.G. 2002. XIX. Yüzyıl Yazılı Anlatılarında Sözlü Kültür Etkileri. Ankara
- Altındağ, A. 1994. Osmanlı'da Kadın. Stamboll
- Alver, K. 2002. "Züppeliğin Sosyolojisi: Türk Romanında Züppe Tipler Örneği." Hece: Türk Romanı Özel Sayısı. Stamboll
- And, M. 1976. "Osmanlı Tiyatrosu" Kuruluşu - Gelişimi - Katkısı. Ankara.
- And, M. 1970. Türk Tiyatrosu Tarihi. Stamboll
- And, M. 1970. 100 Soruda Türk Tiyatrosu Tarihi. Ankara.
- And, M. 1972. Tanzimat ve İstibdat Döneminde Türk Tiyatrosu 1839-1908. Ankara
- Anderson, M. Smith. 2001. Doğu Sorunu. Stamboll
- Andrews, W.G. 2000. "Yabancılaşmış "Ben" in Şarkısı: Guattari, Deleuze ve Osmanlı Şiirinde Özne'nin Lirik Kod Çözümü." Defter.
- Arai, M. 2000. Jöntürk Dönemi Türk Milliyetçiliği. Stamboll
- Arat, Y. 1999. "Türkiye'de Modernleşme Projesi ve Kadınlar." Türkiye'de Modernleşme ve Ulusal Kimlik. Stamboll
- Arık, S. 2005. Roman Yokuşunda Türkler. Ankara
- Armağan, M. 2006. Abdülhamid'in Kurtlarla Dansı. Stamboll
- Artun, A. 2004. "Sunuş: Baudelaire'de Sanatın Özerkleşmesi ve Modernizm." Charles Baudelaire. Stamboll
- Assmann, J. 2001. Kültürel Bellek. Stamboll
- Atılgan, Y. 2002. Aylak Adam. Stamboll
- Atsız. 1997. İçimizdeki Şeytan - En Sinsi Tehlike - Hesap Böyle Verilir. Stamboll
- Avcıoğlu, D. 1969. Türkiye'nin Düzeni (Dün-Bugün-Yarın). Ankara
- Avcıoğlu, D. 1995. Türkiye'nin Tarihi. Stamboll
- Aydın, M.S. 1992. Din Felsefesi. Ankara
- Ayag, S. 2003. Ahmet Mithat Efendi'nin Din Eğitimi Anlayışı. Stamboll
- Aytaç, G. 1999. Çağdas Türk Romanları Üzerine İncelemeler. Ankara
- Aytaç, G. 1999. Edebiyat Yazıları-I. Ankara
- Aytaç, G. 2002. Tanzimatta Tiyatro Edebiyatı Tarihi. Ankara
- Babinger, F. 1992. Osmanlı Tarih Yazarları ve Eserleri. Ankara
- Bahardiroğlu, Y. 2006. Biz Osmanlıyız. Stamboll
- Banarlı, Nihad Sami (1990), Resimli Türk Edebiyatı Tarihi, C.II, Stamboll.
- Barbarosoglu, F.K. 1995. Modernleşme Sürecinde Moda ve Zihniyet. Stamboll
- Batur, A. 1996. "Geç Osmanlı İstanbul'u." Dünya Kenti İstanbul. Stamboll

- Bauman, Z. 2001. Parçalanmış Hayat: Postmodern Ahlâk Denemeleri. Stamboll
- Bauman, Z. 2003. Modernlik ve Müphemlik. Stamboll
- Baydar, M. 1954. Ahmet Mithat Efendi: Hayatı, Sanatı, Eserleri. Stamboll
- Baykal, H. 1990. Türk Basın Tarihi 1831–1923. Stamboll
- Bayraktar, E. 2000. Stamboll’un Kibar Serserisi: Cingöz Recai
- Bayraktar, E. 2000. Paranoya, Polisiye ve II. Abdülhamid
- Belge, M. 1998. Polis Romanları. Stamboll
- Belge, M. 1983. “Türkiye’de Günlük Hayat.” Cumhuriyet Dönemi Türkiye Ansiklopedisi. Stamboll
- Belge, M. 1998. Edebiyat Üstüne Yazılar. Stamboll
- Berat, A. 2006. Esrar-i Cinayat’ın Sırları. Merhaba Ey Muharrir. Stamboll
- Bedreddin, H.– Manastırlı, R. 1292/1875. Ebulûlâ yahut Mürüvvet. Stamboll
- Bedreddin, H – Manastırlı, R. 1292/ 1875. Hud’a ve Aşk. Stamboll
- Bereketzade I.H. 1997. Yad-ı Mazi. Stamboll
- Berk, Ö. 2004. “Batılılaşma ve Çeviri.” Modern Türkiye’de Siyasi Düşünce: Modernleşme ve Batıcılık. Stamboll
- Berkes, N. 2004. Türkiye’de Çağdaslaşma. Stamboll
- Berkes, N. 1975. Türk Düşününde Batı Sorunu. Ankara
- Berman, M. 1994. Katı Olan Her Şey Buharlaşıyor. Stamboll
- Beyatlı, Y.K. 1984. Edebiyata Dair. Stamboll
- Bilgegil, M. K. 1972. Harabat Karşısında Namık Kemal. Stamboll
- Bilgegil, M. K. 1979. Ziya Pasa Üzerine Bir Arastırma. Ankara
- Birsel, S. 1975. Kahveler Kitabı. Stamboll
- Bleda, M.S. 1979. İmparatorlugun Çöküsü. Stamboll
- Bolay, S. Hayri, Türkiye’de Ruhçu ve Maddeci Görüşün Mücadelesi. Ankara
- Bolayır, A.E. 1998. Namık Kemal. Ankara.
- Bora, E. 1998. Kara Karadır
- Boyunkara, H. 1997. Romanda Bakış Açısı ve Anlatılış. Stamboll
- Brockelmann, C. 1992. İslâm Ulusları ve Devletleri Tarihi. Ankara
- Budak, A. 2004. Batılılaşma Sürecinde Çok Yönlü Bir Osmanlı Aydını Münif Paşa. Stamboll
- Bulut, K. 1992. Ahmet Mithat Efendi’nin Siyasi Görüşleri. İzmir
- Crary, J. 2004. Gözlemcinin Teknikleri: On Dokuzuncu Yüzyılda Görme ve Modernite. Stamboll
- Çağlar, B.K. 1954. Namık Kemal. Stamboll
- Çakır, H. 2002. Osmanlıda basın iktidar ilişkileri. Ankara
- Çakır, S. 1996. Osmanlı Kadın Hareketi. Stamboll
- Çelik, Z. 1996. 19. Yüzyılda Osmanlı Başkenti: Değişen İstanbul. Stamboll
- Çiğdem, A. 2004. Modern Türkiye’de Siyasi Düşünce: Modernleşme ve Batıcılık. Stamboll
- Danışman, Z. 1985. Koçi Bey Risalesi. Ankara
- Davison, R.H. 2005. Osmanlı İmparatorlugu’nda Reform (1856-1876). Stamboll
- De Foe, D. 1302/1885. Robenson. Stamboll
- Demiralp, O. 1999. Tanrı Bakışlı Çocuk: Walter Benjamin Üzerine 49’a Parçalanmış Deneme. Stamboll
- Deren, S. 2004. Modern Türkiye’de Siyasi Düşünce - Modernleşme ve Batıcılık. Stamboll
- Doğan, M. 1976. Batılılaşma İhaneti. Stamboll
- Doğan, R.I. 1996. Mesrutiyet Döneminde Batıcılık Akımının Din ve Eğitim Öğretim
- Dağlıoğlu, H.T. 1934. Şemseddin Sami Bey Hayatı ve Eserleri. Stamboll

- Doğan, R.I. 2000. Sosyoloji. Stamboll
- Duman, H.H. 2005. Metin Çözümleme Yöntemleri. Stamboll
- Dumonoit- Donnery. 1290. İhtiyar Onbaşı. Stamboll
- Duru, O. 1991. Polis Var, Polisiye Yok.
- Ekrem, R. M. 1896. Araba Sevdası. Ankara
- Eldem, İ.H.1311. On Dokuzuncu Asrın Türk Müellifleri Şemseddin Sami Bey. Stamboll
- Eliot. T.S. 1983. Edebiyat Üzerine Düşünceler. Ankara
- Emil, B. 1997. Türk Kültür ve Edebiyatından Meseleler
- Enginün, I. 1990. Ahmet Mithat Efendi'nin Tiyatroları. Stamboll
- Enginün, İ. 2000. Araştırmalar ve Belgeler. Stamboll
- Enginün, İ. -Kerman, Z. 1988. Mehmet Kaplan'dan Seçmeler-I. Ankara
- Enginün, İ. 1992. Mukayeseli Edebiyat
- Enginün, İ. 1979. Tanzimat Devrinde Shakespeare Tercümeleleri ve Tesiri. Stamboll
- Enginün, İ. 1998. Yeni Türk Edebiyatı Araştırmaları. Stamboll
- Enginün, İ. 2006. Yeni Türk Edebiyatı – Tanzimat'tan Cumhuriyet'e. Stamboll
- Enginün, İ. 2010. Yeni Türk Edebiyatı Tanzimat'tan Cumhuriyete, botimi V, Stamboll
- Erbay, E. 1997. Eskiler ve Yeniler. Erzurum
- Erbay, E.U.A. 2002. Ahmet Mithat Felsefe Metinleri. Stamboll
- Ercilasun, B. 1981. Servet-i Fünun'da Edebi Tenkit. Ankara
- Ercilasun, B. 1997. Yeni Türk Edebiyatı Üzerine İncelemeler. Ankara
- Erdoğan, İ -Korkmaz, A. 2005. Popüler Kültür ve İletişim. Ankara
- Erkal, M. 1996. Sosyoloji. Stamboll
- Ergun, Z. 2003. Kardeşimin Bekçisi. Stamboll
- Ergut, F. 2004. Modern Devlet ve Polis. Stamboll
- Erjem, Y. 1996. Açıklamalı Sosyoloji Sözlüğü. İzmir
- Esen, N. 2006. . Merhaba Ey Muharrir! Ahmet Mithat Üzerine Eleştirel Yazılar. Stamboll
- Esen, N. 2006. Modern Türk Edebiyatı Üzerine Okumalar. Stamboll
- Eren, A.C. 1979. Tanzimat. İslam Ansiklopedisi
- Esen, N. 1991. Türk Romanında Aile Kurumu. Ankara
- Evin, A.Ö. 2004. Türk Romanının Kökenleri ve Gelişimi. Stamboll
- Faroqhi, S. 2002. Osmanlı Kültürü ve Gündelik Yaşam. Stamboll
- Fatih, A. 1999. Polisiye Roman I.
- Fındıkoğlu, Z.F. 1940. Tanzimat, "Tanzimat'ta İçtimai Hayat". Ankara
- Fikret, A. 1988. Asmalimescit 74 (Bohem hayatı). Stamboll
- Fikret, A. 1990. Gardenbar Geceleri / Avare Gençlik. Stamboll
- Findley, C.V. 1999. Ahmet Mithat Efendi Avrupa'da. Stamboll
- Findley, C.V. 2000. Ahmet Mithat'ın Sevda-yı Say-ü Amel'i.
- Finn, R. 1984. Türk Romanı. Ankara
- Frisby, D. 2004. Modern Kültürde Çatışma. Stamboll
- Forster, E. M. 1985. Roman Sanatı. Stamboll
- Gaspıralı, İ. 2004. Seçilmiş Eserleri: II Fikrî Eserleri. Stamboll
- Georgon, F. 2006 . II. Abdülhamit. Stamboll
- Giddens, A. 2004. Modernliğin Sonuçları. Stamboll
- Göçgün, Ö. 1987. Namık Kemal. Ankara
- Göçgün, Ö. 1992. 'Tanzimat Devri Türk Edebiyatı', Türk Dünyası El Kitabı. Ankara
- Gökalp, Z. 1976. Türkçülüğün Esasları. Ankara
- Gökalp, Z. 1976. Türk Medeniyeti Tarihi. Ankara

- Gökalp, Z. 1976. Türk Töresi. Ankara
- Gökalp, Z. 1976. Türkleşmek, İslâmlaşmak, Muasırlaşmak. Ankara
- Gökalp, Z. 1976. Türk Medeniyeti Tarihi. Ankara
- Gökalp, Z. 1976. Yeni Hayat – Dogru Yol. Ankara
- Gökberk, M. 2000. Değişen Dünya Değişen Dil. Stamboll
- Göksen, E.N. 1964. ‘İlk Gerçekçi Romanımız:Araba Sevdası’
- Göle, N. 1999. “Modernleşme Bağlamında İslami Kimlik Arayışı.” Türkiye’de Modernleşme ve Ulusal Kimlik. Stamboll
- Göral, Ö.S. 2004. Patlamaya Hazır Bir ‘Şimdi’: Putları Yıkıyoruz.
- Gözaydin, I. 2005. ‘Suç mu İslendi? Ya Sonra?’.
- Günay, Üç 2000. Din Sosyolojisi. Stamboll
- Gündüz, O. 1997. Meşrutiyet Romanında Yapı ve Tema I-II. Stamboll
- Günkör, E. 2000 Ahlak Psikolojisi ve Sosyal Ahlak. Stamboll
- Gür, Â.1998. Ebüzziya Tefvik Hayatı; Dil, Edebiyat, Basın, Yayın ve Matbaacılığa Katkıları. Ankara
- Gürbilek, N. 2001. Orijinal Türk Ruhu.
- Gürbilek, N. 2004. Kötü Çocuk Türk. Stamboll
- Gürpınar, H.R. 2002. Şık. Stamboll
- Güvenç, B. 2003. İnsan ve Kültür. Stamboll
- Hasluck, F.W. 2000. Bektaşilik Tetkikleri. Ankara.
- Haydar,A.1282/1866. İkinci Ersas. Stamboll
- Haydar,A.1282/1866. Sergüzeşt-i Perviz. Stamboll
- Haydaroğlu, İ.P. 1990. Osmanlı İmparatorluğu’nda Yabancı Okullar. Ankara
- Hazard, P. 1999. Batı Düşüncesindeki Büyük Degisme.
- Hobsbawn, E. 1998. Devrim Çağı 1789-1848. Ankara
- Hobsbawn, E. 1995. Sermaye Çağı 1848-1875. Ankara
- Hummer. 1996. Büyük Osmanlı Tarihi. Stamboll
- Hugo, V. 1297/1880. Sefiller. Stamboll
- Huizinga, J. 2006. Homo Ludens: Oyunun Toplumsal İşlevi Üzerine Bir Deneme. Stamboll
- Huntington, S.P. 2005. Medeniyetler Çatışması ve Dünya Düzeninin Yeniden Kurulması.
- Hülagü, M. 2006. Pan-İslamizm, Osmanlı’nın Son Umudu. Stamboll
- İşık, N. 1991. Şövalye Romanlarından, Pikaesk’ten Polis Romanlarına.
- İçli, G. 2002. Sosyolojiye Giriş. Ankara
- İsın, E. 1985. Osmanlı Modernleşmesi ve Pozitivizm”, Tanzimat’tan Cumhuriyete Türk Ansiklopedisi. Stamboll
- İsın, E. 2006. Tanzimat Ailesi ve Modern Âdâb-ı Muâseret. Ankara
- İlhan, A. 2004. Aydınlar Savaşı. Stamboll
- İlhan, A. 1996. ‘Hangi Batı?’. Stamboll
- İlhan, A. 2003. Sokaktaki Adam. Stamboll
- İnalçık, H. 1992. Tanzimat ve Bulgar Meselesi. Stamboll
- İnci, H. 1996. Türk Romanında İlk Polisiye: Esrar-i Cinayat. Nar
- Jusdanis, G. 1998. Gecikmiş Modernlik ve Estetik Kültür: Milli Edebiyatın İcat Edilişi. Stamboll
- Kabaklı, A. 1994. Türk Edebiyatı (Hikaye ve Roman). Stamboll
- Kabaklı, A. 2002. Kültür Emperyalizmi. Stamboll
- Kahraman, H.B. 2004. Bir Zihniyet, Kurum ve Kimlik Kurucusu olarak Batılılaşma. Stamboll
- Kahraman, H.B. 1991. Dedektif Romanlarında İz Sürmek.

- Kantarcıoğlu, S. 1988. Türk ve Dünya Romanlarında Modernizm. Ankara
- Kaplan, M. 1962. Bir Şairin Romanı: Huzur.
- Kaplan, M. 1998. Büyük Türkiye Rüyası. Stamboll
- Kaplan, R. 1988. Cumhuriyet Dönemi Türk Romanında Köy. Ankara
- Kaplan, M. 1981. Tanzimat Edebiyatı. Sheshi Larousse
- Kaplan, M. 2005. Tip Tahlilleri. Stamboll
- Kaplan, M. 1992. Türk Edebiyatı Üzerine Araştırmalar-1. Stamboll
- Kaplan, M. 1991. Türk Edebiyatı Üzerine Araştırmalar-3. Stamboll
- Kaplan, R. 2004. Yeni Türk Edebiyatı El Kitabı 1839- 2000. Ankara
- Kara, I. 1986. Türkiye’de İslamcılık Düşüncesi. Stamboll
- Karaalioğlu, S.K. 1978. “Tanzimat Edebiyatı”, Türk Edebiyatı Tarihi.
- Karal, E.Z. 1988. Osmanlı Tarihi. Ankara
- Karal, E.Z. 1988. Osmanlı Tarihi. Ankara
- Karaosmanoğlu, Y.K. 1999. Ankara. Stamboll
- Karaosmanoğlu, Y.K. 2003. Kiralık Konak. Stamboll
- Karaosmanoğlu, Y.K. 2002. Sodom ve Gomore. Stamboll
- Kavaz, İ. 2002. Belgelerle Akif Pasa, (Hayatı–Eserleri).
- Kavcar, C. 1995. Batılılaşma Açısından Servet-i Fünun Romanı. Ankara
- Kazıcı, Z. 2003. Osmanlı Devletinde Toplum Yapısı. Stamboll
- Kemal, N.1301/1884. Celâleddin Harzemşah. Stamboll
- Kemal, N. 1880. Cezmi. Ankara
- Kemal, N. 1876. Intibah yahut Sergüzeşt-i Ali Bey. Stamboll
- Kemal, N.1290/1873. Vatan yahut Silistre. Stamboll
- Kenanoğlu, M. M. 2005. Osmanlı Ticaret Hukuku.
- Kerman, Z. 1978. 1862-1910 Yılları Arasında Victor Hugo’dan. Stamboll
- Kılıç, S. 2005. Türk Devrimi ve Fikir Temelleri. Stamboll
- Kılıççelik, S. 2005. Batı Bataklığı. Ankara
- Kısakürek, N. F. 1976. Bâbîâli. Stamboll
- Kısakürek, N.F. 1998. O ve Ben. Stamboll
- Kısakürek, N.F. 2005. Ulu Hakan II. Abdülhamit Han.
- Kuntay, M.C. 1949. Namık Kemal Devrinin İnsanları ve Olayları Arasında. Stamboll
- Kıray, E. 1993. Osmanlı’da Ekonomik Yapı ve Dış Borçlar. Stamboll
- Kızılcıkelik, S. 1996. Açıklamalı Sosyoloji Sözlüğü. İzmir
- Kili, S. 2002. Atatürk Devrimi, Bir Çağdaşlaşma Modeli. Stamboll
- Kocabasoğlu, U. 2004. Modernleşme ve Batıcılık. Stamboll
- Kocatürk, V.M. 1964. Türk Edebiyatı Tarihi, Ayyıldız Matbaası. Ankara
- Koç, M. 2005. Türk Romanında İttihat Terakki (1908-2004). Stamboll
- Koç, M. 2005), Yeni Türk Edebiyatı’nda Boğaziçi ve Boğaziçi Medeniyeti. Stamboll
- Koçak, C. 2004. Yeni Osmanlılar ve Birinci Meşrutiyet: Osmanlı/Türk Siyasi Geleneğinde Modern Bir Toplum Yaratma Projesi Olarak Anayasanın Keşfi. Stamboll
- Koloğlu, O. 2002. Abdülhamit Gerçeği. Stamboll
- Kongar, E. 2004. Toplumsal Değişme Kuramları ve Türkiye Gerçeği. Stamboll
- Kongar, E. 2006. Tarihimize Yüzleşmek. Stamboll
- Koraltürk, M.- Cem Ç. 2005. Türkiye’de Liberal İktisadi Düşünce. Stamboll
- Köksal, Sirma. 2004. Suçlunun Suçu.
- Köktas, M.E. 1993 Türkiye’de Dini Hayat. Stamboll
- Koroğlu, E. 200. Merhaba Ey Muharrir! Ahmet Mithat Üzerine Eleştirel Yazılar. Stamboll
- Köseoğlu, N. 1995. Milli Kültür ve Kimlik. Stamboll
- Kudret, C.1962. Ahmet Mithat. Ankara

- Kudret, C.1987. Türk Edebiyatında Hikaye ve Roman. Stamboll
- Kundera, M. 2002. Roman Sanatı. Stamboll
- Kurdakul, S. 1976. Çağdaş Türk Edebiyatı. Stamboll
- Kurtkan, A. 1976. Genel Sosyoloji. Stamboll
- Kutay, C. 1980. ‘Tarih Ne Zaman İbrettir?’. Stamboll
- Kutlu, S. 1981. Tanzimat Dönemi Türk Edebiyatı Ant. Stamboll
- Küçük, A. 2002. Dinler Tarihi. Ankara
- Küçükboyacı, M. R. 1998. İngiliz Edebiyatında Dedektif Hikayeleri. İzmir
- Leonard, N.G. 1290/1873. Taaşuk-ı Tereze ve Jozeb. Stamboll
- Levend, A.S. 1960. Türk Dilinde Gelişme ve Sadeleşme Evreleri. Ankara.
- Levend, A.S. 1969. Şemseddin Sami. Ankara
- Lewis, B. 1970. Modern Türkiye'nin Doğusu. Ankara
- Lukacs, G. 1985. Roman Kuramı. Stamboll
- Mandel, E. 1996. Hoş Cinayet: Polisiye Romanın Toplumsal Bir Tarihi. Stamboll
- Manisalı, E. 2004. Yeni Dünya Düzeninde Batı ve Türkiye. Stamboll
- Mantran, R. 2002. Osmanlı İmparatorluğu Tarihi II. Isanbul
- Mardin, Ş. 2003. Din Ve İdeoloji. Stamboll
- Mardin, S. 1992. Jön Türklerin Modernleşmesi. Stamboll
- Mardin, S. 1964. Jön Türklerin Siyasi Fikirleri. Ankara
- Mardin, Ş. 1991. Tanzimat'tan Sonra Aşırı Batılılaşma.” Türk Modernleşmesi: Makaleler 4. Stamboll
- Mardin, S. 1985. Tanzimat ve Aydınlar. Stamboll
- Mardin, S. 1996. Türkiye’de Din ve Siyaset. Stamboll
- Mardin, Ş. 2005. Türk Modernleşmesi. Stamboll
- Meriç, C.1992. Bu Ülke. Stamboll
- Meriç, C.1992. Işık Dogudan Gelir. Stamboll
- Meriç, C.2004. Kırk Ambar. Stamboll
- Meriç, C.1992. Jurnal. Stamboll
- Meriç, C.2005. Mağaradakiler. Stamboll
- Meriç, C.1974. Umrândan Uygarlışa. Stamboll
- Moran, B.1989. Edebiyat Kuramları ve Eleştiri. Stamboll
- Moran, B. 2000. Türk Romanına Eleştirel Bir Bakış I. Stamboll
- Mithat, A. 1874. Acâyib-i Âlem. Ankara
- Mithat, A. 2003. Ahbar-ı Asara Tamim-i Enzar. Stamboll
- Mithat, A. 2003. Altın Aşıkları. Ankara
- Mithat, A. 2001. Avrupa Adab-ı Muasereti yahut Alafranga . Ankara
- Mithat, A. 2000. Cellat. Ankara
- Mithat, A. 1884. Çengi-Kafas. Ankara
- Mithat, A. 2005. Demir Bey. Stamboll
- Mithat, A. 2003. Diplomalı Kız. Ankara
- Mithat, A. 2000. Dürdane Hanım. Ankara
- Mithat, A. 1999. Esaret. Ankara
- Mithat, A. 2003. Eski Mektuplar. Ankara
- Mithat, A. 2000. Esrar-i Cinayet. Ankara
- Mithat, A. 1870. Esaret, Letaif-i Rivayat. Stamboll
- Mithat, A. 1994. Fatma Aliye Hanım yahud Bir Muharrire-i Osmaniye'nin Nes'eti. Stamboll
- Mithat, A. 1875. Felatun Bey ile Rakim Efendi. Ankara
- Mithat, A. 1870. Felsefe-i Zenan, Letaif-i Rivayat. Stamboll
- Mithat, A. 2002. Fenni Bir Roman Yahut Amerika Doktorları . Ankara

- Mithat, A. 1870. Firkat, Letaif-i Rivayat. Stamboll
- Mithat, A. 1870. Gençlik, Letaif-i Rivayat. Stamboll
- Mithat, A. 2000. Gönüllü. Ankara
- Mithat, A. 2003 Gürcü Kızı Yahut İntikam. Ankara
- Mithat, A. 2000. Hasan Mellah yahut Sır İçinde Esrar. Ankara
- Mithat, A. 2003. Haydut Montari. Ankara
- Mithat, A. 2000. Hayret. Ankara
- Mithat, A. 2000. Henüz 17 Yasında . Ankara
- Mithat, A. 1875. Hüseyin Fellah. Ankara
- Mithat, A. 2000. Hayret. Ankara
- Mithat, A. 1999. Karı-Koca Masalı. Stamboll
- Mithat, A. 1999. Kari Koca Masalı ve Ahmet Mithat Bibliyografyası. Stamboll
- Mithat, A. 1874. Karnaval. Ankara
- Mithat, A. 2001. Letaif Rivayat. Stamboll
- Mithat, A. 2002. Menfa/Sürgün Hatıraları. Ankara
- Mithat, A. 2003. Mesail-i Muglaka. Ankara
- Mithat, A. 1870. Mihnetkesan, Letaif-i Rivayat. Stamboll
- Mithat, A. 2000. Müşahedat. Ankara
- Mithat, A. 1870. Ölüm Allah'ın Emri. Stamboll
- Mithat, A. 2000. Paris'te Bir Türk . Ankara
- Mithat, A. 2003 Rikalda Yahut Amerika'da Vahşet Alemi. Ankara
- Mithat, A. Süleyman Musuli. Ankara
- Mithat, A. 2000. Taaffüf. Ankara
- Mithat, A. 1870. Teehhül, Letaif-i Rivayat. Stamboll
- Mithat, A. 2004. Üss-inkılap I-II. Stamboll
- Mithat, A. 1874. Vah. Ankara
- Mithat, A. 2000. Yeryüzünde Bir Melek. Ankara
- Mithat, A. 2000. Zeyl-i Hasan Mellah yahut Sır İçinde Esrar. Ankara
- Murat, M.M. 1890. Turfanda mı yoksa Turfa mı. Stamboll
- Naci, F. 2002. "Huzur." "Bir Gül Bu Karanlıklarda": Tanpınar Üzerine Yazılar. Stamboll
- Naci, F. 1997. İnsan Tükenmez. Stamboll
- Naci, F. 1981. 100 Soruda Türkiye'de Roman ve Toplumsal Degisme. Stamboll
- Nazım, N. 1896. Zehra. Ankara
- Necib, A.1290/1874. İdbar ve İkbal. Stamboll
- Niyazi, M. 2001. Medeniyetimizin Analizi ve Geleceği. Stamboll
- Niyazi, M. 2001. Türk Devlet Felsefesi. Stamboll
- Okay, O. 1989. Batı Medeniyeti Karsısında Ahmet Mithat Efendi. Stamboll
- Okay, O. 2005. Batılılaşma Devri Türk Edebiyatı. Stamboll
- Okay, M.O. 1969. Beşir Fuad. Stamboll
- Oktay, A. 1993. Cumhuriyet Dönemi Edebiyatı 1923-1950. Ankara
- Okay, O. 1988. "Edebiyatımızın Batılılaşması Yahut Yenilemesi", Büyük Türk Klasikleri. Stamboll
- Okay, O. 1973. İlk Türk Pozitivisti ve Naturalisti; Besir Fuat. Stamboll
- Okay, O. 1991. Kültür ve Edebiyatımızdan. Ankara
- Oktay, A. 2001. Nevrozdan Psikoza: Aylak Adam'la Anayurt Otelinde Kişiliğin ve Cinsel Kimliğin Oluşumunda Akraların Rolü. Stamboll
- Okay, O. 1990. Sanat ve Edebiyat Yazıları. Stamboll
- Oktay, A. 1993. Türkiye'de Popüler Kültür. Stamboll
- Okay, O. 1990. Yeni Türk Edebiyatı Ders Notları-Tanzimat Edebiyatı. Erzurum



- Ortaylı, İ. 2007. Avrupa ve Biz. Ankara
- Ortaylı, İ. 2004. Gelenekten Geleceğe. Stamboll
- Ortaylı, İ. 1987. İmparatorlugun En Uzun Yüzyılı. Stamboll
- Ortaylı, İ. 2003. İmparatorlugun Sonu – 21. Yüzyılda II. Abdülhamit'e Bakış. Stamboll
- Ortaylı, İ. 2006. Kırk Ambar Sohbetleri. Stamboll
- Ortaylı, İ. 2004. Osmanlı İmparatorlugu'nda İktisadi ve Sosyal Degisim. Ankara
- Ortaylı, İ. 2006. Osmanlı'yı Yeniden Keskfetmek. Stamboll
- Ortaylı, İ. 1986. "Tanzimat Adamı ve Tanzimat Toplumı", Türk Siyasal Hayatının Gelişimi. Stamboll
- Ortaylı, İ. 2004. Tarihin Sınırlarına Yolculuk. Stamboll
- Ortaylı, İ. 2006. Zaman Kaybolmaz. Stamboll
- Oskay, Ünsal. 1991. 'İyi Polisiye Öykülerin Harcanmaması Niçin Gerekiyor?'. Oune, M. de Saint. 1289. Tarih-i Mücmel-i Fransa. Stamboll
- Önertoy, O. 1980. Edebiyatımızda Elestiri Tanzimat ve Servet-i Fünun Dönemleri. Ankara
- Önertoy, O. 1981. Tanzimat Döneminde Edebiyat Anlayısı. Konja
- Özakpınar, Y. 1999. İslam Medeniyeti ve Türk Kültürü. Stamboll
- Özbalcı, M. 1997. Mehmet Raut'un Romanlarında Şahıslar Kadrosu. Stamboll
- Özbilgen, E. 2004. Bütün Yönleriyle Osmanlı. Stamboll
- Özdalga, E- Persson, S. 1999. Sivil Toplum, Demokrasi ve İslam Dünyası. Stamboll
- Özel, İ. 2000. Bilinç Bile İlginç. Stamboll
- Özer, İ. 2005. Avrupa Yolunda Batılasmaya ve Batılılaşma. Stamboll
- Özgüven, F. 1998. 'Neden Polisiye Roman Okuruz?'.
- Özkalp, E. 2001. Sosyolojiye Giriş. Eskişehir
- Özkırmılı, A. 1975. Batılılaşma ve Türk Romanı, Cumhuriyet.
- Özön, M.N.1934. Son Asır Türk Edebiyatı Tarihi. Stamboll
- Özön, M.N.1934. Türkçede Roman. Stamboll
- Öztuna, Y. 2004. Osmanlı Devleti Tarihi – Medeniyet Tarihi 2. Stamboll
- Öztürk, N. 2001. Türk Edebiyatında İnsan. Ankara
- Öztürk, S. 1999. Bilinmeyen Osmanlı. Stamboll
- Pamuk, O. 1999. Öteki Renkler: Seçme Yazılar ve Bir Deneme. Stamboll
- Parla, J. 1993. Babalar ve Ogullar: Tanzimat Romanının Epistemolojik Temelleri. Stamboll
- Parlatır, İ. 1986. Recai-zade Mahmut Ekrem. Ankara
- Parlatır, İ. 1987. Tanzimat Edebiyatında Kölelik. Ankara
- Parlatır, İ. 1988. "Tanzimat Siiri", "Tanzimat Nesri", Büyük Türk Klasikleri. Stamboll
- Parlatır, İ. 1984. Türk Romanında Tipler.
- Parlatır, İ. 1995. Çetin,Nurullah – Sazyek, Hakan, Rezaizade Mahmut Ekrem. Ankara
- Parla, J. 2002. Babalar ve Ogullar, - Tanzimat Romanının Epistemolojik Temelleri. Stamboll
- Parlatır, İ. 1995. Çetin,Nurullah – Sazyek, Hakan, Rezaizade Mahmut Ekrem. Ankara
- Paşa, V. 1991. Akabi Hikayesi (İlk Türkçe Roman). Stamboll
- Paşa, P. 1290/1874. Endülüs Tarihi. Stamboll
- Paşa. N. 1992. Ziya ve Mithat Pasalarla Kemal Bey'in Hayatlarına dair Hatıralar. Stamboll
- Pazarlı, O. 1993. İslam'da Ahlak. Stamboll
- Poe, E.A. Morgue Sokagi Cinayetleri. Stamboll
- Poe, E.A. 2001. Çalınan Mektup. Stamboll

- Rasim, A. 1992. Şehir Mektupları (I. II. III. IV). Stamboll
- Rasony, L. 1996. Tarihte Türklük. Ankara
- Roberts, Th.J. 2005. Okur Çesitliliği. Stamboll
- Rosenthal, M. 1977. Materyalist Felsefe Sözlüğü. Stamboll
- Sakaoğlu, N. 1991. Osmanlı Eğitim Tarihi. Stamboll
- Sami, Ş. 1290/1873. Taaşşuk-ı Talât ve Fıtnat. Stamboll
- Sami, Ş. 1292/1875. Besa yahut Ahde Vefa. Stamboll
- Sami, Ş. 1292/1875. Seydî Yahya. Stamboll
- Sami, Ş. 1293/1876. Gâve. Stamboll
- Sami, Ş. 1296/1879. Medeniyet-i İslâmiyye. Stamboll
- Sami, Ş. 1296 1879. Esâtir. Stamboll
- Sami, Ş. 1296/1879. Kadınlar. Stamboll
- Sami, Ş. 1296/1879. Gök. Stamboll
- Sami, Ş. 1296/1879. Yer. Stamboll
- Sami, Ş. 1296/1879. İnsan. Stamboll
- Sami, Ş. 1296/1879. Emsal. Stamboll
- Sami, Ş. 1300/1883. Letâif. Stamboll
- Sami, Ş. 1302/1885. Hurde-çîn. Stamboll
- Sami, Ş. 1303/1886. Yine İnsan. Stamboll
- Sami, Ş. 1303/1886. Lisan. Stamboll
- Sami, Ş. 1303/1886. Usûl-i Tenkit ve Tertip. Stamboll
- Sami, Ş. 1308/1891. Yeni Usûl Elifbâ-yı Türkî. Stamboll
- Sami, Ş. 1308/1891. Nev Usûl Sarf-ı Türkî. Stamboll
- Sami, Ş. 1317/1889. Bâkî'nin Eş'âr-ı Müntahabesi. Stamboll
- Sami, Ş. 1318/1900. Ali bin Ebi Talib, Eşar-ı Mühtahabat. Stamboll
- Sami, Ş. 1979. Taaşşuk-ı Talât ve Fitnat. Ankara
- Sami, Ş. 1996. Kadınlar. Ankara
- Sami, Ş. 1997. Lisan. Ankara
- Sazyek, H. 2002. Türk Romanında Postmodernist Yöntemler ve Yönelimler.
- Sezai. S. 1889. Sergüzeşt. Ankara
- Sezen, Y. 1990. Sosyolojide Ve Din Sosyolojisinde Temel Bilgiler Ve Tartışmalar. Stamboll
- Sezen, Y. 1988. Sosyolojik Açından Din. Stamboll
- Somay, B. 1998. Çok Basit, Azizim Engels: Bir Tarih Yazımı Metaforu Olarak Polisiye.
- Sönmez, S. 2004. Popüler Edebiyat Okumasının Ötesinde Polisiye Roman.
- Sahin, İ. 2000. Türk Yurdu, Türk Romanı Özel Sayısı.
- Said, E.W. 1995. Kültür ve Emperyalizm. Stamboll
- Said, E.W. 2004. Sarkiyatçılık-Batı'nın Sark Anlayışları. Stamboll
- Safa, P. 1998. Bir Tereddüdün Romanı. Stamboll
- Safa, P. 1976. Doğu-Batı Sentezi. Stamboll
- Safa, P. 1999. Matmazel Noraliya'nın Koltuğu. Stamboll
- Safa, P. 1988. Türk İnkılabına Bakışlar. Ankara
- Sarc, Ö.C. 1999. "Tanzimat ve Sanayimiz", Tanzimat 1. Stamboll
- Sartre, J.P. 1985. Varoluşçuluk ( existantialisme ). Stamboll
- Saydam, A. 2002. Yenileme Döneminde Osmanlı Toplumunu. Ankara
- Saylan, G. 1999. Postmodernizm. Ankara
- Sengel, P. 1991. Hard-boiled ve Casuslar.
- Sevengil, R.A. 1968. Türk Tiyatrosu Tarihi III, Tanzimat Tiyatrosu. Stamboll
- Sevük, İ.H. 1940. Yeni "Edebî Yeniliğimiz". Stamboll

- Sevük, İ.H. 1941. Avrupa Edebiyatı ve Biz. Stamboll
- Sevük, İ.H. 1942. Avrupa Edebiyatı ve Biz. Stamboll
- Sevük, İ. ( pa datë) “Tanzimat Devrinde Hayata Bakış”, Tanzimat Devri Türk Edebiyatı.
- Sevük, İ. 1932. Tanzimat Devri Edebiyatının Umumi Vasıfları. Stamboll
- Simsek, T. 2002. Romandaki Hafiye ya da Polisiye Roman.
- Sisman, A. 2002. Misyonerlik ve Osmanlı Devleti'nin Son Dönemlerinde Kurulan Yabancı Sosyal ve Kültürel Müesseseler. Ankara
- Solok, C.K. 1987. Türk Edebiyatında Hikâye ve Roman Tanzimat'tan Meşrutiyet'e Kadar 1859-1910. Stamboll
- Somay, B. 2001. Bir Garp Mukallidi Züppenin İtirafları.
- Soulie, F. 1295. Şeytanın Yadigârları. Stamboll
- Stael, M. 1997. Edebiyata Dair.
- Stevick, P. 1983. Roman Teorisi. Stamboll
- Subası, T. 2002. Sultan Abdülmecid ve Sultan Abdülaziz. Ankara
- Shaw, S. 2004. Osmanlı İmparatorluğu ve Modern Türkiye. Stamboll
- Şener, S. 1997. Yaşamın Kırılma Noktasında Dram Sanatı. Stamboll
- Şener, S. 1998. Dünden Bugüne Tiyatro Düşüncesi. Ankara
- Şeref, A. 1339/1923. Tarih Musahabeleri. Stamboll
- Tabakoğlu, A. 2002. Yenileşme Dönemi Osmanlı Ekonomisi. Ankara
- Taneri, A. 2004. Türk Devlet Geleneği, Dün – Bugün. Stamboll
- Tanili, S. 2006. Uygarlık Tarihi. Stamboll
- Tanör, B. 2004. Osmanlı-Türk Anayasal Gelismeleri.
- Tansel, F.A. 1965. Namık Kemal'in Hususî Mektupları. Ankara
- Tanpınar, A.H. 1988. 19 uncu Asır Türk Edebiyatı Tarihi. Stamboll
- Tanpınar, A.H. 1956. Asır Türk Edebiyat Tarihi.
- Tanpınar, A.H. 1998. 19uncu Asır Türk Edebiyatı Tarihi. Stamboll
- Taplamacı, M. 1975. Din Sosyolojisi. Ankara
- Taplamacı, M. 1996. Genel Sosyoloji. Ankara
- Tarhan, A.H. 1290/1873. Macerâ-yı Aşk. Stamboll
- Tarhan, A.H. 1292/1875. Duhter-i Hindû. Stamboll
- Tarhan, A.H. 1296/1879. Târik yahut Endülüs Fethi. Stamboll
- Tekin, M. 2001. Roman Sanatı (Romanın Unsurları). Stamboll
- Tevfik, E. 1288/1872. Ecel-i Kaza. Stamboll
- Tevfik, E. 1290. Yeni Osmanlılar Tarihi. Stamboll
- Tevfik, E. 2006. Yeni Osmanlılar İmparatorlugun Son Dönemindeki Genç Türkler. Stamboll
- Timur, T. 1991. Osmanlı - Türk Romanında Tarih, Toplum ve Kimlik. Stamboll
- Timur, T. 1991. Osmanlı Türk Romanında Tarih, Toplum ve Kimlik.
- Todorov, T. 1995. The Typology of Detective Fiction. New York
- Toledono, E.R. 2000. Osmanlı Köle Ticareti. Stamboll
- Topçu, N. 1998), Türkiye'nin Maarif Davası. Stamboll
- Tuncay, H. 1978. Ziya Gökalp. Stamboll
- Tuncer, H. 1992. Arayışlar Devri Türk Edebiyatı - I – Tanzimat Edebiyatı. İzmir
- Tural, S.K. 1993. Edebiyat Bilimine Katkıları. Ankara
- Tural, S. K.- Kerman, Z. - Özgül, M.K. 1987. Hikayeciligimizin 100. Yılında Yüz Örnek. Ankara
- Tural, S. 1999. Semsettin Sami. Stamboll
- Turan, N.S. 2005. Modernleşme Olgusunun Osmanlı Toplum Yasamına Yansımaları ve Ta'addüd-i Zevcat (Çokeslilik) Sorunu. Stamboll

- Turan, G. 2005. 'Nasil, Neden, Kim?'.  
Turhan, M. 1961. 'Garplılaşmanın Neresindeyiz?'. Stamboll  
Turhan, M. 2002. Kültür Degismeleri. Stamboll  
Turhan, M. 1994. Maarifimizin Ana Davaları ve Bazı Hal Çareleri. Stamboll  
Turhan, M. 1972. Garplılaşma'nın Neresindeyiz. Stamboll  
Tümer, G. 2002. Dinler Tarihi. Ankara  
Türkes, A. Ö. 1998. Yeni Polisiye Diziler, Yine Eski Kaliplar.  
Türkdoğan, O. 2004. Milli Kültür, Modernleşme ve İslam. Stamboll  
Türkdoğan, O. 2003. Türk Toplumunda Aydın Sınıfın Anatomisi. Timas  
Türkdoğan, O. 2005. Ulus – Devlet Düşünürü Ziya Gökalp. Stamboll  
Uğur, M. 2000. Avrupa Birliği ve Türkiye. Agora  
Uğurcan, S. 2002. Abdülhak Hâmid Tarhan'ın Eserlerinde Tarih. İzmir.  
Urgan, M.1973. Shakespeare. Stamboll  
Usaklıgıl, H.Z. 1981. Saray ve Ötesi. Stamboll  
Uzunçarsılı, I.H. 1967. Mithat Pasa ve Yıldız Mahkemesi. Ankara  
Ülken, H.Z. 1940. Tanzimattan Sonra Fikir Hareketleri.  
Ülken, H.Z. 2004. Türk Tefekkürü Tarihi. Stamboll  
Ülken, H.Z. 1979. Türkiye'de Çağdas Düşünce Tarihi. Stamboll  
Ünlü, F. 2003. Postmodern Polisiye ve Gizemcilik. Üyepazarcı, E. 2000. Hacı-i Evvel'in Yazdığı ve Pek Bilinmeyen İlginç Sonucuyla İlk Türk Polisiye Roman.  
Ünver, S. 1999. Osmanlı Tebabeti ve Tanzimat Hakkında Yeni Notlar. Stamboll  
Üstel, F. 2005. "Makbul Vatandaş"ın Peşinde: II. Meşrutiyet'ten Bugüne Vatandaşlık Eğitimi. Stamboll  
Üstel, F. 2004. Türkiye Cumhuriyeti'nde Resmî Yurttaş Profiline Evrimi. Stamboll  
Üyepazarcı, E. 1997. Korkmayınız Mr. Sherlock Holmes. Stamboll  
Üyepazarcı, E. 2002. Türkiye'nin İlk Polisiye Roman Yazarı  
Yalçın, H.C. 1975. Edebiyat Anıları. Stamboll  
Yazıcı, N. 2002. Osmanlılık Fikri Ve Genç Osmanlılar Cemiyeti. Ankara  
Yazgıç, K. 1940. Ahmet Mithat Efendi Hayatı ve Hatıraları. Stamboll  
Yazgıç, K. 1940. Ahmet Mithat Efendi- Hayatı Ve Hatıraları. Stamboll  
Yerasimos, S. 2001. Azgelmislik Sürecinde Türkiye II Tanzimat'tan I.Dünya Savaşına. Stamboll  
Yıldırım, E. 1999. Degisen Din Anlayışının Sosyolojisi. Stamboll  
Yılmaz, D. 1990. Roman Kavramı ve Türk Romanının Dogusu. Ankara  
Yöntem, A.C. 1964. Türk Edebiyatı Antolojisi.  
Vahapoglu, M.H. 2005. Osmanlı'dan Günümüze Azınlık ve Yabancı Okullar. Stamboll  
Vahapoglu, M.H. 1977. Roman Kavramı ve Türk Romanı. Ankara  
Zengin, Z.S. 2004. Tanzimat Dönemi Osmanlı Örgün Eğitim Kurumlarında Din Eğitimi ve Öğretimi (1839-1876). Stamboll  
Zürcher, E.J. 2003. Modernleşen Türkiye'nin Tarihi. Stamboll  
Wach, J. 1990. Din Sosyolojisi. Kajseri  
Wilson, E. 2005. İnsanlar Neden Dedektif Romanları Okurlar.  
Wilson, E. 2005. Roger Ackroyd'u Kimin Öldürdüğü Kimin Umrunda. Wright, W.H. 1946. The Great Detective Stories. NewYork  
Wrong, E. M. 1946. Crime and Detection. New York

## B- Artikuj shkencorë

- Abadan, Y. 1940. Tanzimat Fermanının Tahlili, Tanzimati. Stamboll
- Asa, H.E. 1995. Fatma Aliye Hanım. Stamboll
- Arsel, İ. 1974. Devletin haysiyetini ciğneten zihniyet. Ankara
- Asıltürk, B. 1995. Ahmet Mithat Efendi, Türk Dil. Ankara
- Banarlı, N. 1994. Fatma Aliye, Resimli Turk Edebiyatı Tarihi. Stamboll
- Berk, Ö. 2002. Modern Türkiye’de Siyasi Düşünce Modernleşme ve Batıcılık. Stamboll
- Bozdağ, İ. 1990. Tanzimat ve Mustafa Resid Pasa. Stamboll
- Beydilli, K. 1990. 1839 Tanzimat ve 1856 Islahat Fermanları hakkında. Stamboll
- Bayram, M. 1984. Anadolu Bacıları (Bacıyan-ı Rum) Teskilatı”, Tercuman Kadın Ansiklopedisi. Stamboll
- Cosar, O.S. 1974. Turk Kadınının Hak ve Hurriyetleri Konusunda
- Demirel, F. 2005. Müteferrika. Stamboll
- Dumont, P. 2002. Osmanlı İmparatorluğu Tarihi II. Stamboll
- Enginün, I. 1995. Ahmet Mithat Efendi, Türk Dil. Ankara
- Erdinc, E.S. 2000. Osmanlı Dttihat ve Terakki Cemiyeti (Fırkası) Nizamnameleri. Stamboll
- Esen N. – Köroğlu, E. 2006. Merhaba Ey Muharrir. Stamboll
- Esen, N. 2000. Bir Osmanlı Kadın Yazarın Doğusu, Journal of Turkish Studies - Turkluk Bilgisi Araştırmaları.
- Esen, N. 2003. Türk romanının edebi annesinden iki eser: Hos bir tesaduf.
- Esen, N. 1991. Ahmet Mithat Efendi’nin Yapıtlarında Kadın Sorunları, Hürriyet Gösteri Dergisi. Stamboll
- Fındıkoğlu, Z. F. 1955. Ahmed Midhat Efendi, Ahmed Midhat’ı Anıyoruz. Stamboll
- Findley, C. 2000. Ahmet Mithat’ın Sevda-yı Say-ü Amel’i, Tarih ve Toplum. Stamboll
- Gencer, A.İ. 1990. Tanzimat Fermanı’nın ilanı ve tatbiki meselesi. Stamboll
- Gerçek, S.N. 1995. Bir Jübilenin Intibaları: Ahmet Mithat’ı Anıyoruz. Stamboll
- Gökbenli, M. 2000. Ahmet Mithat Efendi ve Osmanlı Türk Kadın Yazarları Fatma Aliye
- Guzel, S. 1985. Tanzimat’tan Cumhuriyet’e toplumsal değişim ve kadın. Stamboll
- Halacoğlu, Y-Aydın, M.A. 1993. Cevdet Pasa. Stamboll
- Hanım ve Sair Fitnat Hanım, Tarih ve Toplum. Stamboll
- Hanıoğlu, S. 1985. Osmanlıcılık, Tanzimattan Cumhuriyete Türkiye Ansiklopedisi. Stamboll
- Hanıoğlu, S. 1985. Türkçülük, Tanzimattan Cumhuriyete Türkiye Ansiklopedisi. Stamboll
- Hanıoğlu, S. 1985. Batıcılık, Tanzimattan Cumhuriyete Türkiye Ansiklopedisi. Stamboll
- Inci, H. 1995. Ahmet Mithat Efendi ve Çocuk Terbiyesi, Türk Dil. Ankara
- Isın, E. 1988. Tanzimat, kadın ve gündelik hayat. Stamboll
- Kara, İ. 1985. Tanzimattan Cumhuriyete İslamcılık Akımları, Tanzimattan Cumhuriyete Türkiye Ansiklopedisi. Stamboll
- Karal, E.Z, 1940. Tanzimattan Evvel Garplılaşma Hareketleri, Tanzimati. Stamboll
- Kehrer, G. 1996. Din Sosyolojisi, Derleyenler. Konya
- Kızıltan, M. 1993. Türk Kadın Hakları Mücadele Tarihinde Fatma Aliye Hanım’ın Yeri.
- Kocu, R.E. 1974. Ahmed Cevdet Pasa’ya dair, Hayat Tarih Mecmuası. Stamboll

- Kodaman, B. 1984. Tanzimat'tan sonra kadın. Stamboll
- Koz, M.S. 2002. Ahmet Mithat Efendi'nin Eserleri, Kitaplık Dergisi
- Kökden, U. 2002. Ahmet Mithat Efendi'nin Büyük Ailesi, Kitap-lık. Stamboll
- Kudret, C. 1086. Ahmet Mithat I, Tarih ve Toplum. Stamboll
- Kuran, E. 1997. Türk çağdaşlaşma tarihinde Tanzimat'ın yeri. Ankara
- Kurnaz, S. 1989. Osmanlı Kadın Dernekleri (1908–1918), Milli Eğitim Dergisi.
- Kurnaz, S. 2007. Emine Semiye ile Nigar Hanım'ın mektuplaşmaları, Turkish Studies /Turkoloji Araştırmaları Dergisi.
- Kurnaz, S. 2007. Emine Semiye'nin gözüyle yüzyıl önce Serez Yaylası'nda Kültür Hayatı, Türk Kültürü ve Hacı Bektaş Veli Araştırma Merkezi Dergisi
- Kutukoğlu, M.S. 1986. Cevdet Pasa ve aile içi munasebetleri. Stamboll
- Mardin, S. 2003. Cumhuriyet'e devreden Düşünce Mirası Tanzimat ve Mesrutiyet'in Birikimi. Stamboll
- Mardin, Ş. 2003. Yeni Osmanlı Düşüncesi, Cumhuriyete Devreden Düşünce Mirası Tanzimat Ve Cumhuriyet Birikimi. Stamboll
- Mardin, Ş. 1985. 19. yy'da Düşünce Akımları Ve Osmanlı Devleti, Tanzimattan Cumhuriyete Türkiye Ansiklopedisi. Stamboll
- Nesin, A. 1985. Namık Kemal'in Siyasal Gülmece Yazıları: Ahmet Mithat'ın Dagarcığı, Tarih ve Toplum. Stamboll
- Okay, O. 2002. Tesebbüse Sarfedilmiş Bir Hayatın Hikayesi, Kitap-lik. Stamboll
- Oner, N. 1989. Ali Sedad", TDV İslam Ansiklopedisi. Stamboll
- Oner, N. 1967. İlim ve mantık anlayışında yenilik hareketleri", Tanzimat'tan Sonra Türkiye'de İlim ve Mantık Anlayışı. Ankara
- Ortaylı, İ. 1985. Tanzimat, Tanzimattan Cumhuriyete Türkiye Ansiklopedisi. Stamboll
- Pamuk, S. 1988. 150. Yılında Balta Limanı Ticaret Antlaşması, Tarih ve Toplum. Stamboll
- Parla, J. 2002. Karnaval Sürüyor, Tarih ve Toplum. İstanbul
- Parla, J. 2003. Tanzimat Edebiyatında Siyasi Fikirler, Cumhuriyete Devreden Düşünce Mirası Tanzimat Ve Mesrutiyet Birikimi. Stamboll
- Parmaksızoğlu, İ. 1976. Mesrutiyet, Türk Ansiklopedis. Ankara
- Somel, S.A. 2003. Osmanlı Reform Çağında Osmanlıcılık Düşüncesi, Cumhuriyete Devreden Düşünce Mirası Tanzimat Ve Mesrutiyet Birikimi. Stamboll
- Sungu, I. 1955. Bir Jübile'nin intiba'ları: Ahmet Midhat'ı Anıyoruz. Stamboll
- Sungu, I. 1955. Ahmet Mithat Efendi'nin Hayatı üzerine, Bir Jübile'nin intiba'ları: Ahmet Midhat'ı Anıyoruz. Stamboll
- Sungu, İ. 1955. İhsan Sungu'nun Konuşması, Ahmed Midhat'ı Anıyoruz. Stamboll
- Sungu, İ. 1940. Tanzimat Ve Yeni Osmanlılar, Tanzimat 1. Stamboll
- Tabakoğlu, A.1990. İktisadi ve sosyal yonlerden Tanzimat. Stamboll
- Tanör, B. 1985. Anayasal Gelismelere Toplu Bir Bakış. Stamboll
- Tasdemirci, E. 2001 "Türk eğitim tarihinde azınlık okulları ve yabancı okular. Kajseri
- Timur, T. 1985. Osmanlı Ve 'Batılılaşma. Stamboll
- Timur, T. 2005. Toplumsal Tarih. Stamboll
- Töre, E. 1955. Ahmet Mithat Efendi'nin Tiyatroları, Türk Dili. Ankara
- Tuncor, F.R. 1969. Emine Semiye. Ankara
- Tuncor, F.R. 1968. Fatma Aliye. Ankara
- Tuncor, F.R. 1966. Kadın yazarlarımız: 2 Fatma Aliye. Ankara
- Turna, N. 2000. Osmanlı İmparatoru'nda Hıristiyan Misyonerlik Faaliyetleri ve Ahmet Mithat Efendi'nin Müdafaa'sı, Tarih ve Toplum. Stamboll

- Uğurcan, S. 1990. Makbule Leman Hayatı, Sahsiyeti, Eserleri”, Turkluk Arastırmaları Dergisi. Stamboll
- Us, H.T. 1955. Hakkı Tarık Us’un Açıs Nutku, Bir Jübile’nin intıba’ları: Ahmet Midhat’ı Anıyoruz. Stamboll
- Van Os, N.A.N.M. 2003. Osmanlı Müslümanlarında Feminizm, Cumhuriyet’e Devreden Düşünce Mirası Tanzimat ve Mesrutiyet’in Birikimi. Stamboll
- Yazgıç, K. 1955. Ahmet Mithat’ın oğlu Kamil Yazgıç’ın Sözleri, Bir Jübile’nin Intıba’ları Ahmet Mithat’ı Anıyoruz. Stamboll
- Yorulmaz, B. 2006. Servet-i Fünun Gözüyle Ahmet Mithat Efendi, Merhaba Ey Muharrir Ahmet Mithat Üzerine Eleştirel Yazılar. Stamboll
- Yuksel, S. 2002. İlk Osmanlı kadın yıllığı: Nevsal-i Nisvan, Kadın/Woman 2000-Kadın Arastırmaları Dergisi/Journal for Woman Studies.
- Yurdakul, N. 2004. Osmanlı Basınında Serbest Piyasa Ekonomisi ve Ahmet Mithat Efendi, Tarih ve Toplum. Stamboll
- Zihnioğlu, Y. 1999. Erken dönem hareket-i nisvanının iki büyük düşünürü: Fatma Aliye ve Emine Semiye.
- Zihnioğlu, Y. 2001. Kadın İnkılabı.

### C- Revista

2000. Hece Dergisi, Türk Öykücülüğü Özel Sayısı
2002. Hece Dergisi, Türk Romanı Özel Sayısı
2000. Türk Yurdu, Türk Romanı Özel Sayısı

### D- INTERNET

- Barlas, M. 2005. Basın Polemiklerinin Bitirmek için Bir Yöntem. <http://www.sabah.com.tr>
- Gaboriau, E. The Mystery of Orcival <http://www.classicreader.com/booktoc.php/sid>.
- Lale, R. Yetim-i Tarih. [http://www.kafder.org.tr/nart.php.yazi\\_id=295](http://www.kafder.org.tr/nart.php.yazi_id=295)
- Yavuz, H. 2001. Anti-Oryantalist bir soykütüğü <http://212.154.21.40/2001/06/01/yazarlar/HilmiYavuz.htm>
- Yavuz, H. 2004. Ahmet Mithat Efendi’nin Üss-i İnkılab’ı ve Avrupa Birliği. <http://www.zaman.com.tr>
- Yavuz, H. 2004. Ahmet Mithat Ziya Gökalp ve Recep Tayip Erdogan I. <http://www.zaman.com.tr>
- Yavuz, H. 2004. Ahmet Mithat Ziya Gökalp ve Recep Tayip Erdogan II. <http://www.zaman.com.tr>
- Yavuz, H. 2004. Üss-i İnkılab ve Modernleşme. <http://www.zaman.com.tr>
- <http://www.sozluk.de> 2007
- <http://www.davetci.com/sozlukler.htm> 2007
- <http://www.tdk.gov.tr/TR/SozBulAyrintili.aspx> 2007
- [http://tr.wikipedia.org/wiki/%C4%B0kinci\\_Me%C5%9Fruhiyet](http://tr.wikipedia.org/wiki/%C4%B0kinci_Me%C5%9Fruhiyet) 2006
- <http://tr.wikipedia.org/wiki/Kremlin> 2007
- [http://tr.wikipedia.org/wiki/Frans%C4%B1z\\_Devrimi](http://tr.wikipedia.org/wiki/Frans%C4%B1z_Devrimi) 2007
- <http://tr.wikipedia.org/wiki/Drahoma> 07.10.2006
- <http://www.dallog.com/kurumlar/darulmuat.htm> 2007
- [http://tr.wikipedia.org/wiki/Robert\\_Kolej](http://tr.wikipedia.org/wiki/Robert_Kolej) 2006
- <http://www.osmanli.org.tr/yazi-377-22.html> 2007
- [http://www.kenthaber.com/Arsiv/Haberler/2006/Mart/04/Haber\\_125567.aspx](http://www.kenthaber.com/Arsiv/Haberler/2006/Mart/04/Haber_125567.aspx) 2000